RAPORT PËRFUNDIMTAR

"AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE"

NË

"DREJTORINË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"
DURRËS

Tiranë, më Mars 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....3
I. 1 Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.....4
I. 2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....4
I. 3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....9

II. HYRJA.....16
II. 1 Objekti i auditimit.....16
II. 2 Qëllimi i auditimit. 16
II. 3 Identifikimi i çështjes.....17
II. 4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 17
II. 5 Përgjegjësitë e audituesve.....18
II. 6 Kriteret e vlerësimit.....18
II. 7 Standardet e auditimit.....19
II. 8 Metodat e auditimit.....19
II. 9 Dokumentimi i auditimit.....20

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....21
III. 1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....21
III. 2 Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.....22
III. 3 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.....22
III. 4 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave 54
III. 5 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....214
III. 6 Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit.....271
III. 7 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit..296
III. 8 Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme 310

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....319

V. ANEKSE.....351

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës), është një institucion i ri, i krijuar me anë të VKM nr. 99, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar". Më parë ka qenë Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës (që mbulonte Rrethin e Durrësit dhe Shijakut), e cila ka patur nën varësi edhe ish-Zyrën e Arsimit Vendor Krujë. Me ndryshimet e mësipërme ligjore, është krijuar DRAP Durrës, institucion i cili është përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e 12 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj: ZVAP Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Durrës, Krujë, Bulqizë, Burrel, Mat, Klos, Dibër. DRAP Durrës menaxhon, mbikëqyr, vlerëson dhe kontrollon institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Pas ndryshimeve në strukturë, aktet ligjore që rregullojnë sistemin arsimor kanë rezultuar të pa harmanizuar, duke shkaktuar konfuzion në kompetencat që DRAP apo ZVAP kanë. Thellimi i linjave të hierarkisë ka rezultuar në mangësi kundrejt monitorimit efektiv të strukturave arsimore me qëllim forcimin e cilësisë së shërbimit arsimor. Riorganizimi i strukturave për arsimin parauniversitar ka qenë një proces i ngadaltë me efekte financiare, problematika në dorëzimin e detyrës, i cili ende nuk ka konkluduar në plotësimin e vakancave dhe emërimin e stafit sipas akteve ligjeve në fuqi, konkretisht 98% e stafit të DRAP Durrës, dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj, vijon të jetë i komanduar, duke nisur që prej Drejtorit të DRAP Durrës e deri tek punonjësit e ZVAP-ve. Janë konstatuar një numër i lartë vakancash në stafin e 12 ZVAP-eve dhe DRAP Durrës (deri në përfundim të periudhës objekt auditimi vakancat rezultojnë në masën 21%) ku në disa raste ato kanë vijuar të tilla për periudha kohore të gjata, duke cënuar vijueshmërinë e punës në këto institucione. dhe përbëjnë risk për realizimin e objektivave. Problematika janë konstatuar në procesin e përzgjedhjes së drejtuesve të IPAP, hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për 12 Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (Bulqizë, Dibër, Durrës, Kamëz, Kavajë, Klos, Krujë, Mat, Rrogozhinë, Shijak, Tiranë dhe Vorë) në varësi të saj, apo moskryerjen e procedurave të prokurimit të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit, në kundërshtim me aktet ligjore. Vendosja e kritereve të pa realizueshëm në përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore, si ai i certifikatës së shkollës së drejtorëve, ka shkaktuar që ky proces të shoqërohet me problematika të shumta. Referuar kuotave të publikuara nga shkolla e drejtorëve, nëse të gjithë kandidatët e pranuar do të ishin nga DRAP Durrës (e cila është vetëm 1 në 4 DRAP), kualifikimi i plotë i të gjithë stafit drejtues arsimor nuk mund të arrihej deri të paktën në vitin 2024. Konstatohen një numër i konsiderueshëm drejtuesish të komanduar në institucionet arsimore publike (78 nga 301 raste në 6 ZVAP-et që u shqyrtuan nga KLSH), ku në disa raste komandimi është kryer në periudha të hershme, dhe në disa të tjera është kryer kohët e fundit, por për shkak të mos plotësimit të kritereve të udhëzimit nga kandidatët, nuk është vijuar me procedurat e konkurrimit për pozicionet respektive, duke i lënë kështu mundësinë punonjësve aktual të vijojnë të komanduar. Shpenzimet jo efektive për buxhetin e shtetit kanë rezultuar në totalin prej 29,706,597 lekë, si rezultat i vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve, nga të cilat për periudhën objekt auditimi është ekzekutuar vlera prej 14,088,075 lekë dhe 15,618,522 lekë përbëjnë detyrime të prapambetura për tu paguar nga ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës në periudhat në vijim. Këto detyrime rezultojnë të mos jenë njohur nga institucionet respektive si detyrime të prapambetura dhe shpenzime për periudha të ardhshme. Informacioni i vendosur në dispozicion fillimisht për grupin e auditimit i pasqyronte këto shpenzime në vlerë 21,111,374 lekë, pra rreth 8,595 mijë lekë më pak se fakti që rezultoi pas verifikimit të grupit të auditimit në 6 ZVAP. Në Raportin e Monitorimit 8 Mujor të MASR për vitin 2020, lidhur me detyrimet e krijuara rishtaz si rezultat i

vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, janë pasqyruar vetëm vendimet e pa ekzekutuara të ZVAP Dibër në vlerë totale 10.1 milion lekë, të cilat nga verifikimi në subjektin audituar rezultojnë në vlerën 10.4 milion lekë. Në raportin e monitorimit të MASR nuk janë pasqyruar detyrimet e krijuara si rezultat i vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara për ZVAP Durrës në vlerë totale 2,663 mijë lekë, ZVAP Tiranë në vlerë totale 901 mijë lekë, ZVAP Kavajë në vlerë totale 901 mijë lekë, ZVAP Bulqizë në vlerë totale 734 mijë lekë.

I.1.Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Grupi i auditimit ka zhvilluar auditim në Drejtorinë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, si dhe ka përzgjedhur disa zyra arsimore për shqyrtim të mëtejshëm, si Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare Tiranë, Shijak, Durrës, Kavajë, Mat, Bulqizë dhe Dibër, duke shqyrtuar procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore, shpenzimet për largimin e padrejtë të ish punonjësve, prokurimet e kryera, shpenzimet e transportit dhe hartimin e pasqyrave financiare. Në DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë është audituar edhe planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit, si dhe efektiviteti i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në përfundim të auditimit janë hartuar akt konstatimet mbi gjetjet e identifikuara, si dhe letrat e punës.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR		PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI	**1**	VKM nr. 99, datë 27.02.2019 në kundërshtim me ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar.	**59-218**	**E Lartë**	DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP të bëjnë propozimet e nevojshme ligjore pranë MASR, dhe ngritjen e grupit të punës.
	2	Problematika në udhëzimin nr.2 lidhur me shqyrtimin e dosjeve nga komisioni.	**59-218**	**E Lartë**	DRAP në bashkëpunim me DPAP të propozojnë pranë MASR, rishikimin e Udhëzimit nr. 2.
MASA ORGANIZATIVE	**1**	98% e stafit të DRAP dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj vijon të jetë i komanduar. **Në 6 ZVAP** me 285 institucione arsimore nën juridiksionin e tyre, aktualisht **janë të komanduar 78 drejtues (27%)**,	**59-218**	**E lartë**	Ministri i MASR, Drejtori i DRAP Durrës, DPAP të ndërmarrin masat e nevojshme për emërimin definitive të punonjësve të DRAP, ZVAP dhe IPAP nëpërmjet procedurave të hapura të konkurimit.
	2	Pas ristrukturimit, drejtori i ish- DAR Durrës nuk ka bërë dorëzim të detyrës në momentin e lirimit nga detyra. Në procedurat e marra në shqyrtim nga grupi i auditimit për emërimin definitiv nëpërmjet konkurrimit të hapur të drejtorëve të dy shkollave, **nuk gjenden dosjet** e procedurës së ndjekur nga ish-DAR Durrës për përzgjedhjen	**59-218**	**E lartë**	Të identifikohen dokumentacionit dhe mjeteve që kanë qenë në përdorim nga ish-DAR Durrës dhe ish-DAR-et e tjera, dhe tani janë në përdorimin të ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës. DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për mosdorëzimin e detyrës nga Ish- DAR

		dhe emërimin e tyre.			Durrës
	3	ZVAP Durrës, Dibër dhe Bulqizë nuk kanë një faqe zyrtare web dhe këto ZVAP-e **nuk** kanë publikuar Shpalljet për vendet e lira në pozicionin drejtor shkolle në faqe zyrtare.	**59-218**	**E mesme**	DRAP Durrës të parashikojë buxhetin për të ngritur faqet web të këtyre ZVAP-ve, dhe të marrin masat për kryerjen e publikimit të shpalljeve.
	4	Nga auditimi janë konstatuar problematika në procedurat e konkurimit të drejtuesve të IPAP nga DRAP dhe DPAP lidhur me përfaqësuesit e tyre.	**59-218**	**E lartë**	DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës, të marrin masat e nevojshme për të përcaktuar përfaqësues në të gjitha procedurat e konkurrimit për vendet e lira në pozicion drejtori shkolle.
	5	Nga auditimi janë konstatuar problematika në procedurat e konkurimit të drejtuesve të IPAP nga DRAP.	**59-218**	**E mesme**	DRAP të respektojë afatet, me qëllim garantimin e finalizimit të procesit të përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve arsimore dhe përcjelljen e informacioneve të azhornuara mbi vendimmarrjen e DRAP.
	6	Komisionet e vlerësimit dhe DRAP kanë pranuar dhe kanë shpallur fitues kandidatë të cilët nuk ishin të pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve. Nga auditimi rezulton se, Komisionet e Vlerësimit dhe DRAP Durrës e kanë trajtuar vërtetimin e lëshuar nga IZHA **si të barazvlefshëm** me certifikatën e lëshuar nga Shkolla e Drejtorëve.	**59-218**	**E lartë**	Të hartohen dhe publikohen shpalljet e pozicioneve të lira të drejtuesve të IPAP në mënyrë që kriteret e kërkuara në shpallje të ndiqen edhe në procedurat e konkurrimit për këto pozicione.
	7	Nga auditimi u konstatuan procedura jo të sakta të ndjekura nga ZVAP në procedurat e konkurimit për pozicionin e drejtorit të IPAP.	**59-218**	**E lartë**	Të merren masat që çdo dokument të ketë të gjithë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor; për vërtetimet për masa disiplinore institucionet të mos tejkalojnë kompetencat e tyre,
	8	Problematika të konstatuara nga komisioni i vlerësimit.	**59-218**	**E lartë**	Të analizohet përbërja e komisionit të vlerësimit dhe të propozohen në MASR masat e nevojshme për të siguruar vlerësimin e kandidatëve për pozicionet e lira

					drejtor shkolle nga komisionet e vlerësimit, në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi.
	9	Drejtimi i ankesave pranë një komisioni ad hoc i cili ngrihet për një procedurë të caktuar, dhe nuk ka një adresë të përcaktuar, nuk siguron trajtimin e tyre.	**59-218**	**E lartë**	Të përcaktohet qartë në shpallje procedura dhe adresa për drejtimin e ankesave ndaj Komisionit të Vlerësimit, me qëllim sigurimin e përcjelljes dhe trajtimin e tyre.
	10	Dosjet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollave janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuar.	**59-218**	**E lartë**	Të unifikohen procedurat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacioneve të procedurave për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore,sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.
	11	Rezultoi se ekzistojnë diferenca mes kërkesave buxhetore të DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë në planifikimin e kryer për fonde sipas PBA-së, krahasuar me fondet e miratuara.	**27-58**	**E mesme**	Të masat për hartimin e dokumentit të projektbuxhetit për periudhat e ardhshme në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ.
	12	Planifikimi i dobët i buxhetit, rialokime të shpeshta të fondeve, me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.	**27-58**	**E mesme**	Të kryhet një planifikim për fonde në përputhje me objektivat institucional, me qëllim shmangien e rishpërndarjeve të shpeshta të fondeve që nuk realizohen deri në fund të vitit, për të sjellë artificialisht planifikimin e tyre, në nivelet e zbatimit.
	13	Problematika në raportet e monitorimit të buxhetit.	**27-58**	**E mesme**	Të hartohen raportet e monitorimit periodike në përputhje me kërkesat e formatit standard; të merren masat për publikimin e raporteve të monitorimit të buxhetit ; të kryejnë saktë detajimin e fondeve buxhetore të lidhura me to, në nivel programi dhe produkti.
	14	Fondet buxhetore nuk akordohen në të njëjtat produkte nga viti në vit, duke mos lejuar kështu edhe analizat krahasimore për përdorimin e tyre.	**27-58**	**E mesme**	DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, të marrin masat për kryerjen e planifikimit të fondeve në nivel produkti, të kryejnë shpenzimet për mallra dhe shërbime në qëllim të

					produkteve për të cilat janë alokuar fondet.
	15	DRAP Durrës ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe manualit të MFK-së, por megjithatë nëse i referohemi zbatueshmërisë së tyre në praktikë, konstatohet se ka vend për përmirësim.	**302-316**	**E mesme**	Titullari i DRAP Durrës, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar në këtë raport.
	16	Nga verifikimi i masave të ndërmarrja nga ZVAP Tiranë për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm dhe përgjegjshmërinë menaxheriale të titullarit të institucionit, rezultojnë të jenë kryer me mangësi detyrimet lidhur me MFK.	**302-316**	**E mesme**	Titullari i ZVAP Tiranë, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar në këtë raport, për të përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të institucionit, dhe monitorimin e risqeve.
	17	Regjistri i aktiveve nuk mbahet i plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme sipas formatit të Udhëzimit nr. 30; Problematika të konstatuara mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.	**219-275**	**E lartë**	Të marrin masat për vlerësimin e materialeve me vlerë 2,423,239 lekë, dhe pasqyrimin e këtyre veprimeve në Pasqyrat Financiare të vitit 2020
	18	U konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave.	**219-275**	**E lartë**	Të merren masat e menjëhershme për gjetjen, inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga këto njësi, për të cilat nga auditimi rezultuan se nuk disponoheshin nga këto institucione. 6
	19	DRAP Durrës, edhe pse ka nën varësinë e tij 12 ZVAP e mësipërme, ka hartuar pasqyra financiare **vetëm** për këtë institucionin, pa përfshirë në to informacionin financiar të 12 njësive të varësisë. Për llogarinë "423,429 - Personeli, paradhënie, deficite, gjoba", në vlerën **3,225,429 lekë**, që përfaqëson detyrime të të tretëve ndaj ZVAP Dibër	**276-301**	**E lartë**	Nga Drejtori i DRAP Durrës, të merren masa për kryerjen e konsolidimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2019, për drejtorinë e DRAP Durrës dhe 12 ZVAP nën varësinë e saj, me qëllim përcaktimin e pozicionit financiar të këtij institucioni. Nga Drejtori i ZVAP Dibër, të kërkohet në

		nuk janë marrë masa për arkëtimin e këtyre vlerave			mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 3,225,429 lekë.
	20	DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës), nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar prej 20 ditësh dhe 6 muajsh, për informimin e KLSH mbi programin për realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.	**316-324**	**E mesme**	Drejtori i DRAP Durrës dhe Drejtori i ZVAP Durrës, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.
MASA PËR SHPËRBLIM DËMI	**1**	Në ZVAP Bulqizë, janë konstatuar mungesa në inventar, mungesa të cilat janë pajisje kompjuterike të ish-punonjësve të cilët janë larguar në shumën **247,178 lekë**, përbën **dëm ekonomik** për llogari të buxhetit të shtetit.	**219-275**	**E lartë**	Nga Drejtori i ZVAP Bulqizë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **247,178 lekë**.
MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.	**1**	Janë kryer pagesat drejtpërdrejtë në kundërshtim me kërkesat ligjore e këtyre shpenzimeve, ka shkaktuar **përdorim pa eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet** të fondeve publike me vlerë **157,423,324 lekë**.	**219-275**	**E lartë**	Nga Drejtori i DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP nën varësi, të marrin masat e menjëhershme për fillimin e procedurave të prokurimit me objekt "Transport mësuesish dhe nxënësish për vitin 2021", me qëllim parandalimin e kryerjes së këtyre shpenzimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë.
	2	Në procedurën e prokurimit, me fond limit 2,636,566 lekë, u konstatua se nga përllogaritja e fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914, duke i shkaktuar **efekt financiar negativ në vlerën 316,388 lekë**.	**219-275**	**E lartë**	2.1 Drejtori i ZVAP Tiranë, të shqyrtojë vlerën 316,388 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në përllogaritjen e vlerës së kontratës të procedurës të prokurimit.
	3	OE A. SHPK, nuk i ka realizuar shërbimet brenda afateve të përcaktuara në kontratë.	**219-275**	**E lartë**	Nga Drejtori i DRAP Durrës, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **32,738 lekë**, nga OE A. SHPK, për kryerjen e vonuar të shërbimeve

	4	Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit në vlerë **29,706,597 lekë**, si rezultat i vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve.	**59-218**	**E lartë**	Të analizohen dhe ekzekutohen vendimeve gjyqësore, prej **29,706,597 lekë,** si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, pasi u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna.
	5	**82 punonjës të liruar nga shërbimi civil** kanë qenë përfitues të pagesës për dëmshpërblim në vlerë totale **28,148,574 lekë**.	**59-218**	**E lartë**	

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Në përfundim të auditimit të zhvilluar nga grupi i auditimit të KLSH, rezultoi se megjithëse linjat hierarkike institucionale janë thelluar, duke zgjeruar vertikalisht strukturat pas krijimit të DPAP, DRAP dhe ZVAP, nuk është siguruar orientimi, monitorimi dhe shqyrtimi efektiv i aktivitetit të strukturave vendimmarrëse në zbatim të misionit për ofrimin dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar. Pas riorganizimit të njësive përgjegjëse për arsimin parauniversitar, me VKM nr. 99 datë 27.02.2019 është krijuar **Drejtoria e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar**, nën varësinë e të cilës janë **4 Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar**, përkatësisht **DRAP Durrës, Fier, Lezhe dhe Korçë.** Këto drejtori, kanë në varësinë e tyre **Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar**. Nën juridiksionin e DRAP Durrës është përcaktuar të jenë ZVAP Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Durrës, Krujë, Bulqizë, Burrel, Mat, Klos, Dibër. Ky organizim i ri ka bërë edhe një shpërndarje të re të kompetencave dhe varësisë, duke kaluar një pjesë të konsiderueshme të tyre nga Zyrat Vendore Arsimore (ish DAR-et), në Drejtorinë Rajonale Arsimore Vendore. Procesi i përzgjedhjes së drejtuesve të IPAP, është cënuar si rezultat i mos analizimit të zbatueshmërisë së kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët për drejtor, si dhe nga një planifikim i dobët, i cili nuk ka siguruar zbatimin e akteve nënligjore mbi pjesëmarrësit në mbledhjet e komisionit. Për shkak se dokumentacionet e procedurave të konkurrimit nuk përmbajnë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, nuk garantohet siguri dhe vërtetësi lidhur me proceset e kryera.

-Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, nuk ka hartuar pasqyra financiare të konsoliduara më 31.12.2019, për 12 Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (Bulqizë, Dibër, Durrës, Kamëz, Kavajë, Klos, Krujë, Mat, Rrogozhinë, Shijak, Tiranë dhe Vorë) në varësi të saj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 120, e cila përcakton që: "*Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor të mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*". Si pasojë e mos-hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara, nuk morëm dot siguri për zëra të rëndësishëm si; pozicioni financiar më 31.12.2019, Aktivet e DRAP Durrës, Llogaritë e Arkëtueshme, Llogaritë e Pagueshme, Performanca Financiare në nivel të konsoliduar, etj. Nga auditimi i llogarive vjetore të institucionit, konstatohet se më datë 31.12.2019, nuk disponohet asnjë informacion dhe dokumentacion kontabël justifikues, në lidhje me:

-Për 4 raste (ZVAP Durrës, Bulqizë, Dibër dhe Mat), për zërin "212 Ndërtesa e konstruksione", për vlerën totale 18,157,999 lekë.

-ZVAP Durrës, për llogarinë "437 Organizma të tjerë shtetërorë" në vlerën 51,095 lekë dhe

llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 252,120 lekë.
-ZVAP Shijak, për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 8,403,460 lekë.
-ZVAP Tiranë, për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 510,158 lekë.
-ZVAP Dibër, për llogarinë "468 - Debitorë të ndryshëm" me vlerë 58,108,800 lekë.
-ZVAP Dibër, për llogarinë "202 Studime dhe kërkime" me vlerë 2,354,091 lekë.
- Për 5 raste (ZVAP Tiranë, Durrës, Kavajë, Dibër dhe Mat), më 31.12.2019, nuk kanë paraqitur në llogarinë "467-Kreditorë të ndryshëm", detyrimet në vlerën 9,751,520 lekë, për vendimet gjyqësore që i kanë mbërritur në institucion para datës së hartimit të këtyre pasqyrave, por që janë paguar përgjatë vitit 2020.
- Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 8,293,975 lekë, që përfaqëson ndërtesën e institucionit të ZVAP Kavajë, për të cilën nuk janë marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saj pranë zyrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- ZVAP Tiranë, për llogarinë "202 Studime dhe kërkime", nën kategorinë e "Aktive afatgjata jomateriale", vlera e vitit paraardhës është 3,467,346 lekë, ndërsa vlera e vitit ushtrimor 2019 është 0 (zero) lekë. Nga auditimi i pasqyrës "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a)" dhe "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b)", pjesë e pasqyrave financiare, për këtë llogari nuk ka pakësime në vlerë. Për pasojë, ZVAP Tiranë e ka fshirë nga pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019, vlerën 3,467,346 lekë, pa evidencat mbështetëse dhe dokumente justifikuese.
- Nga ZVAP Dibër, për llogarinë "423,429 - Personeli, paradhënie, deficite, gjoba", në vlerën 3,225,429 lekë, përfaqëson detyrime të të tretëve ndaj ZVAP Dibër (ish-DAR Dibër), sipas listës prej 28 debitorësh.
- ZVAP Shijak ka paraqitur në PF e vitit 2019, zërin "3. Llogari të arkëtueshme" me vlerë 15,313,876 lekë, po pa e detajuar se nga çfarë zërash përbëhet kjo llogari.
-Riorganizimi i strukturave për arsimin parauniversitar ka qenë një proces i ngadaltë me efekte financiare, problematika në dorëzimin e detyrës, i cili ende nuk ka konkluduar në plotësimin e vakancave dhe emërimin e stafit sipas akteve ligjeve në fuqi (konkretisht 98% e stafit të DRAP Durrës, dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj, vijon të jetë i komanduar, duke nisur që prej Drejtorit të DRAP Durrës e deri tek punonjësit e ZVAP-ve).
-Nga auditimi konstatohet një numër i lartë vakancash në stafin e 12 ZVAP-eve dhe DRAP Durrës (deri në përfundim të periudhës objekt auditimi vakancat rezultojnë në masën 21%) ku në disa raste ato kanë vijuar të tilla për periudha kohore të gjata, duke cënuar vijueshmërinë e punës në këto institucione. dhe përbëjnë risk për realizimin e objektivave.
-Pas ristrukturimit të strukturave përgjegjëse për ofrimin dhe sigurimin e arsimit cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, në kundërshtim me VKM nr. 124, datë 17.02.2016, drejtori i ish- DAR Durrës nuk ka bërë dorëzim të detyrës në momentin e lirimit nga detyra. Një ndër efektet e evidentuar si rezultat i kësaj shkeljeje, është **mungesa e dy dosjeve** të procedurave për emërimin definitiv nëpërmjet konkurrimit të hapur nga **ish-DAR Durrës** për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve të dy shkollave: Adem Sabli dhe Isa Domi, sot nën juridiksionin e **ZVAP Shijak.**
-Pas ristrukturimit, 82 punonjës të institucioneve tanimë nën juridiksionin e DRAP Durrës të liruar nga shërbimi civil, kanë qenë përfitues të pagesës për dëmshpërblim në vlerë totale **28,148,574 lekë**. Këta punonjës janë komanduar menjëherë në ZVAP-të në juridiksionin e DRAP Durrës, ose në DRAP.
-Nga auditimi rezulton së **VKM nr. 99, datë 27.02.2019** dhe **Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020**, i ndryshuar **janë hartuar në kundërshtim** me **Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2018**, për shkak të **përcaktimeve të ndryshme** mbi **autoritetin përgjegjës për emërimin e drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar**, ku më hollësisht sipas Ligjit është titullari i njësisë arsimore vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), dhe sipas VKM-së dhe Udhëzimit nr.2, është autoritet i Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniveritar (DRAP). Si rezultat,

procedurat e ndjekura nga DRAP Durrës për komandimin e përkohshëm të drejtuesve arsimore (rreth 50 procedura), gjatë periudhës 2019-2020 pas daljes së VKM-së nr.99, si dhe procedurat e iniciuara për konkurimin dhe emërimin e drejtuesve të institucioneve arsimore (69 procedura sipas shpalljes nr.1,2, dhe 3) **rezultojnë në kundërshtim me Ligjin nr. 69/2012.**

-Nga auditimi konstatohet se sipas **nenit 55 të ligjit nr. 69/2012**, i ndryshuar, dhe **Udhëzimit nr. 2, 28.01.2020**, i ndryshuar, kandidati për drejtorë duhet **të ketë kryer trajnim dhe të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve**. Në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ligj dhe udhëzim, DPAP me shkresën nr. 246 datë 30.07.2020 ka udhëzuar se **të pasurit certifikatë apo të qenit i regjistruar në Shkollën e Drejtorëve konsiderohet prioritet dhe jo më një kriter i domosdoshëm kualifikues për vijimin e konkurrimit**. Referuar kuotave të publikuara nga shkolla e drejtorëve, nëse të gjithë kandidatët e pranuar do të ishin nga DRAP Durrës (e cila është vetëm 1 në 4 DRAP), kualifikimi i plotë i të gjithë stafit drejtues arsimor nuk mund të arrihej deri **të paktën në vitin 2024**.Gjithashtu, sipas procedurave të ndjekura, trajnimi i zhvilluar nga IZHA, është konsideruar i barazvlefshëm me Shkollën e Drejtorave, edhe pse ky trajnim nuk është i parashikuar në kriteret e ligjit për arsimit, apo udhëzimit nr.2. Fillimisht, pas daljes së udhëzimit nr.2, diispozitat e fundit, Kreu III, pika. 1 ishte parashikuar se "*Në rast **mungese të aplikimeve nga kandidatët të pajisur me certifikatë nga shkolla e drejtoreve**, apo që kanë përfunduar programin e trajnimit të drejtoreve, zhvilluar nga **Instituti i Zhvillimit të Arsimit** në vitin 2016, për pozicionet e lira drejtor ne IPAP, aplikojnë dhe emërohen kandidatë të cilët plotësojnë kriteret sipas pikave "a", "b" dhe "c" të pikës 1, të shkronjës "B" të Kreut I të këtij udhëzimi."* Megjithatë kjo pikë e udhëzimit **ka ndryshuar dhe aktualisht është shfuqizuar** me Udhëzimin Nr. 7, datë 19.03.2020.

Shpallja nr. 1, 2 dhe 3 ka përcaktuar kriteret në përputhje me ligjin dhe udhëzimin nr.2, në një kohë ku vendimmarrja e komisioneve të vlerësimit, ZVAP dhe DRAP është kryer në vijim të përcaktimeve të DPAP (pra në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin nr.2), duke u konsideruar i **mjaftueshëm për kualifikimin e kandidatëve vetëm aplikimi në shkollën e drejtorave, apo trajnimi i zhvilluar nga IZHA, duke krijuar kushte jo të barabarta konkurrimi, si dhe duke cënuar parimin e transparencës.**

Si rezultat, DRAP Durrës ka intervistuar dhe ka shpallur fitues kandidatë të cilët **vetëm kanë aplikuar, ose ishin regjistrua**r në Shkollën e Drejtorëve **dhe nuk ishin certifikuar prej saj**; apo kishin paraqitur **certifikatën trajnimit të IZHA**.

-Nga auditimi konstatohet se afatet e përcaktuara në Shpalljen nr.1 dhe 2 për kryerjen e vlerësimit të kandidatëve për drejtues institucionesh arsimore, e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen në to të një përfaqësuesi të DRAP apo DPAP pasi rezulton se **me 34 punonjës në total të DPAP dhe DRAP Durrës** do të ishte e pamundur përfaqësimi i këtyre institucioneve në **32 konkurse** të cilat do të zhvilloheshin njëherazi sipas shpalljes 1 dhe **37 konkurse** të cilat do të zhvilloheshin njëherazi. Si rezultat në **69** konkurset e hapura për vendet e lira drejtor shkollë, kanë marr pjesë **11** përfaqësues të DRAP Durrës nga të cilët vetëm **7 prej tyre ka patur kanë qenë punonjës të strukturës së DRAP Durrës. Vetëm** 2 prej tyre kanë mbajtur procesverbal mbi mbarëvajtjen e procesit.

-Nga auditimi u konstatuan procedura jo të sakta të ndjekura nga DRAP Durrës në procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtor shkolle, ku përmendim mos respektim afati për intervistimin dhe vlerësimin final të komisionit, pasi vendimi i DRAP në disa raste është shpallur me vonesë, dhe në disa të tjera deri në përfundim të auditimit nuk janë intervistuar kandidatët për t'u përzgjedhur fituesi në tejkalim të çdo afati; mungesë standardizimi në marrjen e masave për rastet kur komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2.

-DRAP Durrës ka komanduar drejtore në shkollën "Hasan Prishtina", në datën 24.01.2020, një kandidate me masë disiplinore në fuqi, **në kundërshtim me** kriteret e udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013, Kreu I, çështja B, pika ç e cila citon se "*Kandidati për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet: ç) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij*. Znj. T.D. është shkarkuar nga detyra po nga DRAP Durrës në 24.12.2019 për shkelje flagrante të udhëzimit të

MASR, **dhe aktualisht disponon një masë disiplinore**, sikundër përcakton vërtetimi i DRAP Durrës i datës 20.08.2020

-Nga auditimi janë konstatuar procedura jo të sakta të ndjekura nga ZVAP në procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtor shkolle, ku ndër problematikat e identifikuara përmendim mos respektim afati për përcjelljen e kandidatëve me pikë maksimale pranë DRAP për intervistën finale, mangësi në njohjen e procedurave që ZVAP duhet të ndjeke për shqyrtimin e dosjeve të komisionit të vlerësimit dhe mos dokumentim të këtij procesi, analizim të vendimmarrjes së komisionit me standarde të ndryshme, lëshim të dëshmive për masa disiplinore nga ZVAP në tejkalim të kompetencave.

- Komisionet e vlerësimit të kandidatëve për drejtues kanë shfaqur **mangësi** në njohjen e bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe shpesh herë kanë vlerësuar në mënyrë jo të drejtë kandidatët. Në problematikat e konstatuara përfshihen skualifikim i menjëhershëm i kandidateve me mungesa pa respektuar afatin 3 ditor për plotësimin me dokumentacion, intervistimi i kandidatëve në të njëjtën ditë me vlerësimin e dosjeve, mos dokumentim i njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, parregullsi në procesverbalet e mbajtura nga komisioni për vlerësimin e kandidatëve, ndryshim të anëtarëve të komisionit pa njoftuar ZVAP, korrigjim të të dhënave të dokumentacioneve, etj.

-Procedurat e udhëzimit nr. 2 lidhur me ankimimet e kandidatëve përcaktojnë drejtimin e ankesave pranë komisionit të vlerësimit, i cili komisioni ad hoc i cili ngrihet për një procedurë të caktuar, dhe nuk ka një adresë të përcaktuar, nuk siguron trajtimin e tyre.

-ZVAP Durrës, Dibër dhe Bulqizë nuk kanë një faqe zyrtare web në kundërshtim me kuadrin rregullator. Mungesa e aplikantëve ka anulluar **6 nga 11** konkurrimet e hapura për pozicionin drejtor shkolle në ZVAP Dibër, **5 nga 9** në ZVAP Durrës dhe **2 nga 3** në ZVAP Bulqizë.

- Konstatohen mangësi në përbërjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacioneve të dosjeve të kandidatëve, si dhe mos protokollim i të gjithë dokumenteve pjesë të tyre, çka nuk krijon siguri për vërtetësinë dhe saktësinë e dosjeve të vlerësimit.

-Konstatohet një numër i konsiderueshëm drejtuesish të komanduar në institucionet arsimore publike (**78 nga 301 raste** në 6 ZVAP-et që u shqyrtuan nga KLSH), ku në disa raste komandimi është kryer në periudha të hershme, dhe në disa të tjera është kryer kohët e fundit por për shkak të mos plotësimit të kritereve të udhëzimit nga kandidatët, nuk është vijuar me procedurat e konkurrimit për pozicionet respektive, duke i lënë kështu mundësinë punonjësve aktual të vijojnë të komanduar.

-Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, në lidhje me shpenzimet e transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, të 7 njësitë e audituara (ZVAP Tiranë,. Durrës, Shijak, Kavajë, Mat, Dibër dhe Bulqizë), nuk kanë kryer procedurat e prokurimit të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit, në kundërshtim me aktet e mësipërme ligjore, duke shkaktuar përdorim pa eficiencë, ekonomicitet në kundërshtim me aktet e mësipërme ligjore, mbart riskun e përdorimit pa eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve publike me vlerë **157,423,324 lekë.**

-Nga auditimi u konstatuan **shpenzime jo efektive për buxhetin e shtetit në total 29,706,597 lekë**, si rezultat i vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve, nga të cilat për periudhën objekt auditimi është ekzekutuar vlera prej 14,088,075 lekë dhe 15,618,522 lekë përbëjnë detyrime të prapambetura për tu paguar nga ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës në periudhat në vijim. Këto detyrime rezultojnë të mos jenë njohur nga institucionet respektive si detyrime të prapambetura dhe shpenzime për periudha të ardhshme.

Informacioni i vendosur në dispozicion fillimisht për grupin e auditimit i pasqyronte këto shpenzime në vlerë 21,111,374 lekë, **pra rreth 8,595 mijë lekë më pak se fakti që rezultoi pas verifikimit të grupit të auditimit në 6 ZVAP.**

-Nga auditimi konstatohet se në *Raportin e Monitorimit 8 Mujor të MASR për vitin 2020,* lidhur me detyrimet e krijuara rishtaz si rezultat i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shkak të

mungesës së fondeve buxhetore, janë pasqyruar **vetëm** vendimet e pa ekzekutuara të ZVAP Dibër në vlerë totale 10.1 milion lekë, të cilat nga verifikimi në subjektin audituar rezultojnë në vlerën 10.4 milion lekë. Në raportin e monitorimit të MASR nuk janë pasqyruar detyrimet e krijuara si rezultat i vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara për ZVAP Durrës në vlerë totale 2,663 mijë lekë, ZVAP Tiranë në vlerë totale 901 mijë lekë, ZVAP Kavajë në vlerë totale 901 mijë lekë, ZVAP Bulqizë në vlerë totale 734 mijë lekë.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar Durrës (*I pamodifikuar / I pakualifikuar*)

Ne audituam pasqyrat financiare të aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar Durrës", më datë 31.12.2019 (*8 muaj: Maj-Dhjetor 2019*), të cilat përbëhen nga Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1); Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2); Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3); Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4); Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5); Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6); Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a); Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b); si dhe Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).
Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare
Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P-10 "Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI", si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të *pamodifikuar/ pakualifikuar*[1] të auditimit.

Opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar Durrës (*Refuzim Opinioni*)

Ne audituam pasqyrat financiare të konsoliduara të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, më datë 31.12.2019.
Ne nuk shprehim opinion mbi pasqyrat financiare[2] të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës. Për shkak të rëndësisë së çështjes së përshkruar në seksionin mbi bazën

[1] ISSAI 1700 - Audituesi do të shprehë një opinion i pakualifikuar kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
[2] ***ISSAI 2705- Refuzimi i opinionit*** *do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.*

e refuzimit të opinionit të raportit tonë, ne nuk siguruam evidenca auditimi përkatëse, të mjaftueshme për të marrë një bazë për dhënien e opinionit të auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Baza për Opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P-10 "Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI", si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.
Ne vumë re se:
-Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, nuk ka hartuar pasqyra financiare të konsoliduara më 31.12.2019, për 12 Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (Bulqizë, Dibër, Durrës, Kamëz, Kavajë, Klos, Krujë, Mat, Rrogozhinë, Shijak, Tiranë dhe Vorë) në varësi të saj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 120, e cila përcakton që: "Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor të mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë". Si pasojë e mos-konsolidimit të pasqyrave financiare, grupi i auditimit e ka të pamundur të marrë siguri për zëra material si: Pozicioni financiar më 31.12.2019, Aktivet e DRAP Durrës, Llogaritë e Arkëtueshme, Llogaritë e Pagueshme, Performanca Financiare në nivel të konsoliduar, etj.

Opinion mbi përputhshmërinë (*Opinion i kundërt*)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Durrës, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të DRAP, Durrës. Gjithashtu auditimi përfshiu një analizë të sistemeve të kontrollit të brendshëm (KB), me qëllim vlerësimin e hartimit, implementimit dhe funksionimit me efektivitet të kontrolleve të brendshme, ku në përfundim u konstatuan thyerje të tyre përgjatë hartimit dhe implementimit e si pasojë edhe funksionimit të tyre. Është përgjegjësi e drejtimit që të hartojë procedura dhe politika që i përshtaten rrethanave të njësisë dhe të kërkojë implementimin e tyre si pjesë integrale e operacioneve të njësisë, në mënyrë që kontrollet e brendshme të funksionojnë në mënyrë efektive, duke mundësuar kufizimin e risqeve të keqpërdorimit të fondeve publike, dhe duke mos rrezikuar realizimin e objektivave të institucionit.
Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin e tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes së shënuar në paragrafin e Bazës për Opinion, veprimtaria e Drejtorisë Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, **nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale**, me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

Baza për Opinionin e Kundërt të Përputhshmërisë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), si ISSAI 400 "Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë", ISSAI 4000 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë", si dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë,

miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P-10 "Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI", si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të siguruar bazat për përgatitjen **e opinionit të kundërt të auditimit**[3].

Nga evidencat e marra rezultuan thyerje materiale të sistemeve të kontrollit në procedurat si vijon:

-Riorganizimi i strukturave për arsimin parauniversitar ka qenë një proces i ngadaltë, me efekte financiare dhe problematika në dorëzimin e detyrës, i cili ende nuk ka konkluduar në plotësimin e vakancave dhe emërimin e stafit sipas akteve ligjeve në fuqi (konkretisht 98% e stafit të DRAP Durrës, dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj, vijon të jetë i komanduar, duke nisur që prej Drejtorit të DRAP Durrës e deri tek punonjësit e ZVAP-ve).

-Megjithëse linjat hierarkike institucionale janë thelluar, duke u zgjeruar vertikalisht me krijimin e DPAP, DRAP dhe ZVAP, nga strukturat përkatëse të përfshira në proces, nuk është siguruar orientimi, monitorimi dhe shqyrtimi efektiv i aktivitetit të strukturave vendimmarrëse në zbatim të misionit për ofrimin dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar.

-Në procedurat për përzgjedhjen e drejtuesve të IPAP (institucione te arsimit para universitar – shkollat) për periudhën nën auditim, u identifikuan parregullsi të shumta, të shkaktuara kryesisht nga kuadri ligjor dhe rregullator i pa harmonizuar, si: VKM nr. 99 datë 27.02.2019 dhe Udhëzimi nr 2, datë 28.01.2020, në kundërshtim me Ligjin 69/2012, i ndryshuar; Urdhri i nxjerrë nga DPAP në kundërshtim me Ligjin 69/2012, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020 i ndryshuar, etj.

-Procesi i përzgjedhjes së drejtuesve të IPAP, është cënuar si rezultat i mos analizimit të zbatueshmërisë nga DPAP dhe DRAP, të kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët për drejtor, si dhe nga një planifikim i dobët, i cili nuk ka siguruar zbatimin e akteve nënligjore mbi pjesëmarrësit në mbledhjet e komisionit.

-Në 20 nga 32 procedura konkurrimi të hapura për pozicionin drejtor në Shpalljen 1, kriteri i domosdoshëm për kandidatët, për të qenë i certifikuar nga shkolla e drejtorëve, nuk është trajtuar si i tillë nga komisionet e vlerësimit dhe nga DRAP Durrës (konstatuar në 4 nga 5 raste, në të cilat kanë përfunduar procedurat dhe janë shpallur fitues).

-Roli i ZVAP-eve në shqyrtimin e procedurave të ndjekura nga komisionet nuk ka qenë i unifikuar, si dhe janë vërejtur raste, ku në të njëjtin ZVAP është vepruar me dy standarde.

-Për shkak se dokumentacionet e procedurave të konkurrimit nuk përmbajnë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, nuk garantohet siguri dhe vërtetësi lidhur me proceset e kryera.

-Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, në lidhje me shpenzimet e transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, të 7 njësitë e audituara (ZVAP Tiranë, Durrës, Shijak, Kavajë, Mat, Dibër dhe Bulqizë), nuk kanë kryer procedurat e prokurimit të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit, në kundërshtim me aktet e mësipërme ligjore, duke mbartur kështu riskun e përdorimit pa eficiencë, ekonomicitet

[3] *ISSAI 4000: Në një auditim përputhshmërie, audituesi duhet të shprehet se deri në çfarë shkalle fusha e audituar është në përputhje me kriteret e vendosura, si dhe duhet të shprehë një **opinion të kundërt** kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura në çështjen e audituar.*

dhe efektivitet të fondeve me vlerë 157,423,324 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. 811/1 prot., datë 01.09.2020 "*Auditim Financiar dhe Përputhshmërie në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës*", i ndryshuar me nr. 811/2 prot., datë 21.09.2020 dhe nr. 811/3 prot.,datë 13.10.2020, nga data 01.09.2020 deri më datë 06.11.2020, u krye auditimi në subjektin "Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri më datë 31.08.2020, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.G., Përgjegjës grupi,
2. M.K., Audituese dhe
3. J.T., Audituese.

II. 1 Objekti i auditimit

Raport Auditimi Financiar dhe Përputhshmërie, mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës (këtu e më poshtë: DRAP Durrës), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2019 deri më 31.08.2020.

Raporti i auditimit është i strukturuar në pesë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuara sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt dhe raporti ka mbyllet me kreun e pestë anekse.

II.2 Qëllimi i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Objektivi i Auditimit të Përputhshmërisë, është dhënia e opinionit nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën rregullatore, i cili qeverisë njësinë e audituar.

Objektivat e auditimit Financiar, ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave
financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare të DRAP Durrës, është rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të këtyre pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë

financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Qëllimi i auditimit të përputhshmërisë është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara, i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese. Përdorimi i fondeve bazohet në parime, rregulla dhe standarde që të gjitha bashkë përbëjnë kuadrin rregullator.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:
1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse;
-Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
-Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
-Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
-Veprimtaria e shoqërisë është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
-Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.
4. Shkalla e realizimit të objektivat kryesore të përcaktuar në programet ekonomike dhe financiare;
5. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së DRAP Durrës.

II.3 Identifikimi i çështjes
Raporti i Auditimit "Financiar dhe Përputhshmërie", mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare të DRAP Durrës, për periudhën 01.01.2019 – 31.08.2020, ka identifikuar sipas kritereve të specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:
-Mbi hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit.
-Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
-Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
-Auditimi i llogarive vjetore të administratës së DRAP Durrës dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë, Dibër, Durrës, Kavajë, Mat, Shijak dhe Tiranë.
Ndërsa për Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz, Klos, Krujë, Rrogozhinë dhe Vorë, nuk u krye auditim.
-Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
-Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.
Strukturat drejtuese të DRAP Durrës, kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.
Strukturat drejtuese të DRAP Durrës, janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në

mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
Strukturat drejtuese të DRAP Durrës, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.
Strukturat drejtuese të DRAP Durrës, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

II.5 Përgjegjësitë e audituesve.
Audituesit e KLSH[së] kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni.
Audituesit e KLSH[së] kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.
Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare
Audituesit e KLSH[së] kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar.
Audituesit e KLSH[së] kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;
-njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
-promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

II.6 Kriteret e vlerësimit.
Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:
-Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
-Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
-Ligji nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar;
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;

-Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;
-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit";
-VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar";
-Urdhri i Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019 për "Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar";
-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
-Udhëzimi i Ministrit të MASR nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit Parauniversitar", i ndryshuar;
-Rregullorja e Ministrit të MASR "Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", datës 30.04.2019;
-Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015.
-Rregullore "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr.63, datë 22.06.2020.
-Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit.

II.7 Standardet e auditimit.
Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:
-Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);
-Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
-INTOSAI-P-1 "Deklarata e Limës";
-INTOSAI-P-10-99 "Parimet themelore të INTOSAI";
-INTOSAI-P-10 "Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI";
-INTOSAI-P-12 "Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve";
-INTOSAI-P-20 "Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies";
-INTOSAI-P-50 "Parimet e juridiksionit të SAI";
-ISSAI 100-129 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
-ISSAI 2000-2899 "Standardet e Auditimit Financiar";
-ISSAI 400 "Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë";
-ISSAI 4000 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë";
-ISSAI 2705 "Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur";
-Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020;
-Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020.

II.8 Metodat e auditimit.
Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.
Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar: Drejtori Rajonale që ka nën varësi 12 Zyra Rajonale Vendore të Arsimit Parauniversitar, të cilat përfshijnë afërsisht 75% të nxënësve në shkallë vendi, periudha e audituar, fakti që është institucion i krijuar në vitin 2019, shtrirja territoriale (nga Kavajë në Dibër); në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;
b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;
d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;
h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

II.9 Dokumentimi i auditimit.
Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e OSHEE SHA, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me Akt-Konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

III. 1.Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës), është një institucion i ri, i krijuar me anë të VKM nr. 99, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar".

Më parë ka qenë Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës (që mbulonte Rrethin e Durrësit dhe Shijakut), e cila ka patur nën varësi edhe ish-Zyrën e Arsimit Vendor Krujë.

Me ndryshimet e mësipërme ligjore, është krijuar DRAP Durrës, institucion i cili është përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e 12 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj. DRAP Durrës, menaxhon, mbikqyr, vlerëson dhe kontrollon institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Zyrat Vendore Arsimit Parauniversitar, nën varësinë e DRAP Durrës janë:

ZVAP Bulqizë,
ZVAP Dibër,
ZVAP Durrës,
ZVAP Kamëz,
ZVAP Kavajë,
ZVAP Klos,
ZVAP Krujë,
ZVAP Mat,
ZVAP Rrogozhinë,
ZVAP Shijak,
ZVAP Tiranë dhe
ZVAP Vorë.

Në total, brenda juridiksionit të DRAP Durrës, sipas të dhënave të këtij institucioni, janë mbi 1200 institucione të arsimit parauniversitar private dhe publike (shkolla 9-vjeçare, të mesme dhe kopshte), rreth 10,000 mësues dhe rreth 200,000 nxënës të të gjitha niveleve.

DRAP Durrës, së bashku me Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar nën varësinë e saj, janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryejnë këto detyra:

a) Menaxhojnë, mbikëqyrin, vlerësojnë dhe kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

b) Sigurojnë zbatimin e kurrikulës, metodologjive dhe standardeve.

c) Mbikëqyrin veprimtarinë e përditshme dhe funksionimin e institucioneve arsimore, përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsinë e procesit mësimor.

ç) Vlerësojnë nevojat dhe problematikat gjatë ofrimit të shërbimit arsimor dhe propozojnë zgjidhjen e tyre.

d) Ofrojnë ekspertizë teknike në hartimin e metodologjive mësimore, praktikave dhe teknikave që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.

dh) Monitorojnë kualifikimet e personelit mësimdhënës për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara nga institucioni përgjegjës.

e) Garantojnë miradministrimin e burimeve njerëzore për institucionet publike të arsimit parauniversitar, si dhe shpërndarjen e tyre në varësi të aftësive, kontributit të gjithsecilit dhe parimeve të drejtësisë e meritokracisë.

ë) Garantojnë ngritjen e rrjeteve profesionale të mësuesve, si dhe përhapin praktika e përvoja të suksesshme të mësuesve.
f) Janë përgjegjëse për rekrutimin e mësuesve nëpërmjet portalit kombëtar "Mësues për Shqipërinë", ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimin e analizimin e të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.
g) Garantojnë miradministrimin e burimeve financiare dhe alokimin e tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore.
gj) Organizojnë dhe mbështesin shërbimin psikosocial në institucionet arsimore parauniversitare publike.
h) Kërkojnë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore.
i) Monitorojnë procedurat për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
j) Mbështesin dhe administrojnë zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar.
k) Grumbullojnë dhe përpunojnë të dhënat statistikore nga institucionet arsimore nën juridiksionin e tyre.
l) Vlerësojnë dhe shqyrtojnë kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin për përmbushjen e kritereve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.
ll) Ofrojnë shërbime ndaj qytetarëve.
DRAP gjithashtu, siguron për zyrat vendore të arsimit që ka nën juridiksion, asistencë juridike dhe përfaqësimin gjyqësor, si dhe shërbimet financiare e mbështetëse që nuk u janë deleguar zyrave vendore të arsimit nga DPAP-ja.

III.2 Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

III.2.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:
Buxheti i miratuar për Drejtorinë Rajonale Arsimore Durrës për vitin 2019 dhe 2020, paraqitet në **3 programe buxhetore**, si më poshtë:
Programi "*Planifikim, Menaxhim, Administrim*", nën kodin (01110). Në bazë të raportit vjetor të buxhetit të MASR parashikohet se ky program ka për qëllim krijimin e një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe efiçient të MFK-së konform standardet ligjore, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance. Eficenca në përdorim e burimeve financiare e materiale në arsim; efektiviteti në përdorimin e burimeve njerëzore: rritja e kapaciteteve e aftësive menaxhuese në nivelin qendror (MASR), rajonal (DRAP/ ZVAP), lokal (institucionet arsimore); Vendosja e mekanizmave transparente të monitorimit e llogaridhënie. Përgatitja e akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislacionin shqiptar e zhvillimin e tij sipas vlerave të përbashkëta të sistemeve bashkohore. Implementimi i stategjive kombëtare.
Programi "*Arsimi Bazë*", nën kodin (09120). Në bazë të raportit vjetor të buxhetit të MASR parashikohet se ky program ka për qëllim sigurimin e një arsimi cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar. Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane. Rritja e aksesit në AP, përfshirja e 100% e fëmijëve 5 vjeçare në klasat përgatitore; Rritja e viteve të shkollimit. Rritja e autonomisë së shkollave; Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në AB, Tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në AB. Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve. Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me

laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB, Shtrirja e shërbimit të punonjësit social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara.

Programi "*Arsimi i Mesëm*", nën kodin (09230). Në bazë të raportit vjetor të buxhetit të MASR parashikohet se ky program ka për qëllim krijimin e mundësive për çdo nxënës që përfundon arsimin bazë të regjistrohet në arsimin e mesëm të lartë në masën në masën 98-99% në fund të vitit 2022, përfshirë dhe arsimin profesional. Zbatimi i kurrikulës së re (me kompetenca). Rritja e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet trajnimit të përvitshëm të mësueseve, drejtueseve Institucioneve Arsimore (IA) dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale si dhe zhvillimit profesional të tyre, sipas sistemit të ri për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Realizimi çdo vit i Maturës Shtetërore dhe portalit "Mësues për Shqipërinë". Përmirësimi i standardeve infrastrukturore".

Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i planifikuar dhe realizuar **<u>për vitin 2019 dhe periudhën janar-gusht 2020</u>** sipas 3 programeve për DRAP Durrës, paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Programi		Viti			
		2019		2020	
		Planifikuar[4]	Realizuar	Planifikuar[5]	Realizuar[6]
I	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	37,930,361	35,963,157	14,088,480	7,648,367
II	**Arsimi Bazë**	5,000,000	0	42,000,000	3,100,000
III	**Arsimi i Mesëm**	3,000,000	0	19,602,000	1,064,736
Total		**45,930,361**	**35,963,157**	**75,690,480**	**11,813,103**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSh

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut IV, paragrafi i fundit, nënpika 49 "Raporti i monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku shprehimisht përcaktohet që: "Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo ministrie/institucioni" <u>Në faqen zyrtare të DRAP Durrës nuk janë publikuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2019 dhe 2020. E njëjta situatë vërehet edhe në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës.</u>

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, miratuar sipas shkresës nr. 4699/1 prot datë 30.04.2019, neni 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, pika a e saj, përcakton "*Hartimin e projektbuxhetit të DRAP-së dhe ZVAP-ve dhe propozimin DPAP-së*", dhe neni 34, pika a "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve", e cila përcakton se "*Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it",* në vijim të verifikimi të kryer në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës, rezulton se ZVAP-et e përcjellin <u>në të njëjtën kohë dokumentacionet pranë DRAP Durrës,</u> dhe MASR duke mos dokumentuar propozimin e dokumentit në DRAP, apo përcjelljen e komenteve nga DRAP për rishikim të materialit, deri në përgatitjen finale të tij, pavarësisht se sikundër është bërë me dije nga DRAP Durrës ka patur komunikime të vijueshme verbale dhe me email me këto institucione për hartimin e dokumentit.

Lidhur me realizimin e shpenzimeve sipas programeve dhe produkteve në të cilat është bërë çelja e fondeve për vitin buxhetor, konstatohet se <u>jo në të gjitha rastet është vepruar në përputhje me objektivat e produktit</u>. Më hollësisht, referuar shpenzimeve të përfshira në produkte të programit "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*", rezulton se DRAP Durrës ka kryer shpenzime për pjesë këmbimi edhe nën produktin "*Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe miratuara"* edhe

[4] Planifikimi për vitin 2019 paraqitet sipas planit përfundimtar pas ndryshimeve të kryera me alokimin e fondeve pas krijimit të DRAP.
[5] Planifikimi për vitin 2020 paraqitet sipas planit fillestar alokuar nga MASR pas miratimit të Buxhetit për vitin 2020.
[6] Niveli i realizimit deri në 31.08.2020.

"Punonjës dhe specialiste te trajnuar", produkte këto me objektiva dhe njësi matëse tërësisht të ndryshme nga sa është kryer shpenzimi. Kjo, pasi edhe çelja e fondeve nga ana e MASR është bërë duke mos patur vijueshmëri në llojin e produkteve për periudhën 2019-2020, edhe pse nuk konstatohet të ketë patur ndryshime në objektivat institucional gjatë kësaj periudhe. Më hollësisht trajtuar si më poshtë.

III.2.1 a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.
Në zbatim të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, miratuar sipas shkresës nr. 4699/1 prot datë 30.04.2019, neni 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, pika a e saj, me urdhrin nr. 23, datë 26.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DRAP Durrës është ngritur grupi i punës për hartimin e PBA-së 2020-2022. Në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", kapitulli 2.5 "Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit" dhe kapitulli 2.6 "Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit" pranë DRAP Durrës rezulton se **nuk** është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programit. Drejtuesi i Ekipit të Programit është përgjegjës për hartimin e kërkesave buxhetore në programin në të cilën bën pjesë dhe realizimin e objektivave dhe produkteve të programit gjatë zbatimit të buxhetit. Duke qenë se në PBA e përgatitur nga DRAP parashikimet e fondeve janë kryer vetëm për një program, pas alokimit të buxhetit në 3 programe, rezulton të mos jenë kryer ndryshime nga Drejtori i DRAP Durrës për ekipin drejtues të secilit program, sikundër përcakton udhëzimi i sipërcituar. Gjithashtu, me urdhrin nr. 3792/2 prot, datë 20.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DRAP Durrës, është ngritur grupi i punës për përgatitjen e PBA 2021-2023, ku sërisht rezulton se nuk janë përcaktuar përgjegjësitë e ekipit të drejtimit të programit, për secilin program që do të menaxhohet nga DRAP Durrës.

Viti 2019
Duke qenë se DRAP Durrës është një institucion i krijuar rishtaz gjatë vitit 2019, për buxhetin e vitit 2019, nga strukturat e këtij institucioni nuk është përgatitur dokumenti i PBA-së për periudhën 2019-2021.

Viti 2020
Plani buxhetor afatmesëm 2020-2022 për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës është dërguar pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë sipas shkresës nr. 426/1, prot datë 15.08.2019, pra duke respektuar afatet të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", jo më vonë se 1 Shtator për fazën e dytë të PBA-së. Vlera totale e shpenzimeve për vitin 2020 për DRAP Durrës është parashikuar në shumën totale prej 75,841 mijë lekë, nga ku shpenzimet korente përbëjnë 37% të totalit (27,991 mijë lekë) dhe shpenzimet kapitale 63 % (47,850 mijë lekë). Planifikimi i buxhetit nga DRAP Durrës është kryer në fazën e PBA vetëm për 1 program,"*Planifikim, Menaxhim, Administrim*", nën kodin (01110), edhe pse për vitin 2019 ky institucion ka qenë përgjegjës për menaxhimin e fondeve të alokuara nën 3 programe, sikundër është trajtuar më sipër.
Në PBA 2020-2022, DRAP Durrës nuk ka hartuar deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit, si dhe nuk paraqitet në formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit në dokumentin "Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2020-2022"
Nga auditimi konstatohet se PBA-ja e hartuar për periudhën objekt auditimi paraqitet me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", ku më hollësisht në kundërshtim me Kapitullin I, pikën 8 të tij, nuk është përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat, treguesit e performancës për programin dhe aktivitetet e planifikuara sipas kërkesave buxhetore.

Planifikimi për Shpenzimet Korente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve dhe kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*" dhe strukturën e miratuar për DRAP Durrës, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr.68, datë 05.04.2019 për "*Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*". Ky zë është parashikuar në shumën totale 11,709 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 janë mbështetur në Ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Ky zë është parashikuar në shumën totale 1,862 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, përcaktuar në bazën ligjore dhe rregullatore për funksionimin e DRAP Durrës. Ky zë është parashikuar në shumën totale 14,120 mijë lekë, duke përfshirë:

Shpenzime për materiale zyre dhe të përgjithshme në shumën totale 1,520 mijë lekë;
Shpenzime për të tretë në shumën totale 5,440 mijë lekë;
Shpenzime transporti në shumën totale 3,080 mijë lekë;
Shpenzime udhëtimi në shumën totale 2,400 mijë lekë;
Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme në shumën totale 400 mijë lekë;
Shpenzime për qeramarrje në shumën totale 1,080 mijë lekë;
Shpenzime të tjera operative në shumën totale 200 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë". Ky zë është parashikuar në shumën totale 300 mijë lekë.

Planifikimi për Shpenzimet Kapitale

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kapitale të Trupëzuara*" është kryer në bazë të nevojave të drejtorisë për vijimin e veprimtarisë së saj. Ky zë është parashikuar në shumën totale 47,850 mijë lekë duke përfshirë:

Shpenzime për ndërtimin e godinës së re të DRAP Durrës në shumën totale 35,000 mijë lekë;
Pajisje inventari ekonomik në shumën totale 11,050 mijë lekë;
Mjete transporti në shumën totale 1,800 mijë lekë.

-Në PBA 2020-2022 të DRAP Durrës shpenzimet për paga të punonjësve janë parashikuar vetëm për vitin 2020, duke mos përfshirë parashikimin e fondeve për paga për vitin 2021 dhe 2022.

-Shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2020, 2021 dhe 2022 janë parashikuar në të njëjtën vlerë për të 3 vitet, me përjashtim të shpenzimeve për të tretë ku për vitin 2020 janë parashikuar në shumën totale 5,440 mijë lekë dhe për vitin 2021 dhe 2022, 100 mijë lekë më pak, përkatësisht 5,340 mijë lekë.

-Shpenzimet për Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës për vitin 2020, 2021 dhe 2022 janë parashikuar në të njëjtën vlerë për të 3 vitet.

-Shpenzimet kapitale për vitin 2021 dhe 2022 janë parashikuar në vlerën zero.

Plani buxhetor afatmesëm 2020-2022 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj është përcjellë sipas shkresës nr.426, prot datë 15.08.2019, pra duke respektuar afatet të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA", jo më vonë se 1 Shtator për fazën e dytë të PBA-së. Dokumentacioni përbëhet nga anekset shoqëruese, duke mos përcaktuar qëllimin, objektivat, treguesit e performancës për programin aktivitetet e planifikuara sipas kërkesave buxhetore. Nuk rezulton të jetë hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit, si

dhe nuk paraqitet në formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit në dokumentin "Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2020-2022". Shpenzimet totale janë parashikuar për vitin 2020 në shumën 32,771,537 mijë lekë nga të cilat 10,907,572 mijë lekë shpenzime korrente dhe 21,863,965 mijë lekë shpenzime kapitale.

Planifikimi për Shpenzimet Korente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" për vitin 2020 nën artikullin 600 është bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve dhe kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*" dhe strukturën e miratuar për DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksion. Ky zë është parashikuar në shumën totale 9,091,334 mijë lekë nga të cilat 120,897 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 6,820,703 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 2,149,735 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" për vitin 2020 nën artikullin 601 janë mbështetur në Ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Ky zë është parashikuar në shumën totale 1,445,955 mijë lekë, nga të cilat nga të cilat 19,228 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 1,084,817 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 341,910 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" për vitin 2020 nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, përcaktuar në bazën ligjore dhe rregullatore për funksionimin e DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj. Ky zë është parashikuar në shumën totale 345,264 mijë lekë, nga të cilat 36,701 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 243,293 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 65,270 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*" për vitin 2020, nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë". Ky zë është parashikuar në shumën totale 25,018 mijë lekë nga të cilat 788 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 23,064 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 1,166 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".

Planifikimi për Shpenzimet Kapitale

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kapitale të Trupëzuara*" për vitin 2020 është kryer në bazë të nevojave të drejtorisë për vijimin e veprimtarisë së saj. Ky zë është parashikuar në shumën totale 21,863,965 mijë lekë nga të cilat 10,861,450 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 10,940,015 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 62,500 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".

Planifikimi i buxhetit për vitin 2021

Plani buxhetor afatmesëm 2021-2023 për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës është dërguar pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë sipas shkresës nr. 1144, prot datë 14.08.2020, pra duke respektuar afatet të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", jo më vonë se 1 Shtator për fazën e dytë të PBA-së. Vlera totale e shpenzimeve për vitin 2021 për DRAP Durrës është parashikuar në shumën totale prej 77,741 mijë lekë, nga ku shpenzimet korente përbëjnë 30% të totalit (23,691 mijë lekë) dhe shpenzimet kapitale 70% (54,050 mijë lekë). Planifikimi i buxhetit nga DRAP Durrës është kryer në fazën e PBA vetëm për 1 program,"*Planifikim, Menaxhim, Administrim*", nën kodin (01110), edhe pse për vitin 2019 dhe 2020 ky institucion ka qenë përgjegjës për menaxhimin e fondeve të alokuara nën 3 programe, sikundër është trajtuar më sipër.

Në PBA 2021-2023, DRAP Durrës nuk ka hartuar deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit, si dhe nuk paraqitet plotësisht me formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit në dokumentin "*Format 2- Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2021-2023- Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi. "*
Nga auditimi konstatohet se PBA-ja e hartuar për periudhën objekt auditimi paraqitet me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", ku më hollësisht në kundërshtim me Kapitullin I, pikën 8 të tij, nuk është përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat, treguesit e performancës për programin dhe aktivitetet e planifikuara sipas kërkesave buxhetore.

Planifikimi për Shpenzimet Korente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve dhe kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*" dhe strukturën e miratuar për DRAP Durrës, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr.68, datë 05.04.2019 për "*Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*". Ky zë është parashikuar në shumën totale 14,295 mijë lekë.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 janë mbështetur në Ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Ky zë është parashikuar në shumën totale 2,274 mijë lekë.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, përcaktuar në bazën ligjore dhe rregullatore për funksionimin e DRAP Durrës. Ky zë është parashikuar në shumën totale 6,820 mijë lekë. Në tabelat bashkëshoqëruese të relacionit, lidhur me detajimin e shpenzimeve në llogarinë 602, janë pasqyruar vetëm shpenzimet e pritshme për vitin 2020, dhe parashikimet për vitin 2021, 2022, 2023 janë lënë në vlerën zero.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë". Ky zë është parashikuar në shumën totale 300 mijë lekë.

Planifikimi për Shpenzimet Kapitale

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kapitale të Trupëzuara*" është kryer në bazë të nevojave të drejtorisë për vijimin e veprimtarisë së saj. Ky zë është parashikuar në shumën totale 54,050 mijë lekë duke përfshirë:
Shpenzime për ndërtimin e godinës së re të DRAP Durrës në shumën totale 40,000 mijë lekë;
Pajisje inventari ekonomik në shumën totale 11,050 mijë lekë;
Mjete transporti në shumën totale 1,000 mijë lekë.
Mikrobuz në shumën totale 2,000 mijë lekë.
-Në PBA 2021-2023 të DRAP Durrës shpenzimet për paga të punonjësve, për mallra dhe shërbime dhe transferta buxhetore janë parashikuar në të njëjtën vlerë edhe për vitin 2021 dhe 2022.
-Shpenzimet kapitale për vitin 2022 dhe 2023 janë parashikuar në vlerën zero.

Plani buxhetor afatmesëm 2021-2023 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj është dërguar pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë sipas shkresës nr. 1143, prot datë 14.08.2020, pra duke respektuar afatet të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", jo më vonë se 1 Shtator për fazën e dytë të PBA-së.

Në këtë dokument janë evidentuar shpenzimet e planifikuara sipas programeve në total për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se ky material nuk jep informacion lidhur me peshën që secili ZVAP ka në buxhetin total, pasi vlerat e pasqyruara nuk kanë bërë një analizë të tillë, por në anekse është pasqyruar vetëm shuma totale e shpenzimeve për DRAP dhe 12 ZVAP-et, sipas llogarive respektive dhe programeve.

Planifikimi për Shpenzimet Korente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" për vitin 2021,2022, 2023 nën artikullin 600 është parashikuar në shumën totale 9,271,315 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 për vitin 2021,2022,2023 janë parashikuar në shumën totale 1,494,081 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 për vitin 2021 janë parashikuar në shumën totale 250,557 mijë lekë. Për vitin 2022 në shumën 344,782 mijë lekë dhe në vitin 2023 në shumën 352,304 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 për vitin 2021 është parashikuar në shumën totale 280,682 mijë lekë. Për vitin 2022 në shumën 292,246 mijë lekë, dhe në vitin 2023 në shumën 302,944 mijë lekë.

Planifikimi për Shpenzimet Kapitale

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kapitale të Trupëzuara*" për vitin 2021 është parashikuar në shumën totale 10,901,1740 mijë lekë. Për vitin 2022 dhe 2023 në vlerën 0.

III.2.1 b. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2019

Pas krijimit të DRAP Durrës me urdhër të Kryeministrit Nr.68, datë 05.04.2019 për "*Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*", fondet buxhetore për vitin 2019 i janë alokuar institucionit nga MASR nëpërmjet shkresave, trajtuar si më poshtë:

Në zbatim të ligjit nr. 99/2017, datë 3.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019" dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.68, datë 05.04.2019 për "Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar", janë kryer ndryshime në shpërndarjen e fondeve për vitin 2019, duke i alokuar institucionit të krijuar rishtaz, DRAP Durrës, fondin prej 7,352 mijë lekë, nga të cilat 6,300 mijë lekë për shpenzimet për paga (llog 600) dhe 1,052 mijë lekë për shpenzimet për sigurime shoqërore (llog 601).

Në zbatim të ristrukturimit të njësive vendore arsimore, për shpërndarjen e fondeve për mallra dhe shërbime (llog 602) janë kryer ndryshime në planin e buxhetit të vitit 2019, nëpërmjet shkresës nr. 3490/1 prot datë 20.06.2019, duke i alokuar DRAP Durrës fondin prej 11,106 mijë lekë nën tre programe. Më hollësisht:

Shpenzime për mallra dhe shërbime (llog 602) në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 3,106 mijë lekë.

Shpenzime për mallra dhe shërbime (llog 602) në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 5,000 mijë lekë.

Shpenzime për mallra dhe shërbime (llog 602) në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 3,000 mijë lekë.

Në mbështetje të shkresës nr.7326/1 prot datë 24.07.2019 "Për ndryshimin në planin e buxhetit të vitit 2019" ku kërkohet transferim fondi për trajtimin financiar të punonjësve si rezultat i ristrukturimit, me shkresën nr. 14187/1 prot datë 31.07.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR janë alokuar pranë DRAP Durrës fondet në shumën **28,148 mijë** lekë nën llogarinë 606, transferta buxhetore. Këto fonde janë parashikuar të përballojnë shpenzimet për ish punonjësit e prekur nga ristrukturimi për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-të që ajo ka në juridiksion.
Në mbështetje të shkresës nr. 288, datë 25.07.2019 dhe nr. 234, datë 12.07.2019 të DRAP Durrës ku është kërkuar çelje fondi e veçantë për trajtimin e punonjësve në ZVA dhe DRAP, me shkresën nr.7572/1, datë 07.08.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR është kryer rishpërndarja e fondeve, duke i alokuar DRAP Durrës fondin prej 109 mijë lekë nën llogarinë 606, transferta buxhetore.
Në mbështetje të kërkesave të DPAP, ZVAP-eve dhe institucioneve të tjera arsimore për akordim të fondeve për paga dhe sigurime shoqërore, me shkresën nr. 8186/1, prot datë 17.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, është kryer rishpërndarja e fondeve, duke i pakësuar DRAP Durrës fondin në shumën totale prej 830 mijë lekë, nga të cilat 730 mijë lekë për shpenzime për paga (llog 600) dhe 100 mijë lekë për shpenzime për sigurime shoqërore (llog 601).
Në mbështetje të shkresës nr. 612, datë 8.10.2019 dhe nr. 670 datë 17.10.2019 të DRAP Durrës, ku është kërkuar çelje fondi e veçantë për trajtimin e punonjësve në ZVA dhe DRAP, me shkresën nr.9240/1, datë 29.10.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR është kryer rishpërndarja e fondeve, duke i alokuar DRAP Durrës fondin prej 44 mijë lekë nën llogarinë 606, transferta buxhetore.
Me shkresën nr. 9891/1, datë 12.11.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, prot në DRAP Durrës nr. 762/19 datë 13.11.2019, është kryer rishpërndarja e fondeve nëpërmjet institucioneve të ndryshme arsimore që MASR ka nën varësi, duke **i pakësuar** DRAP Durrës fondin nën programin "Arsimi Bazë", nën kodin 91103 AE "Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re" fondin prej **3,000 mijë lekë** nën llogarinë 602, mallra dhe shërbime. Nga auditimi konstatohet se lidhur me këtë pakësim të fondeve, në rakordimin mes DRAP dhe Degës së Thesarit në janar 2020 rezulton se fondet prej 3,000 mijë lekë janë **rikthyer sërisht** në buxhetin e DRAP gjatë muajit dhjetor 2019. DRAP Durrës nuk disponon asnjë dokumentacion për kthimin e këtyre fondeve, pasi sipas punonjësve të kësaj drejtorie shkresa nuk ka patur asnjë efekt, dhe është anulluar, pasi DRAP Durrës ka njoftuar Ministrinë e Arsimit se këto fonde janë të ngurtësuara në Degën e Thesarit për shkak të një procedure prokurimi në proces. Megjithatë, nga një verifikim në thesar, rezulton se **faktikisht këto fonde janë pakësuar nga buxheti i DRAP Durrës.** këto fonde kanë qenë të ngurtësuara dhe **nuk mund të pakësoheshin nga buxheti i institucionit për aq kohë që procedura e prokurimit vijon në proces**
Më hollësisht planifikimi fillestar i buxhetit për vitin **2019**, dhe ndryshimet përgjatë vitit paraqiten sipas **aneksit nr.1.1**.

Viti 2020
Në zbatim të ligjit nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020" dhe udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, me shkresën nr. 24325/49, datë 20.01.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë dërguar pranë MASR detajimet e shpenzimeve korente për vitin 2020 për Aparatin e Ministrisë dhe institucionet e varësisë. Në vijim të kësaj shkrese, me shkresën nr. 11168/3, prot datë 27.01.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, është dërguar pranë DRAP Durrës shpërndarja e shpenzimeve korente për vitin 2020, duke bërë alokimin e fondeve të buxhetit për këtë institucion në një total prej 75,690 mijë lekë.

Përgjatë vitit 2020, janë kryer ndryshime në shpërndarjen e shpenzimeve korente në produktet e buxhetit të DRAP Durrës, si më poshtë:

Në vijim të shkresave të institucioneve arsimore "Kërkojmë fonde për mbulimin e shpenzimeve të transportit të mësuesve dhe nxënësve që përfitojnë si rezultat i pasojave të tërmetit të datës 26 Nëntor 2020", me shkresën nr. 1063/1, datë 24.02.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, janë kryer ndryshime nëpërmjet programeve dhe institucioneve DRAP dhe ZVAP, ku përkatësisht janë pakësuar fondet në totalin prej 15,128 mijë lekë dhe kjo shumë është shpërndarë në programet dhe produktet respektive të Zyrave Vendore Arsimore. Si rezultat i këtij ndryshimi, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës i janë pakësuar fondet në shumën 7,520 mijë lekë në programin 09120, produktin 91103 AB *"Nxënës përfitues të shërbimeve arsimore në sistemin 9 vjeçar".*

Në zbatim të aktit normativ nr. 15, datë 15.04.2020, me shkresën nr 6865/133 prot datë 13.05.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë kryer ndryshime në buxhetin e DRAP dhe ZVA, ku në total fondet janë pakësuar në shumën 231,000 mijë lekë. Si rezultat i këtij ndryshimi, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës i janë pakësuar fondet në shumën 8,000 mijë lekë në programin 09120, produktin 91103 AB *"Nxënës përfitues të shërbimeve arsimore në sistemin 9 vjeçar"* dhe 6,000 mijë lekë në programin 09230, produktin 9114 AA *" Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në sistemin arsimor publik"*

Me shkresën nr. 3567/5, prot datë 17.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR janë kryer ndryshime në shpërndarjen e fondeve të DRAP dhe ZVAP për përballimin e detyrimeve të prapambetura dhe shmangien e krijimit të tyre, ku përkatësisht janë pakësuar fondet në totalin prej 12,439 mijë lekë, dhe kjo shumë është shpërndarë në programet dhe produktet respektive të Zyrave Vendore Arsimore. Si rezultat i këtij ndryshimi, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës i janë pakësuar 621 mijë lekë në programin 09230, produktin 91104 AA *"Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet arsimore publike".*

Me shkresën nr. 3955 prot dat 22.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR është kryer rishpërndarje e fondeve nëpërmjet DRAP dhe ZVAP për kryerjen e shpenzimeve në këto të fundit për blerjen e produkteve në vijim të masave parandaluese për COVID-19, ku përkatësisht janë pakësuar fondet në totalin prej 20,000 mijë lekë dhe kjo shumë është shpërndarë në programet dhe produktet respektive të Zyrave Vendore Arsimore. Si rezultat i këtij ndryshimi, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës i janë pakësuar 6,000 mijë lekë në programin 09120, produktin 91103 AB *"Nxënës përfitues të shërbimeve arsimore në sistemin 9 vjeçar"* dhe 1,000 mijë lekë në programin 09230, produktin 91104 AA *"Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet arsimore publike".*

Në zbatim të VKM nr. 557, datë 15.07.2020 "Për dhënien e kontributit financiar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi për blerjen e teksteve shkollore", me shkresën nr. 14152/1 prot datë 29.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është kryer rishpërndarja e fondeve buxhetore për vitin 2020, ku përkatësisht Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës i janë pakësuar 2,000 mijë lekë në programin 09120, produktin 91103 AB *"Nxënës përfitues të shërbimeve arsimore në sistemin 9 vjeçar".*

Në vijim të shkresës nr. 770/7, datë 20/07/2020 dhe nr. 770/9, datë 24.07.2020 të DRAP Durrës "Kërkesë për rishpërndarje të fondit për palën debitore dhe likuidimin e detyrimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë", me shkresën nr. 1240/19 prot datë 14.08.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, janë kryer ndryshime në planin e buxhetit të vitit 2020 ku përkatësisht

janë pakësuar fondet në totalin prej 2,051 mijë lekë, dhe kjo shumë është shpërndarë në programet dhe produktet respektive të Zyrave Vendore Arsimore. Si rezultat i këtij ndryshimi, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës i janë pakësuar 1,690 mijë lekë në programin 09120, produktin 91103 AB *"Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar"* dhe 361 mijë lekë në programin 09230, produktin 91104AA "*Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet arsimore publike".*

Më hollësisht buxheti fillestar për vitin **2020**, dhe ndryshimet përgjatë vitit paraqitet sipas **aneksit nr.1.2.**

Sikundër parqitet në tabelën respektive, ndryshimet e planit krahasuar me alokimin fillestar të fondeve janë konstatuar në **programin e arsimit të mesëm dhe të lartë.** Fondet, edhe pse janë transferuar në fillim të vitit për DRAP Durrës, përgjatë vitit ato rezultojnë të transferohen në ZVAP-et nën juridikisonin e DRAP Durrës.

III.2.1 c. Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2019

Niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2019, sipas 3 programeve në llogaritë respektive, trajtuar në bazë të planit fillestar dhe atij faktik, paraqitet në **aneksin nr 1.3.**

Nga auditimi konstatohet se buxheti i alokuar në DRAP Durrës ka pësuar disa ndryshime në alokimin e fondeve të drejtorisë. Niveli i realizimit në total për tre programet për vitin 2019 paraqitet në masën 78% kundrejt planit te rishikuar. Niveli më i lartë i mosrealizimit paraqitet në programin 09120 "***Arsimi Bazë*****"** dhe 09230 **"*Arsimi i Mesëm*"** me vlerat respektive 5,000 mije lekë dhe 3,000 mijë lekë të planifikuara, ku rezulton se deri në fund të vitit 2019 nuk është kryer asnjë pagesë, pasi kontrata e trajnimit për këto programe është lidhur në fund të vitit 2019, dhe është zhvilluar përgjatë vitit 2020.

Nëse i referohemi planit fillestar, realizimi i shpenzimeve për DRAP Durrës rezulton rreth 489% kundrejt planit, pasi fillimisht, me krijimin e drejtorisë përgjatë vitit 2019, fondet janë alokuar vetëm për shpenzimet për paga të punonjësve.

Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Viti 2019							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[7]	6,300,000	1,052,100	3,106,437	28,301,824	**38.760.361**
		Realizuar	4,684,967	783,726	2,192,640	28,301,824	**35,963,157**
		Realizimi %	**74%**	**74%**	**71%**	**100%**	**93%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[8]			5,000,000		**5,000,000**
		Realizuar			0		**0**
		Realizimi %			**0%**		**0%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[9]			3,000,000		**3,000,000**
		Realizuar			0		**0**
		Realizimi %			**0%**		**0%**
TOTALI		Planifikuar	**6,300,000**	**1,052,100**	**13,299,077**	**28,301,824**	**46,760.361**
		Realizuar	**4,684,967**	**783,726**	**2,192,640**	**28,301,824**	**35,963,157**
		Realizimi %	**74%**	**74%**	**16%**	**100%**	**77%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Lidhur me programin 01110 "***Planifikim, Menaxhim, Administrim***":

[7] Sipas planifikimit fillestar për këtë ze
[8] Alokuar fondet përgjatë vitit 2019
[9] Alokuar fondet përgjatë vitit 2019

Produkti 91101AA "*Punonjës dhe specialiste te trajnuar*" është realizuar në masën 61%, 805 mijë nga 1,316 mijë lekë të planifikuara. Në këto shpenzime janë përfshirë shpenzime të kryera nga DRAP Durrës për kancelari, pjesë këmbimi, internet, materiale të tjera.

Produkti 91101AE "*Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore*", për llogarinë 606 transferta buxhetore është realizuar në masën 100%, 28,301 mijë nga 28,301 mijë lekë të planifikuara. Për llogarinë 600, pagat e punonjësve është realizuar në masën 84%, 4,684 mijë nga 5,570 mijë lekë të planifikuara. Për llogarinë 601, sigurime shoqërore është realizuar në masën 82%, 952 mijë nga 783 mijë lekë të planifikuara. Për llogarinë 602, mallra dhe shërbime është realizuar në masën 99%, 446 mijë nga 450 mijë lekë të planifikuara. Në këto shpenzime janë përfshirë shpenzime të kryera nga DRAP Durrës për postën, dieta, materiale të tjera dhe tabela logjistike.

Produkti 91101AD "*Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara*" është realizuar në masën 99.9%, 939 mijë nga 940 mijë lekë të planifikuara. Në këto shpenzime janë përfshirë shpenzime të kryera nga DRAP Durrës për pjesë këmbimi dhe naftë.

Produkti 91101AC "*Drejtuesve te institucioneve arsimore te trajnuar*", planifikuar në shumën 400 mijë lekë nuk është realizuar pasi kjo shumë është përfshirë kontratën e trajnimit të Arsimit Bazë dhe Arsimit të Mesëm cituar si më sipër, lidhur në fund të vitit 2019, dhe është zhvilluar përgjatë vitit 2020.

Referuar shpenzimeve të përfshira në produkte të programit "***Planifikim, Menaxhim dhe Administrim***", rezulton se DRAP Durrës ka kryer shpenzime për pjesë këmbimi edhe nën produktin "*Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe miratuara"* edhe *"Punonjës dhe specialiste te trajnuar".*

Raporti i Monitorimit 8 mujor për DRAP Durrës për vitin 2019, përcjellë me shkresën nr. 482 prot datë 10.09.2019 në MASR nuk rezulton në përputhje me formatin standard të monitorimit të buxhetit, pasi përbëhet vetëm nga anekset e firmosura nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, duke mos përmbajtur asnjë relacion shpjegues për ndryshimet e planit, produktet, arsyet e mosrealizimit, etj.

Nga auditimi konstatohet se **nuk** rezulton të jetë përgatitur **raporti i monitorimit 8 mujor 2019 për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj.**

Nga auditimi konstatohet se në **raportin vjetor të monitorimit** për vitin 2019, përcjellë në MASR me shkresën nr. 77 prot datë 22.01.2020, shpenzimet për trajnimin e drejtuesve, Produkti 91101AC "*Drejtuesve te institucioneve arsimore te trajnuar*", janë deklaruara si të kontraktuara në shumën 179,344 lekë, megjithatë nga ana e subjektit nuk na është vendosur asnjë dokumentacion që përshkruan detajimin e fondeve të buxhetura në 3 programe të ndryshme, të cilat për zbatim janë përfshirë **nën të njëjtën procedurë prokurimi**.

Nga auditimi konstatohet se **nuk** rezulton të jetë përgatitur **raporti vjetor i monitorimit për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj** për vitin 2019.

Viti 2020

Niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2020, sipas 3 programeve në llogaritë respektive, trajtuar në bazë të planit fillestar dhe atij faktik, paraqitet në **aneksin nr.1.4.**

Nga auditimi konstatohet se buxheti i alokuar në DRAP Durrës ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga faza e PBA-së, në Buxhetin e miratuar vjetor. Gjithashtu, konstatojmë se përgjatë vitit, deri në fund të muajit gusht, buxheti i miratuar ka pësuar shumë ndryshime me efekt reduktimet e buxheteve në Programin e Arsimit Bazë dhe atij të Mesëm. Niveli i realizimit në total për tre programet paraqitet në masën 30% kundrejt planit te rishikuar. Nëse i referohemi planit fillestar, realizimi i shpenzimeve për DRAP Durrës rezulton rreth 15% kundrejt PBA 2020-2022 dhe planit të rishikuar.

Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi[10]			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Total
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar	10,440	1,74	1,905	0	**14,088**
		Realizuar	6,285	1,054	308	0	**7,648**
		Realizimi %	**60%**	**60%**	**16%**	**NA**	**54%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar	0	0	42,000	0	**42,000**
		Realizuar	0	0	3,100	0	**3,100**
		Realizimi %	**NA**	**NA**	**7%**	**NA**	**7%**
09230	**Arsimi I Mesëm**	Planifikuar	0	0	19,602	0	**19,602**
		Realizuar	0	0	1,064	0	**1,064**
		Realizimi %	**NA**	**NA**	**5%**	**NA**	**5%**
TOTALI		Planifikuar	**10,440**	**1,743**	**63,507**	**0**	**75,690**
		Realizuar	**6,285**	**1,054**	**4,473**	**0**	**11,813**
		Realizimi %	**60%**	**60%**	**7%**	**NA**	**15%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2020, realizimi i shpenzimeve në programin 01110 "***Planifikim, Menaxhim dhe Administrim***" deri në fund të muajit gusht 2020 ka qenë 54%, krahasuar me planin. Alokimi fillestar i fondeve të buxhetuara në këtë program, nuk ka pësuar ndryshime. Më hollësisht, realizimi i fondeve sipas produkteve të përfshira në program paraqitet si më poshtë:

Produkti 91101AA "*Punonjës dhe specialiste te trajnuar*" është realizuar në masën 0%, ku përfshihen 900 mijë lekë të planifikuara. Nëse i referohemi vitit 2019, nën këtë produkt janë përfshirë shpenzime të kryera nga DRAP Durrës për kancelari, pjesë këmbimi, internet, materiale të tjera.

Produkti 91101AE "*Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore*", për llogarinë 600, pagat e punonjësve është realizuar në masën 66%, 6,285 mijë nga 10,44 mijë lekë të planifikuara. Për llogarinë 601, sigurime shoqërore është realizuar në masën 65%, 1,054 mijë nga 1,743 mijë lekë të planifikuara. Për llogarinë 602, mallra dhe shërbime është realizuar në masën 30%, 308 mijë nga 1,005 mijë lekë të planifikuara. Në këto shpenzime janë përfshirë shpenzime të kryera nga DRAP Durrës për internet, tonera, dieta, siguracion dhe taksa makine, detergjent.

Nëse i referohemi buxhetit të DRAP Durrës në vitin 2019, nën programin 01110 "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*" është përfshirë edhe produkti 91101AD "*Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara*" ku drejtoria ka përfshirë shpenzime të kryera për pjesë këmbimi dhe naftë. Për vitin 2020 ky produkt nuk ka qenë pjesë e buxhetit të institucionit. E njëjtë gjë vlen edhe për produktin 91101AC "*Drejtuesve te institucioneve arsimore te trajnuar*", fondet për të cilin gjatë vitit 2019 ishin planifikuar dhe bërë pjesë e kontratës të lidhur në fund të vitit 2019 për kryerjen e trajnimeve nën 3 programe, atë të drejtuesve, arsimit bazë dhe të mesëm. Sipas raportit të monitorimit, 179 mijë lekë nga totali i kësaj kontrate, i përkisnin pikërisht këtij produkti. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2020, ku është likuiduar një faturë e kësaj kontrate në vlerën 4,164,736 lekë, ku nëse i referohemi nivelit të realizimit të deklaruar nga DRAP Durrës, janë raportuar shpenzimet nën produktin e **arsimit bazë dhe atij të mesëm**. Sipas drejtorisë na u bë me dije se këto shpenzime janë përllogaritur në bazë të pjesëmarrjes në trajnim të stafit akademik. Megjithatë, sikundër trajtohet më sipër ky trajnim është buxhetuar për të kryer edhe trajnim te drejtuesve.

Realizimi i shpenzimeve për programin 09120 "**Arsimi Bazë**", deri në fund të muajit gusht 2020 ka qenë 18%, krahasuar me planin e rishikuar dhe 7% me planin fillestar. Më hollësisht, realizimi i fondeve sipas produkteve të përfshira në program paraqitet si më poshtë:

Produkti 91103AE "*Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re*" është realizuar në masën 44%, 3,100 mijë lekë nga 7,000 mijë lekë të planifikuara. Buxheti i këtij produkti nuk ka pësuar ndryshime deri në fund të periudhës objekt auditimi.

[10] Planifikimi sipas programeve është paraqitur nëpërmjet planit fillestar për secilin zë

Produkti 91103AB "*Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar"* rezulton i pa realizuar. Nën këtë produkt janë buxhetuar fillimisht 35,000 mijë lekë, të cilat janë rishikuar për tu shpërndarë në zyrat vendore arsimore duke konkluduar në planin final prej 9,789 mijë lekë.
Realizimi i shpenzimeve për programin 09230 "***Arsimi i Mesëm***", deri në fund të muajit gusht 2020 ka qenë 13%, krahasuar me planin e rishikuar dhe 5% me planin fillestar. Më hollësisht, realizimi i fondeve sipas produkteve të përfshira në program paraqitet si më poshtë:
Produkti 91104AA "*Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike*" rezulton i pa realizuar. Nën këtë produkt janë buxhetuar fillimisht 18,102 mijë lekë, të cilat janë rishikuar për tu shpërndarë në zyrat vendore arsimore duke konkluduar në planin final prej 6,319 mijë lekë.
Produkti 91104AC "*Mësues të AML të trajnuar kurrikulën kl 10, 11, 12"* është realizuar në masën 70%, 1,064 mijë lekë nga 1,500 mijë lekë të planifikuara. Buxheti i këtij produkti nuk ka pësuar ndryshime deri në fund të periudhës objekt auditimi.
Pra, për vitin 2019-2020 konstatohet se realizimi i shpenzimeve të kryera nga subjekti **nuk përputhet me objektivat e produktit**. Alokimi i fondeve nuk rezulton të jetë kryer për shpenzime të ngjashme në produkte të njëjta për periudhën 2019-2020. Mospasja e vijueshmërisë në listimin e produkteve respektive sipas objektivave, vështirëson krahasueshmërinë mes zërave, e cila merr rëndësi kur bëhet fjalë për monitorime dhe/ose vlerësime të parashikimeve. Gjithashtu, nëse do t'i referohemi raportit final të konsoliduar të buxhetit të MASR, kryerja e shpenzimeve jo sipas objektivave nga DRAP, rezulton në një raportim jo të saktë të situatës, pasi njësia matëse e indikatorëve paraqitur në këtë raport, nuk reflektohet në shpenzimet e kryera nga njësitë e varësisë së MASR. Kjo situatë është vërejtur edhe në ZVAP Tiranë.
Më hollësisht, objektivat dhe njësia matëse e produkteve të programeve të buxhetit të DRAP Durrës, krahasuar me shpenzimet e përfshira në to për vitin 2019 dhe 2020 paraqiten sipas **aneksit nr.1.5.**
Raporti i Monitorimit i 4 mujorit të parë i vitit 2020 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et është përcjellë me shkresën nr. 710 prot datë 01.06.2020 në MASR dhe *rezulton kryesisht* në përputhje me formatin standard të monitorimit të buxhetit. Ai përmban relacionin përmbledhës për realizimin e shpenzimeve sipas 3 programeve. Në këtë raport është trajtuar niveli i realizimit kundrejt planit në total për DRAP Durrës dhe 12 Zyrat Arsimore që kjo drejtori ka në juridiksion.
Raporti i monitorimit të 4 mujorit të parë të vitit 2020 për institucionin e DRAP Durrës, është përcjellë me shkresën nr. 632 prot datë 08.05.2020 në MASR dhe rezulton kryesisht në përputhje me formatin standard të monitorimit të buxhetit. Ai përmban relacionin përmbledhës për realizimin e shpenzimeve sipas 3 programeve.
Raporti i Monitorimit i 8 mujorit të parë i vitit 2020 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-e është përcjellë me shkresën nr. 1401/2 prot datë 15.09.2020 në MASR. Në këtë dokument evidentohen shpenzimet e realizuara kundrejt planit për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj. Raporti përbëhet nga relacioni dhe anekset shoqëruese me shpenzimet sipas llogarive dhe programeve respektive.
Raporti i Monitorimit i 8 mujorit të parë i vitit 2020 për DRAP Durrës është përcjellë me shkresën nr. 1401/1 prot datë 10.09.2020 në MASR. Në këtë dokument evidentohen shpenzimet e realizuara kundrejt planit për DRAP Durrës ku evidentohet relacioni dhe anekset shoqëruese me shpenzimet sipas llogarive dhe programeve respektive.

III.2.1 ç. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.
Për vitin 2019 dhe 2020 DRAP Durrës nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur dytësore. Lidhur me të ardhurat dytësore në ZVAP-et që kjo drejtori ka në juridiksion, konstatohet se janë realizuar të

ardhura dytësore vetëm për ZVAP Dibër për vitin 2020 në shumën totale 1000 lekë. Kjo shumë ka rezultuar si dhuratë në mallra kancelarie për institucionin.

Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në ZVAP Tiranë

Grupi i auditimit shqyrtoi gjithashtu hartimin dhe zbatimin në **Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë** për vitin 2019 dhe periudhën Janar-Gusht 2020.

Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i planifikuar dhe realizuar për ZVAP Tiranë, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi		Viti			
		2019		2020	
		Planifikuar[11]	Realizuar	Planifikuar[12]	Realizuar[13]
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	20,437	20,420	21,790	12,420
II	Arsimi Bazë	2,595,477	2,584,631	2,988,833	1,959,924
III	Arsimi i Mesëm	1,079,663	1,077,708	1,173,566	746,765
Total		**3,695,578**	**3,682,760**	**4,184,190**	**2,719,110**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se ZVAP Tiranë për vitin 2019 dhe 2020 **nuk** rezulton të ketë publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet e monitorimit të buxhetit, në kundërshtim me udhëzuesin standard të zbatimit të buxhetit.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, miratuar sipas shkresës nr. 4699/1 prot datë 30.04.2019, neni 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, pika a e saj, përcakton "*Hartimin e projektbuxhetit të DRAP-së dhe ZVAP-ve dhe propozimin DPAP-së*", dhe neni 34, pika a "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve", e cila përcakton se "*Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it".* Në vijim të verifikimit të kryer në ZVAP Tiranë, rezulton se institucioni ka përcjellë në të njëjtën kohë dokumentacionet pranë DRAP Durrës, dhe MASR duke mos dokumentuar propozimin e tij fillimisht pranë DRAP; përcjelljen e komenteve nga DRAP për rishikim të materialit apo komente të tjera; deri në përgatitjen finale të tij pranë MASR.

Lidhur me realizimin e shpenzimeve sipas programeve dhe produkteve në të cilat është bërë çelja, konstatohet se jo në të gjitha rastet është vepruar në përputhje me objektivat e produktit. Realizimi i shpenzimeve në llogarinë 602 është kryer sipas fondeve disponibël në çeljen e produkteve, duke mos përcaktuar produktin sipas së cilit duhet të kryhet realizimi i fondeve si për vitin 2019, dhe 2020 (si psh shpenzime karburanti, elektrike, transporti, etj).

Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, miratuar sipas shkresës nr. 4699/1 prot datë 30.04.2019, neni 34 "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve" pranë ZVAP, pika a e saj, përcakton "*Hartimin e projektbuxhetit të ZVAP-ve dhe ia propozimin DRAP-it*".

Nga auditimi konstatohet se Drejtori i ZVAP Tiranë **nuk** ka dokumentuar ngritjen e grupit të punës për hartimin e PBA 2020-2022. Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", kapitulli 2.5 "Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit" dhe kapitulli 2.6 "Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit" pranë ZVAP Tiranë rezulton se **nuk** është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programit,

[11] Planifikimi për vitin 2019 paraqitet sipas planit përfundimtar pas ndryshimeve të kryera me alokimin e fondeve pas krijimit të DRAP

[12] Planifikimi për vitin 2020 paraqitet sipas planit përfundimtar pas ndryshimeve të kryera me alokimin e fondeve.

[13]Niveli i realizimit deri në 31.08.2020.

duke qenë se në buxhetin e ZVAP parashikimet e fondeve dhe alokimet janë në 3 programe. Drejtuesi i Ekipit të Programit është përgjegjës për hartimin e kërkesave buxhetore në programin në të cilën bën pjesë dhe realizimin e objektivave dhe produkteve të programit gjatë zbatimit të buxhetit.

Viti 2019

Duke qenë se ZVAP Tiranë është një institucion i riorganizuar gjatë vitit 2019, për buxhetin e vitit 2019 nga ZVAP Tiranë nuk është përgatitur dokumenti i PBA-së për periudhën 2019-2021, por disponohej PBA 2019-2021 e përgatitur nga ish-DAR dokument i cili përbëhet **vetëm** nga anekset shoqëruese, duke mos rezultuar në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*". Dokumenti nuk përmban përshkrimin e objektivave të institucionit në plotësim të synimeve dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit, sikundër përcakton shkresa nr. 7680, prot datë 16.07.2018 e MASR, Për përgatitjen e PBA 2019-2021. Në dokumentin e vendosur në dispozicion gjendet shkresa nr.2691, datë 10.08.2018 e ish Drejtorit DAR Tiranë, znj. A.B., në të cilin përcaktohet : Përcjellja e PBA 2018-2020.

Fondet janë planifikuar në total **3,230,252 mijë lekë**, nga të cilat 29,458 mijë lekë në programin "*Planifikim, menaxhim dhe administrim*", 2,263,049 mijë lekë në programin "*Arsimi Bazë*", dhe 937,846 mijë lekë në programin "*Arsimi i Mesëm".*

Planifikimi për Shpenzimet Korente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është kryer për fonde në vlerë totale 2,694,138 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601është kryer për fonde në vlerë totale 428,495 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjës në vlerë totale 25,520 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", në vlerë 82,200 mijë lekë.

Planifikimi për Shpenzimet Kapitale

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kapitale të Trupëzuara*" është kryer në bazë të nevojave të drejtorisë për vijimin e veprimtarisë së saj.

Viti 2020

Nga auditimi konstatohet se plani buxhetor afatmesëm 2020-2022 për ZVAP Tiranë është hartuar dhe përcjellë në DRAP dhe MASR në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*". Fondet janë planifikuar në total **4,656,056 mijë lekë**, nga të cilat 22,653 mijë lekë në programin "*Planifikim, menaxhim dhe administrim*", 3,343,708 mijë lekë në programin "*Arsimi Bazë*", dhe 1,289,696 mijë lekë në programin "*Arsimi i Mesëm".*

Planifikimi për Shpenzimet Korente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve dhe kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*" dhe strukturën e miratuar për ZVAP Tiranë në vlerë totale 3,937,833 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 janë mbështetur në Ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në vlerë totale 626,303 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, përcaktuar në bazën ligjore dhe rregullatore për funksionimin e ZVAP në vlerë totale 56,920 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" në vlerë totale 35,000 mijë lekë.

PBA 2021-2023

Me shkresën nr. 7561/1, prot datë 10.08.2020 është përcjellë relacioni për programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2021-2023, në vijim të shkresës nr. 3792/1, datë 14.07.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023" si dhe Udhëzuesit të MASR "Për hartimin e buxhetit në institucionet e arsimit për periudhën afatmesme 2021-2023". Në këtë relacion është pasqyruar baza ligjore e përdorur, dhe mënyrën e përllogaritjes së fondit të pagave dhe shpenzimeve në llogarinë 602. Nga auditimi konstatohet se PBA-ja e hartuar për periudhën objekt auditimi paraqitet me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", ku më hollësisht në kundërshtim me Kapitullin I, pikën 8 të tij, nuk është përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat, treguesit e performancës për programin dhe aktivitetet e planifikuara dhe relacionin shoqërues për kërkesat buxhetore. Gjithashtu, në relacion përcaktohet se për përgatitjen e PBA është ngritur grupi i punës në ZVAP Tiranë, por në këtë dokument nuk janë përcaktuar emrat e anëtarëve të grupit, si dhe është i pafirmosur.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2019

Pas krijimit të ZVAP Tiranë fondet buxhetore për vitin 2019 janë çelur fillimisht me vlerën totale **2,875,385 mijë lekë**, ku sipas programeve paraqiten si më poshtë:

Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 26,330 mijë lekë.

Shpenzime në programin Arsimi Bazë(09120), në shumën totale 1,957,357 mijë lekë.

Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 891,697 mijë lekë.

Në zbatim të ligjit nr. 99/2017, datë 3.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019" dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.68, datë 05.04.2019 për "Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar", janë kryer ndryshime në shpërndarjen e fondeve për vitin 2019.Ndryshimet e kryera në buxhetin e planifikuar për ZVAP Tiranë rezulton se **nuk** janë shoqëruar me shkresat respektive për informimin e institucionin lidhur me vendimmarrjen e MASR për ndryshimet në buxhet. Nga stafi i ZVAP Tiranë bëhet me dije se ndryshimet në buxhet i përcillen institucionit vetëm pas rakordimeve mujore me degën e thesarit. Informacioni është vendosur në dispozicion nga ZVAP Tiranë elektronikisht si më poshtë, ku sikundër vërehet **mungojnë të dhëna lidhur me periudhën në të cilën janë shtuar apo pakësuar fondet**. Buxheti fillestar paraqitet në shumën **2,875,385 mijë lekë**, ku përgjatë vitit *është shtuar me 820,193 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **3,695,578 mijë lekë.**

Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë:

Programi "*Planifikim, menaxhim dhe administrim*" është përcaktuar fillimisht në vlerën 26,330 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në reduktimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe janë alokuar shpenzime në llogarinë 606 që nuk ishin

përfshirë në çeljen fillestare të fondeve në produktin 91101AE. Si rezultat plani i rishikuar *është pakësuar me 5,893 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 20,437 mijë lekë.
Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 1,957,357 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91103AB dhe 91103AC. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim dhe më pas reduktim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 që nuk ishin përfshirë në çeljen fillestare të fondeve në produktet 91103AD dhe 91103AG. Si rezultat plani i rishikuar *është shtuar me 638,120 mijë lekë,* dhe rezulton në shumën 2,595,477 mijë lekë.
Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 891,697 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 që nuk ishin përfshirë në çeljen fillestare të fondeve në produktet 91104AE dhe 91104AG Si rezultat plani i rishikuar ë*shtë shtuar me 187,966 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 1,079,663 mijë lekë.
Planifikimi dhe ndryshimet në buxhet për vitin 2019 paraqiten më hollësisht në **aneksin nr 1.6**.

Viti 2020

Në zbatim të ligjit nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020" dhe udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", për ZVAP Tiranë janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **3,720,472 mijë lekë**, ku sipas programit si më poshtë:
Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 21,405 mijë lekë.
Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 2,813,021 mijë lekë.
Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 886,045 mijë lekë.
Gjatë vitit 2020 janë kryer ndryshime në shpërndarjen e fondeve, të cilat rezultojnë se **nuk** janë shoqëruar me shkresat respektive për informimin e institucionin lidhur me vendimmarrjen e MASR për buxhetin e tij. Nga stafi i ZVAP Tiranë bëhet me dije se ndryshimet në buxhet bëhen me dije për institucionin vetëm pas rakordimit me degën e thesarit.Informacioni është vendosur në dispozicion nga ZVAP Tiranë elektronikisht si më poshtë, ku sikundër vërehet **mungojnë** të dhëna lidhur me periudhën në të cilën janë shtuar apo pakësuar fondet. Buxheti fillestar paraqitet në shumën **3,720,472 mijë lekë**, ku përgjatë vitit *është shtuar me 463,718 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar deri në fund të muajit gusht 2020 rezulton në shumën **4,184,190 mijë lekë.**
Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë:
Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 21,405 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim dhe pakësim të shpenzimeve për paga dhe sigurime. Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 385 mijë lekë,* dhe rezulton në shumën 21,790 mijë lekë.
Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 2,813,021 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91103AB, 91103AC dhe 91103AD. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 që nuk ishin përfshirë në çeljen fillestare të fondeve. Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 175,812 mijë lekë,* dhe rezulton në shumën 2,988,833 mijë lekë.

Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 886,045 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 që nuk ishin përfshirë në çeljen fillestare të fondeve në produktet 91104AE dhe 91104AG Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 287,521 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 1,173,566 mijë lekë. Planifikimi dhe ndryshimet në buxhet për periudhën janar-gusht 2020 paraqiten më hollësisht në **aneksin nr 1.7 .**

Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2019

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Tiranë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2019 sipas PBA 2019-2022	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	29,458	26,330	20,437	20,420
Arsimi Bazë	2,263,049	1,957,357	2,595,477	2,584,631
Arsimi i Mesëm	937,846	1,079,663	1,077,708	-1,955
Total	**3,230,353**	**2,875,385**	**3,695,578**	**3,682,760**

Për sa i përket realizimit të buxhetit të vitit 2019 për ZVAP Tiranë, sipas 3 programeve në nivel produkti në llogaritë respektive, trajtuar në bazë të planit fillestar dhe atij faktik, paraqitet në **aneksin nr.1.8.**

Nga auditimi konstatohet se buxheti i alokuar në ZVAP Tiranë ka pësuar disa ndryshime në alokimin e fondeve të drejtorisë. Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99 % kundrejt planit te rishikuar dhe 128% kundrejt planit fillestar. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **3,695,578 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **3,682,760 mijë lekë**. Niveli i lartë i realizimit vjen për shkak të alokimit të fondeve sipas nevojave të institucionit, duke kryer shtesa/pakësime të shumta përgjatë vitit.

Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2019							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	16,710	2,411	1,147	168	**20,437**
		Realizuar	16,710	2,411	1,129	168	**20,420**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**98%**	**100%**	**99%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	2,128,777	345,201	31,110	90,388	**2,595,477**
		Realizuar	2,128,777	345,201	20,163	90,013	**2,584,631**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**64%**	**99%**	**99%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	902,005	160,356	8,151	9,148	**1,079,663**
		Realizuar	902,005	160,356	6,344	9,000	**1,077,708**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**78%**		**99%**
TOTALI		Planifikuar	3,047,492	507,968	40,408	99,704	**3,695,578**
		Realizuar	3,047,492	507,968	27,636	99,181	**3,682,760**
		Realizimi	**100%**	**100%**	**68%**	**99%**	**99%**

[14] Sipas planit të rishikuar
[15] Sipas planit të rishikuar
[16] Sipas planit të rishikuar

	%					

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Lidhur me programin 01110 "***Planifikim, Menaxhim, Administrim*":**

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën **20,437 mijë lekë**, nga të cilat janë realizuar **20,420 mijë lekë (99%** realizimi) Për këtë program konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 98% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Lidhur me programin 09120 "***Arsimi Bazë***":

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën **2,595,477 mijë lekë**, nga të cilat janë realizuar **2,584,631 mijë lekë (99%** realizimi). Për këtë program konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 64% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99%.

Lidhur me programin 09230 "***Arsimi i Mesëm***":

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën **1,079,663 mijë lekë**, nga të cilat janë realizuar **1,077,708 mijë lekë (99%** realizimi). Për këtë program konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 68% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99%.

Nëse i referohemi **realizimit të shpenzimeve 602 sipas produkteve** në të cilat ato janë përfshirë, konstatohet si më poshtë:

Për programin "**Planifikim, menaxhim, administrim**"(01110), shpenzimet totale për mallra dhe shërbime **(602)** paraqiten në vlerën 1,129 mijë lekë, të cilat në nivel produkti janë përdorur si më poshtë:

Për produktin **91101AE** janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 1,037 mijë lekë:
-Shpenzime kancelarie në vlerë 707 mijë lekë;
-Shpenzime për karburant dhe vaj në vlerë 330 mijë lekë.

Në llogarinë 602, për produktin **91101AA** janë përfshirë shpenzime në vlerë 92 mijë lekë:
-Shpenzime telefonike në vlerë 10 mijë lekë;
-Shpenzime për pagesë ujë në vlerë 75 mijë lekë;
-Shpenzime të tjera material dhe operative, nxënësit e shkollës së baletit në vlerë 5 mijë lekë.

Në llogarinë **606** janë kryer shpenzime për shpërblim dalje në pension në shumën 168 mijë lekë.

Për programin "**Arsimi i Mesëm" (09230)** shpenzimet totale për mallra dhe shërbime **(602)** paraqiten në vlerën 6,344 mijë lekë, të cilat në nivel produkti janë përdorur si më poshtë:

Për produktin **91104AA** janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 4,124 mijë lekë:
-Shpenzime transporti në shumën 3,998 mijë lekë
-Shpenzime energjie elektrike për shkollën Loro Borici 126 mijë lekë.

Për produktin **91104 AB** në shumën totale 2,220 mijë lekë që përfshijnë:
-Shpenzime elektrike për shkollën Loro Borici në vlerë 361 mijë lekë
-Shpenzime telefonike internet në shumën 263 mijë lekë
-Shpenzime për modelet, E.D. në shumën 1,000 mijë lekë
-Shpenzime për modelet, N.H. material sculpture në shumën 585 mijë lekë
-Shpenzime për sigurim jete udhëtimi shkolla e baletit në shumën 10 mijë lekë.

Në llogarinë **606** janë kryer shpenzime për shpërblim dalje në pension në shumën 6,151 mijë lekë dhe subvencione libri në shumën 83,861 mijë lekë.

Për programin "**Arsimi bazë" (09120)** shpenzimet totale për mallra dhe shërbime **(602)** paraqiten në vlerën 20,638 mijë lekë, të cilat në nivel produkti janë përdorur si më poshtë:

Për produktin **91103AA** janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 475 mijë lekë për shpenzime modelim pikture.
Në produktin **91103AB** janë kryer shpenzime totale në shumën 20,163 mijë lekë, që përfshijnë:
-Shpenzime telefonike internet në shumën 646 mijë lekë
-Shpenzime pastrimi dhe gjelbërimi në shumën 15 mijë lekë.
-Shpenzime për vendime gjyqësore në shumën 2,703 mijë lekë
-Shpenzime dieta matura shtetërore në shumën 210 mijë lekë
-Shpenzime transporti në shumën 13,261 mijë lekë
-Shpenzime materialesh për nxënësit e shkollës së baletit në shumën 1,240 mijë lekë.
-Shpenzime kancelarie në shumën 223 mijë lekë.
-Shpenzime modele në shumën 149 mijë lekë.
-Shpenzime riparim pajisje elektronike H.Sh. në shumën 101 mijë lekë.
-Shpenzime material pikture në shumën 109 mijë lekë.
-Shpenzime akordim pianosh në shumën 911 mijë lekë.
-Shpenzime material pikture në shumën 420 mijë lekë.
-Shpenzime material sportive në shumën 170 mijë lekë.
-Shpenzime modelim pikture në shumën 475 mijë lekë.
Në llogarinë **606** janë kryer shpenzime për shpërblim dalje në pension në shumën 2,199 mijë lekë dhe subvencione libri në shumën 6,801 mijë lekë.
Nga sa më sipër rezulton se për produktin **91101AE "Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore**", ZVAP Tiranë i ka përdorur fondet e dedikuara për shpenzime kancelarie dhe karburant. Fondet e dedikuara për produktin **91101AA** "**Punonjës dhe specialiste të trajnuar"**, janë përdorur për material telefonike, pagesa uji dhe shpenzime të tjera operative për materiale.
Në produktin **91103AAPunonjës dhe specialiste të trajnuar** janë përfshirë vetëm shpenzime për modele. Në produktin **91103AB**"**Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar**" janë përfshirë shpenzime për telefoni, internet, vendime gjyqësore, dieta, transporti, kancelari, modele, riparim pajisje elektrike, etj.
Në produktin **91104AA "Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike"** janë përfshirë shpenzime transporti dhe energjie elektrike. Shpenzimet e energjisë rezultojnë të shpenzuara edhe në fondet e buxhetuara për produktin **91104AB "Mësues te AML qe përfitojnë shërbimin e transportit.",** në të cilin janë përfshirë shpenzime elektrike, telefonike, sigurimin e jetës dhe për modele.
Nga sa më sipër, rezulton se shpenzimet në llogarinë **602**, **nuk** janë kryer sipas objektivave të produktin, ku vërehet si më sipër, se për të njëjtat zëra, janë kryer shpenzime në produkte të ndryshme. Kjo, pasi edhe çelja nga MASR është bërë jo gjithmonë për të njëjtat produkte, edhe pse nuk rezulton të ketë patur ndryshim në objektivat institucional të ZVAP Tiranë për periudhën 2019-2020.
Raporti i Monitorimit 4 mujor i ish-DAR Tiranë për vitin 2019, është përcjellë me shkresën nr. 1935 prot datë 08.04.2019 në MASR. Ky dokument **nuk** rezulton në përputhje me formatin standard të monitorimit të buxhetit, pasi përbëhet **vetëm** nga anekset e firmosura nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, duke mos përmbajtur asnjë relacion shpjegues për ndryshimet e planit, produktet, arsyet e mosrealizimit, etj.
Raporti i Monitorimit 8 mujor dhe **Raporti vjetor** për vitin 2019 **nuk** u vendosën në dispozicionin grupit të auditimit.

Viti 2020
Në mënyrë të përmbledhur planifikimi sipas PBA, planit fillestar 2020, atij të rishikuar dhe realizimi për vitin 2020, si dhe realizimi faktik i vitit paraardhës, deri në fund të muajit gusht rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Titulli	Emërtimi	Realizimi 2019	PBA (2020-2022)	Plan Fillestar Viti 2020	Plan i Rishikuar Viti 2020	Realizimi (Janar-Gusht 2020)
0001	Programi 01110	20,420	22,653	21,406	21,790	12,420
0002	Programi 09120	2,584,632	3,343,708	2,813,021	2,988,833	1,959,924
0003	Programi 09230	1,077,709	1,289,696	1,117,499	1,173,566	746,765
Totali		**3,682,761**	**4,646,056**	**3,951,926**	**4,184,190**	**2,719,110**

Burimi: ZVAP Tiranë dhe përpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2020 për ZVAP Tiranë, sipas 3 programeve në llogaritë respektive, trajtuar në bazë të planit fillestar dhe atij faktik sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga subjekti, paraqiten sipas **aneksit nr.1.9.**

Nga auditimi konstatohet se buxheti i alokuar në ZVAP Tiranë ka pësuar disa ndryshime në alokimin e fondeve të drejtorisë. Niveli i realizimit në total **për tre programet** deri në fund të muajit gusht 2020 paraqitet në masën 64 % kundrejt planit te rishikuar dhe 68% kundrejt planit fillestar. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **4,184,190 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **2,719,110 mijë lekë**. Krahasuar me vitin 2019, konstatohet se deri në gusht 2020, plani i rishikuar i fondeve rezulton 488,612 mijë lekë më i lartë se plani i rishikuar i vitit paraardhës.

Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2019							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[17]	17,300	3,390	1,100	0	**21,790**
		Realizuar	9,883	1,650	886	0	**12,420**
		Realizimi %	**57%**	**48%**	**80%**	**%**	**56%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[18]	2,562,866	385,320	1,690	39,005	**2,988,833**
		Realizuar	1,655,188	287,270	0	17,464	**1,959,924**
		Realizimi %	**64%**	**74%**	**0%**	**44%**	**65%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[19]	994,371	176,926	1,901	366	**1,173,566**
		Realizuar	633,013	111,856	1,621	273	**746,765**
		Realizimi %	**63%**	**63%**	**85%**	**75%**	**64%**
TOTALI		Planifikuar	3,574,537	565,636	4,691	**39.371**	**4,184,190**
		Realizuar	2,298,084	400,776	2,507	17,737	**2,719,110**
		Realizimi %	**64%**	**70%**	**53%**	**45%**	**64%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Lidhur me programin 01110 "**Planifikim, Menaxhim, Administrim**":

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën **21,790 mijë lekë**, nga të cilat janë realizuar deri në gusht 2020, **12,420 mijë lekë (56%** realizimi) Për këtë program konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga është në masën 57%, dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 48%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 80% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore nuk ka patur.

Lidhur me programin 09120 "***Arsimi Bazë***":

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën **2,988,833 mijë lekë**, nga të cilat janë realizuar deri në fund të muajit gusht 2002, **1,959,924 mijë lekë (65%** realizimi). Për

[17] Sipas planit të rishikuar
[18] Sipas planit të rishikuar
[19] Sipas planit të rishikuar

këtë program konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga është në masën 64%, dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 74%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 0% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 44%.

Lidhur me programin 09230 "***Arsimi i Mesëm***":

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën **1,173,566 mijë lekë**, nga të cilat janë realizuar **746,765 mijë lekë (64%** realizimi). Për këtë program konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga është në masën 63%, po ashtu edhe ai për sigurime shoqërore (63%). Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 85% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 75%.

Nëse i referohemi realizimit të shpenzimeve 602 sipas produkteve në të cilat ato janë përfshirë, konstatohet si më poshtë:

Për 8 mujorin e parë të vitit 2020, **në kodin 01110 "Planifikim, Menaxhim, Administrim"**, për shpenzime të llog 602, janë kryer shpenzime totale në shumën 887 mijë lekë të cilat në nivel produkti paraqiten si më poshtë:

Për produktin **91101AE** janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 698 mijë lekë:
-Shpenzime Kancelarie në vlerë 360 mijë lekë
-Shpenzime për karburant dhe vaj në vlerë 337 mijë lekë

Për produktin **91101 AA** janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 189 mijë lekë:
-Shpenzime të pastrimit dhe gjelbërimit 15 mijë lekë
-Shpenzime elektricitet 159 mijë lekë
-Shpenzime uji 4 mijë lekë
-Shpenzime telefonike 5 mijë lekë
-Shpenzime të tjera material 3 mijë lekë.

Për 8 mujorin e parë të vitit 2020, **në kodin 09120 Arsimi Bazë** për shpenzime të llog 602 janë në total 15,053 mijë lekë të gjitha në produktin **91103 AD:**
-Blerje uniformash në vlerë 1,658 mijë lekë
-Shërbime bexha në vlerë 37 mijë lekë
-Shpenzime transporti në vlerë13,357 mijë lekë
-Shpenzime materiale dhe shërbime operative modele pikture në vlerë 270 mijë lekë

Në llogarinë **606** janë kryer shpenzime për shpërblim dalje në pension në shumën 273 mijë lekë.

Për 8 mujorin e parë të vitit 2020, **në kodin 09230 Arsimi i Mesëm**, për shpenzime të llog 602 janë kryer në vlerë totale 1,621 mijë lekë:

Për produktin **91104AA** janë përfshirë shpenzime gjyqësore në vlerë 621 mijë lekë:
Për produktin **91104 AB** shpenzime për blerje uniformash liceu në vlerë 1,000 mijë lekë.

Në llogarinë **606** janë kryer shpenzime për shpërblim dalje në pension në shumën 2,141 mijë lekë

Pra, problematika e konstatuar në DRAP Durrës është identifikuar edhe në ZVAP Tiranë, ku realizimi i shpenzimeve të kryera nga subjekti nuk përputhet me objektivat e produktit. Alokimi i fondeve nuk rezulton të jetë kryer për shpenzime të ngjashme në produkte të njëjta për periudhën 2019-2020. Mospasja e vijueshmërisë në listimin e produkteve respektive sipas objektivave, vështirëson krahasueshmërinë mes zërave, e cila merr rëndësi kur bëhet fjalë për monitorime dhe/ose vlerësime të parashikimeve. Gjithashtu, nëse do t'i referohemi raportit final të konsoliduar të buxhetit të MASR, kryerja e shpenzimeve jo sipas objektivave nga ZVAP-et, rezulton në një raportim jo të saktë të situatës. Më hollësisht, objektivat dhe njësia matëse e produkteve të programeve të buxhetit të ZVAP Tiranë krahasuar me shpenzimet e përfshira në to për vitin 2019 dhe 2020 paraqiten në **aneksin nr 1.10**.

Raporti i Monitorimit të 4 mujorit të parë të vitit 2020, është përcjellë vetëm elektronikisht në DRAP Durrës, sipas email-it të datës 19.05.2020. Shkak për këtë, sipas komunikimit me subjektin

është bërë situata e COVID-19. Në përputhje me udhëzimin e procedurave standard të monitorimit të buxhetit është përcjellë relacioni përmbledhës dhe tabelat bashkëshoqëruese. Në tabelat bashkëshoqëruese konstatohet se nuk janë deklaruar vlerat e planifikuara për vitin 2020 sipas dokumentit të PBA-së, me përjashtim të shpenzimeve për transferta buxhetore (llog.606), për programin e arsimit të mesëm, në të cilin është reflektuar planifikimi në PBA për shumën 5,383 mijë lekë.

Raporti i Monitorimit i 8 mujorit të parë të vitit 2020 është përcjellë me shkresën nr. 8431 prot datë 10.09.2020 në MASR dhe rezulton në përputhje me formatin standard të monitorimit të buxhetit, sipas udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave "Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore". Ai përmban relacionin përmbledhës për realizimin e shpenzimeve sipas llogarive të shpenzimeve, por jo në nivel programesh. Bashkëlidhur me relacionin janë pasqyruar edhe anekset analitike.

Në këtë raport është evidentuar edhe fakti që pas ristrukturimit të drejtorisë në vitin 2019, si rezultat i ndryshimeve në shpenzime, nuk mund të kryhet një krahasim i shpenzimeve me periudhat e mëparshme.

Shpenzimet e transportit paraqesin një nivel të konsiderueshëm mosrealizimi (68.1% kundrejt planit të periudhës dhe 43.3% kundrejt planit vjetor), si rezultat i mos kryerjes së shpenzimeve të transportit gjatë pandemisë, si dhe mos realizimi një procedure tenderi.

Totali i fondeve për ZVAP Tiranë në tabelën në faqen 2, paraqitet në shumën 4,181,190,564, por nga verifikimi i shpenzimeve, rezulton se kjo shumë duhet të ishte në vlerën 4,184,190,564 lekë.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

Për vitin 2019 dhe 2020 ZVAP Tiranë nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur dytësore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 189/2, prot datë 13.01.2020 "Dërgim observacionesh" nga znj. Ana Dhamo, Drejtore e DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Kërkesat për fond në paga e sigurime shoqërore janë bazuar në organikat e miratuara apo edhe në kërkesat për shtesë numri punonjësish, vërtetuar edhe me korrespondencat e DRAP Durrës me ZVAP-et respektive ku në disa raste PBA është kthyer për saktësim të dhënash, për të vazhduar më tej me pasqyrat përmbledhëse për 12 ZVAP-et dhe DRAP Durrës. Theksojmë se flitet për zyra të reja dhe shumica janë të rinj në këtë detyrë, dhe nuk mund të le pa theksuar bashkëpunimin me ZVAP-et për të hartuar PBA sa më korrekte. Pasi është hartuar PBA 2020-2022 dhe PBA 2-21-2023, është dërguar në DPAP dhe MASR.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se rekomandimi i grupit të auditimit për sa i përket hartimit të PBA-ve nga ZVAP dhe bashkëpunimit me DRAP Durrës për hartimin e PBA-ve të konsoliduara, ka si qëllim rregullimin e këtij procesi në mënyrë që të krijohen gjurmë auditimi, për të dalluar kështu rolin e DRAP Durrës në konsolidimin e të dhënave, nga ai i ZVAP në hartimin fillestar e më pas atë përfundimtar në vijim të komenteve/sqarimeve/sugjerimeve të DRAP Durrës. Gjithashtu, ky rekomandim vjen edhe si pasojë e shmangies së praktikave ku ZVAP-et dërgojnë individualisht PBA-të apo raportet e monitorimit të buxhetit në DRAP Durrës, DPAP dhe MASR, për sa kohë ky është roli i DRAP Durrës.

Pretendimi i subjektit: Likuidimi i pjesëve të këmbimit është bërë në 2 kode produkti të ndryshme "Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe miratuara" dhe "Punonjës dhe specialistë të trajnuar" është bërë pasi automjeti i institucionit tonë është përdorur edhe për specialistë që kanë bërë monitorime të trajnimeve të bëra si dhe për plotësimin e dokumentacioneve të prokurimit për trajnimin e mësuesve. Viti 2019 ishte viti i parë që filluan të përdoreshin këto kode dhe kuptimi ishte shumë i gjerë, "Punonjës dhe specialistë të trajnuar". Emërtimi i tyre në lejon përdorimin e tyre në funksion të qëllimit që është realizimi i trajnimeve, gjithmonë në konceptin tonë dhe në

konsultë me institucionet e varësisë. DRAP Durrës për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 ka parashikuar vetëm për një program, pasi për vitin 2019 nuk ka qenë e përcaktuar qartë çfarë detyrimesh do i delegoheshin nga MASR për të likuiduar DRAP Durrës, po kështu edhe për buxhetin 2020-2022 e njëjta situatë. Sqarojmë se shumë prokurime i merr përsipër për tu kryer nga MASR apo AKSHI për internetin e institucioneve arsimore, prokurimin për mjete didaktike apo dëftesa, regjistra, mjete didaktike për kopshtet. Në lidhje me përgjegjësitë e ekipit për secilin program për DRAP Durrës nga vetë pozicioni i çdo specialisti në grupin e punës janë grumbulluar dhe të dhënat për hartimin e PBA-ve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit*:*

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se lidhur me likuidimin e shpenzimeve në produkte me objektiva të ndryshëm nga ato për sa është kryer planifikimi dhe raportimi më pas në raportet e monitorimit të MASR, sqarojmë se produkti "Punonjës dhe specialiste te trajnuar" sikundër paraqitet nga MASR ka objekt "Rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese/Trajnimi çdo vit për 100-110 drejtues të institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor" me njësi matëse " Numrin e drejtuesve te trajnuar dhe numrin e auditimeve dhe inspektimeve te realizuara" të cilat kurrsesi nuk lidhen me likuidimin e pjesëve të këmbimit, pasi sikundër rezulton për vitin 2019, nën këtë produkt është planifikuar trajnimi i stafit të institucioneve arsimore, me njësi matëse, numrin e pjesëmarrësve të trajnuar. Gjithashtu, produkti "Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara" ka si njësi matëse "Numrin e akteve te miratuar", i cili sërish nuk mund lidhet me kryerjen e shpenzimeve për pjesë këmbimi. Rishikimet e buxhetit të DRAP Durrës, kryhen në bazë të nevojave të institucionit, dhe përgjatë vitit DRAP mund të kryejë ndryshime në planin në nivel produkti duke paraqitur kërkesat pranë DPAP dhe MASR, në mënyrë që të shmangen praktikat ku raportimi i shpenzimeve në raportin e konsoliduar të përgatitur nga MASR ku analizohen edhe indikatorët sipas njësive matëse të produkteve, nuk reflekton situatën reale të shpenzimeve të kryera nga institucionet e varësisë.

Pretendimi i subjektit: Buxheti i alokuar për citin 2020 ka patur mjaft ndryshime bazuar në një sërë situatash të ndodhura si me urdhrin nr.135, datë 09.03.2020 "Për mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jo publike dhe çerdheve", i ndryshuar të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u vendos mbyllja e institucioneve arsimore publike. Me VKM nr.243, datë 24.03.2020 "për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", i ndryshuar është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyre në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së COVID, ku u miratuan një sërë aktesh, dhe urdhri nr.96, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondi limit të kontratës me objekt "Blerje pajisje didaktike Arsimi Bazë dhe Arsimi i Mesëm". Sjellim në vëmendje se me shkresën nr. 1240,datë 13.02.2020 të MASR "Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH", ngarkohen DRAP-et për të bërë kërkesën për rishpërndarje fondi për palën debitorë. ZVAP Dibër ka 15 raste vendime gjyqësore, ZVAP Tiranë 3, ZVAP Mat dhe ZVAP Durrës. Pra, fondet e alokuara nga DRAP Durrës janë pakësuar duke u bërë shtesë fondesh ZVAP-eve përkatëse. ZVA Dibër ka sjellë mos realizimin më të lartë, pasi punonjësja ka qenë e re. Pra, rishpërndarjet e fondeve kanë patur për qëllim mbulimin e detyrimeve të akumuluara për shpenzime gjyqësore të ZVAP-eve, duke bërë gatë vitit rishpërndarje sipas rasteve për llogari të ZVAP-eve nga ana e MASR-së.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga verifikimet e kryera në ZVAP-e, vendimet gjyqësore të dorëzuara në këto subjekte i përkasin periudhave përgjatë ose përpara vitit 2019, pra institucionet kanë patur informacion lidhur me nevojat respektive për fonde në fillim të vitit 2020. Në këto kushte, rishikimet e shpeshta të buxhetit të DRAP Durrës, në periudha të ndryshme kohore përgjatë vitit, nuk mund të lidhen me kërkesat për likuidim të shpenzimeve gjyqësore, pasi në asnjë rast nuk është konstatuar likuidimi i shpenzimeve të vitit 2020; pra të dorëzuara rishtazi në institucione, për të cilat subjekti mund të mos ketë patur

informacion, dhe në këto kushte të ketë lindur nevoja për alokim buxheti për ZVAP (dhe rishikim i buxhetit të DRAP Durrës).

1. Titulli i Gjetjes:	**Mangësi të konstatuara në hartimin e PBA-ve nga DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë**
Situata:	-Nga verifikimi i kryer në DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë për plotësinë dhe saktësinë e përgatitjes së propozimeve të buxhetit, konstatohet se jo në të gjitha rastet dokumentacioni paraqitej në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018. Më hollësisht, në zbatim të kapitullin 2.5 dhe kapitulli 2.6 të udhëzimit nr.7, për përgatitjen e PBA 2020-2022 dhe 2021-2023, pranë DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë **nuk** rezulton të jetë përcaktuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, edhe pse institucionet për periudhën 2019-2020 kanë menaxhuar fonde në **3 programe të ndryshme**. -Në PBA-në 2020-2022 dhe 2021-2023, **DRAP Durrës** nuk ka hartuar deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit, si dhe dokumenti nuk paraqitet plotësisht në formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit në dokumentin "*Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2020-2022"* dhe "*Format 2-Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2021-2023-Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi."*. E njëjta situatë u vërejt edhe në përgatitjen e PBA 2019-2021 **nga ish-DAR Tiranë** dhe PBA 2021-2023 nga **ZVAP Tiranë.** -Nga auditimi konstatohet se DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë kanë funksionuar si institucione të pavarura, ku përcjellja e PBA-ve të hartuara prej tyre është bërë në mënyrë direkte në MASR, sipas afateve respektive. Nuk rezultojnë të jenë dokumentuar propozimet e ndërsjellta nëpërmjet institucioneve, deri në miratimin final të PBA-së së konsoliduar, me qëllim hartimin e gjurmës së auditimit të këtij procesi, sipas rregullores për organizimin dhe funksionimin. -Nga auditimi rezultoi se ekzistojnë diferenca mes kërkesave buxhetore të DRAP Durrës në fazën e PBA-së, dhe fondeve të alokuara. Më hollësisht, planifikimi nga institucioni është bërë **vetëm për 1 program buxhetor**, "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"* ndërkohë që alokimi i fondeve për vitin 2019 dhe 2020 nga MASR është kryer në **3 programe.** Për vitin **2020** rezulton se fondet janë parashikuar nga DRAP Durrës në vlerën totale rreth 75 milion lekë vetëm për programin "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*", nga të cilat shpenzime korente në vlerë rreth 27 milion lekë dhe shpenzime kapitale në vlerë rreth 48 milion lekë. Alokimi i fondeve është kryer në vlerën totale rreth 75 milion lekë, **por të gjitha shpenzime korente,** nga të cilat programi "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*" rreth 14 milion lekë (*pra 61 milion lekë më pak se kërkesa në total për programin në PBA dhe 13 milion lekë më pak se kërkesa për shpenzime korente nën këtë program në PBA*), "*Arsimi Bazë*" 27 milion lekë dhe "*Arsimi i Mesëm*" 48 milion lekë. Për vitin **2019** sipas PBA 2019-2022 ish DAR Tiranë ka planifikuar fonde në vlerë 3,230 milion lekë, ku rezultojnë te jenë alokuar në buxhetin fillestar të **ZVAP Tiranë** 2,875 milion lekë (**pra 355 milion lekë më pak se kërkesat në PBA**). Në nivel programi, rezultojnë se për programin "*Planifikim Menaxhim Administrim*" janë alokuar 3 milion lekë më pak se

	plani, për programin "*Arsimi Bazë"* 306 milion lekë më pak, dhe për programin "*Arsimi i Mesëm*" 142 milion lekë më shumë". Për vitin **2020** sipas PBA 2020-2023 **ZVAP Tiranë** ka planifikuar fonde në vlerë 4,646 milion lekë (964 milion lekë më shumë se realizimi faktik i vitit 2019), ku rezultojnë te jenë alokuar në buxhetin fillestar 3,951 milion lekë (*pra 695 milion lekë më pak se kërkesat në PBA*). Në nivel programi, rezultojnë se për programin "Planifikim Menaxhim Administrim" janë alokuar 1 milion lekë më pak se plani, për programin "Arsimi Bazë" 530 milion lekë më pak, dhe për programin "Arsimi i Mesëm" 172 milion lekë më pak.
Kriteri:	Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, neni 24 pika a, ku përcaktohet se Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës në DRAP përgatiti projektbuxhetin e DRAP dhe ZVAP-ve dhe ja propozon DPAP; dhe neni 34 pika a e saj ku përcaktohet se, Sektori i Shërbimeve në ZVAP harton projektbuxhetin dhe ja propozon DRAP; Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", kapitulli 2.5 dhe 2.6; "*Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2020-2022*"; "*Format 2- Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2021-2023- Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi*. "
Ndikimi/Efekti:	Mos përcjellja e PBA-ve fillimisht në formë propozimi në nivelin e parë të hierarkisë së institucionit (DRAP), përpara miratimit final në MASR nuk ka lejuar kryerjen dhe dokumentimin e komenteve apo propozimeve të mundshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë së dokumentit; Mungesa e vijimësisë mes kërkesave të fondeve në nivel programi, dhe alokimin e tyre në buxhetin e miratuar cënon realizimin e objektivave institucional, sipas së cilave duhet të mbështetet hartimi i PBA-së.
Shkaku:	Mos njohja e plotë e kuadrit rregullativ nga personeli përgjegjës, si dhe linjat e shumta të hierarkisë për shkak edhe të ndryshimeve si pasojë e ristrukturimit që kanë krijuar shpesh herë konfuzion në institucione; Mos kryerja e planifikimit nga DRAP Durrës në përputhje me alokimin e fondeve në periudhat e mëparshme, ku më hollësisht edhe pse alokimi për institucionin bëhet për 3 programe, kërkesat e PBA trajtojnë vetëm 3 programe.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit në DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, në vijim të ngritjes së Ekipit të Menaxhimit të Programit nga titullari i institucionit, me qëllim menaxhimin efektiv të programeve buxhetore, të marrin masat për hartimin e dokumentit të projektbuxhetit për periudhat e ardhshme në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ, me qëllim përcjelljen për në MASR të një informacioni sa më të plotë, duke përfshirë deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit. DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj dhe DPAP, të marrin masat për kryerjen e një planifikimi sa më efektiv dhe koherent të fondeve, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë vijimësisë së kërkesave të fondeve në nivel programi buxhetor, në mënyrë që të mos ketë diferenca të konsiderueshme mes fondeve të propozuara për miratim në fazën e projektbuxhetit, dhe atyre të alokuara nga MASR,

	të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave institucional, sipas së cilave duhet të mbështetet hartimi i PBA-së. Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës, të marrin masat për përcjelljen e planifikimit zyrtar të projektbuxhetit fillimisht në DRAP Durrës, me qëllim reflektimin e komenteve apo propozimeve prej kësaj drejtorie, përpara dërgimit zyrtar të PBA-së për miratim në MASR, në mënyrë që të krijohet gjurma e auditimit e të gjithë procesit të ndjekur për përmirësimin e cilësisë së këtij dokumenti.

2. Titulli i Gjetjes:	**Rishpërndarjet e shpeshta të fondeve buxhetore përgjatë vitit në DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë**
Situata:	Nga auditimi rezultoi një planifikim i dobët i buxhetit të DRAP Durrës dhe ZVAP-eve nën juridiksionin e saj. Konstatohet se nuk është ndjekur procedura e saktë për ndryshimet buxhetore të ndodhura (shtesa/pakësime/rialokime), pasi njësitë shpenzuese nuk kanë qenë ato të cilat iniciojnë ndryshimet në buxhet, por thjesht vihen në dijeni për to pas faktit, gjatë rakordimeve me degët e thesarit. Konstatohet se në vitin 2020, **DRAP Durrës** i janë alokuar fonde për të menaxhuar dhe administruar programet "Arsimi Bazë" dhe "Arsimi i Mesëm", fonde të cilat nuk rezultojnë të përdoren për ekzekutimin e pagesave të kësaj drejtorie, por përgjatë vitit ato transferohen në ZVAP-e sipas nevojave respektive, praktikë kjo që konsiston në ndryshime të shpeshta të fondeve, me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit (7 ndryshime përgjatë 2019 dhe 6 ndryshime për periudhën janar-gusht 2020 për DRAP Durrës). **-Për vitin 2019,** pas krijimit të **DRAP Durrës**, institucionit i janë alokuar fillimisht fonde në shumën rreth 7 milion lekë, ku deri në fund të vitit, **plani i rishikuar** në tre programet paraqiten në shumën rreth 46 milion lekë **(pra 39 milion lekë më shumë se plani fillestar)**, nga të cilat janë **realizuar** në total 35 milion lekë, pra 28 milion lekë më shumë se plani fillestar (500%), dhe rreth **11 milion lekë më pak se plani i rishikuar** (**77%**). Nëse i referohemi planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në nivel programi, rezulton se programi "Planifikim Menaxhim dhe Administrim" është realizuar në shumën 35 milion lekë, nga 7 milion lekë planifikuar në planin fillestar (pra 28 milion lekë më shumë; realizimi në masën 500%), dhe 37 milion lekë planifikuar në planin e rishikuar (pra 2 milion lekë më pak; realizimi në masën 95%). Niveli më i lartë i mos realizimit rezulton në dy Programet e "Arsimit Bazë" dhe "Arsimit të Mesëm", në vlerat respektive në planin e rishikuar prej 5 milion lekë (realizimi në masën 0%) dhe 3 milion lekë (realizimi në masën 0%), për shkak të mos ekzekutimit të kontratës të trajnimit trajtuar më sipër; -Për **vitin 2020, DRAP Durrës** fillimisht janë planifikuar fonde në tre programe, në shumën rreth 75 milion lekë dhe deri në fund të periudhës objekt auditimi (gusht 2020) **plani i rishikuar** paraqitet në shumën rreth 39 milion lekë **(pra 36 milion lekë më pak se plani fillestar)**, ku deri në përfundim të periudhës objekt auditimi (gusht 2020), **realizimi** i fondeve në tre programe paraqitet në shumën 12 milion lekë, pra **63 milion lekë**

	më pak se plani fillestar (realizimi në masën 15%), dhe **27 milion lekë më pak se plani i rishikuar** (realizimi në masën 30%). Nëse i referohemi planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në nivel programi, rezulton se programi "Planifikim Menaxhim dhe Administrim" janë planifikuar fillimisht fonde në shumën 14 milion lekë të cilat deri në fund të periudhës objekt auditimi janë pakësuar dhe paraqiten në vlerën rreth 14 milion lekë, dhe realizimi i fondeve paraqitet në vlerën 8 milion lekë, pra 6 milion lekë më pak se plani (54%). Në programin "Arsimi Bazë" janë miratuar fonde në vlerën 42 milion lekë, të cilat deri në fund të periudhës objekt auditimi janë pakësuar dhe paraqiten në vlerën rreth 16 milion lekë (pra rreth 26 milion lekë më pak si rezultat i transferimeve në ZVAP-e) nga të cilat janë realizuar 3 milion lekë, ose 13 milion lekë më pak (18%). Për programin 09230 "Arsimi i Mesëm" buxheti i miratuar paraqitet në vlerën rreth 19 milion lekë, i cili deri në fund të periudhës objekt auditimi është pakësuar dhe paraqitet në vlerën rreth 7 milion lekë (pra rreth 12 milion lekë më pak si rezultat i transferimeve në llogaritë e ZVAP-ve) nga të cilat janë realizuar 6 milion lekë më pak (13%). -Grupi i auditimit shqyrtoi hartimin dhe zbatimin e buxhetit në një ndër ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës, konkretisht ZVAP Tiranë. Në buxhetin e **ZVAP Tiranë** u konstatuan 11 ndryshime në vitin 2019 dhe 5 ndryshime për periudhën janar-gusht 2020. Nga auditimi rezultoi se, pas krijimit të ZVAP Tiranë në vitin 2019**,** fillimisht janë alokuar fonde në shumën rreth 2,875 milion lekë, ku plani i rishikuar deri në fund të vitit rezulton në shumën 3,695 milion lekë, pra **820 milion lekë më shumë** se plani fillestar, nga të cilat janë realizuar 3,682 milion lekë (99%). Në vitin 2020 në ZVAP Tiranë fillimisht janë alokuar fonde në shumën rreth 3,720 milion lekë dhe plani i rishikuar deri në muajin gusht rezulton në shumën 4,184 milion lekë, pra **464 milion lekë më shumë** se plani fillestar, nga të cilat janë realizuar deri në fund të muajit gusht 2020, 2,719 milion lekë (64%). Rishikimet e fondeve rezultojnë të kryhen sipas nevojave të institucionit përgjatë vitit, duke diktuar kështu një realizim të lartë në fund të vitit. -Nga auditimi konstatohet se në buxhetin e DRAP Durrës në datën 12.11.2019 **janë pakësuar fondet** nën programin "Arsimi Bazë", nën kodin 91103 AE "Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re" në vlerë **3 milion lekë,** fonde të cilat kanë qenë të dedikuara për një procedure në proces prokurimi gjatë periudhës kur është kryer ky pakësim. DRAP Durrës nuk disponon asnjë dokumentacion për kthimin e këtyre fondeve, ku sipas punonjësve të kësaj drejtorie shkresa nuk ka patur asnjë efekt, dhe është anulluar, pasi DRAP Durrës ka njoftuar Ministrinë e Arsimit për procedurën në proces prokurimi. Megjithatë, nga një verifikim i kryer në të dhënat e konsoliduara në thesar, rezulton se **faktikisht këto fonde janë pakësuar nga buxheti i DRAP Durrës në muajin nëntor dhe janë rikthyer më pas në dhjetor, edhe pse procedura e prokurimit për to ka qenë në proces**.
Kriteri:	Ligji nr. 99/2017, datë 3.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 i Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", Ligji nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" Urdhri i Kryeministrit

	Nr.68, datë 05.04.2019 për "Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"; Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, Kreu I pika 74 përcakton se "Nëpunësi autorizues i njësisë qeverisjes qendrore njofton *zyrtarisht drejtuesit e programeve buxhetore dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë/të gjithë drejtuesit funksionale për rishpërndarjet ose shtesat e fondeve të miratuara sipas përcaktimeve të paragrafëve 72, 73 të këtij udhëzimi*. ", pika 75 "*Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit*"
Ndikimi/Efekti:	Rialokimet e shpeshta të fondeve në DRAP Durrës nuk lejojnë pasqyrimin real të situatës lidhur me nivelin e realizimit, pasi shtimi/pakësimi i tyre kryhet sipas ecurisë dhe jo planifikimit real të institucionit; Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore përbën një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.Duke qenë se DRAP Durrës ka marë vulën e Thesarit për disponibiletitin e fondeve dhe miratimin e inicimit të procedurave për kontratën e trajnimit në Agjensinë e Prokurimeve Publike, pakësimi i tyre gjatë procesit të prokurimin, mund të riskojë disponibilitetin e tyre në momentin e ekzekutimit të kontratës dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura, edhe pse në këtë rast kjo nuk ka ndodhur pasi fondet janë rikthyer në llogari deri në fund të vitit 2019.
Shkaku:	Niveli i dobët i planifikimit, dhe mungesa e harmonizimit mes kërkesave buxhetore, alokimin e fondeve dhe ekzekutimin e tyre; Pakësim i fondeve të buxhetuara për një procedurë prokurimi cila ka qenë në proces dhe mos vënia në dijeni e subjektit për arsyet e pakësimit, dhe më pas për rikthimin e fondeve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	□ DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj, në bashkëpunim me MASR, të marrin masat për kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucional, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve që nuk realizohen deri në fund të vitit, për të sjellë artificialisht planifikimin e tyre, në nivelet e zbatimit, situatë kjo me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit. □ MASR të shmangë praktikat e kryerjes së ndryshimeve në buxhet pa kërkesat e institucioneve (ZVAP apo DRAP), si dhe të përcjellë njoftimet zyrtare për drejtuesit e programeve buxhetore në DRAP dhe ZVAP për rishpërndarjet ose shtesat/pakësimet e fondeve të miratuara. □ Strukturat drejtuese në MASR të marrin masat për shmangien e praktikës së pakësimit të fondeve të dedikuara për një procedurë prokurimi në proces (pra si në rastin e kontratës së trajnimit trajtuar më sipër), të cilat mund të cënojnë zbatimin e kontratave dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura për buxhetin e shtetit.

3. Titulli i Gjetjes:	**Mangësi në hartimin e raporteve të monitorimit nga DRAP Durrës**

	dhe ZVAP Tiranë dhe publikimin e tyre
Situata:	Nga auditimi konstatohet se Raporti i monitorimit 8 mujor për DRAP Durrës për vitin 2019, dhe Raportet e monitorimit të realizuara gjatë vitit 2019 nga ZVAP Tiranë, nuk rezultojnë në përputhje me kërkesat e formatit standard të monitorimit të buxhetit. -Nga auditimi nuk rezulton të jetë përgatitur Raporti i monitorimit 8 mujor dhe ai i vitit 2019 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj. -Në Raportin vjetor të monitorimit për vitin 2019 të DRAP Durrës, në shpenzimet për trajnimin e drejtuesve, Produkti 91101AC "Drejtuesve te institucioneve arsimore te trajnuar", janë deklaruar si të kontraktuara në shumën 179,344 lekë, megjithatë në dosjen e kësaj kontrate **nuk** përshkruhet detajimi i fondeve në bazë të pjesëmarrësve (pra sa prej tyre do të ishin përfaqësues të nivelit drejtues, të arsimit të mesëm apo atij të lartë). Këto fonde janë përfshirë nën të njëjtën procedure prokurimi. Për vitin 2020 ky produkt është planifikuar në vlerën **0,** duke paracaktuar se në trajnim nuk do të marrë pjesë **asnjë** drejtues institucioni. -Nga auditimi konstatohet se nga ana e institucioneve, nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore"* pasi në faqen zyrtare të DRAP Durrës dhe ZVAP-eve nën juridiksionin e saj, **nuk** janë publikuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2019 dhe 2020.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore";* Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit*".
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në raportimin e situatës mbi realizimin e fondeve me qëllim informimin e strukturave të DPAP dhe MASR për nivelin e përdorimit të fondeve dhe ecurinë e realizimit të tyre përgjatë vitit. Mungesë transparence si pasojë e mos publikimit të informacioneve të vlefshëm për publikun, si raportet e zbatimit të buxhetit;
Shkaku:	Mos përmbushja e detyrimit përcaktuar në udhëzim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë për hartimin e raporteve të monitorimit konform kuadrit rregullator në fuqi. Mos kryerja e publikimeve në faqen zyrtare të raporteve periodik të monitorimit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës në DRAP Durrës dhe Sektori i Shërbimeve në ZVAP Tiranë, të hartojnë raportet e monitorimit periodike në përputhje me kërkesat e formatit standard të monitorimit të buxhetit, me qëllim paraqitjen e informacionit të plotë mbi arritjet në terma sasiore dhe cilësore të produkteve të realizuara, duke identifikuar mosarritjet dhe shpjeguar shkaqet e tyre, si dhe duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës. DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj të marrë masat për publikimin e raporteve të monitorimit të buxhetit sipas periudhave, në faqet zyrtare të institucioneve respektive, në zbatim edhe të parimeve të qeverisjes buxhetore sipas OECD mbi transparencën e dokumenteve dhe të dhënave buxhetore, në mënyrë që ato të jenë të

	aksesueshme nga publiku. □ Për kontratat që do të lidhen në vijim, DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj, të kryejnë saktë detajimin e fondeve buxhetore të lidhura me to, në nivel programi dhe produkti, me qëllim ndjekjen e saktë të ecurisë së ekzekutimit të tyre.

4. Titulli i Gjetjes:	**Mospërputhje midis objektivave të produkteve të buxhetit sipas MASR dhe alokimin/ ekzekutimin e tyre nga DRAP Durrës**
Situata:	Nga auditimi mbi alokimin e fondeve buxhetore në nivel programi dhe produkti për DRAP Durrës, konstatohet se për periudhën 2019-2020, fondet nuk akordohen në të njëjtat produkte nga viti në vit, duke mos lejuar kështu edhe analizat krahasimore për përdorimin e tyre. Më hollësisht, në vitin 2019 për programin 01110, fondet janë alokuar në **4** produkte: 91101AE, 91101AA, 91101AD, 91101AC, dhe në vitin 2020 vetëm në **2** produkte: 91101AA dhe 91101AC. -Për sa i përket përdorimit të tyre në Programin 01110 *"*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim", konstatohet se në vitin 2019 nën produktin 91101AA "Punonjës dhe specialiste te trajnuar*",* ku sipas raportit të monitorimit të MASR, mënyra e matjes së këtij produkti është *"Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese/Trajnimi çdo vit për 100-110 drejtues të institucioneve*" janë përfshirë shpenzime të kryera për kancelari, pjesë këmbimi, internet; dhe në vitin 2020 deri në fund të muajit gusht realizimi për këtë produkt është zero, pasi këto shpenzime, pra për internet, tonera, taksa makine etj, janë përfshirë nën produktin 91101AE "Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore". Në vitin 2019, në produktin 91101AD "Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara", ku sipas raportit të monitorimit të MASR, mënyra e matjes së këtij produkti është "*Numri i akteve te miratuar"* janë përfshirë shpenzime për naftë dhe pjesë këmbimi. E njëjta problematikë u identifikua edhe në **ZVAP Tiranë**. Më hollësisht, në produktin 91101 AA, njësia matëse e të cilit lidhet me "*Numrin e drejtuesve të trajnuar*", ZVAP Tiranë ka përfshirë shpenzime karburanti, kancelarie, elektricitet, etj. Në produktin 91103 AD, njësia matëse e të cilit lidhet me "*Numrin e nxënësve dhe mësuesve që përfitojnë shërbimin e transportit*" në Arsimin Bazë, për vitin 2019 ZVAP Tiranë ka përfshirë shpenzime për blerje uniformash, bexha, etj. Në produktin 91104AB, njësia matëse e të cilit lidhet me "*Numrin e nxënësve dhe mësuesve që përfitojnë shërbimin e transportit*" në Arsimin e Mesëm, për vitin 2020 ZVAP Tiranë ka përfshirë shpenzime elektrike, internet, sigurim jete, shpenzime modele, etj.
Kriteri:	Ligji nr. 99/2017, datë 3.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 i Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", Ligji nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" Urdhri i Kryeministrit Nr.68, datë 05.04.2019 për "Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar", Raporti vjetor i MASR për vitin 2019, Raporti i 8 mujorit të parë të MASR për vitin 2020.

Ndikimi/Efekti:	Vështirësi në kryerje e krahasimeve mes zërave, e cila ndikon veçanërisht në kryerjen e monitorime të zbatimit të buxhetit apo vlerësimeve të parashikimeve.
Shkaku:	Alokimi në produkte të ndryshme të fondeve buxhetore për DRAP Durrës, për periudhën 2019-2020; Kryerja e shpenzimeve për likuidimin e pagesave për mallra dhe shërbime nga DRAP Durrës nën produkte që nuk i përkasin objektivave të përcaktuara në to në relacionet e MASR
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime :	DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, në bashkëpunim me DPAP dhe strukturat përgjegjëse në MASR, të marrin masat për kryerjen e planifikimit të fondeve në nivel produkti, dhe alokimin e tyre në mënyrë të vijueshme duke mundësuar kryerjen e krahasimeve mes zërave në raportet e monitorimit, apo vlerësime të parashikimeve. DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, në vijim të objektivave dhe produkteve nën programet të cilat ajo administron, dhe mënyrës së matjes së tyre sikundër trajtohet në raportet e monitorimit të MASR, të kryejnë shpenzimet për mallra dhe shërbime në qëllim të produkteve për të cilat janë alokuar fondet.

III.2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin

Mbi emërimin e stafit të DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj

Referuar VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", çështja III, pika 13, "*Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e rregullave të miratuara me urdhër të ministrit"*. Referuar pikës 14, në të njëjtën çështje, "*Drejtorët e drejtorëve rajonale të arsimit parauniversitar emërohen dhe lirohen nga ministri. Drejtuesit e zyrave vendore, si dhe nëpunësit/punonjësit e drejtorive rajonale e të zyrave vendore emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përcaktimeve në urdhrin përkatës të ministrit*".

Referuar Urdhrit të Ministrit, Nr. 454, datë 13.09.2019, "Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj", emërimi i Drejtuesit të DRAP-së, Nëpunësit të DPAP-së, Nëpunës/Punonjës i DRAP-së, Nëpunës/Punonjës i Zyrave Vendore bëhet nëpërmjet **konkurrimit të hapur.** Gjithashtu, kjo rregullore përcakton qartë të gjitha hapat për emërimin e punonjësve të DRAP, duke filluar nga plani vjetor i nevojave të pranimeve, shpalljen e konkurrimeve, procedurat e konkurrimit në dy faza (faza 1: verifikimi i dosjeve të kandidatëve; dhe faza 2: testi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë), deri në vlerësimin përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit fitues.

Referuar dokumentacionit të emërimit të punonjësve në DRAP Durrës, të konsultuar nga grupi i auditimit, që prej miratimit të VKM-së Nr. 99, datë 27.02.2019 e deri më sot **98% e stafit** të DRAP dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj, vijon të jetë i **komanduar,** edhe pse në urdhrat e emërimit të përkohshëm të pozicioneve në punë nga Drejtori i Përgjithshëm i DRAP përcaktohet se komandimi do të jetë i përkohshëm deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet përkatëse. Nga intervistat e kryera me stafin në DRAP, procedurat e konkurrimit nuk janë zhvilluar pasi DPAP nuk ka bërë shpalljet për fillimin e procedurave.

Mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të detyrës pas ristrukturimit

Nga komunikimi me subjektet ZVAP Shijak dhe ZVAP Durrës, dhe në përgjigje të kërkesës zyrtare të dërguar nga DRAP Durrës drejtuar këtyre ZVAP-ve (në vijim të kërkesës së grupit të auditimit), grupit të auditimin ***nuk ju vu në dispozicion dokumenti i dorëzimit të detyrës nga ish-drejtoresha e DAR Durrës.*** Nga auditimi konstatohet se për dy procedura të audituara nga grupi i auditimit mbi emërimin e drejtoreve të IAP nga ish-DAR Durrës, dosjet e procedurës nuk gjenden sot as në ZVAP Shijak apo ZVAP Durrës.

Mbi pagesat e dëmshpërblimit të punonjësve si rezultat i ristrukturimit

Si rezultat i ristrukturimit të strukturave përgjegjëse për ofrimin dhe sigurimin e arsimit cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, në vijim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e cila përcakton se: "*Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas rasteve të mëposhtme: a) deri në një vit eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 1 muaji; b) nga 1-3 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 3 muajve; c) nga 3-6 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 6 muajve; ç) nga 6-9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 9 muajve; d) mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 12 muajve*", është përcjellë nga Drejtori i Përgjithshëm i DRAP Durrës me shkresën nr. 256, datë 18.07.2019 lista e punonjësve që përfitojnë dëmshpërblim nga heqja e statusit të nëpunësit civil për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-të në varësi,

në DPAP. Përfitues të pagesës për dëmshpërblim ishin 82 punonjës të liruar nga shërbimi civil, në vlerë totale 28,148,574 lekë, e cila është ekzekutuar nga DRAP Durrës në muajit gusht dhe shtator të vitit 2019 përkatësisht në vlerën 23,926,287 lekë dhe 4,331,286 lekë.
Nga komunikimet me stafin në DRAP Durrës rezulton se, 82 punonjësit të cilët kanë përfituar pagesë për dëmshpërblim janë komanduar në ZVAP-të në juridiksionin e DRAP Durrës, ose në DRAP.
Numri i punonjësve që kanë përfituar pagesë dëmshpërblimi dhe fondi i ekzekutuar, sipas institucionit, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Institucioni	***Numri i punonjësve***	***Fondi i alokuar***
ZVAP Tiranë	18	6,251,754
ZVAP Klos	3	715,980
ZVAP Kavajë	7	2,242,020
ZVAP Dibër	10	3,213,960
ZVAP Kamëz	7	2,665,920
ZVAP Krujë	3	1,004,760
ZVAP Vorë	2	780,000
ZVAP Rrogozhinë	2	418,200
ZVAP Mat	4	1,340,280
ZVAP Durrës	11	4,028,040
ZVAP Bulqizë	6	1,807,860
DRAP Durrës	9	3,679,800
Total	***82***	***28,148,574***

Burimi:DRAP Durrës

Mbi strukturën përgjegjëse për emërimin e Drejtorit të Institucionit Arsimor Publik

Referuar Ligjit Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin 48/2018, neni 55, pika 1, përcakton se: "*Drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga **titullari i institucionit arsimor vendor**, përgjegjës për arsimin parauniveritar përkatës, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit*.".
Me VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", është krijuar Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), e cila është e organizuar në:
nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar;
njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik.

Referuar VKM-së së mësipërme, çështja 3, pika 11, përcakton se: "***Drejtorët e drejtorive rajonale** emërojnë drejtorët e institucioneve arsimore publike, sipas **udhëzimit përkatës të ministrit**".*
Në këtë periudhë, në fuqi ishte Udhëzimin i Ministrit Nr. 57, datë 12.11.2013 "*Për Procedurat e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*", sipas çështjes E[20] të të cilit, emërimi i drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit parauniversitar, bëhej nga **Titullari i Njësisë Arsimore Vendore**.

Për periudhën 27.02.2019-28.01.2020 konstatojmë se, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 bie në **kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrit nr. 57, datë

[20] "*Procedura e Emërimit të Drejtorit nga Titullari i Njësisë Arsimore Vendore*"

12.11.2013, lidhur me procedurën e emërimit të drejtorit të IPAP. Nga intervistat e kryera me stafin në DRAP, grupit të auditimit iu bë me dije se situata e mësipërme ka krijuar **ngërç** në procesin e emërimit të drejtorëve në IPAP dhe se, gjatë vitit 2019 plotësimi i vakancave për këtë pozicion është bërë më komandime.

Me daljen e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, "*Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*", i cili shfuqizoi Udhëzimin e Ministrit Nr. 57, datë 12.11.2013, procedura e emërimit të Drejtorit të IPAP përcaktohet në çështjen D, për tu kryer nga **drejtori i DRAP**.

Aktualisht konstatojmë se, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 dhe Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, bie në kundërshtim me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar.

Mbi kriteret për emërimin e Drejtorit të Institucionit Arsimor Publik
Referuar Nenit 55 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, publikuar në fletoren zyrtare nr. 115, datë 03.08.2020, pika 2 "*Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor duhet të ketë, të paktën, kategorinë "Mësues i kualifikuar" dhe të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor".* Referuar dispozitave kalimtare, **kriteri i trajnimit dhe pajisjes me certifikatën** e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar **hyn në fuqi 2 vjet** nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ligji nr. 69/2012, i ndryshuar, hynte në fuqi 15 ditë pas botim në fletoren zyrtare. Ky ligj është botuar në fletoren zyrtare nr. 115, datë 03.08.2018, pra kriteri për trajnimin dhe pajisjen me certifikatë të kandidatit për drejtor ka hyrë në fuqi me datë **18.08.2020**.
Në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, Kreu 1, pika B/1, përcaktohen kushtet që duhet të plotësojë kandidati për drejtor i IPAP:
të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar";
të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar **dhe të jetë certifikuar**, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.*"*
Kreu III, pika1, e udhëzimit nr.2, përcakton se "*Në rast **mungese të aplikimeve nga kandidatët të pajisur me certifikatë nga shkolla e drejtoreve**, apo që kanë përfunduar programin e trajnimit të drejtoreve, zhvilluar nga **Instituti i Zhvillimit të Arsimit** në vitin 2016, për pozicionet e lira drejtor ne IPAP, aplikojnë dhe emerohen kandidatë të cilët plotësojnë kriteret sipas pikave "a", "b" dhe "c" të pikës 1, të shkronjës "B" të Kreut I të këtij udhëzimi."*
Me udhëzimin Nr. 7, datë 19.03.2020 "Për ndryshime në Udhëzimin Nr. 2, datë 28.01.2020" shkronja d), në Kreu 1 pika B/1, ndryshon si vijon: "**të jetë pranuar për të kryer trajnimin** e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar **dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë**, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."
Gjithashtu, Udhëzimin Nr. 7, pika 1 e Kreut III, ndryshon si "*Drejtorët në detyrë të IPAP, për vijimin e detyrës, përveç kritereve të përcaktuara pikat "a", "b" dhe "c" të pikës 1, të shkronjës*

"B" të Kreut I të këtij udhëzimi, duhet të aplikojnë për tu pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor dhe certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve.".

Pra, sipas ndryshimit të pikës 1 të Kreu III të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, trajnimi i zhvilluar nga **Instituti i Zhvillimit te Arsimit *(*IZHA) nuk vlerësohet më si kriter për pranimet.**

Referuar Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të IPAP në Shqipëri", Kreu 1, Neni 3, pika 1, programi i trajnimit të detyrueshëm përgatitor zgjat 9 muaj. Referuar shtojcës 4 të Rregullores, kuotat e pjesëmarrjes në trajnim janë si më poshtë:

Periudha e zhvillimit të trajnimit	Kuota pranimi	Shtrirja territoriale (Qarku)
Viti 2019-2020	48	Tiranë
Viti 2020-2021	192	Tiranë, Durrës, Elbasan
Viti 2021-2024	240	Në të gjithë vendin
Viti 2024 në vijim	240-300	Në të gjithë vendin

Burimi:DRAP Durrës

Referuar pikave 1), 2), 4) të nenit 27 të Rregullores, "*Kandidatët qe kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtues, i nënshtrohen testimit për pajisjen me certifikatë për drejtues pranë Shkollës së Drejtorëve*", "*Kandidati ruan të drejtën për t'u regjistruar në testimin e certifikimit për 2 vjet nga përfundimi me sukses i programit të trajnimit të detyrueshëm*", "*Kandidati ka të drejtë të marrë pjesë në testimin për certifikimi jo më shumë se dy herë.*"

Nga komunikimet me stafin në DRAP Durrës, grupit të auditimit iu bë me dije se në zbatim të Urdhrit nr. 246, datë 30.07.2020 të DPAP-së, protokolluar më shkresë nr. 1870 prot., datë 30.07.2020 procesi i konkurrimit për emërimin e drejtorëve në pozicionet e lira në IPAP ka nisur në muajin Gusht 2020. Në pikën 3 të këtij Urdhri të DPAP-së citohet: "***prioritet** në rekrutimin e drejtuesve të rinj do të kenë ata **konkurrent** të cilët kanë **kryer trajnimin** e detyrueshëm përgatitor në shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitarë **apo janë regjistruar**.*"

Urdhri nr. 246, datë 30.07.2020 i DPAP-së është **në kundërshtim** me nenin 55, pika 2, të **Ligjit nr. 69/2012**, i ndryshuar, sipas të cilit "*Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor duhet të ketë, të paktën, kategorinë "Mësues i kualifikuar" dhe të jetë i **pajisur me certifikatën** e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor",* dhe me shkronjën d), pika B/1, Kreu 1 të **Udhëzimit nr. 2 të MASR-së**, datë 28.01.2020, i ndryshuar sipas të cilit kandidati për drejtor duhet:"*të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar **dhe të jetë certifikuar** nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."*

Referuar nenit 26, pika a e Ligjit nr. 62/2012, i ndryshuar, kompetenca për nxjerrjen e urdhrave dhe udhëzimeve për zbatimin e ligjit është e **Ministrit të MASR-së**.

Në vijim të urdhrit nr.246, datë 30.07.2020 të DPAP, janë bërë **shpalljet nr.1, 2 dhe 3** për vendet e lira të drejtuesve të institucioneve arsimore nën juridiksionin e DRAP Durrës, ku si **kriter kualifikues** për vijimin e konkursit, **është kërkuar që aplikantët të zotërojnë certifikatën e Shkollës së Drejtorëve**, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 dhe udhëzimit nr.2.

Ndërkohë që, nga konstatimet e procedurave të audituara, komisionet e vlerësimit të kandidatëve për drejtor në vijim të shpalljeve, kanë pranuar dhe kualifikuar aplikantë sipas urdhrit nr.246, datë 30.07.2020 të DPAP. Pra, certifikata e Shkollës së Drejtorëve dhe regjistrimi në të, është konsideruar **si prioritet për kandidatët, dhe jo si kriter i domosdoshëm**. Urdhri i nxjerrë nga DPAP, në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin nr.2, ka shkaktuar problematikat e e evidentuara në Akt Konstatimet nr. 15-21, datë 06.11.2020,

të shqyrtuara nga grupi i auditimit të KLSh.

Më pas, me anë të **shkresës** nr. 5072/1, datë 28.09.2020, Drejtori i Përgjithshëm i MASR-së, në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm, i është drejtuar DRAP-ve duke referuar ligjin 69/2012 i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, argumenton se, "*kandidati duhet të jetë pajisur me certifikatë nga Shkolla e Drejtorëve. Në mungesë të kësaj certifikate, kandidati* ***duhet të ketë aplikuar dhe të jetë pranuar*** *nga Shkolla e Drejtorëve për të kryer trajnimin e detyrueshëm. Emërimi definitiv i drejtuesit të institucionit arsimorë parauniversitare do të bëhet* ***pasi*** *ky i fundit* ***të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm përgatitor dhe të jetë pajisur*** *me certifikatën nga Shkolla e Drejtorëve.*"

Mbi përfaqësuesit e DRAP Durrës në mbledhjet e komisioneve të vlerësimit të kandidatëve për drejtorë të IAP

Nga auditimi konstatohet se në vijim të Kreut I, shkronja C, pika 6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se*: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP".* Në kundërshtim me këtë pikë, në **20 procedura** të audituara në ZVAP Tiranë, Durrës, Kavajë, Dibër, Mat dhe Bulqizë, ku është zhvilluar vlerësimi i kandidatëve nga komisioni, DRAP ka dërguar përfaqësues **vetëm për 7 prej tyre.**

Mbi ankimimet e aplikantë për drejtorë në IAP

Kreu C, pika 11 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 përcakton se "*Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune*.". Nga auditimi rezulton se, në ZVAP Kavajë njëri prej aplikantëve në procedurat e konkurrimit të shkollës "Helmas" ka paraqitur një ankesë pranë ZVAP lidhur me vendimmarrjen e komisionit, dhe në përgjigjen e ZVAP është mbajtur qëndrimi: "*Pretendimi i ngritur nga zonja nuk qëndron pasi kjo kërkesë është paraqitur gabim tek ZVAP Kavajë, ku duhet të adresohej tek komisioni i shkollës*." Në vijim të saj, nuk dokumentohet të jetë shqyrtuar apo marrë në konsideratë kjo ankesë. Në gjykimin e grupit të auditimit, drejtimi i ankesave pranë një komisioni ad hoc i cili ngrihet për një procedurë të caktuar, dhe nuk ka një adresë të përcaktuar, nuk siguron trajtimin e tyre.

Mbi komisionet e vlerësimit të aplikantëve për drejtorë në IAP

Kreu C, pika 1 dhe 2, e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se "***1****. Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP, në vijim Komisioni, ngrihet nga ZVAP;* ***2****. Komisioni përbëhet nga: a) kryetari i bordit të IPAP; b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP; c)dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore*." Referuar parregullsive të konstatuara nga grupi i auditimit trajtuar në Akt Konstatimet nr. 15-21, datë 06.11.2020, në procedurat e komisioneve të cilat kanë konkluduar në anullim të procedurave, apo vijimin e tyre në shkelje të kritereve përcaktuar në ligj dhe udhëzim, dhe referuar 2 procesverbaleve (2 nga 2 në total) të mbajtura nga përfaqësuesit e DRAP Durrës në mbledhjet e komisionit, evidentohet se anëtarët kanë shfaqur mangësi në njohjen e bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe shpesh herë kanë vlerësuar në mënyrë jo të drejtë kandidatët.

Mbi lëvizjet paralele të stafit mësimor

Udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë' përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga institucionet për arsimin parauniversitat lidhur me **lëvizjet paralele**. Më hollësisht, Kreu I, pika 7 përcakton se "*Vendet e lira të punës shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe*

sistemimi i mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore deri në 1 ditë para fillimit të vitit arsimor". Pika 8 përcakton se"DRAP ka detyrimin të raportojë në DPAP lëvizjet paralele dhe vendet e lira të punës 1 ditë përpara fillimit të vitit mësimor." Kreu 7, përcakton se "Procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga ZVP, vetëm në periudhën nga **përfundimi i vitit mësimor, deri në fillimin e vitit të ri arsimor.**

ZVAP	Viti	Lëvizjet paralele	Muaji
Rrogozhine	2020	4	Shtator
Kavaje	2019	5	Shtator
Kavaje	2019	5	Tetor
Kamëz	2019	14	Shtator
Kamëz	2019	4	Gusht
Vorë	2019	5	Gusht
Bulqizë	2019	9	Shtator
Krujë	2019	8	Gusht
Krujë	2020	8	Shtator
Mat	2019	2	Shtator
Mat	2020	6	Gusht
Shijak	2019	1	Gusht
Tirana	2019	104	Shtator
Tirana	2020	170	Gusht
Durrës	2019	14	Shtator
Durrës	2020	20	Gusht

Burimi:DRAP Durrës

-Nga auditimi u konstatua se për **5 raste** në ZVAP Kavajë lëvizja paralele e mësuesve është bërë gjatë muajit **tetor.**

Mbi stafin mësimor jashtë profilit

Nga auditimi konstatohet se në vijim të portaleve të zhvilluara gjatë vitit 2019 dhe 2020, në disa ZVAP-e, janë të punësuar në institucionet arsimore mësues **jashtë profilit përkatës, ose pa arsimin përkatës** qe nuk plotësojnë kriteret e nenit 57 dhe 72 te ligjit 69/2012 dhe udhëzimin nr. 30 dt.12.09.2018 të MASR. Këto pozicione, jo në të gjitha rastet janë dokumentuar si vende vakante nga DRAP Durrës, pasi bëhet fjalë për zona tepër të largëta dhe është tepër e vështirë nga mësuesit për të pranuar punësimin në to. Më hollësisht, konstatohet **448 raste** në 12 ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës, si më poshtë:

Nr	ZVAP	Numri i mësuesve
1	Krujë	16
2	Klos	40
3	Kavajë	20
4	Kamëz	19
5	Rrogozhinë	17
6	Shijak	3
7	Vorë	11
8	Tiranë	27
9	Mat	9
10	**Bulqizë**	**177**
11	Durrës	9
12	**Dibër**	**100**
Total		**448**

Burimi:DRAP Durrës

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion për grupin e auditimit, lidhur me drejtorët e nën drejtorëve të institucioneve arsimore, rezulton se deri në fund të vitit 2019, numri i drejtorëve dhe nën drejtorëve në institucionet arsimore që **nuk kanë shkallën e kualifikimit,** paraqitet si më poshtë:

Nr	ZVAP	Numri i Drejtoreve	Numri i Nen Drejtoreve
1	Krujë	1	2
2	Klos		1
3	Kavajë	2	2
4	Kamëz	N/A	N/A
5	Rrogozhinë	N/A	N/A
6	Shijak	N/A	N/A
7	Vorë	N/A	N/A
8	Tiranë	6	11
9	Mat		1
10	**Bulqizë**	**1**	**2**
11	Durrës	1	1
12	**Dibër**	**16**	**30**
Total		**27**	**40**

Burimi:DRAP Durrës

A1. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin për DRAP Durrës

Me VKM nr.99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", çështja III. Organizmi dhe Funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", pika 2 përcakton krijimin e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar me propozim të Ministrit, për të mbuluar jo më pak se 4000 punonjës.

Struktura organizative e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës është krijuar **mbi 1** muaj pas VKM për krijimin e DPAP, sipas Urdhrit nr. 68, datë 5.4.2019 të Ministrit të Arsimit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshëm dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*", si më poshtë:



Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, është organizuar për të funksionuar me një strukturë prej 15 punonjësish, përkatësisht:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe 1 sekretar.

Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, me 1 përgjegjës sektori dhe 3 punonjës, Ky Sektor ka në përbërje 4 punonjës.

Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, me 1 përgjegjës sektori dhe 3 punonjës, Ky Sektor ka në përbërje 4 punonjës.

Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës, me 1 përgjegjës sektori dhe 4 punonjës, Ky Sektor ka në përbërje 5 punonjës.

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Plan
I	**Drejtor**	**III-b**	**1**
	Sekretar		1

II	**Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**		**4**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-a	1
2.	Specialist	IV-b	3
III	**Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë**		**4**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-a	1
2.	Specialist	IV-b	3
IV	**Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës**		**5**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-a	1
2.	Specialist (Për Burimet Njerëzore)	IV-b	1
3.	Specialist (Për Investimet dhe Infrastrukturën)	IV-b	1
4.	Specialist (Për Financën dhe Buxhetin)	IV-b	1
3.	Specialist (Statistike)	IV-b	1
Gjithsej			**15**

Sipas Urdhrit nr. 93, datë 10.07.2020 të Ministrit të Arsimit "*Për një ndryshim në urdhrin nr. 68, datë 5.04.2019 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*" struktura organizative është ndryshuar si më poshtë:

Nr.	**Pozicioni**	**Kategoria**	**Plan**
I	**Drejtor**	**III-a/1**	**1**
	Sekretar		1
II	**Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**		**4**
1.	Përgjegjës Sektori	III-b	1
2.	Specialist	IV-a	3
III	**Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë**		**4**
1.	Përgjegjës Sektori	III-b	1
2.	Specialist	IV-a	3
IV	**Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës**		**5**
1.	Përgjegjës Sektori	III-b	1
2.	Specialist (Për Burimet Njerëzore)	IV-a	1
3.	Specialist (Për Investimet dhe Infrastrukturën)	IV-a	1
4.	Specialist (Për Financën dhe Buxhetin)	IV-a	1
3.	Specialist (Statistike)	IV-a	1
Gjithsej			**15**

Sikurse mund të vërehet dhe në tabelat e mësipërme, Urdhri nr. 93, datë 10.07.2020 krahasuar me Urdhrin nr. 68, datë 5.4.2019, solli ndryshim vetëm në kategorinë e pagave të punonjësve të DRAP Durrës dhe jo në strukturë.

Krijimi i DRAP Durrës

Emërimi i punonjësve pjesë e DRAP Durrës është kryer **mbi 1 muaj** pas miratimit të strukturës së drejtorisë. Në vijim të urdhrit nr. 279, datë 16.05.2019 të Ministrit të Arsimit "Për emërimin e përkohshëm në punë" të Drejtorit të DRAP dhe të urdhrave nr. 258, 259, 260, 261, 264, 265, 266, 267, 268 datë 15.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë", me urdhrin e brendshëm nr.1, datë 20.05.2019, të drejtorit të DRAP Durrës është urdhëruar zbatimi i vendimeve të sipërcituara për emërimin e përkohshëm në detyrë të 10 punonjësve pjesë përbërëse e strukturës së re te krijuar të DRAP Durrës, nga 15 që përcakton Urdhri nr. 68, datë 5.4.2019 i Ministrit të Arsimit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshëm dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*".

Në vijim, struktura e DRAP Durrës është plotësuar sipas:

-Urdhrit nr. 360, datë 06.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë" të Specialistit për Financën dhe Buxhetin në sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës

-Urdhrit nr. 359, datë 06.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë" të sekretares në DRAP Durrës.

-Urdhrit nr. 812, datë 13.11.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë" të Përgjegjësit të Sektorit në sektorin e Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
- Urdhrit nr. 53, datë 13.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë" të Specialistit në Sektorin e Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
Ndryshimet në strukturën e DRAP Durrës kanë qenë kryesisht për shkak të dorëheqjeve, transferimeve apo daljes së pension të stafit ekzistues. Me hollësisht, ndryshimet e brendshme të personelit të drejtorisë janë kryer si më poshtë:
-Me urdhrin nr. 380, datë 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP, specialisti në Sektorin e Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës është emëruar në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të këtij urdhri, me urdhrin e po të njëjtës datë, përkatësisht nr. 380/1, datë 13.06.2019 është kryer anullimi i urdhrit të sipërcituar, duke përcaktuar se punonjësi do të vijojë punën në pozicionin e mëparshëm.
-Me urdhrin nr. 385, datë 8.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë"është urdhëruar zëvendësimi i specialistit për investimet dhe infrastrukturës në sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës, pas daljes në pension të punonjësit të mëparshëm në këtë pozicion sipas urdhrit nr. 384, datë 03.07.2019.
- Sipas shkresës nr. 531 prot datë 22.09.2019 e drejtorit të DRAP është informuar DPAP për mbushjen e moshës së daljes në pension të Specialistit të Statistikës në sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës në datën 22.09.2019.Me urdhrin nr. 796, datë 23.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë" është urdhëruar zëvendësimi i punonjësit të statistikës në sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës, pas daljes në pension të punonjësit të mëparshëm në këtë pozicion.
-Me urdhrin nr. 58, dat 5.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është miratuar dorëheqja e Specialistit për Burimet Njerëzore në sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës, pozicion ky i plotësuar sipas urdhrit nr. 857, datë 28.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP.
-Me urdhrin nr. 41, datë 04.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP "Për emërim të përkohshëm në punë" të sekretarit të DRAP është kryer zëvendësimi i punonjëses së mëparshme për shkak të trajtimit të saj me raport mjekësor nga ISSH.
-Me urdhrin nr. 60, dat 13.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar transferimi i Përgjegjësit të Sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në DRAP Durrës për në ZVAP Tiranë, pozicion ky i plotësuar sipas urdhrit nr. 176, datë 19.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP.

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
	Sekretar	1	1
II	**Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**4**	**2**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	3	1
III	**Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë**	**4**	**4**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	3	3
IV	**Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës**	**5**	**5**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist (Për Burimet Njerëzore)	1	1
3.	Specialist (Për Investimet dhe Infrastrukturën)	1	1
4.	Specialist (Për Financën dhe Buxhetin)	1	1
3.	Specialist (Statistike)	1	1
Gjithsej		**15**	**13**

Nga sa më sipër rezulton se:
-Që prej krijimit e deri më sot, struktura e DRAP Durrës ka **dy vakanca** në pozicioni Specialist i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

-Që prej fillimit të funksionimit të DRAP Durrës (15.05.2019) e deri tani, **të gjithë** punonjësit e DRAP Durrës janë me **emërim të përkohshëm** deri në zhvillimin e procedurave të emërimit.
Referuar VKM 99 datë 27.02.2019, Çështja III, pika 14 "*Drejtorët e drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar emërohen dhe lirohen nga ministri. Drejtuesit e zyrave vendore, si dhe nëpunësit/punonjësit e drejtorive rajonale e të zyrave vendore emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përcaktimeve në urdhrin përkatës të ministrit."*

A.2. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin në ZVAP-e

A.2.1. Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Dibër, Krujë, Kamzë

Me VKM nr.99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", çështja III. Organizmi dhe Funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", pika 1. c përcakton krijimin e njësive të ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit paraauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik. Në vijim, pika 7 e VKM të sipërcituar, përcakton se struktura dhe organika e zyrave vendore të arsimit miratohen me urdhër të ministrit. Në zbatim të kësaj pike, strukturat organizative të zyrave vendore të arsimit parauniversitar janë krijuar mbi 1 muaj pas VKM për krijimin e DPAP, sipas Urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019 të Ministrit të Arsimit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar*". Në këtë urdhër, organika e Zyrave Vendore të Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar: Dibër, Krujë, Kamzë paraqitet si më poshtë:



Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Dibër, Krujë, Kamzë janë organizuar për të funksionuar me struktura prej 10 punonjësish, përkatësisht:
Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës.
Sektori i Shërbimeve me 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë.
Me urdhrin nr. 176, datë 01.07.2020 të Ministrit të Arsimit, "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit paauniversitar", janë kryer ndryshime në organikat e zyrave vendore.
Si rezultat i këtyre ndryshimeve**, ZVAP Dibër** paraqitet me të njëjtin numër punonjësish në strukturat e saj, por me ndryshime në kategorinë e pagave të punonjësve.

Nr.	**Pozicioni**	**Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019**	**Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020**
		Kategoria	
I	**Drejtor**	IV-a	III-b
II	**Sektori i Shërbimeve**		
1.	Përgjegjës sektori	IV-b	IV-a
2.	Specialist	IV-c	IV-b
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**		

1.	Përgjegjës Sektori	IV-b	Iva
2.	Specialist	IV-c	IV-b

ZVAP Krujë, pas ndryshimeve me urdhrin e sipërcituar, përveç ndryshimit në paga, është organizuar për të funksionuar me një strukturë prej 9 punonjësish, përkatësisht:

a. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës.
b. Sektori i Shërbimeve me 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
c. Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me 1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë.

Nr.	Pozicioni	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020
		Kategoria		Numri i punonjësve	
I	**Drejtor**	IV-a	III-b	1	1
II	**Sektori i Shërbimeve**			**3**	**3**
	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
1.	Specialist	IV-c	IV-b	2	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**			**6**	**5**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
2.	Specialist	IV-c	IV-b	5	4
Totali				**10**	**9**

ZVAP Kamzë, pas ndryshimeve me urdhrin e sipërcituar, përveç ndryshimit në paga, është organizuar për të funksionuar me një strukturë prej 11 punonjësish, përkatësisht:

a. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës.
b. Sektori i Shërbimeve me 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë.
c. Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë.

Nr.	Pozicioni	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020
		Kategoria		Numri i punonjësve	
I	**Drejtor**	IV-a	III-b	1	1
II	**Sektori i Shërbimeve**			**3**	**4**
	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
1.	Specialist	IV-c	IV-b	2	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**			**6**	**6**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
2.	Specialist	IV-c	IV-b	5	5
Totali				**10**	**11**

Në vijim paraqitet struktura e miratuar dhe faktike e këtyre ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës, sipas ndryshimeve të ndodhura në to, gjatë periudhës objekt auditimi.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Dibër

Krijimi i ZVAP Dibër

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Dibër, struktura organike është plotësuar me vetëm 6 punonjës, nga 10 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrat[21] nr. 27, 30, 31, 32 dhe 33 datë 15.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit të ZVAP, 1 specialisti në Sektorin e Shërbimeve, Përgjegjësi i Sektorit dhe 3 specialistë në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Në vijim, struktura e ZVAP Dibër është plotësuar si vijon:

[21] Në informacionin e përcjellë nga ZVAP Dibër mungon nr. I urdhërit të emërimit të Specialistit të Financës, I datës 15.09.2019.

-Përgjatë vitit 2019, është plotësuar pozicioni vakant i Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve me Urdhrin 357, datë 06.06.2019. Me urdhrin 765 të datës 16.09.2019 është bërë edhe emërimi i përkohshëm në detyrë i një Specialisti në Sektorin e Monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.
-Gjatë vitit 2020, me urdhrin nr 221, datë 20.07.2020është bërë edhe emërimi i përkohshëm në detyrë i një Specialisti në Sektorin e Monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.
Ndryshimet në strukturën e ZVAP Dibër janë si vijon:
Me daljen në pension të Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve më datë 09.03.2020 është plotësuar kjo vakancë nga një specialist i këtij sektori me urdhrin nr. 87 të datës 24.02.2020. Më datën 16.09.2019 është transferuar në ZVAP Tiranë Përgjegjësi i sektorit të Shërbimeve dhe plotësimi i këtij pozicioni është bërë me datë 24.06.2020. Më datë 16.09.2019 është larguar me dëshirë një specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
Pozicioni **i juristit** në këtë ZVAP që prej fillimit e deri më tani ka qenë **vakant**. Gjithashtu, aktualisht janë **vakantë** edhe pozicionet e dy specialistë në Sektorin e e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit profesional.
Aktualisht struktura organizative e ZVAP Dibër rezulton të funksionojë e plotësuar me **7 punonjës, nga 10** që përcakton organika e miratuar,më saktësisht vak si më poshte*:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**3**	**2**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	2	1
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**6**	**4**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	4	3
Gjithsej		**10**	**7**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Krujë
Krijimi i ZVAP Krujë
Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Krujë, struktura organike është plotësuar me vetëm 2 punonjës, nga 10 që përcakton organika e miratuar në atë periudhë. Më hollësisht, me urdhrat nr. 99 dhe 100 datë 15.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë të Drejtorit të ZVAP, dhe përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
Në vijim, struktura e ZVAP Krujë është plotësuar si vijon:
-Përgjatë vitit 2019, pozicioni i specialistit të Financës është plotësuar me emërim të përkohshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP me urdhër 369, datë 06.06.2019.
-Përgjatë vitit 2020, pozicioni i juristit në Sektorin e Shërbimeve ka vijuar vakant, deri në urdhrin nr. 56 datë 13.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për emërimin e përkohshëm të punonjësit në këtë pozicion. Gjithashtu, Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional ka vijuar me vakanca deri në daljen e urdhrit 101 më datë 15.05.2020 sipas të cilit është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Përgjegjësit të këtij sektori. Ndërsa, me urdhrin 57, datë 13.02.2020 dhe udhërin 305, datë 22.09.2020 janë emëruar dy specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional
Ndryshimet në strukturën e ZVAP Krujë janë si vijon:
-Stafi i komanduar në pozicionet përkatëse nuk ka patur ndryshime përgjatë periudhës objekt auditimi.
Aktualisht struktura organizative e ZVAP Krujë rezulton të funksionojë e plotësuar me **7 punonjës, nga 9** që përcakton organika e miratuar, më hollësisht vakancat janë në pozicionin e specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional
si më poshtë*:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**3**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	2	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**5**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	4	2
Gjithsej		**9**	**7**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamzë

Krijimi i ZVAP Kamëz

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Kamzë, struktura organike është plotësuar me vetëm 7 punonjës, nga 10 që përcaktonte organika e miratuar në atë periudhë. Më hollësisht, me urdhrat nr. 237, 238, 239, 240, 241, 243, 244 datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit të ZVAP, Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve, dhe 5 specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Në vijim, struktura e ZVAP Kamëz është plotësuar si vijon:

-Përgjatë vitit 2019, pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional ka vijuar vakant, deri në urdhrin nr. 859, datë 23.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP, për emërimin e përkohshëm të tij.

-Përgjatë vitit 2019, me anë të urdhrave nr. 371 datë 06.06.2019, nr 758 datë 18.09.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm i dy punonjësve në pozicionin e Juristit dhe specialistit të Financës në Sektorin e Shërbimeve.

-Përgjatë vitit 2020, pozicionet i specialist të Financës në Sektorin e Shërbimeve ka vijuar vakante, deri në urdhrin nr. 200 datë 15.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për emërimin e përkohshëm të specialistit në këtë pozicion.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Kamzë janë si vijon:

-Specialisti i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional është zëvendësuar përkohësisht më pas me urdhër nr. 40 datë 03.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP.

-Si rezultat i largimit për në ZVAP Tiranë të një specialisti të Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me anë të urdhrit nr. 296 datë 15.10.2019 dhe plotësimi i tij është bërë me urdhër nr. 173, datë 19.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Kamzë rezulton të funksionojë me **11 punonjës, nga 11** që përcakton organika e miratuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**4**	**4**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
1.	Specialist	3	3
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**6**	**6**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	6	1
Gjithsej		**11**	**11**

A.2.2 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës

Me VKM nr.99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", çështja III. Organizmi dhe Funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", pika 1. c përcakton krijimin e krijimin e njësive të ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit paraauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik. Në vijim, pika 7 e VKM të sipërcituar, përcakton se struktura dhe organika e zyrave vendore të arsimit miratohen me urdhër të Ministrit. Në zbatim të kësaj pike, strukturat organizative të zyrave vendore të arsimit

parauniversitar janë krijuar mbi 1 muaj pas VKM për krijimin e DPAP, sipas Urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019 të Ministrit të Arsimit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar*". Në këtë urdhër, organika e Zyrës Vendore të Arsimore Durrës, paraqitet si më poshtë:



Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës ishte e organizuar për të funksionuar me strukturë prej 13 punonjësish, përkatësisht:
Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës.
Sektori i Shërbimeve me 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë.
Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me 1 përgjegjës sektori dhe 7 specialistë.
Me urdhrin nr. 176, datë 01.07.2020 të Ministrit të Arsimit, "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit paauniversitar", janë kryer ndryshime në organikat e zyrave vendore. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, **ZVAP Durrës** paraqitet me numër të ndryshuar të punonjësve në strukturën e saj, dhe me ndryshime në kategorinë e pagave të punonjësve.

Nr.	Pozicioni	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020
		Kategoria		Numri i punonjësve	
I	**Drejtor**	IV-a	III-b	1	1
II	**Sektori i Shërbimeve**			**4**	**4**
1	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
2.	Specialist	IV-c	IV-b	3	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**			**8**	**10**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
2.	Specialist	IV-c	IV-b	7	9
Totali				**13**	**15**

Krijimi i ZVAP Durrës
Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Durrës, struktura organike është plotësuar me 10 punonjës, nga 13 që përcakton organika e miratuar për atë periudhë. Më hollësisht, me urdhërat nr. 328, 250, 251, 252, 253,254, 255, 256, 257, 268 datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit të ZRAP, Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve dhe 2 specialistëve në këtë sektor, si dhe i 6 specialistëve në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
Në vijim, struktura e ZVAP Durrës është plotësuar si vijon:

Gjatë vitit 2019 pozicioni i Juristes në Sektorin e Shërbimeve ka vijuar vakant deri në daljen e urdhrit nr. 842, datë 02.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për plotësimin e këtij pozicioni. Me anë të urdhrave nr.736, datë 29.07.2019; nr. 772, datë 27.09.2019; 756 datë 16.09.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP janë emëruar 3 specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Gjatë vitit 2020, pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional ka vijuar vakant deri me daljen e Urdhri të drejtorit të DPAP 177, datë 19.06.2020. Me urdhrin nr. 244, datë 30.07.2020 është urdhëruar emërimi i përkohshëm i një specialisti në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional. Me

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Durrës janë si vijon:

-Drejtori i komanduar i ZVAP Durrës pas krijimit të saj, është transferuar më datë 27.01.2020 në pozicionin e Drejtorit në ZVAP Tiranë. Me urdhrin nr. 35, datë 30.01.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm i Drejtorit të ZVAP Durrës. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve i emëruar me krijimin e ZVAP Durrës, ka dhënë dorëheqjen dhe me anë të urdhrit nr. 744 datë 21.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar plotësimi i këtij pozicioni. 3 specialist në Sektorin e Shërbimeve janë transferuar në ZVAP Kavajë dhe Durrës më datat 21.08.2019, 31.10.2019 dhe 01.01.2020, pozicione të cilat janë plotësuar më pas, me anë të urdhrave nr.801 datë 28.10.2019, nr.743, datë 21.08.2019 dhe nr. 79, datë 18.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP. Gjithashtu, 3 specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, të emëruar me krijimin e DRAP Durrës kanë dhënë dorëheqjen gjatë periudhës qershor-shtator 2019.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Durrës rezulton të funksionojë e plotësuar, me **13 punonjës, nga 15** që përcakton organika e miratuar, e ndryshuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	1	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**4**	**4**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
1.	Specialist	3	3
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**10**	**10**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	9	7
Gjithsej		**15**	**13**

A.2.3 Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë, Mat, Klos, Shijak, Kavajë, Vorë, Rrogozhinë

Me VKM nr.99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", çështja III. Organizmi dhe Funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", pika 1. c përcakton krijimin e njësive të ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit paraauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik. Në vijim, pika 7 e VKM të sipërcituar, përcakton se struktura dhe organika e zyrave vendore të arsimit miratohen me urdhër të ministrit. Në zbatim të kësaj pike, strukturat organizative të zyrave vendore të arsimit parauniversitar janë krijuar mbi 1 muaj pas VKM për krijimin e DPAP, sipas Urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019 të Ministrit të Arsimit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar*". Në këtë urdhër, organika e Zyrave Vendore të Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar: Bulqizë, Mat, Klos, Shijak, Kavajë, Vorë, Rrogozhinë, paraqitet si më poshtë:



Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar **Bulqizë, Mat, Klos, Shijak, Kavajë, Vorë, Rrogozhinë**, janë organizuar fillimisht për të funksionuar me struktura prej 6 punonjësish, përkatësisht:

Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar.

Sektori i Shërbimeve me dy specialistë.

Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Me urdhrin nr. 176, datë 01.07.2020 të Ministrit të Arsimit, "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit paauniversitar", janë kryer ndryshime në organikat e zyrave vendore. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, ZVA Bulqizë, Mat, Klos, Shijak, Vorë, Rrogozhinë, paraqiten me të njëjtin numër punonjësish në strukturat e tyre, por me ndryshime në kategorinë e pagave të punonjësve.

Nr.	Pozicioni	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020
		Kategoria	
I	**Drejtor**	IV-a	III-b
II	**Sektori i Shërbimeve**		
1.	Specialist	IV-c	IV-b
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**		
1.	Përgjegjës Sektori	IV-b	IVa
2.	Specialist	IV-c	IV-b

ZVAP Kavajë, pas ndryshimeve me urdhrin e sipërcituar, përveç ndryshimit në paga, është organizuar për të funksionuar me një strukturë prej 9 punonjësish, përkatësisht:

a. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar

b. Sektori i Shërbimeve me 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

c. Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë.

Më hollësisht ndryshimet në strukturë për këtë ZVAP paraqiten si më poshtë:

Nr.	Pozicioni	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020	Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019	Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020
		Kategoria		Numri i punonjësve	
I	**Drejtor**	IV-a	III-b	1	1
II	**Sektori i Shërbimeve**			**2**	**3**
	Përgjegjës Sektori	-	IVa	-	1
1.	Specialist	IV-c	IV-b	2	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**			**3**	**5**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
2.	Specialist	IV-c	IV-b	2	4
Totali				**6**	**9**

Në vijim paraqitet struktura e miratuar dhe ajo faktike e ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës, sipas ndryshimeve të ndodhura në to, gjatë periudhës objekt auditimi.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Bulqizë

Krijimi i ZVAP Bulqizë

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Bulqizë, struktura organike është plotësuar me vetëm 3 punonjës, nga 6 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrat nr. 131, 132 dhe 331 datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i 1 specialisti në Sektorin e Shërbimeve; 1 specialisti dhe përgjegjësit në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Në vijim, struktura e ZVAP Bulqizë është plotësuar si vijon:

-Përgjatë vitit 2019, pozicioni i drejtorit të kësaj zyre arsimore ka qenë vakant, deri në urdhrin nr. 30, datë 24.01.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP, ku është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit të ZVAP Bulqizë.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Bulqizë janë si vijon:

-Në datën 17.09.2020 përgjegjësi i Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional është larguar nga pozicioni me dëshirë, dhe aktualisht pozicioni vijon vakant.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Bulqizë rezulton të funksionojë me **3 punonjës, nga 6** që përcakton organika e miratuar, ku më hollësisht pozicionet e 2 specialistëve dhe 1 përgjegjësi sektori janë vakante, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**2**	**1**
1.	Specialist	2	1
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**3**	**1**
1.	Përgjegjës Sektori	1	
2.	Specialist	2	1
Gjithsej		**6**	**3**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Mat

Krijimi i ZVAP Mat

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Mat, struktura organike është plotësuar me vetëm 4 punonjës, nga 6 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrat nr. 134, 135, 136 dhe 137 datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë të Drejtorit të ZVAP, 1 specialisti në Sektorin e Shërbimeve; 1 specialisti dhe përgjegjësit në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional. Në vijim drejtori i kësaj ZVAP është emëruar definitiv në këtë pozicion, pas përfundimit të procedurave të emërimit në DPAP.

Në vijim, struktura e ZVAP Mat është plotësuar si vijon:

-Përgjatë vitit 2019, pozicioni i specialistit jurist të Sektorit të Shërbimeve ka vijuar vakant, deri në urdhrin ne. 55 datë 17.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për emërimin e përkohshëm të punonjësit në këtë pozicion.

-Përgjatë vitit 2019, pozicioni i specialistit të Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional ka vijuar vakant, deri në urdhrin nr. 284 datë 17.09.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për emërimin e përkohshëm të punonjësit në këtë pozicion.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Mat janë si vijon:

-Stafi i komanduar në pozicionet përkatëse nuk ka patur ndryshime përgjatë periudhës objekt auditimi.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Mat rezulton të funksionojë e plotësuar, me **6 punonjës, nga 6** që përcakton organika e miratuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**2**	**2**

1.	Specialist	2	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**3**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	2	2
Gjithsej		**6**	**6**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Klos

Krijimi i ZVAP Klos

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Klos, struktura organike është plotësuar me vetëm 1 punonjës, nga 6 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrin nr. 14 datë 15.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i 1 specialisti finance dhe buxheti në Sektorin e Shërbimeve.

Në vijim, struktura e ZVAP Klos është plotësuar si vijon:

-Përgjatë vitit 2019, pozicioni i Drejtorit të ZVAP Klos ka vijuar vakant, deri në urdhrin nr. 129, datë 07.05.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP, për emërimin e përkohshëm të tij.

-Përgjatë vitit 2019, pozicioni i specialistit të burimeve njerëzore të Sektorit të Shërbimeve ka vijuar vakant, deri në urdhrin ne. 54 datë 13.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për emërimin e përkohshëm të punonjësit në këtë pozicion.

-Përgjatë vitit 2019, pozicionet e 2 specialistëve dhe përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional kanë vijuar vakante, deri në urdhrat nr. 228 dhe 229 datë 07.07.2020 dhe nr. 78, datë 18.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për emërimin e përkohshëm të specialistëve dhe përgjegjësit.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Klos janë si vijon:

-Specialisti i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional është larguar me dëshirë për një tjetër pozicion si mësues.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Klos rezulton të funksionojë me **5 punonjës, nga 6** që përcakton organika e miratuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**2**	**2**
1.	Specialist	2	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**3**	**2**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	2	1
Gjithsej		**6**	**5**

Zyra Vendore Arsimore Shijak

Krijimi i ZVAP Shijak

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Shijak, struktura organike është plotësuar fillimisht me vetëm 2 punonjës, nga 6 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrin nr. 230 dhe 231 datë 15.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit të ZVA dhe i 1 specialisti finance në Sektorin e Shërbimeve.

Në vijim, struktura e ZVAP Shijak është plotësuar si vijon:

-Me urdhrin nr. 174, datë 19.06.2020, pas më shumë se 1 vit vakance në këtë pozicion, është urdhëruar komandimi i juristit në Sektorin e Shërbimeve.

-Me urdhrin nr. 760 datë 16.09.2019, është urdhëruar emërimi i përkohshëm i Përgjegjësit të sektorit të Monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.

-Me urdhrin nr. 358 dhe 361, datë 06.06.2019, është urdhëruar emërimi i përkohshëm i dy specialistëve të kurrikulës në sektorin e kurrikulës.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Shijak janë si vijon:

-Sektori i Shërbimeve në ZVAP Shijak ka pësuar një sërë ndryshimesh në specialistin e financës, ku për një periudhë rreth 1 vjeçare kanë ndryshuar katër specialistë për këtë pozicion. Specialisti i

emëruar fillimisht në këtë strukturë me krijimin e saj, nuk është paraqitur në detyrë. Rreth 1 muaj më vonë është emëruar me urdhrin nr. 362, datë 06.06.2019 një tjetër specialist, i cili sërisht nuk është paraqitur në detyrë.Me urdhrin nr.378, datë 13.06.2019 është emëruar përkohësisht një specialist tjetër, i cili 5 muaj më vonë është transferuar në një tjetër ZVAP. Specialisti aktual i financës është komanduar sipas urdhrit nr.802, datë 28.10.2019.

-Sektori i kurrikulës është gjithashtu i ndikuar nga ndryshimet në stafin e tij, ku më hollësisht 2 specialistët e komanduar me krijimin e strukturës në 06.06.2019 janë transferuar në ZVAP të tjera, dhe aktualisht një pozicion qëndron vakant, prej disa muajsh, dhe specialistja tjetër aktuale është komanduar sipas urdhrit nr. 58, datë 13.02.2020.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Shijak rezulton të funksionojë e plotësuar, me **5 punonjës, nga 6** që përcakton organika e miratuar, e ndryshuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**2**	**2**
1.	Specialist	1	1
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**3**	**2**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	2	1
Gjithsej		**6**	**5**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë

Krijimi i ZVAP Kavajë

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Kavajë, struktura organike është plotësuar me 5 punonjës, nga 6 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrin nr. 245, 246, 247, 248 dhe 291 datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit, 1 specialisti në Sektorin e Shërbimeve, përgjegjësit dhe 2 specialistëve në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Në vijim, struktura e ZVAP Kavajë është plotësuar si vijon:

-Me urdhrin nr. 227, datë 20.07.2020 është urdhëruar emërimi i përkohshëm i përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Kavajë janë si vijon:

-Drejtori i komanduar i ZVAP Kavajë pas krijimit të saj, është larguar me dëshirë në datën 30.10.2019 (vetëm 5 muaj pas komandimit të tij), dhe ky pozicion ka vijuar vakant për rreth 7 muaj, deri në urdhrin nr. 149, datë 29.05.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP ku është urdhëruar emërimi i përkohshëm i tij. Në vijim drejtori ka kryer konkurrimin në DPAP për tu emëruar më pas definitiv në këtë pozicion.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Kavajë rezulton të funksionojë e plotësuar, me **6 punonjës, nga 9** që përcakton organika e miratuar, e ndryshuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**3**	**2**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
1.	Specialist	1	1
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**5**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	4	2
Gjithsej		**9**	**6**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë

Krijimi i ZVAP Vorë

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Vorë, struktura organike është plotësuar me 5 punonjës, nga 6 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrin nr. 232, 234, 235, 236 dhe 283 datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë

i Drejtorit, 2 specialistëve në Sektorin e Shërbimeve, përgjegjësit dhe 1 specialisti në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Në vijim, struktura e ZVAP Vorë është plotësuar si vijon:

-Me urdhrin nr. 198, datë 15.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm i 1 specialisti në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Vorë janë si vijon:

- Një specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional është transferuar në ZVAP Tiranë në 06.09.2019.

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Vorë rezulton të funksionojë e plotësuar, me **6 punonjës, nga 6** që përcakton organika e miratuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**2**	**2**
1.	Specialist	2	2
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**3**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	2	2
Gjithsej		**6**	**6**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë

Krijimi i ZVAP Rrogozhinë

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Rrogozhinë, struktura organike është plotësuar me 4 punonjës, nga 6 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrin nr. 155 datë 20.05.2019, nr. 228, datë 20.05.2019, nr. 227, datë 24.08.2019 dhe datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit, 2 specialistëve në Sektorin e Shërbimeve, dhe 1 specialisti në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Në vijim, struktura e ZVAP Rrogozhinë është plotësuar si vijon:

- Me urdhrin nr. 161, datë 02.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm i specialistit në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

-Me urdhrin nr. 290, datë 18.09.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm i përgjegjësit në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

- Me urdhrin nr. 276, datë 19.09.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm i specialistit në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Rrogozhinë janë si vijon:

- Në Sektorin e Shërbimeve, 1 prej specialistëve është larguar me dëshirë vetëm 3 muaj pas komandimit në pozicion (larguar në 16.08.2019), dhe 1 specialist është transferuar në ZVAP Tiranë në 20.07.2020.
- Me urdhrin nr. 226, datë 22.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm i 1 specialisti në Sektorin e Shërbimeve.
- Në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional 1 specialist është larguar me dëshirë vetëm 2 muaj pas emërimit në pozicion (larguar në 01.07.2019) dhe 1 punonjës vetëm 1 ditë pas emërimit në pozicion (larguar në 03.06.2020).

*Aktualisht struktura organizative e ZVAP Rrogozhinë rezulton të funksionojë me **4 punonjës, nga 6** që përcakton organika e miratuar, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt

I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**2**	**1**
1.	Specialist	2	1
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**3**	**2**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	2	1
Gjithsej		**6**	**4**

A.2.4. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë

Sipas Urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019 të Ministrit të Arsimit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar", dhe urdhrit nr. 176, datë 01.07.2020 të Ministrit të Arsimit, "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit paauniversitar", organika e Zyrës Vendore të të Arsimit Parauniversitar Tiranë, ka pësuar ndryshime dhe paraqitet si më poshtë:

Nr.	**Pozicioni**	**Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019**	**Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020**	**Urdhri nr. 234, datë 19.4.2019**	**Urdhri nr. 176, datë 01.07.2020**
		Kategoria		**Numri i punonjësve**	
I	**Drejtor**	IV-a	III-b	1	1
II	**Sektori i Shërbimeve**			**8**	**11**
	Përgjegjës Sektori	IV-b	IVa	1	1
1.	Specialist	IV-c	IV-b	1	1
2.	Specialist jurist	IV-c	IV-b	2	2
3.	Specialist inxhinier	IV-c	IV-b	1	1
4.	Specialist i financës	IV-c	IV-b	3	6
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**			**16**	**23**
1.	Përgjegjës Sektori	IV-b	IV-a	1	1
2.	Specialist	IV-c	IV-b	15	22
Totali				**25**	**35**

Aktualisht ZVA Tiranë është organizuar për të funksionuar me një struktura prej 35 punonjësish, përkatësisht:

a. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
b. Sektori i Shërbimeve me 1 përgjegjës sektori dhe 10 specialistë.
c. Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional me 1 përgjegjës sektori dhe 22 specialistë.

Krijimi i ZVAP Tiranë

Pas urdhrit të krijimit të ZVAP Tiranë, struktura organike është plotësuar me vetëm 15 punonjës, nga 25 që përcakton organika e miratuar. Më hollësisht, me urdhrin nr. 289 datë 15.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Drejtorit të ZVAP Tiranë; me urdhrin nr. 290, datë 15.05.2019 Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve; dhe me urdhrat nr. 262, 294, 295, 296, 297, 298, 304, 305, 307, 308, 309, 310, 329 janë emëruar përkohësisht 13 specialistë (nga të cilët 5 specialistë në Sektorin e Shërbimeve dhe 8 specialistë në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Në vijim, struktura e ZVAP Tiranë është plotësuar si vijon:

-Me urdhrin nr. 240, datë 20.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP është urdhëruar emërimi i përkohshëm në detyrë i Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve.

- Ne lidhje me Sektorin e Shërbimeve, emërimi i përkohshëm i punonjësve në plotësim të strukturës së miratuar është kryer sipas: urdhrit nr. 332, datë 21.05.2019, urdhri nr. 146, datë 29.05.2020, urdhri nr. 199, datë 15.07.2020, urdhri nr. 273, datë 26.08.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP.

-Në lidhje me Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, emërimi i përkohshëm i punonjësve në plotësim të strukturës së miratuar është kryer sipas: urdhrit nr.372,

datë 06.06.2019, urdhri nr. 379, datë 16.06.2019, urdhri nr. 764, datë 16.09.2019, 248, datë 01.10.2019, urdhri nr. 805, datë 30.10.2019, urdhri nr. 71 dhe 72, datë 18.02.2020, urdhri nr. 189, datë 26.06.2020, urdhri nr. 231, datë 21.07.2020.

Ndryshimet në strukturën e ZVAP Tiranë janë si vijon:

-Në datën 04. 12.2019 është larguar Drejtori i ZVAP Tiranë, i cili është zëvendësuar sipas urdhrit nr. 13, datë 24.01.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP për emërimin e përkohshëm të drejtorit në këtë strukturë. Në vijim janë kryer procedurat e emërimit për këtë pozicion në DPAP, dhe drejtori i ZVAP Tiranë është emëruar definitiv në këtë pozicion.

- Në datën 31.08.2019 është larguar përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, vetëm 3 javë pas emërimit në këtë pozicion. Rreth 3 muaj më vonë ky pozicion është plotësuar sipas urdhrit nr. 240, datë 25.11.2019.
- Në datën 18.04.2020 është larguar me dëshirë specialisti i Sektorit të Shërbimeve, rreth 1 vit pas emërimit të tij në pozicion.
- Në datën 23.12.2019 është transferuar për në ZVAP Kamëz specialisti i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, rreth 6 muaj pas emërimit të përkohshëm të tij në këtë pozicion. Ky pozicion është zëvendësuar sipas urdhrit nr. 855, datë 18.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP.
- Në datën 18.06.2019 është larguar me dëshirë specialisti në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, rreth 4 muaj pas emërimit të përkohshëm të tij në këtë pozicion. Ky pozicion është zëvendësuar sipas urdhrit nr. 189, datë 26.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP.

-Në datën 31.08.2020 është larguar me dëshirë specialisti në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, rreth 2 muaj pas emërimit të përkohshëm të tij në këtë pozicion.

*Deri në përfundim të periudhës objekt auditimi (31.08.2020) struktura organizative e ZVAP Tiranë rezulton të funksionojë me **25 punonjës, nga 35** që përcakton organika e miratuar, ku më hollësisht pozicionet e 1 specialisti në Sektorin e Shërbimeve dhe 9 specialistëve në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional janë vakante, si më poshtë:*

Nr.	Pozicioni	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**1**	**1**
II	**Sektori i Shërbimeve**	**11**	**10**
	Përgjegjës Sektori	1	1
1.	Specialist	1	0
2.	Specialist jurist	2	2
3.	Specialist inxhinier	1	1
4.	Specialist i financës	6	6
III	**Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**	**23**	**14**
1.	Përgjegjës Sektori	1	1
2.	Specialist	22	13
Totali		**35**	**25**

Nga auditimi i strukturave të DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP rezulton se:

Në ZVAP-e, që prej krijimit e deri më sot, ka patur **ndryshime** në staf kryesisht si rezultat i transferimve në ZVAP të tjera, dorëheqjeve, daljes në pension dhe lejeve shëndetësorë ose lindje.

Që prej krijimit e deri më sot, strukturat e ZVAP-ve Tiranë, Durrës, Dibër, Kavajë, Krujë, Bulqizë, Klos, Shijak dhe Rrogozhinë vijojnë të kenë vakanca në numër të konsiderueshëm, që përbëjnë risk për realizimin e objektivave (deri në përfundim të periudhës objekt auditimi vakancat rezultojnë 21%, pra strukturat përbëhen nga 111 punonjës nga 140 që përcaktojnë strukturat e miratuar në DRAP dhe 12 ZVAP-e).

Vetëm në ZVAP Tiranë, Kavajë, Durrës, Krujë, Kamëz, Klos, Mat, Bulqizë emërimi i drejtorëve ka qenë definitivë (7.2**%** i total strukturave të DRAP dhe 12 ZVAP-eve nën juridiksionin e saj prej 111 punonjësish), dhe i **gjithë stafi** i ZVAP-ve të tjera është me **emërim të përkohshëm**, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
Referuar VKM 99 datë 27.02.2019, Çështja III, pika 14 "*Drejtuesit e zyrave vendore, si dhe nëpunësit/punonjësit e drejtorive rajonale e të zyrave vendore emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përcaktimeve në urdhrin përkatës të ministrit."*

b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve

Shpenzimet për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 bazohen në VKM nr.187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve dhe kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*", VKM nr. 428, datë 03.06.2020 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 187*" dhe strukturën e miratuar për DRAP Durrës, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr.68, datë 05.04.2019 për "*Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*".
Shpenzimet për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 mbështeten në ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar si dhe ligji nr. 8770, datë 13.10.1994 "*Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë".*
Nga auditimi rezulton se, në DRAP Durrës për vitin 2019 fondi i pagave është realizuar në masën 84% dhe për vitin 2020 (janar-gusht) në masën %.
Institucioni për periudhën objekt auditimi ka patur vakanca në 2 pozicione, sikundër trajtohet më sipër e cila ka sjellë edhe mos realizim të fondeve. Më hollësisht, planifikimi fillestar, i rishikuar dhe realizimi i fondeve për paga paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2019					
Emërtimi	**Plani fillestar**	**Plani i rishikuar**	**Realizimi**	**Diferenca[22]**	**Realizimi %**
Paga	6,300	5,570	4,684	-885	84.11%
Sigurime Shoqërore	1,052	952	783	-168	82.32%

Janar-Gusht 2020						
	PBA 2020-2020	**Plani fillestar**	**Plani i rishikuar**	**Realizimi**	**Diferenca**	**Realizimi %**
Paga	11,709	10,440	10,440,000	6,285,364	4,154,636	66%
Sigurime Shoqërore	1,862	1,743,480	1,743,480	1,054,423	689,057	65%

Për zbatimin e bazës ligjore të pagave, u audituan borderotë/listepagesat e muajve maj, qershor, korrik, gusht, tetor, nëntor, dhjetor 2019 dhe janar, shkurt, mars, maj, korrik 2020. Përgatitja e borderove është mbështetur në listë prezencat mujore të personelit të DRAP Durrës. Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit, janë hartuar me numrin e ditëve të punës në muaj dhe mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë, duke pasqyruar prezencën e punonjësve të drejtorisë. Listë pagesat dhe përmbledhëset e pagave janë të nënshkruara dhe bashkëlidhur gjendeshin listë prezencat dhe urdhrat e brendshëm të drejtuesit të institucionit. Listë pagesat e punonjësve dhe ndarja e pagesave është bërë sipas bankave të nivelit të dytë në të cilat kryhen pagesat.
Nga auditimi rezultoi përputhshmëri midis vlerës në total të pagës bruto, kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare për këto shpenzime.

[22] Kundrejt planit fillestar

Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civile të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur konform legjislacionit në fuqi si CV, diplomë, listë notash, certifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj. Dosjet personale të nëpunësve janë administruar dhe inventarizuar duke përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumenteve.

MBI PROCEDURAT E NDJEKURA PËR PËRGJEDHJEN E DREJTUESVE TË IPAP

ZVAP SHIJAK

ZVAP Shijak ka nën juridiksionin e saj 14 institucione arsimore, nga të cilët vetëm 1 prej drejtuesve është i komanduar në pozicion në datën 14.01.2020. Drejtuesit e tjerë janë të emëruar. Në shpalljet e vendeve vakante të deritanishme nuk është përfshirë asnjë shkollë e ZVAP Shijak.
Gjatë periudhës nën auditim në ZVAP Shijak janë bërë **2 procedura** për zgjedhjen e drejtorëve për shkollat si më poshtë:

"Adem Sabli", Borake
"Isa Domi", Pjezë

Referuar dispozitave kalimtare të VKM 99, datë 27.02.2019, pika 1. "Deri në përfundimin e funksionimit të plotë të DPAP-së, sipas këtij vendimi, strukturat aktuale vazhdojnë funksionimin e tyre sipas numrit faktik në përputhje me strukturat dhe organikat e miratuara. Plotësimi i strukturës së ZVAP Shijak ka nisur më datë 15.05.2019 me emërimin e përkohshëm të Drejtorit të kësaj ZVAP-je, Znj. B.K.

"ADEM SABLI" BORAKE

Emërimi i përkohshëm në pozicionin e drejtorit

Me anë të vendimit nr. 897, datë 11.03.2019, DAR Durrës referuar nenit 55 të ligjit nr. 69/2012 "Për arsimin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të "Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë", të pikës E/7 të Udhëzimit të MAS nr. 57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar, ka emëruar Znj. O.M. në pozicionin e drejtor në shkollën 9- vjeçare Borake, deri në përfundimin e procedurave të konkurrimit.

Emërimi definitiv në pozicionin e drejtorit

Me anë të vendimit nr. 955, datë 07.05.2019, Drejtori i DAR Durrës, Znj. L.M., referuar nenit 55 të ligjit nr. 69/2012 "Për arsimin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të pikës E/7, Kreu 1 të Udhëzimit të MAS nr. 57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", pas dorëheqjes **me dëshirë** të drejtorit të shkollës Znj. O.M., ka emëruar me status definitiv Znj. O.M. në pozicionin e drejtorit të shkollës "Adem Sabli" Borake.

Mungesa e dosjeve së procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit

Referuar Udhëzimit të MASR-s nr. 57, datë 12.11.2013, i cili ishte në fuqi në atë kohë dhe përshkruan procesin e emërimit të drejtorit në IPAP nga shpallja e vendit vakant, dorëzimi i dokumentacionit nga aplikantët, vlerësimi i dosjeve deri tek intervistimi i kandidatëve me pikë më të larta dhe emërimi i tyre nga Titullari i njësisë arsimore vendore, procedura e përzgjedhjes së drejtorit në IPAP bëhet me konkurrim të hapur.

Grupi i auditimit kërkoi në ZVAP Shijak dhe ZVAP Durrës dosjet e procedurës së ndjekur për emërimin definitiv të drejtorit të shkollës Adem Sabli, Borake. Nga komunikimi me stafet e të dy ZVAP-ve, dosja e procedurës së ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të kësaj shkolle **nuk** gjenden.

Nga komunikimi me subjektet ZVAP Shijak dhe ZVAP Durrës, dhe në përgjigje të kërkesës zyrtare të dërguar nga DRAP Durrës drejtuar këtyre ZVAP-ve (në vijim të kërkesës së grupit të auditimit), grupit të auditimin **nuk** ju vu në dispozicion dokumenti i dorëzimit të detyrës nga ish-drejtoresha e DAR Durrës.

Në ZVAP Shijak dhe ZVAP Durrës **nuk** gjendet dosja e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës Adem Sabli, Borake, procedurë e cila ka konkluduar në emërimin definitiv të Znj. O.M. në këtë pozicion. Znj. L.M.- ish Drejtore e DAR Durrës Znj. J.M.- Drejtore ZVAP Durrës Znj. B.K.- Drejtore e ZVAP Shijak Znj. V.L.- ish Drejtori i DRAP Durrës

Për sa më sipër mban përgjegjësi Znj. L.M., ish Drejtore e DAR Durrës.

"ISA DOMI", PJEZË

Emërimi definitiv në pozicionin e drejtorit

Me anë të vendimit nr. 954, datë 07.05.2019, Drejtori i DAR Durrës, Znj. L.M., referuar nenit 55 të ligjit nr. 69/2012 "Për arsimin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të pikës E/7, Kreu 1 të Udhëzimit të MAS nr. 57, datë 12.11.2013 "për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", pas daljes në pension të drejtorit të shkollës, ka emëruar me status definitiv Z. A.V. në pozicionin e drejtorit të shkollës **"Isa Domi", Pjezë.**

Mungesa e dosjeve së procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit

Referuar Udhëzimit të MASR-s nr. 57, datë 12.11.2013, i cili ishte në fuqi në atë kohë dhe përshkruan procesin e emërimit të drejtorit në IPAP nga shpallja e vendit vakant, dorëzimi i dokumentacionit nga aplikantët, vlerësimi i dosjeve deri tek intervistimi i kandidatëve me pikë më të larta dhe emërimi i tyre nga Titullari i njësisë arsimore vendore, procedura e përzgjedhjes së drejtorit në IPAP bëhet me konkurrim të hapur.

Grupi i auditimit kërkoi në ZVAP Shijak dhe ZVAP Durrës dosjet e procedurës së ndjekur për emërimin definitive të drejtorit të shkollës **"Isa Domi", Pjezë.** Nga komunikimi me stafet e të dy ZVAP-ve, dosja e procedurës së ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të kësaj shkolle **nuk** gjenden.

Nga komunikimi me subjektet ZVAP Shijak dhe ZVAP Durrës, dhe në përgjigje të kërkesës zyrtare të dërguar nga DRAP Durrës drejtuar këtyre ZVAP-ve (në vijim të kërkesës së grupit të auditimit), grupit të auditimin **nuk** ju vu në dispozicion dokumenti i dorëzimit të detyrës nga ish-drejtoresha e DAR Durrës.

Në ZVAP Shijak dhe ZVAP Durrës **nuk** gjendet dosja e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës Isa Domi, Pjezë, procedurë e cila ka konkluduar në emërimin definitiv të Znj. A.V. në këtë pozicion. Znj. L.M.- ish Drejtore e DAR Durrës Znj. J.M.- Drejtore ZVAP Durrës Znj. Znj. B.K.- Drejtore e ZVAP Shijak Znj. V.L.- ish Drejtori i DRAP Durrës

MBI VENDIMET GJYQËSORE

ZVAP Shijak nuk kishte **asnjë** vendim gjyqësor të ekzekutuar, të pa ekzekutuar apo çështje për largim të padrejtë nga puna në proces gjyqësor.

ZVAP TIRANE

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka nën juridiksionin e saj 154 institucione publike te arsimit parauniveristar, nga të cilat 118 janë shkolla 9 vjeçare dhe 36 shkolla të mesme.

Për periudhën objekt auditimi 2019-2020, nga totali prej 154 shkollash, **në 21 prej tyre** procedurat për përzgjedhjen e drejtuesve janë kryer me **komandim,** sipas aneksit më poshtë.

	Shkolla	Emri Mbiemër	Data e Komandimit
1	HAMDI MANCAKU	XH.M.	19.12.2019
2	ARBANË	Y.H.	01.10.2019
3	PEZË E VOGËL	E.C.	10.09.2019
4	FERRAJ	R.K.	27.01.2020
5	SADIK STAVILECI	SH.U.	22.07.2020
6	BEDRI LLAGAMI	E.T.	16.10.2019
7	16 SHTATORI	A.A.	23.12.2019
8	DËSHMORËT E LIRISE	M.M.	16.04.2020
9	FAN NOLI	J.L.	03.10.2019
10	HASAN PRISHTINA	T.D.	24.01.2020
11	Inst.I nxënësve qe nuk shikojnë	V.J.	03.02.2020
12	JERONIM DE RADA	S.C.	26.08.2020
13	KONGRESI I LUSHNJES	A.Z.	29.06.2020
14	KOL JAKOVA	L.H.	14.01.2020
15	LIDHJA E PRIZRENIT	S.J.	10.09.2019
16	MURAT TOPTANI	M.K.	28.05.2019
17	MUSTAFA GREBLLESHI	M.Q.	24.07.2020
18	NIKET DARDANI	M.K.	18.09.2019
19	SKENDER LUARASI	GJ.N.	17.09.2019
20	A.Z.CAJUPI	A.D.	24.07.2020
21	SAMI FRASHERI	M.Z.	09.12.2019
22	7 MARSI	A.J.	07.01.2014
23	ALI DEMI	D.K.	21.04.2015
24	MARIE LOGORECI	R.M.	09.04.2014
25	IBRAHIM BRAHJA	M.M.	18.02.2014
26	JORDAN MISJA	V.G.	28.04.2015
27	MUSTAFA QEMAL ATATURK	D.K.	11.03.2014
28	SKËNDER ÇAÇI	D.S.	01.09.2015
29	EMIN DURAKU	B.T.	23.01.2018
30	HASAN TAHSIN	B.M.	06.01.2015

Në **9 shkolla** të tjera drejtorët janë të komanduar në periudha të mëparshme. Pra, nga totali prej **30 shkollash**, pas përfundimit të procedurave të emërimit, vetëm për **5** prej tyre janë emëruar në pozicione punë definitive drejtuesit respektiv, përkatësisht shkolla Sami Frashëri dhe Qemal Stafa (Shpallja nr.1), dhe shkolla Niket Dardani, 1 Maji dhe Dëshmorët e Lirisë (Shpallja nr.2).

Sipas udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar, Kreu 1, pika C. Zëvendësimi i përkohshëm i drejtorit, përcakton se: "*1. Kur drejtori i institucionit publik të arsimit parauniversitar nuk e ushtron përkohësisht detyrën e tij, ai zëvendësohet nga nëndrejtori. Kur institucioni nuk ka nëndrejtor, drejtori zëvendësohet nga një mësues i institucionit.*

2. Nëndrejtori ose mësuesi, që zëvendëson përkohësisht drejtorin, caktohet nga titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse."

Sipas udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar (ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 19.3.2020), *Kreu I. Pika E.* 2, përcakton se: "*Kur vendi i drejtorit të IPAP shpallet i lirë, drejtori i DRAP cakton nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, deri në përfundim të procesit të konkurrimit sipas afateve të përcaktuara në kreun I të këtij udhëzimi"*.

-Për **12 raste** komandimi i drejtuesit është kryer nga stafi ekzistues i shkollës, konform udhëzimit të sipërcituar, pra nga nën drejtori nëse ka patur të tillë në strukturë, dhe në mungesë të tij, nga mësuesi i shkollës.

-Nga auditimi konstatohet se për **7 raste**, në kundërshtim me pikën C.1, Kreu I të udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013, drejtori i institucionit arsimor të larguar nga detyra, nuk është zëvendësuar

nga nën drejtori i vetë shkollës, edhe pse shkolla ka patur nën drejtor në momentin e komandimit të drejtuesve respektim. Më hollësisht:

BEDRI LLAGAMI	E.T.	16.10.2019	Drejtore në Arbanë.	Ka një N.Drejtor
HASAN PRISHTINA	T.D.	24.01.2020	Jashtë sistemi/me 04.12.2019 jep dorëheqjen nga Drejtore tek Sami Frashëri.	Ka dy N.drejtor
Inst.I nxënësve qe nuk shikojne	V.J.	03.02.2020	Mësuese në shkollën, Inst.i nxënësve qe nuk shikojnë.	Ka një N.Drejtor
KONGRESI I LUSHNJES	A.Z.	29.06.2020	Mësuese në shkollën Kongresi i Lushnjës.	N.Dr A. S doli ne pension me dt. 15.07.2020. Nuk ka N.Drejtor te tjerë.
KOL JAKOVA	L.H.	14.01.2020	Drejtore ne shkollen 16 Shtatori.	Ka një N.Drejtor
LIDHJA E PRIZRENIT	S.J.	10.09.2019	Drejtore në shkollën Niket Dardani.	Ka dy N.Dr
SKENDER LUARASI	GJ.N.	17.09.2019	Mësuese në shkollën 9-vj.Gjergj Fishta.	Ka dy N.Drejtor

-Nga auditimi konstatohet se për **3 raste**, në shkollat në të cilat nuk ka patur nën drejtora në strukturat organizative, pas largimit të drejtuesit të institucionit arsimor, nuk është zëvendësuar me një mësues të institucionit, në kundërshtim me pikën C.1, Kreu I të udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013. Më hollësisht:

ARBANË	Y.H.	01.10.2019	Drejtor në shkollën Hamdi Mancaku.	Nuk ka N.drejtor
MURAT TOPTANI	M.K.	28.05.2019	Jashtë sistemi. Ka punuar mësuese ne ZA Kruje.	Nuk ka N.Drejtor
NIKET DARDANI	M.K.	18.09.2019	Drejtore në shkollën Bedri Llagami.	Nuk ka N.Drejtor

-Nga verifikimi i dosjeve të mësuesve të komanduar në pozicionin e drejtorit, rezulton se mësuesin Xh.M. drejtor i komanduar në shkollën Hamdi Mancoku, **nuk** rezulton të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar", në kundërshtim me pikën B.1.b, Kreu I të udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013.

- Nga auditimi konstatohet se znj. T.D. është shkarkuar nga detyra nga DRAP Durrës në 21.12.2019 dhe në 24.01.2020 është komanduar drejtore në shkollën Hasan Prishtina, **në kundërshtim** me kriteret e udhëzimit nr.57, datë 12.11.2013, Kreu I, çështja B, pika ç e cila citon se " *Kandidati për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet: ç) të mos këtë masa disiplinore në fuqi ndaj tij."*

-Nga auditimi konstatohet se në vijim të krijimit të vendit të lirë të punës, në kundërshtim me pikën A.2 të kreut I e cila përcakton se shpallja bëhet jo më vonë se 5 ditë pune nga njoftimi i ZVAP, DRAP Durrës nuk ka kryer shpalljen e vendit të lire konform këtyre afateve. Më hollësisht, **rezultojnë 10 shkolla në ZVAP Tiranë, drejtuesit e të cilave janë të komanduar dhe nuk janë përfshirë në Shpalljet 1, 2 dhe 3 të DRAP Durrës:**

1. 16 Shtatori
2. Bedri Llagamani
3. Ferraj
4. Hamdi Mancaku
5. Instituti i Fëmijëve qe nuk shikojnë[23]
6. Kol Jakova
7. Lidhja e Prizrenit
8. Murat Toptani
9. Peze e Vogel
10. Skënder Luarasi

Për vitin 2020, shpallja e parë e pozicionit të lirë të punës është bërë me shkresën nr. 413/1, prot datë 26.02.2020, publikuar në faqen e internetit të ZVAP Tiranë. Sipas këtij dokumenti të DRAP Durrës është shpallur vendi i lirë i punës për drejtor në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP si më poshtë:

Gjimnazi "Qemal Stafa"

Instituti i nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi"

[23] Perfshire fillimisht ne shpalljen 1, por pas anullimit te saj nuk eshte rishpallur ne shpalljen 2 apo 3.

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 të shkronjës B, është përcaktuar të dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-në përkatëse **jo më vonë se data 09.03.2020.**
Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit janë përcaktuar të shpallen **në datën 17.03.2020.**
Në vijim të kësaj shpalljeje nuk disponohet informacion shkresor për vijueshmërinë e procesit të përzgjedhjet të drejtuesve të shkollave të sipërcituara, por sikundër u vumë në dijeni verbalisht nga ZVAP Tiranë, procesi është pezulluar për shkak të COVID-19.
Nëpërmjet **Shpalljes nr. 1,** nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vorë, Klos, Mat,Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Krujë, dhe Tiranë. Kjo shpallje është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZVAP Tiranë si dhe në ambientet e kësaj zyre vendore. Nëpërmjet kësaj shpallje, për **ZVAP Tiranë** janë shpallur **5 pozicione të lira** për drejtor të shkollave si më poshtë:
Andon Zako Çajupi,
Kongresi i Lushnjës,
Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë " Ramazan Kabashi",
Sami Frashëri,
Qemal Stafa.
Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 të shkronjës B, është përcaktuar të dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-në përkatëse **jo më vonë se data 17.08.2020.**
Pika 3 e shpalljes nr. 1 përcakton se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen **në datën 21 dhe 24 Gusht 2020.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.
Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar(ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 19.3.2020), Kreu I, pika B.1, e cila citon se "Kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e dorëzimit të tij
1. Kandidati për drejtor i IPAP duhet të plotësojë kushtet si vijon:
a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar";
c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
d) të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar **dhe** të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.".
Grupi i auditimit shqyrtoi **5 dosjet** e vendosura në dispozicion nga ZVAP Tiranë mbi procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore nën juridiksionin e kësaj zyre arsimore, për **Shpalljen nr.1**, ku në të 5 dosjet u konstatuan parregullsi, trajtuar si më poshtë:
Gjimnazi "SAMI FRASHËRI"
Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:
Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 7571, datë 11.08.2020, ZVAP Tiranë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e Vlerësimit të drejtorit për shkollën "Sami Frashëri". Me anë të shkresës nr. 2865/1, datë 17.08.2020 Njësia e Administrative nr. 9 ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, Znj. L.D., për të qenë pjesë e Komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Referuar procesverbalit nr. 184. prot. datë 13.08.2020 është mbledhur Këshilli i Mësuesve në shkollën "Sami Frashëri" në kuadër të përzgjedhjes së dy mësuesve, për të qenë pjesë e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Sami Frashëri". Në dosjen e shkollës Sami Frashëri, në ZVAP Tiranë, gjendet procesverbali me emrat e stafit mësimor të cilët kanë votuar, si dhe fletët e votimit që mbajnë datë 13.08.2020. Si rezultat i votimit dolën fitues dy mësues Znj. M.Th. dhe Znj. A.P..

Me anë të shkresës nr. 185 prot. datë 13.08.2020, Drejtori i Gjimnazit "Sami Frashëri", Znj. M.Z., i ka përcjellë ZVAP Tiranë informacionin e më poshtë:

Kryetari i Bordit të Shkollës është Z. A.Z.

Kryetare e Këshillit të Prindërve është Znj. T.L.

Pas votimit të bërë nga Këshilli i Mësuesve të gjimnazit "Sami Frashëri", në datë 13.08.2020, si anëtare të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të gjimnazit Sami Frashëri, rezultuan:

Znj M.Th.

Znj. A.P.

Nëpërmjet kësaj shkrese informohet gjithashtu se Znj. Th. është edhe mësuesja me e vjetër e shkollës.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me anë të shkresës nr. 7701, prot., datë 18.08.2020 ZVAP Tiranë i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës, Federatës së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë njoftimin se mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për Gjimnazin " Sami Frashëri" do të zhvillohej në ambientet e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë në datë 19.08.2020, ora 09:00. Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Tiranë i ka kërkuar institucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj, nuk disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 48, datë 18.08.2020, Drejtori i ZVAP Tiranë urdhëron ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve për drejtor të shkollës "Sami Frashëri", si më poshtë:

M.Th., mësuese- Kryetare

A.P., mësuese- Anëtare

A.Z., Kryetar i Bordit të Shkollës- Anëtar

T.L., Kryetare e Këshillit të Prindërve-Anëtare

L.D., Përfaqësuese e Pushtetit Vendor- Anëtare

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Referuar procesverbalit te mbajtur më datë 19.08.2020, në ambientet e ZVAP Tiranë ndërmjet sekretares së ZVAP Tiranë dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT-it, për pozicionin e drejtorit të shkollës "Sami Frashëri", Komisioni i Vlerësimit mori në dorëzim 4 dosje. Ky procesverbal është firmosur nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe sekretarja e ZVAP Tiranë (e cila, sipas procesverbalit i dorëzoi dosjet Komisionit) Znj. E.P..

Në vijim të marrjes në dorëzim të dosjeve, ka filluar procesi i vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Vlerësimit. Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Sami Frashëri", Komisioni është shprehur:

1. Kandidatja D.V. është skualifikuar pasi referuar pikës 2 të Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020, Kreu 1, pika B/2[24], dokumentacioni është i panoterizuar;

2. Për kandidaten R.C.:

Mungon "Tabela e të dhënave të aplikantit" (shtojca 4),

Mungon certifikimi i kandidatit për drejtor i IPAP,

Mungon vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore (shtojca 2)

Mungojnë plani afatmesëm i shkollës, plani vjetor i shkollës i vitit paraardhës dhe raporti vjetor i shkollës i vitit parashkollor,

Nuk u paraqit aplikantja në intervistën e strukturuar;

3. Kandidatja M.Z., nga shqyrtimi i dosjes rezulton që i ka të gjitha dokumentet e aplikimit sipas kritereve të dhëna në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020;

4. Për kandidaten A.H.:

Vërtetimi nga institucioni që punon që s'ka masë disiplinore ishte i pavulosur dhe i pafirmosur nga titullari i institucionit.

Zotëronte vetëm fletën e pranimit në shkollën e Drejtorëve, jo çertifikimin prej saj.

Intervistimi i kandidatëve

Pas vlerësimit të dosjeve, po më datën 19.08.2020, Komisioni ka zhvilluar intervistat për kandidatët A.H. dhe M.Z.. Referua procesverbalit të mbajtur për zhvillimin e intervistës, kandidatja R.C. nuk u paraqit në intervistë.

Referuar procesverbalit mbi zhvillimin e intervistës, pyetjet e intervistës së strukturuar ishin si më poshtë:

Cilat janë prioritetet e planit afatmesëm të gjimnazit "Sami Frashëri"?

Si mendoni se do të realizoni prioritet e planit afatmesëm?

Pas ndërtimit të shkollës, duket sikur tradita për nxënësit dhe mësuesit e dikurshëm të "Sami Frashërit" humbet..., si mendoni ta zgjidhni?

Çfarë arritjes të tjera realizuat vitin e kaluar shkollor dhe mendoni si do të realizoni edhe në vitin që do të vijojë?

Në lidhje me administrimin e shkollës a mendoni se prioritet dhe Bordi i Shkollës ka rol në 5 pikat e shkollës dhe mbarëvajtjes së saj?

Vlerësimi final i Komisionit të Vlerësimit

[24] Pika B/2 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, parashikon dokumentacionin e apilikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP, sipas pikës 2/A të Shpalljes nr 1, datë 05.08.2020.

Vlerësimi i kandidatëve në pikë rezulton të jetë kryer në të njëjtën datë me vlerësimin paraprak dhe intervistimin e tyre. Komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes	Pikët e intervistës nga K.V.	Pikët e fazës së parë
M.Z.	25.3	10	35.3
A.H.	21.4	3.8	25.2
R.C.	15.7	0[25]	15.7

Kandidatja M.Z. është vlerësuar me 35.3 pikë nga 40 pikë në total, ku 25.3 pikë ka marrë nga vlerësimi i dosjes dhe 10 pikë nga intervista e strukturuar.

Kandidatja A.H. është vlerësuar me 25.2 pikë nga 40 pikë në total, ku 21.4 ka marrë nga vlerësimi i dosjes dhe 3.8 pikë nga intervista e strukturuar

Kandidatja R.C. është vlerësuar me 15.7 pikë nga 40 pikë në total, ku 15.7 pikë ka marrë nga vlerësimi i dosjes dhe 0 pikë në intervistë, pasi nuk u paraqit.

Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 25.08.2020, kryetari i Komisionit të Vlerësimit i dorëzoi titullarit të ZVA Tiranë, Znj. E.A., dy dosjet e kandidatëve me më shumë pikë, atë të Znj. M.Z.t dhe të Znj. A.H..

Shtojca 6, Tabela e rezultateve të vlerësimit final nga Komisioni, për 3 kandidatët për drejtor të shkollës Sami Frashëri rezulton e publikuar në ambientet e ZVAP Tiranë, referuar fotove të cilat janë pjesë e dosjes.

Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Në përputhje me Kreun I të pikës D.1 të Udhëzimit nr.2 sipas të cilës: "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*", me Urdhrin nr. 53, datë 19.08.2020, protokolluar me shkresën nr. 7944 prot., datë 19.08.2020, znj. G.H. është autorizuar nga Drejtori i ZVAP Tiranë, për shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të shkollës Sami Frashëri.

Në vijim të Urdhrit nr. 53, të Drejtorit të ZVAP Tiranë, znj. G.H. ka përgatitur një relacion protokolluar me shkresën nr. 7916/3, datë 27.08.2020, në të cilën ka përshkruar procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Sami Frashëri, duke nisur nga publikimi i Shpalljes nr. 1 deri në dorëzimin e dosjeve nga Kryetari i Komisionit, Drejtorit të ZVAP Tiranë. Në këtë relacion nuk rezultojnë të jenë identifikuar parregullsi të ndodhura në procesin e vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Vlerësimit. Ndërkohë që, për mos respektim të afateve nga komisioni i vlerësimit, znj. G.H. në relacionet e përgatitura më datë 27.08.2020 (pra në të njëjtën datë me relacionin e përgatitur për shkollën Sami Frashëri), në të cilën ka cituar pikën 10/b të pikës C, Kreu I të udhëzimit nr. 2, ka kërkuar **anullimin e procedurave të konkurrimit për shkollat Andon Zako Cajupi dhe Kongresi i Lushnjës.**

Në vijim, me anë të shkresës nr. 7916/1, datë 27.08.2020, ZVAP Tiranë i ka përcjellë DRAP Durrës-it dosjet e dy kandidatëve me pikët më të larta, atë të Znj. M.Z.t dhe të Znj. A.H..

Intervistimi i kandidatëve në DRAP Durrës

Referuar procesverbalit të mbajtur, më datë 03.09.2020 është zhvilluar intervista me dy kandidatët e mësipërm në DRAP Durrës. Në përfundim është shpallur fituese Znj. M.Z.. Me Urdhrin nr.64,

[25] Kandidatja nuk u paraqit në intervistë

datë 08.09.2020 të ish Drejtorit të DRAP Durrës është bërë emërimi definitiv i Znj. Z. si drejtore e shkollës.

Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Sami Frashëri, grupi i auditimit ka evidentuar parregullsitë e përmbledhura si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Sami Frashëri është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Tiranë. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion dhe dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës.

Në vijim të Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, dhe shkresës së ZVAP Tiranë nr. 7701, prot., datë 18.08.2020, në mbledhjen e Komisionit të Vlerësimit **nuk** ka patur përfaqësues të DPAP-së dhe DRAP Durrës.

Procesverbali i dorëzimit të dosjeve të aplikantëve nga sekretarja e ZVAP Tiranë Komisionit të Vlerësimit, nuk është i protokolluar.

Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të dosjeve nga Komisioni i Vlerësimit, vërehet se numri i dosjeve të marra në dorëzim është i korrigjuar.

Referuar të dhënave të përcjella nga Sektori i Shërbimit në ZVAP Tiranë, Znj. E.P. ka nisur punë në ZVAP Tiranë më datë 24.08.2020, pavarësisht emërimit të saj në 19.08.2020. Pra, sekretarja e ZVAP Tiranë, Znj. E.P., ka nisur punë **6 ditë pas datës** që i ka dorëzuar dosjet Komisionit të Vlerësimit.

Procesverbali i mbajtur më datë 19.08.2020, për procesin e vlerësimit të dosjeve është i paprotokolluar dhe vërehet se data e mbledhjes së Komisionit për vlerësimin e dosjeve është e korrigjuar.

Procesverbali i mbajtur më datë 19.08.2020 për procesin e intervistimit të kandiadatëve është i paprotokolluar dhe vërehet se data e mbledhjes së komisionit për zhvillimin e intervistës është e korrigjuar.

Nga shqyrtimi i procesverbalëve të mbajtur për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve dhe intervistimin e tyre rezulton se, Komisioni i Vlerësimit **nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë** kandidatët për pozicionin e drejtorit të shkollës "Sami Frashëri". Znj. D.V. është skualifikuar pasi dokumentacioni ishte i panoterizuar, ndërsa Znj R.C. dhe Znj. A.H. me **mungesë në dokumentacion** kanë kaluar në fazën e intervistës.

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.*" Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar shqyrtimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve **në të njëjtën ditë**, 19.08.2020, duke mos i dhënë mundësinë kandidates së skualifikuar Znj. D.V., si dhe Znj R.C. dhe Znj. A.H. për të plotësuar dokumentacionin. Në gjykimin e grupit të auditimit, shkelja e dispozitave të mësipërme nga Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve, **ka krijuar kushte të pabarabarta konkurrimi**, jo vetëm për kandidaten e skualifikuar të cilës **nuk** i është dhënë e drejta për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, por edhe për kandidaten R.C. e cila **nuk** është vlerësuar për intervistën, pasi nuk ka qenë prezente në datën **19.08.2020** për ta zhvilluar atë, intervistë e cila duhej të zhvillohej pas njoftimit të rezultateve paraprake nga vlerësimi i dosjeve, i cili duhet të bëhej midis datave **21-24 gusht** 2020.

Në vijim të Urdhrit nr. 53, të Drejtorit të ZVAP Tiranë, znj. G.H. ka përgatitur një relacion protokolluar me shkresën nr. 7916/3, datë 27.08.2020, në të cilën ka përshkruar procedurën

e ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Sami Frashëri, duke nisur nga publikimi i Shpalljes nr. 1 deri në dorëzimin e dosjeve nga Kryetari i Komisionit, Drejtorit të ZVAP Tiranë. Në këtë relacion nuk rezultojnë të jenë identifikuar parregullsi të ndodhura në procesin e vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Vlerësimit. Ndërkohë që, për mos respektim të afateve nga komisioni i vlerësimit, znj. G.H. në relacionet e përgatitura **për shkollat Andon Zako Cajupi dhe Kongresi i Lushnjës** më datë 27.08.2020 (pra në të njëjtën datë me relacionin e përgatitur për shkollën Sami Frashëri), në të cilën ka cituar pikën 10/b të shkronjës C, Kreu I të udhëzimit nr. 2, ka kërkuar **anullimin e procedurave të konkurimit.**

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve.

Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Tiranë, në vijim të Kreut I të Pikës D.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 e cila përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*".

Përbërja e Komisionit të Vlerësimit ishte si më poshtë:
- M.Th.- Kryetare
- A.P. – Anëtare
- A.Z. - Anëtar
- T.L. -Anëtare
- L.D. – Anëtare

Personi i autorizuar për shqyrtimin e procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e kandidateve për drejtor të shkollës Sami Frashëri ishte Znj. G.H..
Drejtori i ZVAP Tiranë, Znj. E.A.
Ish-Drejtor i DRAP Durrës, Znj. V.L.

INSTITUTI I NXËNËSVE QË NUK SHIKOJNË " RAMAZAN KABASHI"

Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Me anë të shkresës nr. 7572, datë 11.08.2020, ZVA Tiranë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e Vlerësimit të drejtorit për Institutin "Ramazan Kabashi". Me anë të shkresës nr. 1871/1/1, datë 20.08.2020 Njësia e Administrative nr. 8 ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, Znj. O.Rr. për të qenë pjesë e Komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Sipas procesverbalit të mbajtur në Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë " Ramazan Kabashi", më datë 20.08.2020, në këtë institut u mblodh Këshilli i Mësuesve për përgjedhjen e dy mësuesve që do të jenë pjesë e komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve për pozicionin e drejtorit, në Komisionin që do të ngrihej në ZVAP Tiranë. Sipas këtij procesverbali u përzgjodhën me shumicë votash, me dy raunde, dy mësuesit që do të ishin pjesë e shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të kandidatëve. Në raundin e parë u përzgjodh Znj. E.P., ndërsa për dy mësuesit Znj.V.G. (7 vota) dhe Znj. Dh.B. (8 vota), të cilët rezultuan me nr. të përafërt votash në raundin e parë, u zhvillua një raund i dytë votimi. Në përfundim të raundit të dytë u përzgjodh Znj. V.G. me 11 vota.

Në përfundim të dy raundeve u përzgjodhën për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit dy mësues, Znj. E.P. dhe Znj. V.G.. Me anë të shkresës Nr. 65 prot., datë 20.08.2020, Drejtori i Institutit të Nxënësve që Nuk Shikojnë "Ramazan Kabashi", Znj. V.J., i ka përcjellë ZVAP Tiranë emrat e Kryetarit të Bordit, Kryetarit të Këshillit të Prindërve dhe përfaqësuesin e Njësisë Administrative, sipas të cilës:

Komisioni i Institutit: 1-V.G.

2- E.P.

Kryetar i këshillit të prindërve është B.S.,

Kryetar i bordit të shkollës është F.R.,

Përfaqësuesi i Njësisë Vendore është O.Rr..

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me anë të shkresës nr. 7750, prot., datë 20.08.2020 ZVAP Tiranë i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës-it, Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë njoftimin se, mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë " Ramazan Kabashi", do të zhvillohej në ambientet e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë në datë 20.08.2020, ora 12:30. Nëpërmjetë kësaj shkrese, ZVAP Tiranë i ka kërkuar insitucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj, **nuk** disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhërit nr. 50, datë 20.08.2020, referuar shkresës nr. 1871/1, datë 20.08.2020 të njësisë administrative nr. 8, të shkresës nr. 65, datë 20.08.2020 mbi mësuesit që do të jenë anëtarë të Komisionit, mbi mësuesin më të vjetër në insitutucion si dhe mbi kryetrarin e bordit të shkollës dhe kryetarin e këshillit të prindërve të Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë "Ramazan Kabashi", Drejtori i ZVA Tiranë urdhëron ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Ramazan Kabashi, si më poshtë:

Znj. V.G., mësuese- Kryetare

Znj. E.P., mësuese- Anëtare

Znj. F.R., Kryetare Bordi- Anëtare

Z. B.S., kryetar i këshillit të prindërve- Anëtar

Znj. O.Rr. përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare

b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 20.08.2020, në ambientet e ZVAP Tiranë ndërmjet sekretares së ZVAP Tiranë dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP Tiranë, për pozicionin e drejtorit të Institutit të Nxënësve që nuk Shikojnë "Ramazan Kabashi", Komisioni mori në dorëzim 6 dosje. Ky procesverbal është firmosur nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe sekretarja e ZVAP (e cila sipas procesverbalit i dorëzoi dosjet komisionit) Znj. E.P..

Në vijim të marrjes në dorëzim të dosjeve, ka filluar procesi i vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Vlerësimit. Më datë 20.08.2020 anëtarët dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, po më datë 20.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të Institutit të Nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi", Komisioni është shprehur:

Kandidatja M.M. është skualifikuar për intervistën e strukturuar, pasi lista e notave ishte e panoterizuar

Kandidatja F.K. është skualifikuar për intervistën e strukturuar. Mungon Shkolla e kualifikimit, Vërtetimi nr. 3729 prot., datë 05.11.2015. Lista e notave të Masterit është e panoterizuar.

Kandidatja M.T. skualifikohet sepse nuk përmbush kriterin e diplomimit. Nuk ka diplomë në fushën e edukimit. Nuk ka shkollën e kualifikimit.

Kandidatja V.J. s'kualifikohet për shkak se i mungon noterizimi i shkollës së çertifikatës së kualifikimit. Diploma të pa noterizuara, librezë pune e panoterizuar.

Kandidati E.L. skualifikohet për intervistën e strukturuara. Nuk ka diplomë në në fushën e edukimit dhe nuk ka kategorinë mësues i kualifikuar.

Kandidati A.D. kualifikohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e kandidates F.K. rezultoi se, Vërtetimi nr. 3729 prot., datë 05.11.2015 gjendet në dosje dhe është i lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale i cili vërteton se F.K. ka përfunduar studimet e pjesshme në Pedagogji të Specializuar Sociale. Në dosje gjithashtu gjendet edhe Diploma në Pedagogji të Specializuar Sociale e noterizuar e kandidates F.K..

Referuar procesverbalit të datës 20.08.2020, Komisioni i Vlerësimit është shprehur:

"Duke qenë se në konkurrim mbetet vetëm 1 kandidat A.D., konkurimi me një kandidat nuk mund të vazhdojë. Për këtë arsye Komisioni vendosi:

Anulimin e procedurës për Drejtor në të IPAP " Ramazan Kabashi"

Zyra Vendore Arsimore tiranë të njoftojë DRAP Durrës për anullimin e procedurës së konkurrimit pasi konkurrimi me një kandidatë nuk mund të vazhdojë".

Intervistimi i kandidatëve

Si rezultat se, Komisioni i Vlerësimit ka anuluar konkursin për drejtor të shkollës "Ramazan Kabashi", pa i dhënë mundësinë kandidatëve për të plotësuar dokumentacionin **në kundërshtim** me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për*

plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak." dhe faza e intervistimit nuk është kryer.

c. Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Në përputhje me Kreun I të pikës D.1 të Udhëzimit nr.2 sipas të cilës: "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*", me Urdhrin nr. 53, datë 19.08.2020, protokolluar me shkresën nr. 7944 prot., datë 19.08.2020, znj. G.H. është autorizuar nga Drejtori i ZVAP Tiranë, për shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të shkollës "Ramazan Kabashi." Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, **nuk** rezulton që Znj.G.H. të ketë shqyrtuar procedurën e ndjekur nga Komisioni për vlerësimin e kandidatëve për drejtor të shkollës "Ramazan Kabashi", pasi **nuk** ka përgatitur një relacion për këtë procedurë. Nga komunikimi me punonjësen në fjalë, grupit të auditimit iu bë me dije se si rezultat se procedura është anuluar nga Komisioni, ajo nuk është shqyrtuar për parregullsi teknike të mundshme në ZVAP Tiranë.

Në vijim, me anë të shkresës nr. 7916/1, datë 27.08.2020, ZVAP Tiranë i ka përcjellë DRAP Durrës-it informacionin se, për shkollën Ramazan Kabashi **nuk** ka dosje të kandidatëve me më shumë pikë pasi, Komisioni i Vlerësimit e anuloi konkursin nga 6 kandidatë vetëm 1 prej tyre u kualifikua.

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Ramazan Kabashi është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Tiranë. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion.

Në vijim të Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, dhe shkresës së ZVAP Tiranë nr. 7750, prot., datë 20.08.2020, në mbledhjen e Komisionit të Vlerësimit **nuk** ka patur përfaqësues të DPAP-së dhe DRAP Durrës.

Procesverbali i dorëzimit të dosjeve të aplikantëve nga sekretarja e ZVAP Tiranë Komisionit të Vlerësimit, nuk është i protokolluar.

Referuar të dhënave të përcjella nga Sektori i Shërbimit në ZVAP Tiranë, Znj. E.P. ka nisur punë në ZVAP Tiranë më datë 24.08.2020 pavarësisht emërimit të saj në 19.08.2020. Pra, sekretarja e ZVAP Tiranë, Znj. E.P., ka nisur punë **4 ditë pas datës** që i ka dorëzuar dosjet Komisionit të Vlerësimit.

Procesverbali i mbajtur më datë 20.08.2020 për procesin e vlerësimit të dosjeve është i paprotokolluar.

Komisioni **nuk** ka shqyrtuar me kujdes dosjet e kandidatëve, si p.sh. dokumenti i cili referuar Komisionit mungonte për kandidaten F.K., u identifikua nga grupi i auditimit në dosjen e saj të aplikimit.

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak*."

Komisioni i Vlerësimit ka **anuluar** procedurën, **pa** shpallur rezultatet paraprake nga vlerësimi i dosjeve dhe **pa** i dhënë mundësinë aplikantëve të plotësonin dokumentacionin që mungonte.

Në kundërshtim me Urdhrin nr. 53, datë 19.08.2020, Znj.G.H. nuk rezulton të ketë shqyrtuar procedurën e ndjekur nga Komisioni për vlerësimin e kandidatëve për drejtor të shkollës "Ramazan Kabashi" dhe nuk ka identifikuar parregullsitë e konstatuar në këtë procedure.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimi, në vijim të anulimit të procedurës nga Komisioni i Vlerësimit, DRAP Durrës **nuk** ka kërkuar shqyrtimin dhe vlerësimin e bërë për këtë procedurë nga Sektori i Shërbimeve në ZVAP Tiranë.
Nga procedura e mësipërme e ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Ramazan Kabashi" vërehet se:
Votimi me dy raunde në shkollën Ramazan Kabashi, për përzgjedhjen e mësuesve të shkollës të cilët do të ishin pjesë e Komisionit të Vlerësimit, është kryer më datë 20.08.2020 dhe i është përcjellë ZVAP Tiranë në po këtë datë.
Njësia administrative ka përcjellë emrin e përfaqësuesit të saj në ZVAP Tiranë në datë 20.08.2020
Më datë 20.08.2020 ZVAP Tiranë i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës-it, Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë njoftimin se, Komisioni i Vlerësimit do të mblidhet me datë 20.08.2020, ora 12:30 dhe ka kërkuar nga këto institucioneve caktimin e përfaqësuesve për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure.
ZVAP Tiranë ka ngritur Komisionin e Vlerësimit në datë 20.08.2020.
Komisioni i Vlerësimit është mbledhur më datë 20.08.2020 dhe ka shqyrtuar dosjet e kandidatëve.
Komisioni i Vlerësimit ka anuluar procedurën në datë 20.08.2020.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, **nuk** rezulton të jetë ndërmarrë ndonjë masë nga ZVAP Tiranë apo DRAP Durrës për parregullsitë e lidhura me këtë procedurë.
Përbërja e Komisionit të Vlerësimit ishte si më poshtë:
Znj.V.G.- Kryetare
Znj. E.P.- Anëtare
Znj. F.R.- Anëtare
Z. B.S.- Anëtar
Znj. O.Rr.- Anëtare
Personi i autorizuar për shqyrtimin e procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e kandidateve për drejtor të shkollës Ramazan Kabashi ishte Znj. G.H..
Drejtori i ZVAP Tiranë, Znj. E.A.
Ish-Drejtor i DRAP Durrës, Znj. V.L.

GJIMNAZI " ANDON ZAKO CAJUPI"

a. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit:

Kreu I, pika C.1 e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : *"Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 7574, datë 11.08.2020, ZVAP Tiranë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Andon Zako Cajupi", brenda datës 17.08.2020. Me anë të shkresës nr. 1067/1, datë 17.08.2020, Njësia e Administrative nr. 3 ka përcjellë personin e

përcaktuar nga kjo njësi, z. M.C., për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Me anë të shkresës nr. 71, protokolluar në Gjimnazin Andon Zako Cajupi, datë 17.08.2020 janë përcjellë pranë ZVAP Tiranë anëtarët e komisionit nga mësuesit e shkollës, pas votimit nga stafi i shkollës, duke përzgjedhur znj. M.B. dhe znj. F.Gj. (mësuesja me eksperiencën më të gjatë të punës), sipas pikës C.3 të udhëzimit nr.2. Me shkresën nr. 70, protokolluar në Gjimnazin Andon Zako Cajupi, datë 17.08.2020 janë përcjellë pranë ZVAP Tiranë anëtarët e komisionit, znj. M.V., Kryetar i Bordit dhe z. D.I., Kryetar i Këshillit të Prindërve.

Në vijim, me anë të shkresës nr. 73, protokolluar në Gjimnazin Andon Zako Cajupi, datë 18.08.2020 është përcjellë pranë ZVAP Tiranë informacioni se znj. M.V. do të zëvendësohet me znj. A.D., e cila është kryetare e këshillit të prindërve në klasën XI.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Në mbështetje të pikës 6 dhe 7 të gërmës C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr. 7701, prot. datë 18.08.2020, ZVAP Tiranë i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës, Federatës së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë ka njoftimin se mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për Gjimnazin " Andon Zako Cajupi" do të zhvillohej në ambientet e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë <u>në datë 19.08.2020,</u> ora 10:00. Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Tiranë i ka kërkuar institucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj nuk disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 47, datë 18.08.2020, protokolluar në ZVAP Tiranë, sipas shkresës nr. 7713, prot datë 18.08.2020, Drejtori i ZVAP Tiranë urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Andon Zako Cajupi, si më poshtë:

F.Gj., mësuese- Kryetare

M.B., mësuese- Anëtare

M.V., kryetar i bordit- Anëtar

D.I., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtar

M.C., përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare

<u>Pas zëvendësimit të anëtares znj. M.V. me znj. A.D., ZVAP Tiranë **nuk** ka kryer rishikimin e urdhrit të sipërcituar.</u>

<u>b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni</u>

Vlerësimi i dosjeve

Sipas pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr. 7701, prot. datë 18.08.2020 komisioni ka bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimi. Referuar procesverbalit te <u>mbajtur më datë 19.08.2020</u>, në ambientet e ZVAP Tiranë ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP, për pozicionin e drejtorit të shkollës Andon Zako Cajupi. Komisioni mori në dorëzim 4 dosje. Ky procesverbal është firmosur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe sekretaria e ZVAP, Znj. E.P.. Ky procesverbal është i paprotokolluar. <u>Referuar të dhënave të përcjella nga Sektori i Shërbimit në ZVAP, Znj.E.P. **ka nisur punë në ZVAP më datë 24.08.2020** **pavarësisht emërimit të saj në 19.08.2020, pra 5 ditë më vonë se data në të cilën është firmosur procesverbali.**</u>

Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Andon Zako Cajupi", komisioni është shprehur:

1. Hapet dosja e kandidatit L.H.. Skualifikohet pasi dokumentacioni (nuk) i paraqitur nuk është sipas formës nga Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit.
2. Hapet dosja e kandidates V.K.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
3. Hapet dosja e kandidates A.D.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
4. Hapet dosja e kandidates E.G.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.

Procesverbali është firmosur nga 5 anëtarët e komisionit, por është i paprotokolluar.

Një tjetër procesverbal është mbajtur nga anëtarët e komisionit, në datë 19.08.2020, për skualifikim nga konkurrimi. Komisioni është shprehur se kandidatja znj. T.D. nuk ka paraqitur masën disiplinore për të. Mbështetur në Udhëzimin nr.2, pika B 2.g, kandidati duhet të dorëzojë nga institucioni ku punon se nuk ka masë disiplinore për të. Për sa më sipër komisioni ka skualifikuar kandidaten znj. T.D..

Procesverbali është firmosur nga 5 anëtarët e komisionit, por është i paprotokolluar.

Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me pikën 10.b të udhëzimit nr. 2, ku përcaktohet se "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*" dhe pikën 10.c ku përcaktohet se "*pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni*", Komisioni **nuk** ka njoftuar kandidaten znj. L.H. dhe znj. T.D. për mungesat e konstatuar, **por i ka skualifikuar kandidatet,** dhe ka kryer intervistimin e kandidatëve të kualifikuar, **në të njëjtën ditë** kur është kryer edhe vlerësimi i dosjeve.

Intervistimi i kandidatëve

Pas vlerësimit të dosjeve, po në të njëjtën ditë, në datën 19.08.2020, komisioni ka zhvilluar intervistat për 3 kandidatët, sipas pikës 10.e e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit. Në dosje nuk disponohen dokumentacionet për njoftimin e kandidatëve për datën e intervistës. Vërehet se, edhe ky procesverbal është i firmosur nga komisioni por i paprotokolluar. Në procesverbal **nuk** janë përcaktuar pyetjet e intervistës së strukturuar, por vetëm pikët e kandidatëve. Për vlerësimin me pikë të kandidatëve në përfundim të intervistës, anëtarët e komisionit kanë votuar në mënyrë të pavarur për çdo pyetje.

Vlerësimi final i komisionit

Në vijim, komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
A.D.[26]	22.4[27]	8.4	30.4
V.K.[28]	21[29]	4.7	25.7
E.G.	9.5[30]	4.6	14.1

[26] Piket jane te korrigjuara

[27] Ne vleresimin e dosjes, per mesataren e notave komisioni ka rrumbullakosur piket dhe nuk i ka deklaruar me 2 shifra pas presjes sikunder percakton udhëzimi. Përllogaritja e drejte e pikeve të dosjes do e vleresonte kandidaten me 19.69 pikë, pra ne total kandidatja do te vleresohej me 28.09 pikë dhe jo 30.4.

[28] Piket jane te korrigjuara

[29] Ne vleresimin e dosjes, per mesataren e notave komisioni ka rrumbullakosur piket dhe nuk i ka deklaruar me 2 shifra pas presjes sikunder percakton udhëzimi. Përllogaritja e drejte e pikeve të dosjes do e vleresonte kandidaten me 20.95 pikë, pra ne total kandidatja do te vleresohej me 25.65 pikë dhe jo 25.7.

[30] Piket jane te korrigjuara. Ne vleresimin e dosjes, per mesataren e notave komisioni ka rrumbullakosur piket dhe nuk I ka deklaruar me 2 shifra pas presjes sikunder percakton udhëzimi. Përllogaritja e drejte e pikeve të dosjes do e vleresonte kandidaten me 9.259 pikë, pra ne total kandidatja do te vleresohej me 13.85 pikë dhe jo 14.1.

Sipas procesverbalit po të datës 19.08.2020 komisioni i vlerësimit ka përcaktuar vlerësimin në pikë të 3 kandidatëve, duke përcaktuar se nga 4 dosje të konkurrentëve, skualifikohet kandidatja L.H. pasi dokumentacioni është i panoterizuar. Procesverbali është i firmosur nga komisioni por i paprotokolluar në ZVAP.

Për këtë procedurë në dosje **nuk** disponohet dokumentacioni i dorëzimit të dosjeve të dy kandidatëve me më shumë pikë nga komisioni për ZVAP Tiranë sipas pikës C.12 të udhëzimit nr.2. Gjithashtu në dosje nuk disponohen ankesa të kandidatëve për këtë proces, në vijim të pikës C.11 të udhëzimit nr.2.

c. Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Në përputhje me pikës D.1 të udhëzimit nr.2, me shkresën nr. 7916/2, prot datë 27.08.2020 juristja e ZVAP Tiranë, znj. G.H., autorizuar nga ZVAP, ka përcjellë pranë Drejtores së ZVAP Tiranë një relacion informues mbi procesin e vendimmarrjes të ndjekur nga komisioni i vlerësimit të dosjeve për shkollën Andon Zako Cajupi. Ky relacion ka përshkruar procesin e ndjekur, duke filluar nga shpallja e vendit vakant, deri në vendimmarjen për vlerësimin e dy dosjeve me më shumë pikë nga komisioni. Znj. H, është shprehur se: "*Pasi u bë shqyrtimi i dosjeve të kandidatëve me më shumë pikë rezultoi se:*

-Dosja e znj. V.K. ka ardhur në datën 18.08.2020, dhe jo në datën 17.08.2020, sipas afatit të Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020; Lista e notave e panoterizuar; Ka mospërputhje mes të dhënave të librezës së punës e cila është mbyllur në 20.06.2019, nga ku është transferuar në Vorë dhe nuk figuron e hapur në qendrën e punës aktuale; Vërtetimi që ka qenë administratore provimesh është i panoterizuar; mungon CV.

Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se komisioni nuk ka zbatuar pika 10/b e shkronjës C të kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik". Komisioni është në tejkalim të çdo afati procedurial të përcaktuar nga Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik"."

Në vijim të kësaj shkresë, **nuk** disponohet asnjë dokumentacion nga ZVAP Tiranë për vijueshmërinë e procesit; komunikim me DRAP Tiranë për shpalljen e pavlefshme të vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit; apo pezullim të procesit për drejtorin e shkollës Andon Zako Cajupi. Nga përgjigjet e pyetësorit të DRAP Durrës, me shkresën nr. 1745/1, datë 03.11.2020 procedurat për këtë shkollë janë anulluar si rezultat i **mungesës së kandidatëve.**

Nga auditimi konstatohet se ZVAP Tiranë **nuk** ka respektuar afatet e përcaktuara në pikën D.2, të Kreut 1, ku përcaktohet se "Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.". Nga komisioni vendimmarrja është konkluduar në 19.08.2020 dhe pasaktësitë e konstatuara nga ZVAP duhet të ishin identifikuar brenda 2 ditëve pune.

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

-Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Andon Zako Cajupi është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Tiranë. Dosja përmban mangësi në dokumentacion, të tilla si dokumenti i njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, procesverbali i intervistimit të kandidatëve, pyetjet e intervistës së strukturuar, dorëzimi i 2 dosjeve më të mira nga Komisioni për ZVAP. Procesverbalet e komisionit janë të pa protokolluara.

-Nga auditimi konstatohet se pas ndryshimit të anëtarit të komisionit të vlerësimit, përfaqësues nga prindërit për shkollën Andon Zako Cajupi, datë 18.08.2020, **nuk** është rishikuar urdhri i Drejtores së ZVAP Tiranë për komisionin (i po të njëjtës datë, 18.08.2020). Si rezultat, në mbledhjet e komisionit, është paraqitur dhe ka votuar kandidati i zëvendësuar, i cili faktikisht nuk rezulton në urdhrin e ZVAP për ngritjen e Komisionit.

-Nga auditimi konstatohet se komisioni ka firmosur se ka marrë në dorëzim **4 dosje**, në një kohë ku ai është shprehur në procesverbalet e mbajtura për faktikisht **5 dosje**.

- Nga verifikimi i dokumentacioneve të kandidatëve konstatohet se për znj. L.H., komisioni është shprehur se kandidati skualifikohet pasi dokumentacionet në dosje nuk janë sipas formatit të udhëzimit, por nuk dokumentohet në dosje të jetë njoftuar kandidati për mangësitë e konstatuara në dosjet respektive në mënyrë që nëse këto dokumentacione disponohen, të dorëzohen pranë ZVAP Tiranë brenda 3 ditëve, sikundër përcakton pika C.11 e udhëzimit nr. 2

-Kandidatja znj. T.D., është skualifikuar nga komisioni pasi nuk disponon vërtetimin nga DRAP Durrës për masën disiplinore. Nga verifikimi i dosjes së kandidates, rezulton se ajo ka dorëzuar vërtetimin lëshuar nga ZVAP Tiranë në Gusht 2020, në të cilin deklarohet se ajo **nuk** ka masë disiplinore. Ky dokument është konsideruar i pavlefshëm nga komisioni, por nuk dokumentohet në dosje të jetë njoftuar kandidati për mangësitë e konstatuara në dosjet respektive në mënyrë që nëse këto dokumentacione disponohen, të dorëzohen pranë ZVAP Tiranë brenda 3 ditëve, sikundër përcakton pika C.11 e udhëzimit nr. 2

- Nga auditimi konstatohet se kandidatët janë intervistuar në të njëjtën ditë që është kryer edhe vlerësimi i dosjeve, si dhe është bërë shpallja e kandidatëve fitues, pra komisioni **nuk** ka respektuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr.2, pika C.10: "*b) njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune;c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni; d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit." Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10; f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.*

-Nga auditimi konstatohet se përllogaritjet në pikë të vlerësimit të dosjeve nga komisioni janë të korrigjuara dhe të pasakta.

-Sipas relacionit të përgatitur pas shqyrtimit të dokumentacionit të komisionit, ZVAP Tiranë, ka konkluduar se "*Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se komisioni nuk ka zbatuar pika 10/b e shkronjës C të kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik". Komisioni është në tejkalim të çdo afati procedurial të përcaktuar nga Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik".*" Ky relacion është përgatitur nga ZVAP në datën 27.08.2020, duke cituar si shkelje të komisionit mos respektim të pikës 10/b të shkronjës C të kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik", në një kohë ku relacioni i mbajtur nga juristja për procedurat e ndjekura për shkollën Qemal Stafa, nr. 8071/1, prot datë 02.09.2020, për të cilin komisioni ka qenë gjithashtu në mos respektim të afateve sipas udhëzimit nr.2, dhe relacioni është përgatitur **në një kohë mëvonshme** ai i shkollës Cajupi, znj. H. nuk ka analizuar **me të njëjtin standard** kërkesat e udhëzimit. Gjithashtu, Pika D.1 përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*". Për këtë praktikë, ZVAP Tiranë **nuk** rezulton t'i kthyer dokumentacionet komisionit.

- Në vijim të shkresës së ZVAP, **nuk** disponohet asnjë dokumentacion nga ZVAP Tiranë për vijueshmërinë e procesit; komunikim me DRAP Tiranë për shpalljen e pavlefshme të vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit; apo pezullim të procesit për drejtorin e shkollës Andon Zako Cajupi. Nga përgjigjet e pyetësorit të DRAP Durrës, me shkresën nr. 1745/1, datë 03.11.2020 procedurat për këtë shkollë janë anuluar si rezultat i **mungesës së kandidatëve.**

-Nga auditimi konstatohet se ZVAP Tiranë **nuk** ka respektuar afatet e përcaktuara në pikën D.2, të Kreut 1, ku përcaktohet se "*Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë*

*pikë në DRAP."*Nga komisioni vendimmarrja është konkluduar në 19.08.2020 dhe pasaktësitë e konstatuara nga ZVAP duhet të ishin identifikuar **brenda 2 ditëve pune**.
1.Komisioni i vlerësimit të dosjeve është përbërë nga:
F.Gj., mësuese- Kryetare
M.B., mësuese- Anëtare
A.D., kryetare e bordit- Anëtare
D.I., kryetar i këshillit të prindërve-Anëtar
M.C., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar
2. Personi i autorizuar nga ZVAP Tiranë për shqyrtimin e dokumentacionit të komisionit është znj. G.H..
3. Drejtor i ZVAP Tiranë, E.A.
4. ish Drejtor i DRAP Durrës, znj. V.L.

SHKOLLA KONGRESI I LUSHNJËS

a. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit:

Kreu I, pika C.1 e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 7574, datë 11.08.2020, ZVAP Tiranë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Kongresi i Lushnjës", brenda datës 17.08.2020. Me anë të shkresës nr. 10672/1, datë 17.08.2020, Njësia e Administrative nr. 3 ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, z. M.C., për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Sipas pikës C.3 të udhëzimit nr.2, me procesverbalin e mbajtur në Shkollën Kongresi i Lushnjës, nr.15, datë 14.08.2020, në këtë shkollë u zhvillua votimi i fshehtë për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të jenë pjesë e komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve për pozicionin e drejtorit, në komisionin që do të ngrihej në ZVAP Tiranë. Sipas këtij procesverbali, me shumicën e votave dy mësuesit që do të jenë pjesë e shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të kandidatëve Znj. M.F. (mësuesja me eksperiencën më të gjatë dhe ish drejtuese në shkollë) dhe znj. A.Q. (mësuese me eksperiencë të gjatë punë në këtë shkollë).

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Në mbështetje të pikës 6 dhe 7 të gërmës C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me shkresën nr. 7701, prot datë 18.08.2020 ZVAP Tiranë i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës-it, Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë njoftimin se, mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për shkollën Kongresi i Lushnjës, do të zhvillohej në ambientet e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë në datë 19.08.2020, ora 08.00. Në vijim të saj nuk disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhërit nr. 46, datë 18.08.2020, Drejtori i ZVAP Tiranë urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Kongresi i Lushnjës, si më poshtë:
Znj. M.F., mësuese- Kryetare
Znj. A.Q., mësuese- Anëtare
Znj. R.K., kryetare i këshillit të prindërve - Anëtare
Znj. B.K., përfaqësuese e bordit- Anëtar

Z. M.C., përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare

b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e ëmërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Sipas pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me procesverbalin e mbajtur më datë 19.08.2020, në ambientet e ZVAP Tiranë ndërmjet sekretares së ZVAT dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatën/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT, për pozicionin e drejtorit të shkollës Kongresi i Lushnjës. Komisioni mori në dorëzim 5 dosje. Ky procesverbal është firmosur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe sekretaria e ZVAT (e cila, sipas procesverbalit i dorëzoi dosjet komisionit) Znj. E.P.. Ky procesverbal është u paprotokolluar. Referuar të dhënave të përcjella nga Sektori i Shërbimit në ZVAT, **Znj.E.P. ka nisur punë në ZVAT më datë 24.08.2020, pavarësisht emërimit të saj në 19.08.2020, pra 5 ditë më vonë se data në të cilën është firmosur procesverbali.**

Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës Kongresi i Lushnjës, Komisioni është shprehur:

1. Hapet dosja e kandidates A.Z.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
2. Hapet dosja e A.B.. Skualifikohet dosja pasi nuk i ka dokumentet e noterizuar.
3. Hapet dosja e Sh.D. (Pritje).
4. Hapet dosja e R.C.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
5. Hapet dosja e B.K.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.

Procesverbali është firmosur nga 5 anëtarët e komisionit, por është i paprotokolluar.

Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me pikën 10.b të udhëzimit nr. 2, ku përcakton se "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*" dhe pikën 10.c ku përcaktohet se "*pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni*", Komisioni **nuk** ka njoftuar kandidatin z. A.B. për mungesat e konstatuar, por e ka skualifikuar, dhe ka kryer intervistimin e kandidatëve të kualifikuar, **në të njëjtën ditë** kur është kryer edhe vlerësimi i dosjeve.

Intervistimi i kandidatëve

Pas vlerësimit të dosjeve, po në të njëjtën ditë, në datën 19.08.2020, Komisioni ka zhvilluar intervistat për 5 kandidatët. Në dosje nuk disponohet dokumentacioni sipas së cilit anëtarët e komisionit njoftohen për intervistën. Vërehet se, edhe ky procesverbal është i firmosur nga komisioni por i paprotokolluar.

Pyetjet e intervistës së kandidatëve janë përcaktuar dhe firmosur nga komisioni si më poshtë:

1. Njohja e shkollës.
2. Vizioni për shkollën.
3. Plani afatmesëm
4. Plani vjetor.
5. Korniza Kurrikulare.

Për vlerësimin me pikë të kandidatëve në përfundim të intervistës, anëtarët e komisionit kanë votuar në mënyrë të pavarur për çdo pyetje.

Vlerësimi final i komisionit

Në vijim komisioni ka plotësuar Shtojcën 6 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë)

sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
B.K.	12.8	2.2	15
A.Z.	18.6	9.4[31]	28
Sh.D.	13.9	3.6	17.5
R.C.	15	2.4[32]	17.4

Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 25.08.2020 (pra 6 ditë pas vlerësimit final të kandidatëve nga komisioni), të pa protokolluar në ZVAP Tiranë, kryetari i komisionit të vlerësimit i dorëzoi titullarit të ZVAP Tiranë Znj. E.A. dy dosjet e kandidatëvë me më shumë pikë, atë të znj. A.Z. dhe znj. Sh.D.. Në dosje **nuk** disponohen ankesa të kandidatëve për këtë proces, në vijim të pikës C.11 të udhëzimit nr.2.

Në përputhje me pikës D.1 të udhëzimit nr.2, juristja e ZVAP Tiranë, znj. G.H. ka përcjellë pranë Drejtorit të ZVAP Tiranë një relacion lidhur me procesin e vendimmarrjes së ndjekur nga komisioni për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Kongresi i Lushnjës, protokolluar në ZVAP Tiranë sipas shkresës nr. 7916/1, datë 27.08.2020. Në këtë relacion është përshkruar i gjithë procesi, nga shpallja deri në vendimmarrjen finale me 2 kandidatët me më shumë pikë. Znj. H, është shprehur se: "*Pasi u bë shqyrtimi i dosjeve të kandidatëve me më shumë pikë rezultoi se:*

-znj. A.Z., dosja ishte pa pullë postare; Libreza e punës rezulton e mbyllur në datën 31.08.20216[33]; Mungon shkolla e drejtorëve

-znj. Sh.D., certifikatat ishin të panoterizuara; Mungon shkolla e drejtorëve; Mungon vërtetimi që nuk ka masë disiplinore.

Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se komisioni nuk ka zbatuar pika 10/b e shkronjës C të kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik". Komisioni është në tejkalim të çdo afati procedurial të përcaktuar nga Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik"."

Në vijim të kësaj shkresë, **nuk** disponohet asnjë dokumentacion nga ZVAP Tiranë për vijueshmërinë e procesit; komunikim me DRAP Tiranë për shpalljen e pavlefshme të vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit; apo pezullim të procesit për drejtorin e shkollës Kongresi i Lushnjës. Nga përgjigjet e pyetësorit të DRAP Durrës, me shkresën nr. 1745/1, datë 03.11.2020 procedurat për këtë shkollë janë anuluar si rezultat i **mungesës së kandidatëve.**

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Kongresi i Lushnjës është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Durrës. Dosja nuk përmban dokumentin e njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës. Procesverbalet e komisionit dhe ai i dorëzimit të dosjeve me më shumë pikë në ZVAP janë të pa protokolluara.

-Nga verifikimi i dokumentacioneve të kandidatëve konstatohet se për kandidaten A.B., komisioni është shprehur se kandidati skualifikohet pasi dokumentacionet në dosje janë të pa noterizuara, por nuk dokumentohet në dosje të jetë njoftuar kandidati për mangësitë e konstatuara në dosjet respektive në mënyrë që nëse këto dokumentacione disponohen, të dorëzohen pranë ZVAP Tiranë brenda 3 ditëve, sikundër përcakton pika C.11 e udhëzimit nr. 2.

- Nga auditimi konstatohet se për kandidaten Sh.D. komisioni nuk është shprehur në procesverbal për kualifikim apo skualifikim të kandidates, por ka shënuar komentin (pritje), duke vendosur në vijim edhe një paragraf bosh në procesverbal.

[31] Piket jane te korrigjuara
[32] Piket jane te korrigjuara
[33] !?

-Nga auditimi konstatohet se kandidatët janë intervistuar në të njëjtën ditë që është kryer edhe vlerësimi i dosjeve, pra komisioni pra komisioni nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr.2, pika C.10: "*b) njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune;c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni; d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit." Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10; f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.*
-Nga auditimi konstatohet se përllogaritjet në pikë të vlerësimit të dosjeve nga komisioni janë të korrigjuara.
- ZVAP Tiranë pas shqyrtimit të dokumentacionit është shprehur se ti "*Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se komisioni nuk ka zbatuar pika 10/b e shkronjës C të kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik". Komisioni është në tejkalim të çdo afati procedurial të përcaktuar nga Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik".".* Ky relacion është përgatitur nga ZVAP në datën 27.08.2020, ka cituar si shkelje të komisionit mos respektim të pikës 10/b të shkronjës C të kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 " Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik", në një kohë ku relacioni i mbajtur nga juristja për procedurat e ndjekura për shkollën Qemal Stafa, nr. 8071/1, prot datë 02.09.2020, është përgatitur në një kohë **mëvonshm**e se ai i shkollës Cajupi, dhe nuk ka analizuar **me të njëjtin standard** kërkesat e udhëzimit. Gjithashtu, Pika D.1 përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknik*e". Për këtë praktikë, ZVAP Tiranë **nuk** rezulton t'i ketë kthyer dokumentacionet komisionit.
- Në vijim të kësaj shkresë, nuk disponohet asnjë dokumentacion nga ZVAP Tiranë për vijueshmërinë e procesit; komunikim me DRAP Tiranë për shpalljen e pavlefshme të vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit; apo pezullim të procesit për drejtorin e shkollës Kongresi i Lushnjës. Nga përgjigjet e pyetësorit të DRAP Durrës, me shkresën nr. 1745/1, datë 03.11.2020 procedurat për këtë shkollë janë anulluar si rezultat i mungesës së kandidatëve.
1.Komisioni i vlerësimit të dosjeve është përbërë nga:
•Znj. M.F., mësuese- Kryetare
•Znj. A.Q., mësuese- Anëtare
•Znj. R.K., kryetare i këshillit të prindërve - Anëtare
•Znj. B.K., përfaqësuese e bordit- Anëtar
•Z. M.C., përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare
2. Personi i autorizuar nga ZVAP Tiranë për shqyrtimin e dokumentacionit të komisionit është znj. G.H..

5. GJIMNAZI " QEMAL STAFA"
a. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit:
Kreu I, pika C.1 e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;

c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 7573, datë 11.08.2020, ZVAP Tiranë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Qemal Stafa", brenda datës 17.08.2020. Me anë të shkresës nr. 1492/1, datë 17.08.2020, Njësia e Administrative nr. 10 ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, znj. I.D., për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Me anë të vendimit nr. 24, datë 20.08.2020, protokolluar në Gjimnazin Qemal Stafa sipas shkresës nr. 1602, prot datë 20.08.2020 është njoftuar se pas votimit online, 2 mësuesit të caktuar për pjesëmarrje në Komision, do të ishin znj. Xh.D., mësuesja më e vjetër në shkollë dhe z. B.B.. Përfaqësues nga prindërit janë përcaktuar të jenë z. A.H., Kryetar i Bordit të Shkollës dhe z. L.C., Kryetar i Këshillit të Prindërve të Shkollës.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me anë të shkresës nr. 7837, prot.. datë 25.08.2020 ZVAP Tiranë i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës, Federatës së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë ka njoftimin se mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për Gjimnazin " Qemal Stafa" do të zhvillohej në ambientet e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë <u>në datë **25.08.2020**</u>, ora 12:00, <u>në kundërshtim me pikën C. 8 të shpalljes nr. 1 e cila përcakton se Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP ose të ZVAP, jo më vonë se 3 ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për drejtor të IPAP (Pra për lidhjen 1, ku afat është data **20.08.2020**) dhe kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët.</u> Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Tiranë i ka kërkuar institucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj nuk disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 54, datë 25.08.2020, protokolluar në ZVAP Tiranë, sipas shkresës nr. 7845, prot datë 25.08.2020, Drejtori i ZVAP Tiranë urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Qemal Stafa, si më poshtë:

Xh.D., mësuese- Kryetare

B.B., mësuese- Anëtare

A.H., kryetar i bordit- Anëtar

A.A., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtar

I.D., përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare

<u>b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni</u>

Për këtë procedurë, në dosje **<u>nuk</u>** <u>disponohet një procesverbal ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit,</u> mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatën/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP, për pozicionin e drejtorit shkollës Qemal Stafa, në mënyrë që të identifikohen <u>dosjet që komisioni ka marë në dorëzim.</u>

Më datë 25.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Vlerësimi i dosjeve

Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 25.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Qemal Stafa", Komisioni është shprehur:
1. Hapet dosja e kandidatit G.M.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
2. Hapet dosja e kandidates T.D.. Skualifikohet sepse (ka masë) nuk ka sjellë masën disiplinore nga DRAP Durrës.
3. Hapet dosja e kandidates Sh.E.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
4. Hapet dosja e kandidates M.C.. Skualifikohet për arsye se nuk ka shkollën e drejtorëve dhe mungon vërtetimi për masën disiplinore nga DRAP Durrës.
5. Hapet dosja e kandidates K.J.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
6. Hapet dosja e kandidates L.P.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
7. Hapet dosja e kandidates N.K.. Skualifikohet sepse nuk ka shkollën e drejtorëve.
8. Hapet dosja e kandidates P.M.. Skualifikohet sepse nuk ka shkollën e drejtorëve.
9. hapet dosja e kandidates E.M.. Kualifikohet për intervistën e strukturuar.
Procesverbali është firmosur nga 5 anëtarët e komisionit, por është i paprotokolluar. Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me pikën 10.b të udhëzimit nr. 2, ku përcakton se "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*" dhe pikën 10.c ku përcaktohet se "*pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni*", Komisioni **nuk** ka njoftuar kandidatet znj. T.D., M.C., N.K., P.M. për mungesat e konstatuar, por i ka skualifikuar kandidatet, dhe ka kryer intervistimin e kandidatëve të kualifikuar, një ditë më vonë pas vlerësimit të dosjeve.

Intervistimi i kandidatëve

Pas vlerësimit të dosjeve, një ditë më vonë, në datën 26.08.2020, Komisioni ka zhvilluar intervistat për 5 kandidatët. Në dosje nuk disponohen dokumentacione për njoftimin e kandidatëve për datën e intervistës. Vërehet se, edhe ky procesverbal është i firmosur nga komisioni por i paprotokolluar. Në procesverbal nuk janë përcaktuar pyetjet e intervistës së strukturuar, por vetëm pikët e kandidatëve.

Vlerësimi final i komisionit

Në vijim komisioni ka plotësuar Shtojcën 6 të udhëzimit duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve në total, e cila është publikuar në ambientet e ZVAP Tiranë (dokumentuar me foto), pa identifikuar në të datën e shpalljes. Komisioni **nuk** ka respektuar Pikën 3 të shpalljes nr. 1 përcakton se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen **në datën 21 dhe 24 Gusht 2020.** Aplikantët Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
L.P.	21.2[34]	1.6	22.8
Sh.E.	14[35]	10[36]	24
K.J.	20.88[37]	8.4	29.28
G.M.	14.3[38]	2.2	16.5
E.M.	16.2	6.8	24

c. Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 26.08.2020, kryetari i komisionit të vlerësimit i dorëzoi titullarit të ZVAP Tiranë Znj. E.A. dy dosjet e kandidatëvë me më shumë pikë, atë të znj. K.J. dhe

[34] Piket jane te korrigjuara
[35] Piket jane te korrigjuara
[36] Piket jane te korrigjuara
[37] Piket jane te korrigjuara
[38] Piket jane te korrigjuara

znj. Sh.E.. Në dosje nuk disponohen ankesa të kandidatëve për këtë proces, në vijim të pikës C.11 të udhëzimit nr.2.
Znj. Sh.E. dhe znj. E.M. janë vlerësuar me të njëjtat pikë, por referuar pikës.F.2 të udhëzimit nr.2, kandidati që ka patur më shumë pikë (pra znj. Sh.E. e cila është vlerësuar me pikët maksimale: 10) kalon në fazën e intervistës.
Me shkresën nr. 8071/1, prot datë 02.09.2020 juristja e ZVAP Tiranë, znj. G.H., ka përcjellë pranë Drejtores së ZVAP Tiranë një relacion informues mbi procesin e vendimmarrjes të ndjekur nga komisioni i vlerësimit të dosjeve për shkollën Qemal Stafa, në vijim të pikës D.1 të udhëzimit nr.2. Ky relacion ka përshkruar procesin e ndjekur, duke filluar nga shpallja e vendit vakant,deri në vendimmarjen për vlerësimin e dy dosjeve me më shumë pikë nga komisioni. Në relacion nuk janë konstatuar parregullsi në proces.
Me shkresën nr. 8071, prot datë 02.09.2020, 7 ditë më vonë se data e procesverbalit të dorëzimit të dosjeve nga komisioni, në kundërshtim me kreu I, pika D. 2. "*Drejtori i ZVAP, **brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë** nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.*", Drejtori i ZVAP Tiranë, znj. E.A. ka përcjellë pranë DRAP Durrës konstatimet e bëra, dosjet e kandidatëve me më shumë pikë dhe kopje të dokumentacionit të mbajtur nga komisioni i vlerësimit të dosjeve i mbledhur me Urdhrin nr. 54, datë 25.08.2020 për gjimnazin Qemal Stafa.
Në 15.09.2020 është bërë **emërimi në** detyrë i znj. K.J., nga DRAP Durrës, pas intervistimit të kandidatëve me më shumë pikë.
Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

-Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Qemal Stafa është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar. Dosja përmban mangësi në dokumentacion, të tilla si dokumenti i njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, pyetjet e intervistës së strukturuar, dorëzimi i dosjeve nga ZVAP për Komisionin. Procesverbalet e komisionit janë të pa protokolluara.
-Nga auditimi konstatohet se komisioni i vlerësimit të dosjeve, është mbledhur në datë 25.08.2020, pra 8 ditë pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit datës 17.08.2020, në kundërshtim të udhëzimit Kreu I, C. 8. *"Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP ose të ZVAP, **jo më vonë se tri ditë pune** pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për drejtor të IPAP dhe kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij."*
-Nga verifikimi i dokumentacioneve të kandidatëve konstatohet se për kandidaten M.C. komisioni është shprehur se mungon vërtetimi për masën disiplinore. Për këtë rast, dhe për mungesën e dokumentacionit të shkollës së drejtorëve për kandidatët N.K. dhe P.M., por nuk dokumentohet në dosje të jetë njoftuar kandidati për mangësitë e konstatuara në dosjet respektive në mënyrë që nëse këto dokumentacione disponohen, të dorëzohen pranë ZVAP Tiranë brenda 3 ditëve, sikundër përcakton pika C.11 e udhëzimit nr. 2
-Kandidatja znj. T.D., është skualifikuar nga komisioni pasi nuk disponon vërtetimin nga DRAP Durrës për masën disiplinore, por nuk dokumentohet në dosje të jetë njoftuar kandidati për mangësitë e konstatuara në dosjet respektive në mënyrë që nëse këto dokumentacione disponohen, të dorëzohen pranë ZVAP Tiranë brenda 3 ditëve, sikundër përcakton pika C.11 e udhëzimit nr. 2. Nga verifikimi i dosjes së kandidates, rezulton se ajo ka dorëzuar **vërtetimin lëshuar nga ZVAP Tiranë në Gusht 2020, në të cilin deklarohet se ajo nuk ka masë disiplinore**. Znj. K.J. ka dorëzuar **po të njëjtin dokument pranë komisionit**, vërtetimin për mos pasje të masës disiplinore, sipas shkresës nr. 1735, prot në ZVAP Tiranë datë 03.03.2020.
- Nga auditimi konstatohet se Komisioni nuk ka respektuar Pikën 3 të shpalljes nr. 1 përcakton se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datën **21 dhe 24 Gusht 2020**, pasi data e shpalljes së fituesve dhe intervistimit të kandidatëve nga komisioni është 26 Gusht 2020.

- Nga auditimi konstatohet se kandidatët janë intervistuar një ditë pasi është kryer edhe vlerësimi i dosjeve, ditë në të cilën është bërë shpallja e kandidatëve fitues, pra komisioni **nuk ka respektua**r afatet e përcaktuara në udhëzimin nr.2, pika C.10: "b*) njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune;c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni; d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit." Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10; f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.*"

-Nga vlerësimi i kanditatëve rezulton se kandidatja me pikët maksimale nga vlerësimi i dosjeve (znj. L.P. me 21.2 pikë) është vlerësuar me **pikët më të ulëta** nga komisioni gjatë intervistës (1.6 pikë). Gjithashtu, kandidatja me pikët më të ulëta nga vlerësimi i dosjeve (znj. Sh.E.), është vlerësuar me **pikët më të larta** nga komisioni gjatë intervistës (10 pikë).

-Nga auditimi konstatohet se përllogaritjet në pikë të vlerësimit të dosjeve nga komisioni janë të korrigjuara.

- Nga auditimi konstatohet se dy kandidatet e vlerësuar nga komisioni me pikët maksimale, **nuk disponojnë certikatën për përfundimin e trajnimit të detyrueshëm për ndjekjen e shkollës së drejtorave**, në kundërshtim me kriteret e përcaktuar në udhëzimin nr.2, por janë pranuar në shkollë dhe janë duke e ndjekur atë. Kreu I, pika B.1. d, e cila citon se *"Kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e dorëzimit të tij : 1. Kandidati për drejtor i IPAP duhet të plotësojë kushtet si vijon: d) të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar **dhe** të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.".* Kandidatët e tjerë të intervistuar nga komisioni dhe të vlerësuar me pikë më të ulëta, kanë qenë të pajisur me këtë certifikatë, pas përfundimit të trajnimit respektiv.

-Me shkresën nr. 8071, prot datë 02.09.2020, 7 ditë më vonë se procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit nga komisioni, në kundërshtim me kreu I, pika D. 2. "*Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP*.", Drejtori i ZVAP Tiranë, znj. E.A. ka përcjellë pranë DRAP Durrës konstatimet e bëra, dosjet e kandidatëve me më shumë pikë dhe kopje të dokumentacionit të mbajtur nga komisioni i vlerësimit të dosjeve.

-Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë **të pa identifikuara** nga ZVAP Tiranë, përpara përcjelljes së dosjes në DRAP Durrës për intervistimin e kandidatëve pasi në relacionin e përgatitur nga ZVAP, sipas shkresës nr. 8071/1, prot datë 02.09.2020 juristja e ZVAP Tiranë, znj. G.H., ka përcaktuar se nuk janë konstatuar parregullsi në proces. Gjithashtu, mos respektimi i afateve të Përcaktuar në shpalljen 1, dhe udhëzimin nr.2, **rezultojnë të pa identifikuara nga DRAP Durrës** përpara intervistimit të kandidatëve dhe emërimin në detyrë të drejtuesit të shkollës Qemal Stafa.

1.Komisioni i vlerësimit të dosjeve është përbërë nga:
Xh.D., mësuese- Kryetare
B.B., mësuese- Anëtare
A.H., kryetar i bordit- Anëtar
A.A., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtar
I.D., përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare

2. Personi i autorizuar nga ZVAP Tiranë për shqyrtimin e dokumentacionit të komisionit është znj. G.H..

3. znj. E.A., Drejtor i ZVAP Tiranë.
4. znj. V.L., ish Drejtor i DRAP Durrës.

Nëpërmjet Shpalljes nr. 2, nr.1066/1, prot datë 19.08.2020, "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar ku për **ZVAP Tiranë**, është bërë shpallja për **12 institucionet arsimore** si më poshtë:

Arbanë
Jordan Misja
Mustafa Qemal Ataturku
Niket Dardani
Skënder Caci
Dëshmorët e Lirisë
Sadik Savaleci
Mustafa Greblleshi
Ali Demi
Hasan Prishtina
1 Maji
Marie Logoreci

Cështja B e pikës 2 të shpalljes nr.1 përcakton se dokumentacioni i aplikimit i përcaktuar në pikën 2, të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-et përkatëse **jo më vonë se data 31.08.2020.**

Pika 3 e shpalljes nr. 2 përcakton **se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data 07.09.2020.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

Në përfundim të procedurave të konkurimit për institucionet arsimore të shpalljes nr.2, procesi ka konkluduar **vetëm për 3** prej tyre me emërimin e drejtuesit, për shkollat **Niket Dardani, 1 Maji dhe Dëshmorët e Lirisë.**

Nga verifikimi i dosjes së vendosur në dispozicion nga ZVAP Tiranë rezulton se **asnjëri** prej kandidatëve nuk është i pajisur me shkollën e drejtorave pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, sikundër përcakton pika B.9 e kreut I të udhëzimit nr.2, por disa prej tyre vetëm janë pranuar për kryerjen e trajnimit nga Shkolla e Drejtorave.

Nga auditimi konstatohet se pas shpalljes nr.2, me shkollat e trajtuara më sipër për ZVAP Tiranë, procedurat e emërimit **nuk kanë vijuar** për shkollën **Jordan Misja dhe Ali Demi**. Ish- drejtori i DRAP Durrës në observacionet e dërguara lidhur me projekt raportin e auditimi, ka përcjellë kërkesën e ZVAP Tiranë drejtuar DRAP Durrës për anulimin e procedurava të konkurrimit për këto dy shkolla.

Sipas ZVAP Tiranë, për shkollat **Mihal Duri, Mustafa Qemal Ataturk dhe Sadik Stavileci** procesi i emërimit është **anulluar** nga DRAP Durrës. Shkresa përkatëse nuk disponohej nga ZVAP Tiranë. Gjithashtu, nga DRAP Durrës **nuk** na u vendos në dispozicion kjo shkresë.

Për shkollat **Skënder Cac**i dhe **Hasan Prishtina** procedurat nuk kanë vijuar për ngritjen e komisioneve, pasi ka patur **vetëm 1 aplikant** për secilën shkollë.

Për shkollën **Marie Logoreci**, ka patur **vetëm 1 kandidat që plotësonte kushtet** sipas ZVAP Tiranë, dhe për këtë arsye procesi është **anulluar**. Për këtë procedurë ka patur 3 aplikantë, por vetëm njëri prej tyre ka përfunduar programin e trajnimit të drejtorëve zhvilluar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, dhe 2 të tjerët nuk kanë patur shkollën e drejtorave.

Për shkollën **Mustafa Grebllleshi** procesi është anulluar pasi nga 2 kandidatët që kaluan fazën paraprake, njëri prej tyre u tërhoq.

Shpallja nr. 3

Sipas Shpalljes nr.3, sipas shkresës nr. 1632, prot datë 07.10.2020, nga DRAP Durrës është bërë shpallja e vendit të lirë, duke përfshirë vetëm institucionet nën juridiksionin e ZVAP Tiranë, si më poshtë:

1. Andon Zako Cajupi
2. Fan Noli
3. Kongresi i Lushnjës
4. Mustafa Grebllleshi
5. Jeronim De Rada
6. Mihal Grameno
7. Sadik Stavileci

Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me pikën F, kreu I "*Në rastet kur nuk paraqiten aplikantë ose ka vetëm një aplikant, detyrën e drejtorit të IPAP e kryen përkohësisht drejtori zëvendësues, sipas shkronjës E të kreut I të këtij udhëzimi. Vendi për drejtor rishpallet sipas procedurës së mësipërme.* ", në shpalljen nr.3 nuk janë përfshirë të gjitha shkollat në të cilat procesi i përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve arsimore nuk është finalizuar pas shpalljes 1 dhe 2.

VENDIMET GJYQËSORE

Vendime të ekzekutuara

ZVAP Tiranë për vitin **2019** ka ekzekutuar 3 vendime gjyqësore me vlerë totale **2,703,869** lekë. Pagesat janë kryer në vijim të vendimit të gjykatës nr. 3735, datë 23.10.2018 në vlerë 922,196 lekë (likuiduar sipas u.sh nr.42, datë 14.01.2019); nr. 344, datë 04.10.2018 në vlerë 575,355 lekë (likuiduar sipas u.sh nr.45, datë 18.02.2019); nr. 3818, datë 30.10.2018 në vlerë 1,206,318 lekë (likuiduar sipas u.sh nr.68, datë 05.03.2019),.

Për vitin **2020**, ZVAP Tiranë ka ekzekutuar 2 vendime gjyqësore me vlerë **2,312,144**lekë. Pagesat janë kryer në vijim të vendimit të gjykatës nr. 2868, datë 24.10.2019 në vlerë 621,840 (likuiduar sipas u.sh nr.251, datë 12.08.2020); dhe nr. 2608, datë 3.10.2019 në vlerë 1,690,304 lekë (likuiduar sipas u.sh nr.319, datë 07.10.2020, ku identifikohet se 181,104 lekë janë tarifa përmbarimore dhe 1,509,200 lekë vendimi i gjykatës).

Vendime të pa ekzekutuara

ZVAP Tiranë ka 1 vendim të pa ekzekutuar, në vlerë **901,940 lekë** sipas vendimit të gjykatës nr. 3205, datë 16.12.2019.

Çështje gjyqësore në proces me objekt kthimin në punë

ZVAP Tiranë ka **10 çështje gjyqësore në proces** me objekt kthimin në punë, trajtuar më hollësisht sipas Ankesit më poshtë. ZVAP Tiranë ka **10 çështje gjyqësore në proces** me objekt kthimin në punë, trajtuar më hollësisht sipas Ankesit më poshtë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:
- znj. V.L., ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës,
-znj. E.A., Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë,
-znj. G.H., Specialise e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë,
-Anëtarët e komisionit të vlerësimit të procedurave për përzgjedhjen e drejtuesit në shkollën Sami Frashëri, Andon Zako Cajupi, Kongresi i Lushnjës, Qemal Stafa, Insituti i Nxënësve që nuk shikojnë.

ZVAP KAVAJË

Nga auditimi konstatohet se për shkollat që ZVAP Kavajë ka në juridiksion, **nga 25 prej tyre, 13 drejtorë (ose 52%)** janë të komanduar me vendime që datojnë që në periudha të mëparshme. Për këto, edhe pse ZVAP Kavajë ka informuar DPAP në vijim të shkresës së dërguar prej saj, për to nuk janë hapur procedura rekrutimi. Më hollësisht, lista e shkollave dhe datat e komandimit të drejtorëve paraqiten si më poshtë[39]:

Nr	EMER	MBIEMER	SHKOLLA	DATA E KOMANDIMIT		
				DITA	MUAJI	VITI
1	F.	Xh.	**9-vjecare "3 Deshmoret"**	5	12	2016
2	F.	H.	**9-vjecare Golem**	27	3	2014
3	A.	Gj.	9-vjecare Cete	16	10	2017
4	R.	D.	**9-vjecare Hajdaraj**	15	12	2016
5	S.	D.	9-vjecare Bago	17	9	2019
6	E.	A.	9-vjecare Rrakull	17	3	2014
7	Z.	E.	9-vjecare Qerret	15	12	2016
8	S.	D.	**9-vjecare Shtodher**	18	1	2016
9	L.	K.	**9-vjecare Helmas**	15	12	2016
10	H.	H.	9-vjecare Memzotaj	12	3	2014
11	I.	X.	**9-vjecare Luzi Vogel**	13	5	2019
12	Z.	M.	9-vjecare Vorrozen	29	1	2015
13	T.	M.	**9-vjecare Karpen**	9	10	2019

Si rezultat, ekzistojnë **6 shkolla** nën juridiksionin e ZVAP Kavajë në të cilat drejtuesi vijon të jetë i komanduar, me vendime që datojnë që në vitin 2014, dhe **nuk** rezultojnë të jenë bërë shpalljet për emërimin e drejtuesve të shkollave respektive.

Për sa i përket shpalljeve të bëra nga DRAP Durrës për vitin 2020, nga ZVAP Kavajë procesi ka **konkluduar me emërim vetëm për 1 shkollë,** përkatësisht shkolla Aleksandër Mojsiu. Për **2 raste**, shkolla Karpen dhe Helmes shpallja e fituesit është **pezulluar nga DRAP Durrës**, deri sa kandidatët fitues do të shpallen pas konfirmimit të shkollës së drejtorëve si kandidatë fitues. Për **4 raste** procedura është **anulluar nga komisioni i ngritur nga ZVAP** për shqyrtimin e vendimmarrjes së komisionit. Për 1 rast të shpalljes nr.2, është bërë përcjellja në DRAP Durrës e 2 dosjeve më të mira, por ende nuk ka informacion nga DRAP, në tejkalim të afateve.

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 1,** nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vorë, Klos, Mat,Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Krujë, dhe Tiranë. Kjo shpallje është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZVAP Kavajë si dhe në ambientet e kësaj zyre vendore. Nëpërmjet kësaj shpallje, për **ZVAP Kavajë** janë shpallur **5 pozicione të lira** për drejtor të shkollave si më poshtë:

Aleksandër Moisiu,
3-Dëshmorët,
Helmes,
Golem,
Karpën.

[39] Shkollat me bold janë shkollat në të cilat është bërë shpallja për drejtor

ZVAP Kavajë, nëpërmjet e-mailit të datës 18.08.2020, ora 12:38, drejtuar drejtuesve te 5 shkollave për të cilët do kryhej procedura e përzgjedhjes së drejtorëve, referuar Shpalljes nr. 1, ka informuar se procedurat do të zhvillohet në afatet e mëposhtme:

Nr.	Institucioni	Data e konkurrimit	Ora e konkursit
1	Aleksandër Moisiu	19.08.2020	09.00
2	3- Dëshmorët	19.08.2020	10.00
3	Golem	19.08.2020	11.00
4	Karpën	19.08.2020	12.00
5	Helmes	19.08.2020	13.00

Sipas këtij e-maili, vlerësimi i dosjeve dhe intervista me gojë do të kryhen sipas datës dhe orarit të mësipërm, në ambientet e shkollës "Fiqiri Kurti". Vërehet se, vlerësimi i dosjeve dhe intervista me gojë është planifikuar të zhvillohet në të njëjtën ditë, **në kundërshtim** me Udhëzimin nr. 1 dhe Shpalljen nr.1 (trajtuar me gjerësisht në vijim) sipas të cilës, Komisioni fillimisht duhej të vlerësonte dosjet dhe për ato me mungesë në dokumentacion të lihej 3 ditë afat për plotësimin e tij, dhe më pas të zhvillohej intervista me gojë.

Grupi i auditimit shqyrtoi **5 dosjet** e vendosura në dispozicion nga ZVAP Kavajë mbi procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore nën juridiksionin e kësaj zyre arsimore, për **Shpalljen nr.1**, ku në të 5 dosjet u konstatuan parregullësi, trajtuar si më poshtë:

Shkolla GOLEM

a.Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : ***"****Komisioni përbëhet nga:*

a) kryetari i bordit të IPAP;

b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;

c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;

d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Në dosjen e shqyrtuar nga grupi i auditimit, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga ZVAP Kavajë për të njoftuar zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Golemi, drejtuar njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe për të kërkuar caktimin e një përfaqësuesi nga kjo njësi.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Referuar procesverbalit të mbajtur në shkollën 9-vjecare "Golem", më datë 17.08.2020, ora 09.00, në këtë shkollë është mbledhur Këshilli i Mësuesve për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin të pranishëm në Komisionin për Konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Golem". Sipas procesverbalit, në votim kanë marr pjesë 31 nga 35 mësues.

Në këtë procesverbal përcaktohen dy mësuesit e mëposhtëm, të cilët u zgjodhën me votim të fshehet për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:

Znj. E.Z.

Znj. A.M.

Bashkëlidhur me këtë procesverbal është lista e firmosur nga mësuesit të cilët kanë marr pjesë në votim, por nuk janë dërguar fletët e votimit. Procesverbali është i paprotokolluar.

Me anë të shkresës nr. 142. Prot, datë 17.08.2020 me lëndë "Kërkesë për miratimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve në konkursin për drejtues shkolle në 9-vjecare Golemi", Shkolla 9-vjecare Golemi i kërkon ZVAP Kavajë miratimin e Komisionit të vlerësimit si më poshtë:
A.H. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar)
S.Gj.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
V.V.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)
E.Z.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)
A.M.- Mësues (Anëtare)
Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore
Me anë të shkresës Nr. 581/1 prot. datë 18.08.2020 "Njoftim për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për drejtues", ZVAP Kavajë njofton DPAP, DRAP Durrës dhe përfaqësuesin e Sindikatës së Arsimit, se më datë 19.08.2020, duke filluar nga ora 09.00, në ambientet e shkollës 9 vjeçare "Fiqiri Kurti" zhvillohen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues të institucioneve arsimore "Aleksandër Moisiu", "3-Dëshmorët", "Helmes", "Golem", Karpën, si dhe për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtyre institucioneve për të monitoruar dhe vëzhguar zbatimin e dispozitave të udhëzimit të MASR gjatë këtij procesi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të dosjes, në përgjigje të shkresës Nr. 581/1 prot. datë 18.08.2020 të ZVAP Kavajë, **nuk** rezulton që DRAP Durrës apo DPAP të kenë përcaktuar përfaqësues të tyre, për të qenë pjesëmarrës gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të kandidatëve për drejtor të shkollës "Golem".
Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP
Me anë të Urdhrit nr.19, datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Golem", Drejtori i ZVA Kavajë, Znj. Xh.B., ka urdhëruar:
1. Miratimin e Komisionit të Vlerësimit në konkursin për drejtues shkolle në shkollë Golem, si më poshtë:
A.H.- Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (Anëtar)
S.Gj. – Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
V.A.- Kryetar i Këshillit të Prindërve
E.Z. – Mësuesi më i vjetër i institucionit (Kryetar Komisioni)
A.M. –Mësues (Anëtare)
Komisioni te shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor Golem, sipas shtojcës 5 të udhëzimi dhe shpalljen e pikëve për çdo aplikant sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.
Urdhri nr.19, datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Golem", i Drejtorit të ZVAP Kavajë është i paprotokolluar. Në dosjen e shkollës Golem, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku të ishte përcaktuar Z. A.H., si përfaqësues i kësaj njësi në komisionin për përzgjedhjen e drejtoret të shkollës Golem.

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve
Referuar procesverbalit nr. 581/1 prot., datë 19/08/2020 mbi dorëzimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor shkolle, i cili është mbajtur midis Znj. S.Gj. punonjëse në Sektorin e Shërbimeve të ZVAP Kavajë (dorëzuesi), dhe Znj. E.Z., Kryetare e Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP "Golem" (marrësi), nga verifikimi u konstatua se dosja përmban:
Urdhrin nr. 19, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për drejtues shkolle, të drejtorit të ZVAP Kavajë.
Shtojcën nr. 5 (dy kopje)

Shtojcën nr. 6(dy kopje)
Dosja e kandidatit F.H.
Dosja e kandidatit M.K.

Nga shqyrtimi i dosjes së shkollës "Golem" në ZVAP Kavajë, **nuk** rezulton të jetë mbajtur procesverbal nga Komisioni i Vlerësimi për procedurën e vlerësimit të dosjeve dhe realizimit të intervistës me aplikantët. Si rezultat i sa më sipër, nuk janë evidentuar dokumentet që mungojnë për secilin prej kandidatëve. Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatëve, rezulton se asnjëri prej dy kandidatëve nuk ishte i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, apo të ishte pranuar në të.

Intervistimi i kandidatëve

Në dosje **nuk** rezulton dokumentacion lidhur me procesin e intervistimit apo pyetjet e intervistës së strukturuar drejtuar kandidatëve

Vlerësimi final i Komisionit të Vlerësimit

Vlerësimi i kandidatëve në pikë rezulton të jetë kryer në të njëjtën datë me vlerësimin paraprak dhe intervistimin e tyre. Komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes	Pikët e intervistës nga K.V.	Pikët e fazës së parë
F.H.	25.8	10	35.8
M.K.	12.3	10	22.3

Në dosjen e shkollës "Golem", rezulton shtojca 6, në të cilën janë paraqitur rezultatet finale të kandidatëve, të firmosura nga:
Z.A.H.
Z.S.Gj.
Znj.F.D.
Znj.E.Z.
Znj.A.M.

Nga shqyrtimi i anëtarëve të Komisionit të cilët kanë firmosur shtojcën nr.6, krahasuar me anëtarët e Komisionit të miratuar me Urdhrit nr.19, datë 18.08.2020 të Drejtorit të ZVAP Kavajë rezulton se, Kryetari i Këshillit të Prindërve, Z. V.A. është **zëvendësuar** me Znj. F.D..

Referuar procesverbalit nr. 581/10 prot., datë 19/08/2020 mbi dorëzimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor shkolle, i cili është mbajtur midis Znj. S.Gj. punonjëse në sektorin e shërbimeve të ZVAP Kavajë (marrësi), dhe Znj. E.Z., Kryetare e Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP "Golem" (dorëzuesi), nga verifikimi u konstatua se dosja përmban:

Urdhrin nr 19, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për drejtues shkolle, të drejtorit të ZVAP Kavajë
Shtojcën nr. 5 (dy kopje)
Shtojcën nr. 6(dy kopje)
Dosjen e kandidatit F.H.
Dosjen e kandidatit M.K.

Finalizimi i procedurës-Anulimi i procedurës

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Me Urdhrin nr. 24, nr. 593. prot, datë 24.08.2020 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit për verifikim të procedurës së vlerësimit të dosjeve në konkursin për drejtor të shkollës "Golem", Drejtori i ZVAP Kavajë ka urdhëruar:

Miratimin e Komisionit të Vlerësimit pranë ZVAP Kavajë për verifikimin e procedurës së vlerësimit të dosjeve për shkollën "Golem" si më poshtë:
N.H. (Kryetare)
S.Gj. (Anëtar)
E.M. (Anëtar)
Komisioni të shqyrtojë dhe të vlerësoj procedurën e vlerësimit të dosjeve të aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor Golem, sipas shtojcës 5 të udhëzimit.
Referuar procesverbalit nr. 593/1, datë 24.08.2020, të mbajtur në ZVAP Kavajë nga komisioni i ngritur për verifikimin e procedurës së ndjekur për vlerësimin e kandidatëve për shkollën Golem është konstatuar:
Pas verifikimit të dosjes u konstatua se asnjëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të dosjeve të shkollës Golemi nuk ka plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit, referuar kreut I/C pika 5 "Në mbledhjen e parë të komisionit, anëtarët e komisionit duhet të plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi".
Referuar Urdhërit nr.19, datë 18.08.2019 " Për ngritjen e komisionit për konkursin për drejtues shkolla Golem,", ku Kryetari i Këshillit të Prindërve V.A. është zëvendësuar pa njoftuar, ku sipas kreut I/C pika 9 theksohet qartë "*Zëvendësimi kryhet brenda një dite pune nga titullari i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për anëtarin e zgjedhur prej tij;, bordi i iPAP, Këshilli i Prindërve të IPAP ose Këshilli i Mësuesve, për anëtarët e zgjedhur prej tyre.*"
Për sa më sipër Komisioni i shqyrtimit të procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit për shkollën Golem **vendosi anulimin** e procedurës së vlerësimit të dosjeve të konkursit për drejtues shkolla "Golem".
Ky procesverbal i është dërguar DRAP Durrës nga ZVAP Kavajë me anë të shkresës 593/2. Prot., datë 24.08.2020. Në vijim nuk evidentohen masa të ndërmarra lidhur me këtë procedurë.
Në mënyrë të përmbledhur parregullsitë në procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës Golem, janë si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Golem është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Kavajë. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion, dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës.
Procesverbali i mbajtur në shkollën Golem mbi përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin pjese e Komisionit të Vlerësimit është i pa protokolluar.
Në dosjen e shqyrtuar nga grupi i auditimit, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga ZVAP Kavajë për të njoftuar zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Golemi, drejtuar njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe për të kërkuar caktimin e një përfaqësuesi nga kjo njësi.
Në këtë dosje, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku të ishte përcaktuar Z. A.H., si përfaqësues i kësaj njësi në komisionin për përzgjedhjen e drejtoret të shkollës Golem. Vërehet se shkolla Golem i ka propozuar ZVAP Kavajës edhe përfaqësuesin e njësi vendore për të qenë pjesë e Komisioni të Vlerësimit, i cili është miratuar si anëtar i Komisionit me Urdhrin e Drejtorit të ZVAP.
Në vijim të Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, dhe shkresës nr. 581/1 prot. datë 18.08.2020 të ZVAP Kavajë, **nuk** rezulton që DRAP Durrës apo DPAP të kenë përcaktuar përfaqësues të tyre, për të qenë pjesëmarrës gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të kandidatëve për drejtor të shkollës "Golem".
Urdhri nr.19, datë 18.08.2020 i Drejtorit të ZVAP Kavajë "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Golem", është i **paprotokolluar**.

Në ZVAP Kavajë, për shkollën Golem **nuk** rezulton të jetë mbajtur procesverbal nga Komisioni i Vlerësimi për procedurën e vlerësimit të dosjeve dhe realizimit të intervistës me aplikantët.
Si rezultat i sa mësipër, nuk janë evidentuar dokumentet që mungojnë për secilin prej kandidatëve. Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatëve, rezulton se asnjëri prej dy kandidatëve nuk ishte i certifikuar nga Shkolla e Drejorëve, apo të ishte pranuar në të.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.*" Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar shqyrtimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve në të njëjtën ditë, 19.08.2020, pa i dhënë mundësinë kandidatëve për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve."
Nga shqyrtimi i anëtarëve të Komisionit të cilët kanë firmosur shtojcën nr.6, krahasuar me anëtarët e Komisionit të miratuar me Urdhrit nr.19, datë 18.08.2020 të Drejtorit të ZVAP Kavajë rezulton se, Kryetari i Këshillit të Prindërve, Z. V.A. është zëvendësuar me Znj. F.D..
Administrimi i kësaj procedure nga ZVAP Kavajë **nuk** ofron siguri. Grupi i auditimit **identifikoi** deklaratat e konfliktit të interesit të firmosura nga të pestë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të shkollës "Golemi", **(**këto deklarata ishin në dosjen e shkollës 3-Dëshmorët), mungesa e të cilave ishte një nga dy arsyet e **anulimit** të procedurës nga Komisioni i cili vlerësoi procedurën e ndjekur nga K.V.
Që në fillim procesi i vlerësimit të kandidatëve për shkollat nën juridiksion e ZVAP Kavajë sipas Shpalljes 1, **nuk** është planifikuar saktë, pasi referuar e-mailit të dërguar drejtuesve të shkollave nga ZVAP Kavajë vlerësimi i dosjeve dhe intervistimi ishte planifikuar në të njëjtën datë.
Në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Procedurës pranë ZVAP Kavajë, **nuk** evidentohet mungesa e proceverbaleve të cili duhet të ishin mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të dosjeve dhe intervistimit të kandidatëve, kryerja e procesit të vlerësimit të dosjeve dhe e intervistimit në të njëjtën ditë, dokumentacioni i paplotë i kandidatëve dhe njoftimi i tyre për plotësimin e dokumentacionit, mungesa e certifikatë së drejtorëve, etj.
Në vijim të problematikave të lidhura me këtë procedurë, **nuk** identifikohen të jenë ndërmarrë masa nga ZVAP Kavajë, apo DRAP Durrës.
Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:
Znj.E.Z. (Kryetare Komisioni)

Z.A.H. (Anëtar)
Z.S.Gj. (Anëtar)
Znj.F.D. (Anëtare)
Znj.A.M. (Anëtare
Komisioni i Vlerësimit të procedurës së ndjekur nga K.V kishte përbërjen si më poshtë:
Znj.N.H. (Kryetare)
Znj. S.Gj. (Anëtare)
Znj. E.M. (Anëtare)
Drejtori i ZVAP Kavajë, Znj. Xh.B.
Ish-Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Shkolla "KARPEN"

Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Në dosjen e shqyrtuar nga grupi i auditimit, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga ZVAP Kavajë për të njoftuar zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Karpën, drejtuar njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe për të kërkuar caktimin e një përfaqësuesi nga kjo njësi.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Referuar procesverbalit të mbajtur në shkollën 9-vjecare "Karpen", më datë 17.08.2020, ora 09.00, në këtë shkollë është mbledhur Këshilli i Mësuesve për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin të pranishëm në Komisionin për Konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Karpen". Sipas procesverbalit, në mbledhje kanë marr pjesë 11 nga 11 mësues. Në këtë procesverbal përcaktohen dy mësuesit e mëposhtëm, të cilët u zgjodhën me votim të fshehtë për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:

E.K. (mësuesi me i vjetër në Institucion)
O.Sh. (mësuese).

Me anë të shkresës nr. 42. Prot, datë 17.08.2020, me lëndë "Kërkesë për miratimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve në konkursin për drejtues shkolle në 9-vjecare Karpën" Shkolla 9-vjeçare Karpën i kërkon ZVAP Kavajë miratimin e komisionit të vlerësimit, si më poshtë:

S.S. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (Anëtar)
E.M.- Kryetar Bordi i Institucionit Arsimor (Anëtar)
A.I.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)
E.K.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komision)
O.Sh. – Mësues (anëtare)

Në këtë procesverbal janë pasqyruar emrat e mësuesve të cilët kanë marr pjesë në votim. Mësuesit në fjalë nuk kanë firmosur për pjesëmarrjen e tyre në votim, mungojnë fletët e votimit dhe procesverbali është i paprotokolluar.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me anë të shkresës Nr. 581/1 prot. datë 18.08.2020 "Njoftim për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për drejtues", ZVAP Kavajë njofton DPAP, DRAP Durrës dhe përfaqësuesin e Sindikatës së Arsimit, se më datë 19.08.2020, duke filluar nga ora 09.00, në ambientet e shkollës 9 vjeçare "Fiqiri Kurti" zhvillohen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues të institucioneve arsimore "Aleksandër Moisiu", "3-Dëshmorët", "Helmes", "Golem", Karpën, si dhe për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtyre institucioneve për të monitoruar dhe vëzhguar zbatimin e dispozitave të udhëzimit të MASR gjatë këtij procesi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të dosjes, në përgjigje të shkresës Nr. 581/1 prot. datë 18.08.2020 të ZVAP Kavajë, **nuk** rezulton që DRAP Durrës apo DPAP të kenë përcaktuar përfaqësues të tyre, për të qenë pjesëmarrës gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të kandidatëve për drejtor të shkollës "Karpen".

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të urdhri nr 20, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për konkursin për drejtues shkolla Karpën", Drejtori i ZVA Kavajë, Znj. Xh.B., ka urdhëruar:

Miratimin e Komisionit të Vlerësimit në konkursin për drejtues shkolle në shkollë Karpën, i më poshtë:

S.S. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (Anëtar)

E.M.- Kryetar Bordi i Insitucionit Arsimor (Anëtar)

A.I.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)

E.K.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komision)

O.Sh. – Mësues (anëtare)

Komisioni te shqyrtojë dhe të vlerësojë dokumentacionin e aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor Karpen, sipas shtojcës 5 të udhëzimi dhe shpalljen e pikëve për çdo aplikant sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.

Urdhri nr.20, datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Karpën", i Drejtorit të ZVA Kavajë është i paprotokolluar. Në këtë dosje, nuk u gjet shkresë e përcjellë nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku të ishte përcaktuar Z. S.S., si përfaqësues i kësaj njësi në Komisionin për vlerësimin e kandidatëve për drejtor të shkollës Karpën.

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Referuar procesverbalit me nr. 581/6 prot., datë 19.08.2020 mbi dorëzimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor shkolle, i cili është mbajtur midis Znj. S.Gj. punonjëse në sektorin e shërbimeve të ZVAP Kavajë (dorëzuesi), dhe Znj. E.K., Kryetare e Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP "Karpën" (marrësi), nga verifikimi u konstatua se dosja përmban:

Urdhrin nr 20, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për drejtues shkolle, të drejtorit të ZVAP Kavajë.

Shtojcën nr. 5 (tre kopje)

Shtojcën nr. 6(dy kopje)

Dosjen e kandidatit T.M.

Dosjen e kandidatit Z.I.

Dosjen e kandidatit A.D.

Nga shqyrtimi i dosjes së shkollës "Karpën" në ZVAP Kavajë, **nuk** rezulton të jetë mbajtur procesverbal nga Komisioni i Vlerësimi për procedurën e vlerësimit të dosjeve. Si rezultat i sa më sipër, nuk janë evidentuar dokumentet që mungojnë për secilin prej kandidatëve. Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatëve rezultoi se, asnjëri prej tre kandidatëve nuk ishte i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, apo të ishte pranuar në të.

Në dosjen e procedurës së konkursit të shkollës "Karpen", gjenden deklaratat e konfliktit të interesit të firmosur nga anëtarët e komisionit, të firmosura në datë 19.08.2020, sipas të cilave anëtarët nuk kanë konflikt interesi.

Kandidati T.M. rezulton vetëm të ketë aplikuar në shkollën e Drejtorëve. Kandidatët e tjerë nuk kanë rezultojnë të kenë aplikim, regjistrim, apo certifikim nga Shkolla e Drejtorëve.

Intervistimi i kandidatëve

Nga shqyrtimi i dosjes së shkollës "Karpën" në ZVAP Kavajë, nuk rezulton të jetë mbajtur procesverbal nga Komisioni i Vlerësimi për procedurën e intervistimit të aplikantëve. Gjithashtu, nuk identifikohen pyetjet e intervistës së strukturuar drejtuar kandidatëve.

Në dosjen "Karpën", në ZVAP Kavajë gjenden vlerësimet për kandidatët sipas shtojcës 5, të kryera nga anëtarët e komisionit, të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes	Pikët e intervistës nga K.V.	Pikët e fazës së parë
A.D.	11.5	7.8	19.3
Z.I.	12.2	9	21.2
T.M.	21.8	10	31.8

Në dosje gjendet shtojca 6, në të cilën paraqiten rezultatet finale të kandidatëve, të firmosura nga:

S.S. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (Anëtar)

E.M.- Kryetar Bordi i Institucionit Arsimor (Anëtar)

A.I.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)

E.K.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komision)

O.Sh. – Mësues (anëtare)

Referuar procesverbalit me nr. 581/11 prot., datë 19.08.2020 mbi dorëzimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor shkolle, i cili është mbajtur midis Znj. S.Gj. punonjëse në Sektorin e Shërbimeve të ZVAP Kavajë (marrësi), dhe Znj. E.K., Kryetare e Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP "Karpen" (dorëzuesi), nga verifikimi u konstatua se dosja përmban:

Urdhrin nr 20, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për drejtues shkolle, të drejtorit të ZVAP Kavajë.

Shtojcën nr. 5 (dy kopje)

Shtojcën nr. 6(një kopje)

Dosjen e kandidatit T.M.

Dosjen e kandidatit Z.I.

Dosjen e kandidatit A.D..

Në këtë procesverbal nuk janë refletuar deklaratat e plotësuara të konfliktit të interesit nga pesë anëtarët e komisionit, si pjesë e dosjes së shkollës "Karpën".

Nga krahasimi i datës kur Komisioni i Vlerësimit ka marrë në dorëzim dosjet nga ZVAP Kavajë 19.08.2020, me datën kur i ka dorëzuar ZVAP Kavajë dosjet dhe dokumentacionin e procedurës 19.08.2020 rezulton se, procesi i vlerësimit të dosjeve dhe ai i intervistimit të kandidatëve është kryer në të njëjtën ditë.

Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Me Urdhrin nr. 27, nr. 596. Prot, datë 24.08.2020 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit për verifikimin të procedurës së vlerësimit të dosjeve në konkursin për drejtor shkolla "Karpën", Drejtori i ZVAP Kavajë ka urdhëruar:

Miratimin e Komisionit të Vlerësimit pranë ZVAP Kavajë, për verifikimin e procedurës së vlerësimit të dosjeve si më poshtë:

N.H. (Kryetare)

S.Gj. (Anëtar)

E.M. (Anëtar)

Komisioni të shqyrtojë dhe të vlerësoj procedurën e vlerësimit të dosjeve të aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor Karpën, sipas shtojcës 5 të Udhëzimit.

Referuar procesverbalit nr. 596/1, datë 24.08.2020, të mbajtur në ZVAP Kavajë nga komisioni i ngritur për verifikimin e procedurës së ndjekur për vlerësimin e kandidatëve për shkollën "Karpën", Komisioni është shprehur se **nuk** ka konstatuar parregullsi të natyrës teknike, dhe ka vendosur përcjelljen në DRAP Durrës të kandidatëve me më shumë pikë: T.M me 31.8 pikë dhe Z.I. nga **21.02** pikë.

Komisioni i Vlerësimit në ZVAP **nuk** e ka identifikuar mungesën e procesverbalëve që duhet të mbaheshin nga Komisioni i Vlerësimit për procedurën e vlerësimit të dosjeve dhe atë të intervistimit të aplikantëve apo vlerësimet për çdo kandidatë, për secilën nga pyetjet e intervistës, të të 5-të anëtarëve të komisionit, etj. si parregullsi teknike. Komisioni i Vlerësimit në ZVAP **nuk** ka identifikuar mungesën e certifikimit nga Shkolla e Drejtorëve, të kandidatëve. Referuar shtojcës nr. 6. Z.I. ka marrë **21.2** pikë dhe **jo 21.02** sikurse është shprehur komisioni i shqyrtimit të procedurës së ndrekur nga K.V

Intervistimi i kandidatëve në DRAP Durrës dhe pezullimi i shpalljes së fituesit

Pas zhvillimit të intervistimit në DRAP Durrës dhe shpalljes së fituesit z. T.M., me Vendimin Nr. 69, nr. 1380 prot. datë 10.09.2020 DRAP Durrës ka vendosur:

Pezullimin e shpalljes së fituesit për pozicionin e drejtorit në IPAP si më poshtë:

Gjimnazi "Shote Galica" ZVAP Krujë, znj. F.S.

Shkolla 9-vjecare Helmes, ZVAP Kavajë, znj. L.K.

Shkolla 9- vjeçare Karpen, ZVAP Kavajë, z. T.M.

Shkolla 9-vjecare "Hilary Clinton", ZVAP Kamëz, z. H.U.

Shkollën 9-vjecare Vorë, ZVAP Vorë, z. S.S.

Kandidatët e mësipërm do të shpallen pas konfirmimit nga Shkolla e Drejtorëve si kandidatë fitues, sipas përcaktimeve në nenin 16 të Rregullores për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e drejtorëve/nëndrejtorëve të institucioneve të arsimit parauniveristar në Shqipëri.

Në DRAP Durrës **nuk** u gjet procesverbali i mbajtur nga kjo strukturë, për intervistimin e kandidatëve me më shumë pikë të shkollës Karpen, në përfundim të të cilit kandidati T.M. ka rezultuar fitues dhe emërimi i tij është pezulluar deri në certifikimin nga Shkolla e Drejtore.

Në mënyrë të përmbledhur parregullsitë në procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës Karpen, janë si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Karpen është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Kavajë. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion, dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës.

Proceverbali i mbajtur në shkollën Karpen mbi përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin pjese e Komisionit të Vlerësimit është i pa firmosur nga mësuesit pjesëmarrës dhe i paprotokolluar.

Në dosjen e shqyrtuar nga grupi i auditimit, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga ZVAP Kavajë për të njoftuar zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Karpen, drejtuar njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe për të kërkuar caktimin e një përfaqësuesi nga kjo njësi.
Në këtë dosje, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku të ishte përcaktuar Z. S.S., si përfaqësues i kësaj njësi në Komisionin për përzgjedhjen e drejtoret të shkollës Karpën. Vërehet se shkolla Karpen i ka propozuar ZVAP Kavajës edhe përfaqësuesin e njësi vendore për të qenë pjesë e Komisioni të Vlerësimit, i cili është miratuar si anëtar i Komisionit me Urdhrin e Drejtorit të ZVAP.
Në vijim të Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, dhe shkresës nr. 581/1 prot. datë 18.08.2020 të ZVAP Kavajë, të shkresës nr. 581/1 prot. datë 18.08.2020 të ZVAP Kavajë **nuk** rezulton që DRAP Durrës apo DPAP të kenë përcaktuar përfaqësues të tyre, për të qenë pjesëmarrës gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të kandidatëve për drejtor të shkollës "Karpën".
Urdhri nr.20, datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Karpën", i Drejtorit të ZVA Kavajë është i paprotokolluar.
Nga shqyrtimi i dosjes së shkollës "Karpën" në ZVAP Kavajë, **nuk** rezulton të jenë mbajtur procesverbale nga Komisioni i Vlerësimi për procedurën e vlerësimit të dosjeve dhe atë të intervistimit të aplikantët.
Si rezultat i sa më sipër, **nuk** janë evidentuar dokumentet që mungojnë për secilin prej kandidatëve. Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatëve, G.A evidentoi se asnjëri prej tre kandidatëve nuk ishte i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, apo të ishte regjistruar në të.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.*" Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar shqyrtimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve në të njëjtën ditë, 19.08.2020, pa i dhënë mundësinë kandidatëve për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikëa 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve.
Administrimi i kësaj procedure nga ZVAP Kavajë **nuk** ofron siguri. Që në fillim procesi i vlerësimit të kandidatëve për shkollat nën juridiksion e ZVAP Kavajë sipas Shpalljes 1, **nuk** është planifikuar saktë, pasi referuar e-mailit të dërguar drejtuesve të shkollave nga ZVAP Kavajë vlerësimi i dosjeve dhe intervistimi ishte planifikuar në të njëjtën datë.
Komisioni i shqyrtimi të procedurës së ndjekur nga K.V **nuk** e ka identifikuar mungesën e procesverbalëve që duhet të mbaheshin nga Komisioni i Vlerësimit për procedurën e vlerësimit të dosjeve dhe atë të intervistimit të aplikantëve apo vlerësimet për çdo

kandidatë, për secilën nga pyetjet e intervistës, të të 5-të anëtarëve të komisionit, etj. si parregullsi teknike. Komisioni i Vlerësimit në ZVAP **nuk** ka identifikuar mungesën e certifikimit nga Shkolla e Drejtorëve, të kandidatëve. Referuar shtojcës nr. 6. Z.I. ka marrë **21.2** pikë dhe jo **21.02** sikurse është shprehur Komisioni i shqyrtimit të procedurës së ndjekur nga K.V.
Në DRAP Durrës **nuk** u gjet procesverbali i mbajtur nga kjo strukturë, për intervistimin e kandidatëve me më shumë pikë të shkollës Karpen, në përfundim të të cilit kandidati T.M. ka rezultuar fitues dhe emërimi i tij është pezulluar deri në certifikimin nga Shkolla e Drejtore.
Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:
E.K. (Kryetar Komisioni)
S.S. (Anëtar)
E.M. (Anëtar)
A.I. (Anëtar)
O.Sh. – (Anëtare)
Komisioni i vlerësimit të procedurës së ndjekur nga K.V kishte përbërjen si më poshtë:
Znj.N.H. (Kryetare)
Znj.S.Gj. (Anëtar)
Znj. E.M. (Anëtar)
Drejtori i ZVAP Kavajë, Znj. Xh.B.
Ish-Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Shkolla 3-DËSHMORËT

Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Në dosjen e shqyrtuar nga grupi i auditimit, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga ZVAP Kavajë për të njoftuar zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës 3-Dëshmorët, drejtuar njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe për të kërkuar caktimin e një përfaqësuesi nga kjo njësi.
Megjithatë, identifikohet shkresa nr.3523 prot., datë 17.08.2020, me anë të të cilës Bashkia Kavajë ka emëruar si përfaqësues të saj Z. Sh.B. si anëtar të komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në këtë shkollë.
Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit
Referuar procesverbalit të mbajtur në shkollën 9-vjecare "3- Dëshmorët", më datë 17.08.2020, ora 09.00, në këtë shkollë është mbledhur Këshilli i Mësuesve për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin të pranishëm në Komisionin për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "3- Dëshmorët". Sipas procesverbalit, në mbledhje kanë marr pjesë 28 nga 32 mësues.
Në këtë procesverbal përcaktohen dy mësuesit e mëposhtëm, të cilët u zgjodhën me votim të fshehtë për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:

Z. R.V. (mësuesi me i vjetër në institucion)
Z. A.H. (anëtar)
Në këtë procesverbal janë pasqyruar emrat e mësuesve të cilët kanë marrë pjesë në votim. Mësuesit në fjalë nuk kanë firmosur për pjesëmarrjen e tyre në votim, mungojnë fletët e votimit dhe proceverbali është i paprotokolluar.
Me anë të shkresës nr. 304 prot., datë 17.08.2020, me lëndë "Kërkesë për miratimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve në konkursin për drejtues shkolle në 9-vjecare 3- Dëshmorët" Shkolla 9- vjeçare 3- Dëshmorët i kërkon ZVAP Kavajë miratimin e komisionit të vlerësimit, si më poshtë:
Dh.G. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes vendore (Anëtar)
A.D.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
E.C.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (anëtar)
R.V.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komision)
A.H. – Mësues (Anëtare)
Rezulton se shkolla 3-Dëshmorët ka propozuar një përfaqësues të njësisë së qeverisjes vendore ***të ndryshëm****, nga ai i autorizuar nga Bashkia Kavajë.*
Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore
Nga shqyrtimi i dosjes "3-Dëshmorët" evidentohet Autorizimi Nr.1174/1 prot., datë 18.08.2020, me anë të të cilit Drejtori i DRAP Durrës ka autorizuar Znj. E.V. si përfaqësuese të këtij institucioni, për të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor në shkollën 9-vjecare "3-Dëshmorët".
Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP
Me anë të Urdhri nr 18, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për konkursin për drejtues shkolla 3- Dëshmorët", Drejtori i ZVAP Kavajë, Znj. Xh.B., ka urdhëruar:
Miratimin e Komisionit të Vlerësimit në konkursin për drejtues shkolle në shkollë 3- Dëshmorët, si më poshtë:
Dh.G. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes vendore (Anëtar)
A.D.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
E.C.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (anëtar)
R.V.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komision)
A.H. – Mësues (Anëtare)
Komisioni të shqyrtojë dhe të vlerësojë dokumentacionin e aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor 3-Dëshmorët, sipas shtojcës 5 të udhëzimi dhe shpalljen e pikëve për çdo aplikant sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.
Urdhri nr. 18, datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla 3-Dëshmorët", i Drejtorit të ZVAP Kavajë është i paprotokolluar. Me Urdhrin nr. 18, datë 18.08.2020, si anëtarë i komisionit, përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore është miratuar Z. Dh.G. (i propozuar nga shkolla 3-Dëshmorët) **dhe jo** Z. Sh.B. i emëruar nga Bashkia Kavajë më datë 17.08.2020.

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve
Referuar procesverbalit me nr. 581/4 prot., datë 19/08/2020 mbi dorëzimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor shkolle, i cili është mbajtur midis Znj. S.Gj. punonjëse në Sektorin e Shërbimeve të ZVAP Kavajë (dorëzuesi), dhe Z. R.V., Kryetar i Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP "3-Dëshmorët" (marrësi), nga verifikimi u konstatua se dosja përmban:

Urdhrin nr 18, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për drejtues shkolle, të drejtorit të ZVAP Kavajë.
Shtojcën nr. 5 (dy kopje)
Shtojcën nr. 6(dy kopje)
Dosja e kandidatit F.Xh.
Dosja e kandidatit A.Gj.
Nga shqyrtimi i dosjes së shkollës "Golem" në ZVAP Kavajë, **nuk** rezulton të jetë mbajtur procesverbal nga Komisioni i Vlerësimi për procedurën e vlerësimit të dosjeve dhe realizimit të intervistës me aplikantët. Si rezultat i sa mësipër, nuk janë evidentuar dokumentet që mungojnë për secilin prej kandidatëve. Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatëve rezulton se, asnjëri prej dy kandidatëve nuk ishte i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, apo të ishte regjistruar në të.
Intervistimi i kandidatëve
Në dosje **nuk** rezulton dokumentacion lidhur me procesin e intervistimit apo pyetjet e intervistës së strukturuar drejtuar kandidatëve
Vlerësimi final i Komisionit të Vlerësimit
Vlerësimi i kandidatëve në pikë rezulton të jetë kryer në të njëjtën datë me vlerësimin paraprak dhe intervistimin e tyre. Komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes	Pikët e intervistës nga K.V.	Pikët e fazës së parë
A.Gj.	17.1	8.1	25.2
F.Xh.	20.5	10	30.5

Në dosjen e shkollës "Golem", rezulton shtojca 6, në të cilën janë paraqitur rezultatet finale të kandidatëve, të firmosura nga:
Sh.B. (Anëtar)
F.H. - (Anëtar)
E.C.- (Anëtar)
R.V.- (Kryetar Komision)
A.H.-(Anëtare)
Nga shqyrtimi i anëtarëve të Komisionit të cilët firmosur shtojcën nr.6, krahasuar me anëtarët e miratuar të Komisionit me Urdhrit nr.18, datë 18.08.2020 të Drejtorit të ZVAP Kavajë rezulton se:
Kryetari i Bordit të IPAP, Z. A.D., është **zëvendësuar** me Znj. F.H.
Përfaqësuesi i Njësisë Vendorë, i propozuar nga shkolla 3-Dëshmorët dhe i miratuar me Urdhrin 18, Z. Dh.G., është **zëvendësuar** me Z. Sh.B. të autorizuar nga Bashkia Kavajë.
Referuar procesverbalit nr. 581/10 prot., datë 19.08.2020 mbi dorëzimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor shkolle, i cili është mbajtur midis Znj. S.Gj. punonjëse në Sektorin e Shërbimeve të ZVAP Kavajë (marrësi), dhe Z. R.V., Kryetar i Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP "3-Dëshmorët" (dorëzuesi), nga verifikimi u konstatua se dosja përmban:
Urdhrin nr 18, datë 18.08.2020 "Për ngritjen e komisionit për drejtues shkolle, të drejtorit të ZVAP Kavajë
Shtojcën nr. 5 (dy kopje)
Shtojcën nr. 6(një kopje)
Dosjen e kandidatit F.Xh.
Dosjen e kandidatit A.Gj.

Nga krahasimi i datës kur Komisioni i Vlerësimit ka marrë në dorëzim dosjet nga ZVAP Kavajë 19.08.2020, me datën kur i ka dorëzuar ZVAP Kavajë dosjet dhe dokumentacionin e procedurës 19.08.2020 rezulton se, procesi i vlerësimit të dosjeve dhe ai i intervistimit të kandidatëve është kryer në të njëjtën ditë.

Finalizimi i procedurës-Anulimi i procedurës

Ankimime

Më datë 20.08.2020, Z. A.Gj. ka paraqitur pranë ZVAP Kavajë një ankesë nr. 598/3 prot., datë 21.08.2020, drejtuar ZVAP Kavajë, DRAP Durrës dhe DPAP, sipas të cilës në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 ka paraqitur pretendimet e tij si më poshtë:

Fillimisht në përbërje të komisionit të vlerësimit duhet të ishte Kryetari i bordit të prindërve dhe në rastin konkret **nuk** ka qenë A.D. por F.H..

Nisur nga nr. i lartë i pikëve të kandidatit F.Xh. **nuk** jam i bindur se mënyra e llogaritjes së pikëve është konform Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020. Konform Udhëzimit shuma e pikëve të mia duhet të jetë 21.1 (pa intervistën), dhe pikët e kandidatit tjetër 13-14 pikë (pa intervistën). Nisur nga rezultati final 30.2 pikë për kandidatin tjetër dhe 25.2 pikë unë, i takon që intervista të ketë 16 pikë për F.Xhihani, ose ?! (4.2 pikë unë).

Pretendimet të tjera: Probleme në përbërjen dhe **kompetencën** e komisionit të IPAP në menaxhimin e informacionit konformë udhëzimit dhe metodologjisë së përdorur në intervistën e strukturuar për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. (Vetëm një pyetje nga përfaqësuesi i NJVV, të tjera "lakonike" dhe statistikore).

Mendoj se vetëm juristi mund të qartësojë "paqartësitë" në vlerësimin e dosjeve nga IPAP.

Procesverbali i përfaqësuesit të DRAP

Me anë të shkresës nr. 590/3, datë 24.08.2020, DRAP Durrës i ka përcjellë ZVAP Kavajë procesverbalin e mbajtur nga përfaqësuesi i DRAP Durrës, në konkursin për drejtuesin e shkollës 3-Dëshmorët. Sipas procesverbalit të mbajtur më datë 19.08.2020, në orën 10.30 nga përfaqësuesi i DRAP Durrës:

-Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit përbëhej nga:

Sh.B.
F.H.
E.C.
R.V.
A.H.

U prezantuan 2 dosje: 1- A.Gj. dhe 2- F.Xh.. Gjatë veprimtarisë së Komisionit u konstatuan shkelje:

1. Sipas kreut 1/C, pikës 5, të Udhëzimit Nr.2, datë 28.01.2020 "Anëtarët e komisionit plotësojnë **deklaratën** e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Njëri nga anëtarët u largua nga procesi dhe **u zëvendësua** në mënyrë të paligjshme, ku sipas Kreut I/C, pika 9, theksohet se: "*Zëvendësimi kryhet brenda një dite pune nga titullari i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për anëtarin e zgjedhur prej tij; bordi i IPAP; këshilli i prindërve të IPAP ose këshilli i mësuesve, për anëtarët e zgjedhur prej tyre*."

3. Gjithashtu, pyetjet e drejtuara nga Komisioni për intervistë lini për të dëshiruar, si data vendimesh apo udhëzimesh. Komisioni ishte i **pa trajnuar** për të shqyrtuar apo vlerësuar dokumentacionin e kandidatëve dhe nuk ishin të pajisur me udhëzimin Nr. 2, (me përjashtim të Kryetarit).

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Referuar Urdhrin nr. 23, nr. 589. prot, datë 21.08.2020 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit për verifikim të procedurës së vlerësimit të dosjeve në konkursin për drejtor, shkolla "3-Dëshmorët", më datë 20.08.2020 në adresën elektronike të ZVAP Kavajë ka mbërritur një e-maili nga përfaqësuesja e institucionit DRAP Durrës, Zn. E.V., e cila konstatoi shkelje të veprimtarisë së Komisionit dhe kërkon që ZVAP Kavajë të **pezullojë** dhe verifikojë procedurën e vlerësimit të dosjeve. Me këtë Urdhër, Drejtori i ZVAP Kavajë ka urdhëruar

Miratimin e Komisionit të Vlerësimit pranë ZVAP Kavajë për verifikimin e procedurës së vlerësimit të dosjeve për shkollën "3-Dëshmorët" si më poshtë:

N.H. (Kryetare)

S.Gj. (Anëtar)

E.M. (Anëtar)

Komisioni të shqyrtojë dhe të vlerësoj procedurën e vlerësimit të dosjeve të aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor 3-Dëshmorët, sipas shtojcës 5 të Udhëzimit.

Referuar procesverbalit nr. 589/1, datë 21.08.2020, të mbajtur në ZVAP Kavajë nga Komisioni i ngritur për verifikimin e procedurës së ndjekur për vlerësimin e kandidatëve për shkollën 3-dëshmorët është konstatuar:

"*Pas verifikimit të dosjes u konstatua se asnjëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të dosjeve të shkollës 3-Dëshmorët nuk ka plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit, referuar kreut I/C pika 5*

Sipas Urdhrit nr.18, datë 18.08.2019 " Për ngritjen e Komisionit për konkursin për drejtues shkolla Golem,", ku Kryetari i bordit të prindërve është A.D. ndërsa në tabelën e rezultateve ka firmosur Znj. F.H..

Për sa më sipër Komisioni vendosi:

***Anulimin** e procedurës së vlerësimit të dosjeve të konkursit për drejtues shkolla "3-Dëshmorët"."*

Ky procesverbal i është dërguar DRAP Durrës nga ZVAP Kavajë me anë të shkresës 589/2. Prot., datë 21.08.2020. Në vijim nuk evidentohen masa të ndërmarra lidhur me këtë procedurë.

Në mënyrë të përmbledhur parregullsitë në procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës 3-Dëshmorët, janë si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës 3- Dëshmorët është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Kavajë. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion, dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës.

Procesverbali i mbajtur në shkollën 3- Dëshmorët mbi përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin pjese e Komisionit të Vlerësimit është i pa protokolluar. Mësuesit pjesëmarrës nuk kanë firmosur për pjesëmarrjen e tyre në votim si dhe mungojnë fletët e votimit.

Në dosjen e shqyrtuar nga grupi i auditimit, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga ZVAP Kavajë për të njoftuar zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës 3-Dëshmorët, drejtuar njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe për të kërkuar caktimin e një përfaqësuesi nga kjo njësi.

Urdhri nr.18, datë 18.08.2020 i Drejtorit të ZVAP Kavajë "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla 3-Dëshmorët", është i **pa protokolluar**.

Me Urdhrin nr. 18, datë 18.08.2020, si anëtarë i komisionit, përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore është miratuar Z. Dh.G. (i propozuar nga shkolla 3-Dëshmorët) **dhe jo** Z. Sh.B. i emëruar nga Bashkia Kavajë më datë 17.08.2020. Megjithatë, në mbledhjen e Komisionit ka marrë pjesë dhe ka firmosur Z. Sh.B..

Asnjëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të dosjeve të shkollës 3-Dëshmorët **nuk** ka plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit, referuar kreut I/C pika 5

Në ZVAP Kavajë, për shkollën 3-Dëshmorët **nuk** rezulton të jetë mbajtur procesverbale nga Komisioni i Vlerësimi për procedurën e vlerësimit të dosjeve dhe për atë të intervistimit të aplikantët.
Si rezultat i sa më sipër, nuk janë evidentuar dokumentet që mungojnë për secilin prej kandidatëve. Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatëve, rezulton se asnjëri prej dy kandidatëve nuk ishte i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, apo të ishte pranuar në të. Gjithashtu, nuk identifikohen pyetjet e intervistës së strukturuar drejtuar kandidatëve dhe vlerësimi i kandidatëve nga të 5-të anëtarët e komisionit për intervistën.
Nga shqyrtimi i anëtarëve të Komisionit të cilët firmosur shtojcën nr.6, krahasuar me anëtarët e miratuar të Komisionit me Urdhrit nr.18, datë 18.08.2020 të Drejtorit të ZVAP Kavajë, rezulton se :
Kryetari i Bordit të IPAP, Z. A.D., është zëvendësuar me Znj. F.H.
Përfaqësuesi i Njësisë Vendorë, i propozuar nga shkolla 3-Dëshmorët dhe i miratuar me Urdhrin 18, Z. Dh.G., është zëvendësuar me Z. Sh.B. të autorizuar nga Bashkia Kavajë.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.*" Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar shqyrtimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve në të njëjtën ditë, 19.08.2020, pa i dhënë mundësinë kandidatëve për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve."
Administrimi i kësaj procedure nga ZVAP Kavajë **nuk** ofron siguri. Që në fillim procesi i vlerësimit të kandidatëve për shkollat nën juridiksion e ZVAP Kavajë sipas Shpalljes 1, **nuk** është planifikuar saktë, pasi referuar e-mailit të dërguar drejtuesve të shkollave nga ZVAP Kavajë vlerësimi i dosjeve dhe intervistimi ishte planifikuar në të njëjtën datë.
Në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Procedurës pranë ZVAP Kavajë, **nuk** evidentohet mungesa e proceverbaleve të cili duhet të ishin mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të dosjeve dhe intervistimit të kandidatëve, kryerja e procesit të vlerësimit të dosjeve dhe e intervistimit në të njëjtën ditë, dokumentacioni i paplotë i kandidatëve dhe njoftimi i tyre për plotësimin e dokumentacionit, mungesa e certifikatë së drejtorëve, etj. Në procesverbal **nuk** është evidentuar zëvendësimi i përfaqësuesit të Njësisë Vendore, Z. Dh.G. (miratuar me Urdhrin 18), me Z. Sh.B., etj.
Në vijim të problematikave të lidhura me këtë procedurë, **nuk** identifikohen të jenë ndërmarrë masa nga ZVAP Kavajë, apo DRAP Durrës.
Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:

R.V.- (Kryetar Komision)
Sh.B. (Anëtar)
F.H. - (Anëtar)
E.C.- (Anëtar)
A.H.-(Anëtare)
Komisioni i Vlerësimit të procedurës së ndjekur nga K.V, me përbërje:
Znj.N.H. (Kryetare)
Znj. S.Gj. (Anëtare)
Znj. E.M. (Anëtare)
Drejtori i ZVAP Kavajë, Znj. Xh.B.
Ish-Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Shkolla ALEKSANDËR MOJSIU

a.Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes për pozicionin e lirë të Drejtorit të Shkollës Aleksandër Mojsiu, në dosjen e procedurave të ndjekura për vlerësimin e kandidatëve, në dosje mungon shkresa sipas së cilës ZVAP Kavajë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Aleksandër Mojsiu". Me anë të shkresës nr. 3525/1, datë 17.08.2020, Bashkia Kavajë ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, z. A.D., për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Me anë të procesverbalit datë 17.08.2020, i pa protokolluar në shkollën Aleksandër Moisiu, është njoftuar se pas votimit, 2 mësuesit të caktuar për pjesëmarrje në Komision, do të ishin z. F.E., mësuesi më i vjetër në shkollë dhe z. D.M., mësues.

Me anë të shkresës nr. 236, prot datë 17.08.2020 të Shkollës Aleksandër Moisiu, përcjellë pranë ZVAP Kavajë, janë përcjellë 5 përfaqësuesit për komisionin e vlerësimit.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me anë të shkresës nr. 1174/2, prot datë 18.08.2020 të DRAP Durrës, është autorizuar znj. E.D. për pjesëmarrje në komision si përfaqësuese e DRAP Durrës.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 21, datë 18.08.2020, të pa protokolluar në ZVAP Kavajë, Drejtori i ZVAP Kavajë urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Aleksandër Moisiu, si më poshtë:

1. F.E., mësues- Kryetar
2. D.M.j, mësues- Anëtar
3. J.C., kryetar i bordit- Anëtar
4. S.P., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtare
5. A.D., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar

b.Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Për këtë procedurë, në dosje **nuk** disponohet një procesverbal ndërmjet ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatën/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP Kavajë, për pozicionin e drejtorit shkollës Aleksandër Mojsiu, në mënyrë që të identifikohen dosjet që komisioni ka marë në dorëzim.

Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, ora 09.00 mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Aleksandër Mojsiu", mbajtur në shkollën Fiqiri Kurti, komisioni është shprehur:

Komisioni i mbledhur përbëhet nga 5 anëtarë. Numri i dosjeve që u prezantuan (3) copë. 1.Dosja e kandidatit znj. B.K.

2. Dosja e kandidatit z. I.H.

3. Dosja e kandidatit znj. M.A.

Pasi u panë dokumentacionet e sjellë nga kandidatët dhe duke u vlerësuar në bazë të Udhëzimit nr.2. Komisioni vlerësoi me përpikmëri 3 (tre) kandidatët. Zhvillimi i procesit të vlerësimit të dosjeve si dhe intervista e strukturuar u bë në mënyrë të rregullt dhe pa probleme.

Procesverbali është firmosur nga 5 anëtarët e komisionit, por është i paprotokolluar.

Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 19.08.2020, Komisioni ka pasqyruar vlerësimin final me pikë të kandidatëve, në prezencë të përfaqësueses së DRAP, znj. E.D.. Procesverbali është i paprotokolluar.

Intervistimi i kandidatëve

Në dosje nuk disponohet dokumentacioni për njoftimin e kandidatëve lidhur me datën e intervistës. Ato rezultojnë të jenë kryer në të njëjtën ditë me vlerësimin e dosjeve të kandidatëve. Për intervistën komisioni nuk ka dokumentuar pyetjet e saj, dhe vlerësimin e kandidatëve sipas votave të anëtarëve pas intervistimit.

Vlerësimi final i Komisionit të Vlerësimit

Në vijim komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 dhe 6 të udhëzimit duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve në total. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
B.K.	14.3	8	22.3
I.H.	9.1	10	19.1
M.A.	9.7	9	18.7

Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 19.08.2020, protokolluar në ZVAP Kavajë me shkresën nr. 58/3, datë 19.08.2020, kryetari i komisionit të vlerësimit i dorëzoi përfaqësuesit të ZVAP Kavajë, znj. S.Gj.:

1. Urdhrin nr. 21, datë 18.08.2020 për ngritje të komisionit
2. Shtojca nr.5
3. Shtojca nr. 6
5. Dosja e kandidatit B.K.
6. Dojsa e kandidatit I.H.
7. Dosja e kandidatit M.A.

c. Finalizimi i procedurës

Me urdhrin nr. 26, prot nr. 590/4 datë 24.08.2020, pra 5 ditë pas dorëzimit të dosjeve nga komisioni, në ZVAP Kavajë është urdhëruar ngritja e komisionit në ZVAP Kavajë për verifikimin e procedurës së vlerësimit të dosjeve të vlerësimit, me përfaqësues :
1. Znj. S.Gj., Kryetare
2. M.C., Anëtare
3. E.M., Anëtare.

Nga auditimi konstatohet se anëtarët e këtij komisioni janë punonjës së Sektorit të Shërbimeve me profil financiar, pasi pozicionet e juristëve për ZVAP Kavajë vijojnë vakantë.
Me procesverbalin nr. 17, prot nr. 590/5, datë 24.08.2020 Komisioni i ngritur në ZVAP Kavajë është shprehur se:
Në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit ***nuk konstatoi asnjë parregullsi të natyrës teknike.*** *Për këtë arsye është vendosur përcjellja e dy kandidatëve me më shumë pikë, znj. B.K. dhe z. I.H. pranë DRAP Durrës.*
Me shkresën nr. 590/6 prot datë 26.08.2020, pra **5** ditë pune pas dorëzimit të dosjeve nga komisioni, ZVAP Kavajë janë përcjellë dy dosjet e mësipërme nga Drejtori i ZVAP Kavajë për në DRAP Durrës.
Me shkresën nr. 590/2, prot në ZVAP Kavajë datë 24.08.2020, është përcjellë nga drejtori i ZVAP Kavajë znj. Xh.B. ka përcjellë pranë DRAP Durrës kthim përgjigje për znj. B.K.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni disponohet vetëm ankimimi i zonjës, dhe jo përgjigjia e ZVAP Kavajë. Ky dokument nuk disponohej në protokollin e ZVAP Kavajë, por pas kërkesës së grupit u dorëzua në ZVAP Kavajë nga vetë ankimuesja.
Ankesa e zonjës B.K. lidhet me pretendime për pasaktësi në përllogaritjen e pikëve të saj lidhur me:
1. Vlerësimin për gjuhën italiane në nivelin B2 të pa marë në konsideratë nga komisioni
2. Intervistën e strukturuar kandidatja është shprehur se nuk i është bërë vetëm një pyetje por disa pyetje dhe përfaqësuesi i NJVV e ka vlerësuar me 0 pikë.
3. Mosnjohje të pikëve të arsimit shtesë për Dëshminë për Drejtues dhe Lidership në Institucionet e Arsimit Parauniversitar.

Kandidatja pretendon se duhet të ishte vlerësuar me 30.3 pikë dhe jo 22.3 pikë.
ZVAP Kavajë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 590/1, prot datë 24.08.2020 duke argumentuar se referuar pikës 11 të udhëzimit i cili thotë se " Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para komisionit brenda 3 ditëve punë nga shpallja e rezultateve. Komisioni shqyrton ankesat brenda 1 dite pune", pretendimi i ngritur nga zonja nuk qëndron pasi kjo kërkesë është paraqitur gabim tek ZVAP Kavajë, ku duhet të adresohej tek komisioni i shkollës.
Në vijim, me shkresën nr. 1354 prot datë 08.09.2020 në DRAP Durrës, znj. V.L. ka shpallur fituese të pozicionit znj. B.K..
Me shkresën nr. 1470/1, prot datë 15.09.2020 në DRAP Durrës, emërimi definitiv i znj. B.K. do të fillojë marrëdhëniet e punës në 16.09.2020.
Nga verifikimi i dosjeve të kandidatëve konstatohet se:
-Znj. B.K. ka dorëzuar një fotokopje të email-it datë 30.07.2020, sipas së cilit Shkolla e Drejtorëve të IAP ka njoftuar kandidaten për kalim të fazës së vlerësim të kandidates dhe se regjistrimi në shkollën e drejtorëve do të jetë në varësi të kuotave në dispozicion në brezin e dytë të trajnuarve. Për këtë arsye, kandidatja është njoftuar se do i komunikohet në një njoftim të dytë në lidhje me datën kur do të ndjekë programin.
z. I.H. ka bashkëlidhur aplikimin për shkollën e drejtorëve, dhe email-in e datës 14.07.2020 sipas së cilit është pranuar aplikimi dhe do të njoftohet në vijim për rezultatet e përzgjedhjes.
- Dojsa e kandidates M.A., ka dorëzuar një fotokopje të email-it datë 30.07.2020, sipas së cilit Shkolla e Drejtorëve të IAP ka njoftuar kandidaten për kalim të fazës së vlerësim të kandidates dhe se regjistrimi në shkollën e drejtorëve do të jetë në varësi të kuotave në dispozicion në brezin

e dytë të trajnuarve. Për këtë arsye, kandidatja është njoftuar se do i komunikohet në një njoftim të dytë në lidhje me datën kur do të ndjekë programin.

Në përfundim të auditimit të dosjes mbi këtë procedurë konstatohet se:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Aleksandër Mojsiu është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar.

Në dosje nuk dokumentohet njoftimi i ZVAP Kavajë për njësinë e vetëqeverisjes vendore lidhur me datën në të cilën do të kryhet intervista për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës, dhe caktimin e një përfaqësuesi prej tyre.

Nga verifikimi i dokumentacioneve të kandidatëve konstatohet se të tre kandidatët në këtë procedurë nuk kanë vijuar trajnimin për shkollën e drejtorëve, por 2 prej tyre janë pranuar në këtë shkollë duke u njoftuar se në vijim do të përcaktohet periudha e trajnimit për ta në varësi të kuotave, dhe 1 kandidati vetëm i është pranuar aplikimi për në shkollën e drejtorave, pa u njoftuar për përzgjedhjen/pranimin e tij në këtë shkollë.

Gjithashtu, nuk disponohet në dosje dokumentacioni sipas të cilit kandidatët janë njoftuar për datën në të cilën do të kryhet intervista për ta, por ajo është kryer në të njëjtën ditë me vlerësimin e dosjeve.

Nga auditimi nuk disponohet informacion lidhur me pyetjet e kandidatëve gjatë intervistës së strukturuar, dhe votimit të anëtarëve të komisionit për intervistën e strukturuar.

Në kundërshtim me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit* ***do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht*** *2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak*." Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar shqyrtimin e dosjeve,intervistimin dhe përcjelljen e dosjeve të kandidatëve në të njëjtën ditë, **19.08.2020**. Përcjellja e dosjeve të kandidatëve në datën 19 gusht, **nuk** u ka lejuar ankimuesve përcjelljen e pretendimeve të tyre tek komisioni i vlerësimit, brenda afatit 3 ditor pas shpalljes së rezultateve, sikundër përcaktohet në udhëzimin nr.2.

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: *"Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikëa 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve."

Nga auditimi konstatohet se pas kryerjes së vlerësimit të dosjeve dhe intervistimit të kandidatëve në të njëjtën ditë (19.08.2020), komisioni ka dorëzuar vendimmarrjen e tij në ZVAP Kavajë në 19.08.2020. Drejtori i ZVAP Kavajë ka ngritur komisionin për vlerësimin e procedurave të ndjekura nga Komisioni 5 ditë më vonë (ose 2 ditë pune), përkatësisht në 24.08.2020 dhe 2 ditë më vonë është bërë përcjellja e tyre në DRAP Durrës, në kundërshtim me pikën D. 2, të udhëzimit nr.2, e cila citon se " *Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP."*

Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Kavajë, përpara përcjelljes së dosjes në DRAP Durrës për intervistimin e kandidatëve, në vijim të Pikës D.1 e cila përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP,*

*shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknik*e", pasi ZVAP **nuk** rezulton të ketë identifikuar këto parregullsi në relacionin e përgatitur lidhur me procedurën.
Gjithashtu, këto mangësi rezultojnë të pa identifikuara **edhe** nga përfaqësuesja e DRAP Durrës, pjesëmarrëse në këtë procedurë vlerësimi.
-Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:
F.E., mësues- Kryetar
D.M. mësues- Anëtar
J.C., kryetar i bordit- Anëtar
S.P., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtare
A.D., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar
-Komisioni i Vlerësimit të procedurës së ndjekur nga K.V, me përbërje:
Znj. S.Gj. (Kryetare)
Znj. M.C. (Anëtare)
Znj. E.M. (Anëtare)
-Drejtori i ZVAP Kavajë, Znj. Xh.B.
-Ish-Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Shkolla HELMAS

a.Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Pas shpalljes për poziconin e lirë të Drejtorit të Shkollës Helmas, në dosjen e procedurave të ndjekura për vlerësimin e kandidatëve, **mungon** shkresa sipas së cilës ZVAP Kavajë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Helmas". Gjithashtu mungon shkresa sipas së cilës Bashkia Kavajë të përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.
Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit
Me anë të procesverbalit datë 17.08.2020, i pa protokolluar në shkollën Helmas, është njoftuar se pas votimit, 2 mësuesit të caktuar për pjesëmarrje në Komision, do të ishin z.F.A., mësuesi më i vjetër në shkollë dhe z. S.A., mësues.
Me anë të shkresës nr. 148, prot datë 17.08.2020 të Shkollës Helmas, përcjellë pranë ZVAP Kavajë, janë përcjellë 5 përfaqësuesit për komisionin e vlerësimit, duke përfshirë në këtë shkresë edhe përfaqësuesin e Njësisë së Qeverisjes Vendore, z. E.K..
Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore
Për këtë procedurë **nuk** kemi një shkresë nga DRAP për dërgimin e përfaqësuesit në këtë mbledhje të komisionit të vlerësimit.
Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 17, datë 18.08.2020, të pa protokolluar në ZVAP Kavajë, Drejtori i ZVAP Kavajë urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Helmas, si më poshtë:
1.F.A., mësues- Kryetar
2. S.A., mësues- Anëtar
3.L.K., kryetar i bordit- Anëtar
4. R.K., kryetar i këshillit të prindërve-Anëtar
5.E.K., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar

b.Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Për këtë procedurë, në dosje **nuk** disponohet një procesverbal ndërmjet ZVAP Kavajë dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatën/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT, për pozicionin e drejtorit shkollës Helmas, në mënyrë që të identifikohen dosjet që komisioni ka marë në dorëzim

Më datë 17.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Ne dosje mungon procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Helmas".

Intervistimi i kandidatëve

Gjithashtu mungojnë dokumentacionet justifikuese për zhvillimit të intervistave, të tilla si njoftimi për datën e intervistës, pyetjet e intervistës si dhe votimin e komisionit për kandidatët e intervistuar.

Vlerësimi final i Komisionit të Vlerësimit

Komisioni ka plotësuar shtojcat 5 dhe 6 të udhëzimit, të cilat janë të pa firmosura nga anëtarët. Në vijim komisioni ka plotësuar Shtojcën 6 të udhëzimit duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve në total. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
M.A.	11.7	7	18.7
L.K.	14.8	9	23.8

Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 19.08.2020, protokolluar në ZVAP Kavajë me Me shkresën nr. 581/7, datë 19.08.2020, kryetari i komisionit të vlerësimit i dorëzoi përfaqësuesit të ZVAP Kavajë, znj. S.Gj.:
1. Urdhrin nr. 17, datë 18.08.2020 për ngritje të komisionit
2. Shtojca nr.5
3. Shtojca nr. 6
5. Dosja e kandidatit L.K.
6. Dojsa e kandidatit M.A.

Me urdhrin nr. 25, prot nr. 588/2 datë 24.08.2020 në ZVAP Kavajë është urdhëruar ngritja e komisionit në ZVAP Kavajë për verifikimin e procedurës së vlerësimit të dosjeve të vlerësimit të shkollës Helmas, me përfaqësues :
1. N.H., Kryetare
2. S.Gj., Anëtare
3. E.M., Anëtare.

Me procesverbalin nr. 16, prot nr. 588/3, datë 24.08.2020 komisioni i ngritur në ZVAP Kavajë është shprehur se:

Në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit **nuk konstatoi asnjë parregullsi të natyrës teknike.** Për këtë arsye është vendosur përcjellja e dy kandidatëve me më shumë pikë, znj. L.K. dhe znj. M.A. pranë DRAP Durrës.
Me shkresën nr. 588/4 prot datë 26.08.2020 të ZVAP Kavajë janë përcjellë dy dosjet e mësipërme nga Drejtori i ZVAP Kavajë për në DRAP Durrës.
Me shkresën nr. 588 prot në ZVAP Kavajë datë 20.08.2020, është përcjellë ankesa e znj. M.A., me pretendime për pasaktësi në përllogaritjen e pikëve të saj lidhur me:
1. Dy trajnime me kredite 2.5 dhe 1.5 pikë janë përcjellë me email pranë ZVAP të cilin kandidatja pretendon se ja ka treguar komisionit, por komisioni nuk i ka llogaritur pikët pasi ka kërkuar certifikatën.
2. Kandidatja pretendon për njëanshmëri të komisionit i cili përbëhej nga anëtarë që kishin njohje me kandidaten tjetër, dhe ndoshta dhe interesa të përbashkëta, të cilat sipas saj i kanë treguar me vlerësimin e intervistës me gojë.
Në përgjigje të kësaj ankese, me shkresën nr. 588/1, datë 24.09.2020 ZVAP Kavajë i është përgjigjur ankesës së znj. M.A. duke argumentuar se referuar pikës 11 të udhëzimit i cili thotë se " Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para komisionit brenda 3 ditëve punë nga shpallja e rezultateve. Komisioni shqyrton ankesat brenda 1 dite pune", pretendimi i ngritur nga zonja **nuk** qëndron pasi kjo kërkesë është paraqitur gabim tek ZVAP Kavajë, ku duhet të adresohej tek komisioni i shkollës.
Në vijim, me vendimin nr. 69 datë 10.09.2020, sipas shkresë nr. 1380 prot datë 10.09.2020 në DRAP Durrës dhe protokolluar në ZVAP Kavajë nr. 596/3, datë 14.09.2020, znj. V.L. ka vendosur **pezullimin** e shpalljes së fituesve për pozicionin e drejtorit për shkollën 9 vjeçare Helmas, nën ZVAP Kavajë.
Sipas kësaj shkrese, kandidatet do të shpallen **pas** konfirmimit nga Shkolla e Drejtorëve si kandidat fitues, sipas përcaktimeve të nenit 16 të Rregullores për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e drejtorëve, nëndrejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri.
Nga verifikimi i dosjes së aplikanteve rezulton se:
-Për kandidaten M.A. komisioni e ka vlerësuar me 1.5 pikë për shkallën e kualifikimit, në një kohë ku sipas dokumentacionit në dosjen e aplikantes ajo disponon një kualifikim të nivelit të III, me vlerësimin "mirë", i cili sipas udhëzimit vlerësohet me 0.5 pikë. Vërtetimi në dosjen e kandidates është nr. 86, datë 10,08.2020 është nga shkolla Vorrozen, duke deklaruar se kryemësuesja në shkollën Blerimaj nuk ka masë disiplinore. Kandidatja nuk rezulton të ketë aplikuar apo të jetë pranuar në shkollën e drejtorëve.
-Për kandidaten L. K., ka bashkëlidhur aplikimin e saj në programin e shkollës së drejtorëve në 14.08.2020. Në vlerësimin me pikë të komisionit, për shkallën e kualifikimit ajo është kualifikuar me 3.5 pikë, nga 3 që është maksimalja për këtë seksion, në një kohë ku në dosje ka një shkallë kualifikimi në kategori II, me vlerësimin mirë që duhet vlerësuar me 1.5 pikë.
Në përfundim të auditimit të dosjes mbi këtë procedurë konstatohet se:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Helmas është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar.
Në dosje nuk dokumentohet njoftimi i ZVAP Kavajë për njësinë e vetëqeverisjes vendore lidhur me datën në të cilën do të kryhet intervista për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës, dhe caktimin e një përfaqësuesi prej tyre. Gjithashtu nuk dokumentohet përzgjedhja e përfaqësuesit nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
Nga auditimi konstatohet se për këtë procedurë, në dosje **nuk** disponohet procesverbali i mbajtur nga komisioni për verifikimin e dosjeve të kandidatëve për të cilët do të kryhet vlerësimi.

Nga verifikimi i dokumentacioneve të kandidatëve konstatohet se të dy kandidatët në këtë procedurë **nuk** kanë vijuar trajnimin për shkollën e drejtorëve, por 1 prej tyre është pranuar aplikimi dhe për tjetrin nuk ka informacion.

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve."

Gjithashtu, nuk disponohet në dosje dokumentacioni sipas të cilit kandidatët janë njoftuar për datën në të cilën do të kryhet intervista për ta.

Nga auditimi nuk disponohet informacion lidhur me pyetjet e kandidatëve gjatë intervistës së strukturuar, dhe votimit të anëtarëve të komisionit për intervistën e strukturuar.

Nga auditimi konstatohet se komisioni i vlerësimit ka kryer intervistimin e kandidatëve në të njëjtën ditë me vlerësimin e dosjeve.

Nga auditimi konstatohet se pas kryerjes së vlerësimit të dosjeve dhe intervistimit të kandidatëve në të njëjtën ditë (19.08.2020), komisioni ka dorëzuar vendimmarrjen e tij në ZVAP Kavajë në 19.08.2020. Drejtori i ZVAP Kavajë ka ngritur komisionin për vlerësimin e procedurave të ndjekura nga Komisioni 5 ditë më vonë, përkatësisht në 24.08.2020 dhe 2 ditë më vonë është bërë përcjellja e tyre në DRAP Durrës, në kundërshtim me pikën D. 2, të udhëzimit nr.2, e cila citon se " *Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP*."

Për këtë procedurë nuk ka patur asnjë pjesëmarrës nga DRAP Durrës.

Parregullsitë e trajtuara më sipër lidhur me procesin dhe vendimmarrjen e komisionit, rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Kavajë, përpara përcjelljes së dosjes në DRAP Durrës për intervistimin e kandidatëve, në vijim të Pikës D.1 e cila përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*", pasi ZVAP **nuk** rezulton të ketë identifikuar këto parregullsi në relacionin e përgatitur lidhur me procedurën.

-Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:
1.F.A., mësues- Kryetar
2. S.A., mësues- Anëtar
3.L.K., kryetar i bordit- Anëtar
4. R.K., kryetar i këshillit të prindërve-Anëtar
5.E.K., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar

-Komisioni i Vlerësimit të procedurës së ndjekur nga K.V, me përbërje:
1. N.H., Kryetare
2. S.Gj., Anëtare
3. E.M., Anëtare.

-Drejtori i ZVAP Kavajë, Znj. Xh.B.
-Ish-Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 2**, nr. 1066/1 prot., datë 19.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vorë, Klos, Mat,Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Kavajë, dhe Tiranë. Kjo shpallje është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZVAP Kavajë si dhe në ambientet e kësaj zyre vendore. Nëpërmjet kësaj shpallje, për ZVAP Kavajë janë shpallur 3 pozicione të lira për drejtor të shkollave si më poshtë:

Qamil Xhani,
Shtodher,
Razi Leka (Hajdaraj),

1.Për shkollën "**Qamil Xhani, Luzi i Vogël",** procedura është **anulluar n**ga komisioni i ngritur në ZVAP për shqyrtimin e dosjeve të komisionit**.** Me procesverbalin nr. 21, prot nr. 629, datë 11.09.2020 Komisioni i ngritur në ZVAP Kavajë është shprehur se:

Në procesin e shqyrtimit të dokumentacioneve të kandidatëve, DRAP Durrës ka dërguar si përfaqësues znj. A.O. dhe znj. E.V., të cilat konstatuan se:

Dy kandidate nuk plotësonin kriterin e kreut I, gërma B të udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku thuhet se "Kandidati për drejtor ka të paktën kategorinë mësues i kualifikuar". Për këtë arsye u vendos: ***Anullimi i procedurës së vlerësimit të dosjeve për konkursin për drejtues shkolla "Qamil Xhani".***

2.Për shkollën **"Shtodhër", ZVAP Kavajë** ka përcjellë për në DRAP Durrës me shkresën nr. 623/3 prot datë 02.10.2020**, pra mbi një muaj** pas përfundimit të vlerësimit të dosjeve ZVAP Kavajë dy dosjet e mësipërme nga Drejtori i ZVAP Kavajë për në DRAP Durrës. Nga informacioni i marë nga DRAP Durrës, dosjet e kandidatëve ndodhen në DRAP dhe ende **nuk** janë zhvilluar intervistat e kandidatëve, në tejkalim të afateve të udhëzimit nr.2.

3. Për shkollën **Razi Leka, Hajdaraj** Komisioni i ngritur në ZVAP Kavajë ka vendosur anulimin e procedurës, ku më hollësisht me procesverbalin nr. 22, prot nr. 629/3, datë 16.09.2020 është shprehur se: *Në procesin e shqyrtimit të dokumentacioneve të kandidatëve, DRAP Durrës ka dërguar si përfaqësues znj. A.O. dhe znj. E.V., të cilat konstatuan se:*

Dy kandidate nuk plotësonin kriterin e kreut I, gërma B, pika 1, gërma d të udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku thuhet se "Kandidati për drejtor është pranuar për të kryer trajnimi....". Kandidatëve ju ka 3 ditë kohë për plotësim dokumentacioni, por ky afat nuk u respektua. Për këtë arsye u vendos: ***Anullimi i procedurës së vlerësimit të dosjeve për konkursin për drejtues shkolla "Razi Leka" Hajdaraj.***

Në dosje nuk disponohen dokumentacionet për dërgimin e përfaqësuesve nga DRAP, dhe komunikimin e aplikantëve për plotësimin e mangësive të konstatuara në dosje.

MBI VENDIMET GJYQËSORE

Vendime të ekzekutuara

ZVAP Kavajë për vitin 2019 ka ekzekutuar **1** vendim gjyqësor sipas urdhër shpenzimit nr.222, datë 01.10.2019 **me vlerë totale 766,835 lekë**, nga të cilat 641,119 lekë detyrimi për largimin e padrejtë nga puna, 43,500 lekë shpenzime gjyqësore dhe 82,163 lekë shpenzime përmbaruese.

Vendime të pa ekzekutuara

Pranë ZVAP Kavajë ka ardhur **1** vendim i vitit 2019, për të cilin ende nuk është kryer pagesa, **në vlerë totale 901,174 lekë**, nga të cilat 865,850 lekë detyrimi për largim të padrejtë, 30,270 lekë shpenzime gjyqësore dhe 6,054 lekë shpenzime përmbarimore.

Çështje gjyqësore në proces me objekt kthimin në punë

Sipas ZVAP Kavajë, nuk ka asnjë proces gjyqësor për largim të padrejtë të punonjësve nën juridiksionin e kësaj zyre.

Viti	Data e vendimit	Data e njoftimit për ekzekutim	Detyrimi për largimin e padrejtë	Vlera e shpenzimeve gjyqësore	Vlera e Shpenzimeve Përmbaruese	Total	Paguar	Data e Pagesës

2019	Nr. (82-2015-1167) 1326, datë 07.12.2015	25.06.2019	641,119	43,500	82,163	**766,853**[40]	po	Urdhër pagesa nr. 222, datë 01.10.2019
2019	12-2019-1579/402 datë 31.07.2019	11.11.2019	864,850	30,270	6,054	**901,174**	**jo**[41]	-

Për gjetjet e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi:
-V.L. ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës,
-Xh.B., Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë,
-N.H., Specialiste e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë
-S.Gj., Specialiste e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë
-E.M., Specialiste e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë
-M.C., Specialiste e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë
-Anëtarët e komisioneve të shkollave për të cilat janë identifikuar parregullsi.

ZVAP DURRËS

Nga auditimi konstatohet se për shkollat që ZVAP Durrës ka në juridiksion, **nga 55 prej tyre, 10 drejtorë** janë të komanduar me vendime që datojnë që në periudha të mëparshme. Më hollësisht, lista e shkollave dhe datat e komandimit të drejtorëve paraqiten si më poshtë[42]:

NR	Emër Mbiemër	Shkolla	DATA	STATUSI
1	K.K.	**JUSUF PUKA**	29.06.2020	komanduar
2	E.Ç.	MARIE KAÇULINI	26.09.2019	komanduar
3	F.Z.	DEMOKRACIA	27.07.2020	komanduar
4	S.Y.	**BAJRAMC.**	26.09.2019	komanduar
5	L.K.	**MYSLYM HIDA**	28.12.2016	komanduar
6	M.D.	**BAJRAM GASHI**	25.01.2020	komanduar
7	J.Xh.	**REXHEP MEZINI**	13.09.2017	komanduar
8	B.H.	**OLSI LASKO (KOHE TE SHKURUAR)**	24.10.2016	vakant
9	M.Xh.	**DOM NIKOLLË KAÇORRI**	01.10.2012	komanduar
10	A.A.	GJIMNAZI MANEZ	30.09.2019	komanduar
11	E.Z.	**BENARDINA QERRAXHIJA**	29.06.2020	komanduar

Si rezultat, ekzistojnë **3 shkolla** nën juridiksionin e ZVAP Durrës në të cilat drejtuesi vijon të jetë i komanduar, dhe nuk rezultojnë të jenë bërë shpalljet për emërimin e drejtuesve të shkollave respektive.

Për sa i përket shpalljeve të bëra nga DRAP Durrës për vitin 2020, nga ZVAP Durrës procesi ka **konkluduar me emërim vetëm për 2 shkoll**a, përkatësisht shkolla Nënë Tereza dhe Naim Frashëri. Për **rastet e tjera procesi është anulluar.**

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 1,** nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vorë, Klos, Mat,Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Krujë, dhe Tiranë. Kjo shpallje **nuk** është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZVAP Durrës, pasi nga auditimi rezultoi se institucioni **nuk disponon një faqe web-i.** Nëpërmjet kësaj shpallje, për **ZVAP Durrës** janë shpallur **4 pozicione të lira** për drejtor të shkollave si më poshtë:

Jusuf Puka,
Nënë Tereza,
Naim Frashëri

[40] Sipas përllogaritjeve totali duhet të ishte 766,782 lekë, por vlera e ekzekutuar nga ZVAP është marë sipas përllogaritjeve që ka bërë përmbëruesi.
[41] Për këtë, Zyra Përmbarimore Kavajë, sipas urhdrit nr 1136, prot në Degën Kavajë datë 17.12.2019 ka vendosur urdhrin e sekuestrës për llogarinë e palës Zyra Arsimorë Kavajë për mos ekzekutimin e urdhrit të gjykatës së Rrethit Kavajë, nr. 402, datë 31.07.2019
[42] Shkollat me bold janë shkollat në të cilat është bërë shpallja për drejtor

Benardina Qerraxhia,

Çështja B e pikës 2 të shpalljes nr.1 përcakton se dokumentacioni i aplikimit i përcaktuar në pikën 2, të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-et përkatëse **jo më vonë se data 17.08.2020.**

Pika 3 **përcakton se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datën 21 dhe 24 Gusht 2020.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

Grupi i auditimit shqyrtoi **4 dosjet** e vendosura në dispozicion nga ZVAP Durrës mbi procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore nën juridiksionin e kësaj zyre arsimore, për **Shpalljen nr.1**, ku në të 4 dosjet u konstatuan parregullsi, trajtuar si më poshtë:

Shkolla JUSUF PUKA

Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : ***"****Komisioni përbëhet nga:*

a) kryetari i bordit të IPAP;

b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;

c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;

d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 1254, datë 09.08.2020, ZVAP Durrës ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e Vlerësimit të drejtorit për shkollën "Jusuf Puka". Në vijim **nuk** disponohet komunikim shkresor nga Bashkia mbi përfaqësuesin e përzgjedhur prej tyre.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Referuar procesverbalit të mbajtur në shkollën 9-vjecare "Jusuf Puka", më datë 17.08.2020, ora 09.00, në këtë shkollë është mbledhur Këshilli i Mësuesve për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin të pranishëm në Komisionin për Konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Jusuf Puka". Sipas procesverbalit, në votim kanë marr pjesë 15 nga 22 mësues.

Në këtë procesverbal përcaktohen dy mësuesit e mëposhtëm, të cilët u zgjodhën me votim të fshehtë për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:

Z.I.P.

Znj. A.Th.

Me anë të shkresës nr. 1359. prot, datë 17/08/2020 me lëndë "Kërkesë për miratimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve në konkursin për drejtues shkolle në 9-vjecare "Jusuf Puka", Shkolla 9-vjecare Jusuf Puka i kërkon ZVAP Durrës miratimin e Komisionit të Vlerësimit si më poshtë:

N.R., Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore- (Anëtare)

E.M., Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor- (Anëtare)

I.B., Kryetar i Këshillit të Prindërve- (Anëtar)

I.P., Mësuesi më i vjetër në Institucion- (Kryetar Komisioni)

A.Th., Mësues -(Anëtare)

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me anë të shkresës Nr. 1365 prot. datë 18.08.2020 "Njoftim për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për drejtues", ZVAP Durrës ka njoftuar DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatën e

Arsimit, se më datë 19.08.2020, duke filluar nga ora 09.30, në ambientet e shkollës 9 vjeçare "Leonik Tomeo" zhvillohen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues të institucioneve arsimore "Nënë Tereza", "Naim Frashëri", "Jusuf Puka", "Benardina Qerraxhia" si dhe për pjesëmarrje të një përfaqësuesi nga këto institucione për monitorimin dhe vëzhgimin e zbatimit të dispozitave të udhëzimit të MASR gjatë këtij procesi.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 50/1, nr.1373/1 prot., datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Jusuf Puka", Drejtori i ZVAP Durrës, Znj. J.M., ka urdhëruar:

1. Miratimin e Komisionit të Vlerësimit në konkursin për drejtues shkolle në shkollë Jusuf Puka, si më poshtë:

N.R. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar)

E.M.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)

I.B.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)

I.P.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)

A.Th.-Mësues (Anëtare)

Komisioni te shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor Jusuf Puku, sipas shtojcës 5 të udhëzimi dhe shpalljen e pikëve për çdo aplikant sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Mbledhja 1. Më datë 19.08.2020 është mbajtur një procesverbal midis Komisionit të Vlerësimit dhe përfaqësuesit të ZVAP Durrës, Znj.R.H., sipas të cilit Komisionit i janë dorëzuar dosjet e kandidatëve të mëposhtme:

B.C.

B.M.

D.S.

A.B.

L.Sh..

Sipas pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, Komisioni ka bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimi. Referuar procesverbalit, anëtarët pjesëmarrës në këtë Komisionin ishin anëtarët e miratuar me Urdhrin 50/1, të Drejtorit të ZVAP Durrës, një përfaqësuese e sindikatës së Arsimit dhe një përfaqësuese e DRAP Durrës, Znj. M.C..

Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt. Dosjet pasi u shqyrtuan nga Komisioni, iu dorëzuan sërish ZVA Durrës.

Procesverbali i mbajtur në mbledhjen e datës 19.08.2020 nuk rezulton i protokolluar, si dhe nuk përmban të dhëna mbi vlerësimin e dosjeve të kandidatëve nga Komisioni, lidhur me plotësinë e dokumentacionin. Në të nuk pasqyrohen dokumentet që mungojnë për secilin kandidatë.

Mbledhja 2. Në vijim, referuar procesverbalit të datës 24.08.2020 u ri mblodh Komisioni për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për pozicionin e drejtuesit të shkollës 9-vjecare Jusuf Puka. Sipas procesverbalit, kandidatja L.Sh. pas njoftimit nëpërmjet e-mailit në datë 20.08.2020 për mungesë paraqitje dokumentacioni, përsëri rezulton me mungesë dokumentacion. Në këtë takim, referuar procesverbalit, ka qenë pjesëmarrës edhe një vëzhgues i ZVAP Durrës Znj. L.K., **në kundërshtim me** përcaktimet e udhëzimit nr.2 mbi pjesëmarrësit në mbledhjet e komisionit.

Procesverbali i mësipërm, nuk përmban të dhëna të tjera mbi mbledhjen e zhvilluar nga Komisioni i Vlerësimit të dosjeve, si dhe nuk pasqyron dokumentacionet që mungojnë për kandidaten L.K..

Në dosjen e shkollës "Jusuf Puka", nuk gjendet e-maili i dërguar kandidateve me mungese dokumentacioni për plotësimin e tyre. Nga kontakti me stafin në ZVAP Durrës, e-maili i është dërguar nga anëtarët e Komisionit dhe nuk gjendet në arkivat e këtij institucioni. Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*".

Mbledhja 3 (vlerësimi dosjeve dhe intervistimi i kandidatëve)

Më pas, referuar procesverbalit të mbajtur më datë 26.08.2020 Komisioni i Vlerësimit për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Jusuf Puka", është mbledhur sërisht. Sipas këtij procesverbali:

Kandidatja L.K. nuk është paraqitur pranë Komisionit

Kandidatët e tjerë u vlerësuan si më poshtë:

B.C. -16.4 pikë

B.M.- 26.8 pikë

D.S. -18 pikë

A.B. -17 pikë

Procesverbali i mbledhjes së tretë është i pa protokolluar. Proceverbali i mbledhjes së tretë, në të cilën është bërë vlerësimi i dosjeve dhe intervistimi i kandidatëve, është firmosur nga 4 nga 5 anëtarë të Komisionit. Në procesverbal nuk është argumentuar arsyeja përse Znj. N.R. – Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar) **nuk** ka firmosur. Në dosje nuk disponohet informacion lidhur me shkresën e njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës dhe pyetjet e intervistës së strukturuar.

Nga verifikimi i dosjeve, lidhur me regjistrimin dhe certifikimin e kandidatëve nga Shkolla e Drejtorëve:

Kandidati D.S. është i pajisur me vërtetimin e IZHA,

Kandidati A.B. është i pajisur me vërtetimin (konfirmimin) e pranimit në Shkollën e Drejtorëve,

Kandidatja B.C. është e pajisur me vërtetimin (konfirmimin) e pranimit në Shkollën e Drejtorëve,

Kandidatja B.M. është e pajisur me vërtetimin e aplikimit në Shkollën e Drejtorëve.

Në dosjen "Jusuf Puka", gjenden vlerësimet për kandidatët nga anëtarët e komisionit, sipas shtojcës 5, të përmbledhura nga grupi i auditimit në tabelën e mëposhtme:

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes	Pikët e intervistës nga K.V.	Pikët e fazës së parë
B.M.	17.6	9.2	26.8
D.S.	14.8	3.2	18
A.B.	14.2	2.8	17

Në dosjen e shkollës "Jusuf Puka" rezulton shtojca 6, në të cilën janë paraqitur rezultatet finale të kandidatëve, të firmosura nga anëtarët e Komisionit.

Në ZVAP Durrës, nuk gjendet formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 5) për kandidaten Znj. B.C., nga Komisioni i Vlerësimit për pozicionin e drejtorit në shkollë "Jusuf Puka". Formularët e vlerësimit të kandidatëve të tjerë, sipas shtojcës 5, nuk janë të firmosur nga anëtarët e komisionit.

Në përfundim të procedurës më datë 26.08.2020, në dosjen e shkollës "Jusuf Puka", nuk identifikohet procesverbali për dorëzimin e dosjeve nga Komisioni i Vlerësimit tek ZVAP Durrës.

Finalizimi i procedurës-Anulimi i procedurës

Ankimimet

Më datë 27.08.2020, kandidatja B.C. ka depozituar në ZVAP Durrës, shkresën me lëndë "Kërkesë për ankimin", nr. 1495 prot., datë 27.08.2020, sipas të cilës kërkon:

Të rishikohen pikët e dosjes së sajë dhe t'i komunikohen pikët e intervistës. Sipas saj, dosja e saj vlerësohet 14.5 pikë, sipas të dhënave të paraqitura në dosje.

Të pajiset me certifikatën e administrimit, kërkesë e bërë në datë 14.08.2020.

Referuar shkresës së mësipërme, Znj. B.C. shprehet se kandidatura e saj për drejtor në shkollën "Naim Frashëri", ka një diferencë të madhe pikësh krahasuar me kandidaturën për drejtor në shkollën "Jusuf Puka".

Më datë 27.08.2020 kandidati D.S., me shkresë të protokolluar në ZVAP Durrës nr. 1466 prot., datë 27.08.2020, i ka drejtuar Komisionit të Vlerësimit ankimin si më poshtë:

Gjatë procedurave të konkurrimit janë shkelur Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 21.08.2020, është **shkelur** ky udhëzimin në kreun I, shkronja B e pikës 1.D, ku citohen kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e dorëzimit (Të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e IPAP dhe të jetë certifikuar pas hyrjes në fuqi të pikës 2 neni 55 të ligjit 69/2012, i ndryshuar).

Është shkelur Kreu III, pika 1 e këtij udhëzimi ku thuhet: në rast mungese të aplikantëve për kandidat të IPAP të pajisur me certifikatën e drejtorëve, apo që nuk kanë mbaruar programin e trajnimit të drejtorëve kryer nga IZHA në vitin 2016, për pozicionet e lira si drejtues në IPAP aplikojnë dhe emërohen kandidatë të cilët plotësojnë kriteret sipas pikave a,b,c të pikës 1 të shkronjës B të këtij udhëzimi.

Është shkelur pika C/4 e Kreut I të këtij Udhëzimi ku citohet: "Njëri prej dy mësuesve, me përvojë më të gjatë në atë IPAP, drejton komisionin." Kryetari i Komisionit, z. I.P., nuk rezulton të jetë mësuesi me përvojë më të gjatë në këtë IPAP. Mënyra se si komisioni kishte strukturuar pyetjet, ku në udhëzim përcaktohet qartë në pikën C/10.e: Realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidatë për fushat e njohurive dhe aftësive për drejtimin e IPAP-së dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve për këtë IPAP lë hapësirë për hamendësimi të **shkeljes** së shtojcës 3/1 të këtij udhëzimi ku anëtarët e komisionit kishin njohje të mira me njërin prej kandidatëve për konkurrim e cila vinte nga brenda shkollës.

Nga Komisioni i marrjes në shqyrtim të dosjes së kandidatëve **nuk** na është bërë me dije pikët e vlerësimit të dosjes si dhe nuk na është dërguar dokumentacionin përkatës (plani vjetor i shkollës, plani afatmesëm i shkollës si dhe raporti vjetor i IPAP), i cili sipas udhëzimit i vihen në dispozicion kandidatëve nga shkolla.

E njëjta ankesë, si më sipër, është depozituar edhe nga kandidati A.B. më datë 27.08.2020, protokolluar në ZVAP Durrës me nr.1467 prot., datë 27.08.2020.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Në vijim të sa më sipër, Sektori i Shërbimeve të ZVAP Durrës ka shqyrtuar procedurën e ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të kandidateve për drejtor të shkollës Jusuf Puka. Grupi i auditimit **nuk** identifikoi në dosjen e shkollës "Jusuf Puka" procesverbalin e mbajtur nga Sektori i Shërbimeve të ZVAP Tiranë mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të dosjeve për kandidatët e kësaj shkolle. Pas kërkesës, grupit të auditimi ju vunë në dispozicion tre formularë (sipas shtojcës 5) sipas të cilëve juristja në ZVAP, kishte rivlerësuar tre kandidatë që kishin marrë pjesë në këtë konkurs. Këto formularë janë të pa protokolluar Sipas rivlerësimit nga juristja në ZVAP Durrës (pikët e intervistës janë të njëjta):

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes sipas rivlerësimit	Pikët nga vlerësimi i dosjes sipas rivlerësimit	Pikët e intervistës	Pikët e fazës së parë sipas rivlerësimit	Pikët e fazës së parë sipas Komisionit
B.M.	16.2	17.6	9.2	25.2	26.8
D.S.	16.9	14.8	3.2	20.1	18
A.B.	13.7	14.2	2.8	16.5	17

Për kandidaten B.C., juristja e ZVAP Durrës **nuk** ka bërë rivlerësim të dosjes.

Propozimi për anulimin e procedurës

Me anë të shkresës nr. 1504 prot., datë 31/08/2020 ZVAP Durrës i ka drejtuar DRAP Durrës shkresën me lëndë "Kërkesë për anulimin e konkursit për drejtues të Institucionit Arsimor, Jusuf Puka". Sipas shpresës, "*kjo kërkesë ka ardhur pas kontrollit në ZVAP Durrës, të procedurës së përzgjedhjes së drejtorit të shkollës "Jusuf Puka" të ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit, nisur nga ankimimet e kandidatëve. Nga kontrolli i procedurës, ZVAP konstatoi:*
Gjatë procedurës së konkurrimit janë shkelur përcaktimet e MASR-së, konkretisht:
Kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e dorëzimit të tij. Kandidati për drejtor i IPAP duhet të plotësojë kushtet si vijojnë:
të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar";
të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimi e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
Kreu III dispozitat e fundit:
Në rast mungese të aplikimeve nga kandidatet të pajisur me certifikate nga shkolla e drejtoreve, apo që kane përfunduar programin e trajnimit te drejtoreve, zhvilluar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit ne vitin 2016, për pozicionet e lira drejtor në IPAP, aplikojnë dhe emërohen kandidate të cilët plotësojnë kriteret sipas pikave "a", "b" dhe "c" të pikës 1, të shkronjës "B" të Kreut I të këtij udhëzimi.
*Gjatë procedurës së vlerësimit të kandidatëve, nga Komisioni **nuk** janë zbatuar dispozitat e përmendura më sipër. Komisioni ka pranuar kandidatë të cilët nuk kanë kryer Shkollën e Drejtorëve dhe nuk kanë përfunduar trajnimin e drejtorëve, zhvilluar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit në vitin 2016.*
*Nga rivlerësimi i dosjeve, kryer nga ZVAP Durrës, bazuar në pikën D të Udhëzimit "Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike.", është konstatuar se komisioni **nuk** ka vlerësuar drejt kandidatët."*
Për sa më sipër, drejtori i ZVAP-së ka propozuar **anulimin e procedurës së konkursit për këtë shkollë.**
Anulimi i procedurës nga DRAP Durrës
Me anë të shkresës nr. 1581 prot., datë 09.09.2020, DRAP Durrës, i ka dërguar ZVAP Durrës Vendimin nr. 66, datë 08.09.2020, sipas të cilit bazuar në kërkesën e ZVAP Durrës ka vendosur:
Anulimin e procedurës për vendin e lirë të institucioni të arsimit parauniversitar "Jusuf Puka"
Rishpalljen e procedurës sipas përcaktimit të Udhëzimit të MASR nr.2, datë 28.01.2020, Kreu I, pika F.
Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ZVAP Durrës dhe shkolla "Jusuf Puka"
Kërkesa e DRAP Durrës për rishikim të procedurës
Më tej, me anë të shkresës nr. 1735 prot., datë 14.09.2020, DRAP Durrës, i është drejtuar ZVAP Durrës sipas të cilës: "*Komisioni i Vlerësimit të dosjeve gjatë procedurës së vlerësimit paraprak të dosjeve do të vlerësojë vetëm ata kandidatë të cilët kanë të konfirmuar në rrugë shkresore nga Shkolla e Drejtorëve se kanë kaluar me sukses fazën e pranimit të dokumentacionit. Gjithashtu,*

kërkohet rishikimi i dokumentacionit të kandidatëve dhe të vazhdohet me procedurat e mëtejshme sipas Udhëzimit nr. 2."

Në vijim të sa më sipër më datë 15.09.2020, Komisioni i Vlerësimit të dosjeve ka mbajtur **tre** procesverbale drejtuar ZVAP Durrës dhe kandidatëve të cilët kanë paraqitur ankimime.

Sipas procesverbalit për kandidaten B.C. komisioni është shprehur:

Pikët e dosjes janë të njëjta me pikët e dosjes së shkollës "Naim Frashëri".

Sipas Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, pika 10, a, b, c, d, e, f, g, komisioni sipas pikës f, hartoi tabelën e pikëve dhe renditi kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve në rend zbritës. Pikët sipas shtojcës nr. 6, u afishuan në këndin e njoftimeve të IPAP, njëkohësisht tabela me pikët përkatëse, shtojca nr. 6, u dorëzuar pranë ZVAP Durrës. Pajisja me certifikatë administrimi nga Komisioni i Vlerësimit të dosjeve nuk qëndron si kërkesë.

Sipas procesverbalit për kandidatin D.S., komisioni është shprehur:

Nuk janë shkelur procedurat e konkurrimit të Udhëzimit të MASR. Bazuar në këtë Udhëzim, nuk ka patur shkelje sipas Kreut I, shkronja b, pika 1.d, pasi më datë 30.07.2020, **Urdhër nr. 246** të DPAP-së,"Për procedurat e konkurrimit për drejtues të IPAP" në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar në ligjin nr. 69/2012, në pikën tre të këtij Urdhri thuhet shprehimisht: "Prioritet në rekrutimin e drejtuesve të rinj do të kenë ata kandidatë të cilët kanë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në shkollën e drejtorëve, apo janë të regjistruar."

Nuk është shkelur pika c, e Kreut I të Udhëzimit, pasi anëtarët e Komisioni janë zgjedhur me votë të fshehtë nga Këshilli i Mësuesve të IPAP dhe nga dy anëtarët e zgjedhur, Kryetari i Komisionit ka përvojën më të gjatë në shkollën "Jusuf Puka".

Komisioni drejtoi të njëjtat pyetje për të gjithë kandidatët dhe nuk ka hapësirë për shkelje të shtojcës 3/1 të këtij Udhëzimi, pasi asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk kishte konflikt interesi me asnjë nga kandidatët.

Komisioni marrës në shqyrtim të dosjeve të kandidatëve ka bërë me dije pikët e vlerësimit të dosjes pranë ZVAP Durrës dhe afishimin pranë shkollës përkatëse.

Sipas procesverbalit për kandidatin A.B., komisioni është shprehur në të njëjtën mënyrë si për ankimimin e kandidatit D.S..

Komisioni gjithashtu, më datë 15.09.2020, referuar procesverbalit për dorëzimin e dosjeve, i ka dorëzuar ZVAP Durrës dosjet e aplikantëve me më shumë pikë në këtë konkurs. Ky procesverbal është firmosur vetëm nga Kryetari i komisionit.

*Procesverbalët me anë të të cilëve Komisioni është shprehur për ankimimet e tre kandidatëve janë firmosur **vetëm nga katër** anëtarë të komisionit. Znj.N.R., Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar) në këtë komision, **nuk** i ka firmosur procesverbalët. Procesverbalët e mbajtur më datë 15.09.2020, pas shkresës së DRAP Durrës e cila kërkon rishikimin e dokumentacionit dhe vijimin e procedurës për shkollën "Jusuf Puka", janë të paprotokolluara.*

Lënia në fuqi e Urdhrit nr. 66, për anulimin e procedurës

Në vijim të sa më sipër, ZVAP Durrës, me anë të shkresës nr. 1864 prot., datë 21.09.2020, i ka dorëzuar DRAP Durrës dosjet e dy aplikantëve me më shumë pikë për konkursin Drejtor i institucionit arsimor "Jusuf Puka". Bashkëlidhur me këtë shkresë janë përcjellë edhe procesverbalet e mbajtura nga komisioni.

Me tej, DRAP Durrës me anë të shkresës nr. 1957 prot., datë 25.09.2020, i ka përcjellë ZVAP-së Durrës, Vendimin nr. 81, datë 23.09.2020 "Për anulim të procedurës për drejtor të IPAP" sipas të cilët ka vendosur:

Lënien në fuqi të Vendimit nr. 66, datë 08.09.2020 të drejtorit të DRAP Durrës, për arsye se gjatë rivlerësimit të dosjeve KVD ka llogaritur gabim pikët e kandidatëve.

Rishpalljen e procedurës sipas Udhëzimit të MASR nr. 2, datë 28.01.2020, Kreu I pika f.
Komisioni i disiplinës në IPAP "Jusuf Puka" të marrë masë disiplinore ndaj Kryetarit të KVD-së për shkelje të Udhëzimit nr.2, Kreu I, pika c/10.
Tërheqje vëmendje ndaj specialistit të shërbimit të ZVAP Durrës, për mos përmbushje të detyrimeve sipas Kreut I, pika d/1, të Udhëzimit nr.2
Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ZVAP Durrës dhe IPAP "Jusuf Puka".
Në mënyrë të përmbledhur parregullsitë në procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës Jusuf Puka, janë përmbledhur si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Jusuf Puka është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Durrës. Dokumentacioni ishte i shpërndarë dhe u sistemua gjatë vizitës së grupit të auditimit në këtë ZVAP. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion, dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës.
Procesverbali i mbajtur në shkollën Jusuf Puka mbi përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin pjese e Komisionit të Vlerësimit është i pa protokolluar.
Në këtë dosje, **nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku të ishte përcaktuar Znj. N.R., si përfaqësues i kësaj njësi në Komisionin për përzgjedhjen e drejtoret të shkollës Jusuf Puka. Vërehet se shkolla Jusuf Pukës i ka propozuar ZVAP Durrës edhe përfaqësuesin e njësi vendore për të qenë pjesë e Komisioni të Vlerësimit.
Në vijim të Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, dhe shkresës së ZVAP Durrës nr. 1254, prot., datë 09.08.2020, në mbledhjen e dytë dhe të tretë (në këtë mbledhje është bërë vlerësimi dosjeve dhe intervistimi i kandidatëve) të Komisionit të Vlerësimit **nuk** ka patur përfaqësues të DPAP-së dhe DRAP Durrës, pasi ajo ka qenë pjesë **vetëm** në mbledhjen e parë, për marrjen në dorëzim të dosjeve dhe identifikimin e mangësive në dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët. Në përgjigje të pyetësorit të përcjellë për DRAP Durrës, me shkresën nr. 1745/1, datë 03.11.2020, në listën e përfaqësuesve të DRAP Durrës në procedurat e konkurrimit për drejtuesit e institucioneve arsimore, nuk është përfshirë ky përfaqësues për shkollën "Jusuf Puka".
Në këtë takim, referuar procesverbalit, ka qenë pjesëmarrës edhe një vëzhgues i ZVA Durrës Znj. L.K., **në kundërshtim me** përcaktimet e udhëzimit nr.2 mbi pjesëmarrësit në mbledhjet e komisionit.
3 procesverbalet e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, për mbledhjet 1, 2 dhe 3, janë të pa protokolluar.
Procesverbali i mbledhjes së parë të Komisioni (datë 19.08.2020) **nuk** përmban të dhëna mbi vlerësimin e dosjeve të kandidatëve nga Komisioni lidhur me plotësinë e dokumentacionin, si dhe **nuk** pasqyron dokumentacionet që mungojnë për secilin prej kandidatëve.
Procesverbali i dytë **nuk** pasqyron dokumentacionet që mungojnë për kandidaten L.K..
Procesverbali i mbledhjes së tretë, në të cilën është bërë vlerësimi i dosjeve dhe intervistimi i kandidatëve **nuk** është i firmosur nga Znj. N.R. -Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore. Në të **nuk** evidentohet procesi i vlerësimit të dosjeve, ai i intervistimit të kandidatëve dhe pyetjet e intervistës së strukturuar.
Në ZVAP Durrës, nuk gjendet formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 5) për kandidaten Znj. B.C., nga Komisioni i Vlerësimit për pozicionin e drejtorit në shkollë "Jusuf Puka".
Formularët e vlerësimit të kandidatëve të tjerë, sipas shtojcës 5, nuk janë të firmosur nga anëtarët e komisionit.
Në përfundim të procedurës më datë 26.08.2020, në dosjen e shkollës "Jusuf Puka", nuk identifikohet procesverbali për dorëzimin e dosjeve nga Komisioni i Vlerësimit tek ZVAP

Durrës.
Drejtori i ZVAP Durrës, në kërkesën për anulim të procedurës ka cituar Kreun III të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, **në mënyrë të pasaktë**, pasi Kreu III i këtij udhëzimi ka ndryshuar me udhëzimin Nr. 7, datë 19.03.2020.
Procesverbalet me anë të të cilëve Komisioni është shprehur për ankimimet e tre kandidatëve janë firmosur **vetëm nga katër** anëtarë të komisionit. Znj.N.R., Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar) në këtë komision, **nuk** i ka firmosur procesverbalët. Procesverbalët e mbajtur më datë 15.09.2020, pas shkresës së DRAP Durrës e cila kërkon rishikimin e dokumentacionit dhe vijimin e procedurës për shkollën "Jusuf Puka", janë të pa protokolluara.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve"
Komisioni i Vlerësimit kishte përbërje si më poshtë:
- Z. I.P., Kryetar Komisioni
- Znj.N.R., Anëtare
- Znj. E.M., Anëtare
- Znj. I.B., Anëtare
- Znj. A.Th., Anëtare

Përfaqësuesi i ZVAP Durrës, në Komisioni ishte Znj. L.K..
Znj. R.H., ka rishqyrtuar procedurën e ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit.
Përfaqësuese e DRAP Durrës, Znj. M.C.
Drejtori i ZVAP Durrës, Znj.J.M.
Ish Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Shkolla NAIM FRASHËRI

Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 1254, datë 09.08.2020, ZVAP Durrës ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e

Vlerësimit të drejtorit për shkollën "Naim Frashëri". Në vijim nuk disponohet komunikim shkresor nga Bashkia mbi përfaqësuesin e përzgjedhur prej tyre, dokument i cili u përcoll për grupin e auditimit pas dorëzimit të akt konstatimeve, me observacionet përkatëse. *Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit*

Referuar procesverbalit të mbajtur në shkollën 9-vjecare "Naim Frashri", më datë 17.08.2020, ora 08:30, në këtë shkollë është mbledhur Këshilli i Mësuesve për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin të pranishëm në Komisionin për Konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Naim Frashëri". Sipas procesverbalit, në votim kanë marr pjesë 31 nga 49 mësues.

Në këtë procesverbal përcaktohen dy mësuesit e mëposhtëm, të cilët u zgjodhën me votim të fshehtë për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:

Znj. M.Ç., Mësuesi më i vjetër në institucion.

Znj. M.L., Mësues.

Me anë të shkresës nr. 420. prot, datë 17/08/2020 me lëndë "Kërkesë për miratimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve në konkursin për drejtues shkolle në 9-vjecare "Naim Frashëri", Shkolla 9-vjecare "Naim Frashëri" i kërkon ZVAP Durrës miratimin e Komisionit të Vlerësimit si më poshtë:

E.L. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar)

I.I.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)

F.Z.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)

M.Ç.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)

M.L.-Mësues (Anëtare)

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me anë të shkresës Nr. 1365 prot. datë 18.08.2020 "Njoftim për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për drejtues", ZVAP Durrës ka njoftuar DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatën e Arsimit, se më datë 19.08.2020, duke filluar nga ora 09.30, në ambientet e shkollës 9 vjeçare "Leonik Tomeo" zhvillohen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues të institucioneve arsimore "Nënë Tereza", "Naim Frashëri", "Jusuf Puka", "Benardina Qerraxhia" si dhe për pjesëmarrje të një përfaqësuesi nga këto institucione për monitorimin dhe vëzhgimin e zbatimit të dispozitave të udhëzimit të MASR gjatë këtij procesi. Në vijim të saj, **nuk** disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 50/2, nr.1373/2 prot., datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Naim Frashëri", Drejtori i ZVAP Durrës, Znj. J.M., ka urdhëruar:

Miratimin e Komisionit të Vlerësimit në konkursin për drejtues shkolle në shkollën Naim Frashëri, si më poshtë:

E.L. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar)

I.I.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)

F.Z.- Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)

M.Ç.- Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)

M.L.-Mësues (Anëtare)

Komisioni te shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor Naim Frashëri, sipas shtojcës 5 të udhëzimi dhe shpalljen e pikëve për çdo aplikant sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Mbledhja e parë

Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Referuar proceverbalit të mbajtur më datë 19.8.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor në gjimnazin "Naim Frashëri", kanë dorëzuar dosje 3 kandidatë:
J.N. (Xhavora)
E.Xh.
B.C.
Gjatë punës Komisioni u përqëndrua në dy faza:
Faza 1- Pranimi i dosjeve të kandidatëve
-Shqyrtohet për pranim dosja e kandidatit J.N., Komisioni vendosi të pranojë dosjen e kandidates në fjalë, por i mungon certifikata e trajnimit të detyrueshëm përgatitor për shkollën e drejtorëve. Sipas Udhëzimit nr 2, dt. 28.01.2020 do të informohet në rrugë elektronike për mangësitë në dosje.
-Shqyrtohet për pranim dosja e kandidates B.C, Komisioni vendosi të pranohet dosja e kandidates në fjalë, por dosja ka probleme me noterizimin e dokumentacionit për të cilin do të njoftohet në rrugë elektronike.
-Shqyrtohet për pranim dosja e kandidates E. Xh., Komisioni vendosi të pranohet dosja e kandidates në fjalë pasi i plotëson të gjitha të dhënat.
Faza 2- Vlerësimi (pikëzimi) i dosjes së kandidatëve
Vlerësimi i dosjes së kandidates J.N., sipas tabelës së vlerësimit (shtojca 5 e Udhëzimit në fjalë) kandidatja u vlerësua me 11 pikë, duke mos përfshirë pikët e intervistës.
Vlerësimi i dosjes së kandidates E. Xh., sipas tabelës së vlerësimit (shtojca 5) kandidati u vlerësua me 27.4 pikë, duke mos përfshirë pikët e intervistës.
Vlerësimi i dosjes së kandidates B.C. do të bëhet në fazën pasardhëse.
Procesverbali i mësipërm është firmosur vetëm nga Kryetari i Komisionit dhe 3 anëtar. Z. I.I.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor **nuk** e ka firmosur procesverbalin në fjalë. Ky procesverbal është i paprotokolluar.
Mbledhja 2
Më pas, referuar procesverbalit të mbajtur më datë 24.08.2020, Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shkollës "Naim Frashëri", ka zhvilluar fazën e dytë të vlerësimit të dosjeve. Sipas procesverbalit:
Komisioni ka vlerësuar dosjen e kandidates B.C., e cila u vlerësuar me 12.8 pikë. Sipas Komisionit, kandidatja ka aplikimin për Shkollën e Drejtorëve
Dosja e kandidates E.Xh. është vlerësuar në fazën e parë. Sipas Komisionit, kandidatja ka diplomë të Shkollës së Drejtorëve.
Dosja e kandidates J.N. është vlerësuar në fazën e parë. Sipas Komisionit, kandidates i mungon aplikimi dhe diploma e Shkollës së Drejtorëve.
Procesverbali i mësipërm, është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe nga përfaqësuesi i ZVAP Durrës, Znj. L.K., **në kundërshtim me** përcaktimet e udhëzimit nr.2 mbi pjesëmarrësit në mbledhjet e komisionit.
Procesverbali i mësipërm është i paprotokolluar
Intervistimi i kandidatëve
Referuar procesverbalit të mbajtur në datë 26.08.2020, i mbajtur për zhvillimin e fazës së tretë të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës "Naim Frashëri":

Komisioni kishte përgatitur rreth 5 pyetje mbështetur në bazë ligjore.
Kandidatja e parë që u intervistua ishte J.N. e cila u vlerësua me 6 pikë, nga 10 pikë të mundshme. Nga 5 pyetje, kandidatja ju përgjigje saktë 3 pyetjeve, ndërsa për dy pyetje nuk u përgjigje.
Kandidatja e dytë që u intervistua është E.Xh. e cila u vlerësua me 10 pikë. Nga 5 pyetje, kandidatja ju përgjigje saktë të 5 pyetjeve.
Kandidatja e tretë që u intervistua është B.C., që sipas komisionit u vlerësua me 6 pikë. Nga 5 pyetje kandidatja ju përgjigj saktë, 3 pyetjeve dhe dy pyetjeve nuk ju përgjigje.
Në dosje gjenden pyetjet e intervistës së strukturuar, bazuar në fushat e përcaktuara në Shpalljen Nr. 1.
Komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes	Pikët e intervistës nga K.V.	Pikët e fazës së parë
B.C.	12.8	6	18.8
J.N.	11	6	17
E.Xh.	27.4	10	37.4

Nga shqyrtimi i dosjes së aplikantes E.Xh., rezulton se vërtetimi se nuk ka masë disiplinore në fuqi është lëshuar nga J.M., Drejtore e Zyrës Vendore Tiranë dhe jo nga DRAP Durrës. Aplikantja ka qenë në pozicionin e drejtores në kohën e aplikimit.
Nga verifikimi i dosjeve, lidhur me regjistrimin dhe certifikimin e kandidatëve nga Shkolla e Drejtorëve:
Kandidatja E.Xh. është e pajisur me vërtetimin e IZHA,
Kandidatja B.C. është e pajisur me vërtetimin (konfirmimin) e pranimit në Shkollën e Drejtorëve,
Kandidatja J.N. nuk ka kryer trajnimin nga IZHA dhe nuk është rregjistruar në Shkollën e Drejtorëve.
Kandidatja E.Xh., e cila në përfundim të konkursit **është emëruar definitivisht** si drejtore e shkollës Naim Frashëri, ka përfunduar Programin e Zhvillimit të Arsimit nga IZHA.
Nga shqyrtimi i dosjes së B.C., identifikohet shkresa 1308. Prot, datë 14/08/2020 lëshuar nga ZVAP Durrës, sipas të cilës ajo ka qenë pjesëmarrëse në administrimin e provimeve të maturës shtetërore ndër vite. Sipas Komisionit të Vlerësimit, kandidatja në fjalë është vlerësuar më 0 pikë, në kategorinë "Provimet kombëtare", ndërkohë që duhej të vlerësohej me 1 pikë.
Në dosjen e shkollës "Naim Frashëri", rezulton shtojca 6, e firmosur nga anëtarët e komisionit në të cilën janë paraqitur rezultatet finale të kandidatëve, si më poshtë:

Kandidati	**Totali i pikëve në fazën e parë**
J.N.	17 pikë
E.Xh.	37.4 pikë
B.C.	18.8 pikë

Më datë 01.09.2020, referuar procesverbalit nr. 1520 prot., datë 01.09.2020, Komisioni i Vlerësimit ka dorëzuar në ZVAP Durrës dosjet e dy kandidatëve me më shumë pikë. Ky procesverbali është firmosur vetëm nga Kryetari i Komisionit.

Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Në kundërshtim me Kreu I, Pika D.1 e Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020, i ndryshuar, Sektori i Shërbimeve në ZVAP **nuk** ka shqyrtuar dokumentacionin e Komisionit mbi parregullsi të natyrës teknike, si dhe as Drejtori i ZVAP Durrës **nuk** ka autorizuar një person për të kryer këtë procedurë. Stafi i ZVAP Durrës, është shprehur se në këtë ZVAP, Komisioni i Vlerësimit ngrihet

vetëm në rastet ku ka indicie për parregullsi në proces, si në rastin e shkollës "Jusuf Puka". Rrjedhimisht, parregullsitë e lidhura me këtë proces **nuk** janë identifikuar dhe konkurrimi ka kaluar në fazën tjetër.

Intervistimi i kandidatëve në DRAP Durrës

Më datë 02.09.2020, me anë të shkresës nr. 1542 prot., datë 02.09.2020 ZVAP Durrës i ka dorëzuar DRAP Durrës dosjet e dy aplikantëve me më shumë pikë për konkursin drejtor i institucionit arsimor "Naim Frashëri".

Referuar procesverbalit të mbajtur, më datë 09.09.2020 është realizuar intervista në DRAP Durrës. Në përfundim është shpallur fituese Znj, E.Xh.. Me anë të vendimit nr. 72, datë 15.09.2020 është bërë **emërimi definitiv** i Znj. Xh. si drejtor shkolle.

Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës Sami Frashëri, grupi i auditimit ka evidentuar parregullsitë e përmbledhura si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Naim Frashëri është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Durrës. Dokumentacioni ishte i shpërndarë dhe u sistemua gjatë vizitës së grupit të auditimit në këtë ZVAP. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion, dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës.

Procesverbali i mbajtur në shkollën Naim Frashëri mbi përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin pjese e Komisionit të Vlerësimit, **nuk** ishte firmosur nga mësuesit të cilët kishin marrë pjesë ne votim dhe është i pa protokolluar.

Në këtë dosje, nuk u gjet shkresë e përcjellë nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku të ishte përcaktuar Z. E.L., si përfaqësues i kësaj njësi në Komisionin e vlerësimit të kandidatëve për drejtorë të shkollës Naim Frashëri. Vërehet se shkolla Naim Frashëri i ka propozuar ZVAP Durrës edhe përfaqësuesin e njësi vendore për të qenë pjesë e Komisioni të Vlerësimit, përfaqësues i cili është miratuar me Urdhrin e Drejtorit të ZVAP Durrës për të qenë pjesë e Komisionit.

Në vijim të Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, dhe shkresës së ZVAP Durrës nr. 1254, prot., datë 09.08.2020, në 3 mbledhjet e zhvilluara nga Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve **nuk** ka patur përfaqësues të DPAP-së dhe DRAP Durrës.

Në mbledhjen e komisionit të vlerësimit ka marë pjesë edhe përfaqësuesi i ZVAP Durrës, Znj. L.K., **në kundërshtim me** përcaktimet e udhëzimit nr.2 mbi pjesëmarrësit në mbledhjet e komisionit.

Mungon procesverbali i dorëzimit të dosjeve nga ZVAP Durrës, Komisionit të Vlerësimit.

3 procesverbalet e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, për vlerësimin e dosjeve dhe intervistimin, janë të paprotokolluar.

Procesverbali i mbledhjes në të cilën është bërë vlerësimi i dosjeve për dy kandidatët që në fund rezultuan me më shumë pikë, është firmosur vetëm nga 4 anëtarë. Z. I.I., Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor, **nuk** e ka firmosur procesverbalin në fjalë.

Nga auditimi rezultoi se për kandidaten Znj. E.Xh., e cila rezultoi fituese, vërtetimi se nuk ka masë disiplinore në fuqi është lëshuar nga Drejtori i ZVAP Tiranë dhe jo nga DRAP Durrës, i cili është autoriteti vendimmarrës për masat disiplinore për drejtorët e shkollave. Aplikantja ka qenë në pozicionin e drejtores në kohën e aplikimit.

Komisioni i Vlerësimit **nuk** ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kandidaten B.C..

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës:

"*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve".

Kandidatja E.Xh., e cila në përfundim të konkursit **është emëruar definitivisht** drejtore e shkollës Naim Frashëri, ka përfunduar Programin e Zhvillimit të Arsimit nga IZHA (për të cilën ka paraqitur një vërtetim para komisionit) dhe **jo atë** të **Shkollës së Drejtorëve**. Në dosjen e Znj. Xh., si dhe nga konfirmim i ardhur me e-mail nga ZVAP Durrës rezulton se, ajo **nuk** ka paraqitur dokument për regjistrimin në Shkollën e Drejtorëve apo certifikimin nga kjo shkolle, para Komisionit. Në procedura **të tjera**, kur kandidatët **nuk kanë qenë të regjistruar** në shkollën e Drejtorëve apo **certifikuar** prej saj, ish- Drejtori i DRAP Durrës ose ka **pezulluar** procedurën si në rastin e shkollës Karpën në ZVAP Kavajë, ose **e ka anuluar** atë si në rastin e shkollës Mustafa Gjestila në ZVAP Mat.

Në kundërshtim me Kreu I, Pika D.1 e Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020, i ndryshuar, Sektori i Shërbimeve në ZVAP **nuk** ka shqyrtuar dokumentacionin e Komisionit mbi parregullsi të natyrës teknike, si dhe as Drejtori i ZVAP Durrës **nuk** ka autorizuar një person për të kryer këtë procedurë. Rrjedhimisht, parregullsitë e lidhura me këtë proces nuk janë identifikuar dhe konkurrimi ka kaluar në fazën tjetër duke konkluduar në emërimin definitiv të Znj. E.Xh., si drejtore e shkollës Naim Frashëri.

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion grupit të auditimit, më datë 27.10.2020 nga Z. B.G. dhe në dijeni Znj. J.M., Znj. E.Xh. rezulton e emëruar definitive si drejtore e shkollës Naim Frashëri më datë 23.06.2020, duke mos përcjellë saktë informacioni. Pasi, nga auditimi konstatohet se, pas dorëheqjes së znj. B. M më datë 03.04.2020 nga pozicioni drejtor i shkollës Naim Frashëri në Durrës, më datë 10.04.2020 DRAP Durrës ka komanduar në këtë pozicion z. I.P. (në atë kohë zv. Drejtor i Shkollës Naim Frashëri), Sipas Urdhërit të komandimit të përkohshëm të Z. I.P., ai do të qëndronte në pozicionin e drejtorit të shkollës Naim Frashëri deri në normalizimin e situatës nga COVID -19 dhe përfundimit të procesit të konkurrimit. Megjithatë, DRAP Durrës ka **shkarkuar** nga ky pozicion Z. I.P. dhe ka **emëruar përkohësisht** Znj. E.Xh. më datë 22.06.2020, e cila në atë periudhë ishte drejtore e shkollës Jusuf Puka në Durrës, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit. Pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit, Znj. E.Xh. është emëruar definitivisht në pozicionin drejtor i shkollës Naim Frashëri. Nga kontakti me ZVAP Durrës, konstatohet se Z. I.P. nuk ka paraqitur dorëheqje për largim nga pozicioni. Ngelet i pakuptuar shkarkimi i Z. I.P. dhe emërimi i përkohshëm i Znj. E.Xh. në këtë pozicion

Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:
M.Ç.- (Kryetar Komisioni)
E.L. – (Anëtar)
I.I.- (Anëtar),
F.Z.- (Anëtar)
M.L.- (Anëtare)
Përfaqësuesi i ZVAP Durrës, pjesëmarrëse në mbledhjen e Komisionit të Vlerësimit, Znj. L.K..
Drejtori i ZVAP Durrës, Znj.J.M.
Ish Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Shkolla "NËNË TEREZA"

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*

a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Pas shpalljes **nr. 1**, nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", për pozicionin e lirë të Drejtorit të Shkollës **Nënë Tereza,** në dosjen e procedurave të ndjekura për vlerësimin e kandidatëve, mungon shkresa sipas së cilës ZVAP Durrës ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Nënë Tereza". Ky dokument ju vendos grupit më vonë në dispozicion. Me shkresa nr. 1254, datë 09.08.2020, ZVAP ka njoftuar Bashkinë Durrës për përcaktimin e përfaqësuesve në 4 shkolla, brenda datës 17.08.2020. Në dosje **nuk** disponohet shkresa sipas së cilës Bashkia Durrës ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë, dukument i cili u përcoll për grupin e auditimit pas dorëzimit të akt konstatimeve, me observacionet përkatëse.
Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit
Me anë të procesverbalit datë 17.08.2020, ora 09:00 të pa protokolluar në shkollën Nënë Tereza, është njoftuar se pas votimit, 2 mësuesit të caktuar për pjesëmarrje në Komision, do të ishin znj. M.K., mësuesi më i vjetër në shkollë dhe znj. A.C., mësues.
Me anë të shkresës nr. 217, prot datë 17.08.2020 të Shkollës Nënë Tereza, përcjellë pranë ZVAP Durrës, janë përcjellë 5 përfaqësuesit për komisionin e vlerësimit.
Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore
Me shkresën nr. 1365, prot datë 18.08.2020, është përcjellë pranë DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatës së Arsimi shkresa ku informohen se në datë 19.08.2020 duke filluar nga ora 09.30, në ambientet e gjimnazit Leonik Tomeo, do të zhvillohen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues të institucioneve arsimore "Nënë Tereza", "Naim Frashëri", "Jusuf Puka", "Benardina Qerraxhia". Në vijim të saj **nuk** disponohet informacion nëse janë dërguar përfaqësues nga këto njësi.
Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP
Me anë të Urdhrit nr. 50/3, datë 18.08.2020, protokolluar në ZVAP Durrës sipas shkresës nr. 1373/3, datë 18.08.2020, Drejtori i ZVAP Durrës urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Nënë Tereza, si më poshtë:
1. M.K., mësuese- Kryetar
2. A.C., mësuese- Anëtare
3. B.D., kryetar i bordit- Anëtar
4. B.Q., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtare
5. I.B., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtare

Procedurat e ndjekura nga Komisioni
Vlerësimi i dosjeve
Me anë të procesverbalit nr.1 datë 19.08.2020 ndërmjet ZVAT Durrës dhe Komisionit të Vlerësimit, janë marrë në dorëzim 4 dosje të aplikantëve/kandidatëve që kanë dorëzuar dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT Durrës, për pozicionin e drejtorit shkollës

Nënë Tereza. Ky procesverbal është firmosur nga anëtarët e komisionit dhe përfaqësuesi i ZVAP Durrës, znj. R.H..
Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Sipas procesverbalit nr.1, datë 19.08.2020 kanë firmosur prezencat 5 anëtarët e komisionit, përfaqësues i Sindikatës së arsimit, z. B.Sh. dhe 1 përfaqësues i DRAP, znj. M.C..
-Referuar procesverbalit nr.2 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, ora 09.00 mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Nënë Tereza", mbajtur në shkollën Hysen Cela, për kandidaten A.R. komisioni është shprehur:
Pasi u shqyrtua dosja u vu re se ajo ishte e plotë me të gjitha kërkesat e udhëzimit nr. 2
-Referuar procesverbalit nr.3 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, ora 09.00 mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Nënë Tereza", mbajtur në shkollën Hysen Cela, për kandidaten G.C. komisioni është shprehur:
Pasi u shqyrtua dosja u vu re se ajo ishte e plotë me të gjitha kërkesat e udhëzimit nr. 2
Referuar procesverbalit nr.4 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, ora 09.00 mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Nënë Tereza", mbajtur në shkollën Hysen Cela, për kandidaten E.L. komisioni është shprehur:
Pasi u shqyrtua dosja u vu re se ajo ishte e plotë me të gjitha kërkesat e udhëzimit nr. 2
Referuar procesverbalit nr.5 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 19.08.2020, ora 09.00 mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Nënë Tereza", mbajtur në shkollën Hysen Cela, për kandidaten T.S. komisioni është shprehur:
Pasi u shqyrtua dosja u vu re se ajo kishte disa mungesa: Lista e notave, Certifikatat e noterizuara, Vërtetimi për shkollën e drejtorëve.
Në vijim Komisioni i vlerësimit ka njoftuar me shkrim kandidaten për mungesat në dokumentacionet e dorëzuara. Bashkëlidhur gjendet njoftimi për kandidaten, firmosur nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit, znj. M.K..
Referuar procesverbalit nr.6 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 21.08.2020, në vijim të shkresës së dërguar për kandidaten T.S., për plotësimin me dokumentacion komisioni është shprehur se:
Erdhi përgjigjia me email ku znj. S. është shprehur se nuk mund të dërgonte brenda afatit dokumentacionet e kërkuara dhe se ajo tërhiqet nga gara.
Bashkëlidhur procesverbalit gjendet email-i i kandidates. Për këtë komisioni ka vendosur skualifikimin e saj nga gara.
Referuar procesverbalit nr.7 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 26.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Nënë Tereza", mbajtur në shkollën Hysen Cela, komisioni është mbledhur për intervistimin e kandidatëve. Kandidatët që janë paraqitur në intervistë kanë qenë znj. E.L. dhe znj. E.R..
Kandidatja G.C. nuk është paraqitur në intervistë.
Intervistimi i kandidatëve
Në dosje **nuk** disponohet informacion për njoftimin e kandidatëve lidhur me intervistën që është zhvilluar.
Referuar procesverbalit nr.8 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 26.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Nënë Tereza", mbajtur në shkollën Hysen Cela, komisioni është mbledhur për intervistën e strukturuar. Në procesverbal komisioni është shprehur se:
Kandidatja E.L. është pyetur për:
1. A mendoni se bashkëpunimi me Komunitetin është prioritet për mbarëvajtjen e procesit mësimor edukativ. Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.

2. Nqs në shkollën që ju drejtoni ndodh një grindje verbale dhe fizike mes dy nxënëseve të shkollës, si do vepronit? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
3. Në rast se një mësues del pa normë mësimore ose ka pak orë, si do vepronit ju për të zgjidhur situatën e këtij mësuesi? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
4. Cila është risia që ju mendoni e do të sillni në shkollën ku po konkurroni\? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
5. Cili është motivi që ju nxiti për të konkurruar për drejtues shkollë dhe a keni një projekt për planin e zhvillimit të shkollës nisur nga ligji 69/2012 i arsimit parauniversitar? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
Referuar procesverbalit nr.9 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, <u>më datë 26.08.2020,</u> mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Nënë Tereza", mbajtur në shkollën Hysen Cela, komisioni është mbledhur për intervistën e strukturuar. Në procesverbal komisioni është shprehur se:
Kandidatja A.R. është pyetur për:
1. A mendoni se bashkëpunimi me Komunitetin është prioritet për mbarëvajtjen e procesit mësimor edukativ. Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
2. Nqs në shkollën që ju drejtoni ndodh një grindje verbale dhe fizike mes dy nxënëseve të shkollës, si do vepronit? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
3. Në rast se një mësues del pa normë mësimore ose ka pak orë, si do vepronit ju për të zgjidhur situatën e këtij mësuesi? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
4. Cila është risia që ju mendoni e do të sillni në shkollën ku po konkurroni\? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
5. Cili është motivi që ju nxiti për të konkurruar për drejtues shkollë dhe a keni një projekt për planin e zhvillimit të shkollës nisur nga ligji 69/2012 i arsimit parauniversitar? Në procesverbal është shpjeguar shkurtimisht edhe përgjigja e kandidates.
Sipas procesverbalit nr. 10, datë 26.08.2020 komisioni është shprehur për dosjet e aplikantëve për drejtor:
1. Pikët e aplikantëve A.R., E.L., G.C.. Pesë vlerësime për secilin aplikant nga të gjithë kandidatët.
2. Dosjet e aplikantëve E.L., A.R., G.C., T.S..
3. Procesverbalet nga 1-10.
4. Tabelat me pikët totale(vlerësime për të tre kandidatët lista e 2 kandidatëve me më shumë pikë.
Në vijim komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 dhe 6 të udhëzimit duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve në total në dy dokumente, të firmosura nga komisioni.
Dokumenti nr. 1, pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
A.R.	23	10	33
E.L.	13.9	8.2	22.1
G.C.	11.1	0	21.1

Komisioni është shprehur se "1. *kandidatja G.C. ka mbaruar studimet e larta në UT në degën e gjuhës frënge. Vendi i punës në të cilin ajo po aplikon për drejtues nuk përputhet me profilin që ka mbaruar, pasi kjo shkollë ka 535 nxënës dhe në të zhvillohet sipas kurrikulës gjuhë e huaj e I-rë: italisht dhe gjuhë e huaj e II-të: anglisht. Bazuar në udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018 për numrin e nxënësve në klasë dhe numrat e punës mësimore. Drejtorë plotëson normën me orë të profilit*."

2. Kandidatja E.L. ka mbaruar studimet në universitetin e Shkodrës në degën cikli i ulët. Vendi i punës për të cilin aplikon nuk përputhet me profilin e saj, për shkak të formimit të saj arsimor (cikël i ulët).

Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 1.09.2020, protokolluar në ZVAP Durrës me shkresën nr. 1518, datë 01.09.2020, kryetari i komisionit të vlerësimit znj. M.K. ka dorëzuar dy dosjet e kandidatëve me pikë më të larta. Ky procesverbal është firmosur vetëm nga dorëzuesja, dhe jo nga marrësi në dorëzim në ZVAP Durrës.

Me shkresën nr. 1543, prot datë 02.09.2002, Drejtori i ZVAP Durrës, znj. J.M. ka përcjellë pranë DRAP Durrës dosjet e dy aplikantëve me më shumë pikë, znj. A.R. dhe znj. E.L.. Bashkëlidhur është përcjellë procesverbali i komisionit, dhe dy dosjet e kandidatëve me më shumë pikë.

Intervistimi i kandidatëve në DRAP Durrës dhe shpallja e fituesit

Me vendimi nr.71, datë 15.09.2002 i DRAP Durrës, prot në ZVAP Durrës nr.1759, datë 16.09.2020 është urdhëruar **emërimin definitiv** në detyrë i znj. A.R..

Nga verifikimi i dosjeve të kandidatëve konstatohet se:

-Shtojca nr. 5 e udhëzimit për vendimmarrjen e komisionit gjendet në dosjet e aplikantëve, dhe jo në dosjen e komisionit.. Ajo është e firmosur nga komisioni, ku secili nga kandidatët ka dorëzuar votimin e tij për kandidaten. Votimi është i njëjtë nga të pestë anëtarët për kandidaten znj. A.R.. Për kandidaten E.L. kandidatët kanë votuar në mënyrë të ndryshme.

-Për kandidaten A.R., ka dorëzuar aplikimin për shkollën e drejtorëve (Shkolla e Drejtorëve të IAP), ku emaili i datës 20,08.2020, konfirmon pranimin e saj dhe në vijim do njoftohet për periudhën e trajnimit. Gjithashtu kandidatja ka dorëzuar edhe një vërtetim lëshuar nga MASR, datë 29.01.2020 ku përcaktohet se ajo ka përfunduar me sukses kërkesat e programit "Për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e drejtuesve të institucioneve arsimore", zhvilluar nga Instituti i zhvillimit të Arsimit me 324 orë trajnimi, të barazvlefshme me 54 ditë trajnimi.

-Kandidatja E.L. në përllogaritjen e vjetërsisë në arsim, përllogaritja e pikëve është rrumbullakosur nga komisioni (në 3 vite) në një kohë kur duhet të ishte 3.2. Lidhur me shkollën e drejtorëve, aplikantja ka deklaruar në dosje vetëm një mandat pagese i datës 06.08.2020 për llogari të shkollës së drejtorëve, i cili sipas saj është kryer për aplikimin në shkollën e drejtorëve, por nuk disponohet informacion për pranimin në këtë shkollë. Vlerësimi i mesatares është bërë 4.4. dhe jo 4.5 sikundër është mesatarja e rrumbullakosur e notave.

-Kandidatja G.C. ka dorëzuar pagesën e aplikimit për në shkollën e drejtorëve, datë 05.08;.2020. Kandidatja është vlerësuar me 4 pikë nga komisioni për dëshmi gjuhësh, në një kohë ku ky vlerësim jepet për gjuhe të mbrojtur me testim ndërkombëtar në nivelin B2. Nga verifikimi i provimit të TOEFL kandidatja ka mare 463 pikë, të cilat sipas shpjegimit po në këtë certifikatë i përkojnë vlerësimit B1 (2 pikë).Gjithashtu posedon disa certifikata në gjuhën frënge, të cilat nuk janë përkthyer, në mënyrë që të bëhet vlerësimi në dosje i nivelit të pjesëmarrjes. Kandidatja është vlerësuar nga noti lidhur me notën mesatare 3.1. pikë, në një kohë ku, nga përllogaritja e mesatares për të gjithë studimet e kryera prej saj (bashkë me masterin profesional), mesatarja duhet të ishte 3.9 pikë.

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Durrës. Dokumentacioni ishte i shpërndarë dhe u sistemua gjatë vizitës së grupit të auditimit në këtë ZVAP. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës. Dosjet e kandidatëve më të mirë të dorëzuara nga komisioni për ZVAP janë firmosur vetëm nga dorëzuesi, dhe jo marrësi në dorëzim.

Në dosje n*uk* dokumentohet shkresa nga Bashkia Durrës për përfaqësuesin e njësisë së vetëqeverisjes vendore pjesëmarrës në këtë procedurë konkurrimi.

Komisioni **nuk** rezulton të ketë vlerësuar kandidatët plotësisht konform udhëzimit nr.2, trajtuar pasaktësitë në pikëzim si më sipër.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve".
Kandidatja A.R., e cila në përfundim të konkursit **është emëruar definitivisht** si drejtore e shkollës Nënë Tereza, ka përfunduar Programin e Zhvillimit të Arsimit nga IZHA dhe **jo atë** të **Shkollës së Drejtorëve**.
Në kundërshtim me Kreu I, Pika D.1 e Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020, i ndryshuar, Sektori i Shërbimeve në ZVAP **nuk** ka shqyrtuar dokumentacionin e Komisionit mbi parregullsi të natyrës teknike, si dhe as Drejtori i ZVAP Durrës **nuk** ka autorizuar një person për të kryer këtë procedurë.
Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:
M.K., mësuese- Kryetar
A.C., mësuese- Anëtare
B.D., kryetar i bordit- Anëtar
B.Q., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtare
I.B., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtare
Drejtori i ZVAP Durrës, Znj.J.M.
Ish Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Shkolla "BERNARDINA QERAXHIA"
Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Pas shpalljes **nr. 1**, nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", për pozicionin e lirë të Drejtorit të Shkollës **Bernardina Qeraxhia,** në dosjen e procedurave të ndjekura për vlerësimin e kandidatëve, nuk disponohej shkresa sipas së cilës Bashkia Durrës ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë, dukument i cili u përcoll për grupin e auditimit pas dorëzimit të akt konstatimeve, me observacionet përkatëse.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Në dosje nuk disponohet procesverbali i votimit për shkollën Benardina Qerraxhiu, për përzgjedhjen e 2 mësuesve të caktuar për pjesëmarrje në Komision nga mësuesit e shkollës.

Me anë të shkresës nr. 90, prot datë 17.08.2020 të Shkollës Benardina Qerraxhiu, përcjellë pranë ZVAP Durrës, janë përcjellë 5 përfaqësuesit për komisionin e vlerësimit nga shkolla, por pa patur informacion se si janë përzgjedhur mësuesit dhe përfaqësuesi i Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Me shkresën nr. 1365, prot datë 18.08.2020, është përcjellë pranë DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatës së Arsimi shkresa ku informohen se në datë 19.08.2020 duke filluar nga ora 09.30, në ambientet e gjimnazit Leonik Tomeo, do të zhvillohen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues të institucioneve arsimore "Nënë Tereza", "Naim Frashëri", "Jusuf Puka", "Benardina Qerraxhia". Në vijim të saj **nuk** disponohet informacion nëse janë dërguar përfaqësues nga këto njësi.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 50, datë 18.08.2020, protokolluar në ZVAP Durrës sipas shkresës nr. 1373, datë 18.08.2020, Drejtori i ZVAP Durrës urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Benardina Qerraxhia, si më poshtë:

1. D.S., mësuese- Kryetar
2.S.B., mësues- Anëtar
3.P.P., kryetar i bordit- Anëtar
4. A.S., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtare
5. K.L., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Me anë të procesverbalit të praprotokolluar, datë 19.08.2020 ndërmjet ZVAT Durrës dhe Komisionit të Vlerësimit, janë marrë në dorëzim 6 dosje të aplikatëve/kandidatëve që kanë dorëzuar dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT Durrës, për pozicionin e drejtorit shkollës Bernardina Qeraxhia. Ky procesverbal është firmosur nga anëtarët e komisionit dhe përfaqësuesi i ZVAP Durrës, znj. R.H. dhe znj. J.K..

Më datë 19.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Sipas procesverbalit, të pa protokolluar datë 19.08.2020 kanë firmosur prezencat 5 anëtarët e komisionit.

Sipas procesverbalit (pa datë dhe numër protokolli), për kandidatin L.Sh., komisioni është shprehur se ka mungesë vlerësimi të shkallës së kualiifikimit, shkollës së drejtorëve dhe vetëdeklarimit. Ky procesverbal rezulton i firmosur **vetëm** nga 4 anëtarët e komisionit, ku vihet re se mungon firma e Kryetares së Komisionit, znj. D.S.. Sipas procesverbalit (pa datë dhe numër protokolli), për kandidaten A.G., komisioni është shprehur se ka mungesë së kartës së identitetit, shkollës së drejtorëve dhe librezës së punës. Ky procesverbal rezulton i firmosur **vetëm** nga 4 anëtarët e komisionit, ku vihet re se mungon firma e Kryetares së Komisionit, znj. D.S..

Në vijim komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 dhe 6 të udhëzimit duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve sipas formatit, të firmosura nga komisioni.

Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve, firmosur nga komisioni paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vleresimi nga intervista	Total
E.Z.	21	9	30
A.D.	14.1	10	24.1
P.E.	21.1	2	23.1

A.G.	17.6	4	21.6
L.Sh.	11.3	8	19.3
L.J.	10.9	6	16.9

Nga vlerësimi me pikë i komisionit, vërehet se kandidati me më shumë pikë nga vlerësimi i dosjes, z. P.E. është vlerësuar me pikët më minimale nga komisioni (2 pikë), në një kohë ku kandidatët e tjerë me pikë ndër më të ulëtat nga vlerësimi i dosjes kanë marë vlerësim mbi 5 pikë.

Intervistimi i kandidatëve

Në dosje **nuk** disponohet informacion për datën në të cilën janë vlerësuar kandidatët, datën e intervistës dhe komentet e komisionit për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të tjerë (përveç atyre trajtuar më sipër për të cilët janë evidentuar mangësi në dokumentacion). Edhe pse janë evidentuar mangësi, **nuk** disponohet informacion nëse këto mungesa janë plotësuar më pas nga kandidatët, përpara vlerësimit të tyre përfundimtar nga komisioni.

Ankimime

-Për këtë proces me shkresën nr.27.08.2020, protokolluar në ZVAP nr. 1347/1, datë 28.08.2020 znj A.G., ka kontestuar procesin e konkurrimit duke sqaruar se:

Është njoftuar nga ZVAP Durrës për intervistën e strukturuar nëpërmjet telefonit për datën dhe vendin e zhvillimit të intervistës, e cila sipas ankimueses për arsye të paqarta është shtyrë 1 orë e gjysmë. Ankimuesja pretendon se pritja ka qenë për një kandidat të 5. Pyetjet e komisionit sipas saj ishin të pa strukturuara dhe të pambështetura në udhëzim. Sipas saj është pyetur : Sa njohëse e mirë e sportit është dhe pyetjet e tjera sipas saj ishin të pabazuara në ligj dhe tendencioze.

-Një tjetër ankesë është paraqitur nga z. P.E., i cili ka pretenduar se pyetjet e komisionit nuk kanë qenë sipas udhëzimit nr. 2, por vetëm nga fusha e sportit. Gjithashtu, aplikanti bën me dije se komisioni ka shkelur pikën 1.d, shkronja B, e kreut I, dhe pika i e kreut III.

Procedura finale e përzgjedhjes

Me shkresën nr. 1504/1, prot datë 31.08.2020, ZVAP Durrës, i është drejtuar DRAP Durrës, duke e informuar se pas kontrollit të procedurës së konkurrimit për drejtues shkollë për institucionin "Jusuf Puka"[43] ***nisur nga ankimet e kandidatëve***, konstatohet se: "Gjatë procedurave të konkurrimit janë shkelur përcaktimet e udhëzimit nr.2, konkretisht: pikën 1.d, shkronja B, e kreut I, dhe pika i e kreut III. Komisioni nuk ka respektuar dispozitat e mësipërme, duke pranuar dhe vlerësuar kandidatë që nuk kanë kryer shkollën e drejtorëve dhe as institutin e zhvillimit të arsimit në vitin 2016. Intervista e strukturuar me gojë nuk është zhvilluar në përputhje me udhëzimin nr.2." Si rezultat është propozuar **anulimi i konkurs**it, duke dërguar në DRAP Durrës edhe ankesat e kandidatëve.

Gjithashtu, sipas procesverbalit të mbajtur nga përfaqësuesi i DRAP Durrës në këtë procedurë, protokolluar në datë 27.08.2020, znj. E.D. është shprehur: "*1.Komisioni nuk u mblodh në orën e caktuar nga ZVAP Durrës.*

2.Nga komisioni nuk u mbajt një procesverbal mbi arsyet e kësaj vonese.

3. Në mbledhjet e komisionit, në kundërshtim me kriteret e udhëzimit nr.2, morën pjesë edhe 2 përfaqësues të ZVAP Durrës, znj. R.H. dhe znj. L. K, të cilat diskutonin me komisionin dhe hynin e dilnin nga salla, në kundërshtim me rregullat e procedurës.

4. Në këtë mbledhje komisioni zhvilloi intervistë me gojë me kandidatët që kishin dorëzuar dosjet. Nga pyetjet e bëra nga anëtarët e komisionit, konstatohet se shumica e pyetjeve janë në kundërshtim me kriteret e shpalljes dhe udhëzimin nr.2.4.

5. Parregullsi të tjera të konstatuara si: dosjet e kandidatëve të pa sistemuara, pikëzimi u bë në grup dhe jo nga secili anëtar më vete.

Nga sa më sipër u konkludua se procesi nuk u zhvillua sipas dispozitave ligjore."

[43] Në një kohë kur shkresa bëhet fjalë për shkollën Benardina Qerraxhia

Me vendimin nr.67, prot në DRAP Durrës nr.1319/1, datë 08.09.2020, prot në ZVAP Durrës nr. 1582, prot datë 09.09.2020, znj. V.L. ka vendosur **anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.2.**

Nga verifikimi i dosjeve të kandidatëve konstatohet se:

Për kandidaten A.G., ka dorëzuar email-in që e konfirmon aplikimin e saj në shkollën e drejtorëve. L.Sh. nuk ka asnjë dokumentacion për pjesëmarrjen e tij në shkollën e drejtorëve.

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Durrës. Dokumentacioni ishte i shpërndarë dhe u sistemua gjatë vizitës së grupit të auditimit në këtë ZVAP. Në dosje mungon dokumenti i njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës. **Nuk** është dokumentuar dorëzimi i dokumentacioneve të komisionit për kandidatët më të mirë pranë ZVAP Durrës.

Dy nga procesverbalet e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve janë firmosur **vetëm** nga 4 anëtarët e komisionit, ku vihet re se mungon firma e Kryetares së Komisionit, znj. D.S..

Në dosje **nuk** disponohet informacion për datën në të cilën janë vlerësuar kandidatët, datën e intervistës dhe komentet e komisionit për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të tjerë (përveç atyre trajtuar më sipër për të cilët janë evidentuar mangësi në dokumentacion). Edhe pse janë evidentuar mangësi, **nuk** disponohet informacion nëse këto mungesa janë plotësuar më pas nga kandidatët, përpara vlerësimit të tyre përfundimtar nga komisioni.

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve".

Sikundër citohet edhe në shkresën e përcjellë për DRAP, ZVAP Durrës ka iniciuar kontrollin për procedurat e komisionit **vetëm pas ankimimeve të kandidatëve**, pra jo në përputhje me Kreun I, Pika D.1 e Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020.

Në vijim të parregullsive sa më sipër, rezulton të mos jetë ndërmarrë asnjë masë nga ZVAP Durrës apo DRAP Durrës.

1.Komisioni i Vlerësimit kishte përbërjen si më poshtë:
D.S., mësuese- Kryetar
S.B., mësues- Anëtar
P.P., kryetar i bordit- Anëtar
A.S., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtare
K.L., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar
2. Drejtori i ZVAP Durrës, Znj.J.M.
3. Ish Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 2**, nr. 1066/1 prot., datë 19.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vorë, Klos, Mat,Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Kavajë, dhe Tiranë. Kjo shpallje **nuk** është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZVAP Durrës, pasi institucioni nuk disponon një

faqe web-i. Nëpërmjet kësaj shpallje, për **ZVAP Durr**ës janë shpallur 7 pozicione të lira për drejtor të shkollave si më poshtë:
Bajram Gashi.
Myslim Hida
Bajram Gashi
Rexhep Mezini
Pren Simoni
Don Nikollë Kacorri
Olsi Lasko (Part Time)
Cështja B e pikës 2 të shpalljes nr.1 përcakton se dokumentacioni i aplikimit i përcaktuar në pikën 2, të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-et përkatëse **jo më vonë se data 31.08.2020.**
Pika 3 e shpalljes nr. 2 përcakton **se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data 07.09.2020.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.
ZVAP Durrës **nuk** disponon dosje për procedurat e ndjekura për konkurrimin e aplikantëve për drejtor për shkollat e shpalljes nr.2. Për shpalljen nr. 2, sipas shkresës nr. 1544, prot datë 02.09.2020 është raportuar pranë DRAP për ecurinë e konkurseve në ZVAP Durrës si më poshtë:
-Për shkollën **Pren Simoni,** ka vetëm një kandidat
-Për shkollën **Bajram Gashi.** ka vetëm një kandidat
-Për shkollën **Dom Nikollë Kacorri** knuk ka asnjë kandidat
-Për shkollën **Olsi Lasko Part Time** nuk ka asnjë kandidat.
Nga verifikimi i dokumentacioneve konstatohet se:
-Procedurat për shkollën "**Rexhep Mezini**", sipas shkresës nr. 2132, prot datë 13.10.2020, Drejtori i ZVAP ka bërë **kërkesë për anullim të konkursit**, pasi vetëm një prej aplikantëve ka aplikuar në shkollën e drejtorëve, dhe dy aplikantët e tjerë nuk kanë aplikuar në shkollën e drejtorëve, duke shkelur kriteret e udhëzimit.
-Për procedurën e shkollës "**Bajram Gashi**", me shkresën nr. 1921 prot datë 22.09.2020 i është dërguar një kërkesë DRP në të cilin është kërkuar opinion nëse duhet të vijojmë me konkursin, nisur nga situata ku mësuesja M. D, aplikante në këtë procedurë është përfshirë në debat me mësuesin e shkollës. Sipas saj, thuhet se duke qenë se një pjesë e mirë e komisionit janë mësues dhe prindër, do ishte mirë shtyrja, deri në zgjidhje të problematikës. Nuk ka asnjë informacion për vijimin.
-Për procedurën e shkollës "**Myslym Hida**" me shkresën nr. 1647'/1, prot datë 08.10.2020, me vendimin nr.91 të DRAP është vendosur miratimi i kërkesës së ZVAP Durrës(nuk ka kërkesë në dosje) dhe pezullimin e procedurës për këtë shkollë deri në zëvendësimin e kandidatit nga njësia e vetëqeverisjes vendore, pasi kandidati i vendosur fillimisht nuk mund të marë pjesë në komision. Nuk ka informacion për vijimin e procesit.
Pra, procesi në ZVAP Durrës **nuk ka vijuar apo konkluduar**, për **asnjë** nga shkollat e përfshira në Shpalljen nr.2.

MBI VENDIMET GJYQËSORE
Vendime te ekzekutuara
ZVAP Durrës për vitin 2019 ka ekzekutuar **3** vendime gjyqësore **me vlerë totale 1,016,128 lekë.**
Vendime të pa ekzekutuara
Pranë ZVAP Durrës përgjatë 2019 kanë ardhur **2** vendime, dhe 1 vendim përgjatë 2020, për të cilët ende nuk është kryer pagesa, **në vlerë totale 2,663,777 lekë**.
Çështje gjyqësore në proces me objekt kthimin në punë

Zyra Vendore Arsimore Durrës është vetëm në **1 proces gjyqësor** me ish mësuesen Lindita Perfundi, proces i cili është ne fazën e veprimeve përgatitore.

Për gjetjet e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi:
-V.L. ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës,
-J.M., Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës,
-R.H., Specialiste e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës
-Anëtarët e komisioneve të shkollave për të cilat janë evidentuar parregullsi.

ZVAP MAT

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Mat ka nën juridiksionin e saj **12** institucione publike te arsimit parauniveristar, nga të cilat 6 janë shkolla 9 vjeçare dhe 6 shkolla të mesme. **Nga totali prej 12 shkollash, në 9 prej tyre (75%) drejtuesit janë të komanduar në këto pozicione,** dhe shpalljet e DRAP Durrës deri në përfundim të auditimit, janë **bërë vetëm për 3 prej tyre** ku për **asnjërën** prej tyre nuk është emëruar në pozicione punë drejtuesit definitiv. Procesi për shpalljen e fituesit nga DRAP Durrës është konkluduar **vetëm për 1 shkollë**. Më hollësisht si më poshtë:[44]

Shkollat	Emër Mbiemër	Data e komandimit
SHMB "Abdyrrahman Përmeti" Lis	A.B	14.10.2016
SHMB "Gjergj Kastrioti" Baz	**M.E.**	01.11.2017
SHMB "26 Korriku" Bruç	A.N	24.01.2014
Shkolla 9-vjeçare "ALI METRA" Komsi, Shkolla vartëse Selixe	M. B	18.03.2014
Gjimnazi "PJETER BUDI" Burrel	V. K	05.11.2018
Shkolla 9-vjeçare " 31 KORRIKU" Burrel	**A.S.**	31.08.2018
Shkolla 9-vjeçare " MUSTAFA GJESTILA" Burrel	**L.S.**	16.03.2015
Shkolla 9-vjeçare "ILIA QIQI" Burrel	E.S	03.02.2016
SHMB "AHMET XHETANI " Derjan	E. Ç	04.02.2016

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 1**, nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë,Vorë, Klos, Mat, Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Krujë, dhe Tiranë. Kjo shpallje është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZVAP Mat si dhe në ambientet e kësaj zyre vendore. Nëpërmjet kësaj shpallje, për ZVAP Mat janë shpallur **2** pozicione të lira për drejtor të shkollave si më poshtë:

31 Korriku

Mustafa Gjestila

Pika 3 e shpalljes nr. 1 përcakton se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen **në datën 21 dhe 24 Gusht 2020.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

Grupi i auditimit shqyrtoi **2 dosjet** e vendosura në dispozicion nga ZVAP Mat mbi procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore nën juridiksionin e kësaj zyre arsimore, për **Shpalljen nr.1**, ku në të 2 dosjet u konstatuan parregullsi, trajtuar si më poshtë:

1. Shkolla "31- Korriku"

Me anë të shkresës nr. 469 prot. datë 06.08.2020, ZVAP Mat ka shpallur hapjen e procedurës së konkurrimit për të interesuarit për pozicionin drejtor në shkollën "31 Korriku". Referuar kësaj shpallje, aplikantët duhet të paraqesin pranë ZVAP Mat dosjen personale me dokumentacionet e nevojshëm, brenda datës **14.08.2020**. Ky afat është **taksativ.**

Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : ***"****Komisioni përbëhet nga:*

[44] Shkollat me Bold jane perfshire ne shpalljen nr.1 dhe nr.2

a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Me anë të shkresës nr. 468 prot. datë 06.08.2020 ZVAP MAT ka kërkuar nga Bashkia MAT caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit. Me anë të shkresë nr. 3328/1 prot, data 14.08.2020 Bashkia Mat ka njoftuar pjesëmarrjen e Z. M.Z. në Komisionin e Vlerësimit për shkollën 31- Korriku.
Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit
Referuar procesverbalit të mbajtur në shkollën 9-vjecare "31-Korriku", më datë 17.08.2020, ora 09.00, në këtë shkollë është mbledhur Këshilli i Mësuesve për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin të pranishëm në Komisionin për Konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "31-Korriku". Sipas procesverbalit, në votim kanë marr pjesë 24 nga 36 mësues.
Në këtë procesverbal përcaktohen dy mësuesit e mëposhtëm, të cilët u zgjodhën me votim të fshehtë për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:
Znj. A.P.-Mësuesi më i Vjetër i në Institucion
Znj. M.K.-Mësues
Me anë të shkresës nr. 77. prot, datë 17.08.2020 me lëndë "Informacion për anëtarët e Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve", Shkolla 9-vjecare 31-Korriku i dërgon ZVAP Mat informacionin e mëposhtëm mbi pjesëmarrësit që propozoheshin për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:
A.P. – Mësues më i vjetër në institucion
M.K. - Mësues
F.M.- Kryetar i Bordi Insitucionit Arsimor
E.M.- Nënkryetar i Këshillit të Prindërve
Sipas shkresës së mësipërme, E.M. është Nënkryetare e Këshillit të Prindërve pasi, Kryetari A. C ndodhet larg qytetit dhe nuk është e disponueshme për të qenë pjesë e komisionit.
Me anë të shkresës nr. 78. Prot, datë 17.08.2020 me lëndë "Kërkesë për miratimin e komisionit të vlerësimit të kandidatëve në konkursin për drejtues shkolle në 9-vjecare 31-Korriku", Shkolla 9-vjecare 31-Korriku i kërkon ZVAP MAT miratimin e Komisionit të Vlerësimit si më poshtë:
F.M. - Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
E.M.- Nënkryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)
A.P. - Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)
M.K. - Mësues (Anëtare)
Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore
Me anë të shkresës Nr. 525 prot. datë 18.08.2020 "Njoftim për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për drejtues", ZVAP MAT ka njoftuar DPAP, DRAP Durrës, Sindikatën SPASH (Dega Mat) dhe Sindikatën FSASH (Dega Mat), se më datë 20.08.2020, në orën 11.30, në ambientet e shkollës "31-Korriku" zhvillohen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues të

institucioneve arsimore, si dhe për pjesëmarrje të një përfaqësuesi nga këto institucione për monitorimin dhe vëzhgimin e zbatimit të dispozitave të udhëzimit të MASR gjatë këtij procesi.
Me anë të shkresës nr. 1175 prot. datë 19.08.2020, DRAP Durrës ka autorizuar Z. F.E. të marrë pjesë si përfaqësues i DRAP-it në konkursin që do të zhvillohej për pozicionin e drejtuesit të shkollës "31-Korrik", në ZVAP Mat.
Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP
Me anë të Urdhrit nr. 55, nr. 523 prot., datë 18.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla 31-Korrik", Drejtori i ZVAP MAT, Znj. Sh.T., ka urdhëruar:
1. Miratimin e Komisionit të Vlerësimit në konkursin për drejtues shkolle në shkollë 31-Korrik, si më poshtë:
M.Z. –Përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (anëtar)
F.M. - Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
E.M.- Nënkryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)
A.P. - Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)
M.K. - Mësues (Anëtare)
Komisioni te shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor 31-Korriku, sipas shtojcës 5 të udhëzimi dhe shpalljen e pikëve për çdo aplikant sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.

b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve
Më datë 19.08.2020 është mbajtur një procesverbal, nr. 541/1 prot., datë 20.08.2020, midis Kryetares së Komisionit të Vlerësimit, Znj. A.P., dhe përfaqësuesit të ZVAP MAT, Znj.F.M., sipas të cilit Komisionit i janë dorëzuar dosjet e kandidatëve të mëposhtme:
A.S.
M.D.
Referuar shkresë nr. 541 prot. dosja e Znj. M.D., rezulton e protokolluar më datë **17.08.2020.** Aplikimi i Znj. M.D. është në **tejkalim** të afatit taksativ të vendosur për dorëzimin e dokumentacionit nga kandidatët, datës **14.08.2020**.
Më datë 20.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Në dosjen e procedurës së përzgjedhjes së drejtorit për shkollën "31-Korriku" në ZVAP Mat, **nuk** gjendeshin procesverbalët e mbajtur nga Komisioni për vlerësimin e dosjeve dhe zhvillimin e intervistës me kandidatët. Në vijim të vizitës së grupit të auditimit në subjekt iu vunë në dispozicion procesverbalet ne fjalë, të cilët u morën nga shkolla "31-Korrik".
Referuar procesverbalëve të mësipërm, të cilët **nuk** gjendeshin në dosjen e procedurës së përzgjedhjes së drejtorit të shkollës "31 Korriku" në ZVAP Mat:
Më datë 20.08.2020 është mbledhur Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe Z. F.E. përfaqësuesi i DRAP dhe Z.R.Gj. përfaqësuesi i FSA-së. Sipas procesverbalit, Komisioni është shprehur se dosjet e kandidatëve janë të rregullta. Ky procesverbal ishte mbajtur nga anëtarja e Komisionit Znj. M.K..
Më datë 27.8.2020 është mbledhur Komisioni i Vlerësimit dhe ka zhvilluar intervistat me dy kandidatët. Në procesverbal identifikohen pyetjet e intervistës dhe rezultatet e të dy kandidatëve. Ky procesverbal ishte mbajtur nga anëtarja e Komisionit Znj. M.K..

Procesverbalet e mësipërme **nuk** janë të firmosur nga anëtarët e Komisionit, por vetëm nga Znj. M.K. e cila ka mbajtur procesverbalin. Vlerësimet individualet për secilin kandidat, nga secili anëtarë i Komisionit, **nuk** janë pjesë e procesverbalit. Ato janë në letra të pafirmosura.
Në dosjen "31-Korriku", gjenden vlerësimet për kandidatët nga anëtarët e Komisionit, sipas shtojcës 5, të përmbledhura nga grupi i auditimit në tabelën e mëposhtme:

Kandidati	Pikët nga vlerësimi i dosjes	Pikët e intervistës nga K.V.	Pikët e fazës së parë
A.S.	15.9	9.8	25.7
M.D.	12.3	6.4	18.7

Në dosjen e shkollës "31- Korriku" rezulton shtojca 6, në të cilën janë paraqitur rezultatet finale të kandidatëve, të firmosura nga anëtarët e komisionit.
Nga shqyrtimi i dosjeve të kandidatëve si dhe nga inventari i dosjeve të dërguar në DRAP Durrës me shkresën nr. 605 prot. datë 02.09.2020, identifikohet se kandidatët vetëm kanë aplikuar në Shkollën e Drejtorëve.
Me shkresë nr. 599 prot. datë 01.09.2020, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të dosjeve të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në shkollën "31 Korrik", i ka dërguar drejtorit të ZVAP Mat dosjet e dy kandidatëve si dhe shtojcat 5 dhe 6 të vlerësimit.

Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Nga komunikimi me ZVAP Mat, grupit të auditimit iu bë me dije se Sektori i Shërbimeve në këtë ZVAP në përmbushje të Pikës D.1 të Kreu-ut I të Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020, i ndryshuar, ka shqyrtuar procedurën e ndjekur nga Komisoni i Vlerësimit. Sipas Sektorit të Shërbimeve në këtë procedurë nuk janë evidentuar parregullsi teknik, megjithatë nuk është hartuar një relacion mbi shqyrtimin e kryer. Nga intervista me Drejtoreshën, ky proces rezulton të jetë kryer nga juristja znj. F.M..
Me anë të shkresë nr. 605 prot. datë 02.09.2020, ZVAP Mat i ka përcjellë DRAP Durrës dosjet e dy kandidatëve për pozicionin e drejtorit për shkollën "31-Korriku". Në këtë shkresë janë listuar dokumentet që përmbajnë dosjet e të dy kandidatëve. Referuar shkresës, ZVAP Mat i ka përcjellë DRAP Durrës-it edhe deklaratat e konfliktit të interesit të firmosura nga anëtarët e Komisionit, shtojcat 5 dhe 6 të vlerësimit.

Intervistimi i kandidatëve në DRAP Durrës- anulimi i procedurës

Nga komunikimi me ZVAP Mat, procedura e përzgjedhjes së drejtorit për shkollën "31-Korriku" është ndërprerë nga DRAP Durrës, pasi njëri nga kandidatët është tërhequr nga faza e intervistës. Megjithatë ZVAP Mat nuk ka marrë asnjë informacion në rrugë zyrtare mbi vijueshmërinë e këtij procesi për shkollën " 31-Korriku".
Në vijim të kërkesës zyrtare të drejtuar nga grupi i auditimit, me anë të shkresës nr. 1745/1 datë 03.11.2020 DRAP Durrës ka konfirmuar se procedura e përzgjedhjes së drejtorit për shkollën 31 Korriku është anuluar si rezultat se një nga kandidatët është tërhequr nga intervistimi.
Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës 31-Korriku, grupi i auditimit ka evidentuar parregullsitë e përmbledhura si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës 31-Korriuku është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Mat. Dokumentacioni ishte i shpërndarë dhe u sistemua gjatë vizitës së grupit të auditimit në këtë ZVAP. Në dosje mungonin procesvarbalet e mbajtur nga Komisioni gjatë vlerësimit të kandidatëve, dokumenti i njoftimit të dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës, pyetjet e intervistës, vlerësimi i anëtareve të Komisionit për fazën e intervistës, për secilin kandidatë, etj.
Në këtë procesverbal e mbajtur në shkollën 31- Korriku për përzgjedhjen e mësuesve të

cilët do ishin pjesë e Komisionit, është evidentuar lista e mësuesve pjesëmarrës në votim, por ata nuk kanë firmosur për pjesëmarrjen, si dhe nuk janë dërguar fletët e votimit
Kandidatja për drejtorë, Znj. M.D. ka përcjellë dokumentacionin për aplikim në 17.08.2020, në tejkalim të afatit taksativ të vendosur për dorëzimin e dokumentacionit datës 14.08.2020.
Në dosjen e procedurës së përzgjedhjes së drejtorit për shkollën "31-Korriku" në ZVAP Mat, nuk gjendeshin procesverbalët e mbajtur nga Komisioni për vlerësimin e dosjeve dhe zhvillimin e intervistës me kandidatët. Në vijim të takimit me subjektin, grupit të auditimit iu vunë në dispozicion procesverbalet ne fjalë, të cilët u morën nga shkolla "31-Korrik". Këto procesverbale janë të paprotokolluar.
Procesverbalet e Komisionit të cilët nuk ishin në dosje, nuk janë të firmosur nga anëtarët e Komisionit, por vetëm nga Znj. M.K. e cila ka mbajtur procesverbalin.
Vlerësimet individualet për fazën e intervistës për secilin kandidatë, nga secili anëtarë i Komisionit nuk janë pjesë e procesverbalit. Ato janë në letra të pa firmosura.
Problematikat e mësipërme nuk janë evidentuar gjatë procesit të vlerësimit të procedurës nga Sektori i Shërbimeve më ZVAP Mat.
Në Komisioni e Vlerësimit kanë marrë pjesë:
A.P. - (Kryetar Komisioni)
M.Z. – (Anëtar)
F.M. - (Anëtar)
E.M.- (Anëtar)
M.K. -(Anëtare)
Përfaqësues i DRAP Durrës në Komisionin e Vlerësimit ka qenë z. F.E..
Dosja e komisionit të vlerësimit është shqyrtuar nga znj. F.M.- juriste e ZVAP Mat.
Dosjet e dy kandidatëve me më shumë pikë janë përcjellë nga znj. Sh.T., Drejtori i ZVAP Mat.
Shpallja e vendimit për fituesin, brenda 8 ditëve nga dorëzimi i dosjeve do të kryhej nga znj. V.L., Drejtor i DRAP Durrës.

1. MUSTAFA GJESTILA

a. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit:

Kreu I, pika C.1 e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : *"Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."
Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore
Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 468, datë 06.08.2020, ZVAP Mat ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Mustafa Gjestila", brenda datës 15.08.2020. Me anë të shkresës nr. 3328/1, datë 14.08.2020, Bashkia Mat ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, z. T.B., për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.
Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit
Me anë të procesverbalit sipas shkresës nr. 45, protokolluar në Shkollën 9 vjeçare Mustafa Gjestila Burrel, datë 14.08.2020 janë përcjellë pranë ZVAP Mat anëtarët e komisionit nga mësuesit e shkollës, pas votimit nga stafi i shkollës, duke përzgjedhur znj. M.D. dhe znj. S.H.(mësuesja me eksperiencën më të gjatë të punës), sipas pikës C.3 të udhëzimit nr.2. Me shkresën nr. 46, protokolluar në Shkollën 9 vjeçare Mustafa Gjestila Burrel, datë 17.08.2020 janë përcjellë pranë

ZVAP Mat edhe anëtarët e tjerë të komisionit, znj. D.V., Kryetar i Bordit dhe z. G.P., Kryetar i Këshillit të Prindërve, S.H., Kryetar i Komisionit, M.D., mësuese. Emri i përfaqësuesit të Njësisë së Qeverisjes Vendore në këtë shkresë është lënë bosh.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Në mbështetje të pikës 6 dhe 7 të gërmës C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr. 524, prot. datë 18.08.2020, ZVAP Mat i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës, Sindikatës SPASh Dega Mat, Sindikatës FSASH Dega MAt njoftimin se mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për shkollën Mustafa Gjestila do të zhvillohej në ambientet e shkollës në datë 20.08.2020, ora 09:00. Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Mat i ka kërkuar institucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj në mbledhje rezulton të kenë marrë pjesë vetëm përfaqësues të sindikatave, dhe jo nga DRAP Durrës apo DPAP.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 54, datë 18.08.2020, protokolluar në ZVAP Mat, sipas shkresës nr. 522, prot datë 18.08.2020, Drejtori i ZVAP Mat urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Mustafa Gjestila, si më poshtë:

S.H., mësuese- Kryetare

M.B., mësuese- Anëtare

D.V., kryetar i bordit- Anëtar

G.P., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtar

T.B., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtare

Nga auditimi konstatohet se pas zëvendësimit të anëtarit z. G.P. (trajtuar më poshtë), ZVAP Mat nuk ka kryer rishikimin e urdhrit të sipërcituar.

b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Sipas pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr.540, prot. datë 20.08.2020 Drejtori i ZVAP Mat i ka drejtuar Kryetares së Komisionit të vlerësimit të dosjeve njoftimin për dorëzimin e 2 dosjeve të kandidatëve për procedurën e konkurrimit për këtë shkollë. Referuar procesverbalit nr.540/1 te mbajtur më datë 20.08.2020, ndërmjet juristit të ZVAP dhe Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP, për pozicionin e drejtorit të shkollës Mustafa Gjestila. Komisioni mori në dorëzim 2 dosje. Ky procesverbal është firmosur nga kryetari komisionit të vlerësimit dhe i protokolluar.

Me procesverbalin e mbajtur në datë 20.08.2020 në mbledhjen e Komisionit është përcaktuar se po mbahet një procesverbal për të dokumentuar se pasi u mblodh komisioni në 20.08.2020, ora 09.00, anëtari i komisionit, përfaqësues i Këshillit të Prindërve, z. G.P. detyrohet të largohet për arsye familjare. Ky anëtar u zëvendësua nga anëtari që e përzgjodhi me një tjetër anëtar, znj. Xh.B. në pozicionin e nënkryetaret së Këshillit të Prindërve. Dokumentacionet respektive për zëvendësimin e kësaj kandidateje, dhe nëse është kryer një rishikim në urdhrin e drejtorit të ZVAP Mat, nuk disponohen në dosje.

Më datë 20.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 20.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Mustafa Gjestila", komisioni është shprehur se përveç anëtarëve të komisionit, në mbledhje kanë marë pjesë edhe 2 përfaqësues nga sindikatat, z. A.K. përfaqësues i SPASH dhe z. R.Gj., përfaqësues i FSASH.

Komisioni është shprehur se pas verifikimit rezulton se kandidatët z. N.P. dhe z. L.S. kishin dorëzuar të gjithë dokumentacionet e nevojshme në dosjet respektive. Në fund të mbledhjes është kryer vlerësimi në pikë për dosjet, dhe është vendosur data e intervistës, 24.08.2020.
Procesverbali është firmosur nga 5 anëtarët e komisionit, por është i pa protokolluar.
Intervistimi i kandidatëve
Pas vlerësimit të dosjeve, 2 ditë pune më vonë, në datën 24.08.2020, komisioni ka zhvilluar intervistat për 2 kandidatët, sipas pikës 10.e e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit. Në dosje nuk disponohen dokumentacionet për njoftimin e kandidatëve për datën e intervistës. Për vlerësimin e intervistës është mbajtur protokolli nr. 2, i paprotokolluar, në të cilin kanë marrë pjesë anëtarët e komisionit. Në protokoll është përcaktuar se secili nga anëtarët ka përcaktuar pyetjet për kandidatët, dhe në fund komisioni ka përzgjedhur pyetjet. Është hedhur shorti për cilin kandidat intervista është zhvilluar e para. Gjithashtu, është përcaktuar se secili anëtar ka mbajtur shënimet respektive për përgjigjet e kandidatëve dhe në fund secili anëtar ka kryer vlerësimin në mënyrë individuale dhe më pas komisioni (Kryetarja) nxorri rezultatin përfundimtar për secilin Konkurrent. Janë shënuar pikët në tabelën përkatëse dhe komisioni ka nxjerrë rezultatin përfundimtar për secilin konkurrent, firmosur nga anëtarët e komisionit.
Ky dokument i trajtuar më sipër për mënyrën si është vepruar për vlerësimin në pikë të kandidatëve për intervistën e strukturuar, nuk disponohet në dosje.
Në dosje janë përcaktuar pyetjet e intervistës së strukturuar, dhe emrat e komisionit, por të pa firmosur. Pyetjet e intervistës janë si më poshtë:
1. Në kushtet e pandemisë, si mendoni të menaxhoni situatën (nëse shkolla nis me nxënësit në shkollë)? Po nëse mësimi anulohet, çfarë platforme keni për të paraqitur për stafin pedagogjik?
2. A i njihni pikat e dobëta dhe të forta të kësaj shkolle, çfarë keni menduar për ti minimizuar ato?
3. Cilat janë organizmat ndihmëse dhe vendimmarrëse në shkollë, si keni menduar ti përfshini gjatë punës tuaj si drejtues?
4. Cili është vizioni juaj si drejtues për të sjellë ndryshimin në këtë shkollë? Duke u fokusuar të paktën në 3 drejtime.
5. A keni ideuar një plan veprimtarish për të minimizuar problematika sociale që po hasen sot në një shoqëri si bullizmi, lëndët narkotike, apo nxënës me problematika në sjellje?
Vlerësimi final i komisionit
Në vijim, komisioni ka plotësuar Shtojcën 5, sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
R.P.	16.8	9.4	26.2
L.S.	18.8	9.6	28.4

Sipas shkresës të pa protokolluar, datë 28.08.2020 (pra 4 ditë pune pas intervistës) komisioni, përfaqësuar nga Kryetarja e Komisionit, ka përcjellë pranë ZVAP Mat dokumentacionin e komisionit: Tabelat e vlerësimit, tabelën e rezultateve, procesverbali i zëvendësimit të anëtarit të komisionit, protokolli nr.1, protokolli nr.2, deklaratat e konfliktit të interesit.

c. Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Në kundërshtim me pikën D.1 të udhëzimit nr.2, me shkresën nr. 7916/2, prot datë 27.08.2020 ZVAP Mat, nuk ka përgatitur një relacion informues mbi procesin e vendimmarrjes të ndjekur nga komisioni i vlerësimit të dosjeve në mënyrë që të shprehej nëse janë konstatuar parregullsi në proces. Nga intervista me Drejtoreshën, ky proces rezulton të jetë kryer nga juristja znj. F.M., e cila nuk konstatuar parregullsi.
Me shkresën nr. 606, prot datë 02.09.2020 (pra 3 ditë pune pas dorëzimit të dosjeve nga komisioni), janë përcjellë nga Drejtori i Përgjithshëm i ZVAP Mat, znj. Sh.T., dhe konceptuar shkresa nga juristja znj. F.M., dosjet 2 kandidatëve për këtë procedurë konkurrimi.

Me email-in e datës 08.09.2020 të DRAP Durrës ZVAP Mat është njoftuar se kandidatet fitues nga Komisioni për shkollën 9-vjecare " Mustafa Gjestila " ZVA Mat te paraqiten për intervistën ne DRAP Durrës ne orën 13:00,diten e mërkure, date 09.09.2020.

Në vijim të saj **nu**k disponohet informacion nga ZVAP Mat për vijueshmërinë e këtij procesi, nëse është kryer ose jo shpallja e fituesit nga DRAP Durrës, apo është pezulluar procesi.

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

-Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Mustafa Gjestila Burrel është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Mat. Dosja nuk përmban dokumentin e njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës si dhe tabelën për votimin e komisionit për konkurrentët sipas përgjigjeve respektive. Procesverbalet e komisionit janë të pa protokolluara.

-Nga auditimi konstatohet se ZVAP Mat nuk disponon kopje të dosjeve të aplikantëve, pasi ato origjinale janë dorëzuar në DRAP Durrës. Fillimisht subjekti deklaroi se dosjet ndodheshin në shkollën në të cilën është kryer edhe procesi i vlerësimit, por nga komunikimi me shkollën rezultoi se nuk disponoheshin as atje.

-Nga auditimi konstatohet se pas ndryshimit të anëtarit të komisionit të vlerësimit, përfaqësues nga prindërit për shkollën, datë 20.08.2020, nuk është rishikuar urdhri i Drejtores së ZVAP Mat për komisionin. Si rezultat, në mbledhjet e komisionit, është paraqitur dhe ka votuar kandidati i zëvendësuar, i cili faktikisht nuk rezulton në urdhrin e ZVAP për ngritjen e Komisionit.

-Nga verifikimi i dosjes së kandidatit R.P. rezulton se ka dorëzuar vetëm aplikim e tij në shkollën e Drejtorëve dhe i ka ardhur email-i për pranimin e aplikimit. Nga komisioni është vlerësuar me 1 pikë nëse ka qenë pjesëmarrës në provime, por në dosjen e tij nuk disponohet dokumenti respektiv.

-Nga verifikimi i dosjes së kandidatit L.S. rezulton se ka dorëzuar vetëm aplikim e tij në shkollën e Drejtorëve dhe i ka ardhur email-i për pranimin e aplikimit. Nga komisioni është vlerësuar me 1 pikë nëse ka qenë pjesëmarrës në provime, por në dosjen e tij nuk disponohet dokumenti respektiv.

-Nga auditimi konstatohet se ZVAP Mat nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në pikën D.2, të Kreut 1 (me 1 ditë), ku përcaktohet se "*Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP*.". Nga komisioni vendimmarrja është konkluduar në 24.08.2020, janë dorëzuar në ZVAP Mat në 28.08.2020 dhe përcjellë për DRAP Durrës në 02.09.2020.

-Gjithashtu, Pika D.1 përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*". Për këtë praktikë, ZVAP nuk rezulton të ketë kryer një analizim të dokumentacioneve të dorëzuar nga komisioni dhe të ketë identifikuar parregullsitë e trajtuara më sipër.

- Nga auditimi konstatohet se në vijim të komunikimit të datës 08.09.2020 me DRAP Durrës, ZVAP Mat për njoftimin se kandidatet fitues nga Komisioni për shkollën 9-vjecare "Mustafa Gjestila " do të paraqiten për intervistën në DRAP Durrës datë 09.09.2020, në tejkalim të afateve të përcaktuara në udhëzimin nr. 2, nuk disponohet informacion nga ZVAP Mat për vijueshmërinë e këtij procesi, nëse është kryer ose jo shpallja e fituesit nga DRAP Durrës, apo është pezulluar procesi.

1.Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve përbëhet nga:
- S.H. (Kryetar Komisioni)
– M.B. (Anëtar)
- D.V. (Anëtar)
- G.P. (Anëtar)
- Xh.B. (Anëtare)

2. Dosja e komisionit të vlerësimit është shqyrtuar nga znj. F.M.- juriste e ZVAP Mat

3.Dosjet e dy kandidatëve me më shumë pikë janë përcjellë nga znj. Sh.T., Drejtori i ZVAP Mat
4. Shpallja e vendimit për fituesin, brenda 8 ditëve nga dorëzimi i dosjeve do të kryhej nga znj. V.L., Drejtor i DRAP Durrës

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 2**, nr.1066/1, prot datë 19.08.2020, për ZVAP Dibër, është bërë shpallja e vendit të lirë të drejtorit të institucionit arsimor publik të arsimit parauniversitar IPAP si më poshtë:

1. **Shkolla Gjergj Kastrioti Mat**

Çështja B e pikës 2 të shpalljes nr.1 përcakton se dokumentacioni i aplikimit i përcaktuar në pikën 2, të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-et përkatëse jo më vonë se data 31.08.2020.

Pika 3 e shpalljes nr. 2 përcakton se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data 07.09.2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

Nga auditimi kostatohet se për shkollën Gjergj Kastrioti, procedura e konkurrimit për këtë shkollë ka konkuduar nga drejtori i DRAP Durrës,znj. V.L., edhe pse në **tejkalim të afateve** të DRAP, ZVAP Mat vijon të jetë në pritje të konkluzioneve nga DRAP për vijueshmërinë e procesit të përzgjedhjes së drejtuesve të shkollave në **shpalljen 1**. Me shkresën nr. 1538, prot datë 23.09.2020 të drejtorit të DRAP Durrës është përcjellë vendimi nr.82 datë 23.09.2020, për shpalljen fitues të drejtorit të shkollës Gjergj Kastrioti, znj.M.E.. Në këtë dokument është përcaktuar se kjo shkollë bën pjesë në Shpalljen 1, por faktikisht sikundër është trajtuar më lart kjo procedurë është pjesë përbërëse e **Shpalljes nr. 2.**

MBI VENDIMET GJYQËSORE

Vendime te ekzekutuara

ZVAP Mat për vitin **2019** ka ekzekutuar **2** vendime gjyqësore **në shumën totale 1,921,040 lekë** sipas urdhër shpenzimit nr.144, datë 07.05.2019 me vlerë totale 1,400,103 lekë (sipas vendimit gjyqësor të gjykatës administrative nr.5692, datë 30.11.2016 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 587, datë 28.02.2019, (pa përmbarues); dhe urdhër shpenzimit nr. 220, datë 05.07.2019 në vlerë totale 520,937 lekë (sipas vendimit të gjykatës të rrethit Gjyqësor Mat nr.64, datë 20.04.2018 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 386 datë 23.04.2019). Për këtë vendim është paraqitur urdhri i ekzekutimit datë 12.06.2019 pranë ZVAP Mat, në të cilin është përcaktuar se shuma totale për ekzekutim do të jetë 779,458 lekë, nga të cilat 658,799 lekë detyrime për paga dhe 70,859 lekë tarifë përmbarimore. ZVAP Mat ka likuiduar 520,937 lekë pasi sipas tyre përllogaritja e përmbaruesit ka marrë në konsideratë ngarkesën e plotë të mësuesit, në një kohë ku ai ka patur një ngarkesë të pjesshme dhe përllogaritja është kryer sipas tyre për vlerën 137,862 lekë më pak. Shpenzimet përmbarimore janë likuiduar më vonë, me urdhër shpenzimin nr. 398, datë 13.12.2019 në vlerë 62.400 lekë (pra 8,459 lekë më pak se shkresa e dorëzuar nga përmbaruesi).

ZVAP Mat për vitin **2020** ka ekzekutuar **1** vendim gjyqësor **në shumën 81,000 lekë,** sipas urdhër shpenzimit nr. 205, datë 25.08.2020 (sipas vendimit gjyqësor të rrethit Mat nr.187, datë 20.09.2019).

Vendime të pa ekzekutuara

Sipas ZVAP Mat nuk ka vendime të pa ekzekutuara.

Çështje gjyqësore në proces me objekt kthimin në punë

Sipas ZVAP Mat, nuk ka asnjë proces gjyqësor për largim të padrejtë të punonjësve nën juridiksionin e kësaj zyre.

Për gjetjet e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi znj. V.L. ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe znj. Sh.T., Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit

Parauniversitar Mat dhe anëtarët e komisioneve të shkollave për të cilat janë evidentuar parregullsi.

ZVAP Dibër

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Dibër ka nën juridiksionin e saj 38 institucione publike te arsimit parauniveristar, nga të cilat 30 janë shkolla 9 vjeçare, 5 shkolla të mesme të bashkuara dhe 3 gjimnaze. Për periudhën objekt auditimi 2019-2020, **në 6 prej tyre** (rreth 16%) procedurat për përzgjedhjen e drejtuesve janë kryer me **komandim,** sipas aneksit më poshtë.

Shkolla	Emri Mbiemër	Emëruar/Komanduar/Larguar	Data e komandimit
Sh.M.B Muhurr	E.T.	I komanduar	14.11.2019
9-vjeç Fushe Alie	I.Sh.	I komanduar	19.11.2019
9-vjeç Greve	Sh.P.	I komanduar	8.10.2019
9-vjeç"Selim Alliu"	D.Sh.	I komanduar	20.08.2020
9-vjeçare Selishtë	S.B.	I komanduar	03.08.2020
9-vjeçare Selishtë	S.B.	Anulim	24.8.2020
9-vjeçare Selishtë	R.K.	I komanduar	24.8.2020
9-vjeçare Shemsi Haka	O.L.	I komanduar	03.09.2020

Nga auditimi konstatohet se nga verifikimi i drejtuesve të institucioneve arsimore që **nuk** plotësojnë kriteret, rezultojnë **34 raste**. Nga këto, në **shpalljet e deritanishme** janë përfshirë **vetëm 11 institucione arsimore.** Nga këto, pas përfundimit të procedurave të emërimit, nuk kanë konkluduar për **asnjë** rast nga DRAP Durrës.

Më hollësisht trajtuar më poshtë:

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 1,** nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vorë, Klos, Mat, Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Krujë, dhe Tiranë. Kjo shpallje nuk është publikuar nga ZVAP Dibër, pasi institucioni **nuk** disponon një faqe zyrtare. Nëpërmjet kësaj shpallje, për **ZVAP Dibër** janë shpallur **6 pozicione të lira** për drejtor të shkollave si më poshtë:

Selishtë,
Bllicë,
Haki Stërmilli,
Nazmi Rushiti,
Gjergj Kastrioti.
Dine Hoxha

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 të shkronjës B, është përcaktuar të dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-në përkatëse **jo më vonë se data 17.08.2020.**

Pika 3 e shpalljes nr. 1 përcakton se rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen **në datën 21 dhe 24 Gusht 2020.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

Grupi i auditimit shqyrtoi **6 dosjet** e vendosura në dispozicion nga ZVAP Dibër mbi procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore nën juridiksionin e kësaj zyre arsimore.

Për **Shpalljen nr.1**, ku procedurat kanë vijuar **vetëm në 3 shkolla**, ku parregullsitë e konstatuara janë trajtuar si më poshtë:

Shkolla "BLLIÇE"

Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit e DPAP/DRAP dhe sindikatave:

Kreu I, pika C.1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : ***"****Komisioni përbëhet nga:*

a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se *: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP"*

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: *"Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote*"

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Me anë të shkresës nr. 1203 prot. datë 19.08.2020 ZVAP Dibër ka kërkuar nga Bashkia Dibër caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit. Sipas shkresës, procesi për vlerësimin e kandidatëve do të bëhej në ZVAP Dibër në orën 21.08.2020. Në dosje vërehen **4** shkresa drejtuar Bashkisë Dibër për përcaktimin e përfaqësuesit nga kjo njësi me data të ndryshme protokollimi, apo pa datë protokolli, dhe data të ndryshme për përcjelljen e emrit të përfaqësuesit. Në vijim **nuk** disponohet komunikim shkresor nga Bashkia mbi përfaqësuesin e përzgjedhur prej tyre.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Me anë të shkresës nr. 4215/2. Prot., datë 20.08.2020, ZVAP Dibër i ka kërkuar shkollës Bllice përcaktimin e Kryetarit të Bordit IPAP, Kryetari i Këshillit të Prindërve, dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i prindërve, brenda datës 19.08.2020. Nga shkresa vërehet se, data e protokollimit të shkresës është më e **vonë** se afati i përcaktuar për përcjelljen e informacionit të kërkuar nga shkolla Bllice.

Referuar procesverbalit të mbajtur në shkollën 9-vjecare "Blliçe", më datë 19.08.2020, ora 08.30, në këtë shkollë është mbledhur Këshilli i Mësuesve për përzgjedhjen e dy mësuesve që do të ishin të pranishëm në Komisionin për Konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës "Blliçe". Sipas procesverbalit, në votim kanë marr pjesë 6 nga 9 mësues.

Në këtë procesverbal përcaktohen dy mësuesit e mëposhtëm, të cilët u zgjodhën me votim të fshehet për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit:

Z. D.D.-Mësuesi më i Vjetër i në Institucion

Znj. A.S.-Mësues

Me anë të shkresës nr. 1209 Prot, datë 19.08.2020 me lëndë "Kërkesë për miratimin e Komisionit të vlerësimit të kandidatëve në konkursin për drejtues shkolle Blliçe", Shkolla 9-vjecare Blliçe i kërkon ZVAP Dibër miratimin e Komisionit të Vlerësimit si më poshtë:

S.L.- Përfaqësuesi i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (Anëtar)

I.D.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)

H.Gj.- Kryetari i Këshillit të Prindërve (Anëtar)

D.D. - Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)

A.S. - Mësues (Anëtare)

Vërehet se, shkresa e datës 19.08.2020 me anë të të cilës shkolla Bllicë i ka përcjellë informacionin ZVAP-së Mat, për miratimin e Komisionit të Vlerësimit, është më e **hershme** se shkresa e datës 20.08.2020 me anë të të cilës kërkohej ky informacion nga ZVAP Mat. Mbetet e pakuptimtë se përse përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes pasqyrohet në shkresën e shkollës Bllice.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Në mbështetje të pikës 6 të gërmës C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr. 1216 prot., datë 20.08.2020, ZVAP Dibër i ka përcjellë DPAP-së dhe DRAP Durrës njoftimin se, mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për shkollën Bllice

do të zhvillohej në ambientet e ZVAP-së, në datë 21.08.2020, ora 15:00. Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Dibër i ka kërkuar institucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj **nuk** disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr.413, datë 19.08.2020, nr. 1214 prot., datë 20.08.2020 "Për ngritje komisioni për konkursin për drejtues shkolla Blliçe", Drejtori i ZVAP Dibër, Znj. B.D., ka urdhëruar:

1. Miratimin e Komisionit të Vlerësimit në konkursin për drejtues shkolle në Bllice, si më poshtë:

S.L.- Përfaqësuesi i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (Anëtar)

I.D.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)

H.Gj.- Kryetari i Këshillit të Prindërve (Anëtar)

D.D. - Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)

A.S. - Mësues (Anëtare)

Komisioni te shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e aplikantëve për drejtues në institucionin arsimor Blliçe, sipas shtojcës 5 të udhëzimi dhe shpalljen e pikëve për çdo aplikant sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.

Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Sipas pikës 10, gërma C të Kreut I, të udhëzimit nr.2, komisioni ka bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimi. Në dosje **nuk** disponohet procesverbal ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP, për pozicionin e drejtorit të shkollës Bllice, në mënyrë që të identifikohen numri i dosjeve të mara në dorëzim.

Më datë 21.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Komisioni **nuk** ka përgatitur procesverbal për vlerësimin e të dhënave të kandidatëve.

Intervistimi i kandidatëve

Në dosje **nuk** disponohet informacion lidhur me shkresën e njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, pyetjet e intervistës së strukturuar dhe votimin e Komisionit.

Vlerësimi final i komisionit

Si rezultat se, Komisioni **nuk** e ka bërë vlerësimin e kandidatëve sipas shtojcës 5, por ka vendosur vetëm pikët në totale (në fund të shtojcës 5) për secilin kandidatë, **nuk** mund të identifikohet vlerësimi i kandidatëve sipas kritereve të shtojcës, dhe vlerësimi i kandidatëve në intervistë.

Në dosjen "Bllice", gjendet shtojca 6 në të cilën janë paraqitur rezultatet finale të kandidatëve, të firmosura nga anëtarët e komisionit e cila paraqet informacionin e më poshtë:

K.L., Ska kualifikim, skualifikohet

V.D., Ska kualifikim, skualifikohet

D.I., 8.5 pikë

E.K., 8.3 pikë

Nga analizimi i dosjes së kandidatit rezultoi se, vërtetimi për mos pasje mase disiplinore në fuqi për të D.I., E.K. është lëshuar nga ZVAP Dibër, dhe jo shkolla në të cilin kanë qenë mësues në kohën e aplikimit.

Kandidati **nuk** ka aplikuar, regjistruar apo të jetë pajisur me shkollën e drejtoreve.

Referuar shkresës nr. 1222 prot. 21.08.2020, Komisioni i Vlerësimit i ka dorëzuar dosjet e dy aplikantëve me më shumë pikë për pozicionin e drejtorit në shkollën "Bllice", në ZVAP Dibër.

Në mungesë të procesverbalëve, **nuk** mund të identifikoheshin datat kur është zhvilluar procesi i vlerësimit të dosjeve dhe data e realizimit të intervistës. Nga krahasimi i datës në të cilën janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit 21.08.2020, të cilat referuar Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020, Kreu I, pika C.5 ku citohet se: "*Në mbledhjen e parë të Komisionit, anëtarët plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi*", me datën në të cilën është bërë dorëzimi i kandidatëve më pikët më të larta në ZVAP Dibër 21.08.2020 rezulton se, vlerësimi i dosjeve dhe intervistimi i kandidatëve është bërë në të njëjtën ditë. **Në kundërshtim** me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se:"*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.*" Komisioni ka zhvilluar shqyrtimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve në të njëjtën ditë duke mos i dhënë mundësinë kandidateve të skualifikuar Znj. K.L. dhe Z. V.D., për të plotësuar dokumentacionin, nëse e dispononi.

Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni

Në përputhje me pikës D.1 të Udhëzimit nr.2, nr. 1206, prot., datë 19.08.2020 Drejtori i ZVAP Dibër ka autorizuar Znj. S.K. me detyrë specialiste në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhë Zhvillimit Profesional, për shqyrtimin e natyrës teknike të dokumentacionit të Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit IPAP shkolla 9-vjeçare "Blliçe". Nga komunikimi me Znj.K., ajo ka qenë pjesë e mbledhjes së Komisionit dhe ka vëzhguar procesin e vlerësimit nga Komisioni. Sipas saj procedura nuk ka patur parregullsi të natyrës teknike, por megjithatë nuk është mbajtur një relacion në përfundim të shqyrtimit të procedurës.

Në vijim, Drejtori i ZVAP ka bërë përcjelljen në DRAP Durrës të dokumentacioneve të dy kandidatëve me pikët më të mira sipas shkresës nr.1229, prot datë 24.08.2020. Nga komunikimi me ZVAP Dibër rezulton se, kandidatët nuk janë intervistuar nga DRAP Durrës **dhe në tejkalim të afateve nuk** disponohet asnjë informacion prej kësaj strukture.

Problematikat e mësipërme **nuk** janë evidentuar nga procesi i rivlerësimit.

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Bllice është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Dibër. Dokumentacioni ishte i shpërndarë dhe u sistemua gjatë vizitës së grupit të auditimit në këtë ZVAP. Në dosje mungon dokumenti i dorëzimit të dosjeve Komisionit, procesverbalet e Komisionit, dokumenti i njoftimit të kandidatëve për mungesa në dokumentacion, dokumenti i njoftimit të kandidateve për datën e intervistës, etj.

Shkresa e datës 19.08.2020 me anë të të cilës shkolla Bllicë i ka përcjellë informacionin ZVAP-së Mat, për miratimin e Komisionit të Vlerësimit, është më e **hershme** se shkresa e datës 20.08.2020 me anë të të cilës kërkohej ky informacion nga ZVAP Mat.

Në këtë dosje**, nuk** u gjet shkresë e përcjellë nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku të ishte përcaktuar Z. S.L., si përfaqësues i kësaj njësi në Komisionin e vlerësimit të kandidatëve për drejtorë të shkollës Bllice. Vërehet se shkolla Bllice i ka propozuar ZVAP Durrës edhe përfaqësuesin e njësisë vendore për të qenë pjesë e Komisioni të Vlerësimit, përfaqësues i cili është miratuar me Urdhrin e Drejtorit të ZVAP Durrës për të qenë pjesë e Komisionit.

Në dosje **nuk** disponohet procesverbal ndërmjet ZVAP Dibër dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatën/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP, për

pozicionin e drejtorit të shkollës Bllice, në mënyrë që të identifikohen numri i dosjeve të marra në dorëzim.
Në vijim të Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, dhe shkresës së ZVAP Dibër nr. 1216 prot., datë 20.08.2020, në mbledhjet e organizuara nga Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve **nuk** ka patur përfaqësues të DPAP-së dhe DRAP Durrës.
Në dosjen e procedurës së përzgjedhjes së drejtorit për shkollën "Bllice" në ZVAP Dibër, **nuk** gjendeshin procesverbalët e mbajtur nga Komisioni për vlerësimin e dosjeve dhe zhvillimin e intervistës me kandidatët.
Nga analizimi i dosjes së kandidatit rezultoi se, vërtetimi për mospasje mase disiplinore në fuqi për D.I. dhe E.K. është lëshuar nga ZVAP Dibër, dhe **jo** shkolla në të cilin kanë qenë mësues në kohën e aplikimit.
Kandidatët **nuk** kanë aplikuar, regjistruar apo të jetë pajisur me certifikatë nga Shkolla e Drejtoreve.
Komisioni **nuk** e ka bërë vlerësimin e kandidatëve sipas shtojcës 5, si rezultat **nuk** mund të identifikohet vlerësimi i kandidatëve sipas kritereve të shtojcës, dhe vlerësimi i kandidatëve në intervistë.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika C.10.b të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se:"*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*", si dhe me pikën nr.3 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës "*Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datë 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.*"
Komisioni ka zhvilluar shqyrtimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve në të njëjtën ditë duke mos i dhënë mundësinë kandidateve të skualifikuar Znj. K.L. dhe Z. V.D., për të plotësuar dokumentacionin, nëse e dispononinatë.
Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve."
Problematikat e mësipërme **nuk** janë evidentuar nga procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga punonjësi i autorizuar në ZVAP Dibër.
Nga auditimi konstatohet se pas përcjelljes së dosjeve pranë DRAP Durrës në 24.08.2020, nuk disponohet informacion lidhur me vijueshmërinë e procesit, **në tejkalim të afateve** nga DRAP.
Përbërja e Komisionit të Vlerësimit është si më poshtë:
S.L.- Përfaqësuesi i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore (Anëtar)
I.D.- Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
H.Gj.- Kryetari i Këshillit të Prindërve (Anëtar)
D.D. - Mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar Komisioni)
A.S. - Mësues (Anëtare)
Personi i autorizuar për të shqyrtuar dokumentacionin e Komisionit, S.K.

Drejtori i ZVAP Dibër, Znj. B.D.
Ish Drejtori i DRAP Durrës, Znj. V.L.

SHKOLLA DINE HOXHA (SHMB MUHUR)

a. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit:

Kreu I, pika C.1 e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : ***"****Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të disa shkresave, me numër të ndryshëm protokolli(pa numër, datë 19 dhe 20 gusht), ZVAP Dibër ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Dine Hoxha". Në disa shkresa komisioni është planifikuar të mblidhet në datën 19.08.2020, dhe në disa të tjera në datën 21.08.2020, duke krijuar paqartësi për procedurën e ndjekur. Në vijim të tyre, nuk disponohet komunikim shkresor nga Bashkia Dibër lidhur me personin e përzgjedhur prej tyre.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Me shkresën nr. 62, protokolluar në shkollën Dine Hoxha, datë 04.08.2020 dhe ZVAP Dibër datë 18.08.2020, janë përcjellë pranë ZVAP Dibër anëtarët e komisionit, z. I.T., Kryetar i Komisionit, znj. L.Zh., mësuese, z. M.B., Kryetar i Bordit, z. R.Zh., Kryetar i Këshillit të Prindërve. Bashkëlidhur gjendet edhe procesverbali i shkollës për përzgjedhjen e përfaqësuesve prej saj. Mbetet e pakuptimtë se përse përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes pasqyrohet në shkresën e shkollës, **përpara** dërgimit të shkresës nga ZVAP pranë bashkisë dhe kthimit të përgjigjes prej këtij institucioni.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Në mbështetje të pikës 6 dhe 7 të gërmës C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr. 1216, prot. datë 20.08.2020, ZVAP Dibër i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës, Federatës së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë ka njoftimin se mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për Gjimnazin "Dine Hoxha" do të zhvillohej në ambientet e shkollës, në datë 21.08.2020. Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Dibër i ka kërkuar institucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj **nuk** disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 413, datë 19.08.2020, protokolluar në ZVAP Dibër, sipas shkresës nr. 1205, prot datë 19.08.2020, Drejtori i ZVAP Dibër urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e Dine Hoxha, si më poshtë:

I.T., mësues- Kryetar
L.Zh., mësuese- Anëtare
M.B., kryetar i bordit- Anëtar
R.Zh., kryetar i këshillit të prindërve-Anëtar
S.Q., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar

b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Sipas pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, komisioni ka bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimi. Në dosje **nuk** disponohet procesverbal ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e

tyre pranë sekretarisë së ZVAP, për pozicionin e drejtorit të shkollës Dine Hoxha, në mënyrë që të identifikohen numri i dosjeve të mara në dorëzim.
Më datë 21.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Komisioni **nuk** ka përgatitur procesverbal për vlerësimin e të dhënave të kandidatëve.
Intervistimi i kandidatëve
Në dosje **nuk** diponohet informacion lidhur me shkresën e njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, pyetjet e intervistës së strukturuar dhe votimin e komisionit.
Vlerësimi final i komisionit
Vlerësimi i kandidatëve në pikë rezulton të jetë kryer në të njëjtën datë me vlerësimin paraprak dhe intervistimin e tyre. Komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
E.T.			22
S.B.			9.7

Nga auditimi konstatohet komisioni **nuk** ka pasqyruar vlerësimin me pikë sipas çështjeve specifike për kandidatët sipas seksioneve të shtojcës nr.6, dhe evidentimin e pikëve në intervistë apo dosjet e kandidatëve. Vlerësimi është dhënë vetëm në pikë totale dhe firmosur nga ta. Në këtë shkresë,për kandidaten E.M. komisioni është shprehur se skualifikohet, pasi nuk plotëson kriteret.
Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me pikën 10.b të udhëzimit nr. 2, ku përcakton se "*Komisioni njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune*" dhe pikën 10.c ku përcaktohet se "*pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni*", Komisioni **nuk** ka njoftuar kandidaten për mungesat e konstatuar, por i ka skualifikuar kandidatet, dhe ka kryer intervistimin e kandidatëve të kualifikuar, në të njëjtën ditë kur është kryer edhe vlerësimi i dosjeve.
Sipas shkresës nr. 1223, prot datë 21.08.2020 është kryer dorëzimi i dosjeve të dy kandidatëve me më shumë pikë nga komisioni për ZVAP Dibër sipas pikës C.12 të udhëzimit nr.2.
Gjithashtu në dosje nuk disponohen ankesa të kandidatëve për këtë proces, në vijim të pikës C.11 të udhëzimit nr.2.

c. Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Në përputhje me pikës D.1 të udhëzimit nr.2, me shkresën nr. 126/1, prot datë 19.08.2020, znj. S.K. është autorizuar nga ZVAP Dibër, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacioneve të kandidatëve. Pas dorëzimit të dosjeve nga komisioni **nuk** disponohet në dosje një relacion i përgatitur prej saj për shqyrtimin e tyre.
Në vijim, Drejtori i ZVAP Dibër ka bërë përcjelljen e dokumentacioneve të dy kandidatëve me pikët më të mira sipas shkresës nr.1229, prot datë 24.08.2020. Në vijim, rezulton se kandidatët nuk janë intervistuar nga DRAP Durrës dhe në tejkalim të afateve nuk disponohet asnjë informacion prej kësaj strukture.

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se për procedurën e shkollë Dine Hoxha, nuk mundëm të konkludonim mbi shkresën në të cilën është njoftuar bashkia Dibër për dërgimin e përfaqësuesit të saj, pasi në dosje disponoheshin 3 variante të ndryshme shkresash, ku përfshihen shkresa pa numër protokolli, me datë 20 gusht dhe 21 gusht. Në disa shkresa data për zhvillimin e komisionit është 19 gusht dhe në disa variante 21 gusht.

Nga auditimi konstatohet se ZVAP Dibër **nuk** disponon një faqe zyrtare interneti për publikimin e shpalljeve të vendeve vakante në institucionet arsimore në juridiksionin e saj, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, Kreu I, pika A.3 dhe Rregulloren e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë datë 30.04.2019, neni 37 pika a.

Nga auditimi konstatohet se për procedurën e shkollës Dine Hoxha, lidhur me përfaqësuesit e mësuesve dhe prindërve në komision rezulton se shkresa e dërgimit të përfaqësuesve nga shkolla është e datës 4 gusht, protokolluar në ZVAP në datë 18 gusht, në një kohë ku njoftimi nga ZVAP për shkollën për caktimin e përfaqësuesve është në data të mëvonshme. Në shkresën e Shkollës pasqyrohet edhe përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Dine Hoxha është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Dibër. Dosja përmban mangësi në dokumentacion, të tilla si procesverbali për numrin e dosjeve që i dorëzohen komisionit nga ZVAP, procesverbali i komisionit për vlerësimin e kandidatëve, dokumenti i njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, procesverbali i intervistimit të kandidatëve, pyetjet e intervistës së strukturuar.

Nga verifikimi i dokumentacioneve të kandidatëve konstatohet se për znj. E.M., komisioni është shprehur se kandidati skualifikohet pasi nuk disponon kualifikimin arsimor të nevojshëm për pozicionin, por **nuk** dokumentohet në dosje të jetë njoftuar kandidati për mangësitë e konstatuara në dosjet respektive në mënyrë që nëse këto dokumentacione disponohen, të dorëzohen pranë ZVAP Dibër brenda 3 ditëve, sikundër përcakton pika C.11 e udhëzimit nr. 2.

Nga auditimi konstatohet se kandidatët janë intervistuar në të njëjtën ditë që është kryer edhe vlerësimi i dosjeve, si dhe është bërë shpallja e kandidatëve fitues, pra komisioni nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr.2, pika C.10: "*b) njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune;c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni; d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit." Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10; f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.*

Nga auditimi i dosjeve të kandidatëve të shkollës Dine Hoxha rezulton se shkresa për masat disiplinore (nëse kanë ose jo) është lëshuar nga ZVAP Dibër dhe jo DRAP Durrës.

Nga auditimi mbi të dhënat e kandidatëve ne dosje, dhe lidhur me dokumentacionet në dispozicion rezulton se vlerësimi në pikë për kandidatët nga komisioni është bazuar sipas vetëvlerësimit të kandidatëve, dhe jo dokumentacionit real të dorëzuar nga komisioni.

Nga auditimi konstatohet se për shkollën Dine Hoxha, shtojca 5 e udhëzimit nuk është plotësuar drejt nga komisioni.

Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Dibër, në vijim të Pikës D.1 e cila përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*", pasi ZVAP nuk rezulton të ketë identifikuar këto parregullsi dhe të ketë përgatitur një relacion lidhur me procedurën.

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në*

Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve."

Nga auditimi konstatohet se pas përcjelljes së dosjeve pranë DRAP Durrës në 24.08.2020, **nuk** disponohet informacion lidhur me vijueshmërinë e procesit, **në tejkalim të afateve nga DRAP.**

Komisioni i vlerësimit të dosjeve është përbërë nga:
z. I.T., Kryetar,
znj. L.Zh., mësuese,
z. M.B., kryetar i bordit,
z. R.Zh., kryetare e këshillit të prindërve,
z. S.Q., përfaqësues i pushtetit vendor.

2. Personi i autorizuar nga ZVAP Dibër për shqyrtimin e dokumentacionit të komisionit është znj. S.K..

3. znj. B.D., Drejtor i ZVAP Dibër.

4. znj. V.L., ish Drejtor i DRAP Durrës.

SHKOLLA NAZMI RUSHITI

a. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit:

Kreu I, pika C.1 e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : ***"****Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me shkresën nr. 1203, prot datë 20.08.2020 ZVAP Dibër ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Nazmi Rushiti". Në vijim nuk disponohet komunikim shkresor nga Bashkia mbi personin e përzgjedhur prej tyre.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Me shkresën nr. 36, protokolluar në shkollën Nazmi Rushiti, datë 11.08.2020 dhe ZVAP Dibër datë 18.08.2020, janë përcjellë pranë ZVAP Dibër anëtarët e komisionit,znj. K.K., Kryetar i Komisionit, Sh.K, mësues, z. S.I., Kryetar i Bordit, z. D.L., Kryetar i Këshillit të Prindërve. Bashkëlidhur edhe procesverbali i shkollës për përzgjedhjen e përfaqësuesve prej saj. Mbetet e pakuptimtë se përse përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes pasqyrohet në shkresën e shkollës, përpara dërgimit të shkresës nga ZVAP pranë bashkisë dhe kthimit të përgjigjes prej tyre.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Në mbështetje të pikës 6 dhe 7 të gërmës C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr. 1216, prot. datë 20.08.2020, ZVAP Tiranë i ka përcjellë DPAP-së, DRAP Durrës, Federatës së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë ka njoftimin se mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për Gjimnazin "Nazmi Rushiti" do të zhvillohej në ambientet e shkollës, në datë 21.08.2020. Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Dibër i ka kërkuar institucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për

të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj nuk disponohet informacion nga institucionet respektive për pjesëmarrje në këtë mbledhje.

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 413, datë 19.08.2020, protokolluar në ZVAP Dibër, sipas shkresës nr. 1204, prot datë 19.08.2020, Drejtori i ZVAP Dibër urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollë Nazim Rushiti, si më poshtë:

1.K.K., mësues- Kryetare
2.Sh.K., mësuese- Anëtare
3.S.I., kryetar i bordit- Anëtar
4.D.L., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtar
5.E.K., përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare

b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Sipas pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, komisioni ka bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimi. Në dosje **nuk** disponohet procesverbal ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP, për pozicionin e drejtorit të shkollës Nazim Rushiti, në mënyrë që të identifikohen numri i dosjeve të mara në dorëzim.

Më datë 21.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.

Komisioni **nuk** ka përgatitur procesverbal për vlerësimin e të dhënave të kandidatëve.

Intervistimi i kandidatëve

Në dosje **nuk** disponohet informacion lidhur me shkresën e njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, pyetjet e intervistës së strukturuar dhe votimin e komisionit.

Vlerësimi final i komisionit

Vlerësimi i kandidatëve në pikë rezulton të jetë kryer në të njëjtën datë me vlerësimin paraprak dhe intervistimin e tyre. Komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
E.C.	14	50	64
Xh.S.	7.2	50	57.2

Nga auditimi konstatohet komisioni **nuk** ka pasqyruar vlerësimin me pikë sipas çështjeve specifike për kandidatët sipas seksioneve të shtojcës nr.6, dhe evidentimin e pikëve në intervistë apo dosjet e kandidatëve. Vlerësimi është dhënë vetëm në pikë totale dhe firmosur nga ta. Në kundërshtim me udhëzimin është bërë vlerësimi prej **50 pikësh** për kandidaten, në një kohë ku udhëzimi parashikon **maksimumi 10 pikë**. Sipas shkresës nr. 1224, prot datë 21.08.2020 është kryer dorëzimi i dosjeve të dy kandidatëve me më shumë pikë nga komisioni për ZVAP Dibër sipas pikës C.12 të udhëzimit nr.2.

Gjithashtu në dosje nuk disponohen ankesa të kandidatëve për këtë proces, në vijim të pikës C.11 të udhëzimit nr.2.

c. Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Në përputhje me pikës D.1 të udhëzimit nr.2, me shkresën datë 19.08.2020, znj. S.K. është autorizuar nga ZVAP, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacioneve të kandidatëve. Pas dorëzimit të dosjeve nga komisioni **nuk** disponohet në dosje një relacion i përgatitur prej saj për shqyrtimin e tyre.

Në vijim, Drejtori i ZVAP ka bërë përcjelljen e dokumentacioneve të dy kandidatëve me pikët më të mira sipas shkresës nr.1229, prot datë 24.08.2020. Në vijim, rezulton se kandidatët **nuk** janë intervistuar nga DRAP Durrës dhe në tejkalim të afateve nuk disponohet asnjë informacion prej kësaj strukture. Sipas ZVAP, shkak për këtë është mos pasja e shkollës së drejtorëve prej kandidatëve.

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përcjellë për ZVAP Dibër nga shkolla për të cilën do të kryhen procedurat e konkurrimit dhe jo bashkia Dibër. Mbetet e pakuptimtë se përse përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes pasqyrohet në shkresën e shkollës, përpara dërgimit të shkresës nga ZVAP pranë bashkisë dhe kthimit të përgjgjes prej tyre, pasi shkresa e ZVAP për Bashkinë Dibër është e datës 20 gusht, dhe shkresa e shkollës për njoftimin e anëtarëve të komisionit e datës 11 gusht.

Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Nazmi Rushiti është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Dibër. Dosja përmban mangësi në dokumentacion, të tilla si procesverbali për numrin e dosjeve që i dorëzohen komisionit nga ZVAP, procesverbali i komisionit për vlerësimin e kandidatëve, dokumenti i njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, procesverbali i intervistimit të kandidatëve, pyetjet e intervistës së strukturuar.

Nga auditimi i dosjeve të kandidatëve të shkollës Nazmi Rushiti rezulton se shkresa për masat disiplinore (nëse kanë ose jo) është lëshuar nga ZVAP Dibër dhe jo DRAP Durrës.

Nga auditimi konstatohet se për shkollën Nazmi Rushiti, shtojca 5 e udhëzimit **nuk** është plotësuar drejt nga komisioni, ku më hollësisht nga verifikimi i dosjes së kandidatit Xh. S rezulton se mungon diploma, shkalla e kualifikimit, lista e notave. Këto parregullsi nuk janë identifikuar nga komisioni i cili i ka kryer vlerësimin në pikë në bazë të vetëdeklarimit të aplikantit. Komisioni i ka vlerësuar kandidatët me 50 pikë për intervistën, në një kohë ku maksimumi i pikëve sipas udhëzimit për intervistën është 10.

Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Dibër, në vijim të Pikës D.1 e cila përcakton se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*", pasi ZVAP nuk rezulton të ketë identifikuar këto parregullsi dhe të ketë përgatitur një relacion lidhur me procedurën.

Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve."

Nga auditimi konstatohet se pas përcjelljes së dosjeve pranë DRAP Durrës në 24.08.2020, **nuk** disponohet informacion lidhur me vijueshmërinë e procesit, në tejkalim të afateve nga DRAP.

1. Komisioni i vlerësimit të dosjeve është përbërë nga:
K.K., mësues- Kryetare
Sh.K., mësuese- Anëtare
S.I., kryetar i bordit- Anëtar

D.L., kryetare e këshillit të prindërve-Anëtar
E.K., përfaqësuese e pushtetit vendor- Anëtare
2. Personi i autorizuar nga ZVAP Dibër për shqyrtimin e dokumentacionit të komisionit është znj. S.K..
3. znj. B.D., Drejtor i ZVAP Dibër.
4. znj. V.L., ish Drejtor i DRAP Durrës.

Për **3 shkollat** e tjera të Shpalljes nr.1 **nuk** është zhvilluar procedura:
Konkurse të cilat nuk janë zhvilluar si rezultat i mungesë së aplikantëve:
Nga 6 shkollat për të cilat është hapur konkurrimi për pozicionin drejtor në ZVAP Dibër, rezulton se për 3 shkollat e mëposhtme nuk është zhvilluar procesi i konkurrimit për drejtor si rezultat i mungesës së kandidatëve.
Për Shpalljen nr. 1, datë 05.08.2020 :
Për shkollën 9 vjeçare Selishte nuk ka patur aplikantë.
Për shkollën Gjergj Kastrioti ka patur 1 aplikantë.
Për shkollën Haki Stermilli ka patur 1 aplikantë .
Informacioni i mësipërme, i është përcjellë nga DRAP Durrës, nga ZVAP Dibër më datë 21.08.2020.
Nga auditimi rezultoi se ZVAP Dibër nuk ka një faqe zyrtare web, dhe njoftimet janë bërë vetëm në ambientet e brendshme të ZVAP Dibër. Në gjykimin e grupit të auditimit mungesa e një faqe zyrtare ku të bëhet shpallja e vendeve vakante për pozicionin drejtor ka ndikuar negativisht në numrin e aplikantëve për konkurset e hapura.
Nëpërmjet **Shpalljes nr. 2,** me nr. 1066/1 prot., datë 19.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vorë, Klos, Mat, Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Krujë, dhe Tiranë. Kjo shpallje nuk është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZVAP Dibër pasi **nu**k disponohet një faqe zyrtare, por në ambientet e kësaj zyre vendore. Nëpërmjet kësaj shpallje, për **ZVAP Dibër** janë shpallur **5 pozicione të lira** për drejtor të shkollave si më poshtë:
1. Shemsi Haka,
2. 9 Vjeçare Maqellare,
3. Arras,
4. Hasan Leka
5. Luzni
-Nga auditimi konstatohet se procedurat e konkurrimit për shkollat **Shemsi Haka** dhe **Hasan Leka** janë **anulluar** nga DRAP Durrës, sipas shkresës nr. 1198/1 prot datë 21.08.2020, ku sipas vendimit nr.57, datë 21.08.2002 të DRAP Durrës është vendosur anulimi i pjesshëm i aktit adminisrativ nr. 1066/1, datë 19.08.2020. Kjo, për shkak se për shkollën Shemsi Haka shpallja ishte bërë për pozicionin e drejtueses të larguar me lejen e lindjes, ndërsa për shkollën Hasan Leka pasi drejtori i shkollës ishte definitv, dhe ishte përfshirë gabimisht në listë.
-Proocedurat e konkurrimit për shkollat **9 vjeçare Maqellare, Arras, dhe Luzni janë anulluar**, pasi ka patur vetëm 1 kandidat.

MBI VENDIMET GJYQËSORE

Vendime te ekzekutuara
ZVAP Dibër për vitin **2019** ka ekzekutuar 6 vendime gjyqësore në vlerën **3,169,059 lekë**. Për vitin 2020 nuk është kryer asnjë pagesë.

Vendime të pa ekzekutuara
ZVAP Dibër ka ende pa ekzekutuar vendime në vlerën **10,417,471 lekë**.

Çështje gjyqësore në proces me objekt kthimin në punë

ZVAP Dibër nuk ka informacion për çështjet në procese gjyqësore.
Për gjetjet e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi:
-znj. V.L. ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës,
-znj. B.D., Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Dibër
-Anëtarët e komisioneve të shkollave për të cilat janë evidentuar parregullsi.

ZVAP BULQIZË

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Bulqizë ka nën juridiksionin e saj 17 institucione publike te arsimit parauniveristar nga të cilët **10 drejtorë (ose 59%)** janë të komanduar me vendime që datojnë që në periudha të mëparshme. Për këto, edhe pse ZVAP Bulqizë ka informuar DPAP në vijim të shkresës së dërguar prej saj, me email-in e datës 24.06.2020, për to janë hapur procedura rekrutimi **vetëm për 2 shkolla** në shpalljen nr.1 dhe **1 shkollë** në shpalljen nr.2. Më hollësisht, lista e shkollave dhe datat e komandimit të drejtorëve paraqiten si më poshtë[45]:

Nr.	INSTITUCIONI ARSIMOR	EMËR MBIEMËR	DATA E KOMANDIMIT
1	**Shkolla 9-vjeçare "Jashar Kola" Sopot**	**R.T.**	**25.09.2020**
2	**Shkolla 9-vjeçare Topojan**	**N.J.**	**17.09.2016**
3	**Shmb "jani fullani" Krastë**	**F.Z.**	**03.09.2017**
4	Shkolla 9-vjeçare "Jashar Kola" Sopot	A.S.	24.10.2017
5	Shkolla 9-vjeçare "Man Jella" Zogje	A.S.	08.09.2017
6	Shkolla 9-vjeçare "Shefqet Tançi" Bulqizë.	G.S.	13.09.2017
7	Shkolla 9-vjeçare "Ibrahim Daçi" Shupenzë	E.S.	03.09.2018
8	Shkolla 9-vjeçare "Faslli Cami" Viçisht	L.T.	14.11.2019
9	Gjimnazi "Rifat Manjani" Shupenzë	A.K.	21.09.2015
10	Shmb "Asllan Keta" Fushë - Bulqizë	S.C.	01.10.2018

Si rezultat, ekzistojnë **10 shkolla** nën juridiksionin e ZVAP Bulqizë në të cilat drejtuesi vijon të jetë i komanduar, me vendime që datojnë që në vitin 2015, dhe **për 7 prej** tyre nuk rezultojnë të jenë bërë shpalljet për emërimin e drejtuesve të shkollave respektive.
Për sa i përket shpalljeve të bëra nga DRAP Durrës për vitin 2020, nga ZVAP Bulqizë procesi ka **konkluduar vetëm për 1 rast** për të cilin është bërë zëvendësim i përkohshëm deri në përfundim të shkollës së drejtorëve nga fituesi. Shpallja tjetër është anuluar pasi ka patur vetëm 1 aplikant.
Për periudhën objekt auditimi 2019-2020,, **në 2 raste** procedurat për përzgjedhjen e drejtuesve janë kryer me **komandim,** si pasojë e daljes në pension të drejtorit të shkollës në një rast dhe larguar për në ZVAP Bulqizë në një rast tjetër; dhe **1 rast** është kryer **zëvendësim i përkohshëm** me përfundim të procedurave të konkurrimit sipas udhëzimit nr.2. Sipas udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar(ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 19.3.2020), *Kreu I. Pika E.* 2, përcakton se: " *Kur vendi i drejtorit të IPAP shpallet i lirë, drejtori i DRAP cakton nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, deri në përfundim të procesit të konkurrimit sipas afateve të përcaktuara në kreun I të këtij udhëzimi*", duke qenë se shkollat nuk kanë patur nën drejtor zëvendësimi është kryer nga mësuesit e shkollës.
Nëpërmjet **Shpalljes nr. 1,** nr. 1066 prot., datë 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", ZVAP Bulqizë **nuk** disponon një faqe zyrtare interneti dhe si rezultat për këtë shpallje nuk është bërë publikimi zyrtar për njoftimin e të interesuarave. Sipas këtij dokumenti të DRAP Durrës është shpallur vendi i lirë i punës për drejtor në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP për **2 shkolla** nën juridiksionin e ZVAP Bulqizë si më poshtë:

1.Shkolla Jashar Kola Sopot
2. Shkolla Jani Fullani Krastë

[45] Shkollat me bold janë shkollat në të cilat është bërë shpallja për drejtor. Shkolla Jashar Kola është bërë zëvendësim i përkohshëm pas procedurave të rekrutimit

Grupi i auditimit shqyrtoi **2 dosjet** e vendosura në dispozicion nga ZVAP Bulqizë mbi procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore nën juridiksionin e kësaj zyre arsimore, konstatimet për të cilat janë si më poshtë.

1. JASHAR KOLA

a. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit:

Kreu I, pika C.1 e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcakton se : **"***Komisioni përbëhet nga:*
a) kryetari i bordit të IPAP;
b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;
c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore."

Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pas shpalljes nr. 1, të datës 05.08.2020, me anë të shkresës nr. 566/1, datë 17.08.2020, ZVAP Bulqizë ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Jashar Kola", brenda datës 19.08.2020. Me anë të shkresës nr. 748/2, datë 20.08.2020, Bashkia Bulqizë ka përcjellë personin e përcaktuar nga kjo njësi, z. H.I., për të qenë pjesë e komisionit për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të shkollës në fjalë.

Përfaqësuesit nga shkolla dhe prindërit

Me anë të shkresës nr. 376/1, datë 19.08.2020 janë përcjellë pranë ZVAP Bulqizë anëtarët e komisionit nga mësuesit e shkollës, pas votimit nga stafi i shkollës, duke përzgjedhur znj. F.P. (mësuesja me eksperiencën më të gjatë të punës) dhe znj. N.C., mësuese, z. A.B. Kryetar i Bordit dhe z. E.H., Kryetar i Këshillit të Prindërve, sipas pikës C.3 të udhëzimit nr.2.

Përfaqësuesit nga DPAP, DRAP Durrës dhe Sindikatat arsimore

Në mbështetje të pikës 6 dhe 7 të gërmës C të kreut I, të udhëzimit nr.2, me anë të shkresës nr. 7701, prot. datë 18.08.2020, ZVAP Bulqize i ka përcjellë DPAP-së dhe DRAP Durrës, njoftimin se mbledhja e Komisionit të Vlerësimit për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për shkollën Jashar Kola do të zhvillohej në ambientet e kësaj shkolle <u>në datë 20.08.2020,</u> ora 10:00. Nëpërmjet kësaj shkrese, ZVAP Bulqizë i ka kërkuar insitucioneve të cilave i është drejtuar, caktimin e një përfaqësuesi për të qenë pjesëmarrës në këtë procedure. Në vijim të saj, me shkresën nr. 1183/3, prot datë 20.08.2020 DRAP Durrës ka autorizuar snj. E.C. për të marë pjesë si përfaqësuese e DRAP Durrës në mbledhjet e komisionit të vlerësimit. <u>Znj. E.C. është Nën Drejtoreshë në një tjetër shkollë në ZVAP Bulqizë.</u>

Urdhri i ngritjes së Komisionit nga ZVAP

Me anë të Urdhrit nr. 55, datë 19.08.2020, protokolluar në ZVAP Bulqizë, sipas shkresës nr. 566/5, prot datë 19.08.2020, Drejtori i ZVAP Bulqizë urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës Jashar Kola, si më poshtë:

F.P., mësues- Kryetare

N.C., mësuese- Anëtare

A.B., kryetar i bordit- Anëtar

E.H., kryetar i këshillit të prindërve-Anëtar

H.I., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar

b. Procedurat e ndjekura nga Komisioni

Vlerësimi i dosjeve

Sipas pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, komisioni ka bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimi. Për marrjen në dorëzim të dosjeve konstatohet <u>se nuk është mbajtur një procesverbal ndërmjet</u> ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAP, <u>në mënyrë që të dokumentohet numri i dosjeve</u>. Më datë 20.08.2020 anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në mbështetje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit Nr. 2,

datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, më datë 22.08.2020, mbi vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Jashar Kola", komisioni është shprehur se dokumentacionet e kandidatëve nuk kanë mungesa.
Procesverbali është firmosur nga 5 anëtarët e komisionit, por është i paprotokolluar.
Intervistimi i kandidatëve
Pas vlerësimit të dosjeve, në datën 27.08.2020, komisioni ka zhvilluar intervistat për 2 kandidatët, sipas pikës 10.e e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit. Në dosje nuk disponohen dokumentacionet për njoftimin e kandidatëve për datën e intervistës. Vërehet se, edhe ky procesverbal është i firmosur nga komisioni por i paprotokolluar. Në procesverbal janë përcaktuar pyetjet e intervistës së strukturuar, si më poshtë:
1. Si veprohet për arkëtimin e parave ose kontributeve që i dhurohen shkollës?
2. Sa është shuma maksimale e kontributit vjetor për çdo familje?
3. Kush i grumbullon donacionet e prindërve?
4. Si ngrihet komisioni i blerjeve dhe si procedon për blerje dhe nevoja të shkollës?
5. Cili është niveli arsimor i mësuesit në arsimin fillor?
6. Cili është niveli arsimor i mësuesit në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë?
Për vlerësimin me pikë të kandidatëve në përfundim të intervistës, anëtarët e komisionit kanë votuar në mënyrë të pavarur për çdo pyetje.
Vlerësimi final i komisionit
Në vijim, komisioni ka plotësuar Shtojcën 5 sipas pikës 10. d e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, firmosur nga anëtarët e komisionit dhe shtojcën 6 të udhëzimit (pa datë) sipas pikës 10.g, duke pasqyruar vlerësimin e kandidatëve. Pikët në total nga vlerësimi i dosjeve dhe intervistave të kandidatëve paraqiten si më poshtë:

Kandidati	Vlerësimi i dosjes	Vlerësimi nga intervista	Total
R.T.	12.2	9	**21.2**
K.D.	6.8	8	**14.8**

Me shkresën nr. 780, datë 04.09.2020 janë përcjellë nga Komisioni dosjet e kandidatëve dhe vlerësimi i tyre, i firmosur nga Kryetari i Komisionit, sipas pikës C.12 të udhëzimit nr.2, por nuk është firmosur nga marrësi në dorëzim i dokumentacioneve. Gjithashtu në dosje nuk disponohen ankesa të kandidatëve për këtë proces, në vijim të pikës C.11 të udhëzimit nr.2.

c. Finalizimi i procesit të përzgjedhjes së drejtuesve

Në përputhje me pikës D.1 të udhëzimit nr.2, me shkresën nr. 609, prot datë 19.08.2020, Z. O.T. është autorizuar nga Drejtori i ZVAP Bulqizë për të kryer shqyrtimin e dokumentacionit të komisionit.
Me shkresën nr. 780/1, prot datë 4.9.2020 të ZVAP Bulqizë janë përcjellë dy dosjet e kandidatëve dhe vlerësimi i tyre pranë DRAP Durrës.
Në vijim të procedurave të konkurrimit, DRAP Durrës me shkresën nr. 1563/2, prot datë 25.09.2020 ka vendosur zëvendësimin e përkohshëm të z. R.T., në vend të z. M.H. i cili ka plotësuar kriteret për pension pleqërie. Në këtë shkresë është përcaktuar se zëvendësimi i përkohshëm do të vazhdojë deri në konfirmimin e dosjes së z. T nga shkolla e drejtorëve.

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e konstatuara në këtë proces janë si më poshtë:

-Nga auditimi konstatohet se dosja me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollës Jashar Kola është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar në ZVAP Bulqizë. Dosja nuk përmban dokumentin e njoftimit të kandidatëve për datën e intervistës, dorëzimin e dosjeve të ardhura pranë ZVAP për Komisionin e Vlerësimit. Procesverbalet e komisionit janë të pa protokolluara. Dosjet e kandidatëve janë përcjellë për ZVAP nga Kryetari i

Komisionit, sipas pikës C.12 të udhëzimit nr.2, por dokumenti nuk është firmosur nga marrësi në dorëzim i dosjeve (përfaqësuesi i ZVAP).
-Nga auditimi konstatohet se ZVAP Bulqizë **nuk** disponon një faqe zyrtare interneti dhe si rezultat për këtë shpallje nuk është bërë publikimi zyrtar për njoftimin e të interesuarave në kandidatin për këtë procedurë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, Kreu I, pika A.3 dhe Rregulloren e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë datë 30.04.2019, neni 37 pika a.
-Në kundërshtim me Kreu-n I, Pika B.1.d të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor duhet të jetë pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012*", i ndryshuar, si dhe me Pikën 1.d të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 sipas të cilës: "*Kandidati për drejtor duhet të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe te jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit ka kaluar në fazën e intervistimit nga Komisioni, si dhe ka përcjellë në DRAP Durrës kandidatë të cilët **nuk** ishin të certifikuar nga shkolla e Drejtorëve"
-Nga auditimi konstatohet se në vijim të dërgimit të dokumentacioneve nga ZVAP Bulqizë në 4.9.2020, DRAP Durrës **nuk** ka respektuar afatet e përcaktuara në çështjen D, pika 5 pasi shpallja e fituesit të kësaj procedure është kryer në 25.09. Në zbatim të udhëzimit nr.2, pika D e cila përcakton se: "3. *Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston dy kandidatët.",* DRAP ka njoftuar se intervista do të zhvillohet në 11.09.2020. Në vijim, në kundërshtim me pikën D.5 e cila citon se "*Brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP.",* vendimi i DRAP n**u**k është shpallur deri në 25.09.2020.
-Komisioni i Vlerësimit të dosjeve të kandidatëve përbëhet nga:
1.F.P., mësues- Kryetare
2.N.C., mësuese- Anëtare
3.A.B., kryetar i bordit- Anëtar
4.E.H., kryetar i këshillit të prindërve-Anëtar
5.H.I., përfaqësues i pushtetit vendor- Anëtar
-Përfaqësues i DRAP Durrës në Komisionin e Vlerësimit ka qenë z. F.E..
-Dosja e komisionit të vlerësimit është shqyrtuar nga z. O.T., person i autorizuar nga ZVAP Bulqizë.
-z. K.K., Drejtori i ZVAP Bulqizë.
- znj. V.L., ish-Drejtor i DRAP Durrës.

Jani Fullani Krastë

Mungesa e aplikantëve

Referuar shkresës nr. 603, datë 18.08.2020, me lëndë "Kërkesë për shpalljen e procedurave të konkurrimit për drejtues në shkollën e mesme të bashkuar "Jani Fullani", ZVAP Bulqizë i ka dërguar DRAP Durrës informacionin si vijon, në vijim të hapjes së procedurës së konkurrimit për shkollën "Jani Fullani" sipas Shpalljes nr. 1 të datës 05.08.2020, në ZVAP Bulqizë është protokolluar vetëm dokumentacioni i **një aplikanti** brenda datës 17.08.2020. Në bazë të Kreut Nr. 1, pika F, të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, ZVAP Bulqizë i ka kërkuar DRAP Durrës të shpallë procedurat për konkurs pozicioni drejtues në shkollën e mesme të bashkuar "Jani Fullani".
Kjo shpallje rezulton e afishuar vetëm në ambientet e ZVAP Bulqizë. Grupi i auditimi kërkoi për shpalljen e hapjes së procedurës për konkursin për drejtor të shkollës "Jani Fullani", në faqen zyrtare të ZVAP Bulqizë. Rezultoi se, ZVAP Bulqizë **nuk** ka një faqe zyrtare web, **në kundërshtim me** Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, Kreu I, pika A.3 dhe Rregulloren e Ministrit

të Arsimit Sportit dhe Rinisë datë 30.04.2019, neni 37 pika a.. Vendet e lira për pozicionin drejtor sipas Shpalljes nr. 1 janë publikuar në faqen e Facebook të ZVAP Bulqizë. Në gjykimin e grupit të auditimit, mos pasja e një faqe zyrtare web për publikimin e njoftimeve mbi vendet vakante dhe shpalljet e konkurseve, është një faktor që ka ndikuar negativisht në paraqitjen e aplikantëve për pozicionin vakant të drejtorit..

Referuar Shpalljes nr.3 07.10.2020, të bërë nga DRAP për hapjen e procedurave të konkurrimit për pozicionin e drejtorit në shkollat e ZVAP-ve nën juridiksioni e DRAP Durrës, nuk rezulton të jetë rihapur procedura e konkurrimit për drejtor të shkollës "Jani Fullani", në ZVAP Bulqizë.

Nëpërmjet **Shpalljes nr. 2**, nr. 1066 prot., datë 19.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)", DRAP Durrës ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar në ZVAP-et Bulqizë, Kavajë, Vore, Klos, Mat, Dibër, Rrogozhinë, Kamëz, Durrës, Krujë, dhe Tiranë. Nëpërmjet kësaj shpallje, për ZVAP Bulqizë është shpallur **1 pozicion** i lirë për drejtor të shkollës si më poshtë:

Topojan

Topojan

Mungesa e aplikantëve

Referuar shkresës nr. 607/1 prot., datë 01.09.2020, me lëndë "Kërkesë për shpalljen e procedurave të konkurrimit për drejtues në shkollën e mesme të bashkuar "Topojan", ZVAP Bulqizë i ka dërguar DRAP Durrës informacionin si vijon, në vijim të hapjes së procedurës së konkurrimit për shkollën "Topojan" sipas Shpalljes nr. 2 të datës 19.08.2020, në ZVAP Bulqizë **nuk** është protokolluar dokumentacioni i ndonjë aplikanti brenda datës 31.08.2020. Në bazë të Kreut Nr. 1, pika F, të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, ZVAP Bulqizë i ka kërkuar DRAP Durrës të shpallë procedurat për konkurs pozicioni drejtues në shkollën e mesme të bashkuar "Topojan".

Kjo shpallje rezulton e afishuar vetëm në ambientet e ZVAP Bulqizë. Grupi i auditimi kërkoi për shpalljen e hapjes së procedurës për konkursin për drejtor të shkollës "Topojan", në faqen zyrtare të ZVAP Bulqizë. Rezultoi se, ZVAP Bulqizë nuk ka një faqe zyrtare web. Vendet e lira për pozicionin drejtor sipas Shpalljes nr. 2 janë publikuar në faqen e Facebook të ZVAP Bulqizë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, Kreu I, pika A.3 dhe Rregulloren e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë datë 30.04.2019, neni 37 pika a. Në gjykimin e grupit të auditimit, mos pasja e një faqe zyrtare web për publikimin e njoftimeve mbi vendet vakante dhe shpalljet e konkurseve, është një faktor që ka ndikuar negativisht në paraqitjen e aplikantëve për pozicionin vakant të drejtorit.

Referuar Shpalljes nr.3 datë 07.10.2020, të bërë nga DRAP për hapjen e procedurave të konkurrimit për pozicionin e drejtorit në shkollat e ZVAP-ve nën jurdiksioni e DRAP Durrës, nuk rezulton të jetë rihapur procedura e konkurimit për drejtor të shkollës "Topojan", në ZVAP Bulqizë.

MBI VENDIMET GJYQËSORE

Vendime te ekzekutuara

ZVAP Bulqizë për vitin **2019** ka ekzekutuar **3** vendime gjyqësore për të cilat likuidimi është kryer në këste, ku pagesat e kryera në vitin 2019 janë **në shumën totale 2,118,000 lekë**.

Vendime të pa ekzekutuara

ZVAP Bulqizë ka ende pa ekzekutuar vlerën **734,160 lekë** sipas Vendimit nr.368 datë 18.08.2020 i Gjykatës.

Çështje gjyqësore në proces me objekt kthimin në punë

Sipas ZVAP Bulqizë, ka aktualisht **4 çështje në proces** për kthimin në punë, më hollësisht:

1. Me vendimin nr 3053, datë 11.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë znj. R.H. ka fituar 16 (gjashtëmbëdhjetë) paga, aktualisht në proces Gjyqësor me Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me datë 17.11.2020.
2. Me vendimin nr 3292, datë 24.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kreditori znj. M.L. ka përfituar rikthim në punë dhe pagimin e pagave deri në rikthimin e saj në punë, aktualisht në proces me Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
3. Me vendimin nr 242, datë 24.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër znj. K.K. ka fituar 15.5 paga, ankimuar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
4. Me vendimin nr 129, datë 06.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër znj. A.T. ka fituar 7 (shtatë) paga, ankimuar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Për gjetjet e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi:
-znj. V.L. ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës,
-z. K.K., Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë
-z. O.T., ish punonjës i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/5, prot në KLSH datë 06.01.2021, lënda "Dërgim i objeksioneve në lidhje me projektraportin e auditimit të KLSH nr. 811/4, datë 07.12.2020" nga z. S.H., Drejtor i Përgjithshëm i DPAP, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë. Me qëllim prakticitetin dhe mospërsëritjen e komenteve, fakteve dhe rrethanave të përmendura në Projektraportin e auditimit, si dhe të bazës ligjore të përdorur, është paraqitur vetëm thelbi i kundërshtive, në formë të përmbledhur. Kundërshtitë janë pjesë e dosjes së auditimit në formë fizike, me nënshkrimet origjinale të personave të atakuar. Grupi i auditimit, pasi i lexoi me shumë kujdes këto kundërshti, pa anshmëri, me gjykim dhe skepticizëm profesional, thekson se do të marrë në konsideratë vetëm shpjegimet të cilat janë shoqëruar me dokumente dhe argumente ligjore shtesë, si dhe me prova të reja shkresore të cilat kanë mbështetje ligjore, ndërsa ato shpjegime të cilat nuk gjejnë argumenta, por janë vetëm justifikuese, nuk do të merren në konsideratë dhe do të trajohen përsëri në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Duke vlerësuar pozitivisht punën e grupit të KLSH në auditimin e subjektit të varësisë së institucionit tonë DRAP Durrës, ne si staf drejtues i DPAP jemi të shqetësuar pasi nga grupi i auditimit nuk u mundësua diskutimi apo një ballafaqim me këtë grup. Në disa raste grupi ka dalë jashtë subjektit të auditimit, periudhës së auditimit pasi KLSH sipas ligjit auditon aktivitetin pas kryerjes dhe nuk bëhet pjesë e menaxhimit apo drejtimit të institucionit. Jemi të shqetësuar pasi observacionet tona nuk janë marë në konsideratë dhe nuk janë evidentuar në projektraport siç ne i kemi dërguar dhe nuk është reflektuar asnjë fjalë e jona. Konkretisht nga grupi i auditimit merren kompetenca që u përkasin institucioneve ligjbërëse pasi interpretohet ligji dhe VKM-ja mbi të cilin jemi bazuar në nxjerrjen e një urdhri për një proces konkurrimi brenda juridiksionit administrativ të DPAP-së (sqarojmë se jemi hallka e katërt e hierarkisë: Kuvendi, Qeveria, Ministria dhe DPAP), e pra nuk ka asnjë shkelje apo përgjegjësi ligjore për ne si drejtues. Është në tagrin ligjor të KLSH-së që nëse konstaton kontradikta ta akteve ligjore e nënligjore të paraqesë kundërshtitë dhe të na rekomandojë "Përmirësim ligjor" (Sipas standardeve të auditimit të jashtëm publik). Rekomandimi i dhënë është i përgjithshëm dhe jo i saktë, apo i orientuar konkretisht, sigurisht ne do e vlerësojmë me përgjegjësi. Këtu me të drejtë konstatojmë se nuk ka vend për përgjegjësi administrative e ligjore pasi nuk kemi pasoja, sigurisht mund të ketë vend për përmirësim procedure konkurrimi që të kemi gjithë përfshirje, pra jemi dakord për çdo rekomandim të argumentuar që ta dërgojmë në organin epror MASR për vlerësim e propozime përkatëse. Theksojmë se nëse grupi i auditimit do të kishte kryer ballafaqim një pjesë e problemeve do të ishin sqaruar me frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi. Sqarojmë se nuk jemi dakord me trajtimin e bërë nga grupi i auditimit të këtij problemi dhe kërkojmë të reflektohen sqarimet tona në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Në faqe 71 keni paraqitur pretendimet e

dhëna nga ana jonë si DPAP për emërimin e personelit në DRAP dhe ZVAP me kontratë të përkohshme, ku pranohet se situata që na gjeti ne si institucion të sapokrijuar me një strukturë krejt të re kishte vështirësitë e veta organizative pasi do ngriheshin 4 DRAP dhe 51 ZVAP, proces ky që kërkon maturi dhe një organizim sa më të studiuar, pasi edhe kriteret dhe kërkesat për një arsim parauniversitar sa më profesional janë të larta. Gjithashtu theksojmë se DPAP vepron pas konfirmimit nga MASR në planin e rekrutimeve vjetore ka patur një akt normativ nga Këshilli i Ministrave për pezullimin e procedurave të konkurrimit për shkak të pandemisë, më tej kemi kaluar në fazën e pushimeve të verës ku pjesëmarrja e kandidatëve dhe menaxhimi për shkak të lejeve vjetore të stafeve bëhej e kufizuar. Nuk e kuptojmë se pse mbajmë ne përgjegjësi si drejtues, ndërkohë që ju kemi paraqitur argumente të mbështetura në ligj dhe bazuar në logjikat e menaxhimit publik në përshtatje me situatën e jashtëzakonshme të tërmetit dhe pandemia, ju nuk i merrni parasysh. Sigurisht duhet të bëjmë më shumë, po impakti i situatave të jashtëzakonshme do jap ndikimin e saj në fushën e arsimit dhe pse ne kemi punuar çdo ditë për të përmbushur sa më mirë detyrën, edhe pse situata ka qenë e pafavorshme. Rekomandimi juaj në lidhje me rekrutimet do të zbatohet nga DPAP për të plotësuar stafet e nevojshme në DRAP dhe ZVAP-të, por këmbëngulim se nuk ka vend për përgjegjësi ligjore. Vendosja pas çdo çështje në pikën III.2.2 të përgjegjësisë së Drejtorit të Përgjithshëm e kundërshtojmë me argumentin se nëse ngarkohem me përgjegjësi, grupi i auditimit duhet të dokumentojë gjurmën e auditimit, ku kam nënshkruar si Drejtor i Përgjithshëm i AP, ngarkohem me përgjegjësi direkte ndërkohë që nuk kam asnjë nënshkrim si për emërimin e një Drejtori ose Nëndrejtori në një shkollë të vetme të kontrolluar. Emërimet e tyre nuk janë përgjegjësi e Drejtorit të Përgjithshëm por janë strukturat e DRAP dhe ZVAP që punojnë dhe ne monitorojmë dhe menaxhojmë, pra nuk jemi pjesë direkte e zbatimit të procedurës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me mundësinë e takimit dhe ballafaqimit me grupin e auditimit sqarojmë se, mbështetur në Rregulloren e Procedurave të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, takimi ballafaques realizohet pas përcjelljes së observacioneve të subjektevet lidhur me projekt raportin e auditimit. Më datë 25.01.2021 u zhvillua në ambientet e KLSH-së takimi ballafaques ku u ftuan për të marrë pjesë të gjitha strukturat e përmendura në Projekt-raportin e auditimit, takim në të cilin morën pjesë edhe përfaqësuesit e DPAP-së.

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, sikurse parashikon pika 3 e nenit 6 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", "Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t". Referuar pikës 59 "Raportimit", të Parimeve të Auditimit të Jashtëm Publik në Auditimet e Përputhshmërisë, ISSAI 400, "Parimi i plotësisë kërkon që auditori të marrë parasysh **të gjitha evidencat relevante** të auditimit para lëshimit të raportit." Më hollësisht, sa më sipër trajtohet në Manualin e IDI-it për zbatimin e standardeve INTOSAI, fq.43, ku përcaktohet se, një element i rëndësishëm në auditim është koha kur trajtohet çështja. Trajtimi i çështjeve në auditim duhet të kontribuojë në ndryshime të tilla si reforma apo iniciativa të reja, ndryshe nuk ndikon në ngjarje dhe humbet rëndësinë. Grupi i auditimit ka audituar procesin e përzgjedhjes së drejtuesve të IPAP mbështetur në programin e auditimit, dhe me qëllim evidentimin e problematikave në kohë, në këtë proces i cili realizohet për herë të parë pas ristrukturimit të drejtorive arsimore, për të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësim.*

Lidhur me reflektimin e observacioneve, sikurse u evidentua edhe në takimin ballafaques të datës 25.01.2021, grupi i auditimit ka shqyrtuar me vëmendje observacionet e përcjella nga strukturat përkatëse lidhur me akt-konstatimet, si dhe i ka reflektuar ato në mënyrë të përmbledhur në projekt-raportin e auditimit.

Në përfundim, sqarojmë se megjithë evidenca e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ashtu sikurse u dakortësua edhe në takimin ballafaques me përfaqsuesit e DPAP-së, konstatimi mbi

numrin e lartë të punonjësve të komanduar në ZVAP qëndron, dhe DPAP duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për emërimin definitiv të tyre. Grupi i auditimit mori në konsideratë argumentet e përcjella nga DPAP lidhur me faktorët (tërmeti dhe pandemia) që kanë ndikuar negativisht në këtë proces.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me këto procedura të ndjekura sqarojmë se DRAP Durrës është përballur me së pari, vakum ligjor (dalja e udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 është realizuar 9 muaj më vonë se krijimi i DRAP Durrësit). Së dyti, përplasja e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me procedurën e emërimit dhe shkarkimit të drejtuesit të institucionit arsimor publik parauniversitar. Në nenin 55 të ligjit 69/2012 është përcaktuar se emërimi i drejtorit të institucionit arsimor bëhet nga titullari i njësisë arsimore vendore (dikur DAR/ZA sot ZVAP, ndërsa VKM nr.99, datë 27.02.2019 është përcaktuar se kjo kompetencë është e drejtorit të DRAP). Paqartësia e udhëzimit të sipërcituar në lidhje me pranimin e kandidatëve ose jo të cilët janë certifikuar nga IZHA apo që kanë përfunduar shkollën e drejtorëve. Së treti, numri i madh i vendeve të lira (drejtorë të pa emëruar me procedura konkurrimi). Së katërti, orientimi dhe urdhri i dhënë nga institucionet eprore për zhvillimin sa më parë të procedurave të konkursit. Për vlerësimin në kundërshtim me ligjin 69/2012 me VKM nr.99, datë 27.02.2019, dhe Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, sqarojmë se nuk është kompetencë të Drejtorit të DRAP, ndryshimet e mundshme të akteve ligjore apo nënligjore, por vetëm paraqitja e problematikave të dala gjatë zbatimit të tyre, gjë që ne e kemi bëre në mënyrë të vazhdueshme. DRAP në vijim të procedurave të konkursit ka zbatuar VKM nr.99, dhe Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 për sa është e mundur në kushtet e vakancave ligjore.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nuk janë paraqitur fakte të reja. Me anë të observacionit, përforcohen edhe më tepër gjetjet kryesore të këtij auditimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në zbatim të udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, Kreu C, pika 6 sqarojmë se ZVAP-et janë korrekte në zbatim të kësaj pike, duke njoftuar për vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave të konkurrimit. Në udhëzim është përcaktuar qartë përbërja e këtyre komisioneve dhe mënyra se si veprohet në rast se aty mungon një nga anëtarët. Ndërkohë që prezenca e përfaqësuesit të DRAP nuk është e detyrueshme dhe për rrjedhojë nuk pengon zhvillimin e procedurave. Kjo për analogji dhe të njoftimit që i bëhen dy sindikatave që kanë firmosur kontratën kolektive me MASR, DPAP, DRAP në vijim të njoftimit të ZVAP vendos nëse do të ndjekë ose jo procedurën e konkursit pasi e ka të pamundur të jetë e pranishme në të gjitha procedurat e konkurrimit që zhvillohen në territorin e Shqipërisë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, referuar Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020, i ndryshuar, sikurse është trajtuar dhe në projekt raportin e auditimit, pjesëmarrja e përfaqësuesit të DPAP/DRAP në procedurat e konkurrimit për pozicion drejtor të IPAP është e domosdoshme.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Nisur nga precedenti i krijuar në udhëzimin nr.2, pika 1, kreu III, ku dhe kursi i zhvilluar nga IZHA është vlerësuar për tu përzgjedhur si drejtues i IPAP si dhe duke mbajtur në konsideratë që aplikimet për drejtues janë marrë para hyrjes në fuqi të ligjit ka ndodhur që është vlerësuar edhe kjo certifikatë për emërimin në shkollën Naim Frashëri Durrës, por sqarojmë që gjithashtu drejtuesja është pranuar dhe ndjek edhe programin e shkollës së drejtorëve për vitin 2020-2021. Aktualisht nga MASR dhe shkolla e drejtorëve janë duke u negociuar për njohjen e kursit të kryer nga IZHA në vitin 2016. Në datën 25.06.2020 Sekretari i Përgjithshëm i MASR i është drejtuar me email zyrtar Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP dhe katër drejtorëve të DRAP, lidhur me fillimin e procedurave të konkurrimit të drejtorëve të IPAP ku citon marrjen në konsideratë të 212 personave që kanë zhvilluar programin IZHA (sot ASCAP). .Në datën 03.07.2020 dërgohet në MASR lista sipas formatit, në 17.07.2020 z.F. C i është drejtuar DPAP dhe katër DRAP, ZVAP, etj me modele shkresash, lista e drejtorëve etj. Në 30.07.2020 DPAP i ka përcjellë katër DRAP urdhrin nr. 246, datë 30.07.2020 të Drejtorit të DPAP. Në vazhdim të këtyre komunikimeve, DRAP Durrës vijoi procedurën e konkurrimit, të ndjekur nga Sektori i BNJSHS në DRAP Durrës, znj. K.C. (juriste), e cila ka hartuar shpalljet, ka ndjekur ecurinë e konkurseve, ka mbajtur komunikimin zyrtar me ta, sikundër përcakton përshkrimi i punës së këtij pozicioni. Ky proces ka vijuar deri në ditët e para të muajit shtator sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim. Gjatë procedurës së konkurrimit Komisionit e Vlerësimit në ZVAP kanë hasur vështirësi me klasifikimin e kandidatëve fitues referuar pikës 3 të urdhrit nr.246, të cilat i kemi shprehur dhe jemi porositur të marrim në intervistë edhe kandidatë fitues që kanë aplikuar apo regjistruar në shkollën e drejtorëve. I jemi drejtuar DPAP dhe MASR për interpretim me shkresën datë 17.09.2020 dhe përgjigjia ka ardhur në 28.09.2020 dhe i është deleguar ZVAP për vazhdimin e procedurave të konkurrimit nëpërmjet email datë 29.09.2020.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nuk janë paraqitur fakte të reja. Qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë, sikurse është trajtuar edhe në projekt raportin e auditimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar Kreut I, shkronja C, pika 6 e Udhëzimit nr.2, DRAP Durrës nuk ka patur mundësinë ti plotësojë kërkesat e ZVAP, pasi një pjesë e stafit ishte me lejen vjetore dhe një pjesë e karantinuar nga COVID, prandaj janë autorizuar përfaqësues nga DRAP dhe ZVAP-et në pjesëmarrje për ZVAP Dibër, Mat, Bulqizë, Kavajë, Durrës, Klos, Vorë, Kamëz, Krujë. ZVAP Tiranë do të mbulohej nga DPAP. Ndërkohë që prezenca e DPAP/DRAP nuk është e detyrueshme, për analogji dhe të njoftimit që u bëhet dy sindikatave. DRAP Durrës nuk mund të rrinte pasiv për shkeljet e konstatuara, prandaj edhe ka marë masa për anulim të konkurseve. Masat disiplinore ndaj anëtareve të komisionit shkollor të vlerësimit të dosjeve i merr IPAP dhe ZVAP. DRAP Durrës nuk ka asnjë njoftim zyrtar për ndryshimin e udhëzimit nr.2, nëpërmjet udhëzimit nr.7, datë 19.03.2020, pasqyruar edhe ne komunikimet zyrtare ku gjithmonë i referohemi udhëzimit nr.2. Ky

ndryshim ka ndodhur në kohën e mbylljes nga COVID dhe e kemi konstatuar nga komunikimi në whats app me grupet e punës DPAP në mes të muajit shtator.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, referuar Udhëzimit nr. 2 datë 28.01.2020, i ndryshuar, sikurse është trajtuar dhe në projekt raportin e auditimit, pjesëmarrja e përfaqësuesit të DPAP/DRAP në procedurat e konkurrimit për pozicion drejtor të IPAP është e domosdoshme. Sa më sipër, subjekti nuk ka paraqitur fakte të reja.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për sa më sipër auditi i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka patur si periudhë kontrolli Janar 2019 deri në 31.08.2020, ndërkohë projektraporti ka vijuar edhe për periudhën shtator-tetor 2020 (edhe pasi unë isha në detyrë dhe nuk jam thirrur asnjëherë për të dhënë sqarime), e në këto kushte grupi i audituesve në disa raste as nuk më janë bërë me dije gjetjet e tyre dhe nuk me janë komunikuar Akt Konstatimet përkatëse, me qëllim mbajtjen e qëndrimit tim me gjetjet përkatëse. Procedura e konkursit për emërimin e drejtuesve të IPAP ka filluar në 05.08.2020 dhe ishte duke u zhvilluar ndërkohë që edhe auditohej. Në vlerësimin tim veprimet e audituesve ndikojnë në vendimmarrjen përkatëse në rastin konkret, shtuar dhe faktin që nga ana e tyre nuk u paraqit program kontrolli shtesë lidhur me periudhën përkatëse apo objektin konkret të auditimit. Ndjekja e procedurës në DRAP si hartimi i shpalljeve, respektimi i afateve kohore, realizimi i shpalljeve dhe konkludimi për to ishin detyra të deleguara në sektorin e BNJSSH dhe juristes K.C.. Në cilësinë e drejtorit kam kryer intervistat brenda afatit pasi dy dosjet e kandidatëve fitues janë protokolluar në DRAP. Për procedura që na krijua ngërçe ligjore i jemi drejtuar DPAP dhe MASR. Lidhur me komandimet e Drejtorëve, sqarojmë se me daljen e VKM nr.99, Udhëzimi nr.57 binte ndesh me përcaktimet e kësaj VKM-je dhe DRAP u detyrua të vijonte me procedurat e komandimit për shkak të vakumit ligjor. Për komandimet, ZVAP-et kanë paraqitur vakancat dhe propozimet përkatëse të cilat plotësojnë kriteret e ligjit 69/2012. Komunikimet me ZVAP kanë qenë përmes whats-app, telefon, email, shkresë ose takime të drejtpërdrejta. Paraprakisht për arritjen e kandidatit propozohej një person për plotësimin e kritereve nga kolektivat e shkollave dhe në rastet e mos arritjes së një kandidati janë komanduar mësues, nëndrejtore ose drejtorë të IPAP, të cilët kanë përmbushur me sukses detyrat e tyre funksionale. Në vijim të arsyetimit, veprimet e mia për komandime nuk janë në shkelje të udhëzimit nr.57/2013, pasi ky udhëzim binte ndesh me VKM nr.99/2019 dhe për këtë arsye kriteret janë të pa aplikueshme. Këto procedura janë ngarkuar sipas detyrave funksionale për specialistet E.P. dhe K.C., emri i të cilave pa asnjë shpjegim nuk është përfshirë në Projektraport.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti sqarojmë se, gjatë periudhës që Znj. V.L. ishte Drejtor i DRAP Durrës, grupi i auditimit ka kryer takime të shpeshta me të. Me largimin e Znj. L. nga ky pozicion, grupi i auditimit në përfundim të punës në terren zhvilloi një takim me të ku i bëri me dija gjetjet kryesore të auditimit, si dhe mbajti me Znj. L. Akt-Konstatimet e auditimit. Mbështetur në Rregulloren e Procedurave të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pas përcjelljes së observacioneve të subjektevet lidhur me projekt raportin e auditimit, zhvillohet takimi ballafaques. Më datë 25.01.2021 u zhvillua në ambientet e KLSH-së takimi ballafaques ku u ftuan për të marrë pjesë të gjitha strukturat e përmendura në Projekt-raportin e auditimit, takim në të cilin ishte prezente edhe Znj. L.

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, sikurse parashikon pika 3 e nenit 6 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

*"Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t". Referuar pikës 59 "Raportimit", të Parimeve të Auditimit të Jashtëm Publik në Auditimet e Përputhshmërisë, ISSAI 400, "Parimi i plotësisë kërkon që auditori të marrë parasysh **të gjitha evidencat relevante** të auditimit para lëshimit të raportit." Më hollësisht, sa më sipër trajtohet në Manualin e IDI-t për zbatimin e standardeve INTOSAI, fq.43, ku përcaktohet se një element i rëndësishëm në auditim është koha kur trajtohet çështja. Trajtimi i çështjeve në auditim duhet të kontribuojë në ndryshime të tilla si reforma apo iniciativa të reja, ndryshe nuk ndikon në ngjarje dhe humbet rëndësinë. Grupi i auditimit ka audituar procesin e përzgjedhjes së drejtuesve të IPAP në përmbushje të programit të auditimit, dhe me qëllim evidentimin e problematikave në kohë, në këtë proces i cili realizohet për herë të parë pas ristrukturimit të drejtorive arsimore, për të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësim.*
Lidhur me observacionin se VKM 99/2019 dhe Udhëzimi nr. 57/2013 binin në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe për këtë arsye Udhëzimi nr. 57 nuk është zbatuar, grupi i auditimit konstaton se këto dy dokumente bien në kundërshtim lidhur me strukturën e cila duhet të emërojë apo komandojë drejtuesit e IPAP, e megjithatë ish-Drejtori i DRAP ka vepruar për komandimin e tyre. Referuar VKM 99/2019 dhe Udhëzimit nr. 2 të ndryshuar, përgjegjësia për emërimin dhe komandimin e drejtorëve të IPAP është e titullarit të DRAP, si dhe shpalljet e vendeve të lira për drejtues të IPAP janë sigluar nga ish-titullari i DRAP znj. V.L..
Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Në lidhje me komandimin e znj. T.D. në shkollën Hasan Prishtina sqaroj se pas shkarkimit të saj me urdhrin nr. 45, datë 04.12.2019, dhe pas apelimit të saj në platformën e bashkëqeverisjes, DPAP ka dërguar në DRAP Durrës shkresën zyrtare me nr.259, prot datë 23.01.2020 ku ka kërkuar rikthimin në detyrë të saj, duke propozuar si drejtore në IPAP Hasan Prishtina, në një nivel më të ulët.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga informacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit nga vet DRAP Durrës, më datë 20.08.2020 masa disiplinore e Znj. T.D. rezulton ende në fuqi. Pra, subjekti nuk ka paraqitur fakte që ndryshojnë qëndrimin e grupit të auditimit.
Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Lidhur me rastin e gjimnazit "Naim Frashëri" Durrës, sqaroj se pas dorëheqjes së ish drejtoreshës, është komanduar z. I.P. nën drejtor por si pasojë e keq menaxhimit të burimeve njerëzore më duhej të stabilizoja situatën drejtuese në këtë institucion dhe z.I.P. u rikthye në pozicionin e nën drejtorit ku dhe është i emëruar, dhe znj. E.Xh. u komandua në rolin e drejtorit. Lidhur me ankimin e z. I.P., rasti është trajtuar nga DRAP, DPAP dhe MASR, dhe këto procedura janë ndjekur edhe nga specialistja znj. K.C.. Në të dy rastet (pra edhe për znj. D. dhe z. P.), DRAP ka raportuar në DPAP për çdo emërim, komandim dhe shkarkim të drejtuesve të IPAP.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se në urdhërin e shkarkimit të Z. I.P. **nuk** është cilësuar arsyeja e lirimit të tij nga pozicioni drejtor i komanduar, sikurse ka ndodhur në raste të tjera. Me anë të observacioneve për projekt raportin e auditimit është përcjellë një e-mail dërguar nga Ish-Drejtor i DRAP, në një adresë të panjohur për grupin e auditimit, me anë të të cilit Znj. L. argumenton vendimmarrjen për shkarkimin e Z. P. (e-maili është i datës 24.06.2020, ndëra urdhri i shkarkimi është i datës 22.06.2020) dhe komandimin e Znj.Xh. si drejtori i shkollës Naim Frashëri Durrës. Nga observacionet e përcjella nga ish-drejtori i DRAP Durrës evidentohet se Z. P. ka bërë një ankimim ndaj vendimit të shkarkimit të tij, i cili është ndjekur nga DRAP Durrës. Në vijim, grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion praktika e plotë e ndjekur nga DRAP Durrës e cila ka konkluduar në shkarkimin e Z. I.P., si p.sh. shkresa për njoftimin e tij nga DRAP Durrës për problematikat e evidentuar gjatë vitit mësimor, hapat dhe verifikimet e ndërmarra nga DRAP Durrës për të argumentuar urdhrin e shkarkimit, ankimimi i Z. P. dhe argumentimet e DRAP Durrës në vijim të ankimimit, etj. Në këto kushte, qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 811/6, prot në KLSH datë 13.01.2021, lënda "Observacion në lidhje me Projekt Raportin "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë, nr.811/4, datë 07.12.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit" nga znj. V.L., ish- Drejtor i DRAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për sa i përket anulimit të procedurave të konkursit për IPAP Jordan Misja dhe Ali Demi ato janë anuluar në bazë të kërkesës së ZVAP Tiranë dhe gjenden të protokolluar datë 19.08.2020. Të gjitha shkollat ku drejtuesit janë vakant paraqiten në grafikun e miratuar nga DPAP dhe të ndara në pesë grupe konkurrimi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se pasi kërkesa e ZVAP Tiranë drejtuar DRAP Durrës është përcjelle me observacionet e subjekti, ajo është reflektuar në raportin përfundimtar të auditimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 71, prot datë 13.01.2021, lënda "Kthim përgjigje" nga znj. J.M., Drejtor i ZVAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për gjetjen nr.3 me titull "Ish-DAR Durrës nuk ka bërë dorëzimin e detyrës, pas lirimit nga detyra. Mungesa e dy dosjeve të procedurave të ndjekura për emërimin definitiv të drejtorëve për dy shkolla "Adem Sabli" dhe "Isa Domi", nga stafi i ZVAP janë gjetur këto shkresa: Shkresa nr. 508, prot datë 18.03.2019 me lëndë "Njoftim për vende të lira pune" ku citohet: DAR Durrës shpall vendet vakante për pozicionin e drejtuesit të institucionit arsimor publik në këto shkolla: 1. Shkolla 9 vjeçare Radë, Borake, Dom Nikollë Kacorri dhe Pjezë. Gjithashtu, në librin e protokollit të vitit 2019 janë regjistruar: Nr.615, prot datë 28.03.2019 me lëndë "Kërkesë për konkurs për drejtor shkolle A.V." (Institucioni arsimor Isa Domi), Nr. 616, prot datë 28.03.2019, me lëndë "Kërkesë për konkurs për drejtor shkolle L.C." (Institucioni arsimor Isa Domi). Nr. 595, prot datë 27.03.2019, me lëndë "Kërkesë për konkurs për drejtor shkolle O.M." (Institucioni arsimor "Adem Sabli), Nr. 596, prot datë 27.03.2019, me lëndë "Kërkesë për konkurs për drejtor shkolle Y.V. " (Institucioni arsimor "Adem Sabli"). Më 11.01.2020 në ZVAP Durrës drejtuesi i IA "Isa Domi" ka dorëzuar këto shkresa: Shkresa nr.43, prot datë 11.01.20221, shkresa nr.508, prot datë 18.03.2019 me lëndë "Njoftim për vende të lira pune" (DAR Durrës), Shkresa nr.175, prot datë 28.03.2019 me lëndë "Vendim nr.15 datë 28.03.2019 i Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve", shkresa nr. 168, prot datë 25.03.2019 me lëndë "Ngritje komisioni për shqyrtimin e dosjeve për kandidat për drejtor shkolle 9-vjecare Pjezë". Më 12.01.2020 në ZVAP Durrës drejtuesi i IA "Adem Sabli" ka dorëzuar këto shkresa: Shkresa dërgim dokumentacioni datë 12.01.2021, shkresa

nr.208, prot datë 19.03.2019, procesverbal i mbajtur nga Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve, shkresa nr.210, prot datë 29.03.2019, procesverbal i mbajtur nga Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve, tabela e pikëve të aplikantit me disa shkresa të tjera të cilat i ka patur pjesë të dosjes.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se këto dokumentacione i janë kërkuar subjektit të audituar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë auditimit dhe nuk janë vendosur në dispozicion. Në këto kushte, dërgimi i tyre në këto momente, duke shtuar dhe faktin se për grupin e auditimit është e paqartë se si vetë aplikanti dhe fituesi i pozicioneve respektive të punës disponon vendimmarrjen e komisionit apo dokumentacione të tjera, të cilat duhet të protokollohen dhe të ruhen nga punëmarrësi (ish DAR Durrës, aktualisht ZVAP Shijak apo ZVAP Durrës), nuk përbën siguri dhe nuk mund të merren në konsideratë. Më tej, përcjellja e shkresave të tilla përforcon gjetjen e auditimit mbi mungesën e dosjeve të përmendura më lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 71, prot datë 13.01.2021, lënda "Kthim përgjigje" nga znj. J.M., Drejtor i ZVAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për gjetjen nr. 5, me titull "Mungesa e faqes zyrtare të ZVAP Durrës", dhe rekomandimit të grupit të auditimit për buxhetin e krijimit të faqes së web, ZVAP merr përsipër të krijojë dhe të menaxhojë faqen web brenda një afati kohor të shkurtër.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se ky observacion nuk përmban fakte/evidenca të reja lidhur me gjetjen.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 71, prot datë 13.01.2021, lënda "Kthim përgjigje" nga znj. J.M., Drejtor i ZVAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për gjetjen nr.8 me titull "Pranimi i kandidatëve dhe shpallja e fituesve në pozicionin drejtor shkolle në kundërshtim me ligjin 69/12012 i ndryshuar, udhëzimin nr.2, i ndryshuar dhe Shpalljet nr.1,2 dhe 3, ju bëjmë me dije se kandidatja e shpallur fituese në konkursin për drejtor IPAP "Nënë Tereza" është e pajisur me vërtetimin e trajnimit kryer nga IZHA dhe gjithashtu ka patur pjesë të dosjes vërtetimin që është konfirmuar në Shkollën e Drejtorëve. Znj. A.R. aktualisht ka nisur trajnimet që zhvillon Shkolla e Drejtorëve. Kandidatja e shpallur fituese në konkursin për drejtor të IPAP "Naim Frashëri" është e pajisur me vërtetimin që ka krijuar trajnimin nga IZHA dhe po ashtu në observacionin e ZVAP (shkresën nr. 2395, datë 13.11.2020). Ju është dërguar bashkëlidhur edhe vërtetimi që znj. E.Xh. është konfirmuar për të vazhduar Shkollën e Drejtorëve. ZVAP Durrës dhe Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për drejtor të IPAP kanë zbatuar udhëzimin nr.2, datë 28.01.2020, të pandryshuar pasi ndryshimet në udhëzim janë kryer gjatë periudhës së pandemisë dhe udhëzimi i ri nuk është dërguar nga MASR me atë të adresës elektronike në ZVAP (sikurse procedohet zakonisht në rast të daljes së akteve normative të reja). Për më tepër, me 29.09.2020 nga DRAP Durrës është dërguar në ZVAP Durrës email-i i mëposhtëm: "Në zbatim të Udhëzimit të MASR nr.2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar" i ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 19.03.2020, shkronja B, pika 1/d, ju bëjmë me dije se: 1. Për procedurat e shpallura për pozicion të lirë të drejtuesve të IPAP të cilët kanë përfunduar dhe janë në proces shpallje fituesi ose janë shpallur, nga DRAP Durrës nuk do të bëhet vendimi i emërimit pa ardhur shkresë zyrtare në DRAP konfirmimi i pranimit të kandidatit për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor nga Shkolla e Drejtorëve sipas përcaktimit në udhëzim. Për shpalljet që do të bëhen në vazhdim, Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve nuk do të marrë në vlerësim dosjet e kandidatëve të cilët nuk kanë konfirmim pranimi për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor

nga Shkolla e Drejtorëve. Drejtorët në detyrë në pozicione definitive për vijimin e detyrës përveç plotësimit të pikave a,b, c të pikës 1, shkronja B e Udhëzimit nr.2, duhet të aplikojnë për tu pranuar tek shkolla e drejtorëve dhe të vazhdojnë trajnimin për pajisjen me certifikatë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se udhëzimi i ndryshuar është i publikuar në faqen zyrtare të MASR. Gjithashtu, nga periudha e pandemisë deri në periudhën gusht 2020 është një kohë e mjaftueshme për institucionet për tu bërë të njohur me ndryshimet në legjislacion. Lidhur me email-in e DRAP Durrës, kjo çështje i përket shpalljeve për procedura konkurrimi që do të kryhen në vijim, për vetë kohën e dërgimit të email-it dhe jo për procedurat e konkurrimit të audituara në këtë raport.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 71, prot datë 13.01.2021, lënda "Kthim përgjigje" nga znj. J.M., Drejtor i ZVAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për gjetjen nr.10, me titull "Procedura jo të sakta të ndjekura nga ZVAP për procedurat e konkurrimit për pozicion drejtor shkolle", ZVAP Durrës së bashku me observacionin (shkresën nr.2395, datë 13.11.2020) Ju ka dërguar dhe shkresën nr.10253, prot datë 14.08.2020 të Bashkisë Durrës me lëndë "Kthim përgjigje shkresës suaj", e cila në përmbajtje të saj ka emrat e përfaqësuesve të Bashkisë për konkurset për drejtues të institucioneve arsimore: Bernardina Qerraxhia, Naim Frashëri, Jusuf Puka, Nënë Tereza. Lutemi që kjo shkresë të merret parasysh nga ana juaj. ZVAP Durrës në asnjë rast nuk ka nxjerrë urdhër për krijim komisioni, pa ardhur më parë shkresa zyrtare nga Bashkia për caktimin e përfaqësuesit të këtij institucioni.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se gjatë auditimit këto dokumentacione nuk u vendosën në dispozicion për grupin e auditimit dhe dërgimi i tyre në këtë fazë nuk përbën siguri për grupin, si rezultat observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 71, prot datë 13.01.2021, lënda "Kthim përgjigje" nga znj. J.M., Drejtor i ZVAP Durrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për gjetjen nr.11, ju bëjmë me dije se ZVAP Durrës ka patur 3 vendime gjyqësore të pa ekzekutuara. Brenda datës 30.12.2020 detyrimet monetare që kanë lindur nga këto vendime janë shlyer.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se programi i këtij auditimi reflekton situatën e subjektit të audituar deri në 30.08.2020, për këtë arsye ndryshimet e ndodhura përtej kësaj date nuk janë objekt i auditimit dhe nuk mund të reflektohen në raport.

1.Titulli i gjetjes:	**Mungesë harmonizimi në aktet ligjore dhe nënligjore për përzgjedhjen e drejtuesve të IPAP**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se përcaktimet e VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 dhe Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, bien në **kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar, pasi kompetencat për emërimin e drejtorit të institucioneve arsimore **janë të pa harmonizuara** në aktet respektive. Më hollësisht: Referuar **Ligjit nr. 69/2012** "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me **ligjin 48/2018, neni 55, pika 1**, përcaktohet se: "*Drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga **titullari i institucionit arsimor vendor**, **përgjegjës për arsimin parauniversitar***

	përkatës, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit." Neni 21, i ligjit nr. 48/2018, përcakton se: *"....emërtimi njësitë arsimore vendore, zëvendësohet me emërtimin institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar*". Pra, atributet e përcaktuara në ligj për njësinë arsimore vendore, në kushtet kur nuk ka patur një ndryshim tjetër në ligj, do t'i kalojnë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar. Me ndryshimin e ligjit 48/2018, në nenin 8 të tij përcaktohet se "***Neni 30 shfuqizohet"***. Ky nen kishte të përcaktuara përkufizimin dhe përbërjen e njësisë arsimore vendore, si më poshtë: "1. *Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitë arsimore vendore, të cilat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e tyre miratohen me urdhër të Kryeministrit.* *2. Njësitë arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi.* *3. Njësia arsimore vendore është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj*. " Pas shfuqizimit të këtij neni, **nuk është bërë rishikimi i këtyre përcaktimeve në ligj**, dhe reflektimin e ndryshimeve në organizimin i njësive arsimore vendore. Për analogji, se kujt aktualisht i referohet termi "institucione arsimore vendore", sipas VKM-ve, dhe urdhrave të MASR për mbylljen e disa shkollave në periudhën 2019-2020, është përcaktuar se: "*këto shkolla duhet të vendosin në dispozicion të **institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar**, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e kërkesave...."* Gjithashtu në VKM-të dhe urdhrat respektive të MASR përcaktohet se: "***Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar,*** *nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla ka për detyrë të ngrejë grup pune 3 ditë nga hyrja në fuqi e vendimit..."*. Për sa më sipër, ngritja e grupit të punës dhe dorëzimi i dokumentacioneve nga shkolla është bërë në ZVAP-et nën juridiksionin e të cilave ndodhet shkolla. Pra, **Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar është ZVAP.** Sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*" çështja 3, pika 11, përcakton se: "***Drejtorët e drejtorive rajonale*** *emërojnë drejtorët e institucioneve arsimore publike, sipas* ***udhëzimit përkatës të ministrit*****".** Kjo VKM është hartuar **në kundërshtim** me ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar, pasi në dallim me ligjin i cili përcakton se është pikërisht **titullari i institucionit arsimor vendor ai që emëron drejtorët arsimor, në VKM nr. 99, këto kompetenca i kalojnë titullarëve të drejtorive rajonale.** **Gjithashtu,** në periudhën e miratimit të VKM-së, në fuqi ishte Udhëzimin i Ministrit Nr. 57, datë 12.11.2013 "*Për Procedurat e Emërimit dhe*

	Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar", sipas çështjes E[46] të të cilit, emërimi i drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit parauniversitar, bëhej nga **Titullari i Njësisë Arsimore Vendore**. Për periudhën 27.02.2019-28.01.2020 konstatojmë se, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 bie në **kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrit nr. 57, datë 12.11.2013, lidhur me procedurën e emërimit të drejtorit të IPAP. Me daljen e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, "*Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*", i cili shfuqizoi Udhëzimin e Ministrit Nr. 57, datë 12.11.2013, procedura e emërimit të Drejtorit të IPAP përcaktohet në çështjen D, për tu kryer nga **drejtori i DRAP**, pra udhëzimi nr. 2 është rishikuar dhe hartuar në vijim të VKM-së, që rrjedhimisht e bën atë në kundërshtim me ligjin.
Kriteri:	Ligji nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar "*Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*"
Ndikimi:	Si rezultat i sa më sipër, 50 emërimet e përkohshme të kryera nga DRAP Durrës për periudhën 2019-2020 rezultojnë **në kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar. 69 procedurat e konkurimit të ndjekura për emërimin definitive të drejtorëve të shkollave të IPAP sipas Shpalljes nr. 1 dhe Shpalljes nr. 2, të kryera dhe të shpallura nga DRAP Durrës gjatë periudhës maj 2019-gusht 2020 janë **në kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012.
Shkaku:	Moskryerja e ndryshimeve në akte ligjore në mënyrë të harmonizuar.
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandimi:	-DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP të bëjnë propozimet e nevojshme ligjore pranë MASR, për harmonizimin e Ligjit nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar "*Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*", dhe akte të tjera nënligjore të hartuara në vijim të tyre, lidhur me strukturën përgjegjëse për emërimin e drejtorëve të IPAP. - MASR të marrë masat për ngritjen e grupit të punës, dhe kryerjen e rishikimeve të nevojshme të akteve ligjore dhe rregullatore, me qëllim harmonizimin e tyre, në vijim të konstatimeve trajtuar më sipër.

2.Titulli i gjetjes:	**Problematika të konstatuara në udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020 i ndryshuar "Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar"**
Situata:	Në kreun I, shkronja C, pika 12 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020

[46] "*Procedura e Emërimit të Drejtorit nga Titullari i Njësisë Arsimore Vendore*"

	përcaktohet se "*Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të ZVAP dosjet e aplikimit dhe vlerësimin me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e shkollës*.". Në vijim, sipas Kreut I, shkronja D, pika 1 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, përcaktohet se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*" Sipas pikës 2 "*Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP*". Nga sa më sipër, në kushtet kur në ZVAP dorëzohen vetem dy dosjet e kandidatëve me pikët me të larta (dhe jo te gjithe aplikanteve), vendimmarrja e ZVAP-së (punonjësit të autorizuar) mbetet e cënuar, pasi ai gjykon vetëm mbi dosjet që i dorëzohen dhe jo mbi të gjithë dosjet e aplikantëve. Gjithashtu, referuar shkronjës a, të pikës 2, të nenit 32 të *Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*, të Ministrit të MASR-së, datë 30.04.2019, mbetet në kompetencën e titullarit të ZVAP, kontrolli dhe garantimi i përmbushjes së misionit, objektivave dhe detyrimeve të ZVAP siç është edhe shqyrtimi i vendimmarrjes së komisionit.
Kriteri:	Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 i ndryshuar "Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar"
Ndikimi:	Nga sa më sipër, në kushtet kur në ZVAP dorëzohen vetem dy dosjet e kandidatëve me pikët me të larta (dhe jo te gjithe aplikanteve), vendimmarrja e ZVAP-së (punonjësit të autorizuar) mbetet e cënuar, pasi ai gjykon vetëm mbi dosjet që i dorëzohen dhe jo mbi të gjithë dosjet e aplikantëve. Për më tepër që, në vijim të sa dikton udhëzimi nr. 2, date 28.01.2020, mbetet e paqartë se mbi c'kritere "të natyrës teknike" punonjësi i autorizuar i ZVAP-së shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e kandidadëve, çka mbart riskun që ky proces vlerësimi të jetë subjektiv dhe i pastandardizuar. Roli i titullarit të ZVAP-së në këtë proces të rëndësishëm, mbetet në kufijtë e përcjellësit të dokumentacionit më tej në DRAP, duke mos garantuar përgjegjësinë e tij për funksionimin dhe mbarëvajten e institucioneve arsimore brenda juridiksionit me qëllim sigurimin e cilësisë së shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor.
Shkaku:	Mangësi në hartimin e udhëzimit, si dhe mos përcjellja e nevojave për përmirësim nga DRAP apo ZVAP.
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandimi:	-DRAP në bashkëpunim me DPAP të propozojnë pranë MASR, rishikimin e Udhëzimit nr. 2, në mënyrë që komisioni i vlerësimit t'i kalojë për shqyrtim ZVAP-it, jo vetëm dy dosjet e kandidatëve me më shumë pikë, por të gjithë dokumentacionin e procedurës, për të siguruar kështu vlerësimin e të gjithë praktikës së ndjekur nga komisioni i vlerësimit, me qëllim rritjen e kontrolleve dhe efektivitetit të procedurave të rekrutimit.

	- Me qëllim garantimin e kryerjes së një procesi efektiv të rekrutimit si dhe përfshirjen e të gjitha palëve përkatëse në këtë proces, MASR të rishikojë pikën 1 të shkronjës D, Kreu I të Udhëzimit nr.2, të ndryshuar, mbi sektorin apo personin përgjegjës në ZVAP për rishqyrtimin e procedurës së ndjekur nga komisionet e vlerësimit, duke parashikuar ngritjen e një grupi pune në përbërje të të cilit të jetë edhe Drejtuesi i ZVAP.

3.Titulli i gjetjes:	**Niveli i lartë i vakancave dhe komandimit në Stafin e DRAP Durrës, 12-ZVAP-ve nën juridiksionin e saj si dhe Drejtuesit e IPAP**
Situata:	Referuar dokumentacionit të emërimit të punonjësve në DRAP Durrës, të konsultuar nga grupi i auditimit, janë konstatuar një numër i lartë vakancash në stafin e 12 ZVAP-eve dhe DRAP Durrës (deri në përfundim të periudhës objekt auditimi vakancat rezultojnë në masën 21%) ku në disa raste ato kanë vijuar të tilla për periudha kohore të gjata, duke cënuar vijueshmërinë e punës në këto institucione dhe duke përbërë risk për realizimin e objektivave. Që prej miratimit të VKM-së Nr. 99, datë 27.02.2019 e deri më sot, rezultoi se **98% e stafit** të DRAP dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj vijon të jetë i **komanduar,** duke nisur që prej Drejtorit të DRAP Durrës, e deri tek punonjësit e ZVAP-ve, edhe pse në urdhrat e emërimit të përkohshëm të pozicioneve në punë nga Drejtori i Përgjithshëm i DRAP përcaktohet se komandimi do të jetë i përkohshëm deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet përkatëse. Vetëm emërimi i 8 drejtorëve të ZVAP Tiranë, Kavajë, Durrës, Krujë, Kamëz, Klos, Mat, Bulqizë ka qenë definitivë. Referuar Urdhrit të Ministrit, Nr. 454, datë 13.09.2019, emërimi i Drejtuesit të DRAP-së, Nëpunësit të DPAP-së, Nëpunës/Punonjës i DRAP-së, Nëpunës/Punonjës i Zyrave Vendore bëhet nëpërmjet **konkurrimit të hapur.** Gjithashtu, kjo rregullore përcakton qartë të gjitha hapat për emërimin e punonjësve të DRAP, duke filluar nga plani vjetor i nevojave të pranimeve, shpalljen e konkurrimeve, procedurat e konkurrimit në dy faza (faza 1: verifikimi i dosjeve të kandidatëve; dhe faza 2: testi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë), deri në vlerësimin përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit fitues. -Nga auditimi rezultoi **se në 6 ZVAP** me 285 institucione arsimore nën juridiksionin e tyre, aktualisht **janë të komanduar 78 drejtues (27%)**, ndërsa 207 drejtues të tjerë janë të emëruar definitivisht (ndërkohë që aktualisht edhe këta **nuk** plotësojnë kriteret ligjorë pasi **nuk** janë të pajisur me certifikatën e shkollës se drejtorëve). Konkretisht: **ZVAP Tiranë** rezulton me **30** drejtues të komanduar nga 138 drejtues gjithsej (22%), ku pas përfundimit të procedurave të emërimit, vetëm **5** prej tyre janë emëruar në pozicion pune definitive. Nga auditimi konstatohet se për **7 raste**, në ZVAP Tiranë në kundërshtim me pikën C.1, Kreu I të udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013, drejtori i institucionit arsimor të larguar nga detyra, **nuk** është zëvendësuar nga nën drejtori i vetë shkollës, edhe pse shkolla ka patur nën drejtor në momentin e komandimit të drejtuesve respektim. Për **3 raste**, në shkollat në të cilat nuk ka patur nën drejtora në strukturat organizative, pas largimit të

	drejtuesit të institucionit arsimor, **nuk** është zëvendësuar me një mësues të institucionit, në kundërshtim me pikën C.1, Kreu I të udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013 **ZVAP Kavajë**, rezulton me **13** drejtues të komanduar nga 25 drejtues gjithsej (52%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, vetëm **1** prej tyre është emëruar në pozicion punë definitiv. **ZVAP Durrës,** rezulton me **10** drejtues të komanduar nga 55 drejtues gjithsej (18%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, vetëm **2** prej tyre janë emëruar në pozicion pune definitiv. **ZVAP MAT**, rezulton me **9** drejtues të komanduar nga 12 drejtues gjithsej (75%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, vetëm **1** prej tyre është emëruar në pozicion pune definitiv. **ZVAP Bulqizë** rezulton me **10** drejtues të komanduar nga 17 drejtues gjithsej (59 %) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, procesi nuk ka konkluduar për asnjë kandidat në emërim pozicion pune definitiv. **ZVAP Dibër** rezulton me **6** drejtues të komanduar nga 38 drejtues gjithsej (16%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, procesi nuk ka konkluduar për asnjë kandidat në emërim pozicion pune definitiv. Për shkak se nuk janë kryer procedurat e konkurrimit, në gjykimin e grupit të auditimit, plotësimi i strukturës me anë të komandimeve, situatë kjo që konstatohet që nga niveli i Drejtorit të DRAP Durrës, punonjësit e ZVAP-ve deri tek drejtuesit e IPAP, pa u zhvilluar procedurat e hapura të konkurrimit sikurse e parashikojnë aktet ligjore në fuqi, **nuk** siguron kompetencën e stafit për pozicionet në të cilat janë komanduar, si dhe përmban **riskun** për mos realizimin e objektivave të punës, mos ofrimin apo mos sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar. Nga ana tjetër, për shkak të mungesës së kontratave të emërimit definitiv, të qënit të komanduar përmban risk për punonjësit aktual të kësaj njësie, pasi nuk ofron siguri për vijimësinë e tyre në punë.
Kriteri:	VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", Kreu III, pikat 13 dhe 14, "*Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të* ***konkurrimit të hapur****, mbi bazën e rregullave të miratuara me urdhër të ministrit".*"*Drejtorët e drejtorëve rajonale të arsimit parauniversitar emërohen dhe lirohen nga ministri. Drejtuesit e zyrave vendore, si dhe nëpunësit/punonjësit e drejtorive rajonale e të zyrave vendore emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përcaktimeve në urdhrin përkatës të ministrit*". Urdhrit të Ministrit, Nr. 454, datë 13.09.2019, "*Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj*".
Ndikimi:	Në gjykimin e grupit të auditimit, plotësimi i strukturës me anë të komandimeve, situatë kjo që konstatohet që nga niveli i Drejtorit të DRAP Durrës deri tek punonjësit e ZVAP-ve, pa u zhvilluar procedurat e hapura të konkurimit sikurse e parashikojnë aktet ligjore në fuqi, **nuk**

	siguron kompetencën e stafit për pozicionet në të cilat janë komanduar, si dhe përmban **riskun** për mos realizimin e objektivave të punës, mos ofrimin apo mos sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar. Nga ana tjetër, për shkak të mungesës së kontratave të emërimit definitiv, të qënit të komanduar përmban risk për punonjësit aktual të kësaj njësie, pasi nuk ofron siguri për vijimësinë e tyre në punë.
Shkaku:	Nuk janë hapur procedurat e konkurrimit nga Ministri i MASR-së, DPAP, apo DRAP
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandimi:	-Ministri i MASR dhe Drejtori i DPAP të marrin masat e nevojshme për plotësimin e strukturave të miratuara të DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur në zbatim të VKM nr. 99, datë 27.02.2019, Kreu III, pikat 13 dhe 14. Brenda 6 mujorit të parë 2021 -DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP të ndërmarrin masat e nevojshme për emërimin definitive të drejtuesve të IPAP nën juridiksionin e DRAP Durrës nëpërmjet procedurave të hapura të konkurimit, në rastet kur këto pozicione janë plotësuar me staf të komanduar.

4.Titulli i gjetjes:	**Ish- DAR Durrës nuk ka bërë dorëzimin e detyrës, pas lirimit nga detyra. Mungesa e dy dosjeve të procedurave të ndjekur për emërimin definitiv të drejtorëve për dy shkolla.**
Situata:	Nga dokumentet e vëna në dispozicion grupit të auditimit konstatohet se drejtori i ish- DAR Durrës nuk ka bërë dorëzim të detyrës në momentin e lirimit nga detyra pas ristrukturimin, në kundërshtim me pikat 27, 28, 29, 30 të Kreut III, të VKM nr. 124, datë 17.02.2016, i ndryshuar ku citohet se: "*Nëpunësi që largohet nga shërbimi civil duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil.";* "*Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe te njësia përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar*"; "*Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirimit. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera*"; "*Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 29 të këtij vendimi, konsiderohet **shkelje** e rëndë e detyrës dhe shkelje e rëndë disiplinore*". Në procedurat e marra në shqyrtim nga grupi i auditimit për emërimin definitiv nëpërmjet konkurrimit të hapur të drejtorëve të dy shkollave: Adem Sabli dhe Isa Domi, sot nën juridiksionin e ZVAP Shijak, **nuk gjenden dosjet** e procedurës së ndjekur nga ish-DAR Durrës për përzgjedhjen dhe emërimin e tyre.
Kriteri:	Referuar VKM nr. 124, datë 17.02.2016, i ndryshuar, Kreu III pikat 27), 28), 29), 30): "*Nëpunësi që largohet nga shërbimi civil duhet të bëjë të*

	gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil."; "Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe te njësia përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar"; "*Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirimit. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera*"; "*Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 29 të këtij vendimi, konsiderohet* ***shkelje*** *e rëndë e detyrës dhe shkelje e rëndë disiplinore*".
Ndikimi:	Si rezultat i mosdorëzimit të detyrës nga ish-DAR Durrës: Nuk sigurohet vazhdimësia e punës së bërë nga kjo strukturë duke shkaktuar mos eficiencë, Nuk sigurohet një pamje e qartë dhe e saktë mbi dokumentacionin dhe mjetet e punës të patura në përdorim dhe të dorëzuara pas ristrukturimit, Nuk gjenden të paktën dy dosje për procedurën e ndjekur për emërimin definitiv të drejtorëve të dy shkollave sot nën juridiksionin e ZVAP Shijak. Ekziston risku që të mungojnë dokumentacione apo dosje të tjera të cilat nuk janë audituar nga grupi i auditimit.
Shkaku:	Nuk është bërë dorëzimi i detyrës nga ish-DAR Durrës
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandimi:	-DPAP, në bashkëpunim me DRAP Durrës dhe ZVAP nën juridiksionin e DRAP, të ndërmarrin masat e nevojshme për identifikimin e dokumentacionit dhe mjeteve që kanë qenë në përdorim nga ish-DAR Durrës dhe ish-DAR-et e tjera, dhe tani janë në përdorimin të ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës. Në rast se ekzistojnë diferenca, të përcillet kërkesa për dorëzimin e tyre në strukturat e reja të ndërtuara pas ristrukturimit. - DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës, ZVAP Shijak dhe Durrës të ndërmarrin masat e nevojshme për gjetjen e dosjeve të procedurave të ndjekura për emërimin definitiv të drejtorëve të dy shkollave Adem Sabli dhe Isa Domi, sot nën juridiksionin e ZVAP Shijak. Në rast se ato nuk gjenden, të rishqyrtohet emërimi i drejtorëve të dy shkollave në fjalë. -DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për mosdorëzimin e detyrës nga Ish- DAR Durrës.

5.Titulli i Gjetjes:	**Mungesa e faqes zyrtare të ZVAP Durrës, Dibër dhe Bulqizë**
Situata:	Nga auditimi i ZVAP-ve Tiranë, Durrës, Dibër, Mat, Kavajë, Bulqizë, Shijak konstatohet se ZVAP Durrës, Dibër dhe Bulqizë nuk kanë një faqe zyrtare web në kundërshtim me nenin 37, të rregullores së MASR-së "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" dhe rrjedhimisht, në kundërshtim me pikën 3, shkronjën A të Kreut I, të Udhëzimit nr 2, datë 28.01.2020 e cila përcakton se: "DRAP shpall vendin e lire për drejtor te institucionit publik te arsimit parauniversitar (IPAP) ne faqen elektronike zyrtare te

	DRAP dhe te ZV AP, si dhe ne këndin e njoftimeve te ZVAP. Shpallja publikohet edhe ne këndin e njoftimeve te IPAP, per te cilin behet shpallja e vendit te lire për drejtor", këto ZVAP-e **nuk** kanë publikuar Shpalljet për vendet e lira në pozicionin drejtor shkolle në faqe zyrtare. Në ZVAP Dibër **3 nga 6** konkurrimet e hapura për pozicionin drejtor shkolle sipas Shpalljes 1 dhe **3 nga 5** sipas Shpalljes 2; ZVAP Durrës **4 nga 7** konkurse të hapura sipas Shpalljes 2 dhe në ZVAP Bulqizë **1 nga 2** konkurse e hapura sipas Shpalljes 1 dhe **1** konkurrim i hapur sipas Shpalljes 2 janë anuluar si rezultat i mungesës së kandidatëve.
Kriteri:	Rregullorja e MASR-së "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", neni 37 Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, Kreu I, shkronja A, pika 3.
Ndikimi:	Mungesa e një faqe web në të cilën duhet të publikoheshin Shpalljet për vendet e lira në pozicion drejtor shkolle në ZVAP-et Durrës, Dibër dhe Bulqizë ndikon negativisht në numrin e aplikantëve për këto konkurse, si dhe cënon parimin e transparencës.
Shkaku:	Mungesa e faqeve zyrtare web
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	DRAP Durrës në bashkëpunim me ZVAP Durrës, Dibër dhe Bulqizë të parashikojnë buxhetin për të ngritur faqet web të këtyre ZVAP-ve, dhe të marrin masat për kryerjen e publikimit të shpalljeve që lidhen me shkollat nën juridiksionin e tyre, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes së gjerë të kandidatëve të interesuar për to.

6. Titulli i Gjetjes:	**Mungesa e përfaqësuesve të DPAP/DRAP Durrës në procedurat e konkurrimit të zhvilluara në vijim të Shpalljeve për vendet e lira.**
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në vijim të Kreut I, shkronja C, pika 6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, ku përcaktohet se*: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP",* rezulton se 13 punonjës që ka DRAP + 21 punonjës që janë në organikën e miratuar të DPAP-së, do të duhej të angazhoheshin <u>në të njëjtën kohë</u>, në 32 procedura të çelura njëherazi sipas Shpalljes nr. 1 dhe 37 procedura të hapura njëherazi sipas Shpalljes nr. 2. Nga përllogaritja del qartë se me **34 punonjës në total të DPAP dhe DRAP Durrës** do të ishte **e pamundur** përfaqësimi i këtyre institucioneve në **32 konkurse** të cilat do të zhvilloheshin njëherazi sipas shpalljes 1 dhe **37 konkurse** të cilat do të zhvilloheshin njëherazi sipas shpalljes 2. -Në total, në **69** konkurset e hapura për vendet e lira drejtor shkollë, kanë marrë pjesë vetëm **11 përfaqësues të DRAP Durrës**. -Nga auditimi konstatohet gjithashtu se, në 20 procedura të zgjedhura (midis 69 të zhvilluara gjithsej gjatë periudhës nën auditim), nga 7 përfaqësues që kanë marrë pjesë në procedurat e zgjedhura, **vetëm 3** janë punonjës të DRAP Durrës, pasi 2 janë punonjës të ZVAP-ve dhe 2 janë mësues të IPAP, në kundërshtim me pikën 6, shkronja C, Kreu I i Udhëzimit nr. 2, ku theksohet se në konkurset për vendet e lira për pozicioni drejtor të IPAP duhet të marrin pjesë përfaqësues të DPAP/DRAP. -Nga auditimi konstatohet se në 7 raste kur përfaqësuesit e DRAP

	Durrës kanë marrë pjesë në konkurset për pozicionin drejtor të IPAP, **vetëm 2** prej tyre kanë mbajtur procesverbal mbi mbarëvajtjen e procesit në kundërshtim me pikën 5, të nenit 23 të ligjit nr. 111/2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" ku përcaktohet se :"*Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet **gjurma e duhur e auditimit** për vijueshmërinë dhe monitorimin*." Mungesa e përfaqësuesve të DRAP Durrës apo DPAP në 13 procedurat e konkurrimit të zhvilluara në vijim të Shpalljeve për vendet e lirat drejtues, **nuk** ka siguruar monitorimin dhe vëzhgimin e zbatimit të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të vlerësimit të kandidatëve nga komisionet e vlerësimit. Kjo nuk ka garantuar evidentimin e parregullësive të lidhura me këto procedura, të identifikuar dhe të trajtuara nga grupi i auditimit. Sa më sipër ka bërë që, në total 58 konkurse të kryera sipas shpalljes 1 dhe 2, në mungesë të përfaqësuesve të DPAP/DRAP Durrës të jenë në kundërshtim me kriteret e Udhëzimit nr.2, i ndryshuar.
Kriteri:	Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar. Ligjit nr. 111/2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 23, pika 5.
Ndikimi:	Mungesa e përfaqësuesve të DRAP Durrës apo DPAP në 13 procedurat e konkurrimit të zhvilluara në vijim të Shpalljeve për vendet e lirat drejtues shkolle dhe të marra në shqyrtim nga grupi i auditimit, **nuk** ka siguruar monitorimin dhe vëzhgimin e zbatimit të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të vlerësimit të kandidatëve nga komisionet e vlerësimit. Kjo nuk ka siguruar evidentimin e parregullsive të lidhura me këto procedura, të identifikuar dhe të trajtuara nga grupi i auditimit. Nga 7 përfaqësues që kanë marrë pjesë në 7 procedura konkurrimi, vetëm 2 kanë mbajtur procesverbal mbi mbarëvajtjen e procesit, në të cilat janë paraqitur parregullsitë lidhur me vendimmarrjen e komisionit, duke konkluduar në anulimi të procesit të konkurimit. Sa më sipër ka bërë që, në total 58 konkurse të kryera sipas shpalljes 1 dhe 2, në mungesë të përfaqësuesve të DPAP/DRAP Durrës në kundërshtim me kriteret e Udhëzimit nr.2
Shkaku:	DPAP/DRAP nuk kanë përcaktuar përfaqësues në procedurat e konkurrimit të zhvilluara për vendet e lira në pozicionin e drejtor shkolle, në ZVAP-të nën juridiksionin e DRAP Durrës. Në 5 procedura konkurimi ku përfaqësuesit e DRAP Durrës kanë marrë pjesë, nuk janë dokumentuar konstatimet për mbarëvajtjen e procesit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës, të marrin masat e nevojshme për të përcaktuar përfaqësues në të gjitha procedurat e konkurrimit për vendet e lira në pozicionin e drejtorit të shkollës në ZVAP-të nën juridiksionin e DRAP Durrës, që do të kryhen në vijim, në përmbushje të pikës 6, shkronjës C, Kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar; me qëllim monitorimin dhe zbatimin e kërkesave të

	udhëzimit nga ana e komisionit të vlerësimit, dhe përcjelljen e tyre pranë ZVAP. -DPAP dhe DRAP Durrës të ndërmarrim masat e nevojshme që përfaqësuesit që do të marrin pjesë në procedurat e konkurrimit, të përgatisin një informacion mbi mbarëvajtjen e procesit, i cili duhet të protokollohet dhe të jetë pjesë e dosjes së procedurës së konkurimit me qëllim forcimin e sistemeve të kontrollit dhe krijimin e gjurmës së auditit. -DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP të planifikojnë në mënyrë të kujdesshme afatet e konkurseve për vendet e lira drejtor shkolle të IPAP, në përputhje me mundësitë reale për të përcaktuar përfaqësues të tyre në këto konkurse, sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr. 2, dhe jo të kryerjes formale të tyre.

7. Titulli i Gjetjes:	**Procedura jo të sakta të ndjekura nga DRAP Durrës në procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtor shkolle**
Situata:	Nga auditimi rezultuan problematika lidhur me vendimmarrjen e DRAP Durrës në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të IPAP. Konkretisht: -U konstatua se për **1 rast,** në ZVAP Bulqizë, **1 rast në ZVAP Tiranë**, **1 rast në ZVAP Mat**, **1 rast në ZVAP Durrës,** në vijim të dërgimit të dokumentacioneve nga ZVAP, DRAP Durrës nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në çështjen D, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar ku përcaktohet se: "3. *Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston dy kandidatët.",* Në vijim, në kundërshtim me pikën D.5 e cila citon se "*Brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP.",* vendimi i DRAP në disa raste është **shpallur me vonesë** dhe në disa të tjera deri në përfundim të auditimit **nuk janë intervistuar kandidatët për t'u përzgjedhur fituesi**. Në rastin e shkollës Shtother në ZVAP Kavajë; dhe Blicë, Nazmi Rushiti dhe Dine Hoxha **nuk ka informacion** me vijueshmërinë e procesit. -Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se në **një rast** kur komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, DRAP Durrës **ka kërkuar masë** për kryetarin e komisionit dhe tërheqje vëmendje për përfaqësuesen e ZVAP që kishte marrë pjesë në këtë mbledhje. Ndërsa, për **2 raste** në ZVAP Tiranë, dhe **2 raste** në ZVAP Kavajë, kur nga shqyrtimi i dosjeve ZVAP-të respektive kanë kërkuar anullimin e procedurës pasi komisionet kishin vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, **nuk** evidentohet të jenë ndërmarrë **masa** nga DRAP Durrës. Pra, DRAP Durrës nuk ka vepruar në të njëjtin standard për rastet në të cilat janë konstatuar shkelje nga komisioni, duke cënuar parimin e barazisë. -Nga auditimi konstatohet se, DRAP Durrës ka komanduar drejtore në shkollën "Hasan Prishtina", në datën 24.01.2020, një kandidate me masë disiplinore në fuqi, **në kundërshtim me** kriteret e Udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013, Kreu I, çështja B, pika ç e cila citon se "*Kandidati për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet: ç) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij*. Znj. T.D. është shkarkuar nga

	detyra po nga DRAP Durrës në 24.12.2019 për shkelje flagrante të udhëzimit të MASR, **dhe aktualisht disponon një masë disiplinore**, sikundër përcakton vërtetimi i DRAP Durrës i datës 20.08.2020. Nga auditimi konstatohet se, më datë 10.04.2020 DRAP Durrës ka komanduar në pozicionin e Drejtorit të shkollës "Naim Frashëri" në Durrës z. I.P. (në atë kohë Zv. drejtor i kësaj shkolle) pas dorëheqjes së drejtorit të mëparshëm nga ky pozicioni. Sipas Urdhrit të komandimit të përkohshëm të Z.I.P., ai do të qëndronte në pozicionin e drejtorit të shkollës "Naim Frashëri" deri në normalizimin e situatës nga COVID -19 dhe përfundimit të procesit të konkurrimit. Megjithatë, DRAP Durrës ka **shkarkuar** nga ky pozicion Z. I.P. dhe ka **emëruar përkohësisht** Znj. E.Xh. më datë 22.06.2020, e cila në atë periudhë ishte drejtore e shkollës "Jusuf Puka" në Durrës, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit. Pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit, Znj. E.Xh. është emëruar definitivisht në pozicionin drejtor i shkollës "Naim Frashëri". Nga kontakti me ZVAP Durrës, konstatohet se Z. I.P. nuk ka paraqitur dorëheqje për largim nga pozicioni. Në urdhrin e shkarkimit nga DRAP Durrës nuk është argumentuar kjo vendimmarrje. Si rezultat i sa më sipër, janë shkaktuar vonesa në përzgjedhjen e kandidatëve fitues për kandidatët e institucioneve arsimore dhe mos informim i ZVAP-eve respektive mbi vijueshmërinë e procesit ***Parregullsitë e tjera në vendimmarrjen e DRAP Durrës*** *lidhur me vlerësimin e kandidatit vetëm me email-in e pranimit, apo atë të regjistrimit në shkollën e drejtorëve, në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, sipas të cilit kandidati duhet të jetë i certifikuar nga shkolla e drejtorëve, janë trajtuar më gjerësisht në gjetjen me titull"Pranimi i kandidatëve dhe shpallja e fituesve në pozicionin drejtor shkolle, në kundërshtim me kriteret e parashikuara me ligjin 69/2012 i ndryshuar, udhëzimin nr. 2, i ndryshuar dhe Shpalljet nr.1, nr.2 dhe nr.3."*
Kriteri:	Udhëzimi nr.2, kreu I, shkronja D pika 3 "*Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston dy kandidatët*."; dhe pika 5 e cila citon se "*Brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP*.", Udhëzimi nr.57, datë 12.11.2013, Kreu I, çështja B, pika ç e cila citon se "*Kandidati për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet: ç) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij.";*
Ndikimi:	Vonesa në përzgjedhjen e kandidatëve fitues për kandidatët e institucioneve arsimore dhe mos informim i ZVAP-eve respektive mbi vijueshmërinë e procesit. Si rezultat se, DRAP Durrës nuk ka vepruar në të njëjtin standard për rastet në të cilat janë konstatuar shkelje nga komisioni, është cenuar parimi i barazisë. Komandimi i znj. D. si drejtore e shkollës Hasan Prishtina pak ditë pasi është shkarkuar nga detyra si drejtore e shkollës Sami Frashëri për shkelje flagrante të Udhëzimit të MASR, përbën shkelje të rëndë të Udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013 nga ana e DRAP Durrës.
Shkaku:	Mungesë ose vonesë vendimmarrjes së DRAP Durrës në tejkalim të afateve përcaktuar në udhëzimin nr.2 Veprimi i DRAP Durrës jo me të

	njëjtin standard në trajtimin e rasteve kur janë konstatuar shkelje nga komisioni i vlerësimit. Komandimi në pozicionin drejtor shkolle i personave me masë disiplinore në fuqi nga DRAP Durrës
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-Për të gjitha rastet në vijim, DRAP të respektojë afatet, me qëllim garantimin e finalizimit të procesit të përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve arsimore dhe përcjelljen e informacioneve të azhornuara mbi vendimmarrjen e DRAP. -Në të gjitha rastet në vijim, DRAP Durrës të ndjekë të njëjtin standard në trajtimin e rasteve me shkelje nga Komisioni i Vlerësimit, duke marrë masat e nevojshme për evidentimin e përgjegjësive. -Për të gjitha rastet në vijim, të tregohet kujdes në komandimin/emërimin e drejtuesve duke garantuar mos pasjen e një mase disiplinore në fuqi të kandidatëve respektiv

8. Titulli i Gjetjes:	**Pranimi i kandidatëve dhe shpallja e fituesve në pozicionin drejtor shkolle, në kundërshtim me kriteret e parashikuara me ligjin 69/2012 i ndryshuar, udhëzimin nr. 2, i ndryshuar dhe Shpalljet nr.1, nr.2 dhe nr.3.**
Situata:	Referuar nenit 55 të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 2, 28.01.2020, i ndryshuar, kandidati për drejtorë duhet të ketë kryer trajnim dhe të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve. Referuar Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të IPAP në Shqipëri", kuotat e kualifikimit për zhvillimin e trajnimit në Shkollën e Drejtorëve janë si më poshtë: Viti 2019-2020 - 48 kuota për qarkun e Tiranës Viti 2020-2021 - 192 kuota për qarkun e Tiranës, Durrësit, Elbasanit Viti 2021-2024 - 240 kuota për të gjitha qarqet e vendit Viti 2024 në vijim - 240-300 kuota për të gjitha qarqet e vendit. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtues, i nënshtrohen testimit për pajisjen me certifikatë për drejtues pranë Shkollës së Drejtorëve, e ruajnë të drejtën për të dhënë provimin për dy vite, si dhe provimi mund të jepet deri në dy here. Në krahasim me kuotat në dispozicion për certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve, në maj 2019 numri i drejtorëve të shkolla nën juridiksionin e DRAP Durrës, të cilët nuk dispononin certifikimin e Shkollës së Drejtorëve **ishte 377.** Me ndryshimin e Udhëzimit nr. 2,edhe drejtorët të cilët ishin të emëruar definitivisht, duhet të certifikohen nga Shkolla e Drejtorëve. Pra, me kuotat në dispozicion, Shkolla e Drejtorëve, do të mund të certifikonte deri në 2021 **vetëm 192 kandidatë** nga 3 qarqe, Tiranë, Durrës dhe Elbasan, ku qarku i Elbasanit nuk është nën juridiksionin e DRAP Durrës. Referuar kuotave të publikuara nga shkolla e drejtorëve, nëse të gjithë kandidatët e pranuar do të ishin nga DRAP Durrës (e cila është vetëm 1 në 4 DRAP), kualifikimi i plotë i të gjithë stafit drejtues arsimor nuk mund të arrihej deri të paktën **në vitin 2024**. Përpara publikimit të Shpalljeve të vendeve të lira për pozicionin drejtor shkolle, më datë 30.07.2020 DPAP ka nxjerrë shkresën nr. 246 në

	kundërshtim me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 2 i ndryshuar, sipas të cilës, **të pasurit certifikatë apo të qenit i regjistruar në Shkollën e Drejtorëve konsiderohet prioritet dhe jo më një kriter i domosdoshëm kualifikues për vijimin e konkurrimit**. Në vijim të kësaj shkrese janë publikuar: **Shpalljet nr. 1** dt. 05.08.2020, për 32 pozicione të lira drejtor shkolle në 11 ZVAP nën juridiksionin e DRAP Durrës; **Shpallja nr. 2** dt. 19.08.2020 për 37 pozicione të lira drejtor shkolle në 11 ZVAP nën juridiksionin e DRAP Durrës; **Shpallja nr. 3** dt. 07.10.2020 për 7 pozicione të lira drejtor shkolle (6 prej te cilave janë të përsëritura nga Shpallja nr. 1) në ZVAP Tiranë. Në këto 3 shpallje, si **kriter kualifikues** për vijimin e konkursit, është kërkuar që aplikantët të zotërojnë **certifikatën e Shkollës së Drejtorëve**, në zbatim të Ligjit nr. 69/2012 dhe Udhëzimit nr. 2. **Por**, nga auditimi konstatohet se: Në procedurat e ndjekura nga komisionit e vlerësimit dhe nga DRAP Durrës për vlerësimin e kandidatëve dhe shpalljen e fituesve, **janë pranuar dhe kualifikuar aplikantë** të cilët ishin regjistruar në Shkollën e Drejtorëve në vijim të urdhrit nr. 246, datë 30.07.2020 të DPAP, **dhe jo të certifikuar prej saj,** në kundërshtim me Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2, i ndryshuar, dhe kriteret e publikuara në Shpallje. Për më tepër, komisionet e vlerësimit **kanë pranuar dhe kanë kualifikuar** në fazën tjetër kandidatë të cilët zotëronin vetëm e-mailin e aplikimit **dhe jo** atë të regjistrimit në Shkollën e Drejtorëve. Kjo vërehet në procedurat e ndjekura për pozicionet e lira drejtor shkolle, në të gjitha ZVAP e audituara nga grupi i auditimit: Tiranë, Durrës, Kavajë, Mat, Bulqizë dhe Dibër. DRAP Durrës ka intervistuar dhe ka shpallur fitues kandidatë të cilët **në procedurat e konkurrimit nuk kanë paraqitur certifikatën e Shkollës së Drejtorave**, si në rastin e gjimnazit "Qemal Stafa" në Tiranë, "Nënë Tereza" dhe "Naim Frashëri" në Durrës, dhe "Aleksandër Mojsiu" në Kavajë; apo ka intervistuar dhe shpallur fitues kandidatë të cilët **vetëm kanë aplikuar** në Shkollë e Drejtorëve **dhe nuk janë regjistruar apo certifikuar prej saj**, si në rastin e shkollës Karpen në Kavajë (në vijim, është pezulluar shpallja e fituesit deri sa ky i fundit të pajiset me certifikatën e shkollës së Drejtorëve). DPAP dhe DRAP Durrës, kanë shpallur procedurat e konkurimit, duke vendosur si kriter të domosdoshëm certifikatën e shkollës së drejtorëve, për ZVAP-et ku ky trajnim ende nuk ka nisur nga Shkolla e Drejtorave, si ZVAP Dibër, Kavajë, Mat, Bulqize, etj. Nga auditimi rezultoi se me ndryshimin e pikës 1, të kreut III të Udhëzimit nr. 2, vërtetimi i lëshuar nga IZHA **nuk** konsiderohet më si i barazvlefshëm me certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve në konkurrimet e hapura për pozicionin drejtore shkolle. Megjithatë, Komisionet e Vlerësimit dhe DRAP Durrës e kanë trajtuar vërtetimin e lëshuar nga IZHA **si të barazvlefshëm** me certifikatën e lëshuar nga Shkolla e Drejtorëve. Më evident, ky rast është konstatuar në procedurën e konkurrimit në shkollën "Naim Frashëri" në Durrës, ku Komisioni i Vlerësimit dhe DRAP Durrës kanë pranuar dhe shpallur fitues kandidatë

	të cilët nuk ishin të certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, por kishin vërtetimin nga IZHA. Trajtimi i vërtetimit të lëshuar nga IZHA si të barazvlefshëm me certifikatën e lëshuar nga shkolla e drejtorëve **nuk** është përfshirë në kriteret e shpalljes, si dhe në asnjë akt rregullator në fuqi. *Për sa më sipër mban përgjegjësi z. S.H., Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, znj. V.L. ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Sektorët e Shërbimeve në ZVAP ose personat e autorizuar nga Drejtorët e ZVAP-ve (të cilët kanë shqyrtuar procedurat e komisioneve të vlerësimit dhe nuk kanë identifikuar parregullësit e komisioneve), dhe në mungesë të tyre Drejtorët e ZVAP.*
Kriteri:	Ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, "Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar"; Udhëzimin Nr. 7, datë 19.03.2020 "Për ndryshime në Udhëzimin Nr. 2, datë 28.01.2020"; Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të IPAP në Shqipëri"; Urdhri nr. 246, datë 30.07.2020 i DPAP-s; Shpalljet nr. 1 dt. 05.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)"; Shpallja nr. 2 dt. 19.08.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)"; Shpallja nr. 3 dt. 07.10.2020 "E vendit të lirë për Drejtor të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar (IPAP)".
Ndikimi:	Pranimi dhe emërimi i kandidatëve të cilët nuk janë regjistruar në Shkollën e Drejtorëve, apo janë regjistruar, por nuk janë certifikuar prej saj, mund të shkaktojë mungesë të eficiencës në procesin e përzgjedhjes dhe emërimit të tyre dhe mund të cënojë arritjen e objektivave të punës, pasi përmban riskun që ata mund të mos pranohen në këtë shkollë, pas vlerësimit të dosjeve (në rastin kur vetëm kanë aplikuar), apo të mos certifikohen pas fazës së testimit, (kandidati ruan të drejtën për tu testuar deri në dy vite pas trajnimit dhe mund ta zhvillojë këtë test deri në dy herë), duke risjellë kështu nevojën për rihapjen e konkurrimit për këto pozicione. Fakti se, komisionet e vlerësimit dhe DRAP kanë pranuar dhe kanë shpallur fitues kandidatë të cilët nuk ishin të pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve ndërkohe që, në **Shpalljet** për vendet e lira pasja e certifikatës nga Shkolla e Drejtorëve është përcaktuar si kriter i domosdoshëm për aplikim, **ka krijuar kushte jo të barabarta konkurrimi, si dhe ka cënuar parimin e transparencës.** Si pasojë e sa më sipër, i gjithë procesi i ndjekur për vlerësimin dhe emërimin e kandidatëve për drejtues të IPAP është i pavlefshëm.
Shkaku:	Urdhri nr. 246 i DPAP-së sipas të cilit regjistrimi dhe pasja e certifikatës nga Shkolla e Drejtorëve konsiderohet **si prioritet dhe jo si kriter për aplikim**, është **në kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar dhe

	Udhëzimin nr. i ndryshuar. Mos identifikimi nga ana e ZVAP-eve, në rolin e shqyrtuesit të procedurës së komisionit të vlerësimit, i parregullsive në pranimin e kandidatëve të pa pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve, dhe përcjellja e tyre pranë DRAP Durrës në kundërshtim me ligjin. Shpallja e fituesve të pa pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve nga DRAP Durrës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DRAP Durrës, në çdo rast të hartojnë dhe publikojnë shpalljet e pozicioneve të lira të drejtuesve të IPAP në mënyrë që kriteret e kërkuara në shpallje të ndiqen edhe në procedurat e konkurrimit për këto pozicione. DRAP Durrës, në bashkëpunim me DPAP të rishpallë procedurat e konkurrimit për pozicionin e drejtorit të IPAP sipas shpalljeve 1 dhe 2, për shkollat nën juridiksionin e DRAP Durrës, për të cilat procesi ka vijuar me pranimin dhe vlerësimin e kandidatëve të pa pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve, me qëllim trajtimin e drejtë dhe të barabartë të kandidatëve. MASR, të ngrejë grupe pune të veçanta me qëllim analizimin e parregullsive të mësipërme dhe të ndërmarrin masa për punonjësit përgjegjës në proporcion me shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit. Në vijimësi, MASR të analizojë zbatueshmërinë e këtij kriterit sipas të cilit kandidati për drejtor të IPAP duhet të jetë i pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve, dhe të marrë masat për zgjidhjen e ngërçit të krijuar si rezultat i kuotave të kufizuara për kryerjen e këtij trajnimi në Shkollën e Drejtorëve.

9. Titulli i Gjetjes:	**Procedura jo të sakta të ndjekura nga ZVAP në procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtor shkolle**
Situata:	Nga auditimi rezultuan problematika lidhur me vendimmarrjen e ZVAP-eve nën juridiksionin e DRAP Durrës në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të IPAP. Konkretisht: -U konstatuan procedura jo të sakta të ndjekura nga ZVAP në procedurat e konkurimit për pozicionin e drejtorit të IPAP. Për **1 shkollë** në ZVAP Tiranë, **5 shkolla në** ZVAP Kavajë, **1 shkollë** në ZVAP Mat, **nuk është respektuar afati** i trajtuar në pikën D.2, të Kreut 1, ku përcaktohet se Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP. -Konstatohet se për **3 shkolla** në ZVAP Kavajë, **4 shkolla** në ZVAP Durrës dhe **3 shkolla** në ZVAP Dibër përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore në komisionin e vlerësimit të dosjeve është caktuar dhe përcjellë **nga vetë shkolla** për të cilën janë kryer procedurat e konkurimit, dhe jo nga njësia e vetqeverisjes vendore. **-Në 1 rast**, në ZVAP Kavajë, përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozuar nga shkolla dhe miratuar me urdhrin e ZVAP për ngritjen e komisionit, **nuk është i njëjtë** me atë të dërguar nga njësia e vetqeverisjes vendore.

	-Në 1 rast, në ZVAP Mat, njëri nga dy aplikantët, pjesë e konkursit për drejtuesin e shkollës rezulton se ka kryer aplikimin në tejkalim të afateve të përcaktuara në shpalljen nr.1. -Konstatohet se **3 shkolla në ZVAP Durrës, 2 shkolla në ZVAP Mat,** dhe **3 shkolla në ZVAP Dibër** nuk rezulton të jetë dokumentuar shqyrtimi i dosjeve të komisionit të vlerësimit pas përcjelljes prej tij të dosjeve të 2 kandidatëve me pikë maksimale në ZVAP-e. Për **2 shkolla në ZVAP Tiranë**, "Andon Zako Cajupi" dhe "Kongresi i Lushnjës" në përfundim të procedurave të përzgjedhjes nga komisioni, është përgatitur relacioni, duke konkluduar se "*... Komisioni është në tejkalim të çdo afati procedurial të përcaktuar nga Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020".* Shkeljet e trajtuara në këto relacione janë evidentuar **edhe në dy shkolla të tjera**, "Sami Frashëri" dhe "Qemal Stafa", por në këtë rast ZVAP Tiranë i ka konsideruar procedurat e rregullta, **duke mos analizuar me të njëjtin standard procedurat e ndjekura**, dhe procesi ka konkluduar me emërim definitiv të dy kandidatëve. **-Në 2 shkolla, në ZVAP Kavajë** nuk rezulton të jetë identifikuar mos zbatimi i afateve nga komisionet e vlerësimit pasi relacioni i përgatitur nga ZVAP ka përcaktuar se procedurat kanë qenë të rregullta. -Nga auditimi konstatohet se në vijim të pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr.2, **për 4 nga 5 shkollat** (Andon Zako Cajupi, Kongresi i Lushnjës, Ramazan Kabashi dhe Sami Frashëri) për të cilat është hapur konkurimi për pozicionin e drejtorit të shkollës në ZVAP Tiranë**:** është mbajtur procesverbali i datës **19.08.2020**, në ambientet e ZVAP Tiranë ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët/kandidatët. Këto procesverbale janë firmosur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe sekretaria e ZVAP, Znj. E.P.. Këto procesverbale janë të paprotokolluar. -Referuar të dhënave të përcjella nga Sektori i Shërbimit në ZVAP Tiranë, Znj.E.P. ka nisur punë në ZVAP më datë **24.08.2020** pavarësisht emërimit të saj në 19.08.2020. Pra, Znj. E.P. e cila referuar procesverbalit i ka dorëzuar komisionit të vlerësimit dosjet e konkurentëve, ka nisur punën **6 ditë pas datës** që ka bërë dorëzimin. Mosprotokollimi i procesverbalit, në shkelje të ligjit për arkivat, të mbajtur midis sekretares së ZVAP Tiranë dhe komisioneve të vlerësimit, nuk krijon gjurmë auditimi dhe nuk krijon mundësinë për të konkluduar mbi vërtetësinë e këtyre proceseve. Gjithashtu konstatohet se në rastin e shkollës "Sami Frashëri", data e mbledhjes së komisionit të vlerësimit është e korrigjuar. Ndërsa, për shkollën "Andon Zako Cajupi" konstatohet se, komisioni ka firmosur se ka marrë në dorëzim 4 dosje, në një kohë ku ai është shprehur në procesverbalet e mbajtura për faktikisht 5 dosje. Nga auditimi konstatohet se për 1 **rast në ZVAP Tiranë, 1 rast në ZVAP Durrës dhe 2 raste në ZVAP Dibër**, vërtetimi për masë disiplinore është lëshuar nga ZVAP në tejkalim të kompetencave ligjore, pasi këto vërtetime duhet të lëshohen nga DRAP Durrës (në rastin kur aplikanti është në pozicion drejtues shkolle), apo shkolla (në rastin kur aplikanti është në pozicion mësues apo nën drejtor shkolle). Madje, në vijim të sa më sipër, në rastet e ZVAP Tiranë, dhe Durrës kandidatet

	respektive janë shpallur fituese, mbështetur në këto vërtetime (jo vetëm). Në një rast në ZVAP Tiranë u konstatua që kandidatja edhe pse ka patur një masë disiplinore, ZVAP Tiranë ka lëshuar vërtetim jo të vërtetë (për znj. T.D.), (edhe pse jo me pasoja juridike pasi kandidatja është skualifikuar), në të cilin shprehet se ajo **nuk** ka masë disiplinore. Emërimi në detyrë i kandidatëve sipas vërtetimeve të lëshuar nga ZVAP, dhe jo DRAP apo IA, sikundër evidentohet në rastin e znj. D., nuk pasqyron situatën reale për statusin e kandidates, e cila sipas DRAP Durrës ka masë disiplinore, ndërsa sipas ZVAP Tiranë nuk ka masë disiplinore në fuqi. *Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtori i DPAP, z. S.H. dhe ish Drejtori i DRAP Durrës, znj. V.L., sektorët e shërbimeve në ZVAP ose personat e autorizuar nga Drejtorët e ZVAP-ve të cilët kanë shqyrtuar procedurat e komisioneve të vlerësimit, dhe në mungesë të tyre Drejtorët e ZVAP.*
Kriteri:	Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020, Kreu I: - shkronja D, pika 1 përcakton se: "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike*."; -shkronja D, pika 2, përcakton se:"*Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.";* -shkronja E, pika 3, përcakton se: "*Tejkalimi i afateve të përcaktuara në kreun I të këtij udhëzimi shoqërohet me masë disiplinore për drejtorin e ZVAP*." Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë;Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 Neni 106 dhe neni 107 i Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në RSh, datë 28.01.2020, cili citon se *"Titullari I DRAP ngre komisionin e disiplinës që shqyrton masën disiplinore për drejtorin e IA…";"Komisioni i disiplinës I IA jep masën disiplinore për mësuesin apo nëndrejtorin…"*
Ndikimi:	Mosidentifikimi i parregullsive të mësipërme, nga ZVAP-et për shqyrtimin e procedurave të ndjekura nga komisionet e vlerësimit, ka lejuar që këto konkurseve, të zhvilluara në kundërshtim me aktet nënligjore dhe rregullare, të konkludojnë në emërim definitv të drejtorëve të shkollave, apo mosmarrjen e masave për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen. Fakti që, Znj. E.P. ka nisur punën në ZVAP Tiranë 6 ditë më vonë seç ka bërë dorëzimin e dosjeve tek komisionet e vlerësimit, ngre pikëpyetje mbi vërtetësinë e procesit të konkurrimit për pozicionin drejtor për shkollat Andon Zako Cajupi, Kongresi i Lushnjës, Ramazan Kabashi dhe Sami Frashëri. Mosprotokollimi i procesverbalit, në shkelje të ligjit për arkivat, të mbajtur midis sekretares së ZVAP Tiranë dhe komisioneve të vlerësimit, nuk krijon gjurmë auditimi dhe nuk krijon mundësinë për të konkluduar mbi vërtetësinë e këtyre proceseve.

	Emërimi në detyrë i kandidatëve sipas vërtetimeve të lëshuar nga ZVAP, dhe jo DRAP apo IA, sikundër evidentohet në rastin e znj. D., nuk pasqyron situatën reale për statusin e kandidates, e cila sipas DRAP Durrës ka masë disiplinore, ndërsa sipas ZVAP Tiranë nuk ka masë disiplinore në fuqi.
Shkaku:	Mos respektimi i kritereve të Udhëzimit nr.2, nga ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës. Dorëzimi i dosje komisionit të vlerësimit, nga një punonjës i cili nuk rezulton të ketë qenë pjesë e stafit të ZVAP Tiranë, në kohë e dorëzimit. Mosprotokollimi i procesverbaleve nuk krijon mundësinë për të konkluduar mbi vërtetësinë e procedurave të ndjekura për zhvillimin e konkurseve për pozicionin drejtor në shkollat Andon Zako Cajupi, Kongresi i Lushnjës, Ramazan Kabashi dhe Sami Frashëri në Tiranë. Lëshimi i vërtetimeve për masë disiplinore të aplikantëve për drejtues të institucioneve arsimore nga ZVAP, përtej kompetencave të tyre. Referuar Udhëzimit nr. 2 28.01.2020, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit i përcjellë ZVAP-së, vetëm dosjet e dy kandidatëve me pikë më të larta, dhe jo dosjen e të gjithë procedurës së ndjekur (përfshirë këtu edhe dosjet e kandidatëv të skualifikuar nga komisioni), duke mos i mundësuar kështu ZVAP-së shqyrtimin e të gjithë praktikës së ndjekur nga komisioni i vlerësimit të kandidatëve për drejtor të IPAP. Gjithashtu, referuar këtij udhëzimi, roli i titullarit të ZVAP, në procesin e shqyrtimit të procedurës së ndjekur nga komisioni i vlerësimit, mbetet në kufijtë e percjellësit të informacionit në tej në DRAP.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP-në, të analizojnë parregullsitë e konstatuar në ZVAP-ve dhe të marrin masa për shmangien e tyre, duke bërë të mundur kryerjen e procedurave të konkurrimit për pozicionin drejtues të IPAP nga ZVAP, konform afateve dhe përcaktimeve të tjera në aktet respektive. -Për te gjitha rastet në vijim, me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, dhe shmangien e riskut të tjetërsimit të pasurisë natyrore/ humbjen e tyre, nga ZVAP Tiranë të merren masat që çdo dokument të ketë të gjithë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor. -Për të gjitha rastet në vijim, vërtetimet për masa disiplinore të jenë lëshuar nga DRAP/IPAP. ZVAP, në asnjë rast të mos tejkalojnë kompetencat e tyre, duke lëshuar vërtetime për masë disiplinore.

10. Titulli i Gjetjes:	**Mangësi të konstatuara në vendimmarrjen e komisioneve të vlerësimit të aplikantëve për drejtorë në IPAP.**
Situata:	Nga auditimi rezultuan problematika lidhur me vendimmarrjen e komisioneve të vlerësimit në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të IPAP. Konkretisht: - U konstatua se për të **5 shkolla**t për të cilat është zhvilluar procedura e konkurrimit nën ZVAP Tiranë, të **5 shkollat** në ZVAP Kavajë dhe të **3 shkollat** në ZVAP Dibër, komisioni **nuk ka respektuar afatet** e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, pika C.10 dhe Pikën 3, të Shpalljes nr.

	1, datë 05.08.2020, ku më hollësisht kandidatët me mungesa në dokumentacion pas vlerësimit paraprak**, janë skualifikuar** menjëherë nga komisioni duke mos respektuar afatin 3 ditor pas identifikimit të mungesave. Intervistimi i kandidatëve në shumicën e rasteve është kryer **në të njëjtën ditë** me vlerësimin e dosjeve. Më evidente kjo situatë rezulton për shkollën "Ramazan Kabashi", në ZVAP Tiranë ku procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për drejtuesin e shkollës është anulluar, pasi 5 nga 6 aplikantët kishin mungesë të dokumentacionit, dhe komisioni ka vendosur **anullimin** pa i njoftuar ata për plotësimin e mungesave me dokumentet respektive. Procesverbali i vlerësimit të dosjeve të komisionit në **2 raste**, në ZVAP Durrës është firmosur nga **vetëm 4** anëtarë, nga 5 që duhet të përmbajë komisioni. Nga auditimi konstatohet se për **1 shkollë në ZVAP Tiranë** ("Andon Zako Cajupi") dhe 1 shkollë në ZVAP Mat për të cilat është zhvilluar procedura e konkurrimit për pozicionin drejtor, pas ndryshimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit, **nuk** dokumentohet përcjellja e informacionit të ndryshimit pranë ZVAP me qëllim rishikimin e urdhrit i Drejtorëve të ZVAP për komisionin **në kundërshtim** me pikën 9, shkronja C, Kreu I, i Udhëzimit nr. 2, i ndryshuar. Si rezultat, në mbledhjet e komisionit, është paraqitur dhe ka votuar kandidati i zëvendësuar, i cili faktikisht nuk rezulton në urdhrin e ZVAP për ngritjen e Komisionit. Kreu I, shkronja C, pika 1 dhe 2, e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, përcakton se "***1**. Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP, në vijim Komisioni, ngrihet nga ZVAP; **2**. Komisioni përbëhet nga: a) kryetari i bordit të IPAP; b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP; c)dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve; d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore*." Referuar parregullsive në procedurat e konkurimit të zhvilluara nga komisionet e vlerësimit të cilat kanë konkluduar në anulim të procedurës, apo kanë vijuar me shkelje të kritereve përcaktuar në ligj dhe udhëzim, evidentohet se anëtarët kanë shfaqur **mangësi** në njohjen e bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe shpesh herë kanë vlerësuar në mënyrë jo të drejtë kandidatët. **Mungesa e njohurive të anëtarëve të komisioneve të vlerësimit** është paraqitur si problematikë edhe në 2 procesverbalet (2 nga 2 në total) e mbajtura nga përfaqësuesit e DRAP Durrës në mbledhjet e komisioneve. Nga auditimi konstatohet gjithashtu që, në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, në rast të veprimit të komisionit të vlerësimit në kundërshtim me këto akte gjatë procedurës së vlerësimit të kandidatëve për pozicionet e lira drejtor shkolle, nuk parashikohen masa për evidentimin e përgjegjësive dhe minimizimin apo shmangien e tyre. Në një rast, DRAP Durrës, në vijim të parregullsive të komisionit, ka kërkuar marrjen e masës disiplinore ndaj kryetarit të komisionit të vlerësimit. *Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtori i DPAP, z. S.H. dhe ish Drejtori i DRAP Durrës, znj. V.L., komisionet e ngritura dhe në rastet kur problematikat nuk janë identifikuar nga ZVAP-et respektive,*

	sektorët e shërbimeve në ZVAP ose personat e autorizuar nga Drejtorët e ZVAP-ve të cilët kanë shqyrtuar procedurat e komisioneve të vlerësimit, dhe në mungesë të tyre Drejtorët e ZVAP.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020, pika C.10: "*b) njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune;c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni; d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit." Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10; f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6;* Pikën 3, të Shpalljes nr.1, datë 05.08.2020 e cila përcakton se " *Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen në datën 21 dhe 24 Gusht 2020. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet email-it për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditëve nga data e njoftimit të verifikimit paraprak*"; Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, Kreu I, shkronja C, pika 1 dhe 2.
Ndikimi:	Si rezultat se komisionet e vlerësimit, në rastet e përmendura më lartë, nuk kanë respektuar afatet për t'i mundësuar kandidatëve plotësimin e dokumentacionit që mungonte në dosjet e tyre, por i kanë skualifikuar menjëherë ata dhe kanë vijuar me intervistimin e kandidatët të tjerë ose kanë anuluar konkurrimin, ka shkaktuar që këto konkurse të jenë zhvilluar **në kundërshtim** me aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi duke **cënuar** eficiencen dhe efektivitetin e proceseve. Si rezultat i mungesës së kompetencave të komisioneve në vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionet e lira drejtore shkolle në IPAP, konkurset janë anuluar ose kanë vijuar në shkelje të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi, të cilat përbëjnë mungesë në eficiencë dhe efektivitet të procesit. Si rezultat se, në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi nuk parashikohen masa në rast të veprimit të komisionit të vlerësimit në kundërshtim me rregullat dhe kriteret për zhvillimin e procedurave të konkurimit, ekziston risku i veprimit jo me përgjegjshmëri nga ana e komisionit të vlerësimit.
Shkaku:	Shpallja e procedurave të konkurrimit nga DPAP dhe DRAP Durrës, duke vendosur si kriter të domosdoshëm certifikatën e shkollës së drejtorëve, për ZVAP-et ku ky trajnim ende nuk ka nisur nga Shkolla e Drejtorëve, si ZVAP Dibër, Kavajë, Mat, Bulqize, etj. Mosrespektimi i afateve të Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020, i ndryshuar dhe të Shpalljes nr. 1. Mangësi në njohjen e bazës ligjore dhe rregullatore nga anëtarët e komisioneve gjatë vlerësimit të kandidatëve për drejtor shkolle, duke qenë se komisioni përbëhet nga 2 mësues të shkollës për të cilën po zhvillohet konkurrimi, 2 prindër dhe 1 anëtar i vetëqeverisjes vendore

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP, të analizojnë përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe të propozojnë në MASR masat e nevojshme, që problematikat e konstatuara më lart të shmangen në të ardhmen, më qëllim që të sigurohet vlerësimi i kandidatëve për pozicionet e lira drejtor shkolle nga komisionet e vlerësimit, në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi.

11. Titulli i Gjetjes:	**Ankimimet e aplikantëve për drejtorë në IPAP i drejtohen komisionit ad hoc të vlerësimit, duke mos siguruar trajtimin e tyre.**
Situata:	Kreu C, pika 11 e Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, përcakton se "*Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune*." Në pikën 6 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 përcaktohet se: "*Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankimimet përpara Komisionit brenda 3 ditëve punë nga shpallja e rezultateve të konkurrimit*", Nga auditimi rezulton se, në ZVAP Kavajë njëri prej aplikantëve në procedurat e konkurrimit të shkollës "Helmas" ka paraqitur një ankesë pranë ZVAP lidhur me vendimmarrjen e komisionit, dhe në përgjigjen e ZVAP është mbajtur qëndrimi: "*Pretendimi i ngritur nga zonja nuk qëndron pasi kjo kërkesë është paraqitur gabim tek ZVAP Kavajë, ku duhet të adresohej tek komisioni i shkollë*s." Në vijim të saj, nuk dokumentohet të jetë shqyrtuar apo marrë në konsideratë kjo ankesë, pasi drejtimi i ankesave pranë një komisioni ad hoc i cili ngrihet për një procedurë të caktuar, dhe nuk ka një adresë të përcaktuar, nuk siguron trajtimin e tyre.
Kriteri:	Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, Kreu I, shkronja C, pika 11. Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020, pika 6.
Ndikimi:	Drejtimi i ankesave pranë një komisioni ad hoc i cili ngrihet për një procedurë të caktuar, dhe nuk ka një adresë të përcaktuar, nuk siguron trajtimin e tyre.
Shkaku:	Trajtimi i ankesave jo i rregulluar në një mënyrë që të sigurojë shqyrtimin e tyre.
Rëndësia:	**E mesme**
Rekomandimi:	DRAP Durrës të marrë masat e nevojshme që në shpalljet e ardhshme për vendet e lira për pozicionin drejtor shkolle, të përcaktohet qartë procedura dhe adresa për drejtimin e ankesave ndaj Komisionit të Vlerësimit, me qëllim sigurimin e përcjelljes dhe trajtimin e tyre.

12. Titulli i Gjetjes:	**Mangësi në përbërjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacioneve të dosjeve të kandidatëve, si dhe mos protokollim i të gjithë dokumentëve pjesë të tyre**
Situata:	Nga auditimi konstatohet se DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj nuk rezultojnë të kenë miratuar në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë",

	rregullat për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivor. Si rezultat, dosjet me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollave janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuar në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës. Nga verifikimi ne disa prej zyrave arsimore, konstatohet se nuk rezulton i unifikuar procesi i administrimit të dokumentacioneve, pasi në disa raste dosjet origjinale të të gjithë aplikantëve janë administruar dhe ndodhen në zyrat e ZVAP; në disa raste dosjet origjinale janë përcjellë në DRAP Durrës dhe ZVAP-et disponojnë vetëm fotokopjet; dhe në disa të tjera dokumentacionet origjinale gjenden në shkollat për të cilat janë zhvilluar procedurat e konkurrimit. Dokumentacionet respektive në disa ZVAP-e ishin të shpërndara, të duplikuara, me data të ndryshme, ose të korrigjuara. Gjithashtu, procesverbalet e komisionit dhe shumë dokumentacione të tjera, si urdhri i ngritjes së komisionit të vlerësimit (3 raste në ZVAP Kavajë), pjesë të dosjes janë të pa protokolluara, duke mos garantuar siguri për grupin e auditimit lidhur me plotësinë dhe saktësinë e dokumentacioneve pjesë të dosjes. Konstatohet se në dosjet e procedurave nuk është dokumentuar procesverbali i intervistimit të kandidatëve dhe votimi i komisionit për **të 5 shkollat në ZVAP Kavajë, 1 shkollë në ZVAP Tiranë**; 2 shkolla në ZVAP Durrës. Pyetjet e intervistës së strukturuar nuk janë pjesë e dosjes për **të 5 shkollat në ZVAP Kavajë, 2 shkolla ZVAP Tiranë, 2 shkolla ZVAP Durrës.** Konstatohet se mungojnë procesverbalet e dorëzimit të dosjeve nga ZVAP për komisionin në **2 shkolla në ZVAP Kavajë**, **për 2 shkolla në ZVAP Tiranë 2 raste ZVAP Bulqizë**; **1 shkollë në ZVAP Durrës**. Nuk është pjesë e dosjes, procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e kandidatëve në **4 shkolla** në ZVAP Kavajë. Kjo situatë përbën një risk të shtuar për tjetërsimin e informacionit, menaxhimin dhe ruajtjen e dokumentacioneve respektive.
Kriteri:	Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave teknike-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë;Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020
Ndikimi:	Risku i shtuar për ruajtjen e dokumentacioneve, për shkak të përfshirjes së shumë institucioneve në një procedurë, si dhe mungesa e unitetit në degët arsimore për menaxhimin e dokumentacioneve të procedurave të konkurrimit për drejtues shkolle. Risku i tjetërsimit të informacionit dhe mungesa e sigurisë për audituesit në dokumentacionet pjesë të dosjes, duke qenë se shume prej tyre janë të pa protokolluara, me data të duplikuara ose të korrigjuara, dhe të shpërndara.
Shkaku:	Sisteme të dobëta të kontrollit të brendshëm në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës të cilët nuk kanë inventarizuar dhe arkivuar dosjet respektive me dokumentat e plota, si dhe mos përcaktimi i qartë në kuadrin rregullativ për institucionin përgjegjës për administrimin e dokumentacioneve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj, të marrin masat për unifikimin e procedurave të ndjekura për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacioneve të procedurave për

	përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore, duke kërkuar për çdo zyrë inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve me dokumentacione të plota. -Për te gjitha rastet në vijim, me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, dhe shmangien e riskut të tjetërsimit të pasurisë natyrore/ humbjen e tyre, nga DRAP Durrës të merren masat që çdo dokument të ketë të gjithë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

13. Titulli i Gjetjes:	**Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit në total 29,706,597 lekë, si rezultat i vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve, nga të cilat për periudhën objekt auditimi është ekzekutuar vlera prej 14,088,075 lekë dhe 15,618,522 lekë vendime të formës së prerë të pa ekzekutuara deri në përfundim të auditimit që përbëjnë detyrime të prapambetura për tu paguar në periudhat në vijim.**
Situata:	Nga auditimi konstatohen shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit në vlerë **29,706,597**, si rezultat i vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve, nga të cilat për periudhën objekt auditimi është ekzekutuar vlera prej 14,088,075 lekë, dhe 15,618,522 lekë përbëjnë detyrime të prapambetura për tu paguar nga ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës në periudhat në vijim. Nga totali i 21 vendimeve të ekzekutuara në vlerë **14,088,075 lekë, shuma 11,694,931 lekë janë ekzekutuar gjatë vitit 2019 dhe 2,393,144 lekë gjatë 2020**. Për sa i përket vendimeve të pa ekzekutuara, 10,093,945 lekë i përkasin vendimeve të përcjella pranë institucioneve përgjatë **2020** dhe 5,524,577 lekë gjatë **2019** ose më parë. Informacioni i vendosur në dispozicion fillimisht për grupin e auditimit nga DRAP Durrës sipas raportimit të ZVAP. i pasqyronte këto shpenzime në vlerë **21,111,374 lekë**, pra rreth 8,595 mijë lekë më pak se fakti që rezultoi pas verifikimit të grupit të auditimit në 6 ZVAP. Nga auditimi konstatohet se në *Raportin e Monitorimit 8 Mujor të MASR për vitin 2020*, lidhur me detyrimet e krijuara rishtaz si rezultat i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, janë pasqyruar vetëm vendimet e pa ekzekutuara të **ZVAP Dibër** në vlerë totale 10.1 milion lekë, të cilat nga verifikimi në subjektin audituar rezultojnë në vlerën 10.4 milion lekë. Në raportin e monitorimit të MASR nuk janë pasqyruar detyrimet e krijuara si rezultat i vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara për **ZVAP Durrës** në vlerë totale 2,663 mijë lekë, **ZVAP Tiranë** në vlerë totale 901 mijë lekë, **ZVAP Kavajë** në vlerë totale 901 mijë lekë, **ZVAP Bulqizë** në vlerë totale 734 mijë lekë. Konstatohet gjithashtu se institucionet nuk dispononin asnjë komunikim zyrtar me gjykatat respektive, në mënyrë që të dokumentohej ndjekja e çështjeve lidhur me ish punonjësit e këtyre drejtorive. Informacioni që subjektet dispononin për vendimet, lidhej vetëm me dorëzimin e kërkesave për ekzekutim të fondeve nga përmbaruesit dhe në shumicën e rasteve ekzekutimi i kërkesave nuk kryhej nëse disponohej vetëm

	vendimi i formës së prerë nga gjykata dhe jo përmbaruesi.
Kriteri:	Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* pika 86 *"Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, që për mungesë fondesh buxhetore apo faktorë të tjerë, kanë detyrime të pa likujduara dhe presin për t'u paguar në periudha të ardhshme, duhet të kryejnë regjistrimin dhe evidentimin në kontabilitet dhe në SIFQ të këtyre detyrimeve të prapambetura (për këtë qëllim do të shërbejë manuali përkatës i procedurës së regjistrimin dhe evidentimin në kontabilitet dhe në SIFQ).*
Ndikimi:	Largimi i padrejtë nga puna i punonjësve, ka shkaktuar një shpenzim jo efektiv në buxhetin e shtetit në vlerën **29,706,597 lekë**
Shkaku:	Largimi i padrejtë nga puna i punonjësve, sot nën juridiksionin e DRAP Durrës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-DRAP Durrës në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, prej **29,706,597 lekë,** si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, pasi u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna. -DRAP Durrës në bashkëpunim me ZVAP, të përcjellë informacionin e plotë dhe të saktë në momentin e krijimit të detyrimit mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë në institucionet përgjegjëse përgjatë vitit, me qëllim pasqyrimin e situatës reale në raportet e monitorimit të MASR, si dhe provigjonimin e këtyre shumave në pasqyrat financiare.
14. Titulli i Gjetjes:	**Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, si pasojë e pagesave nga fondet e buxhetit të shtetit të punonjësve të DRAP Durrës për lirimin nga shërbimi civil dhe humbjen e statusin e nëpunësit civil.**
Situata:	Pas miratimit të VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", strukturat përgjegjëse për ofrimin dhe sigurimin e arsimit cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar janë riorganizuar, proces ky i shoqëruar me kosto financiare për buxhetin e shtetit. Më hollësisht, **82 punonjës të liruar nga shërbimi civil** kanë qenë përfitues të pagesës për dëmshpërblim në vlerë totale **28,148,574 lekë**, në vijim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e cila përcakton se: "*Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë,* ...". Kjo shumë është ekzekutuar nga DRAP Durrës në muajit gusht dhe shtator të vitit 2019 përkatësisht në vlerën 23,926,287 lekë dhe 4,331,286 lekë, në vijim të shkresës nr. 256, datë 18.07.2019 përcjellë nga Drejtori i DRAP Durrës me listën e përfituesve. Nga auditimi konstatojmë se, 82 punonjësit të cilët kanë përfituar pagesë për

	dëmshpërblim janë komanduar në ZVAP-të në juridiksionin e DRAP Durrës, ose në DRAP.
Kriteri:	Urdhri i Kryeministrit me nr. 68, datë 5.4.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DP të DRAP"; Urdhri i MASR me nr. 234, datë 19.4.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZVAP"; Pika 7, nenit 50, i Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, përcakton se: "*Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas rasteve të mëposhtme: a) deri në një vit eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 1 muaji; b) nga 1-3 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 3 muajve; c) nga 3-6 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 6 muajve; ç) nga 6-9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 9 muajve; d) mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 12 muajve*"; Shkresa nr. 256, datë 18.07.2019 e Drejtorit të DRAP Durrës mbi "Listën e punonjësve që përfitojnë dëmshpërblim nga heqja e statusit të nëpunësit civil si rezultat i ristrukturimit".
Ndikimi:	Shpenzime joefektive në buxhetin e shtetit
Shkaku:	Lirimi nga shërbimi civil i 82 punonjësve dhe humbjen e statusin e nëpunësit civil si rezultat i ristukturimit.
Rëndësia:	E mesme

III.2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. 811/1 prot., datë 01.09.2020 "*Auditim Financiar dhe Përputhshmërie në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës*", i ndryshuar me nr. 811/2 prot., datë 21.09.2020 dhe nr. 811/3 prot.,datë 13.10.2020, grupi i auditimit, kreu auditim për pikën 3 "*Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare*", në DRAP Durrës.
Në zbatim të kësaj pike të programit, është kryer për çështjet si vijon:

1. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e aktiveve të institucionit.
2. Mbi qarkullimin e vlerave monetare, ku janë përfshirë edhe auditimi i procedurave të prokurimit publik zhvilluar nga DRAP Durrës dhe ZVAP nën varësinë e saj.

Grupi i auditimit, pasi mori të dhëna në lidhje me shpenzimet e kryera (Regjistrat e Realizimit dhe Parashikimit) nga DRAP Durrës dhe 12 ZVAP nën varësinë e saj, nisur nga kriteri i vlerës më të lartë[47][48], përzgjodhi për auditim njësitë sipas tabelës së mëposhtme:

[47] Në këto vlera, nuk përfshihen fondet për paga dhe kontribute (llogaria 600 dhe 601), por vetëm fondet për blerje mallra e shërbime (602) dhe Investime.
[48] Sqaruar më hollësisht në Letrën e punës nr. 16, datë 06.11.2020.

Nr.	Njësia	Viti 2019	Viti 2020	Shuma	Fondet e përfshira në auditim	Fondet e audituara	Përqindja e fondeve të audituara	Përqindja e fondeve totale
1	ZVAP Durrës	31,978,208	14,052,904	46,031,112	46,031,112	45,308,463	98%	98%
2	ZVAP Tiranë	24,275,163	14,055,004	38,330,167	38,330,167	34,160,038	89%	89%
3	ZVAP Mat	25,869,904	5,827,451	31,697,355	31,697,355	29,884,835	94%	94%
4	ZVAP Dibër	18,175,172	8,773,524	26,948,696	26,948,696	25,587,391	95%	95%
5	ZVAP Krujë	13,336,020	8,607,016	21,943,036	0	0	0%	0%
6	ZVAP Bulqizë	11,614,937	2,717,402	14,332,339	14,332,339	13,081,112	91%	91%
7	ZVAP Kavajë	10,362,453	3,420,283	13,782,736	13,782,736	12,813,873	93%	93%
8	ZVAP Shijak	2,596,731	6,532,631	9,129,362	9,129,362	7,559,362	83%	83%
9	DRAP Durrës	8,380,502	188,547	8,569,049	8,569,049	7,000,000	82%	82%
10	ZVAP Kamëz	3,503,273	3,176,720	6,679,993	0	0	0%	0%
11	ZVAP Vorë	1,715,615	4,099,577	5,815,192	0	0	0%	0%
12	ZVAP Rrogozhinë	1,161,440	2,499,013	3,660,453	0	0	0%	0%
13	ZVAP Klos	220,922	375,432	596,354	0	0	0%	0%
SHUMA		**153,190,340**	**74,325,504**	**227,515,844**	**188,820,816**	**175,395,074**	**93%**	**77%**

Siç rezulton dhe nga tabela e mësipërme, janë përzgjedhur për auditim DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, Tiranë, Mat, Dibër, Bulqizë, Kavajë dhe Shijak. Fondet e këtyre subjekteve së bashku, përbëjnë 83% të fondeve në total.
Në total, janë audituar 93% e fondeve të marra nën auditim, ose 77% e fondeve total.

III.2.3.1. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e aktiveve të institucionit.

III.2.3.1.1. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, konstatohet se për asetet DRAP Durrës mban një regjistër ku përcaktohet përshkrimi, vlera, sasia, data e hyrjes, emri i personit në ngarkim të të cilit është aseti, vlerën e akumuluar të amortizimit, por jo të dhëna si vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, e cila përcakton se:

Formati i rregjistrit te aktiveve hartohet ne vartesi te llojit te tyre afatgjate apo afatshkurter si dhe grupit perkates brenda llojit. Kerkesat minimale qe duhet te permbaje rregjistri i aktiveve ne vartesi te llojit, perfshijne: daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronesia.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësi zbatues T.S. dhe autorizues V.L..

Procesi i inventarizimit për vitin 2019, është kryer nga komisioni i ngritur me anë të Urdhrit të

Drejtorit të DRAP nr. 50/1, nr. prot, datë 23.12.2019, i përbërë nga E.D., E.D. dhe A.T..
Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni nuk ka gjetur mangësi në inventaret e institucionit.

III.2.3.1.2. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë
Sipas formatit të regjistrit të aktiveve që mban ZVAT Tiranë, përmban informacion vetëm për emërtimin dhe sasinë e aktive të shoqërisë, por jo informacion sipas formatit të kërkuar, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, e cila përcakton se:

Formati i rregjistrit te aktiveve hartohet ne vartesi te llojit te tyre afatgjate apo afatshkurter si dhe grupit perkates brenda llojit. Kerkesat minimale qe duhet te permbaje rregjistri i aktiveve ne vartesi te llojit, perfshijne: daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronesia.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi T.S. me detyrë specialiste e financës dhe K.F. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve (nëpunës zbatues), si dhe nëpunësit autorizues, sipas periudhës objekt auditimi (R.D., S.K., E.A.).

Me anë të Urdhrit nr. 36, nr. 5595 prot., datë 23.12.2019, të Drejtorit të ZVAP Tiranë z. F.Ç., është ngritur komisioni për inventarizimin e magazinës dhe zyrave të ZVAP Tiranë, i përbërë nga: T.S., E.A., E.Z. dhe A.L..
Nga ky proces inventarizimi, u konstatua se:
-Komisioni nuk ka prodhuar asnjë relacion mbi rezultatet e procesit të inventarizimit.
-Komisioni nuk ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve, për arsye se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se komisioni ka firmosur mbi fletat e aktiveve sipas gjendjes kontabile, ndërsa pjesa sipas të dhënave të inventarit (sasia, mungesat, teprica, nxjerrje jashtë përdorimi, etj.), është e paplotësuar nga komisioni.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 85-86, të cilat përcaktojnë se:

85. Komisioni i inventarizimit ka pergjegjesine per:
a. Verifikimin fizik dhe cilesor te gjendjes se aktiveve ne ngarkim/perdorim te personelit te njesise publike dhe pasqyrimin e te dhenave te inventarizimit ne proceverbalin perkates, i cili ruhet gjate periudhes se inventarizimit.
b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë proçesverbalet.
c. Te perpiloje nje raport lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, per kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe per vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat pergjegjes, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorezoje per veprime te metejshme Nepunesit Autorizues.
86. Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të inventarizimit T.S., E.A., E.Z. dhe A.L..

Me anë të Urdhrit nr. 37, nr. 5656 prot., datë 24.12.2019, Drejtori i ZVAP Tiranë z. F.Ç., ka

urdhëruar kalimin kapital të automjetit me targa TR3211F, për llogari të shkollës së mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë. Sipas këtij urdhri, kalimi do bëhet me anë të një procesverbali që do mbahet nga z. K.F. për ZVAP Tiranë dhe një përfaqësues i shkollës së mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë.
Ky urdhër është nxjerrë në zbatim të rekomandimit të dërguar nga Auditi i Brendshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dërguar me shkresën e Ministrit nr. 1177, datë 01.02.2019.
Në zbatim të Urdhrit nr. 37, nr. 5656 prot., datë 24.12.2019, me anë të procesverbalit të datës 28.12.2019, të mbajtur midis z. K.F. për ZVAP Tiranë dhe z. A. K për shkollën e mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë, është vendosur kalimi kapital i automjetit me targë TR3211F dhe me vlerë fillestare 920,000 lekë.
Kalimi kapital i këtij mjeti nga ZVAP Tiranë për llogari të shkollës së mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë me anë të Urdhrit nr. 37, nr. 5656 prot., datë 24.12.2019, është kryer në tejkalim të kompetencave të Drejtorit të ZVAT Tiranë, për arsye se përgjegjësinë për nxjerrjen jashtë përdorimi dhe tjetërsimin e aktiveve, nuk e ka Drejtori i ZVAT Tiranë, por Ministri i MASR. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 111, e cila përcakton se:

Makineritë dhe pajisjet nxirren nga përdorimit me miratimin e:
a. Titullarit te njesise publike për aktive te tilla si: Sistemime dhe rregullime te tokave; Prita mbrojtese e te ngjashme; Mure rrethuese; Terrene sportive; Rruge, rrjete (perfshi rrjetin kompjuterik) dhe vepra ujore, Mjete Transporti; Sisteme te teknologjise dhe informacionit me shtrirje kombetare, Instalime teknike e pajisje me vlere materiale dhe rendesi te konsiderueshme per realizimin e objektivave te njesise publike; Aktive afatgjata jomateriale si studime dhe kerkime.

Pika, 5, e cila përcakton se:

Përgjegjësia e Titullarit te njesise publike[3]
5. Titullari i njësisë publike eshte pergjegjes per miratimin e rregullave specifike dhe procedurave per ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashte perdorimit te aktiveve te njesise publike4 ne perputhje me kerkesat e ketij udhezimi.
3. Kreu i organit qendror te njesise publike sipas nenit 4/22 te ligjit nr.10296, date 8.07.2010 "Per MFK" (Ministri, Kreu i Institucionit te Pavarur, Kryetari i Bashkise, Komunes, Keshillit te Qarkut).

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 22, e cila përcakton se:

22. "Titullar i njësisë publike" është kreu i organit qëndror të njësisë publike.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ky automjet nuk konstatohet të jetë nxjerrë jashtë përdorimi, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 108-109, të cilat përcaktojnë se:

108. Aktivet afatgjata qe konsiderohen te panevojshme per njesine ne nje periudhe te mevonshme te funksionimit te saj (ne rast mbylljeje/shkrirjeje te njesise, ndryshimi te misionit apo objektivave afatgjate te njesise), por qe mbeten ne gjendje perdorimi mund të jepen ne rend shterues (nga a ne b).
a. transferohen pa pagese në një njësi tjetër publike brenda sektorit te qeverisjes se pergjithshme. Konfirmimi zyrtar nga njesia perfituese verteton perfundimin e transaksionit;
b. shiten në formën e ankandit publik
109. Aktivet që pas vleresimit nxirren jashte përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale te ricikluesshme, hiqen nga rregjistri i aktiveve ne perdorim, behen hyrje ne magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga perdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillesare, groposur ose

djegur.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi K.F. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve dhe F.Ç. ish-drejtor i ZVAP Tiranë.

III.2.3.1.3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për ZVAP Durrës, konstatohet se për asetet ZVAP Durrës mban një regjistër ku përcaktohet vetëm vlera dhe sasia e asetit, por jo të dhëna si datën e hyrjes ose marrjes në dorezim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.
Një fakt i tillë është pranuar dhe nga vetë ZVAP Durrës, në procesverbalin e datës 31.12.2019, i mbajtur në përfundim të procesit të inventarizimit nga komisioni përkatës (B.Sh., V.Ç. dhe M.M.) dhe përgjegjësi i sektorit të shërbimeve z. B.G., si dhe i miratuar Drejtori i ZVAP znj. E.A. me anë të Vendimit nr. 1315, datë 31.12.2019.
Nga inventarizimi i vitit 2019, grupet kanë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi materiale në vlerën 2,423,239 lekë, të cilat edhe pse janë vlerësuar si jashtë përdorimi, nuk janë marrë masa për nxjerrjen jashtë përdorimi të tyre dhe pasqyrimit të këtyre veprimeve në pasqyrat financiare.
Megjithëse janë konstatuar këto mangësi në procesin e inventarizimit, nga strukturat drejtuese të ZVAP Durrës, nga dokumentacionit dhe informacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet të jenë marrë masa për rregullimin e gjendjes së krijuar.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, e cila përcakton se:

Formati i rregjistrit te aktiveve hartohet ne vartesi te llojit te tyre afatgjate apo afatshkurter si dhe grupit perkates brenda llojit. Kerkesat minimale qe duhet te permbaje rregjistri i aktiveve ne vartesi te llojit, perfshijne: daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronesia.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësit zbatues dhe autorizues, sipas periudhës objekt auditimi (E.A. dhe J.M.).

III.2.3.1.4. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shijak

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për ZVAP Shijak, konstatohet se:
-ZVAP Shijak nuk ka një regjistër të aktiveve që ka në zotërim dhe/ose përdorim.
-ZVAP Shijak nuk ka kryer inventarizimin e aktiveve për vitin ushtrimor 2019.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:
Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", i cili përcakton se:

1. Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.
2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare.

Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, e cila përcakton se:

Formati i rregjistrit te aktiveve hartohet ne vartesi te llojit te tyre afatgjate apo afatshkurter si dhe grupit perkates brenda llojit. Kerkesat minimale qe duhet te permbaje rregjistri i aktiveve ne vartesi te llojit, perfshijne: daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronesia.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi M.D. dhe B.K..

III.2.3.1.5. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për ZVAP Kavajë, konstatohet se për asetet ZVAP Kavajë mban një regjistër ku përcaktohet vetëm vlera dhe sasia e asetit, por jo të dhëna si daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronësia, etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, e cila përcakton se:

Formati i rregjistrit te aktiveve hartohet ne vartesi te llojit te tyre afatgjate apo afatshkurter si dhe grupit perkates brenda llojit. Kerkesat minimale qe duhet te permbaje rregjistri i aktiveve ne vartesi te llojit, perfshijne: daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronesia.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësit zbatues (N.Sh. dhe S.Gj. dhe autorizues (S.P. dhe M.C.).

III.2.3.1.6. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Dibër

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave Materiale e monetare, për ZVAP Dibër, konstatohet se për asetet ZVAP Dibër mban një regjistër ku përcaktohet vetëm vlera dhe sasia e asetit, por jo të dhëna si datën e hyrjes ose marrjes në dorezim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Veprimet e mësipërme janë
në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, e cila përcakton se:

Formati i rregjistrit te aktiveve hartohet ne vartesi te llojit te tyre afatgjate apo afatshkurter si dhe grupit perkates brenda llojit. Kerkesat minimale qe duhet te permbaje rregjistri i aktiveve ne vartesi te llojit, perfshijne: daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronesia.

-ZVAP Dibër, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për viti 2019, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", i cili përcakton se:

1. Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.
2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësit zbatues (Sh.C. dhe V.K. dhe autorizues (A.H. dhe B.D.).

III.2.3.1.7. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Bulqizë

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave Materiale e monetare, për ZVAP Bulqizë, konstatohet se për asetet ZVAP Bulqizë mban një regjistër ku përcaktohet vetëm vlera dhe sasia e asetit, por jo të dhëna si datën e hyrjes ose marrjes në dorezim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, e cila përcakton se:

Formati i rregjistrit te aktiveve hartohet ne vartesi te llojit te tyre afatgjate apo afatshkurter si dhe grupit perkates brenda llojit. Kerkesat minimale qe duhet te permbaje rregjistri i aktiveve ne vartesi te llojit, perfshijne: daten e hyrjes ose marrjes ne dorezim, pershkrimin e aktivit, vleren e blerjes, daten e daljes ne perdorim, daten e skadences, vleren e shpenzimeve kapitale te mepasshme qe sjellin rritje te vleres se aktivit, vendndodhjen, personin pergjegjes, vleren e akumuluar te amortizimit, kohen e sherbimeve te mirembajtjes, vleren e akumuluar te shpenzimeve te mirembajtjes, daten e daljes nga pronesia.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi P.L. dhe K.K..

Procesi i inventarizimit për vitin 2019, është kryer me anë të Urdhrit të Brendshëm të Drejtorit nr. 34, datë 04.12.2019.
Në përfundim të procesit të inventarizimit, janë konstatuar mungesa në inventar, mungesa të cilat janë pajisje kompjuterike të ish-punonjësve të ZVAP Bulqizë, të cilët janë larguar nga detyra, por nuk kanë dorëzuar këto pajisje në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës. Mungesat dhe personat në ngarkim, janë:

1. Labtop ASUS me vlerë **61,000 lekë**, H.Xh. me detyrë ish specialiste finance, larguar më 31.05.2019.
2. Tablet me vlerë **35,726 lekë**, A.H. me detyrë ish specialist i TIK, larguar më 31.05.2019.
3. Labtop LENOVO me vlerë **79,000 lekë** dhe Tablet me vlerë **35,726 lekë**, B.M. me detyrë ish Drejtor ZVAP Bulqizë deri në janar 2018, larguar më 09.03.2018.
4. Tablet me vlerë **35,726 lekë**, K.D. me detyrë ish përgjegjës i sektorit të shërbimeve mbështetëse, larguar më 15.05.2017.

Vlera totale e pajisjeve të padorëzuara nga ish punonjësit, **në shumën 247,178 lekë**, përbën **dëm ekonomik** për llogari të buxhetit të shtetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 13, e cila përcakton se:

Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit te percaktuar nga Nepunesi Autorizues i njesise respektive sipas specifikave te aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nepunesi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.

Nga ana e komisionit të inventarizimit dhe Drejtorit të ZVAP Bulqizë, edhe pse janë konstatuar këto mangësi, nuk janë marrë masa për zhdëmtimin dhe ngarkimin me përgjegjësinë materiale të personave që i kanë patur në ngarkim këto pajisje, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 89 dhe pika 93, të cilat përcaktojnë se:

89. Në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vleftë, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësit me përgjegjësi materiale, kurse tepricat behen hyrje ne magazine dhe shkojnë në dobi të njesisë.
93. Nepunesi autorizues i njesise jep urdhër zhdemtimin per mungesat e konstatuara ne ngarkim te personave me pergjegjesi materiale. Nepunesi Zbatues ndjek procesin dhe kryen rregjistrimet kontabel perfundimtare.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi:
-Për mos dorëzimin e pajisjeve pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës, ish punonjësit që i kanë në ngarkim këto pajisje.
-Për mos ndjekjen e hapave ligjorë për rimarrjen e pajisjeve ose zhdëmtimin e tyre, P.L. dhe K.K..

III.2.3.2. Mbi qarkullimin e vlerave monetare.
Në këtë pikë, është përfshirë auditimi i procedurave të prokurimit, si dhe i shpenzimeve të kryera nga DRAP Durrës dhe ZVAP e përzgjedhur për auditim.

Në lidhje me shpenzimet e transportit për mësuesit dhe nxënësit, VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, përcakton që:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, në lidhje me këto shpenzime, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar të marra nën auditim, kanë operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit. Përjashtim nga kjo mënyrë, bën vetëm ZVAP Bulqizë, edhe kjo vetëm për vitin 2019, për të cilin ka realizuar procedurë prokurimi, ndërsa për vitin 2020, nuk ka realizuar një të tillë.
Kryerja e këtyre pagesave në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur procedurat e prokurimit, sipas kërkesave të pikës 3, të VKM nr. 682, datë 29.07.2015, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

Në total, nga ZVAP e marra nën auditim, janë kryer pagesa në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4 dhe VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, në vlerën 157,423,324 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Institucioni	Viti 2019	Viti 2020	Shuma
1	ZVAP Tiranë	17,259,435	13,357,338	**30,616,773**
2	ZVAP Durrës	29,493,852	13,764,611	**43,258,463**
3	ZVAP Shijak	2,296,731	5,262,631	**7,559,362**
4	ZVAP Kavajë	9,915,366	2,898,507	**12,813,873**
5	ZVAP Mat	24,261,874	5,622,961	**29,884,835**
6	ZVAP Dibër	15,775,961	9,811,430	**25,587,391**
7	ZVAP Bulqizë	5,325,175	2,377,452	**7,702,627**
Shuma		**104,328,394**	**53,094,930**	**157,423,324**

Pagesa e drejtpërdrejtë në kundërshtim me kërkesat ligjore e këtyre shpenzimeve, **ka shkaktuar përdorim pa eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet** të fondeve publike me vlerë **157,423,324 lekë**.

Për vitin 2019, nisur nga fakti se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ish-Drejtorive Arsimore Rajonale) përkatëse.

Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).

Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "*...Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*

Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.

*Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar **ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.".

Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi:

-Nëpunësit Zbatues dhe Autorizues, të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ish-Drejtorive Arsimore Rajonale), për kryerjen e pagesave pa procedurë prokurimi.

-Për mos zhvillimin e procedurave të prokurimit për vitin 2020, V.L. drejtor i DRAP Durrës për

periudhën objekt auditimi.
Më hollësisht, trajtimi i kësaj çështje sipas Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar përkatëse, është si më poshtë vijon:

III.2.3.2.1. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës

1. Procedura e prokurimit e zhvilluar me objekt "*Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12*", viti 2019.

DRAP Durrës, për vitin 2019, sipas Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve, ka zhvilluar një procedurë "Kërkesë për propozim" me vlerë 7,000,000 lekë dhe 5 procedura me "Blerje me vlerë të vogël", ndërsa për vitin 2020, ka realizuar 3 procedura me "Blerje me vlerë të vogël".
Në lidhje me këtë pikë, është audituar transaksioni për kryerjen e pagesës me anë të Urdhër Shpenzimit nr. 26, datë 26.05.2020, me vlerë 4,164,736 lekë, procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt "*Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12*", me fond limit 7,000,000 lekë, nga ku është konstatuar si vijon:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:

1. Urdhër Prokurimi Nr. 7, datë 07.10.2019	**3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit (Njësia e Prokurimit)**	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 38, datë 23.10.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për Propozim	Urdhër Nr. 7, datë 07.10.2019 E.P., Specialiste (jurist) L.C., Specialiste (inxhinier) E.D., specialiste (ekonomiste)	E.D. F.K. P.N.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 7,000,000 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** OE A. SHPK 6,816,120 lekë pa tvsh	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 183,880 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 11.11.2019	**9. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomike** **a)** Pjesëmarrës në tender Numër **1 OE** b) S'kualifikuar **0** OE, c) Kualifikuar **1** OE

11. Ankimime **AK**-s'ka; **APP**– s'ka; **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr datë	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave

14. Lidhja e kontratës Nr. Datë	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** lekë	**16. Likuiduar deri** **dt.....Lekë** **Palikuiduar deri dt..... Lekë.....**
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/ Shërbimi dt.... Vlera me tvsh.....lekë Vlera pa tvsh.....lekë	**18. Afati i kontratës në dite** Parashikuar ditë Zbatuar__ditë	**19. Zgjatja e kontratës me..... ditë** Shkresa (Amendamenti) nr..... dt.....

20. **Mbikëqyrësi i punimeve** Emri Mbiemri	Licen. Nr.....	Kontrata Nr ....Prot....datë ___ lekë	Likuiduar ..... lekë)	Pa likuiduar .....lekë)
21. **Kolaudatori i punimeve** Emri Mbiemri	Licen. Nr	Nr .....Prot.....datë	Likuiduar (.... lekë)	Pa likuiduar (...lekë)
22. Akt Kolaudimi datë.....	**23**. **Akt i marrjes në dorëzim** Nr. ___, datë ____		**24**. Fletë Hyrja	

Ky zë është i parashikuar në Regjistrin e Parashikimeve Publike të vitit 2019, të dërguar me shkresën nr. 666, daë 07.10.2019, dërguar Degës së Thesarit Durrës dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vlerën 7,000,000 lekë pa tvsh.

Ky zë parashikohet në Buxhetin e vitit ushtrimor 2019, në programet përkatëse për trajnimin e punonjësve të:

- Arsimit bazë në vlerën 5,000,000 lekë,
- Arsimit të mesëm në vlerën 3,000,000 lekë lekë dhe
- Drejtuesve të institucioneve arsimore në vlerën 400,000 lekë.

Por, me shkresën nr, 9891/1 datë 12.11.2019 të MASR, fondet e arsimit të mesëm janë pakësuar me vlerën 3,000,000 lekë. Si rezultat i këtij pakësimi, fondet e mbetura të miratuara për këtë procedurë, janë në vlerën 5,400,000 lekë, por AK ka vazhduar me procedurën e prokurimit pa reflektuar në fondin limit të kësaj procedure. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70, i cili përcakton se:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

Si dhe me Udhëzimin nr. 9.1, datë 20.03.2018 "Për procedurat e zbatimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të Qeverisë", Kreu III, pika 15/b, e cila përcakton se:

***b. Faza e angazhimit financiar**. Nepunesi Zbatues merr njoftim nga struktura pergjegjese per prokurimet per perfundimin e procesit te prokurimit që shoqerohet me nenshkrim kontrate per blerje dhe shërbime, procedon me dhenien e opinionit pas kontrollit te njoftimit përfundimtar zyrtar per shpalljen e fltuesit, shpalljen ne buletinin e prokurimeve publike dhe negocimit te kontratës per afatet e pagesave.*

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit (E.P., E.D. dhe L.C.), titullari i AK V.L. dhe nëpunësi zbatues T.S..

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me anë të Urdhrit nr. 36/1, datë 26.09.2019 "Për përllogaritjen e fondit limit për prokurimin "Trajnimi i mësuesve", titullari i AK znj. V.L., ka ngritur komisionin për përllogaritjen e fondit limit, të përbërë nga znj. E.P. juriste dhe znj. L.C. specialiste në sektorin e BNJSSH.
Komisioni me anë të shkresës pa numër protokolli dhe pa datë, ka hartuar fondin limit në vlerën 7,000,000 lekë pa tvsh, si mesataren e 3 ofertave të mëposhtme:

1. A. SHPK me vlerë 2,157 lekë për mësues;
2. S.G.SHPK me vlerë 2,242 lekë për mësues dhe
3. Q.O.D. me vlerë 2,247 lekë për mësues.

Grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike dhe ka përllogaritur fondin limit, bazuar në numrin e 3160 mësuesish për tu trajnuar. Grupi i punës ka përgatitur gjithashtu edhe planin dhe kurrikulën e trajnimit, përfshirë edhe pushimet ndërmjet seancave.

Në lidhje me këtë përllogaritje fondi limit, konstatohet se:
-Grupi i punës nuk ka argumentuar se përse ka përzgjedhur metodën e studimit të vlerës së kontratës.
-Grupi i punës nuk ka argumentuar OE të përzgjedhur për studimin e vlerës së kontratës, në kushtet kur:

- OE Q.O.D. nuk rezulton të jetë i regjistruar në QKB (as me NIPT as me emër);
- OP S.G.SHPK, me adresë në Fier, nuk ka për objekt të aktivitetit objektin e prokurimit (trajnim i mësuesve).

-Grupi i punës nuk ka përcaktuar se përse do kryhet trajnim vetëm për 3160 mësues, nga të gjithë mësuesit që ka nën juridiksion kjo drejtori (mbi 10 mijë).
-Në vijim të buxhetimit të fondeve sipas pjesëmarrësve në trajnim, në përllogaritjen e fondit limit nuk është kryer një analizë mbi ndarjen e këtyre pjesëmarrësve (arsim bazë, i mesëm – i lartë dhe drejtues institucionesh arsimore).
-Sipas specifikimeve teknike të hartuara, parashikohet që në një ditë të trajnohen 12 grupe prej maksimumi 26 mësuesish në grup në një ditë trajnimi, me një kohëzgjatje prej 4 orësh, për 7 tema dhe 62 nëntema. Ky model trajnimi i hartuar është i paarritshëm për tu kryer.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:
Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 23, pikat 1 dhe 4, të cilat përcaktojnë se:

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 1, e cila përcakton se:

Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Si dhe neni 59, i cili ndër të tjera përcakton se:

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit (E.P. dhe L.C.).

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 7, datë 07.10.2019, titullari i AK znj. V.L., ka urdhëruar njësjes e kësaj procedure me fond limit 7,000,000 lekë, me procedurë "Kërkesë për propozim", si dhe ka ngritur Njësinë e Prokurimit të përbërë nga:

1. E.P., juriste,
2. E.D., ekonomiste dhe
3. L.C., inxhiniere.

Por nga shqyrtimi i sistemit elektronik të APP për këtë procedurë, rezulton në seksionin e "Zyrtarët e Prokurimit", janë vetëm 2 emra: K.C. (zëvendësoi E.P.) dhe L.C.. Mos pasqyrimi i emrit të E.D., e cila është anëtare e NjP e caktuar me Urdhrin e titullarit të AK nr. 7, datë 07.10.2019, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 57, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në raste të tjera, titullari i autoriteti kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit...

Për këtë veprim mbajnë me përgjegjësi anëtarët e NjP (E.P., E.D. dhe L.C.).

Sipas Inventarit të dosjes së prokurimit në fjalë, rezulton se DT janë miratuar me anë të Procesverbalit nr. 01/1, datë 21.10.2019, por që ky procesverbal nuk u gjend në dosjen e tenderit.

Dokumentet e tenderit (DT) janë protokolluar me nr. 01, datë 18.10.2019. Në lidhje me hartimin, ndryshimin dhe miratimin e këtyre DT, konstatohet se:

-Nuk është kryer argumentimi i OE të ftuar për këtë procedurë prokurimi, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.

-DT janë firmosur vetëm prej 2 anëtarëve nga 3 të tillë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

-DT janë hartuar dhe miratuar 3 ditë më para se të hartohet Procesverbali i hartimit të DT, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

-Nuk konstatohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit për Anëtarët e NjP, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 56, i cili ndër të tjera përcakton se:

Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

-Afati i ekzekutimit të kontratës, në dokumentet e miratuara dhe publikuara, rezulton i ndryshëm 3 herë, e konkretisht:

1. Në Formularin e Njoftimit të Kontratës: 1 muaj nga nënshkrimi i kontratës;
2. Në shtojcën 10 të DT: Nga lidhja deri në përmbushjen e saj (pa afat);
3. Në DT, seksioni I. Njoftimi i Kontratës, pika 2.9 (faqe 4): Deri më 30.12.2019.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 1, e cila përcakton se:

Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

-Në DT e publikuara, Shtojca nr. 7, pika 2.1, është kërkuar që: "*Operatori ekonomik duhet te jete i akredituar prane Ministrise Arsimit, Sportit dhe Rinise per zhvillimin e trajnimeve*". Një kërkesë e tillë është e paqartë, për arsye se nuk është specifikuar se për çfarë fushe trajnimesh duhet të jenë të akredituar OE. Në zbatim të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin mësimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimit të Ministrit të MASR nr. 1, datë 20.01.2017 "Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë", MASR akrediton modulet e trajnimit të paraqitur nga OE dhe nuk akrediton vetë OE.

-Në DT e publikuara, Shtojca nr. 7, pika 2.3, është kërkuar që: "*Operatoret ekonomik duhet te kene ne dispozicion per kryerjen e ketij trajnimi gjithsej 26 (Njezet e gjashte) trajnues te profileve sipas tabeles se meposhme*".

Një kërkesë e tillë është e pargumentuar dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, ku në një ditë do kryhet trajnim vetëm për 12 grupe, ndërkohë që kërkohen 26 trajnues (2 trajnues për çdo grup/temë).

Gjithashtu, nuk është kërkuar se për çfarë teme duhet të jenë të specializuar trajnuesit, por vetëm profili (arsim fillor, 9-vjeçar dhe i mesëm).

-Në DT e publikuara, Shtojca nr. 7, pika 2.3, është kërkuar që: "*Listen e personelit kryesor te nevojshem per zhvillimin e kesaj proçedure prokurimi stafi i administrimit dhe CV e personelit te stafit te administrimit*". Një kërkesë e tillë është e paargumentuar, për arsye se nuk është përcaktuar cili është stafi i administrimit dhe cilët janë detyrat dhe kërkesat e këtij stafi për realizimin e kësaj kontrate.

-Në DT e publikuara, Shtojca nr. 7, pika 2.3, është kërkuar që: "*Operatori ekonomik duhet te kete minimumi 30 (tridhjet) punonjes te siguruar. Per kete Operatori Ekonomik duhet te paraqese liste pagesat e kontributit te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per periudhen Janar-Shtator 2019*". Një kërkesë e tillë është e pargumentuar dhe nuk është nëpërpjestim me aftësinë zbatuese të kontratës.

-Në DT e publikuara, Shtojca nr. 7, pika 2.3, është kërkuar që: "*Shenim: Te gjithe trajnuesit duhet te jene ne katalogun e MASR*", kërkesë kjo e pargumentuar dhe e paqartë për arsye se nuk është specifikuar se në cilin katalog duhet të jenë të përfshirë trajnuesit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 46, pika 1, e cila përcakton se:

*1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme**, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese***.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 2, e cila përcakton se:

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e NjP (E.P., E.D. dhe L.C.).

Me anë të emailit të datës 28.10.2019, Koordinimi APP ka dërguar komentet mbi DT, ku janë të përfshira edhe sa më sipër. Me anë të Urdhrit nr. 713, datë 30.10.2019, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar NjP për shqyrtimin e ankesës. Pezullimi i kryer nga titullari i AK, është kryer në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 11, datë 22.05.2015 "Për procesin e pezullimit, modifikimit të dokumentave standarde të tenderit dhe shtyrjen e afatit të proçedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik", për arsye se nuk parashikohet pezullimi i procedurës për shkak të shqyrtimit të rekomandimeve të APP. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK V.L..
Me anë të Shtojcës datë 30.10.2019 "Për disa ndryshime në dokumentat standarde të tenderit me objekt "Trajnimi i mësuesve të arsimit bazë për kurrikulën e re dhe trajnim i mësuesve të arsimit te mesëm të lartë per kurrikulën e klasave 10,11 dhe 12"", janë bërë disa ndryshime të DT. Kjo shtojcë është e pafirmosur dhe nuk konstatohet të jetë e qartë hartuesit dhe miratuesit e saj, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Me anë të Urdhrit nr. 714, datë 30.10.2019 "Urdhër për heqje pezullimi procedure prokurimi", titullari i AK ka urdhëruar heqjen e procedurës së pezullimit dhe shtyrjen e afatit të pranimit të ofertave deri më datë 01.11.2019. Por afati i mëparshëm i hapjes për këtë procedurë ishte data 04.11.2019 dhe me ndryshimin e DT jo vetëm që nuk është shtyrë, por është afruar me 3 ditë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 62, i cili përcakton se:

Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 (pesë) ditë për prokurimet me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë dhe me 10 (dhjetë) ditë për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, në përputhje me nenin 42 të LPP-së.

Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK (V.L.).

Zhvillimi i procedurës
Me anë të Urdhrit nr. 38, datë 23.10.2019, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e KVO, të përbërë nga:

1. E.D., kryetare,
2. F.K.dhe
3. P.N., anëtarë.

Vendosja e E.D. në cilësinë e anëtares së KVO, e cila është njëkohësisht edhe anëtare e NjP, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili ndër të tjera përcakton se:

Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi titullari i AK V.L. dhe anëtarja e NjP E.D..

Nga shqyrtimi i sistemit elektronik për këtë procedurë, konstatohet se afati i fundit i pranimit të ofertave është data 11.11.2019, e jo data 01.11.2019, e vendosur me anë të Urdhrit të titullarit të AK nr. 714, datë 30.10.2019 "Urdhër për heqje pezullimi procedure prokurimi". Hapja e ofertave 10 ditë pas datës së përcaktuar nga titullari i AK dhe pranimi i tyre nga KVO, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 63, pika 1, e cila përcakton se:

1. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktor nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit.

Për këtë veprim mban përgjegjësi anëtari i NjP të ngarkuar me veprimin në sistem (në mungesë të procesverbalit të miratimit të DT nuk mund të konstatohet se cili është) dhe anëtarët e KVO (E.D., F.K.dhe P.N.).

Me anë të emalit të datës 20.11.2019, protokolluar me nr. 01/9, datë 20.11.2019, drejtuar anëtares së NjP E.P., KVO i ka kërkuar një shpjegim si juriste, mbi faktin se OE A. SHPK nuk ka paraqitur Ekstraktin Historik të QKB. Me anë të shkresës nr. 01/10, datë 20.11.2019, drejtuar KVO, juristja i ka kthyer përgjigje OE e ka ezauruar këtë kërkese me anë të Shtojcës nr. 4 "Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme".
Me anë të Raportit përmbledhës nr. 01/11, datë 28.11.2019, KVO ka miratuar procedurën dhe ka shpallur fitues OE A. SHPK me ofertë në vlerën 6,816,120 lekë pa tvsh. Në lidhje me këtë Raport Përmbledhës konstatohet se:
-Sipas Raportit Përmbledhës dhe sistemit elektronik të kësaj procedure prokurimi, procesi i vlerësimit ka përfunduar më datë 20.11.2019, duke u kaluar me 4 ditë afati 5 ditor për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave (total 9 ditë), veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 5, e cila përcakton se:

5. Shqyrtimi i ofertave dhe njoftimi i klasifikimit të ofertuesve duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave.

-OE A. SHPK ka paraqitur një listë me 28 trajnerë të ndryshëm, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar dhe identifikuar se cili nga këta trajnerë do kryejë trajnim në arsimin fillor, 9-vjeçar dhe të mesëm, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në shtojcën nr. 7, pika 2.3, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
-OE A. SHPK, në listën prej 28 trajnerësh të paraqitur, nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë që trajnuesit janë në katalogun e MASR, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në shtojcën nr. 7, pika 2.3, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
-OE A. SHPK ka parqitur Vendimin e Komisionit të Akreditimit të Programeve/ Moduleve të Trajnimit nr. 35, datë 19.12.2017 "Për akreditimin e moduleve të trajnimit", me anë të së cilit, për OE "Sh.B.A.", akreditohen modulet e trajnimeve "Menaxhimi i klasës", "Mësimdhënia në kurrikulat e reja" dhe "Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimim gjithë-përfshirës". Trajnuesit e akredituar janë N.P. dhe D.T.. Në lidhje me këtë akreditim, konstatohet se është lëshuar për OE "Sh.B.A." dhe jo për OE A. SHPK.
Akreditimi është i vlefshëm për 2 nga 7 temat e kërkuara për trajnim. Për temat e mbetura Pedagogjia, Drejtimi i shkolllës, TIK në mësimdhënie dhe nxënie, Dokumentacioni, si dhe Çështje ndërkurrikulare, ky OE nuk është i akredituar, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në shtojcën nr. 7, pika 2.1, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

Referuar konstatimeve të mësipërme, AK duhej të skualifikonte OE A. SHPK e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53, pika 3, e cila përcakton se:

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO (E.D., F.K.dhe P.N.).

Me anë të Vendimit nr. 01/12, datë 29.11.2019, titullari i AK ka miratuar procedurën dhe shpalljen e fituesit.
Formulari i Njoftimit të Fituesit është dërguar me shkresën nr. 01/15, datë 23.12.2019 dhe është publikuar në Buletinin e APP nr. 52, datë 30.12.2019, faqe 74-75. Dërgimi i Njoftimit të Fituesit pothuaj 1 muaj pas përfundimit të procesit të vlerësimit, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 58, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, njoftimi i fituesit dërgohet në platformën elektronike të prokurimit, ditën e nesërme të punës nga marrja e vendimit.

Ky njoftim është dërguar në zbatim të Vendimit të Titullarit të AK nr. 36/2, nr. prot. 01/13, datë 23.12.2019 "Për vazhdimin e procedurës së prokurimit "Trajnim i mësuesve"".
Gjithashtu, me anë të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 21920, datë 02.12.2019 "Mbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore", në pikën 2 të saj, MFE urdhëron që:

Autoritetet Kontraktore ndalohen menjëherë të nënshkruajnë kontrata të reja që janë në proces prokurimi apo të ndërmarrin procedura të reja prokurimi me fondet publike (përveç fondeve të emergjencës/fatkeqësisë).

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e NjP (E.P., E.D. dhe L.C.) dhe titullari i AK V.L..

Me anë të Urdhrit e titullarit të AK nr. 01/14, datë 23.12.2019, zëvendësohet anëtarja e NjP E.P. me K.Ç..

OE A. SHPK ka sjellë Formularin e Sigurimit të Kontratës nr. 0013450, datë 24.12.2019, me vlerë 817,935 lekë.
Kontrata nr. 01/18, datë 24.12.209, me vlerë 6,816,120 lekë pa tvsh ose 8,179,344 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2019, është nënshkruar nga titullari i AK znj. V.L. dhe për OE A. SHPK nga z. P.A..
Ndërsa me Amendamentin e kontratës të datës 24.12.2019, të nënshkruar nga nga titullari i AK znj. V.L. dhe për OE A. SHPK nga z. P.A., palët kanë rënë dakord për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të kësaj kontrate deri më datë 15.02.2020.
Nënshkrimi i kontratës nga titullari i AK znj. V.L., është kryer në kundërshtim me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 21920, datë 02.12.2019 "Mbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore", pika 2, e cila përcakon se:

Autoritetet Kontraktore ndalohen menjëherë të nënshkruajnë kontrata të reja që janë në proces prokurimi apo të ndërmarrin procedura të reja prokurimi me fondet publike (përveç fondeve të emergjencës/fatkeqësisë).

Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK V.L..

Zbatimi i kontratës
Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 26, datë 26.05.2020, me vlerë 4,164,736 lekë, është kryer likuidimi për faturën nr. 19773, datë 21.05.2020, me vlerë 4,164,736 lekë me tvsh.
Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate, konstatohet se:
-Nga AK nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar, përsë kjo kontratë është zbatuar në masën 51%, duke mbetur pa u zbatuar pjesa tjetër në vlerën 4,014,608 lekë me tvsh.
-Sipas Urdhrit nr. 56, datë 21.02.2020, të titullarit të AK, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, konstatohet se trajnimi për ZVAP Dibër dhe ZVAP Burrël do zhvillohet më datë 21.02.2020, ndërkohë që kontrata përfundon më datë 15.02.2020.
Për sa më sipër, OE A. SHPK, nuk i ka realizuar shërbimet brenda afateve të përcaktuara në

kontratën nr. 01/18, datë 24.12.209, të ndryshuar me Amendamentin e datës 24.12.2019, e për pasojë nga AK duhej të përllogariteshin dëme të likuidueshme për kryerjen e vonuar të shërbimeve, si më poshtë vijon:
Për ZVAP Dibër dhe ZVAP Bulqizë në vlerën **32,738 lekë**, e cila përllogaritet 6 ditë (15.02.2020 deri në 21.02.2020) * 4/1000 (Shtjoca 15 e Kushteve të Kontratës, neni 20.1/a) * 1,364,087 lekë (Vlera e mbetur e parealizuar për këto dy ZVAP: 527 mësues * 2,157 lekë/mësues + TVSH).

Me anë të Amendamentit të Kontratës nr. 01/18, datë 13.02.2020, të nënshkruar nga titullari i AK znj. V.L. dhe përfaqësuesi i OE A. SHPK z. P.A., palët kanë rënë dakord për shtyrjen e afatit të realizimit të kontratës deri më datë 31.12.2020. Sipas këtij amendamenti, arsyeja e shtyrjes është "*Për arsye të pamundësisë së AK për të plotësuar detyrimet kontraktuale të përcaktuar në nenin Detyrimet e Punëdhënësit*".
Në lidhje me këtë amendamenti, konstatohet se:
-Me anë të këtij amendamenti, titullari i AK ka shtyrë afatin e realizimit të kontratës fillestare me 10.5 muaj të tjerë, në kushtet kur sipas parashikimeve të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë, kohëzgjatja e saj ishte parashikuar vetëm 1 muaj nga nënshkrimi i kontratës.
-Në kushtet kur ka mbetur pa realizuar vetëm 49% të kontratës.
-Në kushtet kur kontrata fillestare është nënshkruar pa fonde në dispozicion, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70, i cili përcakton se:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

Si dhe me Udhëzimin nr. 9.1, datë 20.03.2018 "Për procedurat e zbatimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të Qeverisë", Kreu III, pika 15/b, e cila përcakton se:

b. Faza e angazhimit financiar. *Nepunesi Zbatues merr njoftim nga struktura pergjegjese perprokurimet per perfundimin e procesit te prokurin-rit qd shoqerohet me nenshkrim kontrate perblerje dhe sherbime. procedon me dhenien e opinionit pas kontrollit te njoftimit përfundimtar zyrtar per shpalljen e fltuesit. shpalljen ne buletinin e prokurimeve publike dhe negocimit tekontrat€s per afatet e pagesave*.

-Me nënshkrimin e këtij amendamenti, AK ka shmangur procedurat e LPP, duke mos zhvilluar procedurë të re, por me shtyrjen pa afat të kësaj kontrate, duke shkelur kështu parimet e transparencës në procedurat e prokurimit dhe barazinë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, si dhe duke shmangur ligjin e prokurimit publik.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 2, pikat b dhe c, të ciltat përcaktojnë se:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:
b) transparencë në procedurat e prokurimit;
c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Dhe nenin 4, i cili përkcaton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK V.L..

III.2.3.2.2. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë

1. Procedura e zhvilluar me objekt "Akordim dhe riparim pianosh"

Në zbatim kërkesës së Drejtorit të Shkollës Koreografike Tiranë me nr. 105 prot, datë 21.01.2019, protokolluar në ZVAP Tiranë me nr. 236, datë 22.01.2019, si dhe të kërkesës së Drejtorit të Shkollës Artistike "Jordan Misja" Tiranë me nr. 100, datë 21.01.201, protokolluar në ZVAP Tiranë me nr. 213, datë 21.01.2019;
Me anë të Urdhrit nr. 10, datë 13.03.2019, Drejtori i ZVAP Tiranë ka ngritur komisionin për përcaktimin e nevojave për akordim pianosh dhe analizën e kostove për shkollën koreografike. Me anë të relacionit të datës 01.04.2019, komisioni ka përllogaritur nevojat dhe ka përllogaritur fondin limit në vlerën 423,055 lekë pa tvsh, si mesataren e 3 ofertave.
Me anë të Urdhrit nr. 11, datë 13.03.2019, Drejtori i ZVAP Tiranë ka ngritur komisionin për përcaktimin e nevojave për akordim pianosh dhe analizën e kostove për shkollën "Jordan Misja". Me anë të relacionit të datës 01.04.2019, komisioni ka përllogaritur nevojat dhe ka përllogaritur fondin limit në vlerën 366,666 lekë pa tvsh, si mesataren e 3 ofertave.

Me anë të Urdhër-Prokurimit nr. 10, nr. 52 prot, datë 01.04.2019 "Për akordim dhe riparim pianosh", titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës me fond limit 789,721 lekë pa tvsh (947,666 lekë me tvsh), me procedurë "Blerje me vlerë të vogël". Sipas Ftesës për Ofertë nr. 53, datë 03.04.2019, data e zhvillimit të procedurës do jetë data 05.04.2019, ora 09:00.
Sipas sistemit elektronik të APP, në datën e hapjes kanë paraqitur ofertë OE si më poshtë vijon:

1. T.K. 759,800 lekë,
2. S.Rr. 765,800 lekë,
3. Sh.K. 779,999 lekë,
4. E.A. 789,000 lekë,
5. O.M.789,500 lekë dhe
6. A.D. 789,700 lekë.

Me anë të procesverbalit të datës 05.04.2019, komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, ka shpallur fitues OE T.K. me ofertë në vlerën 759,800 lekë pa tvsh, bazuar në kriterin e çmimit më të ulët.
Kontrata nr. 54, datë 08.04.2019, me vlerë 911,760 lekë me tvsh, me afat 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.
Me anë të faturës tatimore nr. 11, datë 24.05.2019, me vlerë 911,760 lekë me tvsh, OE T.K. ka faturuar për shërbimet e kryera.
Shërbimet janë pranuar me anë të Procesverbaleve të marrjes në dorëzim të datës 27.05.2019 për shkollën "Jordan Misja" dhe datë 02.05.2019 për shkollën koreografike, nga komisionet e ngritura respektivisht me urdhrat e titullarit të AK nr. 26 dhe nr. 27, datë 25.04.2019.

2. Procedura e zhvilluar me objekt "Blerje paisje dhe materiale për skulpturë, për shkollën "Jordan Misja" Tiranë"

Në zbatim kërkesës së Drejtorit të Shkollës Artistike "Jordan Misja" Tiranë me nr. 100, datë 21.01.2019, protokolluar në ZVAP Tiranë me nr. 213, datë 21.01.2019, me anë të Urdhrit nr. 6, datë 25.02.2019, Drejtori i ZVAP Tiranë ka ngritur komisionin për përcaktimin e nevojave dhe analizën e kostove për procedurën "Blerje paisje dhe materiale për skulpturë, për shkollën "Jordan Misja" Tiranë". Me anë të procesverbalit të datës 26.03.2019, komisioni ka përllogaritur nevojat dhe ka përllogaritur fondin limit në vlerën 540,033 lekë pa tvsh, si mesataren e 3 ofertave.
Me anë të Urdhër-Prokurimit nr. 7, nr. 35 prot, datë 26.0.2019 "Blerje paisje dhe materiale për skulpturë, për shkollën "Jordan Misja" Tiranë", titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës me fond limit 540,033 lekë pa tvsh (648,040 lekë me tvsh), me procedurë "Blerje me vlerë të vogël". Sipas Ftesës për Ofertë nr. 36, datë 26.03.2019, data e zhvillimit të procedurës do jetë data 28.03.2019, ora 09:00.
Sipas sistemit elektronik të APP, në datën e hapjes kanë paraqitur ofertë 10 OE.
Me anë të procesverbaleve datë 29.03.2019, 02.04.2019 dhe 02.04.2019, komisioni ka shpallur fitues OE N.H. me vlerë 488,000 lekë pa tvsh, për shkak të tërheqjes nga oferta të OE të renditur i

pari dhe mos paraqitjes së OE të renditur i dyti.
Me anë të faturës tatimore nr. 40, datë 05.04.2019, me vlerë 585,600 lekë me tvsh, OE N.H. ka faturuar për mallrat e sjellë.

Mallrat janë marrë në dorëzim me anë të Procesverbalit të marrjes në dorëzim të datës 05.04.2019, nga komisioni i ngritur me anë të Urdhrit të titullarit të AK nr. 20, datë 28.03.2019.

3. Procedurën e prokurimit te zhvilluar me objekt "Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë"

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë procedurë, konstatohet që:

<table>
<tr><td colspan="6">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë"</td></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 15.01.2019
2. lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim"</td><td colspan="2">3. Njësia e prokurimit
Urdhër nr. 1, datë 15.01.2019
B.S.
M.L.
T.T.</td><td colspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 1, datë 15.01.2019
E.P.
E.T.
E.S.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa tvsh)
2,636,566 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa tvsh)
2,539,430 lekë</td><td colspan="2">7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)
97,136 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
28.01.2019</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td colspan="2">10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
1. E.D 2,539,430 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimime
JO</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK
N/A</td><td colspan="2">13. Përgjigje ankesës nga AKKP-
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="6">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. lidhje e kontratës
Nr. 6, datë 08.02.2019</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me tvsh)
3,047,316 lekë</td><td colspan="2">16. Likuiduar 2,948,496 lekë
Pa likuiduar: 98,820 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë
13.01.2020</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës në ditë
Parashikuar nga lidhja deri më 25.12.2019</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës me ditë
JO</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td colspan="2">Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td colspan="2">Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="2">22. Akt Kolaudimi
N/A</td><td colspan="2">23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm
N/A</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja nr:
N/A</td></tr>
</table>

Kjo procedurë është nisur në zbatim kërkesës së Drejtorit të Shkollës Artistike "Jordan Misja" Tiranë me nr. 27, datë 05.10.2018, protokolluar në ZVAP Tiranë me nr. 3543, datë 08.10.2018.
Me anë të Urdhrit nr. 24, datë 27.11.2018, titullari i AK znj. A.B., ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit, të përbërë nga B.L., B.H. dhe B.Sh..
Me anë të procesverbalit të datës 13.12.2018, komisioni ka përllogaritur fondin limit në vlerën 2,636,566 lekë pa tvsh, për 8,326 orësh modelimi.

Në lidhje me përllogaritjen e fondit limit, konstatohet se:
-Komisioni ka administruar 3 ofertat si më poshtë:

1. A.S.O. SHPK ka ofruar 300 lekë/ora ulur,
2. PF E.D. ka ofruar 300 lekë lekë/ora dhe
3. I.C. SHPK ka ofruar 350 lekë/ora ulur.

Komisioni nuk ka argumentuar përse ka marrë mesataren e këtyre 3 ofertave dhe jo vlerën më të

ulët, çka ka sjellë që fondi limit të llogaritej në çmimin 317 lekë ora (2,636,566 lekë / 8,326 orë), ose 17 lekë më shtrentë se 2 ofertat e para.
-Komisioni nuk ka argumentuar arsyen e përzgjedhjes së metodës së studimit të tregut, në hartimin e fondit limit.
-Komisioni nuk ka argumentuar përzgjedhjen e OE të marrë në studim tregu, në kushtet kur sipas verifikimeve të kryera në QKB, vetëm OE PF E.D. ka për objekt aktiviteti kryerjen e shërbimeve të modelingut, ndërsa OE S.O. SHPK dhe I.C. SHPK, nuk kanë për objekt aktiviteti kryerjen e shërbimeve të modelingut.
-Komisioni nuk ka argumentuar përse nuk ka përzgjedhur si metodë të përllogaritjes së fondit limit, vlerën e kontratave të mëparshme, në kushtet kur gjatë vitit 2018, ky shërbim është kryer me çmimin 267 lekë/ora.
Për pasojë, nga mos argumentimi i mënyrës së përzgjedhur të përcaktimit të fondit limit dhe mos marrja në konsideratë e vlerës së kontratës së mëparshme, komisioni ka përllogaritur fondin limit me çmim më të lartë se kontrata e mëparshme në vlerën 50 lekë/ora, ose me vlerë **415,787 lekë** (pa tvsh). Gjithashtu, nisur nga fakti që ofertat e OE A.S.O. SHPK dhe I.C. SHPK, janë marrë dhe administruar në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik (RrPP), ofertat e tyre janë të pavlefshme.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit B.L., B.H. dhe B.Sh., si dhe titullari i AK A.B. për miratimin e vlerës së përllogaritur.

Në zbatim të Urdhër Prokurimit nr. 12, datë 13.12.2018, titullari i AK znj. A.B., ka urdhëruar nisjen e procedurës "*Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë*", me procedurë "Kërkesë për propozim-Marrëveshje kuadër", me fond limit në vlerën 2,636,566 lekë pa tvsh.
Sipas Raportit Përmbledhës datë 08.01.2019, miratuar nga titullari i AK në datën e hapjes është paraqitur vetëm 1 ofertë, ajo e PF E.D., e cila është skualifikuar për arsye se afati i punësimit të punonjësve që shërbejnë si modele, përfundon në qershor 2019 dhe jo në dhjetor 2019, siç kërkohet në DT.

Në zbatim të Urdhër Prokurimit nr. 1, datë 15.01.2019, titullari i AK znj. A.B., ka urdhëruar nisjen e procedurës "*Modele pikture 2019*", me procedurë "Kërkesë për propozim-Marrëveshje kuadër", me fond limit në vlerën 2,636,566 lekë pa tvsh.
Sipas Raportit Përmbledhës datë 08.01.2019, miratuar nga titullari i AK në datën e hapjes është paraqitur vetëm 1 ofertë, ajo e PF E.D. në vlerën 2,539,430 lekë pa tvsh, ofertë e cila është pranuar nga AK.
Kontrata nr. 6, datë 08.02.2019, me vlerë 3,047,316 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2019, është nënshkruar nga titullari i AK z. R. D dhe z. E.D. për OE PF E.D.. Formulari i sigurimit të kontratës nr. 056012, datë 07.02.2019, është me vlerë 304,731.6 lekë.

Sipas Formularit të Ofertës së OE PF E.D., pjesë e kontratës nr. 6, datë 08.02.2019, çmimi për njësi është në vlerën 305 lekë/ora. Si rezultat i përllogaritjes së fondit limit në vlerën 317 lekë/ora, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ka sjellë në faktin e një rritje të paargumentuar të fondit limit e për pasojë të vlerës së ofertës së OE PF E.D. me 38 lekë/ora (305 lekë/ora – 267 lekë/ora) çmim për njësi, ose në vlerën totale **316,388 lekë** (38 lekë/ora * 8,326 orë modelimi). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit B.L., B.H. dhe B.Sh., si dhe titullari i AK A.B. për miratimin e vlerës së përllogaritur.

Zbatimi i kontratës
Kjo kontratë është realizuar dhe paguar sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:
Me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 79, datë 28.03.2019, me vlerë 1,149,972 lekë, për faturën tatimore nr. 12, datë 25.03.2019, me vlerë 1,149,972 lekë. Kjo faturë është pranuar me anë të Procesverbalit nr. 144, datë 19.03.2019, të nënshkruar nga znj. V.G. dhe z. H.M., përkatësisht drejtor dhe zv. drejtor të shkollës artistike "Jordan Misja".
Me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 201, datë 04.07.2019, me vlerë 1,528,416 lekë, për faturën tatimore nr. 21, datë 24.06.2019, me vlerë 1,528,416 lekë. Kjo faturë është pranuar me anë të Procesverbalit nr. 228, datë 20.06.2019, të nënshkruar nga znj. V.G. dhe z. H.M., përkatësisht drejtor dhe zv. drejtor të shkollës artistike "Jordan Misja".
Me anë të Urdhër-Shpenzimit nr. 73, datë 19.02.2020, me vlerë 270,108 lekë, për faturën tatimore nr. 25, datë 13.01.2020, me vlerë 270,108 lekë. Shërbimet janë pranuar me anë të Procesverbalit nr. 93, datë 10.01, të nënshkruar nga znj. V.G. dhe z. H.M., përkatësisht drejtor dhe zv. drejtor të shkollës artistike "Jordan Misja", sipas Urdhrit të drejtorit të shkollës artistike "Jordan Misja" znj. V.G. nr. 114, datë 08.02.2019.

Në lidhje me procesverbalet e marrjes në dorëzim, konstatohet se janë 2 modele (N. C dhe F. Xh), të cilat nuk janë pjesë e kontratës kolektive të paraqitur nga OE PF E.D. në procedurën e prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 60, pikat 1 dhe 2, të cilat përcaktojnë se:

1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese.
2. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, duhet të përmbushen në mirëbesim nga palët.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim sipas Urdhrit nr. 114, datë 08.02.2019 V.G. dhe H.M..

4. Shpenzimet e transportit
Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion në lidhje me pagesat e shpenzimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, ZVAP Tiranë, ka operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit. Këto pagesa janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Vlera	Nëpunësi Autorizues	Nëpunësi Zbatues
	Nr.	Datë			
1	177	09/07/2019	4,379	R.D.	K.F.
2	178	09/07/2019	65,803	R.D.	K.F.
3	179	09/07/2019	8,380	R.D.	K.F.
4	183	09/07/2019	68,837	R.D.	K.F.
5	184	09/07/2019	1,921,838	R.D.	K.F.
6	185	09/07/2019	2,464	R.D.	K.F.
7	211	10/07/2019	2,723,600	R.D.	K.F.

8	180	11/07/2019	1,177,991	R.D.	K.F.
9	241	05/08/2019	1,242,300	R.D.	K.F.
10	429	13/12/2019	3,784	S.K.	K.F.
11	430	13/12/2019	213,121	S.K.	K.F.
12	431	13/12/2019	105,708	S.K.	K.F.
13	432	13/12/2019	3,945,878	S.K.	K.F.
14	458	13/12/2019	1,404,920	S.K.	K.F.
15	433	13/12/2019	4,370,432	S.K.	K.F.
16	59	19/02/2020	942,547	E.A.	K.F.
17	60	19/02/2020	51,975	E.A.	K.F.
18	61	19/02/2020	27,852	E.A.	K.F.
19	69	19/02/2020	880	E.A.	K.F.
20	128	22/04/2020	4,048	E.A.	K.F.
21	129	22/04/2020	235,372	E.A.	K.F.
22	130	22/04/2020	110,298	E.A.	K.F.
23	132	22/04/2020	4,519,258	E.A.	K.F.
24	131	06/05/2020	3,587,036	E.A.	K.F.
25	164	27/05/2020	3,878,072	E.A.	K.F.

Në lidhje me këto shpenzime, totali i të cilave është në **vlerën 30,616,773 lekë** për periudhën 01.01.2019-31.08.2020, ZVAP Tiranë, nuk ka kryer procedurë prokurimi, por i ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Për vitin 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e ZVAP Tiranë, për arsye se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019. Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).

Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "*...Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë*

15 ditore.
Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.
*Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar **ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.".
Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësi zbatues (K.F.) dhe autorizues (R.D., S.K., E.A.), sipas tabelës së mësipërme dhe V.L. drejtor i DRAP Durrës për periudhën objekt auditimi.

III.2.3.2.3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës

1. Procedura e prokurimit me objekt "*Shërbim Interneti 2019*"

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë procedurë, konstatohet që:

<table>
<tr><td colspan="5">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shërbim Interneti 2019"</td></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 8, datë 28.01.2019
2. lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim-Shërbime"</td><td colspan="2">3. Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi nr. 8, datë 28.01.2019
T.S.
G.Q.
E.P.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhri N/A
I.G.
K.Ll.
L.R.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa tvsh)
2,050,000 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa tvsh)
1,271,150 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)
778,850 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
12.02.2019</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
1. A. SHPK 1.271.150 lekë,
2. N. SHPK 1,590,000 lekë,
3. A. SHPK 1,636,000 lekë,
4. A. SHPK 1,796,000 lekë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimime
N/A</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK
N/A</td><td>13. Përgjigje ankesës nga AKKP-
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="5">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. Lidhje e kontratës
Nr. 656, datë 02.04.2019</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me tvsh)
1,525,380 lekë</td><td>16. Likuiduar 1,525,380 lekë
Pa likuiduar: 0 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë
31.10.2019</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës në ditë
Parashikuar nga lidhja deri më 31.12.2019</td><td>19. Zgjatja e kontratës me ditë
JO</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td>Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
N/A</td><td>Licencë
N/A</td><td>Kontrata
N/A</td><td>Likuiduar
N/A</td><td>Pa likuiduar
N/A</td></tr>
<tr><td colspan="2">22. Akt Kolaudimi
N/A</td><td colspan="2">23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm
N/A</td><td>24. Fletë Hyrja nr:
N/A</td></tr>
</table>

Në lidhje me këtë procedurë, nga ZVAP Durrës nuk gjendjej dosja fizike e procedurës së prokurimit, veprim ky në kundërshtim me në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 22, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

4. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

Nenin 12, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.
Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:
a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;
ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
dh) vlerën ose mënyrën e përllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

-Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.

Me anë të observacioneve të dërguara me shkresën nr. 1308/33, datë 13.11.2020, për Akt-Konstatimin nr. 8, datë 06.11.2020, anëtarja e Njësisë së Prokurimit T.S., ka dërguar një kopje të dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi. Sipas kësaj shkrese, znj. Sulejmani pretendon se kjo dosje, është gjetur në arkivën e Shkollës 9-vjeçare "Marie Kaçulini", por pa dhënë asnjë shpjegim ligjor se përse dosja e prokurimit të ish-DAR Durrës, gjendjen në arkivën e kësaj shkolle, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
Pas verifikimit të dokumenteve të paraqitura nga anëtarja e Njësisë së Prokurimit T.S. për këtë procedurë, konstatohet se:
-Mungon Procesverbali i miratimit të DT dhe ndarjes së detyrave ndërmjet anëtarëve të Njësisë së Prokurimit (*nuk përcaktohet se cili nga anëtarët është autorizuar për kryerjen e veprimeve në SPE*), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 4.
-Mungon Formulari i Njoftimit të Kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 5 "Publikimi i njoftimit të kontratës".

Gjatë shqyrtimit të observacioneve të Projektraportit të Auditimit, grupi i auditimit është vënë në dijeni të Procesverbalit "Për dorëzim dokumentacioni", i mbajtur më datë 22.08.2019, i mbajtur

midis z. B.G. dhe znj. L.D., ku përcaktohet se: "Ky procesverbal mbahet me qëllim të dorëzimit të detyrës si pasojë e dorëheqjes së znj. D". Ky procesverbal është i nënshkruar nga znj. L.D. dhe z. B.G..
Përveç sa më sipër, konstatohet se sipas këtij procesverbali, **z. B.G. ka marrë në dorëzim edhe procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt "Shërbim Interneti 2019"**, procedurë të cilën nuk ja vuri në dispozicion grupit të auditimit, me pretendimin se nuk ishte dorëzuar nga ish-punonjësit.
Pretendimi i z. B.G. për mos vënien në dispozion të dokumentacionit, përveç faktit që **është një pretendim i rremë**, duke mos vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacionin e kërkuar në bazë të këtij pretendimi të rremë, ka penguar Kontrollin e Lartë të Shtetit në ushtrimin e detyrave kushtetuese, duke kryer kështu **një shkelje të rëndë të detyrës dhe Ligjit** 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 26 "Aksesi në dokumentet zyrtare".
Për këto veprime mban përgjegjësi B.G..

Pretendimi i znj. L.D., me observacionin nr. 1278 prot., datë 30.12.2020, mbi dorëzimin e detyrës te z. B.G. qëndron dhe merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Në mungesë të dosjes fizike, auditimi për këtë procedurë prokurimi u krye vetëm mbi dokumentacionin dhe informacionin elektronik të administruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) në APP, si dhe dokumentacionin fizik të pagesave.
Sipas Njoftimi të Fituesit në SPE, konstatohet të kenë ofertuar 4 OE, të cilët janë pranuar të gjithë:
1. OE A. SHPK me ofertë 1,271,150 lekë pa tvsh,
2. OE N.SHPK me ofertë 1,590,000 lekë pa tvsh,
3. OE A.SHPK me ofertë 1,636,000 lekë pa tvsh,
4. OE A.SHPK me ofertë 1,796,000 lekë pa tvsh.

Fitues është shpallur OE A. SHPK me ofertë në vlerën 1,271,150 lekë pa tvsh.

Kontrata nr. 656 prot., datë 02.04.2019, me vlerë 1,525,380 lekë me tvsh, me afat deri në 31.12.2019, është nënshkruar nga znj. L.M. për AK dhe z. T.Y. për OE A. SHPK.
Por nga verifikimi i SPE, konstatohet se Njoftimi i Lidhjes së Kontratës është dërguar më datë 20.03.2019 ose 13 ditë para nënshkrimit të kontratës, ndërsa Konfirmimi i Lidhjes së Kontratës, është dërguar më datë 28.03.2019 ose 5 ditë para nënshkrimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 6, pika 2, e cila përcakton se:

2. Autoriteti kontraktor dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit (T.S., G.Q. dhe E.P.).

2. Shpenzimet e transportit
Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion në lidhje me pagesat e shpenzimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se:
Për periudhën objekt auditimi, ZVAP Durrës, ka operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit.
Këto pagesa janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Vlera	Nëpunësi Zbatues	Nëpunësi Autorizues
	Nr.	Datë			
1	97	11.04.2019	584,822	L.D.	L.M.

2	98	11.04.2019	336,268	L.D.	L.M.
3	100	15.04.2019	107,268	L.D.	L.M.
4	101	15.04.2019	229,000	L.D.	L.M.
5	96	11.04.2019	2,021,958	L.D.	L.M.
6	93	10.04.2019	9,608,350	L.D.	L.M.
7	176	21.06.2019	501,588	L.D.	E.A.
8	177	21.06.2019	319,951	L.D.	E.A.
9	168	21.06.2019	957,734	L.D.	E.A.
10	174	21.06.2019	1,689,602	L.D.	E.A.
11	175	21.06.2019	1,321,663	L.D.	E.A.
12	368	12.12.2019	8,814,560	B.G.	E.A.
13	369	12.12.2019	1,392,975	B.G.	E.A.
14	370	12.12.2019	1,062,865	B.G.	E.A.
15	371	12.12.2019	209,342	B.G.	E.A.
16	372	12.12.2019	246,395	B.G.	E.A.
17	396	31.12.2019	41,760	B.G.	E.A.
18	400	31.12.2019	47,751	B.G.	E.A.
19	39	18.02.2020	490,917	B.G.	J.M.
20	40	18.02.2020	266,200	B.G.	J.M.
21	65	11.03.2020	3,322,637	B.G.	J.M.
22	111	22.04.2020	454,100	B.G.	J.M.
23	114	22.04.2020	617,493	B.G.	J.M.
24	110	22.04.2020	6,855,937	B.G.	J.M.
25	191	07.07.2020	635,466	B.G.	J.M.
26	189	07.07.2020	72,817	B.G.	J.M.
27	186	07.07.2020	873,197	B.G.	J.M.
28	112	22.04.2020	77,611	B.G.	J.M.
29	113	22.04.2020	98,236	B.G.	J.M.

Në lidhje me këto shpenzime, totali i të cilave është në **vlerën 43,258,463 lekë**, ZVAP Durrës, nuk ka kryer procedurë prokurimi, por i ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Për vitin 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e ZVAP Durrës, për arsye se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019. Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).
Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "...*Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*
Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.
Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.".
Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësit zbatues (L.D. dhe B.G.) dhe autorizues (L.M., E.A. dhe J.M.), sipas tabelës së mësipërme dhe V.L. drejtor i DRAP Durrës për periudhën objekt auditimi.

III.2.3.2.4. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shijak

1. Shpenzimet e transportit

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion në lidhje me pagesat e shpenzimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se:
Për periudhën objekt auditimi, ZVAP Shijak, ka operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit. Këto pagesa janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Vlera në lekë	Nëpunësi Zbatues	Nëpunsi Autorizues
	Nr.	Datë			
1	91	13/12/2019	1,647,657	M.D.	B.K.
2	92	13/12/2019	72,624	M.D.	B.K.
3	93	13/12/2019	476,592	M.D.	B.K.
4	94	13/12/2019	36,312	M.D.	B.K.
5	95	13/12/2019	22,695	M.D.	B.K.
6	96	13/12/2019	40,851	M.D.	B.K.
7	36	09/03/2020	1,350,931	M.D.	B.K.
8	37	09/03/2020	19,200	M.D.	B.K.
9	39	09/03/2020	169,930	M.D.	B.K.

10	40	09/03/2020	20,610	M.D.	B.K.
11	81	05/06/2020	20,410	M.D.	B.K.
12	82	05/06/2020	20,410	M.D.	B.K.
13	84	08/06/2020	3,449,213	M.D.	B.K.
14	98	23/07/2020	66,878	M.D.	B.K.
15	99	23/07/2020	20,292	M.D.	B.K.
16	100	23/07/2020	45,696	M.D.	B.K.
17	102	23/07/2020	79,061	M.D.	B.K.

Në lidhje me këto shpenzime, totali i të cilave është në **vlerën 7,559,362 lekë**, ZVAP Shijak, nuk ka kryer procedurë prokurimi, por i ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Për vitin 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e ZVAP Shijak, për arsye se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019. Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).
Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "*...Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*
Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.
Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare****.*".
Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në

zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësi zbatues (M.D.) dhe autorizues (B.K.), sipas tabelës së mësipërme dhe V.L. drejtor i DRAP Durrës për periudhën objekt auditimi.

III.2.3.2.5. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë

1. Shpenzimet e transportit

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion në lidhje me pagesat e shpenzimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se:

Për periudhën objekt auditimi, ZVAP Kavajë, ka operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit.

Këto pagesa janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Vlera në lekë	Nëpunësi Zbatues	Nëpunsi Autorizues
	Nr.	Datë			
1	41	20/02/2019	713,092	N.Sh.	S.P.
2	46	20/02/2019	321,800	N.Sh.	S.P.
3	65	19/03/2019	746,672	N.Sh.	S.P.
4	72	28/03/2019	344,370	N.Sh.	S.P.
5	100	16/04/2019	329,510	N.Sh.	S.P.
6	101	16/04/2019	23,560	N.Sh.	S.P.
7	102	16/04/2019	19,190	N.Sh.	S.P.
8	103	16/04/2019	11,970	N.Sh.	S.P.
9	126	16/05/2019	772,512	N.Sh.	S.P.
10	131	28/05/2019	256,390	N.Sh.	S.P.
11	132	28/05/2019	18,544	N.Sh.	S.P.
12	133	28/05/2019	14,089	N.Sh.	S.P.
13	134	28/05/2019	7,272	N.Sh.	S.P.
14	135	28/05/2019	352,660	N.Sh.	S.P.
15	136	28/05/2019	24,800	N.Sh.	S.P.
16	137	28/05/2019	20,200	N.Sh.	S.P.
17	138	28/05/2019	11,200	N.Sh.	S.P.
18	156	21/06/2019	1,087,068	S.Gj.	S.P.
19	157	21/06/2019	365,693	S.Gj.	S.P.
20	158	21/06/2019	30,080	S.Gj.	S.P.
21	159	21/06/2019	20,429	S.Gj.	S.P.
22	160	21/06/2019	10,542	S.Gj.	S.P.
23	161	21/06/2019	507,230	S.Gj.	S.P.
24	162	21/06/2019	41,000	S.Gj.	S.P.
25	163	21/06/2019	29,290	S.Gj.	S.P.
26	164	21/06/2019	16,240	S.Gj.	S.P.
27	279	22/11/2019	1,385,032	S.Gj.	M.C.
28	282	22/11/2019	298,396	S.Gj.	M.C.
29	302	10/12/2019	1,174,096	S.Gj.	M.C.
30	305	10/12/2019	205,047	S.Gj.	M.C.
31	306	10/12/2019	10,472	S.Gj.	M.C.

32	342	31/12/2019	612,568	S.Gj.	M.C.
33	345	31/12/2019	126,960	S.Gj.	M.C.
34	346	31/12/2019	7,392	S.Gj.	M.C.
35	35	19/02/2020	1,104,664	S.Gj.	M.C.
36	36	19/02/2020	115,512	S.Gj.	M.C.
37	99	15/05/2020	1,391,632	S.Gj.	M.C.
38	100	15/05/2020	286,699	S.Gj.	M.C.

Në lidhje me këto shpenzime, totali i të cilave është në **vlerën 12,813,873 lekë**, ZVAP Kavajë, nuk ka kryer procedurë prokurimi, por i ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Për vitin 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e ZVAP Kavajë, për arsye se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019. Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).
Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "*...Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*
Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.
Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.".
Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësit zbatues (N.Sh. dhe S.Gj.) dhe autorizues (S.P. dhe

M.C.), sipas tabelës së mësipërme dhe V.L. drejtor i DRAP Durrës për periudhën objekt auditimi.

III.2.3.2.6. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Mat

1. Shpenzimet e transportit

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion në lidhje me pagesat e shpenzimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se:

Për periudhën objekt auditimi, ZVAP Mat, ka operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit.

Këto pagesa janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Vlera	Nëpunësi Zbatues	Nëpunësi Autorizues
	Nr.	Datë			
1	63	18/03/2019	62,241	D.P.	Sh.T.
2	64	18/03/2019	26,130	D.P.	Sh.T.
3	65	18/03/2019	7,054	D.P.	Sh.T.
4	66	18/03/2019	19,640	D.P.	Sh.T.
5	67	19/03/2019	137,344	D.P.	Sh.T.
6	69	19/03/2019	15,197	D.P.	Sh.T.
7	70	19/03/2019	38,377	D.P.	Sh.T.
8	71	19/03/2019	870,725	D.P.	Sh.T.
9	72	19/03/2019	232,002	D.P.	Sh.T.
10	73	19/03/2019	59,310	D.P.	Sh.T.
11	74	19/03/2019	166,134	D.P.	Sh.T.
12	78	25/03/2019	5,349,456	D.P.	Sh.T.
13	114	18/04/2019	89,054	D.P.	Sh.T.
14	115	18/04/2019	26,041	D.P.	Sh.T.
15	116	18/04/2019	9,870	D.P.	Sh.T.
16	118	18/04/2019	421,452	D.P.	Sh.T.
17	119	18/04/2019	129,885	D.P.	Sh.T.
18	120	18/04/2019	30,380	D.P.	Sh.T.
19	121	18/04/2019	80,064	D.P.	Sh.T.
20	122	18/04/2019	3,061,867	D.P.	Sh.T.
21	148	13/05/2019	2,513,983	N.H.	Sh.T.
22	179	11/06/2019	76,308	N.H.	Sh.T.
23	180	11/06/2019	25,924	N.H.	Sh.T.
24	181	11/06/2019	9,400	N.H.	Sh.T.
25	182	11/06/2019	20,371	N.H.	Sh.T.
26	183	11/06/2019	413,226	N.H.	Sh.T.
27	184	11/06/2019	136,313	N.H.	Sh.T.
28	185	11/06/2019	25,164	N.H.	Sh.T.
29	186	11/06/2019	76,231	N.H.	Sh.T.
30	193	21/06/2019	123,162	N.H.	Sh.T.
31	194	21/06/2019	43,544	N.H.	Sh.T.
32	195	21/06/2019	12,512	N.H.	Sh.T.
33	196	21/06/2019	35,996	N.H.	Sh.T.

34	197	21/06/2019	576,623	N.H.	Sh.T.
35	198	21/06/2019	187,633	N.H.	Sh.T.
36	199	21/06/2019	37,166	N.H.	Sh.T.
37	200	21/06/2019	115,283	N.H.	Sh.T.
38	201	21/06/2019	2,888	N.H.	Sh.T.
39	202	21/06/2019	887	N.H.	Sh.T.
40	203	21/06/2019	406	N.H.	Sh.T.
41	204	21/06/2019	456	N.H.	Sh.T.
42	219	04/07/2019	3,765,946	N.H.	Sh.T.
43	239	13/08/2019	1,195,168	N.H.	Sh.T.
44	322	06/11/2019	19,516	N.H.	Sh.T.
45	323	06/11/2019	19,395	N.H.	Sh.T.
46	324	06/11/2019	6,902	N.H.	Sh.T.
47	325	06/11/2019	6,840	N.H.	Sh.T.
48	326	06/11/2019	214,634	N.H.	Sh.T.
49	327	06/11/2019	62,675	N.H.	Sh.T.
50	328	06/11/2019	13,680	N.H.	Sh.T.
51	329	06/11/2019	20,939	N.H.	Sh.T.
52	321	06/11/2019	1,875,942	N.H.	Sh.T.
53	346	19/11/2019	12,276	N.H.	Sh.T.
54	347	19/11/2019	10,452	N.H.	Sh.T.
55	348	19/11/2019	11,176	N.H.	Sh.T.
56	349	19/11/2019	12,276	N.H.	Sh.T.
57	350	19/11/2019	161,429	N.H.	Sh.T.
58	351	19/11/2019	57,881	N.H.	Sh.T.
59	352	19/11/2019	17,439	N.H.	Sh.T.
60	353	19/11/2019	28,832	N.H.	Sh.T.
61	374	12/12/2019	100,172	N.H.	Sh.T.
62	375	12/12/2019	48,803	N.H.	Sh.T.
63	376	12/12/2019	18,105	N.H.	Sh.T.
64	377	12/12/2019	26,987	N.H.	Sh.T.
65	378	12/12/2019	79,440	N.H.	Sh.T.
66	379	12/12/2019	29,727	N.H.	Sh.T.
67	380	12/12/2019	5,610	N.H.	Sh.T.
68	381	12/12/2019	8,211	N.H.	Sh.T.
69	383	13/12/2019	1,165,722	N.H.	Sh.T.
70	400	22/01/2020	15,455	N.H.	Sh.T.
71	401	22/01/2020	12,555	N.H.	Sh.T.
72	402	22/01/2020	6,855	N.H.	Sh.T.
73	403	22/01/2020	7,800	N.H.	Sh.T.
74	36	11/02/2020	31,631	N.H.	Sh.T.
75	37	11/02/2020	15,980	N.H.	Sh.T.
76	38	11/02/2020	9,140	N.H.	Sh.T.
77	39	11/02/2020	9,640	N.H.	Sh.T.

78	40	11/02/2020	411,912	N.H.	Sh.T.
79	41	11/02/2020	131,139	N.H.	Sh.T.
80	42	11/02/2020	43,594	N.H.	Sh.T.
81	43	11/02/2020	77,275	N.H.	Sh.T.
82	68	19/03/2020	51,097	D.P.	Sh.T.
83	65	24/03/2020	35,231	N.H.	Sh.T.
84	66	24/03/2020	16,740	N.H.	Sh.T.
85	67	24/03/2020	9,140	N.H.	Sh.T.
86	68	24/03/2020	10,400	N.H.	Sh.T.
87	69	24/03/2020	1,181,742	N.H.	Sh.T.
88	86	21/04/2020	64,242	N.H.	Sh.T.
89	87	21/04/2020	174,636	N.H.	Sh.T.
90	88	21/04/2020	38,750	N.H.	Sh.T.
91	89	21/04/2020	192,182	N.H.	Sh.T.
92	85	21/04/2020	499,023	N.H.	Sh.T.
93	90	22/04/2020	7,272	N.H.	Sh.T.
94	91	22/04/2020	5,022	N.H.	Sh.T.
95	92	22/04/2020	2,742	N.H.	Sh.T.
96	93	22/04/2020	3,120	N.H.	Sh.T.
97	117	22/05/2020	258,740	N.H.	Sh.T.
98	118	22/05/2020	85,618	N.H.	Sh.T.
99	119	22/05/2020	30,384	N.H.	Sh.T.
100	120	22/05/2020	35,308	N.H.	Sh.T.
101	122	22/05/2020	31,067	N.H.	Sh.T.
102	123	22/05/2020	753,112	N.H.	Sh.T.
103	141	05/06/2020	1,060,257	N.H.	Sh.T.
104	172	08/07/2020	21,238	N.H.	Sh.T.
105	173	08/07/2020	15,444	N.H.	Sh.T.
106	174	08/07/2020	4,680	N.H.	Sh.T.
107	175	08/07/2020	12,402	N.H.	Sh.T.
108	176	08/07/2020	158,629	N.H.	Sh.T.
109	177	08/07/2020	50,271	N.H.	Sh.T.
110	178	08/07/2020	17,732	N.H.	Sh.T.
111	179	08/07/2020	23,764	N.H.	Sh.T.

Në lidhje me këto shpenzime, totali i të cilave është në **vlerën 29,884,835 lekë**, ZVAP Mat, nuk ka kryer procedurë prokurimi, por i ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe

punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Për vitin 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e ZVAP Mat, për arsye se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019. Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).
Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "*...Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*
Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.
Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.".
Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësit zbatues (D.P. dhe N.H.) dhe autorizues (Sh.T.), sipas tabelës së mësipërme dhe V.L. drejtor i DRAP Durrës për periudhën objekt auditimi.

Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve", konstatohet se:
-Në dosjen e administruar nga ZVAP Mat për këtë procedurë, gjenden vetëm dokumentet e mëposhtme:

1. Urdhër prokurimi nr. 25, datë 26.03.2019, me procedurë "Tender i hapur", me fond limit në vlerën 13,658,300 lekë, me Njësi Prokurimi D.P., T.K. dhe R.Gj..
2. Urdhri nr. 34, datë 15.04.2019, për ngritjen e KVO të përbërë nga N.S., E.H. dhe N.H..
3. Formulari i Njoftimit të Anulimit datë 16.05.2019.

Përveç, këtyre dokumenteve, ZVAP Mat nuk dispononte asnjë dokumentacion tjetër për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 22, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

4. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

Nenin 12, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.
Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:
a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;
ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
dh) vlerën ose mënyrën e përllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Si dhe me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
-Nga auditimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) të APP, konstatohet procedura është hedhur në sistem, por pas procesit të hapjes së ofertave, nuk është zhvilluar asnjë proces në SPE, çka ka sjellë që kjo procedurë, edhe pse është zhvilluar dhe anuluar (16.05.2019), nuk rezulton si e tillë në SPE (është akoma në procesin e vlerësimit të ofertave), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 72 "Zhvillimi i procedurave me mjete elektronike", i cili përcakton se:

Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, procedura e hapjes dhe e vlerësimit të ofertave do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën datë 11.01.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, të vënë në dispozicion nga z. D.P. gjatë takimit ballafaques të datës 25.01.2021, kryer në zyrat e KLSH, sqarojmë si më poshtë vijon:
Një kopje e procedurës së zhvilluar, është dërguar fizikisht me anë të observacioneve të dërguara me shkresën nr. 942, datë 12.11.2020, procedurë e iniciuar me anë të Urdhër Prokurimit nr. 25, datë 26.03.2019 dhe sipas Formularit të Njoftimit të Anulimit datë 16.05.2019, është anuluar me argumentin se nuk u paraqit asnjë ofertë brenda afateve ligjore. Në mungesë të dosjes fizike të procedurës së prokurimit gjatë fazës së auditimit në terren, grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi përputhshmërinë e kësaj procedure prokurimi.
Sipas observacionit të dërguar me shkresën nr. 942, datë 12.11.2020, pretendohet se kjo dosje është transferuar në ZVAP Klos, me argumentin e dhënies në përdorim të mobiljeve të ZVAP Mat.
Ndërsa në observacionin e dërguar me shkresën datë 11.01.2021, nga z. P. pretendohet se këtë dosje e ka dorëzuar me procesverbal, se bashku me gjithë dokumentet e tjera. Nga verifikimi i procesverbalit të dorëzimit të dokumentacionit, mbajtur më datë 20.05.2019, ndërmjet z. P. dhe z.

H., nuk përcaktohet në mënyrë të qartë së nëse është dorëzuar ose jo kjo dosje.
Nga verifikimi i kryer në APP, për këtë procedurë, konstatohet se:
-Procedura me numër reference REF-18062-04-15-2019, është hapur më datë 16.04.2019;
-Procedura është mbyllur më datë 16.05.2019;
-Procedura nuk është pezulluar;
-Procedura është në proces vlerësimi akoma (!).
Për këtë arsye, grupi i auditimit, nuk mund ta shihte procedurën në Sistemin të Prokurimit Elektronik (SPE) të APP, gjatë aksesimit me kredencialet e audituesit të ZVAP Mat.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:
-Anëtarët e njësisë së prokurimit D.P., T.K. dhe R.Gj..
-Anëtarët e KVO N.S., E.H. dhe N.H..
-Titullari i AK Sh.T..

Anëtari i NjP z. D.P., është njëkohësisht nëpunës zbatues për ZVA Mat, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3. ***Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK dhe D.P..***

III.2.3.2.7. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Dibër

1. Shpenzimet e transportit

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion në lidhje me pagesat e shpenzimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se këto pagesa janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Vlera	Nëpunësi Zbatues	Nëpunësi Autorizues
	Nr.	Datë			
1	95	25/02/2019	1,147,704	Sh.C.	A.H.
2	96	25/02/2019	368,398	Sh.C.	A.H.
3	97	25/02/2019	37,412	Sh.C.	A.H.
4	98	25/02/2019	97,104	Sh.C.	A.H.
5	149	21/03/2019	1,513,944	Sh.C.	A.H.
6	150	21/03/2019	420,538	Sh.C.	A.H.
7	151	21/03/2019	39,600	Sh.C.	A.H.
8	152	21/03/2019	121,732	Sh.C.	A.H.
9	210	23/04/2019	1,729,626	Sh.C.	B.D.
10	211	23/04/2019	496,694	Sh.C.	B.D.
11	212	23/04/2019	37,244	Sh.C.	B.D.
12	213	23/04/2019	110,876	Sh.C.	B.D.
13	264	24/05/2019	1,706,456	Sh.C.	B.D.
14	265	24/05/2019	497,508	Sh.C.	B.D.
15	266	24/05/2019	36,856	Sh.C.	B.D.
16	267	24/05/2019	113,052	Sh.C.	B.D.
17	319	21/06/2019	37,244	Sh.C.	B.D.
18	320	21/06/2019	196,230	Sh.C.	B.D.
19	321	21/06/2019	1,864,708	Sh.C.	B.D.
20	538	25/10/2019	893,934	Sh.C.	B.D.

21	539	25/10/2019	653,096	Sh.C.	B.D.
22	540	25/10/2019	113,674	Sh.C.	B.D.
23	541	25/10/2019	43,140	Sh.C.	B.D.
24	631	10/12/2019	2,079,493	Sh.C.	B.D.
25	632	10/12/2019	599,316	Sh.C.	B.D.
26	633	10/12/2019	40,512	Sh.C.	B.D.
27	634	10/12/2019	172,622	Sh.C.	B.D.
28	637	11/12/2019	607,248	Sh.C.	B.D.
29	36	22/01/2020	2,006,238	Sh.C.	B.D.
30	71	10/02/2020	786,868	Sh.C.	B.D.
31	72	10/02/2020	221,598	Sh.C.	B.D.
32	73	10/02/2020	65,076	Sh.C.	B.D.
33	78	20/02/2020	606,456	Sh.C.	B.D.
34	119	13/03/2020	1,581,556	V.K.	B.D.
35	166	16/04/2020	1,581,556	V.K.	B.D.
36	217	13/05/2020	851,156	V.K.	B.D.
37	218	13/05/2020	76,200	V.K.	B.D.
38	219	13/05/2020	151,520	V.K.	B.D.
39	220	13/05/2020	146,150	V.K.	B.D.
40	221	13/05/2020	134,430	V.K.	B.D.
41	421	21/10/2020	122,278	V.K.	B.D.
42	422	21/10/2020	547,020	V.K.	B.D.
43	423	21/10/2020	115,964	V.K.	B.D.
44	423	22/10/2020	72,938	V.K.	B.D.
45	424	22/10/2020	479,706	V.K.	B.D.
46	222	13/05/2020	264,720	V.K.	B.D.

Në lidhje me këto shpenzime, totali i të cilave është në **vlerën 25,587,391 lekë**, ZVAP Dibër, nuk ka kryer procedurë prokurimi, por i ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Për vitin 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e ZVAP Dibër, për arsye se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019. Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre

shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).
Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "...*Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*
Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.
Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.".
Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunësit zbatues (Sh.C. dhe V.K.) dhe autorizues (A.H. dhe B.D.), sipas tabelës së mësipërme dhe V.L. drejtor i DRAP Durrës për periudhën objekt auditimi.

Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit
Në ZVAP Dibër, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, kjo njësi pretendon se ka zhvilluar procedurë prokurimi për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve, si dhe ka vënë në dispozicion **vetëm** dokumentacionin si më poshtë vijon:
1. Me anë të Urdhrit nr. 19, datë 11.03.2019, titullari i AK z. A.H., ka urdhëruar ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit për procedurën "Për transportin e punonjësve arsimor që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit për vitin 2019 në institucionet në varësi të Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër". Komisioni përbëhet nga Sh.C., N.N. dhe S.T..
2. Me anë të urdhrit nr. 21, datë 11.03.2019, nga ngritur komisionin e vlerimit të ofertave, të përbërë nga Sh.C., S.Xh. dhe N.N..
3. Me anë të shkresës nr. 511, datë 20.03.2019, titullari i AK ka miratuar Dokumentet e Tenderit për këtë procedurë, me fondin 11,876,982 lekë pa tvsh, procedurë e hapur.
4. Formularët e Njoftimit të Kontratës nr. 519, 520, 521, 522, 523, 524, 525, 526, 527, 528, 529, 530, 531, 533, 534, 535, 536, 537, 538 dhe 539 prot (gjithsej 20 copë), datë 20.03.2020, me **vlerë totale 11,876,982 lekë**, ku konstatohet të jetë ndarë në 20 Lote. Sipas këtyre formularëve, data e zhvillimit të tenderit do jetë data 15.04.2019, ora 19:00.
5. Formulari i Njoftimit të Anulimit nr. 556, atë 25.03.2019, nënshkruar nga titullari i AK znj. B.D., ku në pikën 5, arsyeja e anulimit, përcaktohet që: "***Të tjera****: Nuk është publikuar procedura, sepse Formulari i Njoftimit të Kontratës duhet të përmbajë të gjitha lotet e evidentuara me nr. e Referencës, Objektin e kontratës dhe Fondin Limit të seclit Lot në një Formular të vetëm*".
6. Vlerat e përcaktuara në Formularët e Njoftimit të Kontratës, vlera e të cilave është 11,876,982 lekë, është e ndryshme nga vlerat e përcaktuar në Formularin e Njoftimit të Anulimit, vlera totale e të cilave është 11,876,982 lekë. Ndryshimet janë sipas tabelës si vijon:

Nr. Prot	Vlera Njoft.	Vlera Njoft.	Diferenca

	Kontratës	Anulimit	
519	795,410	795,410	0
520	340,340	340,340	0
521	249,480	249,480	0
522	146,813	146,813	0
523	818,253	818,253	0
524	486,127	486,127	0
525	503,067	503,067	0
526	498,960	498,960	0
527	256,923	256,923	0
528	2,221,730	2,221,730	0
529	700,513	700,513	0
530	261,800	261,800	0
531	261,800	558,507	296,707
532	0	477,190	477,190
533	370,685	370,685	0
534	1,165,010	1,165,010	0
535	200,713	200,713	0
536	506,147	506,147	0
537	134,867	134,867	0
538	586,670	586,670	0
539	597,777	597,777	0
SHUMA	**11,103,085**	**11,876,982**	**773,897**

Për këtë procedurë, nga ZVAP Dibër, pretendohet të jenë zhvilluar procedura prokurimi në mënyrë elektronike, por nga verifikimi elektronik i SPE të APP, nuk konstatohet të jetë zhvilluar në mënyrë elektronike. Gjithashtu, Formulari i Njoftimit të Anulimit nr. 556, atë 25.03.2019, vërtëton faktin se kjo procedurë nuk është zhvilluar në SPE.

Pas "Anulimit" të procedurës së parë, konstatohet se nga AK është nisur procedura e dytë, e cila disponon **vetëm** dokumentacionin si vijon:
1. Urdhri nr. 44, datë 14.05.2019, i titullarit të AK B.D., për ngritjen e KVO, të përbërë nga Sh.C., S.Xh. dhe N.N..
2. Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 576, datë 27.03.2019, nënshkruar nga titullari i AK B.D., sipas të cilit data e zhvillimit të tenderit do jetë data 22.04.2019, pra 09:00.
Sipas këtij formulari, procedura është ndarë në 21 Lote, me vlerë totale 11,876,982 lekë.
3. Formulari i Njoftimit të Anulimit nr. 727, datë 26.04.2019, me arsyetimin se nuk është paraqitur asnjë ofertues (neni 24/1, pika a, e LPP).

Me gjithë kërkesat e grupit të auditimit, nga ZVAP Dibër nuk u vu në dispozicion dokumentacion tjetër për këtë procedurë, me arsyetimin se nuk disponojnë dokumenta të tjera për këtë procedurë. Në lidhje sa më sipër, konstatohet se:
-Asnjëra nga këto procedura nuk është zhvilluar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të APP, por në mënyrë shkresore, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 72 "Zhvillimi i procedurave me mjete

elektronike", i cili përcakton se:

Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, procedura e hapjes dhe e vlerësimit të ofertave do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

-Nuk është hartuar Urdhri i Prokurimit për këtë procedurë, ku të jetë e përcaktuar objekti i prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe emrat e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 60, i cili përcakton se:

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:
-objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe
marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

-Përveç dokumenteve të sipërcituara, ZVAP Dibër nuk dispononte asnjë dokumentacion tjetër për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 22, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

4. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

Nenin 12, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.
Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto
të dhëna:
a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;
ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e
ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
dh) vlerën ose mënyrën e përllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47
të këtij ligji;
g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Si dhe me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.

-Anëtarët e KVO Sh.C. dhe N.N., janë në të njëjtën kohë edhe anëtarë të komisionit për përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili ndër të tjera përcakton se:

Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

-Vendosja e z. Sh.C. si anëtar i NjP dhe KVO, i cili është njëkohësisht **Nëpunës Zbatues** i ZVAP Dibër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e, të cilat përcaktojnë se:

3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: *a) garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit;* *e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;*

Nisur nga fakti që:
Për këtë procedurë prokurimi, ka mungesa të theksuara të dokumentacionit, si Urdhri i Prokurimit, Procesvebali i hartimit të Dokumenteve të Tenderit, Dokumentet e Tenderit, Raporti Përmbledhës;
-Vlera e përcaktuar e fondit limit për këtë procedurë është ndryshe në Formularët e Njoftimit të Kontratës dh ndryshe në Formularin e Njoftimit të Anulimit;
-si dhe kjo procedurë nuk konstatohet të jetë zhvilluar në SPE (nga llogaria e audituesit nuk rezulton asnjë procedurë e tillë);
Grupi i auditimit arrin në konkluzionin se ZVAP Dibër, nuk ka zhvilluar procedura prokurimi në kuptim të Ligjit për Prokurimet Publike, për këto shpenzime, por vetëm ka hartuar manualisht disa nga dokumentet që kërkohen nga LPP.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi:
-Titullarët e AK: A.H. dhe B.D..
-Anëtarët e komisionit për përllogaritjen e fondit limit të ngritur me anë të Urdhrit nr. 19, datë 11.03.2019: Sh.C., N.N. dhe S.T..
-Anëtarët e KVO të ngritur me anë të urdhrit nr. 21, datë 11.03.2019: Sh.C., S.Xh. dhe N.N..

III.2.3.2.8. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Bulqizë

1. Nga shqyrtimi i procedurës zhvilluar me objekt "*Transport mesues dhe nxenes ne Institucionet Arsimore Publike ne varesi te Z.A Bulqize*", konstatohet se:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Transport mesues dhe nxenes ne Institucionet Arsimore Publike ne varesi te Z.A Bulqize*"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 30.01.2019	**3. Njësia e prokurimit** O.T. P.L. Dh.D.	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** O.T. P.L. H.Xh.
2. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "Kërkesë për propozim-Shërbime"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,566,893 lekë	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** 4,537,042 lekë	**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 29,851 lekë

8. Data e hapjes së ofertave 22.02.2019	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i Shtetit		**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1. A. SHPK 4,537,042 lekë	
11. Ankimime JO	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** N/A		**13. Përgjigje ankesës nga AKKP-** N/A	
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. Lidhje e kontratës Pa numër, datë 12.03.2019	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** 5,444,450 lekë		**16. Likuiduar** 5,378,485 lekë Pa likuiduar: 65,965 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë 26.11.2019	**18. Afati i kontratës në muaj** 4 muaj		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** JO	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. **Akt Kolaudimi** N/A	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm** N/A		**24.** Fletë Hyrja nr: N/A	

Asnjë nga dokumentet e vëna në dispozicion, pjesë e dosjes së kësaj procedure prokurimi, nuk janë të protokolluara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
-Nuk janë kryer trajnime të stafit që bëjnë pjesë e komisioneve të caktuara në procedurat e prokurimeve publike, çka ka rezultuar në mos kuptimin e plotë të legjislacionit të prokurimit publik nga këta punonjës.

Sipas Urdhër-Prokurimit nr. 1, datë 30.01.2019, titullari i AK z. K.K., ka urdhëruar nisjen e procedurës me objekt "Transport mesues dhe nxenes ne Institucionet Arsimore Publike ne varesi te Z.A Bulqize", me fond limit 4,366,893 lekë pa tvsh. Sipas pikës 3 të këtij urdhri, njësia e prokurimit (NjP) dhe komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), do jenë grupet e ngritura për vitin 2019. Në lidhje me këtë konstatohet se:
-Urdhri i prokurimit nuk përmban emrat e anëtarëve të NjP, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 60, i cili ndër të tjera përcakton se:

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:
-emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

-2 nga anëtarët e NjP janë njëkohësisht edhe anëtarë të KVO (O.T. dhe P.L.), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili ndër të tjera përcakton se:

Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

-Vendosja e z. P.L. si anëtar i NjP dhe KVO, i cili është njëkohësisht **Nëpunës Zbatues** i ZVAP Bulqizë, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e, të cilat përcaktojnë se:

3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:
a) garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit;

e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi titullari i AK K.K., anëtarët e NjP (O.T., P.L. dhe Dh.D.) dhe anëtarët e KVO (O.T., P.L. dhe H.Xh.).

Me anë të Procesverbalit nr. 4, datë 04.02.2019, NjP ka miratuar DT, nga auditimi i të cilave u konstatua se:

-Nuk është kryer argumentimi i OE të ftuar për këtë procedurë prokurimi, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 4, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.

-Nuk konstatohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit për Anëtarët e NjP dhe KVO, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 56, i cili ndër të tjera përcakton se:

Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

-Nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kërkesave për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se:

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

-Në pikën 2.2.b. të Shtojcës nr. 7, është parashikuar që: "*b. Një dokument të gjendjes financiare te leshuar nga një ose më shumë banka ku vlera e tyre te jete gjithesej jo me pak se 10% e fondit limit. Leshimi i saj te mos jete bere me pare se 10 dite nga data e zhvillimit te tenderit*", kërkesë e cila nuk parashikohet më në kontratat e shërbimeve.

-Në pikën 2.3.c.c. të Shtojcës nr. 7, është parashikuar që: "c*) Të ketë reputacion dhe sjellje të mirë. Vertetim nga prokuroria dhe gjykata.*", por një kërkesë e tillë është e paqartë, për arsye se prokuroria dhe gjykata japin vërtetime vetëm në lidhje me veprat penale dhe jo reputacionin e sjelljen e qytetarëve.

-Në pikën 2.3.c.e. të Shtojcës nr. 7, është parashikuar që: "*e) Edhe ne rast kontraktimi te mjeteve, per te ushtruar kontroll te plote mbi drejtuesit e tyre, duhet te figurojne ne listepagesat e subjektit per gjate gjithe kohezgjatjes kontrates.*", kërkesë për të cilën nuk konstatohet mënyra se si KVO do e verifikojë gjatë procesit të vlerësimit.

-Në pikën 2.3.c.f. të Shtojcës nr. 7, është parashikuar që: "*f) Ne listepagesa subjekti duhet te kete jo me pak se 10 punonjes per nje periudhe 6 muajt e fundit perfshi edhe drejtuesin teknik te shoqerise*", kërkesë e cila ska lidhje me këtë procedurë, për arsye se është kontratë shërbimesh dhe jo punimesh (nuk ka nevojë për drejtues teknik).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 46, pika 1, e cila përcakton se:

*1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme**, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese***.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 2, e cila përcakton se:

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë

zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e NjP (O.T., P.L. dhe Dh.D.).

Në lidhje me procesin e vlerësimit konstatohet se:
-OE A. SHPK ka paraqitur si shërbim të ngjashëm, Faturën nr. 07, datë 04.02.2019, me vlerë 833,334 lekë pa tvsh (ose 1,000,000 lekë me tvsh) dhe Faturën nr. 09, datë 14.02.2019, me vlerë 250,000 lekë pa tvsh (ose 300,000 lekë me tvsh). Totali i këtyre faturave pa tvsh është në shumën 1,083,334 lekë ose në masën 24% të fondit limit (vlera me tvsh në masën 28% të fondit limit), në kundërshtim me kriterin 2.3.a. të Shtojcës 8 (kërkohet minimumi 30%), e për pasojë ky OE nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
-Me anë të Vërtetimeve të Komisiaratit të Policisë Dibër të datës 14.02.2019 (8 copë për 8 mjetet), konstatohet se këto mjete nuk kanë gjoba të papaguara në sistemin elektronik të administrimit të gjobave "E-Gjoba", por nuk provon mos ndëshkimin e shoferëve për drejtimin e mjetit nën efektin e alkolit dhe/ose lëndëve droguese, në kundërshtim me kriterin 2.3.c.e, e për pasojë ky OE nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.
Referuar konstatimeve të mësipërme, AK duhej të skualifikonte OE A. SHPK e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53, pika 3, e cila përcakton se:

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO (O.T., P.L. dhe H.Xh.) dhe titullari i AK K.K..

Formulari i Sigurimit të Kontratës nr. 59078615, datë 12.03.2019, me vlerë 544,445 lekë, me afat deri më datë 08.08.2019.
Kontrata pa numër protokolli, datë 12.03.2019, pa vlerë por sipas Ofertës së OE A. SHPK, është nënshkruar nga z. K.K. për AK dhe z. Artan Balla për OE A. SHPK.

2. Shpenzimet e transportit

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion në lidhje me pagesat e shpenzimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se këto pagesa janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Urdhër Shpenzimi		Vlera në lekë	Nëpunësi Zbatues	Nëpunësi Autorizues	Përfituesi
	Nr.	Datë				
1	5	24/01/2019	1,408,360	P.L.	K.K.	Posta
2	10	12/02/2019	1,519,724	P.L.	K.K.	Posta
3	19	18/03/2019	253,740	P.L.	K.K.	Posta
4	24	25/03/2019	218,380	P.L.	K.K.	Posta
5	32	24/04/2019	1,398,722	P.L.	K.K.	Posta
6	49	24/05/2019	1,700,000	P.L.	K.K.	A. SHPK
7	60	12/06/2019	526,249	P.L.	K.K.	Posta
8	74	17/07/2019	1,805,283	P.L.	K.K.	A. SHPK
9	118	26/11/2019	1,873,202	P.L.	K.K.	A. SHPK
10	35	22/04/2020	2,377,452	P.L.	K.K.	Posta

Në lidhje me këto shpenzime, totali i të cilave është në vlerën **13,081,112 lekë**, konstatohet se:
-Për shpenzime në vlerën 5,378,485 lekë (sipas Urdhër-Shpenzimeve të tabelës së mësipërme), i janë paguar OE A. SHPK, në zbatim të kontratës pa numër protokolli, datë 12.03.2019, me vlerë **5,444,450 lekë me tvsh**, lidhur ndërmjet ZVAP Bulqizë dhe OE A. SHPK, si rezultat i procedurës së prokurimit zhvilluar me objekt "Transport mesues dhe nxenes ne Institucionet Arsimore Publike ne varesi te Z.A Bulqize", zhvilluar në vitin 2019.
-Për shpenzime në vlerën **7,702,627 lekë** (sipas Urdhër-Shpenzimeve të tabelës së mësipërme), ZVAP Bulqizë, nuk ka kryer procedurë prokurimi, por i ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kundërshtim me:
-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4, i cili përcakton se:

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.

-VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se:

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Për vitin 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e ZVAP Bulqizë, për arsye se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019. Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).
Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "*...Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*
Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.
Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.".
Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu Procedurat e Prokurimit Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, e cila përcakton se:

24. "Rregullat e prokurimit" janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi nëpunës zbatues P.L. dhe autorizues K.K., sipas tabelës së

mësipërme dhe V.L. drejtor i DRAP Durrës për periudhën objekt auditimi.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 189 prot., datë 13.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 811/7, datë 15.01.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga anëtarët e KVO E.D., F.K.dhe P.N., sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi i subjektit**: "Ne si anëtarë KVO nuk gëzojmë eksperiencë në fushën e prokurimeve dhe nuk jemi trajnuar për këtë proces dhe ky ka qenë procesi i parë në të cilin kemi marrë pjesë".*
***Qëndrimi i Grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se nuk është i provuar nga ana dokumentare e ligjore, që ju ti keni bërë me dije titullarit të AK, mbi këtë fakt.*
***Pretendimi i subjektit**: "KVO ka vlerësuar se ky staf (i OE A. SHPK) ka kualifikimet dhe aftësitë e nevojshme për të realizuar objektin e prokurimit".*
***Qëndrimi i Grupit të auditimit**: Pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se nuk OE A. SHPK ka paraqitur një listë me 28 trajnerë të ndryshëm, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar dhe identifikuar se cili nga këta trajnerë do kryejë trajnim në arsimin fillor, 9-vjeçar dhe të mesëm, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në shtojcën nr. 7, pika 2.3, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 19 prot., datë 12.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 811/7, datë 15.01.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga përfaqësuesit e ZVAP Shijak: B.K. dhe M.D., sqarojmë se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë, me të njëjtat argumente si sqaruar në përgjigjet e observacioneve të Akt-Konstatimeve.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 189/1 prot., datë 13.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 811/7, datë 15.01.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga përgjegjësja e sektorit të financës Tea Sulejmani, sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi juaj** mbi regjistrin e aktiveve, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.*
***Pretendimi juaj** mbi fondet e procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt "Trajnimi i mësuesve", nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70 dhe Udhëzimin nr. 9.1, datë 20.03.2018 "Për procedurat e zbatimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të Qeverisë", Kreu III, pika 15/b.*
***Pretendimi juaj** mbi procedurën e prokurimit "Blerje interneti", nuk qëndron, sipas argumenteve të sqaruara në përgjigjet e observacioneve të Akt-Konstatimeve.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 71 prot., datë 13.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 811/7, datë 15.01.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga përfaqësuesit e ZVAP Durrës, sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi juaj** se problematikat kanë ardhur si pasojë e marrjes së detyrës pa u bërë dorëzimet e nevojshme nga znj. L.D., nuk qëndron për arsye se grupit të auditimit i është vënë në dispozicion Procesverbali "Për dorëzim dokumentacioni", i mbajtur më datë 22.08.2019, i mbajtur midis z. B.G. dhe znj. L.D., ku përcaktohet se: "Ky procesverbal mbahet me qëllim të dorëzimit të detyrës si pasojë e dorëheqjes së znj. D". Ky procesverbal është i nënshkruar nga znj. L.D. dhe z. B.G..*
Përveç sa më sipër, konstatohet se sipas këtij procesverbali, z. G ka marrë në dorëzim edhe procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt ""Shërbim Interneti 2019", procedurë të cilën nuk ja vuri në dispozicion grupit të auditimit, me pretendimin se nuk ishte dorëzuar nga ish-punonjësit.
*Për sa më sipër, në kushtet kur z. B.G., në mënyrë të vazhdueshme ka penguar punën e grupit të auditimit, **duke nxjerrë pretendime të rreme**, përgjegjësia për mungesën e dosjes së prokurimit, nuk është më e ish-Njësisë së Prokurimit, por e z. B.G..*

Pretendimi juaj *mbi shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, nuk qëndron, sipas argumenteve të sqaruara në përgjigjet e observacioneve të Akt-Konstatimeve.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën datë 12.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 811/6, datë 13.01.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga ish Drejtori i DRAP Durrës V.L., sqarojmë si më poshtë vijon:
Pretendimet e juaja *mbi shpenzimet e transportit nuk qëndrojnë, sipas argumenteve të sqaruara në përgjigjet e observacioneve të Akt-Konstatimeve përkatëse.*
Pretendimet e juaja *mbi procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt "Trajnimi i mësuesve", nuk qëndrojnë, sipas argumenteve të sqaruara në përgjigjet e observacioneve të Akt-Konstatimeve përkatëse.*

1. Titulli i gjetjes:	Mbajtja e regjistrit të aktiveve të paplotë
Situata:	Në 6 raste (për DRAP Durrës, ZVAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë, ZVAP Dibër dhe ZVAP Bulqizë), konstatohet se regjistri i aktiveve nuk mbahet i plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme sipas formatit të Udhëzimit nr. 30, të tilla si, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e plotë e informacion kontabël mbi aktivet e institucionit
Shkaku:	Krijimi i institucioneve të reja me riorganizimin sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019
Rëndësia:	E mesëm
Rekomandime:	Drejtori i DRAP Durrës dhe Drejtorët ZVAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë, ZVAP Dibër dhe ZVAP Bulqizë, të marrin masat për përditësimin e regjistrit të aktiveve të institucioneve përkatëse, me të gjitha të dhënat e nevojshme sipas formatit të Udhëzimit nr. 30.

2. Titulli i gjetjes:	Mungesa e regjistrit të aktiveve
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për ZVAP Shijak, konstatohet se: -ZVAP Shijak nuk ka një regjistër të aktiveve që ka në zotërim dhe/ose përdorim. -ZVAP Shijak nuk ka kryer inventarizimin e aktiveve për vitin ushtrimor 2019.
Kriteri:	Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e plotë e pozicion financiar
Shkaku:	Krijimi i institucioneve të reja me riorganizimin sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtori i ZVAP Shijak, të marri masat për plotësimin dhe përditësimin e

	regjistrit të aktiveve të ZVAP Shijak, me të gjitha të dhënat e nevojshme sipas formatit të Udhëzimit nr. 30.

3. Titulli i gjetjes:	Mos dorëzim i aktiveve në ngarkim pas lënies së detyrës
Situata:	Në ZVAP Bulqizë, në përfundim të procesit të inventarizimit, janë konstatuar mungesa në inventar, mungesa të cilat janë pajisje kompjuterike të ish-punonjësve të cilët janë larguar nga detyra, por nuk kanë dorëzuar këto pajisje në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës. Vlera totale e pajisjeve të padorëzuara nga ish punonjësit, në shumën **247,178 lekë**, përbën **dëm ekonomik** për llogari të buxhetit të shtetit. Nga ana e komisionit të inventarizimit dhe Drejtorit të ZVAP Bulqizë, edhe pse janë konstatuar këto mangësi, nuk janë marrë masa për zhdëmtimin dhe ngarkimin me përgjegjësinë materiale të personave që i kanë patur në ngarkim këto pajisje.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 13, 89 dhe 93.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik në vlerën 247,178 lekë.
Shkaku:	Mos dorëzim i detyrës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Drejtori i ZVAP Bulqizë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 247,178 lekë, përkatësisht nga H.Xh. në vlerën 61,000 lekë, A.H. në vlerën 35,726 lekë, B.M. në vlerën 114,726 lekë dhe K.D. në vlerën 35,726 lekë, për pajisjet në ngarkim të cilat nuk i kanë dorëzuar pas ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës.

4. Titulli i gjetjes:	Mos kryerje e procesit të inventarizimit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave Materiale e monetare, në 2 rastet e mëposhtme u konstatua se nuk është kryer procesi i inventarizimit: -ZVAP Dibër, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për viti 2019. Nuk ka asnjë urdhër të drejtorit të këtij institucioni për kryerjen e procesit të inventarizimit. -Në ZVAP Tiranë, komisioni i inventarizimit i ngritur me anë të Urdhrit nr. 36, nr. 5595 prot., datë 23.12.2019, të Drejtorit të ZVAP Tiranë, nuk ka prodhuar asnjë relacion mbi rezultatet e procesit të inventarizimit, si dhe nuk ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve, për arsye se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se komisioni ka firmosur mbi fletat e aktiveve sipas gjendjes kontabile, ndërsa pjesa sipas të dhënave të inventarit (sasia, mungesat, teprica, nxjerrje jashtë përdorimi, etj.), është e paplotësuar nga komisioni.
Kriteri:	Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 85-86.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e plotë e pozicion financiar
Shkaku:	Mos kryerje e detyrave nga përfaqësuesit e ZVAP Tiranë dhe Dibër
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Nga Drejtori i ZVAP Tiranë dhe ZVAP Dibër, të merren masa që ti kushtohet një vëmendje e posaçme procesit të inventarizimit nga

	komisionet përkatëse, me qëllim paraqitjen e saktë të gjendjes së inventarit në pasqyrat financiare të institucionit.

5. Titulli i gjetjes:	Kalim kapital aktivi pa miratimet përkatëse
Situata:	Me anë të Urdhrit nr. 37, nr. 5656 prot., datë 24.12.2019, Drejtori i ZVAP Tiranë ka urdhëruar kalimin kapital të automjetit me vlerë 920,000 lekë, për llogari të shkollës së mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë, në tejkalim të kompetencave të Drejtorit të ZVAT Tiranë, për arsye se përgjegjësinë për nxjerrjen jashtë përdorimi dhe tjetërsimin e aktiveve, nuk e ka Drejtori i ZVAT Tiranë, por Ministri i MASR.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 22 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 5, 108, 109 dhe 111.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e saktë e pozicioni financiar
Shkaku:	Rekomandimet e Auditit të Brendshëm të MASR
Rëndësia:	I ulët
Rekomandime:	Nga drejtori i ZVAP Tiranë, të merren masa për marrjen e miratimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për kalimin kapital të automjetit të institucionit për llogari të shkollës së mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë.

6. Titulli i gjetjes:	Nxjerrja jashtë përdorimi i materialeve
Situata:	Në përfundim të procesit të inventarizimit të kryer në vitit 2019, komisionet përkatëse kanë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi materiale në vlerën 2,423,239 lekë. Megjithëse janë konstatuar këto mangësi në procesin e inventarizimit, nga strukturat drejtuese të ZVAP Durrës, nuk konstatohet të jenë marrë masa për rregullimin e gjendjes së krijuar, si nxjerrja e tyre jashtë përdorimi të tyre dhe pasqyrimi i këtyre veprimeve në pasqyrat financiare të viti 2019.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e saktë e pozicionit financiar të institucionit
Shkaku:	Mos kryerje e detyrës nga përfaqësuesit e institucionit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtori dhe përgjegjësi i sektorit të shërbimeve të ZVAP Durrës, të marrin masat për vlerësimin e materialeve me vlerë 2,423,239 lekë, sipas rekomandimeve të komisionit të inventarizimit dhe pasqyrimin e këtyre veprimeve në Pasqyrat Financiare të vitit 2020.

7. Titulli i gjetjes:	Realizim i shërbimeve në shmangie të ligjit për prokurimin publik (LPP)
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, në lidhje me shpenzimet e transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar të marra nën auditim, kanë operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit. Përjashtim nga kjo mënyrë, bën vetëm ZVAP Bulqizë, edhe kjo vetëm për vitin 2019, për të cilin ka realizuar procedurë prokurimi, ndërsa për vitin 2020, nuk ka realizuar një të tillë.

Në total, nga ZVAP e marra nën auditim, janë kryer pagesa në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4 dhe VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, në vlerën 157,423,324 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Institucioni	Viti 2019	Viti 2020	Shuma
1	ZVAP Tiranë	17,259,435	13,357,338	**30,616,773**
2	ZVAP Durrës	29,493,852	13,764,611	**43,258,463**
3	ZVAP Shijak	2,296,731	5,262,631	**7,559,362**
4	ZVAP Kavajë	9,915,366	2,898,507	**12,813,873**
5	ZVAP Mat	24,261,874	5,622,961	**29,884,835**
6	ZVAP Dibër	15,775,961	9,811,430	**25,587,391**
7	ZVAP Bulqizë	5,325,175	2,377,452	**7,702,627**
Shuma		**104,328,394**	**53,094,930**	**157,423,324**

Pagesa e drejtpërdrejtë në kundërshtim me kërkesat ligjore e këtyre shpenzimeve, ka shkaktuar **përdorim pa eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet** të fondeve publike me vlerë **157,423,324 lekë**.

Për vitin 2019, nisur nga fakti se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ish-Drejtorive Arsimore Rajonale) përkatëse.

Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës thekson se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).

Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës V.L., nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësinë e saj, i informon se: "...*Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*

Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve.

Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare***.". Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte 3 muaj kohë të realizonte këto procedura, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu LPP.

Kriteri:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 3, pika 24, neni 4 dhe VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin

	e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Përdorim pa eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve publike me vlerë 157,423,324 lekë
Shkaku:	Krijimi i institucioneve të reja me riorganizimin sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019 dhe mos-qartësimi i kompetencave ndërmjet DRAP Durrës dhe ZVAP në varësi.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga Drejtori i DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP nën varësi, të marrin masat e menjëhershme për fillimin e procedurave të prokurimit me objekt "Transport mësuesish dhe nxënësish për vitin 2021", me qëllim parandalimin e kryerjes së këtyre shpenzimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë.

8. Titulli i gjetjes:	Shkelje e dispozitave ligjore në zhvillimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit publik
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara nga DRAP Durrës dhe ZVAP të përfshira në auditim, u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave, kryesisht si më poshtë vijon: -Dosjet e procedurave të zhvilluara nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. -Nuk janë kryer trajnime të stafit që bëjnë pjesë e komisioneve të caktuara në procedurat e prokurimeve publike, çka ka rezultuar në mos kuptimin e plotë të legjislacionit të prokurimit publik nga këta punonjës. -Në 3 raste (Dibër, Mat dhe Bulqizë), nëpunësi zbatues është pjesë e procedurave të prokurimit si anëtar i NjP dhe/ose anëtar i KVO (në ZVAP Bulqizë ishte në të dyja), në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3. -Në 3 raste, për procedurat e zhvilluara me objekt "Shërbim Interneti 2019" në ZVAP Durrës, "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve" në ZVAP Mat dhe "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve" në ZVAP Dibër, në institucion nuk gjendjes dosja përkatëse e procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 12, pika 2, neni 22, pika 4, si dhe me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. -Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt "Shërbim Interneti 2019" në ZVAP Durrës, konstatohet se Njoftimi i Lidhjes së Kontratës është dërguar më datë 20.03.2019 ose 13 ditë para nënshkrimit të kontratës, ndërsa Konfirmimi i Lidhjes së Kontratës, është dërguar më datë 28.03.2019 ose 5 ditë para nënshkrimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 6, pika 2. DRAP Durrës, për vitin 2019, sipas Regjistrit të Realizimit të

	Prokurimeve, ka zhvilluar një procedurë "Kërkesë për propozim" me vlerë 7,000,000 lekë (audituar) dhe 5 procedura me "Blerje me vlerë të vogël", ndërsa për vitin 2020, ka realizuar 3 procedura me "Blerje me vlerë të vogël". Në lidhje me këtë pikë, është audituar transaksioni për kryerjen e pagesës me anë të Urdhër Shpenzimit nr. 26, datë 26.05.2020, me vlerë 4,164,736 lekë, procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt "*Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12*", me fond limit 7,000,000 lekë, nga ku është konstatuar si vijon: -Autoriteti Kontraktor (AK), ka vazhduar procedurën me të njëjtin fond limit (7,000,000 lekë), edhe pse MASR i ka pakësuar fondet me 3,000,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70 dhe Udhëzimin nr. 9.1, datë 20.03.2018 "për procedurat e zbatimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të Qeverisë", Kreu III, pika 15/b. -Përllogaritja e fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 23, pikat 1 dhe 4 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 1 dhe neni 59. -Zyrtarët e emëruar për këtë procedurë prokurimi me anë të Urdhrave të titullarit të AK, janë të ndryshëm me ato të pasqyruar në sistemin elektronik të APP për këtë procedurë prokurimi. -Hartimi, ndryshimi dhe miratimi i Dokumenteve të Tenderit (DT), është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pikat 1 dhe 2, neni 39, pika 4, neni 56, neni 61, pika 2. -Është kryer pezullimi i procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 11, datë 22.05.2015 "Për procesin e pezullimit, modifikimit të dokumentave standarde të tenderit dhe shtyrjen e afatit të proçedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik". -Një nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), është njëkohësisht edhe anëtar i NjP, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58. -Nga shqyrtimi i sistemit elektronik për këtë procedurë, konstatohet se afati i fundit i pranimit të ofertave është data 11.11.2019, e jo data 01.11.2019, e vendosur me anë të Urdhrit të titullarit të AK nr. 714, datë 30.10.2019 "Urdhër për heqje pezullimi procedure prokurimi". Hapja e ofertave 10 ditë pas datës së përcaktuar nga titullari i AK dhe pranimi i tyre nga KVO, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 63, pika 1. -Procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 5, e për pasojë AK duhej të skualifikonte OE A. SHPK e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP.
-Formulari i Njoftimit të Fituesit është dërguar 1 muaj pas përfundimit të procesit të vlerësimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 58, pika 2, ku përcaktohet se dërgohet ditën e nesërme të punës.
-OE A. SHPK, nuk i ka realizuar shërbimet brenda afateve të përcaktuara në kontratën nr. 01/18, datë 24.12.209, të ndryshuar me Amendamentin e datës 24.12.2019, e për pasojë nga AK duhej të përllogariteshin dëme të likuidueshme për kryerjen e vonuar të shërbimeve, në vlerën **32,738 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për llogari të Buxhetit të Shtetit.
-Me anë të Amendamentit të Kontratës nr. 01/18, datë 13.02.2020, ka vendosur shtyrjen e afatit të realizimit të kontratës deri më datë 31.12.2020. Në lidhje me këtë shtyrje, konstatohet se:
Me anë të këtij amendamenti, titullari i AK ka shtyrë afatin e realizimit të kontratës fillestare me 10.5 muaj të tjerë, në kushtet kur sipas parashikimeve të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë, kohëzgjatja e saj ishte parashikuar vetëm 1 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

-Në kushtet kur ka mbetur pa realizuar vetëm 49% të kontratës.

-Në kushtet kur kontrata fillestare është nënshkruar pa fonde në dispozicion, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70 dhe Udhëzimin nr. 9.1, datë 20.03.2018 "Për procedurat e zbatimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të Qeverisë", Kreu III, pika 15/b.

-Janë shmangur procedurat e LPP, duke mos zhvilluar procedurë të re, duke shkelur kështu parimet e transparencës në procedurat e prokurimit dhe barazinë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, si dhe duke shmangur ligjin e prokurimit publik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 2, pikat b dhe c dhe neni 4.

-Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: "Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë", me fond limit 2,636,566 lekë, u konstatua se nga përllogaritja e fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2, Buxhetit të Shtetit i është shkaktuar **efekt financiar negativ në vlerën 316,388 lekë**, për arsye se komisioni i përllogaritjes së fondit limit nuk ka argumentuar arsyen e përzgjedhjes së metodës së studimit të tregut, në hartimin e fondit limit, nuk ka argumentuar përzgjedhjen e OE të marrë në studim tregu, në kushtet kur sipas verifikimeve të kryera në QKB, vetëm OE PF E.D. ka për objekt aktiviteti kryerjen e shërbimeve të modelingut, ndërsa OE S.O. SHPK dhe I.C. SHPK, nuk kanë për objekt aktiviteti kryerjen e shërbimeve të modelingut, si dhe nuk ka argumentuar përse nuk ka përzgjedhur si metodë të përllogaritjes së fondit limit, vlerën e kontratave të mëparshme, në kushtet kur gjatë vitit 2018, ky shërbim është kryer me çmimin 267

	lekë/ora. -Konstatohet se 2 nga modelet e paraqitura nga OE PF E.D. gjatë zbatimit të kontratës, ndryshojnë nga lista e paraqitur gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 60, pikat 1 dhe 2. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion këtë procedurën e prokurimit "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve", me fond limit 13,658,300 lekë, zhvilluar nga ZVAP Mat, konstatohet se: -Në dosjen e administruar nga ZVAP Mat për këtë procedurë, gjenden vetëm Urdhri i Prokurimit, Urdhri për ngritjen e KVO dhe Formulari i Njoftimit të Anulimit datë 16.05.2019. Përveç, këtyre dokumenteve, ZVAP Mat nuk dispononte asnjë dokumentacion tjetër për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 22, pika 4, neni 12 pika 2, Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. -Nga auditimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) të APP, konstatohet procedura është hedhur në sistem, por pas procesit të hapjes së ofertave, nuk është zhvilluar asnjë proces në SPE, çka ka sjellë që kjo procedurë, edhe pse është zhvilluar dhe anuluar (16.05.2019), nuk rezulton si e tillë në SPE (është akoma në procesin e vlerësimit të ofertave), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 72. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion këtë procedurat (2 procedura) e prokurimit "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve", me fond limit 11,876,982 lekë, zhvilluar nga ZVAP Dibër, konstatohet se: -Asnjëra nga këto procedura nuk është zhvilluar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të APP, por në mënyrë shkresore, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 72. -Nuk është hartuar Urdhri i Prokurimit për këtë procedurë, ku të jetë e përcaktuar objekti i prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe emrat e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 60. -Përveç dokumenteve të sipërcituara, ZVAP Dibër nuk dispononte asnjë dokumentacion tjetër për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 12, pika 2, neni 22, pika 4, si dhe me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. -Anëtarët e KVO Sh.C. dhe N.N., janë në të njëjtën kohë edhe anëtarë të komisionit për përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58. Nga shqyrtimi i procedurës zhvilluar me objekt "Transport mesues dhe

	nxenes ne Institucionet Arsimore Publike ne varesi te Z.A Bulqize", me fond limit 4,566,893 lekë, konstatohet se: -Urdhri i prokurimit nuk përmban emrat e anëtarëve të NjP. -2 nga anëtarët e NjP janë njëkohësisht edhe anëtarë të KVO. -Vendosja e z. P.L. si anëtar i NjP dhe KVO, i cili është njëkohësisht **Nëpunës Zbatues** i ZVAP Bulqizë, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e. -Nuk është kryer argumentimi i OE të ftuar për këtë procedurë prokurimi. -Nuk konstatohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit për Anëtarët e NjP dhe KVO. -Nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kërkesave për kualifikim. -Në 4 raste, janë vendosur kërkesa për kualifikim të paqarta dhe që nuk përdoren për procedurat e prokurimit të shërbimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. -Në lidhje me procesin e vlerësimit konstatohet se kualifikimi i OE A. SHPK, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53, pika 3, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; Udhëzimi i APP nr. 11, datë 22.05.2015 "Për procesin e pezullimit, modifikimit të dokumentave standarde të tenderit dhe shtyrjen e afatit të proçedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik". Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat"; "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
Ndikimi/Efekti:	Zhvillim i procedurave të prokurimit publik në kundërshtim me LPP; Efekt financiar negativ në vlerën 316,388 lekë; Efekt financiar negativ në vlerën 32,738 lekë.
Shkaku:	Krijimi i institucioneve të reja me riorganizimin sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019; Mos kuptimi i ligjit për prokurimin publik; Staf i kufizuar;
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 1:	Nga Drejtori i DRAP Durrës, si dhe Drejtorët e ZVAP Mat, Dibër dhe Durrës, të merren masat e menjëhershme për gjetjen, inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga këto njësi, për të cilat nga auditimi rezultuan se nuk disponoheshin nga këto institucione.
Rekomandimi 2:	Nga Drejtori i DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP nën varësi, të merren masa për kryerjen e trajnimeve të nevojshme për punonjësit që janë pjesë të komisioneve të procedurave të prokurimit publik, me qëllim sigurimin e një procesi sa më transparent në përmbushje të qëllimit të LPP

Rekomandimi 3:	Drejtori i ZVAP Tiranë, të shqyrtojë vlerën 316,388 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në përllogaritjen e vlerës së kontratës të procedurës të prokurimit me objekt "Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë", si dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit.
Rekomandimi 4:	Drejtori i DRAP Durrës, të shqyrtojë vlerën **32,738 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në zbatimin e kontratës me objekt "*Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12*", si dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit.

III.2.4. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:
Në zbatim të të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. 811/1 prot., datë 01.09.2020 "*Auditim Financiar dhe Përputhshmërie në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës*", i ndryshuar me nr. 811/2 prot., datë 21.09.2020 dhe nr. 811/3 prot.,datë 13.10.2020, grupi i auditimit, kreu auditim për pikën 4 "*Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit*", në Drejtorinë e Përgjiythshme të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Durrës, Shijak, Kavajë, Mat, Dibër dhe Bulqizë.
Auditimi i llogarive vjetore të DRAP Durrës dhe 7 ZVAP në varësi të saj, paraqitet më hollësisht si vijon:

III.2.4.2.1. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës

Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga z. T.S. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe miratuar nga znj. V.L. Drejtori i DRAP Durrës dhe me anë të shkresës nr. 511/1, datë 09.03.2020, i janë dërguar Degës së Thesarit Durrës.
Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);
3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të DRAP Durrës, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 36,768,804 lekë dhe që përbëhen nga 35,963,234 lekë grant nga Buxheti për NjQP (qendrore) dhe 805,571 lekë Financim i pritshëm nga buxheti.

Shpenzimet janë në vlerën 36,165,771 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 5,375,256 lekë,
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 899,006 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 2,192,719 lekë,
- Transferime korrente në vlerën 28,301,824 lekë,
- Ndryshim i gjendjes së inventarit në vlerën 603,034 lekë.

Totali i aktiveve në vlerën 1,730,189 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
31	Materiale	575,194
32	Inventar i imët	27,840
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	805,571
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	287,035
215	Mjete transporti	34,549
Shuma		**1,730,189**

Në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?*", nga DRAP Durrës nuk i është përgjigjur. Nisur nga fakti që godina e zyrave të këtij institucioni, është në pronësi të Bashkisë Durrës dhe e përdor DRAP Durrës, ky institucion duhej ta kishte paraqitur këtë ndërtesë në zërin nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim". Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.

Si dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 1,730,189 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
42	Detyrime ndaj personelit	568,900
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	44,076
435	Sigurime shoqërore	192,594
101	Teprica (Fondi i Akumuluar/Defiçiti i Akumuluar)	321,584
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	603,034
Shuma		**1,730,189**

Në lidhje me hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, konstatohet se:
Në zbatim të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me anë të VKM nr. 99, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", krijohet Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP). Në zbatim të këtij Vendimi, me anë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019, pika 3, është krijuar Drejtoria e Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës), së bashku me ato të Fierit, Lezhës dhe Korçës.
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me anë të Urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019 "Për për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar", pika 2, ka vendosur që nën varësinë dhe përgjegjësinë e DRAP Durrës, janë edhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), si më poshtë vijon:

1. ZVAP Bulqizë,
2. ZVAP Dibër,
3. ZVAP Durrës,
4. ZVAP Kamëz,
5. ZVAP Kavajë,
6. ZVAP Klos,
7. ZVAP Krujë,
8. ZVAP Mat,
9. ZVAP Rrogozhinë,
10. ZVAP Shijak,
11. ZVAP Tiranë dhe
12. ZVAP Vorë.

Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 120, përcakton që: "*Ministritë dhe institucionet e tjera qendore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor të mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prilll të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*".
DRAP Durrës, edhe pse ka nën varësinë e tij 12 ZVAP e mësipërme, ka hartuar pasqyra financiare **vetëm** për këtë institucionin, pa përfshirë në to informacionin financiar të 12 njësive të varësisë.
Mos hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për këtë institucion, ka ndikuar në mos-paraqitjen **me vërtetësi dhe besueshmëri** të pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimeve në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të të DRAP Durrës, duke mos arritur qëllimin për të cilin këto pasqyra janë hartuar.
Në rast të paraqitjes së Pasqyrave Financiare të Konsoliduara nga DRAP Durrës, totali i aktivit të këtij institucioni, do paraqitej sipas tabelës së mëposhtme:

Nr. Rreshti	Referenca e Llogarive	E M Ë R T I M I	Aktivet sipas DRAP Durrës	Aktivet[49] pas konsolidimit
1	**A**	**A K T I V E T**	**1,730,189**	**852,853,815**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**1,408,605**	**816,828,840**
3		**1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	**0**	**9,687,170**
4	531	Mjete monetare ne Arke	0	0

[49] Vlerat e kësaj kolone, përbëjnë shumën e zërave sipas llogarive përkatëse në Pasqyrat përkatëse Financare, për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP nën varësinë e saj.

5	512,56	Mjete monetare ne Banke	0	8,403,460
6	520	Disponibilitete ne Thesar	0	1,283,710
7	50	Letra me vlere	0	0
8	532	Vlera te tjera	0	0
9	54	Akreditiva dhe paradhenie	0	0
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)	0	0
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**603,034**	**8,549,224**
12	31	Materiale	575,194	7,256,739
13	32	Inventar I imet	27,840	1,281,121
14	33	Prodhim nre proces	0	0
15	34	Produkte	0	0
16	35	Mallra	0	11,364
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri	0	0
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	0	0
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	0	0
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)	0	0
21		**3.Llogari te Arketushme**	**805,571**	**796,437,038**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme	0	0
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	0	3,225,429
24	431	Tatim e Taksa	0	0
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal	0	0
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti	0	0
27	435	Sigurime Shoqërore	0	0
28	436	Sigurime Shëndetsore	0	0
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore	0	0
30	44	Institucione te tjera publike	0	327,194
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere	0	0
32	468	Debitore te ndryshem	0	64,506,632
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	805,571	713,063,907
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	0	0
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim (-)	0	0
		Të tjera	0	15,313,876
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**2,155,408**
37	409	Parapagime	0	0
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin	0	0
39	477	Diferenca konvertimi aktive	0	0
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime	0	0
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	0	2,155,408
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**321,584**	**36,024,975**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**2,354,091**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	0	0
45	202	Studime dhe kerkime	0	2,354,091
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	0	0
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**321,584**	**32,016,436**
48	210	Toka, T,roje, Terene	0	0
49	211	Pyje, Plantacione	0	0
50	212	Ndertesa e Konstruksione	0	26,451,974
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	0
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	287,035	1,414,836
53	215	Mjete Transporti	34,549	34,549
54	216	Rezerva Shteterore	0	0

55	217	Kafshe pune e prodhimi	0	1,873,449
56	218	Inventar ekonomik	0	2,241,628
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	0	0
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	0	0
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie	0	0
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	0	0
62		**4.Investime**	**0**	**1,654,448**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	0	1,654,448

Siç dallohet edhe nga tabela e mësipërme, DRAP Durrës **ka paraqitur vetëm 0.2% të aktiveve** që duhej të paraqiste (1,730,189 lekë nga 852,853,815 lekë që duhej të ishte), nga mos hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenin 11 dhe 12, të cilët përcaktojnë se:

Neni 11

1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike.

2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave ***financiare të konsoliduara****.*

Neni 12

1. Grupet ekonomike, subjekt i këtij ligji, hartojnë pasqyra financiare të konsoliduara.

2. Grupet e vogla përjashtohen nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare të konsoliduara dhe raport drejtimi të konsoliduar, përveç rastit kur ndonjë prej njësive të grupit është njësi ekonomike me interes publik.

3. Njësia ekonomike mëmë dhe të gjitha njësitë e kontrolluara prej saj duhen përfshirë në konsolidim, pavarësisht se ku operojnë dhe ku i kanë selitë njësitë e kontrolluara.

-Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 101/a, paragrafi 2, si dhe pika 120, të cilat përcaktojnë se:

101. Në ***pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara*** *duhet të grupohet informacioni (duke bërë eleminimet dhe mënjanuar dublimet) në nivelet e mëposhtme:*

a) Për ministritë dhe njësitë apo institucionet e tjera qendrore, duke përfshirë:

- *Në nivel qendror, për të gjitha njësitë qendrore të të gjitha ministrive apo institucioneve të tjera qendrore;*

120. Ministritë dhe ***institucionet e tjera qendore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar*** *të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor të mbyllur,* ***për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre****, brenda muajit Prilll të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;*

Për sa më sipër mban përgjegjësi T.S. në cilësinë e hartuesit dhe V.L. në cilësinë e miratuesit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2019.

ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetar.

Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	Vlera

Të tjera, arkëtuar (+)	45,930,361
Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor	35,963,234
Transferime në buxhet të fondeve të papërdorura	9,967,127

III.2.4.2.2. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë

Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga z. K.F., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, pranë ZVAP Tiranë.

PF janë dërguar pranë Degës së Thesarit Tiranë, me anë të shkresës së Drejtorit të ZVAP Tiranë E.A. nr. 1940/1, datë 04.04.2020.

Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);
3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare, në përgjithësi janë hartuar sipas përmbajtjes dhe përbërjes së miratuar me anë të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Nga auditimi i PF, konstatua se:

Në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?*", nga ZVAP Tiranë i janë përgjigjur me **JO**. ZVAP Tiranë nuk i është përgjigjur në mënyrë të drejtë kësaj pyetje, për arsye se godina e zyrave të këtij institucioni, është në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe e përdor ZVAP Tiranë. Zërin nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim", në pasqyrat financiare është 0 (zero), ZVAP Tiranë, nuk ka paraqitur vlerën e godinës së zyrave të saj, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të

standardeve kontabël të aplikueshme.

Si dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi hartuesit dhe miratuesit e pasqyrave financiare (K.F. dhe E.A.).

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të ZVAP Tiranë, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 3,682,760,683 lekë dhe që përbëhen nga 3,342,062,576 lekë grant nga Buxheti për NjQP (qendrore) dhe 340,698,107 lekë financim i pritshëm nga Buxheti.

Shpenzimet janë në vlerën 3,682,760,683 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 3,047,494,038 lekë,
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 507,969,931 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 28,114,033 lekë,
- Transferime korrente në vlerën 99,182,681 lekë.

Totali i aktiveve në vlerën 349,139,030 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
520	Disponibilitete në Thesar	510,158
31	Materiale	4,645,572
44	Llogari të arkëtueshme nga institucione të tjera publike	327,194
468	Debitorë të ndryshëm	5,051,515
4342	Operacione me shtetin (të drejta)	335,319,398
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	1,411,744
218	Inventar ekonomik	1,873,449
Shuma		**349,139,030**

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 349,139,030 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
42	Detyrime ndaj personelit	234,292,561
431	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	19,191,159
435	Sigurime shoqërore	71,863,103
436	Sigurime shëndetësore	9,972,575
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike	327,194
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	510,158
4341	Operacione me shtetin	5,051,515

101	Teprica fondi i akumuluar /deficiti i akumuluar	7,930,765
Shuma		**349,139,030**

Në lidhje me zërat e mësipërm:
-Për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 510,158 lekë, nga ZVAP Tiranë, nuk disponohej dokumentacion dhe informacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere, në Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7 "Dokumenti kontabël", i cili përcakton se:

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

-Për llogarinë "202 Studime dhe kërkime", nën kategorinë e "Aktive afatgjata jomateriale", vlera e vitit paraardhës është 3,467,346 lekë, ndërsa vlera e vitit ushtrimor 2019 është 0 (zero) lekë. Nga auditimi i pasqyrës "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a)" dhe "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b)", pjesë e pasqyrav financiare, për këtë llogari nuk ka pakësime në vlerë. Për pasojë nuk konstatohet arsyeja e mos paraqitjes së vlerës 3,467,346 lekë për llogarinë "202 Studime dhe kërkime".
-ZVAP Tiranë nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, detyrime në vlerën 3,214,084 lekë, për vendimet gjyqësore që i kanë mbërritur në institucion brenda vitit 2019, por që janë paguar përgjatë vitit 2020
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.

Si dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi hartuesit dhe miratuesit e pasqyrave financiare: K.F. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve dhe E.A. drejtor i ZVAP Tiranë.

Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	Vlera
Akordim fonde buxhetore për shpenzime korrente	3,695,273,409
Të hyra nga mjetet në ruajtje	510,158
Pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara	-340,698,108
Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor	-3,355,085,459
Derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet	-12,512,726
Shuma	**-12,512,726**

III.2.4.2.3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës

Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga z. B.G. me detyrë Përgjegjës e Sektorit të Shërbimeve dhe miratuar nga znj. J.M. Drejtori i ZVAP Durrës.
Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);
3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare, në përgjithësi janë hartuar sipas përmbajtjes dhe përbërjes së miratuar me anë të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të ZVAP Durrës, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 1,483,187,725 lekë dhe që përbëhen nga 1,370,001,785 lekë grant nga Buxheti për NjQP (qendrore) dhe 113,185,940 lekë Financim i pritshëm nga buxheti.

Shpenzimet janë në vlerën 1,483,791,542 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 1,202,185,019 lekë,
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 201,471,858 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 47,153,118 lekë,
- Transferime korrente në vlerën 32,377,730 lekë,
- Ndryshim i gjendjes së inventarit në vlerën 603,817 lekë.

Totali i aktiveve në vlerën 125,407,866 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
520	Disponibilitete në Thesar	303,215
31	Materiale	159,732
32	Inventar i imët	164,652
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	113,185,940
212	Ndërtesa e konstruksione	11,056,960
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	8,560

218	Inventar ekonomik	528,807
Shuma		**125,407,866**

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 125,407,866 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
42	Detyrime ndaj personelit	78,964,625
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	6,381,902
435	Sigurime shoqërore	24,446,860
436	Sigurime shëndetësore	3,392,553
437	Organizma të tjerë shtetërorë	51,095
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	252,120
101	Teprica (Fondi i Akumuluar/Defiçiti i Akumuluar)	12,522,528
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	-603,817
Shuma		**125,407,866**

Në lidhje me zërat e mësipërm:
-Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 11,056,960 lekë (8.8% të aktivit), që përfaqëson ndërtesën e institucionit të ZVAP Durrës, me shkresën nr. 1393, datë 20.08.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është kërkuar informacion mbi inventarin e pronave që zotëron ZVAP Durrës, për arsye se nuk disponojnë informacion mbi to. Me shkresën nr. 9393/1, datë 02.09.2020, protokolluar në ZVAP Durrës me nr. 1393/1, datë 14.09.2020, A.Shtetërore e Kadastrës kthen përgjigje ku citon se ndërtesa e ZVAP Durrës është në pronësi të Bashkisë Durrës. ZVAP Durrës, edhe pse nuk ka patur dokumentacion mbi pronësinë e kësaj ndërtese, sërish e ka paraqitur në pasqyrat financiare si ndërtesë të sajën.
-Për llogarinë "437 Organizma të tjerë shtetërorë" në vlerën 51,095 lekë, ZVAP Durrës nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere.
-Për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 252,120 lekë, ZVAP Durrës nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere.
Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7 "Dokumenti kontabël", i cili përcakton se:

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

Dhe neni 15 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", i cili përcakton se:

1. Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.
2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare.

Për sa më sipër mban përgjegjësi B.G. në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare dhe J.M. në cilësinë e miratuesit të PF.

ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetar.
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	Vlera
Të hyra, Sponsorizime nga të tretë	51,095
Pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara	124,139,050
Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor	1,370,001,785
Pagesat për mjetet në ruajtje	157,475
Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale	8,918,640
Transferime në buxhet të fondeve të papërdorura	24,466,395

III.2.4.2.4. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shijak
Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga znj. M.D., me detyrë Specialiste Finance, pranë ZVAP Shijak.
PF janë dërguar pranë Ministrisë së Arsimit, me anë të shkresës nr. 285, datë 16.04.2020.
Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);
3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare, në përgjithësi janë hartuar sipas përmbajtjes dhe përbërjes së miratuar me anë të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Nga auditimi i PF, konstatua se:
-Në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar*

në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?", nga ZVAP Shijak i janë përgjigjur me **JO**. ZVAP Shijak nuk i është përgjigjur në mënyrë të drejtë kësaj pyetje, për arsye se godina e zyrave të këtij institucioni, është në pronësi të Bashkisë Shijak dhe e përdor ZVAP Shijak. Zërin nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim", në pasqyrat financiare është 0 (zero), ZVAP Shijak, nuk ka paraqitur vlerën e godinës së zyrave të saj.
-Në zërin e aktiveve, ZVAP Shijak ka paraqitur vetëm nënzërin "Inventar i imët" me vlerë 900 lekë. ZVAP Shijak nuk ka paraqitur asnjë të dhënë mbi inventarin që ky institucion ka në përdorim (kompjutera, printera, etj).
-ZVAP Shijak ka paraqitur në PF e vitit 2019, zërin "3. Llogari të arkëtueshme" me vlerë 15,313,876 lekë, po pa e detajuar se nga çfarë zërash përbëhet ky llogari.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.

Nenin 7 "Dokumenti kontabël", i cili përcakton se:

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

Si dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Për sa më sipër mban përgjegjësi M.D. me detyrë specialiste e financës dhe B.K. me detyrë drejtor i ZVAP Shijak.

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të ZVAP Shijak, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 140,324,227 lekë dhe që përbëhen nga 124,40,990 lekë grant nga Buxheti për NjQP (qendrore) dhe 15,920,237 lekë Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit.

Shpenzimet janë në vlerën 140,324,227 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 107,249,538 lekë,
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 17,839,336 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 2,350,002 lekë,
- Transferime korrente në vlerën 12,884,451 lekë.

Totali i aktiveve në vlerën 23,718,236 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
512,56	Disponibilitete në Thesar	8,403,460
32	Inventar i imët	900
	Llogari të arkëtueshme	15,313,876
Shuma		**23,718,236**

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 23,718,236 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
42	Detyrime ndaj personelit	10,556,330
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	893,213
435	Sigurime shoqërore	3,393,422
436	Sigurime shëndetësore	470,911
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	8,403,460
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	900
Shuma		**23,718,236**

Në lidhje me zërat e mësipërm:
-Për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 8,403,460 lekë, nga ZVAP Shijak, nuk disponohej dokumentacion dhe informacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni Dokumenti kontabël", i cili përcakton se:

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

Për sa më sipër mban përgjegjësi M.D. me detyrë specialiste e financës dhe B.K. me detyrë drejtor i ZVAP Shijak.

ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetar.
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	**Vlera**
Akordim fonde buxhetore për shpenzime korrente	3,695,273,409
Të hyra nga mjetet në ruajtje	510,158
Pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara	340,698,108
Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor	3,355,085,459
Derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet	12,512,726
Shuma	**-12,512,726**

III.2.4.2.5. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë

Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga znj. S.Gj., me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës, pranë ZVAP Kavajë.
PF janë dërguar pranë Ministrisë së Arsimit, me anë të shkresës nr. 471/1, datë 10.03.2020.
Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);

3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare, në përgjithësi janë hartuar sipas përmbajtjes dhe përbërjes së miratuar me anë të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të ZVAP Kavajë, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 479,048,036 lekë dhe që përbëhen nga 443,796,355 lekë grant nga Buxheti për NjQP (qendrore) dhe 35,251,681 lekë Financim i pritshëm nga buxheti.

Shpenzimet janë në vlerën 479,048,036 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 393,466,169 lekë,
- Paga, personel i përkohshëm në vlerën 205,200 lekë
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 63,290,340 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 13,097,823 lekë,
- Transferime korrente në vlerën 8,533,264 lekë,
- Ndryshim i gjendjes së inventarit në vlerën 455,240 lekë.

Totali i aktiveve në vlerën 45,802,475 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
31	Materiale	1,326,054
32	Inventar i imët	49,913
4342	Operacione me shtetin	35,251,681
212	Ndërtesa e konstruksione	8,293,975
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	559,265
218	Inventar ekonomik	321,587
Shuma		**45,802,475**

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 45,802,475 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
42	Detyrime ndaj personelit	25,920,682
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,781,880
435	Sigurime shoqërore	6,586,004
436	Sigurime shëndetësore	913,490
467	Kreditorë të ndryshëm	49,625
101	Teprica (Fondi i Akumuluar/Defiçiti i Akumuluar)	10,550,794
Shuma		**45,802,475**

Në lidhje me zërat e mësipërm:
-ZVAP Kavajë nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, detyrime në vlerën 901,174 lekë, për vendimet gjyqësore që i kanë mbërritur në institucion brenda vitit 2019, por që janë paguar përgjatë vitit 2020, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.

-Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 8,293,975 lekë, që përfaqëson ndërtesën e institucionit të ZVAP Kavajë, për të cilën nuk janë marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saj pranë zyrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, neni 24, i cili përcakton se:

Regjistrimi fillestar i çdo pasurie të paluajtshme përfshin pasqyrimin e saj në hartën kadastrale dhe përgatitjen e një kartele, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e çdo akti, që përcakton pronësinë ose të drejta të tjera reale që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi S.Gj. dhe S.P., në cilësinë e hartuesit dhe miratuesit të PF.

ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetar.
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	Vlera
Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor	493,084,239
Transferime në buxhet të fondeve të papërdorura	12,489,105
Shuma	**505,573,344**

III.2.4.2.6. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Mat

Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga z. D. P me detyrë ish-shef i financës dhe z. N.H. me detyrë Specialist i Financës dhe miratuar nga znj. Sh.T. Drejtor i ZVAP Mat.
Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);
3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);

4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare, në përgjithësi janë hartuar sipas përmbajtjes dhe përbërjes së miratuar me anë të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të ZVAP Mat, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 430,730,605 lekë dhe që përbëhen nga 403,431,674 lekë grant nga Buxheti për NjQP (qendrore) dhe 27,286,94 lekë Financim i pritshëm nga buxheti.

Shpenzimet janë në vlerën 432,396,199 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 335,380,662 lekë,
- Paga, personel i përkohshëm në vlerën 185,210 lekë
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 55,865,222 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 29,111,345 lekë,
- Transferime korrente në vlerën 10,188,166 lekë,
- Ndryshim i gjendjes së inventarit në vlerën 1,665,594 lekë.

Totali i aktiveve në vlerën 29,514,103 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
31	Materiale	457,962
32	Inventar i imët	168,570
468	Debitorë të ndryshëm	62,108
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	26,635,712
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	651,233
212	Ndërtesa e konstruksione	1,184,121
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	43,546
218	Inventar ekonomik	310,851
Shuma		**29,514,103**

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 29,514,103 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
42	Detyrime ndaj personelit	18,807,807
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,533,515
435	Sigurime shoqërore	5,518,546
436	Sigurime shëndetësore	765,844
44	Institucione të tjera publike	10,000
467	Kreditorë të ndryshëm	651,233
4341	Operacione me shtetin (Detyrime)	62,108
101	Teprica (Fondi i akumuluar/Deficiti i akumuluar)	4,357,609
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	-1,665,594
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	-801,707
1013	Konsumi i aktiveve të qëndrueshme	-233,001
1015	Nxjerrje jashtë përdorimi e aktiveve të qëndrueshme	-1,406,763
	Të tjera (Amortizimi i akumuluar i aktiveve të dala nga njësia)	1,914,506
Shuma		**29,514,103**

Në lidhje me zërat e mësipërm:
-Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 1,184,121 lekë (4% të aktivit), që përfaqëson magazinën e ZVAP Mat, për të cilën edhe pse nuk disponohet dokumentacion mbi pronësinë e kësaj ndërtese (certifikatë pronësie), ZVAP Mat e ka paraqitur në pasqyrat financiare si ndërtesë të sajën.
-Në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?*", nga ZVAP Mat i janë përgjigjur me **JO**. ZVAP Mat nuk i është përgjigjur në mënyrë të drejtë kësaj pyetje, për arsye se godina e zyrave të këtij institucioni, është në pronësi të Bashkisë Mat dhe e përdor ZVAP Mat. Zërin nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim", në pasqyrat financiare është 0 (zero), ZVAP Mat, nuk ka paraqitur vlerën e godinës së zyrave të saj.
-ZVAP Mat nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, detyrime në vlerën 81,000 lekë, për vendimet gjyqësore që i kanë mbërritur në institucion brenda vitit 2019, por që janë paguar përgjatë vitit 2020.
Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.

Si dhe neni 7 "Dokumenti kontabël", i cili përcakton se:

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

Për sa më sipër mban përgjegjësi hartuesit dhe miratuesit e pasqyrave financiare (N.H. dhe Sh.T.).
ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetar.

Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	Vlera
Të hyra nga të ardhurat jotatimore	11,986
Pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara	43,398,504
Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor	403,443,660
Derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet	11,986
Transferime në buxhet të fondeve të papërdorura	15,755,440

III.2.4.2.7. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Dibër

Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga z. Sh.C. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve dhe miratuar nga znj. B.D. Drejtor i ZVAP Dibër.
Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);
3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare, në përgjithësi janë hartuar sipas përmbajtjes dhe përbërjes së miratuar me anë të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të ZVAP Dibër, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 1,119,999 lekë lekë dhe që përbëhen nga sponsorizime të brendshme (llogaria 7207).
Ndërsa shpenzimet janë në vlerën 735,176,251 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 589,404,487 lekë,
- Shpenzime të tjera për personelin në vlerën 740,900 lekë,
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 89,991,552 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 30,863,677 lekë,
- Subvencione të tjera në vlerën 24,175,635 lekë,

Totali i aktiveve në vlerën 69,054,813 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
32	Inventar i imët	297,746
35	Mallra	11,364
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	3,225,429
468	Debitorë të ndryshëm	58,108,800
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	92,431
202	Studime dhe kërkime	2,354,091
212	Ndërtesa e konstruksione	4,277,933
24	Inventar ekonomik	687,019
Shuma		**69,054,813**

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 69,054,813 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,006,238
42	Detyrime ndaj personelit	39,586,310
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	3,064,442
435	Sigurime shoqërore	11,814,641
436	Sigurime shëndetësore	1,637,169
437,438	Organizma të tjerë shtetërorë	3,225,429
4341	Operacione me shtetin (Detyrime)	92,431
101	Teprica (Fondi i akumuluar/Deficiti i akumuluar)	7,628,153
Shuma		**69,054,813**

Në lidhje me zërat e mësipërm:
-Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 4,277,933 lekë (6.2% të aktivit), ZVAP Dibër nuk disponon dokumentacion mbi origjinën dhe natyrën e kësaj vlere, por pretendon që kjo vlerë përbën vlerën e rikonstruksionit të zyrave të saj të një kohe mbi 15 vite më parë. Këtë vlerë sërish e ka paraqitur në pasqyrat financiare, edhe pse për zyrat e këtij institucioni nuk gjendet dokumentacion mbi pronësinë e tyre.
-Në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?*", nga ZVAP Dibër i janë përgjigjur me **PO**, por pa shpjeguar se çfarë aktivesh janë. Gjithashtu, vlera e zërit nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim", në pasqyrat financiare është 0 (zero).
-Për llogarinë "423,429 - Personeli, paradhënie, deficite, gjoba", në vlerën **3,225,429 lekë**, që përfaqëson detyrime të të tretëve ndaj ZVAP Dibër (ish-DAR Dibër), sipas listës prej 28 debitorësh, si më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti	Vlera
1	Subjekti"P."	49,065
2	Subjekti"4G."	248,204

3	Subjekti"V."	185,436
4	Subjekti"E"	1,041,106
5	Subjekti"Sh."	189,759
6	B.I.	100,000
7	F.P.	50,000
8	Xh.H.	100,000
9	F.E.	2,305
10	M.F.	86,300
11	F.S.	49,800
12	L.G.	45,400
13	V.K.	19,900
14	F.D.	53,900
15	G.H.	115,400
16	D.M.	68,500
17	A.M.	42,400
18	L.N.	81,500
19	Sh.H.	60,500
20	S.T.	30,400
21	N.K.	39,900
22	I.B.	85,400
23	F.K.	47,200
24	S.Sh.	176,800
25	M.H.	45,800
26	F.D.	105,800
27	D.H.	60,700
28	B.J.	43,954
Shuma		**3,225,429**

Nga ZVAP Dibër, nuk konstatohet të jenë marrë masa për arkëtimin e këtyre vlerave.
-Për llogarinë "468 - Debitorë të ndryshëm" me vlerë 58,108,800 lekë, ZVAP Dibër nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi origjinën dhe natyrën e kësaj vlere.
-Për llogarinë "202 Studime dhe kërkime" me vlerë 2,354,091 lekë, ZVAP Dibër nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi origjinën dhe natyrën e kësaj vlere.
-ZVAP Dibër nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, detyrime në vlerën 4,623,403 lekë, për vendimet gjyqësore që i kanë mbërritur në institucion brenda vitit 2019, por që janë paguar përgjatë vitit 2020.
Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.

Si dhe neni 7 "Dokumenti kontabël", i cili përcakton se:

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose inFormatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.

2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetar.
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	Vlera
Të hyra sponsorizime nga të tretë	1,119,999
Veprimtaria e shfrytëzimit	735,176,251

Nga ZVAP Dibër nuk janë pasqyruar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, akordimet e fondeve nga Buxheti i Shtetit në vlerën 741,623,362 lekë, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 72, e cila përcakton se:

72. Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Sh.C. në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare dhe B.D. me detyrë drejtor i ZVAP Dibër.

III.2.4.2.8. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Bulqizë
Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2019, janë përgatitur nga z. P.L. me detyrë specialist i financës dhe miratuar nga z. K.K. Drejtor i ZVAP Bulqizë.
Pjesë të pasqyrave financare, janë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (Formati nr. 1);
2. Pasqyra e performancës financiare (Formati nr. 2);
3. Pasqyra e flukseve monetare (Formati nr. 3);
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto (Formati nr. 4);
5. Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare (Formati nr. 5);
6. Investimet dhe burimet e financimit (Formati nr. 6);
7. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a);
8. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b);
9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare, në përgjithësi janë hartuar sipas përmbajtjes dhe përbërjes së miratuar me anë të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Sipas pasqyrës së perfomancës financiare të ZVAP Bulqizë, të ardhurat e institucionit janë në vlerën 361,931,810 lekë dhe që përbëhen nga 334,022,176 lekë grant nga Buxheti për NjQP (qendrore), 27,809,634 lekë Financim i pritshëm nga buxheti dhe 100,000 lekë të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh.

Shpenzimet janë në vlerën 361,931,810 lekë, e që përbëhen nga:

- Paga, personel i përhershëm në vlerën 286,912,221 lekë,
- Kontribute të sigurimeve në vlerën 48,374,774 lekë,
- Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 15,046,879 lekë,
- Transferime korrente në vlerën 11,597,936 lekë,

Totali i aktiveve në vlerën 30,732,828 lekë, është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Aktivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
468	Debitorë të ndryshëm	1,284,209
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	27,809,634
212	Ndërtesa e konstruksione	1,638,985
Shuma		**30,732,828**

Totali i Pasivit gjithashtu është në vlerën 30,732,828 lekë dhe është i ndarë sipas llogarive të mëposhtme:

Pasivi		
Llogaria	**Zëri**	**Vlera**
401-408	Furnitorë e llogari të lidhrua me to	14,074
42	Detyrime ndaj personelit	19,551,463
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,527,477
435	Sigurime shoqërore	5,897,885
436	Sigurime shëndetësore	818,735
4341	Operacione me shtetin (Detyrime)	1,284,209
101	Teprica (Fondi i akumuluar/Deficiti i akumuluar)	1,638,985
Shuma		**30,732,828**

Në lidhje me zërat e mësipërm:
-Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 1,638,985 lekë (5.3% të aktivit), që përfaqëson ish zyrat e ZVAP Bulqizë, të cilat i kanë kaluar në përdorim Bashkisë Bulqizë, për të cilën edhe pse nuk disponohet dokumentacion mbi pronësinë e kësaj ndërtese (certifikatë pronësie), ZVAP Bulqizë e ka paraqitur në pasqyrat financiare si ndërtesë të sajën.
-Në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?*", nga ZVAP Bulqizë i janë përgjigjur me **JO**. ZVAP Bulqizë nuk i është përgjigjur në mënyrë të drejtë kësaj pyetje, për arsye se godina e zyrave të këtij institucioni, është në pronësi të Bashkisë Bulqizë dhe e përdor ZVAP Bulqizë. Zërin nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim", në pasqyrat financiare është 0 (zero), ZVAP Bulqizë, nuk ka paraqitur vlerën e godinës së zyrave të saj.

Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6 "Mbajtja e kontabilitetit", i cili përcakton se:

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.

Si dhe neni 7 "Dokumenti kontabël", i cili përcakton se:

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose inFormatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

Për sa më sipër mban përgjegjësi P.L. në cilësinë e hartuesit e pasqyrave financiare dhe K.K. në detyrë drejtori i ZVAP Bulqizë.

ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetar.
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare (Thesarit) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri	Vlera
Të hyra nga të ardhurat jotatimore	380,497,616
Pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara	27,879,185
Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor	335,285,752
Transferime në buxhet të fondeve të papërdorura	17,266,714

Nga auditimi i llogarive vjetore të vitit 2019, për DRAP Durrës dhe ZVAP e audituara (Durrës, Tiranë, Kavajë, Shijak, Mat, Dibër dhe Bulqizë), u konstatua se këto njësi përdornin për regjistrimet kontabël programin Microsoft Excel. Programi "Microsoft Excel" me të cilin operojnë këto njësi, nuk të ndalon mundësinë e ndryshimit të veprimeve kontabël të periudhave të mëparshme, duke lënë të hapur mundësinë për ndryshime të këtyre veprimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3, pika 15, e cila përcakton se:

"Bartës informatik" është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 189/1 prot., datë 13.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 811/7, datë 15.01.2021, mbi Projektraportin e Auditimit, dërguar nga përgjegjësja e sektorit të financës T.S., sqarojmë si më poshtë vijon:
***Pretendimi juaj** mbi kërkesën e MASR për dorëzimin e PF individuale për çdo njësi, nuk ju shmang nga detyrimi ligjor për të hartuar PF të konsoliduara. Çdo ZVAP duhet të hartonte PF individuale, ndërsa DRAP Durrës, duhej të hartonte edhe PF të konsoliduara për 12 ZVAP në varësi të saj.*
***Pretendimi juaj** mbi opinionin e auditimit, nuk qëndron për arsye se Opinioni i auditimit, është plotësisht i mbështetur në evidencat përkatëse (në këtë rast mos hartimi i PF të konsoliduara).*
***Pretendimi juaj** mbi përdorimin e programit Excel, nuk qëndron për arsye se grupi i auditimit nuk*

ka përcaktuar që janë bërë ndryshime, por që ky program lë hapur mundësinë për ndryshime, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3, pika 15.

1. Titulli i gjetjes:	Hartimi i pasqyrave financiare
Situata:	-Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 120, përcakton që: "*Ministritë dhe* ***institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor të mbyllur****, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*". DRAP Durrës, edhe pse ka nën varësinë e tij 12 ZVAP e mësipërme, ka hartuar pasqyra financiare **vetëm** për këtë institucionin, pa përfshirë në to informacionin financiar të 12 njësive të varësisë. Mos hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për këtë institucion, ka ndikuar në mos-paraqitjen **me vërtetësi dhe besueshmëri** të pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimeve në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të DRAP Durrës, duke mos arritur qëllimin për të cilin këto pasqyra janë hartuar. -DRAP Durrës dhe ZVAP e audituara (Durrës, Tiranë, Kavajë, Shijak, Mat, Dibër dhe Bulqizë), përdornin për regjistrimet kontabël programin Microsoft Excel. Programi "Microsoft Excel" me të cilin operojnë këto njësi, nuk të ndalon mundësinë e ndryshimit të veprimeve kontabël të periudhave të mëparshme, duke lënë të hapur mundësinë për ndryshime të këtyre veprimeve. -DRAP Durrës dhe ZVAP: Tiranë, Durrës, Shijak, Bulqizë, Mat dhe Bulqizë, Pyetjes në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?*", i janë përgjigjur me **JO**. Këto institucione nuk i janë përgjigjur në mënyrë të drejtë kësaj pyetje, për arsye se godinat e zyrave të këtyre institucioneve, janë në pronësi të Njësive respektive të Qeverisjes Vendore dhe këto njësi thjesht i përdorin këto godina. Për pasojë, zërin nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim", në pasqyrat financiare për këto institucione, është 0 (zero). -Për 4 raste (ZVAP Durrës, Bulqizë, Dibër dhe Mat), për zërin "212 Ndërtesa e konstruksione", për vlerën totale 18,157,999 lekë, nuk disponohej asnjë dokumentacion dhe informacion mbi këto vlera. -Për 5 raste (ZVAP Tiranë, Durrës, Kavajë, Dibër dhe Mat), më 31.12.2019, nuk kanë paraqitur në llogarinë "467-Kreditorë të ndryshëm", detyrimet në vlerën 9,751,520 lekë, për vendimet gjyqësore që i kanë mbërritur në institucion para datës së hartimit të këtyre pasqyrave, por që janë paguar përgjatë vitit 2020. -Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 8,293,975 lekë, që përfaqëson ndërtesën e institucionit të ZVAP Kavajë, për të cilën nuk janë marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saj pranë zyrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. -ZVAP Durrës, për llogarinë "437 Organizma të tjerë shtetërorë" në vlerën 51,095 lekë dhe llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën

	252,120 lekë, nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere. -ZVAP Shijak, ka paraqitur në zërin e aktiveve, vetëm nënzërin "Inventar i imët" me vlerë 900 lekë. ZVAP Shijak nuk ka paraqitur asnjë të dhënë mbi inventarin që ky institucion ka në përdorim (kompjutera, printera, etj). -ZVAP Shijak ka paraqitur në PF e vitit 2019, zërin "3. Llogari të arkëtueshme" me vlerë 15,313,876 lekë, po pa e detajuar se nga çfarë zërash përbëhet ky llogari. -ZVAP Shijak, për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 8,403,460 lekë, nuk disponon dokumentacion dhe informacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere. -ZVAP Tiranë, për llogarinë "202 Studime dhe kërkime", nën kategorinë e "Aktive afatgjata jomateriale", vlera e vitit paraardhës është 3,467,346 lekë, ndërsa vlera e vitit ushtrimor 2019 është 0 (zero) lekë. Nga auditimi i pasqyrës "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a)" dhe "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto (Formati nr. 7/b)", pjesë e pasqyrave financiare, për këtë llogari nuk ka pakësime në vlerë. Për pasojë nuk konstatohet arsyeja e mos paraqitjes së vlerës 3,467,346 lekë për llogarinë "202 Studime dhe kërkime". -ZVAP Tiranë, për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 510,158 lekë, nuk disponon dokumentacion dhe informacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere. -Nga ZVAP Dibër, për llogarinë "423,429 - Personeli, paradhënie, deficite, gjoba", në vlerën **3,225,429 lekë**, përfaqëson detyrime të të tretëve ndaj ZVAP Dibër (ish-DAR Dibër), sipas listës prej 28 debitorësh, nuk konstatohet të jenë marrë masa për arkëtimin e këtyre vlerave. -ZVAP Dibër, për llogarinë "468 - Debitorë të ndryshëm" me vlerë 58,108,800 lekë, nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi origjinën dhe natyrën e kësaj vlere. -ZVAP Dibër, për llogarinë "202 Studime dhe kërkime" me vlerë 2,354,091 lekë, ZVAP Dibër nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi origjinën dhe natyrën e kësaj vlere. -ZVAP Dibër nuk ka pasqyruar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, akordimet e fondeve nga Buxheti i Shtetit në vlerën 741,623,362 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligji nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pasqyra financiare të cilat nuk paraqesin me besueshmëri dhe vërtetësi pozicionin financiar të DRAP Durrës.
Shkaku:	Krijimi i institucioneve të reja me riorganizimin sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019 dhe mos kuptim i përgjegjësive institucionale

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 1:	Nga Drejtori i ZVAP Dibër, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 3,225,429 lekë, nga 28 debitorët sipas Tabelës nr. 1, në Kapitullin VI "Anekse", të këtij raporti.
Rekomandimi 2:	Nga Drejtori i DRAP Durrës, të merren masa për kryerjen e konsolidimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2019, për drejtorinë e DRAP Durrës dhe 12 ZVAP nën varësinë e saj, me qëllim përcaktimin e pozicionit financiar të këtij institucioni.

III.2.5 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:
Mbi rregulloren e funksionimit të DRAP Durrës
DRAP Durrës funksionon sipas rregullores së brendshme për ogranizimin dhe funksionimin e DRAP Durrës, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPAP, z. S.H., sipas shkresës nr. 33, prot datë 29.05.2019. Mbetet e paqartë për strukturat e DRAP dhe ZVAP lidhur me autoritetin vendimmarrës për miratimin e rregulloreve të brendshme respektive, pasi sikundër është vërejtur gjatë auditimit, në ZVAP Tiranë dhe ZVAP Durrës miratimi i rregullores është bërë nga vetë drejtori i institucionit respektiv. Pra, nëse do të ndiqnim këtë linjë, miratimi për DRAP do të kryhej nga vetë titullari i DRAP Durrës.
Në këtë rregullore nuk parashikohet mënyra se si do të administrohen dosjet e personelit në DRAP Durrës. Gjithashtu nuk është përfshirë në rregullore mënyra se si do të rregullohet komunikimi i brendshëm i DRAP. Në lidhje me rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve elektronike dhe përgjegjësit për përditësimin e faqes së zyrtare së institucion, nuk rezultojnë të jenë përcaktuar në rregulloren e miratuar këto çështje. Sipas observacionit të subjektit të audituar është ngarkuar një person për këtë rol nga drejtori i DRAP Durrës.
Sipas urdhrit nr. 773, prot nr. 2379/1, datë 20.09.2020 të DPAP është urdhëruar miratimi i përshkrimeve individuale të punës për punonjësit e DPAP. Në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar se drejtuesit e DRAP dhe ZVA-ve të bëjnë përshkrimet individuale të punës sipas strukturave të miratuara. Miratimi i përshkrimeve të punës nga DPAP, DRAP apo ZVAP bie ndesh me kërkesat e pikës 18, germa "c", kreu IV, të VKM nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë nën varësinë e të cilit është institucioni, në këtë rast MASR. Përshkrimet e punonjësve të DRAP, (i cili edhe pse nuk është një institucion tanimë me status civil, është nën varësinë e një ministrie), janë miratuar nga DPAP, ku drejtori i përgjithshëm ka kryer miratimin në cilësinë e eporit direkt, edhe pse faktikisht eprori direkt për punonjësit e DRAP është titullari i këtij institucioni. Nga verifikimi në ZVAP Tiranë përshkrimet e pozicioneve të punës, sipas rregullores së institucionit miratohet nga drejtori i ZVAP.
Mbi nëpunësin autorizues dhe zbatues
Në vijim të shkresës nr.5374, datë 20.05.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë", dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, me email-in e datës 21.05.2019 të znj. A.B është miratuar si nëpunëse autorizuese për Drejtorinë Rajonale Arsimore Durrës, znj. V.L..
Në vijim të shkresës nr.5374, datë 20.05.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë", dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i

ndryshuar, me shkresën nr.9768/1, datë 31.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit është miratuar si nëpunës zbatues i DRAP Durrës, znj. T.S..

Mbi ngritjen e GMS dhe aktivitetin e tij

Në përputhje me nenet 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, të ndryshuar *'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", dhe kreut III, pika 4.2.9 të Manualit "*Për MFK*", Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur me urdhër të Drejtorit të DRAP Durrës me shkresën nr. 169/1 prot datë 20.06.2019, me përbërje:

Znj. V.L., NA
Znj. T.S., NZ
E.M., P/SIVC
E.P., Specialiste e BNJ në SBNJSHS
P.N., Specialist në SIVC.

Me shkresën nr. 169/2 prot datë 07.01.2020, është urdhëruar ndryshim në GMS, si më poshtë:

Znj. V.L., NA
Znj. T.S., NZ
E.M., P/SIVC
K.C., Specialiste e BNJ në SBNJSHS
P.N., Specialist në SIVC.

Drejtoria disponon protokollin e mbledhjeve të GMS-së për vitin 2019 dhe 2020. Në këtë dokument janë pasqyruar **vetëm** tre mbledhje të GMS gjatë vitit **2019**. Në mbledhjen e datës 20.06.2019 të GMS është miratuar Udhëzimi dhe rregullorja e Menaxhimit të Riskut në DRAP Durrës, Strategjia e menaxhimit të riskut të brendshëm në DRAP Durrës, Regjistri i Riskut.

Në vijim, në mbështetje të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike u miratuan:

Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, dhe **Koordinator Risku** znj. V.L..

Koordinatori i Deleguar i Riskut është znj. E.D., specialist e financës dhe buxhetit në SBNJSHS.

Ekipi i Menaxhimit të Riskut është z. L.G., I.G. dhe z. M.M.

Me shkresën nr. 169/1 prot datë 10.11.2019 është kryer zëvendësim i grupit, ku më hollësisht L.G. dhe I.G., zëvendësohen me znj. L.C. dhe znj. E.D..

Në mbledhjen e datë 27.06.2019 është diskutuar lidhur me hartimin e rregullores dhe menaxhimin me sukses së udhëzimit nr. 13, datë 20.05.2019.

Në mbledhjen e datës 10.11.2019 është shqyrtuar situate e fatkeqësisë natyre, riorganizimi i punës dhe minimizimin e pasojave të mundshme.

Për vitin **2020 nuk** rezulton e dokumentuar asnjë mbledhje e GMS. Sipas observacionit të DRAP Durrës, mbledhjet janë zhvilluar online, por dokumentohet asnjë protokoll i mbajtur për problematikat e trajtuara në to si dhe masat e ndërmarrra.

Mbi Raportin Vjetor të Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit

Për vitin 2019, në zbatim të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", institucioni ka dorëzuar Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë, sipas shkresës nr. 78, prot datë 22.01.2020. Neni 18, i këtij ligji përcakton se "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", pika 1 e cila citon se "*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë vetë vlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i pare autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një*

sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji;", rezulton se pyetësori i përcjellë nga DRAP Durrës, pasqyron situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm, **vetëm** në këtë institucion, duke mos reflektuar një analizë me të dhëna të konsoliduara për 12 njësitë e varësisë nën juridiksionin e saj.

Nga verifikimi i përgjigjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit nga DRAP Durrës rezulton se përgjithësisht njësia ka plotësuar saktë, duke mos u bazuar vetëm në përgjigje të shkurtra, por shoqëruar këto me dokumentacionet specifike sipas rastit.

Nga auditimi rezulton se për **pyetjen 33** të Parimit 4 të pyetësorit, "A ka ndonjë çështje apo problem në lidhje me rekrutimin e personelit që ndikon dukshëm në performancën e njësisë publike", DRAP është përgjigjur "Nuk kemi patur dhe nuk kemi asnjë problem në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj". Faktikisht, një ndër problematikat e konstatuara në procedurat e rekrutimit të stafit në këtë drejtori, është komandimi i tyre nga DPAP, dhe mos inicimi prej DPAP i asnjë procedure për konkurrimin konform rregullores së MASR. Gjithashtu, lëvizjet e shpeshta të stafit dhe vakancat relativisht të konsiderueshme janë çështje që duhet të ishin identifikuar në pyetësor.

Në vijim të **pyetjeve 69-74**, të Parimit 11 "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli të përgjithshme dhe kontrollit të teknologjisë", rezulton se pavarësisht përgjigjes me "jo" të DRAP për të gjitha çështjet, në vijim nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë hapa për përmirësimin e situatës, duke rishikuar rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përfshirjen e tyre.

Në **pyetjen 83**, të Parimit 15, "A kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar", DRAP është përgjigjur "Të gjithë punonjësit e DRAP kanë në përdorim email-i zyrtar dhe personal për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm". Faktikisht, punonjësit e institucionit nuk disponojnë një email zyrtar për komunikimin e brendshëm, dhe si rezultat ai realizohet me adresat personale të punonjësve.

Në **pyetjen 94**, të Parimit 16 "A kryen auditimi i brendshëm në mënyrë të rregullt vlerësime specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm? A siguron për titullarin e njësisë publike një informacion të pavarur për sistemet e kontrollit të brendshëm të njësisë publike?, DRAP është përgjigjur me "Po", në një kohë ku institucioni nuk ka auditim të brendshëm, sikundër përcaktuar edhe në pyetjet e tjera të pyetësorit.

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë DRAP Durrës për vitin 2020 rezulton të jetë përgatitur në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", pika 16 dhe Shtojca 2 e udhëzimit, në të cilat përcaktohet se " ….*Raporti duhet te strukturohet sipas formatit te përshkruar ne Shtojcën 2 te këtij udhëzimi, i cili përbehet nga: (a) Përmbledhja ekzekutive; (b) Vlerësimi i sistemit ekzistues te menaxhimit financiar dhe kontrollit te njësisë; (c) Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm; Masat e marra gjate vitit për përmirësimin e sistemit te kontrollit te brendshëm ne njësi dhe plan veprimin për te ardhmen; (d) Rekomandime te përgjithshme për Ministrinë e Financave lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit."*

Mbi vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e tij

Me shkresën nr. 169, prot datë 20.06.2019 DRAP Durrës ka hartuar *Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar* për periudhën 2020-2022, në përputhje me nenet 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 (pika 2), të ligjit nr. 10296 dhe kreun III, pika 3.2 të Manualit të MFK; dhe *Regjistrin e Riskut për DRAP* Durrës me shkresën nr. 169, prot date 20.06.2019, sipas kërkesave të neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Drejtoria operon nën *Rregulloren e Menaxhimit të Riskut në DRAP Durrës.* Në vijim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

Kodi etik është miratuar nga Drejtori i DRAP Durrës me shkresën nr. 33/8, prot datë 29.05.2019. Në fund të kodit përcaktohet se ky kod është përbërëse e rregullores së brendshme të DRAP Durrës, megjithatë në bazën ligjore te cituar në dokumentin e kodit etik, është vetëm rregullorja nr. 4699/1, datë 30.04.2019 e MASR.

Mbi hartimin e gjurmës së auditit dhe hartën e proceseve të punës në DRAP Durrës

Gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit është miratuar në DRAP Durrës nga Drejtori, sipas shkresës nr. 249, prot datë 18.07.2019. Në këtë dokument janë përshkruar proceset, duke identifikuar referencat ligjore, aktivitetet e kontrollit dhe strukturat përgjegjëse për to. Proceset kryesore janë: procedurat standard të shpërndarjes së fondeve të buxhetit vjetor, rishpërndarja e fondeve buxhetore, marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, rakordimi mujor i shpenzimeve, investimet me financim të huaj, rakordimi mujor i të ardhurave dhe raportet e monitorimit. Gjurma është miratuar nga T.S., E.D. dhe E.P..

Harta e proceseve të punës si kërkesë e pikës 3.3, të manualit të MFK është e pa miratuar nga titullari dhe përfshin çështje të: Drejtorisë së DRAP Durrës dhe Sekretarisë për regjistrimin dhe arkivimin e dokmentacionit; Specialisti i burimeve njerëzore dhe specialistët e inspektimit për menaxhimin e burimeve njerëzore; Sektori i Burimeve Njerëzore Shërbime dhe Statistikës për Menaxhimin financiar dhe Buxhetin e DRAP Durrës.

Në këtë dokument të përgatitur në 01.09.2020 (të pafirmosur dhe protokolluar në DRAP) janë përfshirë 3 procese pune:

Regjistrimi dhe arkivimi i dokumentacionit

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Menaxhimi Financiar dhe Buxheti i DRAP Durrës

Ky dokument nuk është rishikuar pas ndryshimit në udhëzim për përzgjedhjen e drejtuesit të institucioneve arsimore në vitin 2020, në mënyrë që të identifikohet roli konkret i DRAP në këtë proces, si një ndër më të rëndësishmit e kësaj drejtorie. Si rezultat, nuk është parashikuar roli i drejtorisë në vlerësimin me pikë të dosjes së mësuesve nga ana e DRAP, dhe më pas menaxhimin e këtij procesi në përfundim të pikëve në portal. Gjithashtu, edhe në lidhje me procesin e përzgjedhjes së drejtorit, nuk janë shqyrtuar detyrat konkrete dhe përshkrimin e procesit për rekrutimin e drejtuesve të institucioneve arsimore.

Gjurma e auditit për menaxhimin e aktiveve është miratuar në DRAP Durrës nga Drejtori, sipas shkresës nr.249/1, datë 18.07.2019. Në këtë dokument janë përshkruar proceset, duke identifikuar referencat ligjore, aktivitetet e kontrollit dhe strukturat përgjegjëse për to. Proceset kryesore janë: Menaxhimi i Aktiveve; Lista e Proceseve të Punës për inventarizimin fizik të aktiveve; Lista e proceseve të punës për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve në DRAP Durrës; Lista e proceseve të punës për procesin e vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit në DRP Durrës;

Gjurma e auditit për prokurimet me vlerë të vogël nën 800,000 lekë pa tvsh është miratuar ne DRAP Durrës nga Drejtori, sipas shkresës nr. 249/2, prot datë 18.07.2019. Në këtë dokument janë përfshirë si procese kryesore Organizimi i Prokurimit Publik, Zhvillimi i Procedurës dhe Dokumentet që duhet të dorëzohen në Thesar.

Gjurma e auditit për prokurimet me vlerë mbi 800,000 lekë pa tvsh është miratuar ne DRAP Durrës nga Drejtori, sipas shkresës nr. 249/3, prot datë 18.07.2019. Në këtë dokument janë përfshirë si procese kryesore Organizimi i Prokurimit Publik, Zhvillimi i Procedurës, Lidhja e kontratës, Zbatimi i Kontratës dhe Dokumentet që duhet të dorëzohen në Thesar.

DRAP Durrës nuk disponon një sistem back-up me qëllim ruajtjen e informacionit dhe të dhënave të konsoliduara. Megjithatë, gjatë periudhës së covid, punonjësit kanë përcjellë të gjitha informacionet e gjeneruara nga ta në një adresë personale të institucionit, me qëllim ruajtjen e tyre. DRAP Durrës nuk disponon një email të brendshëm zyrtar dhe si rezultat punonjësit e institucionit komunikojnë me adresat e tyre personale të email-it.

Nga auditimi konstatohet se në lidhje me zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit të DRAP Durrës, institucioni nuk disponon një plan të trajnimeve dhe stafi ka realizuar vetëm një program trajnimi, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 3/1, nënçështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016.

Nga verifikimi i 6 ZVAP-eve nën juridiksionin e DRAP Durrës, u konstatuan gjithashtu problematika lidhur me njohjen dhe zbatimin e Ligjit të MFK-së. Më hollësisht, dosjet e procedurave të zhvilluara për prokurim, dhe për procedurat e përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve arsimore nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.

-Problematika u vërejtën edhe me pozicionin e nëpunësit zbatues dhe autorizues, ku në 3 raste (Dibër, Mat dhe Bulqizë), nëpunësi zbatues është pjesë e procedurave të prokurimit si anëtar i NjP dhe/ose anëtar i KVO (në ZVAP Bulqizë ishte në të dyja), në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3.

- Pas ristrukturimit u konstatuan problematika në dorëzimin e dokumenteve të punës dhe pajisjeve nga ish-DAR në ZVAP. Nga dokumentet e vëna në dispozicion grupit të auditimit konstatohet se: drejtori i ish- DAR Durrës nuk ka bërë dorëzim të detyrës në momentin e lirimit nga detyra si rezultat i ristrukturimit, në kundërshtim me pikat 27, 28, 29, 30 të Kreut III, të VKM nr. 124, datë 17.02.2016, i ndryshuar ku citohet se: "*Nëpunësi që largohet nga shërbimi civil duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil.";* "*Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe te njësia përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar*"; "*Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirimit. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera*"; "*Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 29 të këtij vendimi, konsiderohet* ***shkelje*** *e rëndë e detyrës dhe shkelje e rëndë disiplinore*".Si rezultat për 2 raste të kërkuara nga grupi i auditimit, **nuk gjenden dosjet** e procedurës së ndjekur nga ish-DAR Durrës për përzgjedhjen dhe emërimin e tyre.

Analiza e komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

1. Mjedisi i Kontrollit

a. Vendosja e objektivave

Në zbatim të kapitullit e III të Manualit të MFK mbi detyrimet në lidhje me Deklaratën e misionit dhe vizionit, në Rregulloren e brendshme të institucionit, neni 5 përcakton se "*DRAP Durrës ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në juridiksionin e DRAP Durrës, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë qe të përballojë sfidat e të ardhmes."*.Institucioni vepron sipas rregullores së brendshme të institucionit, të ndryshuar sipas urdhrit nr.28, datë 1205.2020 të Drejtorit të DRAP Durrës. Gjithashtu, pas situatës së shkaktuar nga epidemia COVID 19, DRAP Durrës ka hartuar rregulloren për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së DRAP Durrës gjatë epidemisë së shkaktuar nga COVID 19, sipas vendimit nr.23, date 20.05.2020 të Drejtorit të DRAP Durrës.

b. Etika personale dhe profesionale.

DRAP Durrës disponon një kod etik, miratuar nga Drejtori i DRAP Durrës me shkresën nr. 33/8, prot datë 29.05.2019 dhe gjithashtu, çështjet lidhur me etikën në këtë institucion janë trajtuar në nenin 21 "Etika" të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e DRAP Durrës.

c. Struktura organizative

Me VKM nr.99, datë 27.02.2020 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", çështja III. Organizmi dhe Funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", pika 2 përcakton krijimin e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar me propozim të Ministrit, për të mbuluar jo më pak se 4000 punonjës. Struktura organizative e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës është krijuar mbi 1 muaj pas VKM për krijimin e DPAP, sipas Urdhrit nr. 68, datë 5.4.2019 të Ministrit të Arsimit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshëm dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*",organizuar për të funksionuar me një strukturë prej 15 punonjësish. Sipas Urdhrit nr. 93, datë 10.07.2020 të Ministrit të Arsimit "*Për një ndryshim në urdhrin nr. 68, datë 5.04.2019 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar*" struktura organizative janë ndryshuar kategoritë e punonjësve. Deri në fund të vitit 2019, pra rreth 9 muaj pas urdhrit për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, struktura organizative e drejtorisë dispononte 13 punonjës, nga 15 qe përcakton struktura, pra 2 vakanca, përkatësisht të 2 specialistëve në Sektorin e Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Deri në fund të periudhës objekt auditimi (31.08.2020), struktura organizative e drejtorisë disponon 14 punonjës, nga 15 qe përcakton struktura, pra 1 vakancë, përkatësisht të ë specialistëve në Sektorin e Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional përgjatë vitit 2019 e ka ushtruar veprimtarinë me 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist, pra 2 vakanca. Për vitin 2020, deri në fund të periudhës objekt auditimi (31.08.2020), pozicioni i përgjegjësit të sektorit ka qenë vakant për nj periudhë 4 mujore dhe struktura ka funksionuar me 2 specialistë, ku 1 prej tyre është emëruar vetëm ne fund të muajit Shkurt 2020. Aktualisht, ky sektor disponon një vakancë në pozicionin e specialistit.

Për sa më sipër, rezulton se sipas Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Pëgjithshme të Arsimit Parauniversitar, miratuar nga MASR sipas shkresës nr. 4699/1, prot datë 30.04.2019, neni 25 i saj, përcakton se Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional ka si detyra:

Zbatimin e Strategjisë Arsimore në nivel DRAP dhe ZVAP;

Bashkëveprimin me MASR dhe institucionet e saj të varësisë për zbatimin e politikave dhe projekteve në shkolla;

Organizimin e veprimtarive të zhvillimit profesional për të përmirësuar aftësitë e drejtuesve të shkollave dhe mësuesve në fushën e kurrikulës.

Ndjekjen e plotësimit nga shkollat të parapëlqimeve të nxënësve në kurrikulën me zgjedhje.

Këshillimin e drejtuesit, mësuesit lëndorë dhe ata kujdestarë në fushën e kurrikulës.

Identifikimin e nevojave për zhvillim profesional të mësuesve përmes pyetësorëve, bisedave me ta, pjesëmarrjes në mbledhjet e ekipeve lëndorë, vizitave në institucione arsimore, vëzhgimeve të orëve mësimore, kryerjes me nxënësit të testeve të standartizuara e minitesteve, takimeve me prindër e nxënës e organizma që i përfaqesojnë ato, me përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Në bashkëpunim me organizma qeveritae ose joqeveritare, harton dhe zbaton projekte në fushën e kurrikulës në dobi të institucioneve arsimore dhe në bashkëpunim me to

Merr informacion mujor nga shkollat mbi gjendjen e mjeteve elektronike të TIKut de të laboratorëve të kompjuterëve, verifikon gjendjen dhe raporton në DRAP dhe DPAP.

Mbikqëyr instalimin e pjesëve hardëerike të kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera: teknologjike dhe softëare.

Mirëmban rrjetin LAN në DRAP dhe ZVAP mirëmban të gjitha pajisjet teknologjike të informacionit si dhe mirëmban shërbimin e internetit.

Kontribuon qe shërbimi i internetit dhe i laboratorëve të kompjuterave në cdo shkollë të jetë në përputhje me parametrat e kontraktuara.
Verifikon saktësinë e plotësimit të amzës së digjitalizuar në shkolla.
Mosplotësimi i **strukturave të këtij sektori, dhe lëvizjet e stafit,** rreth 1 vit e gjysëm pas krijimit ë DRAP Durrës nën gjykimin e grupit të auditimit cënon realizimin e funksioneve dhe detyrave në bazë të së cilave është krijuar kjo drejtori.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me dispozitat e kodit të punës. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë mbikëqyren e kryerjes së detyrave të tyre nga DRAP Durrës. Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, me VKM nr. 243, datë 24.03.2020, DRAP Durrës ka hartuar planin e masave me qëllim menaxhimin e situatës në institucion, sipas shkresës nr. 539, prot datë 25.03.2020. Ky plan është rishikuar më pas me shkresën nr. 600/1, datë 28.04.2020, në zbatim të udhëzimit nr.253, datë 10.04.2020 "Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevoje për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë të shkaktuar nga COVID 19".

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të DRAP Durrës, dhe përshkrimit të pozicioneve të punës, janë përcaktuar përgjegjësitë për çdo zyrë dhe punonjës.

2. Vlerësimi i riskut

Nga ana e dokumentacionit vlerësimi i riskut rezulton të jetë i rregulluar në DRAP Durrës. Më hollësisht, në mbështetje të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", janë emëruar Koordinatori Risku, Koordinatori i Deleguar i Riskut, Ekipi i Menaxhimit të Riskut. Është hartuar *Strategjia e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar* për periudhën 2020-2022, në përputhje me nenet 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 (pika 2), të ligjit nr. 10296 dhe kreun III, pika 3.2 të Manualit të MFK; dhe *Regjistri i Riskut për DRAP* Durrës, sipas kërkesave të neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Drejtoria operon nën *Rregulloren e Menaxhimit të Riskut në DRAP Durrës.*

3. Aktivitetet e kontrollit

Pavarësisht se në strukturën e miratuar vërehet se ekziston një ndarje e qartë e detyrave, struktura aktuale nuk i përgjigjet të gjithë funksioneve të parashikuara nga drejtoria, dhe si rezultat disa detyra mbulohen nga stafi i ngarkuar në detyra të tjera sipas strukturës, trajtuar edhe më sipër. Struktura nuk ka një ndarje të veçantë për IT. Dokumentacionet e dosjeve të personelit, apo procedurave të konkurrimit të drejtuesve janë të pa arkivuara në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" dhe nga ana e DRAP në strukturë nuk disponohet pozicioni i protokoll arkivës/magazinier.

4. Informacioni dhe Komunikimi

Titullari i DRAP Durrës informohet nga përgjegjësit e sektorëve, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme të brendshme. DRAP Durrës nuk disponon një email të brendshëm zyrtar dhe si rezultat punonjësit e institucionit komunikojnë me adresat e tyre personale të email-it. Institucioni nuk ka parashikuar mënyrat për mbrojtjen e të dhënave nëpërmjet sistemit të back up.

5. Monitorimi

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut VI, paragrafi 257, nënpika 63 "Raportet e monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ku shprehimisht përcaktohet që: "Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare.." Në faqen zyrtare të

DRAP Durrës nuk janë publikuar raportet e buxhetit. Gjithashtu, në kundërshtim me nenin 24 të rregullores së brendshme të DRAP Durrës, në faqen zyrtare nuk rezulton të jetë publikuar raporti vjetor i institucionit.
Me urdhrin nr. 42, datë 19.11.2019 të paprotokolluar të DRAP Durrës janë përcaktuar koordinatorët për ndjekjen e çdo problemi në 12 zyrat arsimore nën juridiksionin e institucionit. Me urdhrin nr. 17, prot nr. 498, datë 09.03.2020 të DRAP Durrës është urdhëruar ngarkimi i specialistëve të institucionit për mbikëqyrjen e veprimtarisë së ZVAP-eve në varësi, duke u kërkuar raportime ditore të tyre.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucionin e DRAP Durrës rezultojnë pjesërisht efektive, me disa dobësi të trajtuara në çështjet më sipër, të cilat kërkojnë vëmendje nga ana e institucionit për përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në ZVAP Tiranë
Mbi rregulloren e ZVAP Tiranë
Në vijim të rregullores nr. 4699/1 datë 30.04.2019 të MASR "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DPAP", ZVAP Tiranë ka miratuar rregulloren e brendshme, datë 10.06.2019, mbi organizimin dhe funksionimin e ZVA Tiranë. Sipas Rregullores së Brendshme të ZVAP Tiranë, Kreu III, neni 14 përcakton se Drejtori i ZVAP "Miraton përshkrimin e punës së përgjegjësave të sektorëve dhe specialistëve të ZVAT-it (në përshkrimin e punës së përgjegjësave të sektorëve parashikohet që në një pjesë të kohës kryen detyra si specialist i sektorit)." Ky përcaktim i rregullores bie ndesh me kërkesat e pikës 18, germa "c", kreu IV, të VKM nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë. Përshkrimet e pozicioneve të vendosura në dispozicion nga ZVAP Tiranë janë të pafirmosura dhe pa datë, dhe si rezultat nuk mund të identifikojmë se nga kush janë miratuar. Nga verifikimi në DRAP Durrës rezulton se përshkrimet e punës janë firmosur për institucionin nga Drejtori i DPAP, duke mos ndjekur një linjë me përcaktimet e rregullores së ZVAP.
ZVAT Tiranë ka miratuar në datë 10.06.2019 "Rregulloren për përpunimin dhe mbrojten e të dhënave personale në ZVA Tiranë". Në këtë rregullore janë përcaktuar procedurat organizative e teknike, masat për mbrojtjen e të dhënave personale, ruajtjes dhe administrimi i tyre në strukturat e zyrës.
ZVAP Tiranë nuk disponon një kod etik, por çështjet lidhur me etikën në këtë institucion janë trajtuar në nenin 39 "Etika" të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ZVAP Tiranë.
Mbi nëpunësin autorizues dhe zbatues
Në vijim të shkresës nr.308, datë 24.01.2020 të DPAP, dhe në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë", dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, me email-in e datës 21.05.2019 të z. Arian Kraja është miratuar si nëpunëse autorizuese për ZVAP Tiranë, znj. E.A..
Në vijim të shkresës nr.5168/1, datë 20.05.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë", dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, me shkresën nr.9768/1, datë 31.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit është miratuar si nëpunës zbatues i ZVAP Tiranë, z. K.F..

Mbi ngritjen e GMS dhe aktivitetin e tij

Në kundërshtim me nenet 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, të ndryshuar'*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", dhe kreut III, pika 4.2.9 të Manualit "*Për MFK*", në ZVAP Tiranë nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, edhe pse në përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit përcjellë në MFE në 14.02.2019, për ish DAR Tiranë është konfirmuar ekzistenca e tij. Manuali i MFK, përcakton se: *"Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të veprojë si një komitet, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të këshillojë Nëpunësin Autorizues mbi përmbajtjen e raportit vjetor për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut."…. "Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë….Grupi për Menaxhimin Strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë."*

Në kundërshtim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", **nuk** është ngritur koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Koordinatori i Riskut dhe Ekipi i Menaxhimit të Riskut.

Mbi përgatitjen e Deklaratës për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë, Raportin vjetor të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit

Për vitin 2019, në bazë të përcaktimeve të kreut III, pika 3.3 e Manualit të MFK dhe cilësimeve të nenit 18 të ligjit nr.10296, institucioni ka dorëzuar brenda afateve në MFE, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë, Raportin vjetor të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm në DAR Tiranë për vitin 2018, dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit sipas shkresës nr.341, prot datë 14.02.2019.

Në raportin vjetor janë pasqyruar objektivat e njësisë së DAR Tiranë dhe në vijim është bërë përshkrimi i situatës për çdo komponent të MFK, ku sistemi i kontrollit të brendshëm në DAR Tiranë është konsideruar efektiv. Rregullorja sipas së cilës funksionon institucioni është miratuar në vitin 2014, ku janë përshkruar pozicionet e punës dhe delegimi i detyrave. Kjo rregullore e miratuar 4 vjet më parë, nuk pasqyron ndryshimet që ka pësuar legjislaconi mbi institucionet arsimore.

Në këtë raport janë pasqyruar si risqe mungesa e pajisjeve teknologjike (pasi ato aktuale janë pothuajse jashtë funksionit), mungesa e një sistemi back up, dhe trajnime për teknologjinë e informacionit. Raporti **nuk** rezulton të jetë përgatitur në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", pika 16 dhe Shtojca 2 e udhëzimit, në të cilat përcaktohet se: " *Raporti duhet te përfshijë ne tërësinë e tij elementet si vijon: (a) shtrirjen e përgjegjësisë se menaxhimit te larte ne fushën e kontrollit te brendshëm; (b) qëllimin e sistemit te kontrollit te brendshëm; (c) një përshkrim te kuadrit te riskut dhe kontrollit brenda njësisë; (d) një vështrim te efektivitetit te kuadrit te riskut dhe te kontrollit, qe përmban edhe një pasqyre te masave te marra, apo te propozuara për te trajtuar çdo lloj çështjeje me rendësi qe i referohet kontrollit te brendshëm. Raporti duhet te strukturohet sipas formatit te përshkruar ne Shtojcën 2 te këtij udhëzimi, i cili përbehet nga: (a) Përmbledhja ekzekutive; (b) Vlerësimi i sistemit ekzistues te menaxhimit financiar dhe kontrollit te njësisë; (c) Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm; Masat e marra gjate vitit për përmirësimin e sistemit te kontrollit te brendshëm ne njësi dhe plan veprimin për te ardhmen; (d) Rekomandime te përgjithshme për Ministrinë e Financave lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nenligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit."*

Nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit përcjellë në vitin 2019 nga ish DAR Tiranë rezulton se përgjigjet kanë qenë relativisht tepër të shkurtra, pa përcjellë informacion të

detajuar dhe të nevojshëm për secilën pyetje sipas çështjeve përkatëse. Si rezultat, pyetësori rezulton të jetë kryer në kundërshtim me Kapitullin III, Hapi III, kreu "Procesi i Implementimit të MFK" dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar.

Për vitin 2020 nuk u vendos në dispozicion informacion nga ZVAP Tiranë për përgatitjen e Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë, Raportin vjetor të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm. Pyetësori i vetëvlerësimit u përcoll me observacionet pas dorëzimit të akt konstatimit. Ky pyetësor nuk reflektonte situatën reale të njësisë së audituar në përgjigjet e dhëna.

Nga auditimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 8, neni 8 të ligjit nr.10296, lidhur me përgjegjshmërinë menaxheriale të titullarit të institucionit, rezultojnë të jenë kryer me mangësi detyrimet lidhur me:

-ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

-hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave, planit dhe plan veprimit për arritjen e objektivave të institucionit.

-vendosja e linjave të raportimit në strukturën organizative për të mundësuar kryerjen efektive të përgjegjësive.

Mbi vlerësimin e risqeve dhe strategjinë për menaxhimin e riskut

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale për monitorimin e risqeve të institucionit, në kundërshtim me kërkesat e neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

ZVAP Tiranë nuk rezulton të ketë hartuar *Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm* në kundërshtim me nenet 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 (pika 2), të ligjit nr. 10296 dhe kreun III, pika 3.2 të Manualit të MFK.

ZVAP Tiranë nuk ka hartuar *Regjistrin e Riskut* në kundërshtim me kërkesat e neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

ZVAP Tiranë nuk disponon një *Rregullore për Menaxhimit të Riskut, në* vijim të Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

Mbi gjurmën e auditit dhe hartën e proceseve të punës

ZVAP Tiranë nuk rezulton të ketë hartuar dhe miratuar gjurmën e auditit për zbatimin e buxhetit, prokurimeve, menaxhimin e aktiveve, etj; në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, ku shprehimisht përcaktohet:*"Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit*".

ZVAP Tiranë nuk ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve të punës dhe manualeve të proceseve të punës, si kërkesë e pikës 3.3, të manualit të MFK. Krijimi i të tilla manualeve krijon një standardizim për proceset e punës që kryhen nga ZVAP, në mënyrë që të identifikohet proces, përgjegjësitë, afatet dhe aktivitetet e kontrollit me qëllim përmbushjen e objektivave.

ZVAP Tiranë nuk ka parashikuar mënyrat për mbrojtjen e të dhënave nëpërmjet sistemit të back up.

ZVAP Tiranë nuk disponon një email të brendshëm zyrtar dhe si rezultat punonjësit e institucionit komunikojnë me adresat e tyre personale të email-it.

ZVAP Tiranë nuk disponon plane të trajnimeve apo një regjistër për kualifikimin periodik të stafit, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin profesional të punonjësve, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.3/1, nënçështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të

Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr.108, datë 17.11.2016. Si rezultat i mungesës së trajnimeve në këto fusha, stafi ekzistues rezulton të ketë njohuri të pakta lidhur me dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, duke cënuar kështu efikasitetin dhe eficencën e punës në kuadër të menaxhimin të fondeve publike.

Për sa i përket marrëdhënies mes ZVAP, DRAP dhe DPAP rezulton se hartimi i linjave raportuese dhe komunikuese për këto institucione përmban dobësi të konsiderueshme. ZVAP Tiranë operon si njësi e pavarur shpenzuese. Si e tillë, pavarësisht se në rregullore parashikohet një ndërveprim mes ZVAP dhe DRAP për hartimin e buxhetit të njësisë, ZVAP Tiranë miraton dhe përcjell në MASR PBA, Buxhetin dhe raportet e monitorimit të pavarur nga DRAP Durrës. Gjithashtu, pasqyrat financiare të ZVAP Tiranë përgatiten dhe miratohen nga vetë institucioni, pa u kryer një konsolidim në DRAP Durrës për të gjitha ZVAP-et nën juridiksionin e kësaj zyre.

Në lidhje me auditimin e brendshëm, për periudhën objekt auditimi, ZVAP Tiranë nuk rezulton të ketë qenë objekt kontrolli i auditimit të brendshëm nga MASR, DRAP apo DPAP.

Analiza e komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

1. Mjedisi i Kontrollit

a. Vendosja e objektivave

Në zbatim të kapitullit e III të Manualit të MFK mbi detyrimet në lidhje me Deklaratën e misionit dhe vizionit, në Rregulloren e brendshme të institucionit, neni 5 përcaktohet se "*ZVAR ka për mision zbatimin e politikave në fushën e arsimit parauniversitar dhe realizimin e qëllimeve që rrjedhin prej tyre duke mundësuar sigurimin e një sistemi arsimor cilësor që mundëson zhvillimin e plotë dhe t gjithëanshëm të individit, shanse të barabarta, si dhe formimin e cdo individi në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes për te gjithë nxënësit e institucioneve arsimore të qytetit të Tiranës".*

b. Etika personale dhe profesionale.

ZVAP Tiranë nuk disponon një kod etik, por çështjet lidhur me etikën në këtë institucion janë trajtuar në nenin 39 "Etika" të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ZVAP Tiranë.

c. Struktura organizative

Struktura organizative ë ZVAP Tiranë është miratuar sipas Urdhrit nr. 234, datë19.4.2019 të Ministrit të Arsimit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar*". dhe urdhrit nr.176, datë 01.07.2020 të Ministrit të Arsimit, "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit paauniversitar"* me një strukturë prej 30 punonjësish. Nga auditimi konstatohet se deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, ekzistojnë **10 vakanca** krahasuar me strukturën e planifikuar për njësinë. Zhvillimi i veprimtarisë në një institucion me 2/3 e kapacitetit të stafit, cënon performancën dhe objektivat institucional. ZVAP Tiranë nuk disponon plane të trajnimeve apo një regjistër për kualifikimin periodik të stafit, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin profesional të punonjësve, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.3/1, nënçështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr.108, datë 17.11.2016. Si rezultat i mungesës së trajnimeve në këto fusha,stafi ekzistues rezulton të ketë njohuri të pakta lidhur me dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, duke cënuar kështu efikasitetin dhe eficencën e punës në kuadër të menaxhimin të fondeve publike. Në strukturën organizative të ZVAP nuk ekziston pozicioni i sekretares dhe arkivistes. Në rregulloren e brendshme të institucionit, neni 15 ka parashikuar në strukturë "Specialist që mbulon edhe sekretarinë". Megjithatë, përshkrimet e pozicioneve të punës për specialistët ndahen në specialist të sektorit të monitorimit dhe kurrikulës, në kundërshtim me rregulloren. Gjithashtu, në nenin 15 të rregullores specialistja është përgjegjëse për mbajtjen e librit arshivë protokoll të institucionit, detyra këto sërish të pambuluara në strukturën e miratuar të ZVAP dhe përshkrimet e detyrave të punonjësve.

Neni 26 i rregullores së brendshme të ZVAP "Dosjet e personelit", përcakton se dosjet administrohen nga sektori i shërbimeve dhe të gjitha procedurat për plotësimin e dokumentacionit ndiqen nga Sektori i Shërbimeve. Nga auditimi konstatohet se faktikisht, në kundërshtim me rregulloren, dosjet janë administruar nga specialist i Sektorit të Kurrikulës, të cilit i është ngarkuar verbalisht kjo detyrë, pa një autorizim të titullarit.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me dispozitat e kodit të punës. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë mbikëqyren e kryerjes së detyrave të tyre nga ZVAP Tiranë.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të ZVAP Tiranë, dhe përshkrimit të pozicioneve të punës, janë përcaktuar përgjegjësitë për çdo zyrë dhe punonjës.

2. Vlerësimi i riskut

Vlerësimi i riskut rezulton të jetë pak i zhvilluar në ZVAP Tiranë. Më hollësisht, nuk është miratuar koordinatori i Riskut, Ekipi i Menaxhimit të Riskut, Rregullorja për Menaxhimit të Riskut, Regjistri i Riskut, Strategjia e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm.

3. Aktivitetet e kontrollit

Pavarësisht se në strukturën e miratuar vërehet se ekziston një ndarje e qartë e detyrave, struktura aktuale nuk i përgjigjet të gjithë funksioneve të parashikuara nga drejoria, dhe si rezultat disa detyra mbulohen nga stafi i ngarkuar në detyra të tjera sipas strukturës, trajtuar edhe më sipër. Struktura nuk ka një ndarje të veçante për IT, por një specialist i mbulon këto funksione. Dokumentacionet e dosjeve të personelit, apo procedurave të konkurrimit të drejtuesve janë të pa arkivuara në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave teknike-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".

4. Informacioni dhe Komunikimi

Titullari i ZVAP Tiranë informohet nga përgjegjësit e sektorëve, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme të brendshme. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve rezulton të paraqesë dobësi me raportimin e situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, e dokumentuar kjo edhe me mungesën e disa raporteve të monitorimit përcjellë në MASR. ZVAP Tiranë nuk disponon një email të brendshëm zyrtar dhe si rezultat punonjësit e institucionit komunikojnë me adresat e tyre personale të email-it. Institucioni nuk ka parashikuar mënyrat për mbrojtjen e të dhënave nëpërmjet sistemit të back up. Neni 27 i rregullores së Brendshme të ZVAP përcakton se përgjegjësit e sektorëve të ZVAT komunikojnë ose raportojnë me titullarin nëpërmjet memove për të gjitha problemet, propozimet, ecurinë e mëtejshme të punës. Specialistët komunikojnë me eprorët për problemet apo ecurinë e punës nëpërmjet memove.

5. Monitorimi

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut VI, paragrafi 257, nënpika 63 "Raportet e monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ku shprehimisht përcaktohet që: "Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare.." Në faqen zyrtare të ZVAP nuk janë publikuar raportet e buxhetit për vitin 2019 dhe 2020. Gjithashtu, në kundërshtim me nenin 32 të rregullores së brendshme të ZVAP Tiranë, në faqen zyrtare nuk rezulton të jetë publikuar raporti vjetor i institucionit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucionin e ZVAP Tiranë rezultojnë me mangësi të konsiderueshme, të cilat kërkojnë një vëmendje të menjëhershme për përmirësimin e çështjeve trajtuar më lart.

1. Titulli i Gjetjes:	**Problematika të konstatuara në sistemet e konstrollit të brendshëm financiar publik në DRAP Durrës**
Situata	Nga verifikimi i masave të ndërmarrja nga DRAP Durrës për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, konstatohet se përgjithësisht institucioni ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe manualit të MFK-së në hartimin e dokumenteve respektiv, por megjithatë nëse i referohemi zbatueshmërisë së tyre në praktikë, konstatohet se ka vend për përmirësim. Disa nga problematikat e identifikuara trajtohen si më poshtë: -Pyetësori, deklarata dhe raporti i gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, i përcjellë nga DRAP Durrës sipas shkresës nr. 78, prot datë 22.01.2020, pasqyron situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm, **vetëm** në këtë institucion, duke mos reflektuar një analizë me të dhëna të konsoliduara për 12 njësitë e varësisë nën juridiksionin e saj. -Autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe përshkrimeve individuale të DRAP dhe ZVAP nuk është i unifikuar, ku më hollësisht për DRAP Durrës është kryer nga DPAP, dhe në ZVAP Tiranë nga vetë titullari i institucionit. -Në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e DRAP Durrës, nuk parashikohet sektori përgjegjës për administrimin e dosjeve të personelit; nuk janë trajtuar çështje që lidhen me komunikimin e brendshëm të personelit; rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve elektronike; si dhe përgjegjësit për përditësimin e faqes së zyrtare së institucionit. -Mbledhjet e GMS zhvilluar gjatë vitit 2020 zhvilluar online nuk janë dokumentuar, duke mos disponuar minutat e takimeve dhe vendimmarrjen e tyre në asnjë rast. -Harta e proceseve të punës të DRAP Durrës dhe gjurma e auditit nuk ka reflektuar ndryshimet e udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 për rolin e DRAP Durrës në përzgjedhjen e drejtuesve të IPAP. - DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj nuk disponojnë një email të brendshëm zyrtar dhe si rezultat punonjësit e institucionit komunikojnë me adresat e tyre personale të email-it, të cilat shpesh herë shfaqin probleme. -DRAP Durrës, nuk disponon një plan dhe regjistër të trajnimeve. Gjatë periudhës objekt auditimi personeli ka realizuar vetëm një program trajnimi me vetëm 4 pjesëmarrës në të. -DRAP Durrës nuk disponon një plan për mbështetjen rezervë (back-up plans) për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit kundër humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.
Kriteri:	Rregullore e Brendshme për Orgranizimin dhe Funksionimin e DRAP Durrës, datë 29.05.2019, pika 18, germa "c", kreu IV, e VKM nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"; Ligji nr.110/2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 18, pika 1, Manuali i MFK; Pika nr. 3/1, nënçështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016.
Ndikimi/Efekti:	Mangësitë në sistemet e MFK ndikojnë në arritjetn e objektivave

	institucional, vendimmarrjen e përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive në zbatimin e tyre. Mungesa e harmonizimit të kerkesave të kuadrit rregullativ sipas së cilave funksionojnë DRAP-et dhe ZVAP-et, krijon konfuzion dhe mungesë uniteti në kompetencat e titullarëve; Mos përcaktimet e qarta në rregullore për orientimin/udhëzimin i personelit lidhur me procedurave nuk mundëson kontrollin/verifikimin e tyre; Problematika në sistemet e kontrolleve të KBFP për marjen e masave në kohë për përmirësimin e situatës.
Shkaku:	Mungesa e harmonizimit të kuadrit rregullativ sipas së cilave funksionojnë DRAP-et dhe ZVAP-et; Mangësi në hartimin rregullores së brendshme të institucionit; Mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	-Titullari i DRAP Durrës, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar në këtë raport, për të përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë

2. Titulli i Gjetjes:	**Mangësi në vendimmarrjen e ZVAP Tiranë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.**
Situata	-Nga verifikimi i masave të ndërmarrja nga ZVAP Tiranë për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm dhe përgjegjshmërinë menaxheriale të titullarit të institucionit, <u>rezultojnë të jenë kryer me mangësi detyrimet lidhur me:</u> *-ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike* *-hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave, planit dhe plan veprimit për arritjen e objektivave të institucionit.* *-vendosja e linjave të raportimit në strukturën organizative për të mundësuar kryerjen efektive të përgjegjësive.* -Raporti i sistemeve të KBFP për vitin 2018, përcjellë në MFE në vitin 2019, **nuk** rezulton të jetë përgatitur në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të MFE. Për vitin 2019, raporti nuk rezulton të jetë përgatitur. Pyetësori i vetëvlerësimit sipas ZVAP Tiranë është përcjellë elektronikisht në MFE, ku vihet re se përgjigjet e subjektit nuk pasqyrojnë situatën reale në institucion. -Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik duke mos dokumentuar asnjë mbledhje të tij. -Nuk rezulton të ketë hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm dhe Rregullorja për Menaxhimin e Riskut. -Nuk është ngritur Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Koordinatori i Riskut dhe Ekipi i Menaxhimit të Riskut, duke mos përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale për monitorimin e risqeve të institucionit. -Nuk është hartuar dhe miratuar gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit, prokurimeve, menaxhimin e aktiveve, etj. -Nuk është hartuar dhe miratuar harta e proceseve të punës dhe manualeve të proceseve të punës. -Nuk disponohen plane të trajnimeve apo një regjistër për kualifikimin periodik të stafit, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin profesional të punonjësve.

	-Nuk disponon një plan për mbështetjen rezervë (back-up plans) për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit kundër humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.
Kriteri:	Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, të ndryshuar*'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", nenet 8, 10 dhe 27/2 21/2, 10, 11 /2, 12 /3, 9.4, 16 kreut III, pika 3.1, 3.2, 4.2.9 Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr.108, datë 17.11.2016., Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinarit të menaxhimit finaniar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike". Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike",
Ndikimi/Efekti:	Sistemet e dobëta të MFK ndikojnë në arritjen e objektivave institucional, vendimmarrjen e përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive në zbatimin e tyre.
Shkaku:	Mos përmbushja e detyrimeve në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale për sisteme të forta të kontrollit të brendshëm në njësinë shpenzuese dhe monitorimin e risqeve të institucionit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Titullari i ZVAP Tiranë, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar në këtë raport, për të përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të institucionit, dhe monitorimin e risqeve.

III.2.6. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:
KLSH ka kryer në ish-Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës, auditim me objekt "*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*", për periudhën 01.07.2017 deri 31.12.2019, ku në përfundim të të cilit, me anë të Shkresës Përcjellëse nr. 1440/8, datë 30/07/2019, janë përcjellë rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit, të miratuar me anë të Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 21, datë 27.07.2019.
Në përfundim të auditimit, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 21, datë 27.07.2019, me anë të Shkresës Përcjellëse nr. 1440/8, datë 30/07/2019, janë rekomanduar gjithsej:

- 2 masa për propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.
- 16 masa organizative.
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës së rekomandimeve, subjekti duhet të informojë Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi programin e tij për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimit i mëparshëm.
Në zbatim të të nenit 30, pika 2, të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", subjekti brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, subjekti duhet ti raportojë Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, nga KLSH është kryer auditim

në bazë të Autorizimit të Kryetarit të KLSH nr. 675/2, datë 14.07.2020, në përfundim të të cilit, nga përfaqësuesit e KLSH është hartuar Akt-Verifikimi nr. 1, datë 27/07/2020.

Në zbatim të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me anë të VKM nr. 99, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar"; Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019, pika 3; si dhe Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 234, datë 19.4.2019 "Për për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar", pika 2; janë shkrirë ish-Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe krijuar Drejtoria e Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës), nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP).
DRAP Durrës, ka të përfshirë nën varësinë dhe përgjegjësinë e saj 12 Zyrave Vendorë ë Arsimit Parauniversitar (ZVAP), ndër to edhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës).

Të dy institucionet, si DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, pretendojnë se shkresa përcjellëse e dërgimit të rekomandimeve dhe raportit përfunditar nr. 1440/8, datë 30/07/2019, **nuk ka mbërritur në institucionet e tyre**.
Pas njoftimit për fillimin e auditimit për zbatimin e rekomandimeve në zbatim të Autorizimit nr. 675/2, datë 14.07.2020, DRAP Durrës me anë të shkresës nr. 954 prot, datë 13/07/2020, drejtuar Postës Shqiptare SHA (Drejtorisë së Përgjithshme) dhe Filialit të Postës Shqiptare Durrës, i kërkon verifikimin mbi adresën e dërgimit të shkresës së KLSH nr. 1440/8, datë 30/07/2019.
Me anë të shkresës nr. 369/1, datë 20.07.2020 "Kthim përgjigje", Filili i Postës Durrës, ndër të tjera informon se:

U kontrolluan Regjistrat e objekteve të porositura dhe korrespondenca e datave 01.08.2019 deri më 10.08.2020 dhe na rezulton se nuk kemi asnjë objekt me këtë numër protokolli.

Drejtoria e Përgjithshme e Posta Shqiptare SHA, me anë të shkresës nr. 1916/1, datë 23.07.2020 "Kthim përgjigje kërkesës së datës 13.07.2020", ndër të tjera informon se:

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga ju, gjatë verifikimeve të bëra në sistemin informatik të Postës Shqiptare, rezulton se shkresa nr. 1440/8 prot, datë 30.07.2019, e depozituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në zyrën postare nr. 5, Tiranë, është adresuar vetëm për Ministrinë e Arsimit Tiranë dhe z. V. L me banim në Tiranë.
Shkresa është procesura me barkodet respektive RR603996025AA dhe RR605561936AA dhe objektet postare janë dorëzuar në destinacionet përkatëse.

Si rezultat i mos marrjes së shkresës së KLSH, nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës), nuk është kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi programin për realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, gërma "j", e cila përcakton se:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:
j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, ***brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës****;*

Si dhe, nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës), nuk është raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit të kërkuar prej 6 muaj, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30,

pika 2, e cila përcakton se:

2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Ecuria e zbatimit të rekomandimeve, konstatohet të jetë si më poshtë vijon:

A. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi

Janë propozuar gjithsej 2 masa për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, të zbatimi i të cilave është si më poshtë vijon:

Rekomandimi 1. Nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë: Të merren masa për shfuqizimin e Rregullores Tip, miratuar nga Ministri MASH me Udhëzimin nr. 3, datë 18.01.2011, "Rregullore për funksionimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Zyrës Arsimore", si akt i dalë në zbatim të ligjit nr. 7592, datë 21.06.1995, dispozitë e shfuqizuar dhe rënë nga fuqia, si dhe të hartojë një rregullore të re, e cila të harmonizohet me ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", dispozitat ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar publik e kontrollin e brendshëm, si dhe aspektet e veprimit të ligjit për shërbimin civil mbi miratimin e përshkrimit të vendit të punës për secilin punonjës. Kjo rregullore të miratohet nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Brenda 60 ditëve

Situata: Me anë të ndryshimeve ligjore të strukturës së organizimit të institucioneve rajonale të arsimit parauniversitar, me anë të VKM nr. 99, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", janë shfuqizuar edhe aktet ligjore të dala para kësaj date.

Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi 2: MASR të rishikojë dhe përmirësojë Udhëzimin e MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar", në lidhje me aspektet e mëposhtme:

a. Të korrigjohet kreu II, pika 2 e Udhëzimit, duke përcaktuar që gjithë dokumentet të jenë fotokopje të noterizuara për të shmangur rrezikun e abuzimit nga përdorimi i dokumentacionit fotokopje.

b. Të rishikohet pika 1 e kreut II të Udhëzimit që bën klasifikimin e dokumenteve të detyrueshme,(ku 3 nga 13 dokumentet e dosjes së aplikimit, konsiderohen si dokumente të detyrueshëm, dhe mungesa e së paku njërit prej tyre sjellin dhe s'kualifikimin) dhe duke caktuar përfundimisht listën e dokumenteve për aplikim.

c. Të qartësohen në Udhëzim procedurat e njoftimit dhe të konfirmimit nga ana e kandidatëve, pasi shumë kandidatë që banojnë në rrethe mbeten jashtë skemës së njoftimeve, sidomos në kushtet që kontaktimi dhe faktimi i kontaktimit të aplikantëve të portalit për përzgjedhjen e vendit të punës, shpesh është e vështirë të kryhet.

d. Detyrat që i ngarkohen Komisionit te Vlerësimit, sipas kreut 2/ pika 5, kreu 5 /pika 5 dhe kreu 3 pika 3, 4, 5, tejkalojnë përgjegjësitë e anëtarëve të këtij komisioni, nëse i referohemi përbërjes së tij. Më konkretisht, Komisioni përbehet nga 4 mësues, 2 përfaqësues të prindërve, 1 punonjës psiko-social. Këta anëtarë detyrohen ti përgjigjen një pune që kërkon njohuri mbi vlerësimin e dokumentacioneve ligjore, saktësi të prezantimit të të dhënave, angazhim me një kohë të konsiderueshme në proces. Këto detyra, të cilat nuk konsiderohen si kohë pune për të paguar, krahas aspekteve dhe vështirësi teknike- aspekte që zbehin ndjeshëm motivimin dhe përgjegjësinë e realizimit të procedurave nga anëtarët. Në këtë kuadër, bien pritshmëritë mbi përfitimin e një produkti efikas dhe eficent gjatë procesit.

e. Barra e vijimit të procesit që lidhen me njoftimet, kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së vendit të punës, ngarkohet thuajse totalisht mbi Kryetarin e Komisionit (punonjës i Sektorit të Kurrikulës).

f. Dokumentacioni që hartohet nga Komisioni i Vlerësimit nuk është i unifikuar dhe i standardizuar zyrtarisht. Shkresa shoqëruese, apo çdo dokument tjetër është hartuar sipas një konceptimi që nuk ka marrë një miratim zyrtar.
g. Ky proces duhet të kryhet dhe të ndiqet nga sektori që ka si detyrë funksionale Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, pasi është teknikisht e pamundur, qoftë edhe si kohë fizike të punës, që një specialist i Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë të angazhohet me një punë që kërkon minimalisht një punonjës me kohë të plotë pune (referuar ngarkesave të punës de facto që kryen komisioni). Për më tepër, ky proces nuk lidhet me përshkrimin e punës së një punonjësi të sektorit të kurrikulës.

Brenda 3-muajve

Situata: Udhëzimin i MAS nr. 38, datë 06.10.2015 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar", është shfuqizuar me anë të Udhëzimit të Ministrit të MASR nr. 13, datë 22.05.2019 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë"".
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

B. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 1: Drejtori i DARD të ngrejë një grup pune për të rakorduar me organet e vetëqeverisjes vendore dhe kryer procedurat e transferimit në përputhje me ligjin dhe pas saktësimit të kësaj situate, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme të kryejë sistemimet në kontabilitet dhe reflektojë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare të vitit 2019, për efektet e këtyre transferimeve.

Deri me 30 gusht 2019

Situata: ZVAP Durrës, me anë të shkresës nr. 1448, datë 26.08.2020, ka njoftuar Bashkinë Durrës për rekomandimin e lënë nga KLSH dhe ka konfirmuar gadishmërinë e ZVAP Durrës për zbatimin e këtij rekomandimi duke përcaktuar si person kontakti përgjegjësin e sektorit të shërbimeve z. B.G..
Bashkia Durrës, me anë të shkresës nr. 10803/1, datë 22.09.2020, drejtuar Sektorit të Pronrave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Qendrës Ekonomik të Arsimit Durrës, si dhe për dijeni ZVAP Durrës, i ka informuar se koordinimi duhet të kryhet ndërmjet këtyre institucioneve, si dhe i kërkon për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Rekomandimi 2: Për një pasqyrim te drejtë ne kontabilitet te vlerës se tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim te DARD bëhet domosdoshmëri vlerësimi nga ana e ekspertëve vlerësues të pavarur; azhurnimi, dhe pasqyrimi në kontabilitetin e institucionit i vlerave të pasurive zotëruese respektive, kjo në referencë të hartës së vlerës se tokave, të miratuar sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016.

Deri më 30 shtator 2019

Rekomandimi 3: Pas rakordimit me organet e qeverisjes vendore për objektet shkollore në administrimin e tyre dhe saktësimit të sipërfaqeve të tokave dhe trojeve në administrim të DARD, të kryhen përllogaritjet dhe pasqyrohen në kontabilitet efektet financiare sa sipër.

Deri më 30 shtator 2019

Situata: ZVAP Durrës, me anë të shkresës nr. 1393, datë 20.08.2020, i është drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për verifikimin e pronave që kjo zyrë ka. Me shkresën nr. 9393/1, datë 11.09.2020 "Kthim përgjigje", ASHK e informon ZVAP Durrës, se godina e këtij institucioni është në ronësi të Bashkisë Durrës.
Zbatimi i këtyre rekomandimeve, do verifikohet pas hartimit të pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2020.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimet janë në proces zbatimi.

Rekomandimi 4: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve te inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27/12/2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, bazuar në listën e aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe kritereve për vlerësimin e aktiveve. Të dokumentohen gjithë hapat e procesit për dhënien në përdorim / tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ose dhënien në përdorim a tjetërsimin e aktiveve në referencë të paragrafit 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave.

Brenda një muaji

Situata: Procesi i inventarizimit për vitin 2020, akoma nuk ka filluar në ZVAP Durrës.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Rekomandimi 5: Nga strukturat e menaxhimit të DARD të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, të ndjekin gjurmën e auditimit duke u shoqëruar me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, vend ndodhjen e groposjes së tyre, asgjësimin etj, shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

Vazhdimisht

Situata: Procesi i inventarizimit për vitin 2020, akoma nuk ka filluar në ZVAP Durrës.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Rekomandimi 6: DAR Durrës, të marrë masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit dhe Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Vazhdimisht

Rekomandimi 7: DAR Durrës të rishikojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioriteteve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion, në zbatim të neneve 10 dhe 21, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Vazhdimisht

Situata: Me anë të Urdhrit nr. 7/2, datë 17.02.2020, drejtori i ZVAP Durrës ka ngritur grupin e punës për hartimin e regjistrimit të riskut, të përbërë nga J.M. (drejtor i ZVAP Durrës), B.G. dhe R.H..
Ndërsa me anë të Urdhrit nr. 57, datë 19.10.2020, ka ngritur Grupin për Menaxhimin Strategjik, të përbëra nga J.M., B.G. dhe M.L..
Deri më datë 06.11.2020, datë në të cilën përfundoi auditimit, nga ZVAP Durrës, nuk u vu në dispozicion informacion dhe dokumentacion mbi rezultatet e grupit të punës.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimet janë në proces zbatimi.

Rekomandimi 8: Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore në DARD, gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të argumentojnë mosrealizimin e produkteve dhe të parashikojnë masat që duhen ndërmarrë në të ardhmen për realizimin e tyre. Institucioni të marrë masa për dorëzimin e raporteve 4-mujore të monitorimit në Ministrinë e linjës si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare, referuar Udhëzimit të sipërpërmendur.

Periodikisht, çdo katër mujor

Situata: ZVAP Durrës ka dorëzuar në mënyrë periodike raportet e monitorimit në MASR.
Ndërsa për procesin e argumentimit të mos realizimit dhe marrjen e masave rregulluese, nuk u vu në dispozicion informacion dhe dokumentacion nga ZVAP Durrës.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.
Rekomandimi 9: Nga ana e DARD, në bashkëpunim me DAP dhe MASR, të fillojnë procedurat për rekrutimin e stafit në pozicionet vakante në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë, në Sektorin e IT-së, si dhe në Sektorin e Programim Zhvillimit.

Menjëherë

Situata: Nga auditimi konstatohet se ZVAP Durrës ka 2 pozicione vakante. Rekomandimi nuk mund të zbatohet nga ZVAP Durrës, por nga DPAP.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi nuk është zbatuar.
Rekomandimi 10: Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, të marrë masa që listë prezencat mujore për punonjësit e saj dhe personelin e shkollave të arsimit para universitar në varësi, të përpilohen duke pasqyruar prezencën e mësuesve dhe punonjësve të shkollave për çdo ditë kalendarike të muajit.

Vazhdimisht

Situata: ZVAP Durrës ka hartuar modelin e listëprezenncës në punë të punonjësve, si dhe ka kërkuar zbatimin e këtij modeli nga drejtuesit e IAP.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi është zbatuar.
Rekomandimi 11: DARD të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve personale të nëpunësve dhe arsimtarëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe manualit "Mbi arkivimin e dokumenteve" dhe aktet e tjera që normojnë këtë proces.

Brenda muajit korrik 2019

Situata: Nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, nuk u vu në dispozicion dokumentacion dhe informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi nuk është zbatuar.
Rekomandimi 12: Institucioni të marrë masa për të gjitha rastet e kryerjes së shpenzimeve për shërbime, të përpilojë rregullisht dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton kryerjen efektive të shërbimit, apo marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës. Në të gjitha rastet, procesverbali i realizimit të shërbimit të nënshkruhet rregullisht nga komisioni, duke e bashkëlidhur me faturën e furnitorit, situacionet e shpenzimeve për shërbimet dhe riparimet, dhe dokumentuar në përputhje me kërkesat e parimet e menaxhimit financiar publik.

Vazhdimisht

Situata: Zbatimi i këtij rekomandimi është në vazhdimësi. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se mungonin disa Urdhër-Shpenzime, të cilat nuk gjendeshin nga përfaqësuesit e ZVAP Durrës.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi është në proces zbatimi.
Rekomandimi 13: Nga DAR Durrës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të merren masat e duhura për identifikimin dhe parashikimin e nevojave për trajnim si dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve në përputhje me kërkesat e ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Mbi këtë bazë të programohen dhe kryhen trajnime e seminare, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, veçanërisht mbi aspektet e analizës së menaxhimit të riskut, menaxhimit të buxhetit dhe aktiveve në dispozicion, prokurimin publik elektronik, si dhe të gjitha detyrimet e tjera, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Në vazhdim

Situata: Nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, nuk u vu në dispozicion dokumentacion dhe informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi nuk është zbatuar.
Rekomandimi 14: Të sigurohet pjesëmarrja në këto trajnime të drejtuesve të programeve

buxhetore, drejtuesve të njësive shpenzuese, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues, drejtuesve të shkollave si dhe specialistëve të tjerë. Detyrimi për trajnimin e stafit dhe drejtorëve të shkollave mbi aspektet e menaxhimit financiar bëhet i domosdoshëm, për faktin se ato autorizojnë pagesat e mësuesve për orët mësimore sipas normës së miratuar dhe ato mbinormë, shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, subvencionimin e teksteve shkollore për kategoritë vulnerabël, etj.

Në vazhdim

Situata: Nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, nuk u vu në dispozicion dokumentacion dhe informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Rekomandimi 15: DARD të përgatisë manualin e proceseve të punës, bazuar në modelimin dhe formatet standarde të lëshuara nga struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave, për të asistuar institucionet për ta realizuar këtë proces.

Në vazhdim

Situata: Nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, nuk u vu në dispozicion dokumentacion dhe informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Rekomandimi 16: Drejtori i DAR Durrës dhe njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të koordinojë veprimet dhe miratojnë përshkrimet e punës tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Departamentin e Administratës Publike, në përputhje me kërkesat e pikës 18, germa "c", kreu IV, të VKM nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" si dhe pikës nr. 4.1.1, kreu IV, të Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 2, datë 7.4.2014 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

Brenda 60 ditëve

Situata: Me ndryshimet ligjore të strukturave të ish-DAR, përshkrimet e punës janë miratuar me anë të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të DPAP, nr. 4699/1, datë 30.04.2019, të miratuar nga Ministri i ASR.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomanimi është zbatuar.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Rekomandimi 1: DARD të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për ekzekutimin vendimeve gjyqësore, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, pasi u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, ku përfshihen dhe tarifat përmbarimore e shpenzimet gjyqësore dhe të mos lejojë kryerjen e pagesave të kësaj kategorie pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për vendimmarrjet e gabuara të largimit të padrejtë nga puna.

Në vazhdim

Situata: Nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, nuk u vu në dispozicion dokumentacion dhe informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Rekomandimi 2: DARD të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shenzuara për këtë shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit

Në vazhdim

Situata: Nga DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, nuk u vu në dispozicion dokumentacion dhe informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.
Komenti i Grupit të Auditimit: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Si konkluzion:
Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. *Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 2 rekomandime, të cilat janë zbatuar.*
b. Janë rekomanduar ***16 masa organizative***, nga të cilat janë zbatuar 2 masa, nuk janë zbatuar 5 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, si dhe janë në proces zbatimi 8 masa.
c. Janë rekomanduar ***2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike***, masa të cilat nuk janë zbatuar.

1. Titulli i gjetjes:	Dërgimi i planit të zbatimit të rekomandimeve.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës me shkresën nr. 1440/8, datë 30/07/2019, konstatohet se: DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës), nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi programin për realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", neni 15, gërma "j".
Ndikimi/Efekti:	Mos raportim në KLSH mbi planet dhe programet për realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.
Shkaku:	Mos-arritja e shkresës nr. 1440/8, datë 30/07/2019, në zyrat e DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandime:	Drejtori i DRAP Durrës dhe Drejtori i ZVAP Durrës, të marrin masa për për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

2. Titulli i gjetjes:	Raportimi në KLSH mbi realizimin e rekomandimeve.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës me shkresën nr. 1440/8, datë 30/07/2019, konstatohet se: DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës), nuk kanë raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit të kërkuar prej 6 muajsh.
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", neni 30, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Mos raportim në KLSH mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, brenda afatit 6-mujor.
Shkaku:	Mos-arritja e shkresës nr. 1440/8, datë 30/07/2019, në zyrat e DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandime:	Drejtori i DRAP Durrës dhe Drejtori i ZVAP Durrës, të marrin masa për për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

3. Titulli i gjetjes:	Realizimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Situata:	Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës me shkresën nr. 1440/8, datë 30/07/2019, konstatohet se: **a.** *Për përmirësimin e* ***dispozitave ligjore*** *dhe nënligjore janë lënë 2 rekomandime, të cilat janë zbatuar.* **b.** Janë rekomanduar ***16 masa organizative***, nga të cilat janë zbatuar 2 masa, nuk janë zbatuar 5 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, si dhe janë në proces zbatimi 8 masa. **c.** Janë rekomanduar ***2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike***, masa të cilat nuk janë zbatuar.
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", neni 15, pika c.
Ndikimi/Efekti:	Zbatimi i plotë i rekomandimeve do të ndikojë në përmirësimin e aktivitetit të DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës.
Shkaku:	Mos-arritja e shkresës nr. 1440/8, datë 30/07/2019, në zyrat e DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandime:	Drejtori i DRAP Durrës dhe Drejtori i ZVAP Durrës, të marrin masa për për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se përcaktimet e VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 dhe Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, sa i takon kompetencave për emërimin e drejtorëve të IAP-ve (Institucionet e Arsimit Parauniversitar), bien në **kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar, pasi këto kompetencat **rezultuan të pa harmonizuara** mes akteve respektive. Më hollësisht:

Referuar Ligjit nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin 48/2018, neni 55, pika 1, përcaktohet se: "*Drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit*."

Neni 21, i ligjit nr. 48/2018, përcakton se: *"(....) emërtimi njësive arsimore vendore, zëvendësohet me emërtimin "institucion arsimor vendor", përgjegjës për arsimin parauniversitar.*"

Sipas sa më sipër, atributet e përcaktuara në ligj për njësinë arsimore vendore, në kushtet kur nuk ka patur një ndryshim tjetër në ligj, do t'i kalojnë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Me ndryshimin e ligjit 48/2018, në nenin 8 të tij përcaktohet se "*Neni 30 shfuqizohet"*. Ky nen kishte të përcaktuara përkufizimin dhe përbërjen e njësisë arsimore vendore, si më poshtë:

"1. *Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitë arsimore vendore, të cilat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e tyre miratohen me urdhër të Kryeministrit.*

2. Njësitë arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi.

3. Njësia arsimore vendore është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj."

Nga auditimi rezultoi se, pas shfuqizimit të këtij neni, **nuk është bërë rishikimi i këtyre përcaktimeve në ligj**, dhe si pasojë as reflektimi i këtyre ndryshimeve në organizimin i njësive arsimore vendore, duke lënë të paqartë se kush në fakt do të konsiderohet "institucion arsimor vendor".

Për të verifikuar se kujt aktualisht i referohet ky term, grupi i auditimit konstatoi se, sipas VKM-ve, dhe urdhrave të MASR për mbylljen e disa shkollave në periudhën 2019-2020, është përcaktuar se: "*këto shkolla duhet të vendosin në dispozicion të **institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar**, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e kërkesave....*".

Gjithashtu në VKM-të dhe urdhrat respektive të MASR përcaktohet se: "***Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar,** nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla ka për detyrë të ngrejë grup pune 3 ditë nga hyrja në fuqi e vendimit..."*. Për sa më sipër, ngritja e grupit të punës dhe dorëzimi i dokumentacioneve nga shkolla është bërë në ZVAP-et nën juridiksionin e të cilave ndodhet shkolla.

Pra konkluduam se, në urdhrat apo VKM-të përkatëse, referenca për "**Institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar" në çdo rast i bëhet ZVAP-eve.**

Në vijim, sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*" çështja 3, pika 11, përcakton se: "***Drejtorët e drejtorive rajonale** emërojnë drejtorët e institucioneve arsimore*

publike, sipas ***udhëzimit përkatës të ministrit*****".**
Kjo VKM është hartuar **në kundërshtim** me ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar, pasi në dallim me ligjin i cili përcakton se është pikërisht **titullari i institucionit arsimor vendor ai që emëron drejtorët arsimor, në VKM nr. 99, datë 27.02.2019, këto kompetenca i kalojnë titullarëve të drejtorive rajonale.**
Gjithashtu, në periudhën e miratimit të VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019, në fuqi ishte Udhëzimin i Ministrit Nr. 57, datë 12.11.2013 "*Për Procedurat e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*", sipas çështjes E[50] të të cilit, emërimi i drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit parauniversitar, bëhej nga **Titullari i Njësisë Arsimore Vendore**.
Për periudhën 27.02.2019-28.01.2020 konstatojmë se, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 bie në **kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrit nr. 57, datë 12.11.2013, lidhur me procedurën e emërimit të drejtorit të IPAP.
Me daljen e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, "*Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*", i cili shfuqizoi Udhëzimin e Ministrit Nr. 57, datë 12.11.2013, procedura e emërimit të Drejtorit të IPAP përcaktohet në çështjen D, për tu kryer nga **drejtori i DRAP**, pra udhëzimi nr. 2 është rishikuar dhe hartuar në vijim të VKM-së, që rrjedhimisht e bën atë në kundërshtim me ligjin.
Si rezultat i sa më sipër, konkludojmë se rezultojnë **në kundërshtim** me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar:
- 50 emërimet e përkohshme të kryera nga DRAP Durrës për periudhën 2019-2020; dhe
- 69 procedurat e konkurrimit të ndjekura për emërimin definitiv të drejtorëve të shkollave të IPAP-ve, sipas Shpalljes nr. 1 dhe Shpalljes nr. 2, të kryera dhe të shpallura nga DRAP Durrës gjatë periudhës maj 2019-gusht 2020

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP të bëjnë propozimet e nevojshme ligjore pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), për harmonizimin e Ligjit nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar "*Për Procedurat e Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*", si dhe me akte të tjera nënligjore të hartuara në vijim dhe zbatim të tyre, lidhur me strukturën përgjegjëse për emërimin e drejtorëve të IPAP.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

1.2 Rekomandimi: MASR të marrë masat për ngritjen e grupit të punës, dhe kryerjen e rishikimeve të nevojshme të akteve ligjore dhe rregullatore, me qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, lidhur me strukturën përgjegjëse për emërimin e drejtorëve të IPAP, në vijim të konstatimeve trajtuar më sipër.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të rekrutimit, rezultoi se, në kreun I, shkronja C, pika 12 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcaktohet se "*Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të ZVAP dosjet e aplikimit dhe vlerësimin me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e shkollës*.".
Në vijim, sipas Kreut I, shkronja D, pika 1 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, përcaktohet se "*Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës*

[50] "*Procedura e Emërimit të Drejtorit nga Titullari i Njësisë Arsimore Vendore*"

teknike"
Sipas pikës 2 "*Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP*".
Nga sa më sipër, në kushtet kur në ZVAP dorëzohen vetëm dy dosjet e kandidatëve me pikët me të larta (dhe jo të të gjithë aplikantëve), vendimmarrja e ZVAP-së (punonjësit të autorizuar) mbetet e cënuar, pasi ai gjykon vetëm mbi dosjet që i dorëzohen dhe jo mbi të gjithë dosjet e aplikantëve pjesëmarrës. Për më tepër që, në vijim të sa dikton udhëzimi nr. 2, date 28.01.2020, mbetet e paqartë se mbi ç'kritere "të natyrës teknike" punonjësi i autorizuar i ZVAP-së shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e kandidateve, çka mbart riskun që ky proces vlerësimi të jetë subjektiv dhe i pa standardizuar. Nga ana tjetër vumë re se, roli i titullarit të ZVAP-së në këtë proces të rëndësishëm, mbetet në kufijtë e përcjellësit të dokumentacionit më tej në DRAP, duke mos garantuar përfshirjen dhe përgjegjësinë e tij për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit me qëllim sigurimin e cilësisë së shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor. Referuar shkronjës a, të pikës 2, të nenit 32 të *Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversita*r, të Ministrit të MASR-së, datë 30.04.2019, mbetet në kompetencën e titullarit të ZVAP, kontrolli dhe garantimi i përmbushjes së misionit, objektivave dhe detyrimeve të ZVAP siç është edhe shqyrtimi i vendimmarrjes së komisionit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: DRAP në bashkëpunim me DPAP të propozojnë pranë MASR, rishikimin e Udhëzimit nr. 2, në mënyrë që komisioni i vlerësimit t'i kalojë për shqyrtim ZVAP-it, jo vetëm dy dosjet e kandidatëve me më shumë pikë, por të gjithë dokumentacionin e procedurës, për të siguruar kështu vlerësimin e të gjithë praktikës së ndjekur nga komisioni i vlerësimit, me qëllim rritjen e kontrolleve të brendshme dhe efektivitetit të procedurave të rekrutimit.

Brenda 3 mujorit të II-të 2021

2.2 Rekomandimi: Me qëllim garantimin e kryerjes së një procesi efektiv të rekrutimit si dhe përfshirjen e të gjitha palëve përkatëse në këtë proces, **MASR** të rishikojë pikën 1 të shkronjës D, Kreu I të Udhëzimit nr. 2, të ndryshuar, mbi sektorin apo personin përgjegjës në ZVAP për rishqyrtimin e procedurës së ndjekur nga komisionet e vlerësimit, duke parashikuar ngritjen e një grupi pune në përbërje, të të cilit të jetë edhe Drejtuesi i ZVAP, nga i cili gjykojmë se nevojitet miratim dhe jo thjesht përcjellje e dokumentacionit, në përmbushje të misionit dhe objektivave të vetë ZVAP-së.

Brenda 3 mujorit të II-të 2021

C. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të emërimit të punonjësve në DRAP Durrës, të konsultuar nga grupi i auditimit, janë konstatuar një numër i lartë vakancash në stafin e 12 ZVAP-eve dhe DRAP Durrës (deri në përfundim të periudhës objekt auditimi vakancat rezultojnë në masën 21%), ku në disa raste ato kanë vijuar të tilla për periudha kohore të gjata, duke cënuar vijueshmërinë e punës në këto institucione dhe duke përbërë risk për realizimin e objektivave. Nga auditimi rezultoi se për një periudhë rreth 2 vjeçare (që prej miratimit të VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 e deri më sot), rreth **98% e stafit** të DRAP dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj, vijon të jetë i **komanduar,** duke nisur që prej Drejtorit të DRAP Durrës, e deri tek punonjësit e ZVAP-ve, edhe pse në urdhrat e emërimit të përkohshëm të pozicioneve në punë nga Drejtori i Përgjithshëm i DRAP përcaktohet se komandimi do të jetë i përkohshëm deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet përkatëse. Vetëm emërimi i 8 drejtorëve të ZVAP

Tiranë, Kavajë, Durrës, Krujë, Kamëz, Klos, Mat, Bulqizë ka qenë definitivë.
Referuar Urdhrit të Ministrit, Nr. 454, datë 13.09.2019, emërimi i Drejtuesit të DRAP-së, Nëpunësit të DPAP-së, Nëpunës/Punonjës i DRAP-së, Nëpunës/Punonjës i Zyrave Vendore bëhet nëpërmjet **konkurrimit të hapur.** Gjithashtu, kjo rregullore përcakton qartë të gjitha hapat për emërimin e punonjësve të DRAP, duke filluar nga plani vjetor i nevojave të pranimeve, shpalljen e konkurrimeve, procedurat e konkurrimit në dy faza (faza 1: verifikimi i dosjeve të kandidatëve; dhe faza 2: testi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë), deri në vlerësimin përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit fitues.
1.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi **se në 6 ZVAP** me 285 institucione arsimore nën juridiksionin e tyre, aktualisht **janë të komanduar 78 drejtues (ose 27%)**, ndërsa 207 drejtues të tjerë janë të emëruar definitivisht (ndërkohë që aktualisht edhe këta **nuk** plotësojnë kriteret ligjorë pasi **nuk** janë të pajisur me certifikatën e shkollës se drejtorëve). Konkretisht:
- ZVAP Tiranë rezulton me **30** drejtues të komanduar, nga 138 drejtues gjithsej (22%), ku pas përfundimit të procedurave të emërimit, vetëm **5** prej tyre janë emëruar në pozicion pune definitive. Nga auditimi konstatohet se për **7 raste**, në ZVAP Tiranë në kundërshtim me pikën C.1, Kreu I të udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013, drejtori i institucionit arsimor të larguar nga detyra, **nuk** është zëvendësuar nga nën drejtori i vetë shkollës, edhe pse shkolla ka patur nën drejtor në momentin e komandimit të drejtuesve respektim. Për **3 raste**, në shkollat në të cilat nuk ka patur nën drejtora në strukturat organizative, pas largimit të drejtuesit të institucionit arsimor, **nuk** është zëvendësuar me një mësues të institucionit, në kundërshtim me pikën C.1, Kreu I të udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013
- ZVAP Kavajë, rezulton me **13** drejtues të komanduar nga 25 drejtues gjithsej (52%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, vetëm **1** prej tyre është emëruar në pozicion punë definitiv.
- ZVAP Durrës, rezulton me **10** drejtues të komanduar nga 55 drejtues gjithsej (18%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, vetëm **2** prej tyre janë emëruar në pozicion pune definitiv.
-ZVAP MAT, rezulton me **9** drejtues të komanduar nga 12 drejtues gjithsej (75%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, vetëm **1** prej tyre është emëruar në pozicion pune definitiv.
-ZVAP Bulqizë rezulton me **10** drejtues të komanduar nga 17 drejtues gjithsej (59 %) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, procesi nuk ka konkluduar për asnjë kandidat në emërim pozicion pune definitiv.
-ZVAP Dibër rezulton me **6** drejtues të komanduar nga 38 drejtues gjithsej (16%) ku, pas përfundimit të procedurave të emërimit në vitin 2020, procesi nuk ka konkluduar për asnjë kandidat në emërim pozicion pune definitiv.
Në gjykimin e grupit të auditimit, për shkak se nuk janë kryer procedurat e konkurrimit, plotësimi i strukturës me anë të komandimeve (situatë kjo që konstatohet që nga niveli i Drejtorit të DRAP Durrës, i punonjësve të ZVAP-ve deri tek niveli i drejtuesve të IPAP, pa u zhvilluar procedurat e hapura të konkurrimit sikurse e parashikojnë aktet ligjore në fuqi), **nuk** siguron kompetencën e stafit për pozicionet në të cilat janë komanduar, si dhe mbart **riskun** për mos realizimin e objektivave të punës, mos ofrimin apo mos sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar. Nga ana tjetër, për shkak të mungesës së kontratave të emërimit definitiv, të qenit të komanduar përmban risk për punonjësit aktual të kësaj njësie, pasi nuk ofron siguri për vijimësinë e tyre në punë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Ministri i MASR dhe Drejtori i DPAP të marrin masat e nevojshme për plotësimin e strukturave të miratuara të DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-ve nën juridiksionin e saj, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur në zbatim të VKM nr. 99, datë 27.02.2019, Kreu

III, pikat 13 dhe 14.

Brenda vitit 2021

1.2 Rekomandimi: DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP të ndërmarrin masat e nevojshme për emërimin definitive të drejtuesve të IPAP nën juridiksionin e DRAP Durrës nëpërmjet procedurave të hapura të konkurimit, në rastet kur këto pozicione janë plotësuar me staf të komanduar.

Brenda vitit 2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentet e vëna në dispozicion grupit të auditimit konstatohet se pas ristrukturimit, drejtori i ish- DAR Durrës nuk ka bërë dorëzim të detyrës në momentin e lirimit nga detyra, në kundërshtim me pikat 27, 28, 29, 30 të Kreut III, të VKM nr. 124, datë 17.02.2016, i ndryshuar. Si pasojë e sa më sipër:
-Nuk sigurohet vazhdimësia e punës së bërë nga kjo strukturë duke shkaktuar mungesë eficiencë;
-Nuk sigurohet një pamje e qartë dhe e saktë mbi dokumentacionin dhe mjetet e punës në përdorim dhe atyre të dorëzuara pas ristrukturimit;
-Si rezultat i mos dorëzimit të detyrës, në procedurat e marra në shqyrtim nga grupi i auditimit për emërimin definitiv nëpërmjet konkurrimit të hapur të drejtorëve të dy shkollave: "Adem Sabli" dhe "Isa Domi", sot nën juridiksionin e ZVAP Shijak, **nuk gjenden dosjet** e procedurës së ndjekur nga ish-DAR Durrës për përzgjedhjen dhe emërimin e tyre.
-Ekziston risku që të mungojnë dokumentacione apo dosje të tjera të cilat nuk janë përzgjedhur për tu audituar nga grupi i auditimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: DPAP, në bashkëpunim me DRAP Durrës dhe ZVAP nën juridiksionin e DRAP, të ndërmarrin masat e nevojshme për identifikimin e dokumentacionit dhe mjeteve që kanë qenë në përdorim nga ish-DAR Durrës dhe ish-DAR-et e tjera, dhe tani janë në përdorimin të ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës. Në rast se ekzistojnë diferenca, të përcillet kërkesa për dorëzimin e tyre në strukturat e reja të ndërtuara pas ristrukturimit.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

2.2 Rekomandimi: DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës, ZVAP Shijak dhe Durrës të ndërmarrin masat e nevojshme për gjetjen e dosjeve të procedurave të ndjekura për emërimin definitiv të drejtorëve të dy shkollave "Adem Sabli" dhe "Isa Domi", sot nën juridiksionin e ZVAP Shijak. Në rast se ato nuk gjenden, të rishqyrtohet emërimi i drejtorëve të dy shkollave në fjalë.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

2.3 Rekomandimi: DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për mosdorëzimin e detyrës nga Ish- DAR Durrës.

Brenda 3-mujorit të I-rë 2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ZVAP-ve Tiranë, Durrës, Dibër, Mat, Kavajë, Bulqizë, Shijak konstatohet se ZVAP Durrës, Dibër dhe Bulqizë nuk kanë një faqe zyrtare web në kundërshtim me nenin 37, të rregullores së MASR-së "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" dhe rrjedhimisht, në kundërshtim me pikën 3, shkronjën A të Kreut I, të Udhëzimit nr 2, datë 28.01.2020, këto ZVAP-e **nuk** kanë publikuar Shpalljet për vendet e lira në pozicionin drejtor shkolle në faqe zyrtare. Në ZVAP Dibër, **3 nga 6** konkurrimet e hapura për pozicionin drejtor shkolle sipas Shpalljes 1, dhe **3 nga 5** sipas Shpalljes 2; në ZVAP Durrës, **4 nga 7** konkurse të hapura sipas Shpalljes 2; dhe në ZVAP Bulqizë, **1 nga 2** konkurse e hapura sipas Shpalljes 1 dhe **1** konkurrim i hapur sipas Shpalljes 2, rezultuan të jenë

anuluar si rezultat i mungesës së kandidatëve. Mungesa e një faqeje web-i, në të cilën duhet të publikoheshin shpalljet për vendet e lira në pozicion drejtor shkolle në ZVAP-et Durrës, Dibër dhe Bulqizë ka ndikuar negativisht në numrin e aplikantëve për këto konkurse, si dhe mbart risqe të cënojë parimin e transparencës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: DRAP Durrës në bashkëpunim me ZVAP Durrës, Dibër dhe Bulqizë të parashikojnë buxhetin për të ngritur faqet web të këtyre ZVAP-ve, dhe të marrin masat për kryerjen e publikimit të shpalljeve që lidhen me shkollat nën juridiksionin e tyre, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes së gjerë të kandidatëve të interesuar për to.

Brenda vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në vijim të Kreut I, shkronja C, pika 6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, ku përcaktohet se*: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP",* rezulton se 13 punonjës që ka DRAP + 21 punonjës që janë në organikën e miratuar të DPAP-së, do të duhej të angazhoheshin në të njëjtën kohë, në 32 procedura të çelura njëherazi sipas Shpalljes nr. 1 dhe 37 procedura të hapura njëherazi sipas Shpalljes nr. 2. Nga përllogaritja del qartë se me **34 punonjës në total të DPAP dhe DRAP Durrës** do të ishte **e pamundur** përfaqësimi i këtyre institucioneve në **32 konkurse** të cilat do të zhvilloheshin njëherazi sipas shpalljes 1 dhe **37 konkurse** të cilat do të zhvilloheshin njëherazi sipas shpalljes 2.
-Në total, në **69** konkurset e hapura për vendet e lira drejtor shkollë, kanë marrë pjesë vetëm **11 përfaqësues të DRAP Durrës**.
-Nga auditimi konstatohet gjithashtu se, në 20 procedura të zgjedhura (midis 69 të zhvilluara gjithsej gjatë periudhës nën auditim), nga 7 përfaqësues që kanë marrë pjesë në procedurat e zgjedhura, **vetëm 3** janë punonjës të DRAP Durrës, pasi 2 janë punonjës të ZVAP-ve dhe 2 janë mësues të IPAP, në kundërshtim me pikën 6, shkronja C, Kreu I i Udhëzimit nr. 2, ku theksohet se në konkurset për vendet e lira për pozicioni drejtor të IPAP duhet të marrin pjesë përfaqësues të DPAP/DRAP.
-Nga auditimi konstatohet se në 7 raste kur përfaqësuesit e DRAP Durrës kanë marrë pjesë në konkurset për pozicionin drejtor të IPAP, **vetëm 2** prej tyre kanë mbajtur procesverbal mbi mbarëvajtjen e procesit në kundërshtim me pikën 5, të nenit 23 të ligjit nr. 111/2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" ku përcaktohet se :"*Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet **gjurma e duhur e auditimit** për vijueshmërinë dhe monitorimin*."
Mungesa e përfaqësuesve të DRAP Durrës apo DPAP në 13 procedurat e konkurrimit të zhvilluara në vijim të Shpalljeve për vendet e lirat drejtues, **nuk** ka siguruar monitorimin dhe vëzhgimin e zbatimit të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të vlerësimit të kandidatëve nga komisionet e vlerësimit. Kjo nuk ka garantuar evidentimin e parregullsive të lidhura me këto procedura, të identifikuar dhe të trajtuara nga grupi i auditimit.
Sa më sipër ka bërë që, në total 58 konkurse të kryera sipas shpalljes 1 dhe 2, në mungesë të përfaqësuesve të DPAP/DRAP Durrës të jenë në kundërshtim me kriteret e Udhëzimit nr. 2, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: DPAP në bashkëpunim me DRAP Durrës, të marrin masat e nevojshme për të përcaktuar përfaqësues në të gjitha procedurat e konkurrimit për vendet e lira në pozicionin e drejtorit të shkollës në ZVAP-të nën juridiksionin e DRAP Durrës, që do të kryhen në vijim, në

përmbushje të pikës 6, shkronjës C, Kreut I të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar; me qëllim monitorimin dhe zbatimin e kërkesave të udhëzimit nga ana e komisionit të vlerësimit, dhe përcjelljen e tyre pranë ZVAP.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

4.2 Rekomandimi: DPAP dhe DRAP Durrës të ndërmarrim masat e nevojshme që përfaqësuesit që do të marrin pjesë në procedurat e konkurrimit, të përgatisin një informacion mbi mbarëvajtjen e procesit, i cili duhet të protokollohet dhe të jetë pjesë e dosjes së procedurës së konkurimit me qëllim forcimin e sistemeve të kontrollit dhe krijimin e gjurmës së auditit.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

4.3 Rekomandimi: DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP të planifikojnë në mënyrë të kujdesshme afatet e konkurseve për vendet e lira drejtor shkolle të IPAP, në përputhje me mundësitë reale për të përcaktuar përfaqësues të tyre në këto konkurse, sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr. 2, dhe jo të kryerjes formale të tyre.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultuan problematika lidhur me vendimmarrjen e DRAP Durrës në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të IPAP. Konkretisht:
-U konstatua se: për **1 rast,** në ZVAP Bulqizë, **1 rast në ZVAP Tiranë**, **1 rast në ZVAP Mat**, **1 rast në ZVAP Durrës,** në vijim të dërgimit të dokumentacioneve nga ZVAP, DRAP Durrës nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në çështjen D, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, vendimi i DRAP në disa raste është **shpallur me vonesë** dhe në disa të tjera deri në përfundim të auditimit **nuk janë intervistuar kandidatët për t'u përzgjedhur fituesi**. Në rastin e shkollës "Shtother" në ZVAP Kavajë dhe Blicë, "Nazmi Rushiti" dhe "Dine Hoxha" **nuk ka informacion** me vijueshmërinë e procesit.
-Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se DRAP Durrës ka vepruar me dy standarde për rastet në të cilat janë konstatuar shkelje nga komisioni, duke cënuar parimin e barazisë, konkretisht: në **një rast** kur komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, DRAP Durrës **ka kërkuar masë** për kryetarin e komisionit dhe tërheqje vëmendje për përfaqësuesen e ZVAP që kishte marrë pjesë në këtë mbledhje. Ndërsa, për **2 raste** në ZVAP Tiranë, dhe **2 raste** në ZVAP Kavajë, kur nga shqyrtimi i dosjeve ZVAP-të respektive kanë kërkuar anullimin e procedurës pasi komisionet kishin vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, **nuk** evidentohet të jenë ndërmarrë **masa** nga DRAP Durrës.
-Nga auditimi konstatohet se, DRAP Durrës ka komanduar drejtore në shkollën "Hasan Prishtina", në datën 24.01.2020, një kandidate me masë disiplinore në fuqi, **në kundërshtim me** kriteret e Udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013, Kreu I, çështja B, pika ç e cila citon se "*Kandidati për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet: ç) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij*. Znj. T.D. është shkarkuar nga detyra po nga DRAP Durrës në 24.12.2019 për shkelje flagrante të udhëzimit të MASR, **dhe aktualisht disponon një masë disiplinore**, sikundër përcakton vërtetimi i DRAP Durrës i datës 20.08.2020.
Nga auditimi konstatohet se, më datë 10.04.2020 DRAP Durrës ka komanduar në pozicionin e Drejtorit të shkollës "Naim Frashëri" në Durrës z. I.P. (në atë kohë Zv. drejtor i kësaj shkolle) pas dorëheqjes së drejtorit të mëparshëm nga ky pozicioni. Sipas Urdhrit të komandimit të përkohshëm të z. I.P., ai do të qëndronte në pozicionin e drejtorit të shkollës "Naim Frashëri" deri në normalizimin e situatës nga COVID -19 dhe përfundimit të procesit të konkurrimit. Megjithatë, DRAP Durrës ka **shkarkuar** nga ky pozicion Z. I.P. dhe ka **emëruar përkohësisht** Znj. E.Xh. më datë 22.06.2020, e cila në atë periudhë ishte drejtore e shkollës "Jusuf Puka" në Durrës, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit. Pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit, znj. E.Xh. është emëruar definitivisht në pozicionin drejtor i shkollës "Naim Frashëri". Nga kontakti me

ZVAP Durrës, konstatohet se Z. I.P. nuk ka paraqitur dorëheqje për largim nga pozicioni. Në urdhrin e shkarkimit nga DRAP Durrës nuk është argumentuar kjo vendimmarrje.
Si rezultat i sa më sipër, janë shkaktuar vonesa në përzgjedhjen e kandidatëve fitues për kandidatët e institucioneve arsimore dhe mos informim i ZVAP-eve respektive mbi vijueshmërinë e procesit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Për të gjitha rastet në vijim, DRAP të respektojë afatet, me qëllim garantimin e finalizimit të procesit të përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve arsimore dhe përcjelljen e informacioneve të azhornuara mbi vendimmarrjen e DRAP.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

5.2 Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, DRAP Durrës të ndjekë të njëjtin standard në trajtimin e rasteve me shkelje nga Komisioni i Vlerësimit, duke marrë masat e nevojshme për evidentimin e përgjegjësive.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

5.3 Rekomandimi: Për të gjitha rastet në vijim, të tregohet kujdes në komandimin/emërimin e drejtuesve duke garantuar mos pasjen e një mase disiplinore në fuqi të kandidatëve respektiv.

Brenda 3-mujorit të I-rë 2021

6. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 55 të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 2, 28.01.2020, i ndryshuar, kandidati për drejtorë duhet të ketë kryer trajnim dhe të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve. Referuar Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të IPAP në Shqipëri", kuotat e kualifikimit për zhvillimin e trajnimit në Shkollën e Drejtorëve janë si më poshtë:
Viti 2019-2020 - 48 kuota për qarkun e Tiranës
Viti 2020-2021 - 192 kuota për qarkun e Tiranës, Durrësit, Elbasanit
Viti 2021-2024 - 240 kuota për të gjitha qarqet e vendit
Viti 2024 në vijim - 240-300 kuota për të gjitha qarqet e vendit.
Kandidatët që kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtues, i nënshtrohen testimit për pajisjen me certifikatë për drejtues pranë Shkollës së Drejtorëve, e ruajnë të drejtën për të dhënë provimin për dy vite, si dhe provimi mund të jepet deri në dy here.
Në krahasim me kuotat në dispozicion për certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve, në maj 2019 numri i drejtorëve të shkolla nën juridiksionin e DRAP Durrës, të cilët nuk dispononin certifikimin e Shkollës së Drejtorëve **ishte 377.** Me ndryshimin e Udhëzimit nr. 2,edhe drejtorët të cilët ishin të emëruar definitivisht, duhet të certifikohen nga Shkolla e Drejtorëve. Pra, me kuotat në dispozicion, Shkolla e Drejtorëve, do të mund të certifikonte deri në 2021 **vetëm 192 kandidatë** nga 3 qarqe, Tiranë, Durrës dhe Elbasan, ku qarku i Elbasanit nuk është nën juridiksionin e DRAP Durrës. Referuar kuotave të publikuara nga shkolla e drejtorëve, nëse të gjithë kandidatët e pranuar do të ishin nga DRAP Durrës (e cila është vetëm 1 në 4 DRAP), kualifikimi i plotë i të gjithë stafit drejtues arsimor nuk mund të arrihej deri të paktën **në vitin 2024**.
Përpara publikimit të Shpalljeve të vendeve të lira për pozicionin drejtor shkolle, më datë 30.07.2020 DPAP ka nxjerrë shkresën nr. 246 në kundërshtim me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 2 i ndryshuar, sipas të cilës, **të pasurit certifikatë apo të qenit i regjistruar në Shkollën e Drejtorëve konsiderohet prioritet dhe jo më një kriter i domosdoshëm kualifikues për vijimin e konkurrimit**. Në vijim të kësaj shkrese janë publikuar:
Shpalljet nr. 1 dt. 05.08.2020, për 32 pozicione të lira drejtor shkolle në 11 ZVAP nën juridiksionin e DRAP Durrës;

Shpallja nr. 2 dt. 19.08.2020 për 37 pozicione të lira drejtor shkolle në 11 ZVAP nën juridiksionin e DRAP Durrës;
Shpallja nr. 3 dt. 07.10.2020 për 7 pozicione të lira drejtor shkolle (6 prej te cilave janë të përsëritura nga Shpallja nr. 1) në ZVAP Tiranë.
Në këto 3 shpallje, si **kriter kualifikues** për vijimin e konkursit, është kërkuar që aplikantët të zotërojnë **certifikatën e Shkollës së Drejtorëve**, në zbatim të Ligjit nr. 69/2012 dhe Udhëzimit nr. 2.
Por, nga auditimi konstatohet se:
Në procedurat e ndjekura nga komisionit e vlerësimit dhe nga DRAP Durrës për vlerësimin e kandidatëve dhe shpalljen e fituesve, **janë pranuar dhe kualifikuar aplikantë** të cilët ishin regjistruar në Shkollën e Drejtorëve në vijim të urdhrit nr. 246, datë 30.07.2020 të DPAP, **dhe jo të certifikuar prej saj,** në kundërshtim me Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2, i ndryshuar, dhe kriteret e publikuara në Shpallje.
Për më tepër, komisionet e vlerësimit **kanë pranuar dhe kanë kualifikuar** në fazën tjetër kandidatë të cilët zotëronin vetëm e-mailin e aplikimit **dhe jo** atë të regjistrimit në Shkollën e Drejtorëve. Kjo vërehet në procedurat e ndjekura për pozicionet e lira drejtor shkolle, në të gjitha ZVAP e audituara nga grupi i auditimit: Tiranë, Durrës, Kavajë, Mat, Bulqizë dhe Dibër.
DRAP Durrës ka intervistuar dhe ka shpallur fitues kandidatë të cilët **në procedurat e konkurrimit nuk kanë paraqitur certifikatën e Shkollës së Drejtorave**, si në rastin e gjimnazit "Qemal Stafa" në Tiranë, "Nënë Tereza" dhe "Naim Frashëri" në Durrës, dhe "Aleksandër Mojsiu" në Kavajë; apo ka intervistuar dhe shpallur fitues kandidatë të cilët **vetëm kanë aplikuar** në Shkollë e Drejtorëve **dhe nuk janë regjistruar apo certifikuar prej saj**, si në rastin e shkollës Karpen në Kavajë (në vijim, është pezulluar shpallja e fituesit deri sa ky i fundit të pajiset me certifikatën e shkollës së Drejtorëve).
DPAP dhe DRAP Durrës, kanë shpallur procedurat e konkurimit, duke vendosur si kriter të domosdoshëm certifikatën e shkollës së drejtorëve, për ZVAP-et ku ky trajnim ende nuk ka nisur nga Shkolla e Drejtorave, si ZVAP Dibër, Kavajë, Mat, Bulqize, etj.
Nga auditimi rezultoi se me ndryshimin e pikës 1, të kreut III të Udhëzimit nr. 2, vërtetimi i lëshuar nga IZHA **nuk** konsiderohet më si i barazvlefshëm me certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve në konkurrimet e hapura për pozicionin drejtore shkolle. Megjithatë, Komisionet e Vlerësimit dhe DRAP Durrës e kanë trajtuar vërtetimin e lëshuar nga IZHA **si të barazvlefshëm** me certifikatën e lëshuar nga Shkolla e Drejtorëve. Më evident, ky rast është konstatuar në procedurën e konkurrimit në shkollën "Naim Frashëri" në Durrës, ku Komisioni i Vlerësimit dhe DRAP Durrës kanë pranuar dhe shpallur fitues kandidatë të cilët nuk ishin të certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, por kishin vërtetimin nga IZHA. Trajtimi i vërtetimit të lëshuar nga IZHA si të barazvlefshëm me certifikatën e lëshuar nga shkolla e drejtorëve **nuk** është përfshirë në kriteret e shpalljes, si dhe në asnjë akt rregullator në fuqi.
Pranimi dhe emërimi i kandidatëve të cilët nuk janë regjistruar në Shkollën e Drejtorëve, apo janë regjistruar, por nuk janë certifikuar prej saj, mund të shkaktojë mungesë të eficiencës në procesin e përzgjedhjes dhe emërimit të tyre dhe mund të cënojë arritjen e objektivave të punës, pasi përmban riskun që ata mund të mos pranohen në këtë shkollë, pas vlerësimit të dosjeve (në rastin kur vetëm kanë aplikuar), apo të mos certifikohen pas fazës së testimit, (kandidati ruan të drejtën për tu testuar deri në dy vite pas trajnimit dhe mund ta zhvillojë këtë test deri në dy herë), duke risjellë kështu nevojën për rihapjen e konkurimit për këto pozicione. Fakti se, komisionet e vlerësimit dhe DRAP kanë pranuar dhe kanë shpallur fitues kandidatë të cilët nuk ishin të pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve ndërkohe që, në Shpalljet për vendet e lira pasja e certifikatës nga Shkolla e Drejtorëve është përcaktuar si kriter i domosdoshëm për aplikim, **ka krijuar kushte jo të barabarta konkurrimi, si dhe ka cënuar parimin e transparencës.** Si pasojë e sa më sipër, i gjithë procesi i ndjekur për vlerësimin dhe emërimin e kandidatëve për drejtues të IPAP është i pavlefshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: DPAP, në çdo rast të hartojnë dhe publikojnë shpalljet e pozicioneve të lira të drejtuesve të IPAP në mënyrë që kriteret e kërkuara në shpallje të ndiqen edhe në procedurat e konkurrimit për këto pozicione.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

6.2 Rekomandimi: DRAP Durrës, në bashkëpunim me DPAP të rishpallë procedurat e konkurimit për pozicionin e drejtorit të IPAP sipas shpalljeve 1 dhe 2, për shkollat nën juridiksionin e DRAP Durrës, për të cilat procesi ka vijuar me pranimin dhe vlerësimin e kandidatëve të papajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorave, me qëllim trajtimin e drejtë dhe të barabartë të kandidatëve.

Brenda vitit 2021

6.3. Rekomandimi: MASR, të ngrejë grupe pune të veçanta me qëllim analizimin e parregullsive të mësipërme dhe të ndërmarrin masa për punonjësit përgjegjës në proporcion me shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit.

Brenda vitit 2021

6.4 Rekomandimi: Në vijimësi, MASR të analizojë zbatueshmërinë e këtij kriterit sipas të cilit kandidati për drejtor të IPAP duhet të jetë i pajisur me certifikatën e Shkollës së Drejtorëve, dhe të marrë masat për zgjidhjen e ngërçit të krijuar si rezultat i kuotave të kufizuara për kryerjen e këtij trajnimi në Shkollën e Drejtorëve, sipas së cilit na rezulton se kualifikimi i plotë i të gjithë stafit drejtues arsimor në DRAP Durrës nuk mund të arrihet deri të paktën në vitin 2024.

Brenda vitit 2021

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultuan problematika lidhur me vendimmarrjen e ZVAP-eve nën juridiksionin e DRAP Durrës në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të IPAP. Konkretisht:

-U konstatuan procedura jo të sakta të ndjekura nga ZVAP në procedurat e konkurimit për pozicionin e drejtorit të IPAP. Për **1 shkollë** në ZVAP Tiranë, **5 shkolla në** ZVAP Kavajë, **1 shkollë** në ZVAP Mat, **nuk është respektuar afati** i trajtuar në pikën D.2, të Kreut 1, ku përcaktohet se Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjellë dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.

-Konstatohet se për **3 shkolla** në ZVAP Kavajë, **4 shkolla** në ZVAP Durrës dhe **3 shkolla** në ZVAP Dibër përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore në komisionin e vlerësimit të dosjeve është caktuar dhe përcjellë **nga vetë shkolla** për të cilën janë kryer procedurat e konkurimit, dhe jo nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

-Në 1 rast, në ZVAP Kavajë, përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozuar nga shkolla dhe miratuar me urdhrin e ZVAP për ngritjen e komisionit, **nuk është i njëjtë** me atë të dërguar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

-Në 1 rast, në ZVAP Mat, njëri nga dy aplikantët, pjesë e konkursit për drejtuesin e shkollës rezulton se ka kryer aplikimin në tejkalim të afateve të përcaktuara në shpalljen nr. 1.

-Konstatohet se **3 shkolla në ZVAP Durrës, 2 shkolla në ZVAP Mat,** dhe **3 shkolla në ZVAP Dibër** nuk rezulton të jetë dokumentuar shqyrtimi i dosjeve të komisionit të vlerësimit pas përcjelljes prej tij të dosjeve të 2 kandidatëve me pikë maksimale në ZVAP-e. Për **2 shkolla në ZVAP Tiranë**, "Andon Zako Cajupi" dhe "Kongresi i Lushnjës" në përfundim të procedurave të përzgjedhjes nga komisioni, është përgatitur relacioni, duke konkluduar se "*... Komisioni është në tejkalim të çdo afati procedurial të përcaktuar nga Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020".* Shkeljet e trajtuara në këto relacione janë evidentuar **edhe në dy shkolla të tjera**, "Sami Frashëri" dhe "Qemal Stafa", por në këtë rast ZVAP Tiranë i ka konsideruar procedurat e rregullta, **duke mos**

analizuar me të njëjtin standard procedurat e ndjekura, dhe procesi ka konkluduar me emërim definitiv të dy kandidatëve.
-Në 2 shkolla, në ZVAP Kavajë nuk rezulton të jetë identifikuar mos zbatimi i afateve nga komisionet e vlerësimit pasi relacioni i përgatitur nga ZVAP ka përcaktuar se procedurat kanë qenë të rregullta.
-Nga auditimi konstatohet se në vijim të pikës 10, gërma C të kreut I, të udhëzimit nr. 2, **për 4 nga 5 shkollat** ("Andon Zako Cajupi", "Kongresi i Lushnjës", "Ramazan Kabashi" dhe "Sami Frashëri") për të cilat është hapur konkurrimi për pozicionin e drejtorit të shkollës në ZVAP Tiranë**:** është mbajtur procesverbali i datës **19.08.2020**, në ambientet e ZVAP Tiranë ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët/kandidatët. Këto procesverbale janë firmosur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe sekretaria e ZVAP, Znj. E.P.. Këto procesverbale janë të pa protokolluar.
-Referuar të dhënave të përcjella nga Sektori i Shërbimit në ZVAP Tiranë, Znj. E.P. ka nisur punë në ZVAP më datë **24.08.2020** pavarësisht emërimit të saj në 19.08.2020. Pra, Znj. E.P. e cila referuar procesverbalit i ka dorëzuar komisionit të vlerësimit dosjet e konkurrenteve, ka nisur punën **6 ditë pas datës** që ka bërë dorëzimin. Mos protokollimi i procesverbalit, në shkelje të ligjit për arkivat, të mbajtur midis sekretares së ZVAP Tiranë dhe komisioneve të vlerësimit, nuk krijon gjurmë auditimi dhe nuk krijon mundësinë për të konkluduar mbi vërtetësinë e këtyre proceseve. Gjithashtu konstatohet se, në rastin e shkollës "Sami Frashëri", data e mbledhjes së komisionit të vlerësimit është e korrigjuar. Ndërsa, për shkollën "Andon Zako Cajupi" konstatohet se, komisioni ka firmosur se ka marrë në dorëzim 4 dosje, në një kohë ku ai është shprehur në procesverbalet e mbajtura për faktikisht 5 dosje.
-Nga auditimi konstatohet se për 1 **rast në ZVAP Tiranë, 1 rast në ZVAP Durrës dhe 2 raste në ZVAP Dibër**, vërtetimi për masë disiplinore është lëshuar nga ZVAP në tejkalim të kompetencave ligjore, pasi këto vërtetime duhet të lëshohen nga DRAP Durrës (në rastin kur aplikanti është në pozicion drejtues shkolle), apo shkolla (në rastin kur aplikanti është në pozicion mësues apo nën drejtor shkolle). Madje, në vijim të sa më sipër, në rastet e ZVAP Tiranë, dhe Durrës kandidatet respektive janë shpallur fituese, mbështetur në këto vërtetime (jo vetëm). Në një rast në ZVAP Tiranë u konstatua që kandidatja edhe pse ka patur një masë disiplinore, ZVAP Tiranë ka lëshuar vërtetim jo të vërtetë (për znj. T.D.), (edhe pse jo me pasoja juridike pasi kandidatja është skualifikuar), në të cilin shprehet se ajo **nuk** ka masë disiplinore. Emërimi në detyrë i kandidatëve sipas vërtetimeve të lëshuar nga ZVAP, dhe jo DRAP apo IA, sikundër evidentohet në rastin e znj. D., nuk pasqyron situatën reale për statusin e kandidates, e cila sipas DRAP Durrës ka masë disiplinore, ndërsa sipas ZVAP Tiranë nuk ka masë disiplinore në fuqi.
Mos-identifikimi i parregullsive të mësipërme, nga ZVAP-et për shqyrtimin e procedurave të ndjekura nga komisionet e vlerësimit, ka lejuar që këto konkurse, të zhvilluara në kundërshtim me aktet nënligjore dhe rregullatore, të konkludojnë në emërim definitiv të drejtorëve të shkollave, apo mos marrjen e masave për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP-në, të analizojnë parregullsitë e konstatuar në ZVAP-ve dhe të marrin masa për shmangien e tyre, duke bërë të mundur kryerjen e procedurave të konkurrimit për pozicionin drejtues të IPAP nga ZVAP, konform afateve dhe përcaktimeve të tjera në aktet ligjore dhe rregullatorë respektive.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

7.2 Rekomandimi: Për te gjitha rastet në vijim, me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, dhe shmangien e riskut të tjetërsimit të pasurisë natyrore/ humbjen e tyre, nga ZVAP Tiranë të merren masat që çdo

dokument të ketë të gjithë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

7.3 Rekomandimi: Për të gjitha rastet në vijim, vërtetimet për masa disiplinore të jenë lëshuar nga DRAP/IPAP. ZVAP, në asnjë rast të mos tejkalojnë kompetencat e tyre, duke lëshuar vërtetime për masë disiplinore.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultuan problematika lidhur me vendimmarrjen e komisioneve të vlerësimit në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve të IPAP. Konkretisht:
- U konstatua se, për të **5 shkolla**t për të cilat është zhvilluar procedura e konkurrimit nën ZVAP Tiranë, të **5 shkollat** në ZVAP Kavajë dhe të **3 shkollat** në ZVAP Dibër, komisioni **nuk ka respektuar afatet** e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, pika C.10 dhe Pikën 3, të Shpalljes nr. 1, datë 05.08.2020, ku më hollësisht kandidatët me mungesa në dokumentacion pas vlerësimit paraprak**, janë skualifikuar** menjëherë nga komisioni duke mos respektuar afatin 3 ditor pas identifikimit të mungesave. Intervistimi i kandidatëve në shumicën e rasteve është kryer **në të njëjtën ditë** me vlerësimin e dosjeve. Më evidente kjo situatë rezulton për shkollën "Ramazan Kabashi", në ZVAP Tiranë ku procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për drejtuesin e shkollës është anulluar, pasi 5 nga 6 aplikantët kishin mungesë të dokumentacionit, dhe komisioni ka vendosur **anullimin** pa i njoftuar ata për plotësimin e mungesave me dokumentet respektive.
Procesverbali i vlerësimit të dosjeve të komisionit në **2 raste**, në ZVAP Durrës është firmosur nga **vetëm 4** anëtarë, nga 5 që duhet të përmbajë komisioni.
Nga auditimi konstatohet se për **1 shkollë në ZVAP Tiranë** ("Andon Zako Cajupi") dhe 1 shkollë në ZVAP Mat për të cilat është zhvilluar procedura e konkurrimit për pozicionin drejtor, pas ndryshimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit, **nuk** dokumentohet përcjellja e informacionit të ndryshimit pranë ZVAP me qëllim rishikimin e urdhrit i Drejtorëve të ZVAP për komisionin **në kundërshtim** me pikën 9, shkronja C, Kreu I, i Udhëzimit nr. 2, i ndryshuar. Si rezultat, në mbledhjet e komisionit, është paraqitur dhe ka votuar kandidati i zëvendësuar, i cili faktikisht nuk rezulton në urdhrin e ZVAP për ngritjen e Komisionit.
Referuar parregullsive në procedurat e konkurimit të zhvilluara nga komisionet e vlerësimit të cilat kanë konkluduar në anulim të procedurës, apo kanë vijuar me shkelje të kritereve përcaktuar në ligj dhe udhëzim, evidentohet se anëtarët kanë shfaqur **mangësi** në njohjen e bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe shpesh herë kanë vlerësuar në mënyrë jo të drejtë kandidatët. **Mungesa e njohurive të anëtarëve të komisioneve të vlerësimit** është paraqitur si problematikë edhe në 2 procesverbalet (2 nga 2 në total) e mbajtura nga përfaqësuesit e DRAP Durrës në mbledhjet e komisioneve.
Nga auditimi konstatohet gjithashtu që, në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, në rast të veprimit të komisionit të vlerësimit në kundërshtim me këto akte gjatë procedurës së vlerësimit të kandidatëve për pozicionet e lira drejtor shkolle, nuk parashikohen masa për evidentimin e përgjegjësive dhe minimizimin apo shmangien e tyre. Në një rast, DRAP Durrës, në vijim të parregullsive të komisionit, ka kërkuar marrjen e masës disiplinore ndaj kryetarit të komisionit të vlerësimit.
Fakti që komisionet e vlerësimit, në rastet e përmendura më lart, nuk kanë respektuar afatet për t'i mundësuar kandidatëve plotësimin e dokumentacionit që mungonte në dosjet e tyre, por i kanë skualifikuar menjëherë ata dhe kanë vijuar me intervistimin e kandidatët të tjerë ose kanë anuluar konkurrimin, ka shkaktuar që këto konkurse të jenë zhvilluar **në kundërshtim** me aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi duke **cënuar** eficiencën dhe efektivitetin e proceseve. Mungesa e kompetencës së komisioneve në vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionet e lira drejtore shkolle në IPAP, ka sjellë si pasojë anulimin e konkurseve ose vijimësinë e tyre në shkelje

të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi, të cilat përbëjnë mungesë të eficiencës dhe efektivitetit të procesit në tërësi. Si rezultat se, në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi nuk parashikohen masa në rast të veprimit të komisionit të vlerësimit në kundërshtim me rregullat dhe kriteret për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, ekziston risku i veprimit jo me përgjegjshmëri nga ana e komisionit të vlerësimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: DRAP Durrës në bashkëpunim me DPAP, të analizojnë përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe të propozojnë në MASR masat e nevojshme, që problematikat e konstatuara më lart të shmangen në të ardhmen, më qëllim që të sigurohet vlerësimi i kandidatëve për pozicionet e lira drejtor shkolle nga komisionet e vlerësimit, në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi.

Brenda 3 mujorit të II-të 2021

9. Gjetje nga auditimi: Kreu C, pika 11 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, i ndryshuar, përcakton se "*Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune*." Në pikën 6 të Shpalljes nr. 1 datë 05.08.2020 përcaktohet se: "*Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankimimet përpara Komisionit brenda 3 ditëve punë nga shpallja e rezultateve të konkurrimit*", Nga auditimi rezulton se, në ZVAP Kavajë njëri prej aplikantëve në procedurat e konkurrimit të shkollës "Helmas" ka paraqitur një ankesë pranë ZVAP lidhur me vendimmarrjen e komisionit, dhe në përgjigjen e ZVAP është mbajtur qëndrimi: "*Pretendimi i ngritur nga zonja nuk qëndron pasi kjo kërkesë është paraqitur gabim tek ZVAP Kavajë, ku duhet të adresohej tek komisioni i shkollë*s." Në vijim të saj, nuk dokumentohet të jetë shqyrtuar apo marrë në konsideratë kjo ankesë, pasi drejtimi i ankesave pranë një komisioni ad hoc i cili ngrihet për një procedurë të caktuar, dhe nuk ka një adresë të përcaktuar, nuk siguron trajtimin e tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: DRAP Durrës të marrë masat e nevojshme që në shpalljet e ardhshme për vendet e lira për pozicionin drejtor shkolle, të përcaktohet qartë procedura dhe adresa për drejtimin e ankesave ndaj Komisionit të Vlerësimit, me qëllim sigurimin e përcjelljes dhe trajtimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj nuk rezultojnë të kenë miratuar në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", rregullat për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivor. Si rezultat, dosjet me dokumentacionet për përzgjedhjen e kandidateve të pozicionit të drejtorit të shkollave janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuar në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës. Nga verifikimi ne disa prej zyrave arsimore, konstatohet se nuk rezulton i unifikuar procesi i administrimit të dokumentacioneve, pasi në disa raste dosjet origjinale të të gjithë aplikantëve janë administruar dhe ndodhen në zyrat e ZVAP; në disa raste dosjet origjinale janë përcjellë në DRAP Durrës dhe ZVAP-et disponojnë vetëm fotokopjet; dhe në disa të tjera dokumentacionet origjinale gjenden në shkollat për të cilat janë zhvilluar procedurat e konkurrimit. Dokumentacionet respektive në disa ZVAP-e ishin të shpërndara, të duplikuara, me data të ndryshme, ose të korrigjuara. Gjithashtu, procesverbalet e komisionit dhe shumë dokumentacione të tjera, si urdhri i ngritjes së komisionit të vlerësimit (3 raste në ZVAP Kavajë), pjesë të dosjes janë të pa protokolluara, duke mos garantuar siguri për grupin e auditimit lidhur me plotësinë dhe saktësinë e dokumentacioneve pjesë të dosjes. Konstatohet se në dosjet e procedurave nuk është dokumentuar procesverbali i intervistimit të kandidatëve dhe votimi i

komisionit për **të 5 shkollat në ZVAP Kavajë, 1 shkollë në ZVAP Tiranë**; 2 shkolla në ZVAP Durrës. Pyetjet e intervistës së strukturuar nuk janë pjesë e dosjes për **të 5 shkollat në ZVAP Kavajë, 2 shkolla ZVAP Tiranë, 2 shkolla ZVAP Durrës.** Konstatohet se mungojnë procesverbalet e dorëzimit të dosjeve nga ZVAP për komisionin në **2 shkolla në ZVAP Kavajë**, **për 2 shkolla në ZVAP Tiranë 2 raste ZVAP Bulqizë**; **1 shkollë në ZVAP Durrës**. Nuk është pjesë e dosjes, procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e kandidatëve në **4 shkolla** në ZVAP Kavajë. Kjo situatë përbën një risk të shtuar për tjetërsimin e informacionit, menaxhimin dhe ruajtjen e dokumentacioneve respektive.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj, të marrin masat për unifikimin e procedurave të ndjekura për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacioneve të procedurave për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve arsimore, duke kërkuar për çdo zyrë inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve me dokumentacione të plota.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

10.2 Rekomandimi: Për te gjitha rastet në vijim, me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, dhe shmangien e riskut të tjetërsimit të pasurisë natyrore/ humbjen e tyre, nga DRAP Durrës të merren masat që çdo dokument të ketë të gjithë elementët e nevojshëm sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në PBA-të e periudhave 2020-2022 dhe 2021-2023, DRAP Durrës nuk ka hartuar deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit, duke mos i paraqitur këto dokumente plotësisht në përputhje me formatin e përcaktuar nga MASR sipas "*Formatit standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2020-2022"* dhe "*Formatit 2- Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2021-2023- Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi."*. E njëjta situatë u vërejt edhe në përgatitjen e PBA-së 2019-2021 nga ish-DAR Tiranë dhe PBA-së 2021-2023 nga ZVAP Tiranë.
-Nga auditimi rezultoi se ekzistojnë diferenca mes kërkesave buxhetore të DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë në planifikimin e kryer për fonde sipas PBA-së, krahasuar me fondet e miratuara. DRAP Durrës ka planifikuar fonde vetëm për 1 program buxhetor, "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"* ndërkohë që alokimi i fondeve për vitin 2019 dhe 2020 nga MASR është kryer në 3 programe, duke përfshirë dhe Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm.
-Nga verifikimi i kryer në DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë për plotësinë dhe saktësinë e përgatitjes së propozimeve të buxhetit, konstatohet se DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë nuk rezulton të kenë ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit, edhe pse institucionet për periudhën 2019-2020 kanë menaxhuar fonde në 3 programe të ndryshme.
-Nga auditimi rezultoi se DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë kanë funksionuar si institucione të pavarura, ku përcjellja e PBA-ve të hartuara prej tyre është bërë në mënyrë direkte në MASR, sipas afateve respektive. Nuk rezultojnë të jenë dokumentuar propozimet e ndërsjellta nëpërmjet institucioneve, deri në miratimin final të PBA-së së konsoliduar, me qëllim hartimin e gjurmës së auditimit të këtij procesi, sikundër përcakton Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 22-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit në DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, në vijim të ngritjes së Ekipit të Menaxhimit të Programit nga titullari i institucionit, me qëllim menaxhimin efektiv të programeve buxhetore, të marrin masat për hartimin e dokumentit të projektbuxhetit për periudhat e ardhshme në përputhje me kërkesat e kuadrit

rregullativ, me qëllim përcjelljen për në MASR të një informacioni sa më të plotë, duke përfshirë deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit.

Në vijimësi

11.2 Rekomandimi: DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj dhe DPAP, të marrin masat për kryerjen e një planifikimi sa më efektiv dhe koherent të fondeve, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë vijimësisë së kërkesave të fondeve në nivel programi buxhetor, në mënyrë që të mos ketë diferenca të konsiderueshme mes fondeve të propozuara për miratim në fazën e projektbuxhetit, dhe atyre të alokuara nga MASR, të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave institucional, sipas së cilave duhet të mbështetet hartimi i PBA-së.

Në vijimësi

11.3 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës, të marrin masat për përcjelljen e planifikimit zyrtar të projektbuxhetit fillimisht në DRAP Durrës, me qëllim reflektimin e komenteve apo propozimeve prej kësaj drejtorie, përpara dërgimit zyrtar të PBA-së për miratim në MASR, në mënyrë që të krijohet gjurma e auditimit e të gjithë procesit të ndjekur për përmirësimin e cilësisë së këtij dokumenti.

Në vijimësi

12.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi një planifikim i dobët i buxhetit të DRAP Durrës dhe ZVAP-eve nën juridiksionin e saj. Konstatohet se nuk është ndjekur procedura e saktë për ndryshimet buxhetore të ndodhura (shtesa/pakësime/rialokime), pasi njësitë shpenzuese nuk kanë qenë ato të cilat iniciojnë ndryshimet në buxhet, por thjesht vihen në dijeni për to pas faktit, gjatë rakordimeve me degët e thesarit. Konstatohet se në vitin 2020, **DRAP Durrës** i janë alokuar fonde për të menaxhuar dhe administruar programet "Arsimi Bazë" dhe "Arsimi i Mesëm", fonde të cilat nuk rezultojnë të përdoren për ekzekutimin e pagesave të kësaj drejtorie, por përgjatë vitit ato transferohen në ZVAP-e sipas nevojave respektive, praktikë kjo që konsiston në ndryshime të shpeshta të fondeve, me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit (7 ndryshime përgjatë 2019 dhe 6 ndryshime për periudhën janar-gusht 2020 për DRAP Durrës).

-Për vitin 2019, pas krijimit të **DRAP Durrës**, institucionit i janë alokuar fillimisht fonde në shumën rreth 7 milion lekë, ku deri në fund të vitit, **plani i rishikuar** në tre programet paraqiten në shumën rreth 46 milion lekë **(pra 39 milion lekë më shumë se plani fillestar)**, nga të cilat janë **realizuar** në total 35 milion lekë, pra 28 milion lekë më shumë se plani fillestar (500%), dhe rreth **11 milion lekë më pak se plani i rishikuar** (**77%**).

Nëse i referohemi planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në nivel programi, rezulton se programi "Planifikim Menaxhim dhe Administrim" është realizuar në shumën 35 milion lekë, nga 7 milion lekë planifikuar në planin fillestar (pra 28 milion lekë më shumë; realizimi në masën 500%), dhe 37 milion lekë planifikuar në planin e rishikuar (pra 2 milion lekë më pak; realizimi në masën 95%). Niveli më i lartë i mos realizimit rezulton në dy Programet e "Arsimit Bazë" dhe "Arsimit të Mesëm", në vlerat përkatëse në planin e rishikuar prej 5 milion lekë (realizimi në masën 0%) dhe 3 milion lekë (realizimi në masën 0%), për shkak të mos ekzekutimit të kontratës të trajnimit trajtuar më sipër;

-Për **vitin 2020, DRAP Durrës** fillimisht janë planifikuar fonde në tre programe, në shumën rreth 75 milion lekë dhe deri në fund të periudhës objekt auditimi (gusht 2020) **plani i rishikuar** paraqitet në shumën rreth 39 milion lekë **(pra 36 milion lekë më pak se plani fillestar)**, ku deri në përfundim të periudhës objekt auditimi (gusht 2020), **realizimi** i fondeve në tre programe paraqitet në shumën 12 milion lekë, pra **63 milion lekë më pak se plani fillestar** (realizimi në masën 15%), dhe **27 milion lekë më pak se plani i rishikuar** (realizimi në masën 30%).

Nëse i referohemi planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në nivel programi, rezulton se programi "Planifikim Menaxhim dhe Administrim" janë planifikuar fillimisht fonde në shumën 14 milion lekë të cilat deri në fund të periudhës objekt auditimi janë pakësuar dhe paraqiten në vlerën rreth 14 milion lekë, dhe realizimi i fondeve paraqitet në vlerën 8 milion lekë, pra 6 milion lekë më pak se plani (54%). Në programin "Arsimi Bazë" janë miratuar fonde në vlerën 42 milion lekë, të cilat deri në fund të periudhës objekt auditimi janë pakësuar dhe paraqiten në vlerën rreth 16 milion lekë (pra rreth 26 milion lekë më pak si rezultat i transferimeve në ZVAP-e) nga të cilat janë realizuar 3 milion lekë, ose 13 milion lekë më pak (18%). Për programin 09230 "Arsimi i Mesëm" buxheti i miratuar paraqitet në vlerën rreth 19 milion lekë, i cili deri në fund të periudhës objekt auditimi është pakësuar dhe paraqitet në vlerën rreth 7 milion lekë (pra rreth 12 milion lekë më pak si rezultat i transferimeve në llogaritë e ZVAP-ve) nga të cilat janë realizuar 6 milion lekë më pak (13%).

12.2 Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit shqyrtoi hartimin dhe zbatimin e buxhetit në një ndër ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës, konkretisht ZVAP Tiranë. Në buxhetin e **ZVAP Tiranë** u konstatuan 11 ndryshime në vitin 2019 dhe 5 ndryshime për periudhën janar-gusht 2020. Nga auditimi rezultoi se, pas krijimit të ZVAP Tiranë në vitin 2019**,** fillimisht janë alokuar fonde në shumën rreth 2,875 milion lekë, ku plani i rishikuar deri në fund të vitit rezulton në shumën 3,695 milion lekë, pra **820 milion lekë më shumë** se plani fillestar, nga të cilat janë realizuar 3,682 milion lekë (99%). Në vitin 2020 në ZVAP Tiranë fillimisht janë alokuar fonde në shumën rreth 3,720 milion lekë dhe plani i rishikuar deri në muajin gusht rezulton në shumën 4,184 milion lekë, pra **464 milion lekë më shumë** se plani fillestar, nga të cilat janë realizuar deri në fund të muajit gusht 2020, 2,719 milion lekë (64%). Rishikimet e fondeve rezultojnë të kryhen sipas nevojave të institucionit përgjatë vitit, duke diktuar kështu një realizim të lartë në fund të vitit.

12.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në buxhetin e DRAP Durrës në datën 12.11.2019 **janë pakësuar fondet** nën programin "Arsimi Bazë", nën kodin 91103 AE "Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re" në vlerë **3 milion lekë,** fonde të cilat kanë qenë të dedikuara për një procedure në proces prokurimi gjatë periudhës kur është kryer ky pakësim. DRAP Durrës nuk disponon asnjë dokumentacion për kthimin e këtyre fondeve, ku sipas punonjësve të kësaj drejtorie shkresa nuk ka patur asnjë efekt, dhe është anulluar, pasi DRAP Durrës ka njoftuar Ministrinë e Arsimit për procedurën në proces prokurimi. Megjithatë, nga një verifikim i kryer në të dhënat e konsoliduara në thesar, rezulton se **faktikisht këto fonde janë pakësuar nga buxheti i DRAP Durrës në muajin nëntor dhe janë rikthyer më pas në dhjetor, edhe pse procedura e prokurimit për to ka qenë në proces**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 22-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj, në bashkëpunim me MASR, të marrin masat për kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucional, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve që nuk realizohen deri në fund të vitit, për të sjellë artificialisht planifikimin e tyre, në nivelet e zbatimit, situatë kjo me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.

Në vijimësi

12.2 Rekomandimi: MASR të shmangë praktikat e kryerjes së ndryshimeve në buxhet pa kërkesat e institucioneve (ZVAP apo DRAP), si dhe të përcjellë njoftimet zyrtare për drejtuesit e programeve buxhetore në DRAP dhe ZVAP për rishpërndarjet ose shtesat/pakësimet e fondeve të miratuara.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

12.3 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në MASR të marrin masat për shmangien e praktikës së pakësimit të fondeve të dedikuara për një procedurë prokurimi në proces (pra si në rastin e kontratës së trajnimit trajtuar më sipër), të cilat mund të cënojnë zbatimin e kontratave dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura për buxhetin e shtetit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Raporti i monitorimit 8 mujor për DRAP Durrës për vitin 2019, dhe Raportet e monitorimit të realizuara gjatë vitit 2019 nga ZVAP Tiranë, nuk rezultojnë në përputhje me kërkesat e formatit standard të monitorimit të buxhetit.
-Nga auditimi nuk rezulton të jetë përgatitur Raporti i monitorimit 8 mujor dhe ai i vitit 2019 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj.
-Në Raportin vjetor të monitorimit për vitin 2019 të DRAP Durrës, në shpenzimet për trajnimin e drejtuesve, Produkti 91101AC "Drejtuesve te institucioneve arsimore te trajnuar", janë deklaruar si të kontraktuara në shumën 179,344 lekë, megjithatë në dosjen e kësaj kontrate **nuk** përshkruhet detajimi i fondeve në bazë të pjesëmarrësve (pra sa prej tyre do të ishin përfaqësues të nivelit drejtues, të arsimit të mesëm apo atij të lartë). Këto fonde janë përfshirë nën të njëjtën procedure prokurimi. Për vitin 2020 ky produkt është planifikuar në vlerën **0,** duke paracaktuar se në trajnim nuk do të marrë pjesë **asnjë** drejtues institucioni.
-Nga auditimi konstatohet se nga ana e institucioneve, nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore"* pasi në faqen zyrtare të DRAP Durrës dhe ZVAP-eve nën juridiksionin e saj, **nuk** janë publikuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2019 dhe 2020.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 22-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës në DRAP Durrës dhe Sektori i Shërbimeve në ZVAP Tiranë, të hartojnë raportet e monitorimit periodike në përputhje me kërkesat e formatit standard të monitorimit të buxhetit, me qëllim paraqitjen e informacionit të plotë mbi arritjet në terma sasiore dhe cilësore të produkteve të realizuara, duke identifikuar mosarritjet dhe shpjeguar shkaqet e tyre, si dhe duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës.

Në vijimësi

13.2 Rekomandimi: DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj të marrë masat për publikimin e raporteve të monitorimit të buxhetit sipas periudhave, në faqet zyrtare të institucioneve respektive, në zbatim edhe të parimeve të qeverisjes buxhetore sipas OECD mbi transparencën e dokumenteve dhe të dhënave buxhetore, në mënyrë që ato të jenë të aksesueshme nga publiku.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

13.3 Rekomandimi: Për kontratat që do të lidhen në vijim, DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj, të kryejnë saktë detajimin e fondeve buxhetore të lidhura me to, në nivel programi dhe produkti, me qëllim ndjekjen e saktë të ecurisë së ekzekutimit të tyre.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi alokimin e fondeve buxhetore në nivel programi dhe produkti për DRAP Durrës, konstatohet se për periudhën 2019-2020, fondet nuk akordohen në të njëjtat produkte nga viti në vit, duke mos lejuar kështu edhe analizat krahasimore për përdorimin e tyre. Më hollësisht, në vitin 2019 për programin 01110, fondet janë alokuar në **4** produkte:

91101AE, 91101AA, 91101AD, 91101AC, dhe në vitin 2020 vetëm në **2** produkte: 91101AA dhe 91101AC.
-Për sa i përket përdorimit të tyre në Programin 01110 *"*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim", konstatohet se në vitin 2019 nën produktin 91101AA "Punonjës dhe specialiste te trajnuar*",* ku sipas raportit të monitorimit të MASR, mënyra e matjes së këtij produkti është *"Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese/Trajnimi çdo vit për 100-110 drejtues të institucioneve*" janë përfshirë shpenzime të kryera për kancelari, pjesë këmbimi, internet; dhe në vitin 2020 deri në fund të muajit gusht realizimi për këtë produkt është zero, pasi këto shpenzime, pra për internet, tonera, taksa makine etj, janë përfshirë nën produktin 91101AE "Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore". Në vitin 2019, në produktin 91101AD "Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara", ku sipas raportit të monitorimit të MASR, mënyra e matjes së këtij produkti është "*Numri i akteve te miratuar"* janë përfshirë shpenzime për naftë dhe pjesë këmbimi.
E njëjta problematikë u identifikua edhe në **ZVAP Tiranë**. Më hollësisht, në produktin 91101 AA, njësia matëse e të cilit lidhet me "*Numrin e drejtuesve të trajnuar*", ZVAP Tiranë ka përfshirë shpenzime karburanti, kancelarie, elektricitet, etj. Në produktin 91103 AD, njësia matëse e të cilit lidhet me "*Numrin e nxënësve dhe mësuesve që përfitojnë shërbimin e transportit*" në Arsimin Bazë, për vitin 2019 ZVAP Tiranë ka përfshirë shpenzime për blerje uniformash, bexha, etj. Në produktin 91104AB, njësia matëse e të cilit lidhet me "*Numrin e nxënësve dhe mësuesve që përfitojnë shërbimin e transportit*" në Arsimin e Mesëm, për vitin 2020 ZVAP Tiranë ka përfshirë shpenzime elektrike, internet, sigurim jete, shpenzime modele, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 22-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, në bashkëpunim me DPAP dhe strukturat përgjegjëse në MASR, të marrin masat për kryerjen e planifikimit të fondeve në nivel produkti, dhe alokimin e tyre në mënyrë të vijueshme, duke mundësuar kryerjen e krahasimeve mes zërave në raportet e monitorimit, apo vlerësime të parashikimeve.

Në vijimësi

14.2 Rekomandimi: DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, në vijim të objektivave dhe produkteve nën programet të cilat ajo administron, dhe mënyrës së matjes së tyre sikundër trajtohet në raportet e monitorimit të MASR, të kryejnë shpenzimet për mallra dhe shërbime në qëllim të produkteve për të cilat janë alokuar fondet.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i masave të ndërmarrja nga DRAP Durrës për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, konstatohet se përgjithësisht institucioni ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe manualit të MFK-së në hartimin e dokumenteve përkatëse, por megjithatë nëse i referohemi zbatueshmërisë së tyre në praktikë, konstatohet se ka vend për përmirësim. Disa nga problematikat e identifikuara trajtohen si më poshtë:
-Pyetësori, deklarata dhe raporti i gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, i përcjellë nga DRAP Durrës sipas shkresës nr. 78, prot datë 22.01.2020, pasqyron situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm, **vetëm** në këtë institucion, duke mos reflektuar një analizë me të dhëna të konsoliduara për 12 njësitë e varësisë nën juridiksionin e saj.
-Autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe përshkrimeve individuale të DRAP dhe ZVAP nuk është i unifikuar, ku më hollësisht për DRAP Durrës është kryer nga DPAP, dhe në ZVAP Tiranë nga vetë titullari i institucionit.
-Në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e DRAP Durrës, nuk parashikohet sektori përgjegjës për administrimin e dosjeve të personelit; nuk janë trajtuar çështje që lidhen me

komunikimin e brendshëm të personelit; rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve elektronike; si dhe përgjegjësit për përditësimin e faqes së zyrtare së institucionit.
-Mbledhjet e GMS zhvilluar gjatë vitit 2020 zhvilluar online nuk janë dokumentuar, duke mos disponuar minutat e takimeve dhe vendimmarrjen e tyre në asnjë rast.
-Harta e proceseve të punës të DRAP Durrës dhe gjurma e auditit nuk ka reflektuar ndryshimet e udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 për rolin e DRAP Durrës në përzgjedhjen e drejtuesve të IPAP.
- DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksionin e saj nuk disponojnë një email të brendshëm zyrtar dhe si rezultat punonjësit e institucionit komunikojnë me adresat e tyre personale të email-it, të cilat shpesh herë shfaqin probleme.
-DRAP Durrës, nuk disponon një plan dhe regjistër të trajnimeve. Gjatë periudhës objekt auditimi personeli ka realizuar vetëm një program trajnimi me vetëm 4 pjesëmarrës në të.
-DRAP Durrës nuk disponon një plan për mbështetjen rezervë (back-up plans) për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit kundër humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 294-308, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Titullari i DRAP Durrës, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar në këtë raport, për të përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të institucionit, dhe monitorimin e risqeve.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i masave të ndërmarrja nga ZVAP Tiranë për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm dhe përgjegjshmërinë menaxheriale të titullarit të institucionit, rezultojnë të jenë kryer me mangësi detyrimet lidhur me:
-ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike
-hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave, planit dhe plan veprimit për arritjen e objektivave të institucionit.
-vendosja e linjave të raportimit në strukturën organizative për të mundësuar kryerjen efektive të përgjegjësive.
-Raporti i sistemeve të KBFP për vitin 2018, përcjellë në MFE në vitin 2019, **nuk** rezulton të jetë përgatitur në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të MFE. Për vitin 2019, raporti nuk rezulton të jetë përgatitur. Pyetësori i vetëvlerësimit sipas ZVAP Tiranë është përcjellë elektronikisht në MFE, ku vihet re se përgjigjet e subjektit nuk pasqyrojnë situatën reale në institucion.
-Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik duke mos dokumentuar asnjë mbledhje të tij.
-Nuk rezulton të ketë hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm dhe Rregullorja për Menaxhimin e Riskut.
-Nuk është ngritur Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Koordinatori i Riskut dhe Ekipi i Menaxhimit të Riskut, duke mos përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale për monitorimin e risqeve të institucionit.
-Nuk është hartuar dhe miratuar gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit, prokurimeve, menaxhimin e aktiveve, etj.
-Nuk është hartuar dhe miratuar harta e proceseve të punës dhe manualeve të proceseve të punës.
-Nuk disponohen plane të trajnimeve apo një regjistër për kualifikimin periodik të stafit, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin profesional të punonjësve.
-Nuk disponon një plan për mbështetjen rezervë (back-up plans) për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit kundër humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 294-308, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Titullari i ZVAP Tiranë, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar në këtë raport, për të përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të institucionit, dhe monitorimin e risqeve.

Brenda 3-mujorit të II-të 2021

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, konstatohet se:

1. -Në 6 raste (për DRAP Durrës, ZVAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë, ZVAP Dibër dhe ZVAP Bulqizë), konstatohet se regjistri i aktiveve nuk mbahet i plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme sipas formatit të Udhëzimit nr. 30, të tilla si, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj.
-ZVAP Shijak nuk ka një regjistër të aktiveve që ka në zotërim dhe/ose përdorim.

2. -ZVAP Shijak nuk ka kryer inventarizimin e aktiveve për vitin ushtrimor 2019.
-ZVAP Dibër, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për viti 2019. Nuk ka asnjë urdhër të drejtorit të këtij institucioni për kryerjen e procesit të inventarizimit.
-Në ZVAP Tiranë, komisioni i inventarizimit i ngritur me anë të Urdhrit nr. 36, nr. 5595 prot., datë 23.12.2019, të Drejtorit të ZVAP Tiranë, nuk ka prodhuar asnjë relacion mbi rezultatet e procesit të inventarizimit, si dhe nuk ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve, për arsye se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se komisioni ka firmosur mbi fletat e aktiveve sipas gjendjes kontabile, ndërsa pjesa sipas të dhënave të inventarit (sasia, mungesat, teprica, nxjerrje jashtë përdorimi, etj.), është e paplotësuar nga komisioni.
Mos kryerja e procesit të inventarizimit nga këto ZVAP, ndikon në mungesën e ofrimit të sigurisë për vlerën e aktiveve, paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019 për këto institucione.

3. Me anë të Urdhrit nr. 37, nr. 5656 prot., datë 24.12.2019, Drejtori i ZVAP Tiranë ka urdhëruar kalimin kapital të automjetit me vlerë 920,000 lekë, për llogari të shkollës së mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë, në tejkalim të kompetencave të Drejtorit të ZVAT Tiranë, për arsye se përgjegjësinë për nxjerrjen jashtë përdorimi dhe tjetërsimin e aktiveve, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 22 dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 5 dhe 111, nuk e ka Drejtori i ZVAT Tiranë, por Ministri i MASR.

4. Në përfundim të procesit të inventarizimit të kryer në vitit 2019, komisionet përkatëse kanë propozuar, për nxjerrje jashtë përdorimi, materiale në vlerën 2,423,239 lekë. Megjithëse janë konstatuar këto mangësi në procesin e inventarizimit, nga strukturat drejtuese të ZVAP Durrës, nuk konstatohet të jenë marrë masa për rregullimin e gjendjes së krijuar, si nxjerrja e tyre jashtë përdorimi të tyre dhe pasqyrimi i këtyre veprimeve në pasqyrat financiare të viti 2019, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3., faqe 213-269, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

17.1 Rekomandimi: Drejtori i DRAP Durrës dhe Drejtorët ZVAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë, ZVAP Dibër dhe ZVAP Bulqizë, të marrin masat për plotësimin dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve të institucioneve përkatëse, me të gjitha të dhënat e nevojshme sipas formatit të Udhëzimit nr. 30.

Drejtori i ZVAP Shijak, të marri masat për plotësimin dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve të ZVAP Shijak, me të gjitha të dhënat e nevojshme sipas formatit të Udhëzimit nr. 30.

Brenda vitit 3-mujorit të II-të 2021 dhe në vijimësi

17.2 Rekomandimi: Nga Drejtori i ZVAP Tiranë dhe ZVAP Dibër, të merren masa që ti kushtohet një vëmendje e posaçme procesit të inventarizimit nga komisionet përkatëse, me qëllim paraqitjen e saktë të gjendjes së inventarit në pasqyrat financiare të institucionit.

Në vijimësi

17.3 Rekomandimi: Nga Drejtori i ZVAP Tiranë, të merren masa për t'ju drejtuar Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me qëllim miratimin për kalimin kapital të automjetit të institucionit për llogari të shkollës së mesme të ndërtimit "Karl Gega" Tiranë.

Brenda vitit 3-mujorit të II-të 2021

17.4 Rekomandimi: Drejtori dhe përgjegjësi i sektorit të shërbimeve të ZVAP Durrës, të marrin masat për vlerësimin e materialeve me vlerë 2,423,239 lekë, sipas rekomandimeve të komisionit të inventarizimit dhe pasqyrimin e këtyre veprimeve në Pasqyrat Financiare të vitit 2020.

Brenda vitit 3-mujorit të II-të 2021

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara nga DRAP Durrës dhe ZVAP të përfshira në auditim, u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave, kryesisht si më poshtë vijon:

1. Dosjet e procedurave të zhvilluara nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
-Nuk janë kryer trajnime të stafit që bëjnë pjesë e komisioneve të caktuara në procedurat e prokurimeve publike, çka ka rezultuar në mos kuptimin e plotë të legjislacionit të prokurimit publik nga këta punonjës.
-Në 3 raste (Dibër, Mat dhe Bulqizë), nëpunësi zbatues është pjesë e procedurave të prokurimit si anëtar i NjP dhe/ose anëtar i KVO (në ZVAP Bulqizë ishte në të dyja), në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12/3.
-Në 3 raste, për procedurat e zhvilluara me objekt "Shërbim Interneti 2019" në ZVAP Durrës, "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve" në ZVAP Mat dhe "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve" në ZVAP Dibër, në institucion nuk u gjend dosja përkatëse e procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 12, pika 2, neni 22, pika 4, si dhe me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
-Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt "Shërbim Interneti 2019" në ZVAP Durrës, konstatohet se Njoftimi i Lidhjes së Kontratës është dërguar më datë 20.03.2019 ose 13 ditë para nënshkrimit të kontratës, ndërsa Konfirmimi i Lidhjes së Kontratës, është dërguar më datë 28.03.2019 ose 5 ditë para nënshkrimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 6, pika 2, që parashikon se AK dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.

2. DRAP Durrës, për vitin 2019, sipas Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve, ka zhvilluar një procedurë "Kërkesë për propozim" me vlerë 7,000,000 lekë (audituar) dhe 5 procedura me "Blerje

me vlerë të vogël", ndërsa për vitin 2020, ka realizuar 3 procedura me "Blerje me vlerë të vogël".
Në lidhje me këtë pikë, është audituar transaksioni për kryerjen e pagesës me anë të Urdhër Shpenzimit nr. 26, datë 26.05.2020, me vlerë 4,164,736 lekë, procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt "*Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12*", me fond limit 7,000,000 lekë, nga ku është konstatuar si vijon:
-Autoriteti Kontraktor (AK), ka vazhduar procedurën me të njëjtin fond limit (7,000,000 lekë), duke vijuar me zhvillimin e procedurës (Raporti Përmbledhës nr. 01/11, datë 28.11.2019), edhe pse MASR me shkresën nr. 9891/1 datë 12.11.2019, i ka pakësuar fondet me 3,000,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70 dhe Udhëzimin nr. 9.1, datë 20.03.2018 "për procedurat e zbatimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të Qeverisë", Kreu III, pika 15/b. Ndryshimi i fondeve në dispozicion, është inicuar dhe kryer nga MASR, pa dijeninë e DRAP Durrës. DRAP Durrës është vënë në dijeni të faktit të kryer, pas mbërritjes së nr. 9891/1 datë 12.11.2019, në institucionin e tyre.
-Përllogaritja e fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 23, pikat 1 dhe 4 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 1 dhe neni 59, për arsye se nuk është argumentuar metoda e përzgjedhur për përcaktimin e vlerës së kontratës, nuk janë argumentuar OE të përzgjedhur për studimin e vlerës së kontratës (një operator nuk është i regjistruar në QKB dhe një tjetër nuk ka për objekt të aktivitetit objektin e prokurimit), si dhe nuk është përcaktuar se përse do kryhet trajnim vetëm për 3160 mësues nga të gjithë mësuesit që ka nën juridiksion kjo drejtori (mbi 10 mijë), nuk është kryer një analizë mbi ndarjen e pjesëmarrësve në trajnim.
-Zyrtarët e emëruar për këtë procedurë prokurimi me anë të Urdhrave të titullarit të AK, janë të ndryshëm me ato të pasqyruar në sistemin elektronik të APP për këtë procedurë prokurimi.
-Hartimi, ndryshimi dhe miratimi i Dokumenteve të Tenderit (DT), është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pikat 1 dhe 2, neni 39, pika 4, neni 56, neni 61, pika 2, për arsye se DT janë firmosur vetëm prej 2 anëtarëve nga 3 të tillë, DT janë hartuar dhe miratuar 3 ditë më para se të hartohet Procesverbali i hartimit të DT, nuk konstatohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit për Anëtarët e Njësisë së Prokurimit (NjP), afati i ekzekutimit të kontratës, në dokumentet e miratuara dhe publikuara, rezulton i ndryshëm 3 herë (1 muaj nga nënshkrimi i kontratës; nga lidhja deri në përmbushjen e saj (pa afat); Deri më 30.12.2019), është kërkuar akreditimi nga MASR i OE, ndërkohë që nga MASR akrediton modulet e trajnimit të paraqitur nga OE dhe jo OE, si dhe në 3 raste DT janë të pa argumentuara dhe jo në përpjestim me aftësinë zbatuese të kontratës.
-Është kryer pezullimi i procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 11, datë 22.05.2015 "Për procesin e pezullimit, modifikimit të dokumentave standarde të tenderit dhe shtyrjen e afatit të proçedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik".
-Një nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), është njëkohësisht edhe anëtar i NjP, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58.
-Nga shqyrtimi i sistemit elektronik për këtë procedurë, konstatohet se afati i fundit i pranimit të ofertave është data 11.11.2019, e jo data 01.11.2019, e vendosur me anë të Urdhrit të titullarit të AK nr. 714, datë 30.10.2019 "Urdhër për heqje pezullimi procedure prokurimi". Hapja e ofertave 10 ditë pas datës së përcaktuar nga titullari i AK dhe pranimi i tyre nga KVO, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 63, pika 1.
-Procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643,

datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 5, për arsye se OE A. SHPK i shpallur fitues nuk plotësonte 3 kritere, e për pasojë AK duhej të skualifikonte këtë OE (i vetmi pjesëmarrës) e të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP.
-Formulari i Njoftimit të Fituesit është dërguar 1 muaj pas përfundimit të procesit të vlerësimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 58, pika 2, ku përcaktohet se dërgohet ditën e nesërme të punës.
-Me anë të Amendamentit të Kontratës nr. 01/18, datë 13.02.2020, ka vendosur shtyrjen e afatit të realizimit të kontratës deri më datë 31.12.2020. Në lidhje me këtë shtyrje, konstatohet se:
Me anë të këtij amendamenti, titullari i AK ka shtyrë afatin e realizimit të kontratës fillestare me 10.5 muaj të tjerë, në kushtet kur sipas parashikimeve të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë, kohëzgjatja e saj ishte parashikuar vetëm 1 muaj nga nënshkrimi i kontratës.
-Në kushtet kur ka mbetur pa realizuar vetëm 49% të kontratës.
-Në kushtet kur kontrata fillestare është nënshkruar pa fonde në dispozicion, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70 dhe Udhëzimin nr. 9.1, datë 20.03.2018 "Për procedurat e zbatimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të Qeverisë", Kreu III, pika 15/b.
-Janë shmangur procedurat e LPP, duke mos zhvilluar procedurë të re, duke shkelur kështu parimet e transparencës në procedurat e prokurimit dhe barazinë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, si dhe duke shmangur ligjin e prokurimit publik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 2, pikat b dhe c dhe neni 4.

3. Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: "Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë", 2 nga modelet e paraqitura nga OE PF E.D. gjatë zbatimit të kontratës, ndryshojnë nga lista e paraqitur gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 60, pikat 1 dhe 2.

4. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion këtë procedurën e prokurimit "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve", me fond limit 13,658,300 lekë, zhvilluar nga ZVAP Mat, konstatohet se:
-Në dosjen e administruar nga ZVAP Mat për këtë procedurë, gjenden vetëm Urdhri i Prokurimit, Urdhri për ngritjen e KVO dhe Formulari i Njoftimit të Anulimit datë 16.05.2019. Përveç, këtyre dokumenteve, ZVAP Mat nuk dispononte asnjë dokumentacion tjetër për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 22, pika 4, neni 12 pika 2, Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
-Nga auditimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) të APP, konstatohet procedura është hedhur në sistem, por pas procesit të hapjes së ofertave, nuk është zhvilluar asnjë proces në SPE, çka ka sjellë që kjo procedurë, edhe pse është zhvilluar dhe anuluar (16.05.2019), nuk rezulton si e tillë në SPE (është akoma në procesin e vlerësimit të ofertave), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 72.
-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit "Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve", me fond limit 11,876,982 lekë, zhvilluar nga ZVAP Dibër, konstatohet se:
✓ Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet 2 procedura të tilla.

- ✓ Asnjëra nga këto procedura nuk është zhvilluar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të APP, por në mënyrë shkresore, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 72.
- ✓ Nuk është hartuar Urdhri i Prokurimit për këto procedura, ku të jetë e përcaktuar objekti i prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe emrat e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 60.
- ✓ Përveç Urdhrit të titullarit për ngritjen e KVO, Formularit të Njoftimit të Kontratës dhe Formularit të Njoftimit të Anulimit, ZVAP Dibër nuk dispononte asnjë dokumentacion tjetër për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 12, pika 2, neni 22, pika 4, si dhe me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13.
- ✓ Anëtarët e KVO Sh.C. dhe N.N., janë në të njëjtën kohë edhe anëtarë të komisionit për përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58.

-Nga shqyrtimi i procedurës zhvilluar me objekt "Transport mësues dhe nxënës ne Institucionet Arsimore Publike ne varësi te Z.A Bulqize", me fond limit 4,566,893 lekë, konstatohet se:

- ✓ Urdhri i prokurimit nuk përmban emrat e anëtarëve të NjP.
- ✓ 2 nga anëtarët e NjP janë njëkohësisht edhe anëtarë të KVO.
- ✓ Vendosja e z. P.L. si anëtar i NjP dhe KVO, i cili është njëkohësisht **Nëpunës Zbatues** i ZVAP Bulqizë, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e.
- ✓ Nuk është kryer argumentimi i OE të ftuar për këtë procedurë prokurimi.
- ✓ Nuk konstatohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit për Anëtarët e NjP dhe KVO.
- ✓ Nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kërkesave për kualifikim.
- ✓ Në 4 raste, janë vendosur kërkesa për kualifikim të paqarta dhe që nuk përdoren për procedurat e prokurimit të shërbimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

-Në lidhje me procesin e vlerësimit konstatohet se kualifikimi i OE A. SHPK, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53, pika 3, e për pasojë AK duhej të vazhdonte me anulimin e procedurës në zbatim të nenit 24, të LPP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 213-269, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i DRAP Durrës, si dhe Drejtorët e ZVAP Mat, Dibër dhe Durrës, të merren masat e menjëhershme për gjetjen, inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga këto njësi, për të cilat nga auditimi rezultuan se nuk disponoheshin nga këto institucione.

Brenda vitit 3-mujorit të II-të 2021

18.2 Rekomandimi: Nga Drejtori i DRAP Durrës, në bashkëpunim me ZVAP nën varësi, të merren masa për kryerjen e trajnimeve të nevojshme për punonjësit që janë pjesë të komisioneve të procedurave të prokurimit publik, me qëllim sigurimin e një procesi sa më transparent në përmbushje të qëllimit të LPP

Brenda vitit 3-mujorit të II-të 2021

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive vjetore të DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, Tiranë, Kavajë, Shijak, Mat, Dibër dhe Bulqizë, u konstatua se:
-Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 120, përcakton që: "*Ministritë dhe **institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor të mbyllur**, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*".
DRAP Durrës, edhe pse ka nën varësinë e tij 12 ZVAP e mësipërme, ka hartuar pasqyra financiare **vetëm** për këtë institucion dhe nuk ka paraqitur përmbledhësen e konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2019, për 12 njësitë e varësisë.
Mos hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për këtë institucion, ka ndikuar në mos-paraqitjen e pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimeve në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të DRAP Durrës.
-DRAP Durrës dhe ZVAP e audituara (Durrës, Tiranë, Kavajë, Shijak, Mat, Dibër dhe Bulqizë), përdornin për regjistrimet kontabël programin Microsoft Excel. Programi "Microsoft Excel" me të cilin operojnë këto njësi, nuk të ndalon mundësinë e ndryshimit të veprimeve kontabël të periudhave të mëparshme, duke lënë të hapur mundësinë për ndryshime të këtyre veprimeve.
-DRAP Durrës dhe ZVAP: Tiranë, Durrës, Shijak, Bulqizë, Mat dhe Bulqizë, Pyetjes në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare", pyetjes nr. 12 "*A ju kanë caktuar Aktive Afatgjata për përdorim që i keni evidentuar në llogarinë 107 "Aktive afatgjata në përdorim"?*", i janë përgjigjur me **JO**. Këto institucione nuk i janë përgjigjur në mënyrë të drejtë kësaj pyetje, për arsye se godinat e zyrave të këtyre institucioneve, janë në pronësi të Njësive respektive të Qeverisjes Vendore dhe këto njësi thjesht i përdorin këto godina. Për pasojë, zërin nr. 107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim", në pasqyrat financiare për këto institucione, është 0 (zero).
-Për 4 raste (ZVAP Durrës, Bulqizë, Dibër dhe Mat), për zërin "212 Ndërtesa e konstruksione", për vlerën totale 18,157,999 lekë, nuk disponohej asnjë dokumentacion dhe informacion mbi këto vlera.
-Për 5 raste (ZVAP Tiranë, Durrës, Kavajë, Dibër dhe Mat), më 31.12.2019, nuk kanë paraqitur në llogarinë "467-Kreditorë të ndryshëm", detyrimet në vlerën 9,751,520 lekë, për vendimet gjyqësore që i kanë mbërritur në institucion para datës së hartimit të këtyre pasqyrave, por që janë paguar përgjatë vitit 2020.
-Për llogarinë "212 Ndërtesa e konstruksione" me vlerë 8,293,975 lekë, që përfaqëson ndërtesën e institucionit të ZVAP Kavajë, nuk janë marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saj pranë zyrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
-ZVAP Durrës, për llogarinë "437 Organizma të tjerë shtetërorë" në vlerën 51,095 lekë dhe llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 252,120 lekë, nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere.
-ZVAP Shijak, ka paraqitur në zërin e aktiveve, vetëm nën zërin "Inventar i imët" me vlerë 900 lekë. ZVAP Shijak nuk ka paraqitur asnjë të dhënë mbi inventarin që ky institucion ka në përdorim (kompjutera, printera, etj).
-ZVAP Shijak ka paraqitur në PF e vitit 2019, zërin "3. Llogari të arkëtueshme" me vlerë 15,313,876 lekë, po pa e detajuar se nga çfarë zërash përbëhet ky llogari.
-ZVAP Shijak, për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 8,403,460 lekë, nuk disponon dokumentacion dhe informacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere.
-ZVAP Tiranë, për llogarinë "202 Studime dhe kërkime", nën kategorinë e "Aktive afatgjata jomateriale", vlera e vitit paraardhës është 3,467,346 lekë, ndërsa vlera e vitit ushtrimor 2019 është 0 (zero) lekë. Nga auditimi i pasqyrës "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (Formati nr. 7/a)" dhe "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën

neto (Formati nr. 7/b)", pjesë e pasqyrave financiare, për këtë llogari nuk ka pakësime në vlerë. Për pasojë nuk konstatohet arsyeja e mos paraqitjes së vlerës 3,467,346 lekë për llogarinë "202 Studime dhe kërkime".
-ZVAP Tiranë, për llogarinë "466 Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerë 510,158 lekë, nuk disponon dokumentacion dhe informacion mbi natyrën dhe origjinën e kësaj vlere.
-ZVAP Dibër, për llogarinë "468 - Debitorë të ndryshëm" me vlerë 58,108,800 lekë, nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi origjinën dhe natyrën e kësaj vlere.
-ZVAP Dibër, për llogarinë "202 Studime dhe kërkime" me vlerë 2,354,091 lekë, ZVAP Dibër nuk disponon informacion dhe dokumentacion mbi origjinën dhe natyrën e kësaj vlere.
-ZVAP Dibër nuk ka pasqyruar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, akordimet e fondeve nga Buxheti i Shtetit në vlerën 741,623,362 lekë.
-Për llogarinë "423,429 - Personeli, paradhënie, deficite, gjoba", në vlerën **3,225,429 lekë**, që përfaqëson detyrime të të tretëve ndaj ZVAP Dibër (ish-DAR Dibër), sipas listës prej 28 debitorësh sipas Tabelës nr. 1, në Kapitullin VI "Anekse", të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, nuk janë marrë masa për arkëtimin e këtyre vlerave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 269-294, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i DRAP Durrës, të merren masa për kryerjen e konsolidimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2019, për drejtorinë e DRAP Durrës dhe 12 ZVAP nën varësinë e saj, me qëllim përcaktimin e pozicionit financiar të këtij institucioni.

Brenda vitit 3-mujorit të I-rë 2021

19.2 Rekomandimi: Nga Drejtori i ZVAP Dibër, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 3,225,429 lekë, nga 28 debitorët sipas listës në Aneksin nr. 1, të Kreut VI, të këtij raporti.

Brenda vitit 3-mujorit të I-rë 2021

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, ka pasaktësi të shifrave të raportuara sa i takon detyrimeve të prapambetura deri më datë 31.08.2020 në DRAP Durrës. Nisur nga informacioni i vendosur fillimisht në dispozicion nga DRAP Durrës për grupin e auditimit këto shpenzime pasqyroheshin në vlerën 21,111 mijë lekë, ose rreth 8,595 mijë lekë më pak se fakti që rezultoi pas verifikimit të grupit të auditimit në 6 ZVAP. Sa më sipër si pasojë edhe e mos-konsolidimit të pasqyrave financiare të DRAP Durrës.
Në vijim, konstatuam se, në Raportin e Monitorimit 8 mujor, të MASR, për vitin 2020, janë pasqyruar vendimet e pa ekzekutuara të ZVAP Dibër në vlerë totale 10.1 milion lekë, të cilat në fakt nga verifikimi i KLSH-së rezultuan në vlerën 10.4 milion lekë.
Gjithashtu, në raportin e monitorimit të MASR nuk janë pasqyruar detyrimet e krijuara si rezultat i vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara për ZVAP Durrës në vlerë totale 2,663 mijë lekë, ZVAP Tiranë në vlerë totale 901 mijë lekë, ZVAP Kavajë në vlerë totale 901 mijë lekë, ZVAP Bulqizë në vlerë totale 734 mijë lekë.
Konstatohet gjithashtu se institucionet nuk dispononinasnjë komunikim zyrtar me gjykatat respektive, në mënyrë që të dokumentohej ndjekja e çështjeve lidhur me ish punonjësit e këtyre drejtorive, e më pas reflektimi i saktë i tyre në pasqyrat financiare dhe provigjionimi respektiv. Informacioni që subjektet dispononinpër vendimet, lidhej vetëm me dorëzimin e kërkesave për ekzekutim të fondeve nga përmbaruesit dhe në shumicën e rasteve ekzekutimi i kërkesave nuk kryhej nëse disponohej vetëm vendimi i formës së prerë nga gjykata dhe jo përmbaruesi, duke shtuar këtu edhe kostot e përmbarimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Nga të gjitha njësitë shpenzuese si dhe DRAP Durrës të merren masa, që Sektorët/njësitë që mbulojnë çështjet juridike, të ndjekin me kujdes proceset gjyqësore dhe të përcjellin informacionin e plotë dhe të saktë në njësitë që merren me financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, me shkresën nr. 1440/8, datë 30/07/2019, konstatohet se:
-DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës), nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi programin për realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, gërma "j".
-DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës (ish-DAR Durrës), nuk kanë raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit të kërkuar prej 6 muajsh, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2.

-Zbatimi i rekomandimeve të dërguara subjektit Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës me shkresën nr. 1440/8, datë 30/07/2019, rezulton si më poshtë vijon:
a. *Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 2 rekomandime, të cilat janë zbatuar.*
b. Janë rekomanduar ***16 masa organizative***, nga të cilat janë zbatuar 2 masa, nuk janë zbatuar 5 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, si dhe janë në proces zbatimi 8 masa.
c. Janë rekomanduar ***2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike***, masa të cilat nuk janë zbatuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.6, faqe 308-316, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: Drejtori i DRAP Durrës dhe Drejtori i ZVAP Durrës, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

Brenda vitit 3-mujorit të I-rë 2021

D.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në ZVAP Bulqizë, në përfundim të procesit të inventarizimit, janë konstatuar mungesa në inventar, mungesa të cilat janë pajisje kompjuterike të ish-punonjësve të cilët janë larguar nga detyra, por nuk kanë dorëzuar këto pajisje në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës. Vlera totale e pajisjeve të pa dorëzuara nga ish punonjësit, në shumën 247,178 lekë, përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.
Nga ana e komisionit të inventarizimit dhe Drejtorit të ZVAP Bulqizë, edhe pse janë konstatuar këto mangësi, nuk janë marrë masa për zhdëmtimin dhe ngarkimin me përgjegjësinë materiale të personave që i kanë patur në ngarkim këto pajisje.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 213-269, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i ZVAP Bulqizë, të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **247,178 lekë**, përkatësisht nga H.Xh. në vlerën

61,000 lekë, A.H. në vlerën 35,726 lekë, B.M. në vlerën 114,726 lekë dhe K.D. në vlerën 35,726 lekë, për pajisjet në ngarkim të cilat nuk i kanë dorëzuar pas ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës.

Menjëherë

D.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, në lidhje me shpenzimet e transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar të marra nën auditim, kanë operuar duke i kryer pagesat drejtpërdrejtë në llogaritë e mësuesve dhe te Posta Shqiptare SHA, për nxënësit. Përjashtim nga kjo mënyrë, bën vetëm ZVAP Bulqizë, edhe kjo vetëm për vitin 2019, për të cilin ka realizuar me sukses procedurën e prokurimit me objekt "*Transport mësues dhe nxënës ne Institucionet Arsimore Publike ne varesi te Z.A Bulqize*" me fond limit 4,566,893 lekë, ndërsa për vitin 2020, nuk ka realizuar një të tillë.

Në total, nga ZVAP e marra nën auditim, janë kryer pagesa në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4 dhe VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, në vlerën 157,423,324 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Institucioni	Viti 2019	Viti 2020	Shuma
1	ZVAP Tiranë	17,259,435	13,357,338	**30,616,773**
2	ZVAP Durrës	29,493,852	13,764,611	**43,258,463**
3	ZVAP Shijak	2,296,731	5,262,631	**7,559,362**
4	ZVAP Kavajë	9,915,366	2,898,507	**12,813,873**
5	ZVAP Mat	24,261,874	5,622,961	**29,884,835**
6	ZVAP Dibër	15,775,961	9,811,430	**25,587,391**
7	ZVAP Bulqizë	5,325,175	2,377,452	**7,702,627**
Shuma		**104,328,394**	**53,094,930**	**157,423,324**

Pagesa e drejtpërdrejtë në kundërshtim me kërkesat ligjore të këtyre shpenzimeve, **mbart riskun e përdorimit pa eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet** të fondeve publike me vlerë **157,423,324 lekë**.

Sa i takon vitit 2019, nisur nga fakti se DRAP Durrës ka funksionuar nga Maji 2019, prokurimi i këtyre shpenzimeve ka qenë përgjegjësi e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ish-Drejtorive Arsimore Rajonale) përkatëse.

Ndërsa për vitin 2020, prokurimi i këtyre shërbimeve, është përgjegjësi e DRAP Durrës, konfirmuar edhe me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 71/3, datë 04.02.2020, drejtuar DRAP Durrës, me anë të së cilës theksohet se këto procedura prokurimi do zhvillohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (*shkresa i është dërguar të gjithë DRAP*).

Me anë të shkresës së Drejtorit të DRAP Durrës nr. 557, datë 02.04.2020, drejtuar ZVAP nën varësi, informohet se: "...*Me krijimin e situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19 Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 2225 prot, datë 12.03.2020 "Njoftim", pezulloi shpalljen e procedurave të reja, procedurat në proces dhe zbatimet e kontratave për një periudhë 15 ditore.*

Në këto kushte DRAP Durrës nuk mund të shpallë dhe realizojë me sukses procedurën e prokurimit për transportin e nxënësve dhe mësuesve". Për sa më sipër në zbatim të shkresës së sipërcituar ***ZVAP-t të vazhdojnë pagesën e nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe zyrave postare.***". Me anë të kësaj shkrese, edhe pse APP i ka

pezulluar vetëm për 15 ditë procedurat, edhe pse deri në pezullimin e procedurave kishte ende 3 muaj kohë për realizimin e këtyre procedurave, Drejtori i DRAP Durrës ka vendosur të marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i udhëzuar ZVAP të vazhdojnë pagesat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur kështu LPP.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 213-269, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i DRAP Durrës, të merren masa për realizimin me sukses të procedurave të transportit të nxënësve dhe mësuesve, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në rast të konstatimit të vështirësive në implementimin e këtij kuadri ligjor, të bëhen propozimet përkatëse të mbështetura në evidenca dhe fakte konkrete, duke rishikuar kriteret dhe kryer një analize të kosto-efektivitetit të këtyre procedurave, në funksion të shërbimit të transportit të nxënësve dhe mësuesve, si përfituesit e këtij shërbimi.

Brenda vitit 3-mujorit të I-rë 2021

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit zhvilluar me objekt: "Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë", me fond limit 2,636,566 lekë, u konstatua se nga përllogaritja e fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2, Buxhetit të Shtetit i është shkaktuar **efekt financiar negativ në vlerën 316,388 lekë**, që përbën diferencën ndërmjet çmimit të ofertës së OE të shpallur fitues dhe çmimit të kontratës së mëparshme, për arsye se komisioni i përllogaritjes së fondit limit nuk ka argumentuar arsyen e përzgjedhjes së metodës së studimit të tregut, në hartimin e fondit limit, nuk ka argumentuar përzgjedhjen e OE të marrë në studim tregu, në kushtet kur sipas verifikimeve të kryera në QKB, nga 3 OE e marrë në studim tregu, vetëm OE PF E.D. ka për objekt aktiviteti kryerjen e shërbimeve të modelingut, ndërsa OE S.O. SHPK dhe I.C. SHPK, nuk kanë për objekt aktiviteti kryerjen e shërbimeve të modelingut, si dhe nuk ka argumentuar përse nuk ka përzgjedhur si metodë të përllogaritjes së fondit limit, vlerën e kontratave të mëparshme, në kushtet kur gjatë vitit 2018, ky shërbim është kryer me çmimin 267 lekë/ora.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 213-269, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtori i ZVAP Tiranë, të shqyrtojë vlerën 316,388 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në përllogaritjen e vlerës së kontratës të procedurës të prokurimit me objekt "Modele pikture për shkollën "Jordan Misja", Tiranë", si dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit.

Brenda vitit 3-mujorit të I-rë 2021

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt "*Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12*", me fond limit 7,000,000 lekë, OE A. SHPK, nuk i ka realizuar shërbimet brenda afateve të përcaktuara në kontratën nr. 01/18, datë 24.12.209, të ndryshuar me Amendamentin e datës 24.12.2019, e për pasojë nga AK duhej të përllogariteshin dëme të likuidueshme për kryerjen e vonuar të shërbimeve, në vlerën **32,738 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për llogari të Buxhetit të Shtetit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 213-269, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtori i DRAP Durrës, të shqyrtojë vlerën **32,738 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në zbatimin e kontratës me objekt "*Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12*", si dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit.

Brenda vitit 3-mujorit të I-rë 2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultuan shpenzime jo efektive në buxhetin e shtetit në vlerë **29,706 mijë lekë**, si rezultat i 21 vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve; nga të cilat ekzekutuar vlera prej **14,087 mijë lekë**, dhe konstatuar **15,618 mijë lekë që** i përkasin vendimeve të formës së prerë të pa ekzekutuara deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve nga ana e ZVAP-eve nën juridiksionin e DRAP Durrës.
Më hollësisht, për vitin **2019** janë konstatuar vendime gjyqësore në vlerë 17,219 mijë lekë, nga të cilat ekzekutuar vlera prej 11,694 mijë lekë dhe 5,525 mijë lekë rezultojnë të pa ekzekutuara. Për vitin **2020** janë konstatuar vendime gjyqësore në vlerë 12,487 mijë lekë, nga të cilat ekzekutuar vlera prej 2,393 mijë lekë, dhe 10,093 mijë lekë rezultojnë të pa ekzekutuara deri në përfundim të periudhës objekt auditimi.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: DRAP Durrës në bashkëpunim me ZVAP-et nën juridiksionin e saj, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për vendimet gjyqësore që u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, për vlerën e ekzekutuar prej **14,087 mijë lekë**, si dhe për vlerën e konstatuar në vendimet e formës së prerë, por ende të pa ekzekutuar në vlerë **15,618 mijë lekë,** me efekt negativ në buxhetin e shtetit si pasojë e menaxhimit pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet.

Brenda 6 mujorit të parë 2021

5. Gjetje nga auditimi: Pas miratimit të VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 "*Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", strukturat përgjegjëse për ofrimin dhe sigurimin e arsimit cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar janë riorganizuar, proces ky i shoqëruar me kosto financiare për buxhetin e shtetit. Më hollësisht, **82 punonjës të liruar nga shërbimi civil** kanë qenë përfitues të pagesës për dëmshpërblim në vlerë totale **28,148,574 lekë**, në vijim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e cila përcakton se: "*Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, ...*". Kjo shumë është ekzekutuar nga DRAP Durrës në muajit gusht dhe shtator të vitit 2019 përkatësisht në vlerën 23,926,287 lekë dhe 4,331,286 lekë, në vijim të shkresës nr. 256, datë 18.07.2019 përcjellë nga Drejtori i DRAP Durrës me listën e përfituesve. Nga auditimi konstatojmë se, 82 punonjësit të cilët kanë përfituar pagesë për dëmshpërblim janë komanduar në ZVAP-të në juridiksionin e DRAP Durrës, ose në DRAP.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 53-213, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

E. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

Referuar shkeljeve të konstatuara në lidhje me shpenzimet e transportit për mësuesit dhe nxënësit, të kryera nga Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Durrës, Shijak, Kavajë, Mat, Dibër dhe Bulqizë, të përshkruara në gjetjen 1/ paragrafi C "Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike", dhe trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe përgjegjësive individuale të evidentuara dhe pasqyruara në këtë raport, mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe*

Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, me qëllim marrjen e masave disiplinore ose administrative, për mos zhvillimin e procedurave të prokurimit për transportin e mësuesve dhe nxënësve, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, neni 4 dhe VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 3, për titullarët e AK si vijon:

1. V.L., në cilësinë e drejtorit të DRAP Durrës;
2. R.D., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Tiranë;
3. S.K., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Tiranë;
4. E.A., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Tiranë dhe titullarit të ZVPA Durrës;
5. L.M., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Durrës;
6. J.M., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Durrës;
7. B.K., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Shijak;
8. S.P., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Kavajë;
9. M.C., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Kavajë;
10. Sh.T., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Mat;
11. A.H., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Dibër;
12. B.D., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Dibër;
13. K.K., në cilësinë e titullarit të AK ZVAP Bulqizë.

F. MASA DISIPLINORE

F.1. PËR MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar dhe Kontratat Individuale të Punës, i rekomandojmë **Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë**, që të ngrejë një grup punë me qëllim që, në varësi të analizës së përgjegjësive, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, ***konkretisht***:

1. S.H., në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ngarkuar me përgjegjësi për nxjerrjen e shkresës nr. 246, datë 30.07.2020, ku ZVAP-et udhëzohen se të paturit certifikatën e Shkollës së Drejtorëve do të konsiderohet prioritet gjatë procedurave të rekrutimit dhe jo domosdoshmëri, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; si dhe për të gjitha problematikat që kanë rrjedhur në vijim të këtij urdhri në procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtueseve të IPAP.

F.2. PËR DREJTORINË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar dhe Kontratat Individuale të Punës, i rekomandojmë **Drejtorit të DRAP Durrës**, që në bashkëpunim me **DPAP**, të ngrejë një grup punë me qëllim që, në varësi të analizës së përgjegjësive, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, ***konkretisht***:

Për mos identifikimin e problematikave të konstatuara në procedurat e konkurrimit për përzgjedhjen e drejtorëve të IPAP nga komisionet e vlerësimit:
1. E.A., në pozicionin e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë. Përgjegjëse gjithashtu për vonesat në dorëzimin e dokumentacioneve në DRAP Durrës; trajtim me standard të ndryshëm të procedurave të rekrutimit ndjekur nga komisionet e vlerësimit; dhe lëshim të vërtetimeve për masa disiplinore jo në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.
2. J.M., në pozicionin e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës.
3. Xh.B., në pozicionin e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë. Përgjegjëse gjithashtu për vonesat në dorëzimin e dokumentacioneve në DRAP Durrës.
4. B.D., në pozicionin e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Dibër.
5. K.K., në pozicionin e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë.
6. Sh.T., në pozicionin e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Mat.

Për mos vënien në dispozicion të grupit të auditimit, procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim Interneti 2019":
7. B.G., në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve në ZVAP Durrës.

F.3. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.
Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.
Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishin propozuar për masa disiplinore, për:
1. V.L., me detyrë dhe në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, për periudhën 05.04.2019-09.10.2020.
2. L.M., me detyrë dhe në cilësinë e Drejtorit të ish-DAR Durrës deri në maj 2019, përgjegjëse për mos dorëzim të detyrës pas largimit nga puna.

Grupi i Auditimit:

A.G.

J.T.

M.K.

Drejtori i Departamentit

A.J.

V. ANEKSE

Aneksi nr.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
Nga faqja nr.22 deri në nr. 52 e Raportit Përfundimtar

Aneksi nr. 1. 1
Planifikimi fillestar i buxhetit për vitin **2019**, dhe ndryshimet përgjatë vitit.

Në mijë lekë

BUXHETI					Plani 2019								
					Shtesa						Pakësime		Plani final
					Plani fillestar (Shkresa nr. 5723, datë 29.05.2019)	Shkresa nr. 3490/1, datë 20.06.2019	Shkresa nr. 14187/1, datë 31.07.2019)	Shkresa nr. 7372/1, datë 07.08.2019	Shkresa nr. 9240/1, datë 29.10.2019	Shtesë fondi (Shkresa mungon)	Shkresa nr. 8186/1, datë 17.09.2019	Shkresa nr. 9891/1, datë 12.11.2019)	
Llog	Prog	Kodi	Produkti	Emërtimi	Shpenzime Korente								
600	01110	91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Paga	6,300						-730		5,570
601		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Sigurime Shoqërore	1,052						-100		952
602		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Mallra dhe shërbime të tjera		450							450
		91101AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar			1,316							1,316
		91101AC	Drejtuesve të institucioneve arsimore të trajnuar			400							400
		91101AD	Akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara			940							940
606		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Transferta Buxhetore			28,148	109	44				28,301
Total Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim (A)					**7,352**	**3,106**	**28,148**	**109**	**44**	**0**	**-830**	**0**	**37,930**
602	09120	91103AE	Mësues të arsimit bazë të trajniar për kurrikulën e re	Mallra dhe shërbime të tjera		5,000				3,000		-3,000	
Total Programi Arsimi Bazë (B)					**0**	**5,000**	**0**	**0**	**0**	**3,000**	**0**	**-3,000**	**5,000**
602	09230	91104AC	Mësues të AML të trajnar kurrikulën kl 10, 11, 12.	Mallra dhe shërbime të tjera		3,000							
Total Programi Arsimi Mesëm (C)					**0**	**3,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**3,000**
Totali (A) + (B) + (C)					**7,352**	**11,106**	**28,148**	**109**	**44**	**3,000**	**-830**	**-3,000**	**45,930**

Burimi: DRAP Durrës dhe përpunuar grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr. 1.2
Planifikimi fillestar i buxhetit për periudhën janar-gusht 2020, dhe ndryshimet përgjatë vitit.

Në mijë lekë

BUXHETI					Fakti 2019	Plani 2020								Plani final
						Buxheti Fillestar		Pakësime						
						PBA 2020-2022 *(në mijë lekë)*	Buxheti 2020 (Shkresa nr. 11168/3, datë 27.01.2020)	Pakësim fondi (Shkresa nr. 1063/1, datë 24.02.2020)	Pakësim fondi (Shkresa nr. 6865/122 datë 13.05.2020	Pakesim fondi (Shkresa nr. 3567, datë 17.07.2020)	Pakesim fondi (Shkresa nr. 3955, datë 22.07.2020)	Pakesim fondi (Shkresa nr. 14152/1, datë 29.07.2020)	Pakësim fondi (Shkresa nr. 1240/19 datë 14.08.2020)	
Llog	Prog	Kodi	Prod	Emër.	SHPENZIME KORENTE									
PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM														

600	01110	91101AE	Veprimtaria e MASR sipas kërkesave ligjore	Paga	4,684	11,709	10,440							10,440
601		91101AE		Sigurime Shoqërore	783	1,862	1,743							1,743
602		91101AE		Mallra dhe shërbime të tjera	446	14,120	1,005							1,005
		91101AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar		805		900							900
		91101AC	Drejtuesve të institucione ve arsimore të trajnuar		0		0							
		91101AD	Akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara		939		0							
606	01110	91101AE	Veprimtaria e MASR sipas kërkesave ligjore	Transferta Buxhetore	28,301	300	0							
Totali (A)					**35,963**	**27,991**	**14,088**							**14,088**
ARSIMI BAZE														
602	09120	91103AE	Mësues të arsimit bazë të trajniar për kurrikulën e re	Mallra dhe shërbime të tjera	0		7,000							7,000
602	09120	91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjecar	Mallra dhe shërbime të tjera	N/A		35,000	-7,520	-8,000		-6,000	-2,000	-1,690	9,789
Totali (B)							**42,000**	**-7,520**	**-8,000**	**0**	**-6,000**	**-2,000**	**-1,690,**	**16,789**
ARSIMI I MESËM														
602	09230	91104AA	Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike	Mallra dhe shërbime të tjera	N/A		18,102	-3,800	-6,000	-621	-1,000		-361	6,319
602	09230	91104AC	Mësues të AML të trajnar kurrikulën kl 10, 11, 12.	Mallra dhe shërbime të tjera	0		1,500							1,500
Totali (C)							**19,602**	**-3,800**	**-6,000**	**-621**	**-1,000**		**-361,**	**7,819**
					SHPENZIME KAPITALE									
231				Shpenzime kapitale të trupëzuara	N/A	47,850	0							0
Totali (D)						**47,850**								**0**
TOTAL (A+ B+C+D)					**35,963**	**75,841**	**75,690**	**-11,320**	**-14,000**	**-621**	**-7,000**	**-2,000**	**-2,051**	**38,697**

Burimi: DRAP Durrës dhe përpunuar grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr. 1.3

Niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2019, sipas 3 programeve në llogaritë respektive:

Në mijë lekë

Viti 2019										
BUXHETI						**Plani fillestar**	**Plani final**	**Fakti**	**Diferenca**	**Realizimi (%)[51]**
Llog	**Programi**		**Kodi**	**Produkti**	**Emërtimi**	**Shpenzimet Korente**				
600	**01110**	Planifikim, Menaxhim, Administrim	91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Paga	6,300	5,570	4,684	-885	84.11%
601			91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Sigurime Shoqërore	1,052	952	783	-168	82.32%
602			91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Mallra dhe shërbime të		450	446	-4	99.32%
			91101AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar			1,316	805	-511	61.20%

[51] Niveli i realizimit kundrejt planifikimit të rishikuar

			91101AC	Drejtuesve të institucioneve arsimore të trajnuar	tjera		400	0	-400	0.00%
			91101AD	Akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara			940	939	-2	100.00%
606			91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Transferta Buxhetore		28,301	28,301	0	100.00%
Total Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim						7,352	37,930	35,963	-1,967	95%
602	09120	Arsimi Baze	91103AE	Mësues të arsimit bazë të trajniar për kurrikulën e re	Mallra dhe shërbime të tjera		5,000	0	-5,000	0.00%
602	09230	Arsimi i Mesëm	91104AC	Mësues të AML të trajnar kurrikulën kl 10, 11, 12.	Mallra dhe shërbime të tjera		3,000	0	-3,000	0.00%
TOTAL						7,352	45,930	35,963	-9,967	78.30%

Burimi: DRAP Durrës dhe përpunuar grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr. 1.4

Niveli i realizimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2020, sipas 3 programeve në llogaritë respektive:

Në mijë lekë

BUXHETI					Viti 2019	PBA 2020-2022 *(në mijë lekë)*	Viti 2020				
							Plani fillestar	Plani final i rishikuar deri në 31.08.2020	Realizimi faktik deri në 31.08.2020	Diferenca	Realizimi (%)
Llog	**Prog**	**Kodi**	**Produkti**	**Emërtimi**			**Shpenzime Korente**				
PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM											
600	01110	91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Paga	4,684	11,709	10,440	10,440	6,285	4,154	66%
601		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Sigurime Shoqërore	783	1,862	1,743	1,743	1,054	689	65%
602		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Mallra dhe shërbime të tjera	446	14,120	1,005	1,005	308	696	30%
		91101AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar		805		900	900	0	900	0%
		91101AC	Drejtuesve të institucioneve arsimore të trajnuar		0		0	0	NA	NA	NA
		91101AD	Akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara		939		0	0	NA	NA	NA
606		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Transferta Buxhetore	28,301	300	0	0	NA	NA	NA
Totali (1)					**35,963**	**27,991**	**14,088**	**14,088**	**7,648**	**6,440**	**54%**
					Shpenzime kapitale						
231	NA	NA	NA	Shpenzime kapitale të trupëzuara		47,850					
Totali (2)						**47,850**					
TOTALI A (1)+(2)					**35,963**	**75,841**	**14,088**	**14,088**	**7,648**	**6,440**	**54%**
ARSIMI BAZË											
602	09120	91103AE	Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0	7,000	7,000	3,100	3,900	44%
602	09120	91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjecar	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0	35,000	9,789	0	9,789	0%
Totali (B)					**0**	**0**	**42,000**	**16,789**	**3,100**	**13,689**	**18%**
ARSIMI I MESËM											
602	09230	91104AA	Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0	18,102	6,319	0	6,319	0%
602	09230	91104AC	Mësues të AML të trajnuar kurrikulën kl 10, 11, 12.	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0	1,500	1,500	1,064	435	70%

Totali (C)	**0**	**0**	**19,602**	**7,819**	**1,064**	**6,754**	**13%**
TOTAL (A+ B+C)	**35,963**	**75,841**	**75,690**	**38,697**	**11,813**	**26,884**	**30%**

Burimi: DRAP Durrës dhe përpunuar grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr.1.5

Objektivat dhe njësia matëse e produkteve të programeve të buxhetit të DRAP Durrës, krahasuar me shpenzimet e përfshira në to për vitin 2019 dhe 2020

DRAP Durrës shpenzime në nivel programi dhe produkti 2019-2020						
Programi	**Përshkrimi**	**Kodi**	**Përshkrimi i produktit sipas MASR**	**Njësia matëse**	**Produktet e përfshira 2020**	**Produktet e përfshira 2019**
01110	Planifikim , Menaxhim, Administrim	91101AE	**Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore**	Nr . i punonjësve përfitues	Internet, tonera, dieta	Posta, dieta,postera
					Siguracion, taksa makine, detergjent	Material të tjera
		91101 AA	**Punonjës dhe specialiste te trajnuar"** Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese/Trajnimi çdo vit për 100-110 drejtues të institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor	Nr . drejtuesve te trajnuar nr . I auditimeve dhe inspektimeve te realizuara	-	kancelari Pjesë këmbimi internet Material të tjera
		91101AD	Aktet ligjore dhe nënligjore të hartuara	Nr . I akteve te miratuar	-	Pjesë këmbimi, naftë
		91101AC	Drejtuesve te institucioneve arsimore te trajnuar "Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese në masën 10-15% nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese"	Nr punonjësve përfituese	-	Kontrate për trajnim (buxhetuar, realizimi 0%)
09120	Arsimi Bazë	91103 AE	Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re" Trajnimi i mësuesve te arsimit baze, për implementimin e kurikulave e programeve mësimore, rritjen e kompetencave profesionale	Nr. mësuesve te trajnuar	Kontrata e trajnimit	
		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçar.	Nr. fëmijëve qe ndjekin arsimin 9-vjecar	Transferuar në ZVAP-e gjatë vitit (realizimi 0% në DRAP)	
09230	Arsimi i Mesëm	91104AA	Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë ne institucionet arsimore publike.	Nr. nxënësve qe përfitojnë shërbim arsimor	Transferuar në ZVAP-e gjatë vitit (realizimi 0% në DRAP)	
		91104AC	"Mësues të AML të trajnuar kurrikulën kl 10, 11, 12"	Nr.i mësuesve te trajnuar	Kontrata e trajnimit	

Burimi: DRAP Durrës dhe përpunuar grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr. 1.6

Planifikimi dhe ndryshimet në buxhetin e ZVAP Tiranë për vitin 2019

Në mijë lekë

BUXHETI		**Plani 2019**												**Plani final**
		Buxheti Fillestar Shkresa nr. 13287/2 dt 19.01.2019	**Shtesa/ Pakësime**											
			Qershor	**Korrik**	**Shkresa 9240/1 dt 29.10.2019**	**Shkresa 11.04.2019**	**Shtese**	**Shtese**	**Shtator**	**Shkresa 29.09.2019**	**Dhjetor**	**Dhjetor**	**xx**	
Llog	**Prod**	**SHPENZIME KORENTE**												
PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM														
600	91101AE	21,580	-2,100	-2,769										16,710
601	91101AE	3,603	-350	-841										2,411
602	91101AE	647												647
	91101AA	500												500
	91101AC	0												0
	91101AD													0
606	91101AE	0			168									168
Totali (A)		**26,330**	**-2,450**	**-3,610**	**168**									**20,437**
ARSIMI BAZE														
600	91103AB	1,614,331					67,535	393,215	-7,000		31,000	3,747		2,102,830
600	91103AC	61,712			-7,506						-28,258			25,947

601	91103AB	260,206			-1,440		10,130	60,401			1-,440	14,056		344,794
601	91103AC	9,997							-150		-9,440			407
602	91103AE	0												0
602	91103AB	11,110						8,000				-10,000		9,110
602	91103AD	0						5,000				17,000		22,000
606	91103AB	0				1,064		144	62			4,091	900	6,264
606	91103AG	0								34,630		49,231	262	84,124
Totali (B)		**1,957,357**			**-8,946**	**1,064**	**77,665**	**466,761**	**-7,087**	**34,630**	**-5,258**	**78,127**	**1,163**	**2,595,477**
ARSIMI I MESËM														
600	91104AA	756,247	110,811		29,870						5,076			902,005
601	91104AA	128,797	19,063		4,480						8,015			160,356
602	91104AA	3,217	1,500											4,717
602	91104AB	3,434												3,434
602	91104AC	0												0
606	91104AE	0	30	1,585		426					305,200			2,347
606	91104AG	0		6,801										6,801
Totali (C)		**891,697**		**8,387**	**34,351**	**426**					**13,397**			**1,079,663**
SHPENZIME KAPITALE														
231		0												0
Totali (D)		**0**												**0**
TOTAL (A+ B+C+D)		**2,875,385**	**-2,450**	**-3,183**	**25,572**	**132,469**	**77,665**	**475,148**	**6,309**	**34,630**	**-5,258**	**78,127**	**1,163**	**3,695,578**

Burimi: ZVAP Tiranë dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr. 1.7

Planifikimi dhe ndryshimet në buxhetin e ZVAP Tiranë për periudhën janar-gusht 2020

Në mijë lekë

BUXHETI					Fakti 2019	Plani 2020						Plani final
						Buxheti Fillestar	Shtesa/ Pakësime					
							Pakësim fondi Korrik	Shtese fondi, shkresa 4109 dt 29.07.2002	xx	xx	xx	
Llog	**Prog**	**Kodi**	**Prod**	**Emër.**	**SHPENZIME KORENTE**							
PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM												
600		91101AE			16,710	17,400	-3,000	2,900				17,300
601		91101AE			2,411	2,905		484,300				3,390
602		91101AE			1,037	800						800
		91101AA			92	300						300
		91101AC			0	0						0
		91101AD			0	0						0
606		91101AE			168	0						0
Totali (A)					**20,420**	**21,405**	**-3,000**	**3,384**				**21,790**
ARSIMI BAZE												
600		91103AB			2,128,777	2,351,854			149,300			2,501,154
600		91103AC				61,712						61,712
601		91103AB			345,201	352,923			22,400			375,323
601		91103AC				9,997						9,997
602		91103AA			475	0						0
602		91103AE			0	0						0
602		91103AB			20,163	0					1,690	1,690
602		91103AD			0	36,534						36,534
606		91103AB			90,013	0				2,421		2,421
Totali (B)					**2,584,631**	**2,813,021**			**149,300**	**2,421**	**1,690**	**2,988,833**
ARSIMI I MESËM												
600		91104AA			902,005	756,247	46,900	191,224				994,371
601		91104AA			160,356	128,797	7,900	40,228				176,926
602		91104AA			4,124	0				621	280	901
602		91104AB			2,220	1,000						1,000
602		91104AC			0	0			366			366
606		91104AA			9,000	0						0
Totali (C)					**1,077,708**	**886,045**	**54,800**	**231,452**	**366**	**621**	**280**	**1,173,566**
SHPENZIME KAPITALE												
231		Shpenzime kapitale të trupëzuara			N/A							0
Totali (D)					**0**	**0**						**0**
TOTAL (A+ B+C+D)					**3,682,760**	**3,720,472**	**226,500**	**228,452**	**3,750**	**3,043**	**1,970**	**4,184,190**

Burimi: ZVAP Tiranë dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr. 1.8

Realizimit të buxhetit të vitit 2019 për ZVAP Tiranë, sipas 3 programeve në nivel produkti në llogaritë respektive, trajtuar në bazë të planit fillestar dhe atij faktik.

Në mijë lekë

BUXHETI					Viti 2019				
					Plani fillestar	Plani final i rishikuar deri në 31.12.2019	Realizimi faktik 2019	Diferenca[52]	Realizimi (%)[53]
Llog	**Prog**	**Kodi**	**Produkti**	**Emërtimi**	**Shpenzime Korente**				
PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM (01110)									

[52] Kundrejt planit të rishikuar

[53] Kundrejt planit të rishikuar

600		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Paga	21,580	16,710	16,710	0	100%
601		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Sigurime Shoqërore	3,603	2,411	2,411	0	100%
602		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Mallra dhe shërbime të tjera	647	647	1,037	390	160%
		91101AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar		500	500	92	-408	18%
		91101AC	Drejtuesve të institucioneve arsimore të trajnuar		0		0		
		91101AD	Akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara		0		0		
606	01110	91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Transferta Buxhetore	0	168	168	0	100%
Totali (1)					**26,330**	**20,437**	**20,420**	**-17**	**99%**
Shpenzime kapitale									
231	NA	NA	NA	Shpenzime kapitale të trupëzuara	**0**	**0**	**0**		
Totali (2)					**0**	**0**	**0**		
TOTALI A (1)+(2)					**26,330**	**20,437**	**20,420**	**-17**	**99%**
ARSIMI BAZË (09120)									
600		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçar.		1,614,331	2,102,830	2,128,777	0	100%
600		91103AC	Fëmijë ne nevoje qe përfitojnë shërbim arsimor cilësor.		61,712	25,947			
601		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçar.		260,206	344,794	345,201	0	100%
601		91103AC	Fëmijë ne nevoje qe përfitojnë shërbim arsimor cilësor.		9,997	407			
602	09120	91103AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar		0		475	--	--
602		91103AE	Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re	Mallra dhe shërbime të tjera	0		0	-	
602		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar	Mallra dhe shërbime të tjera	11,110	9,110	20,163	-8,853	64%
602		91103AD				22,000			
606		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçar.			6,264	90,013	-375	99%
606		91103AG				84,124			
Totali (B)					**1,957,357**	**2,595,477**	**2,584,631**	**-10,846**	**99%**
ARSIMI I MESËM (09230)									
600		91104AA	Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike		756,247	902,005	902,005	0	100%
601					128,797	160,356	160,356	0	100%%
602				Mallra dhe shërbime të tjera	3,217	4,717	4,124	-593	87%
	09230	91104AB	Mësues te AML qe përfitojnë shërbimin e transportit.		3,434	3,434	2,220	-1214	64%
602		91104AC	Mësues të AML të trajnuar kurrikulën kl 10, 11, 12.	Mallra dhe shërbime të tjera			0		
606		91104AE	Nxënës të grupeve sociale në nevojë që përfitojnë tekste arsimore falas			2,347	9,000	-148	98%
606		91104AG	N/A			6,801			
Totali (C)					**891,697**	**1,079,663**	**1,077,708**	**-1,955**	**99%**
TOTAL (A+ B+C)					**2,875,385**	**3,695,578**	**3,682,760**	**-12,818**	**99%**

Burimi: ZVAP Tiranë dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr. 1.9

Realizimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2020 për ZVAP Tiranë, sipas 3 programeve në nivel produkti në llogaritë respektive, trajtuar në bazë të planit fillestar dhe atij faktik.

Në mijë lekë

BUXHETI					**Fakti 2019**		**Viti 2020**				
						PBA 2020	**Plani fillestar**	**Plani final i rishikuar deri në 31.08.2020**	**Realizimi faktik deri 31.08.2020**	**Diferenca**	**Realizimi (%)**
Llog	**Prog**	**Kodi**	**Produkti**	**Emërtimi**		**Shpenzime Korente**					
PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM (01110)											
600	01110	91101AE	Veprimtari e MASR sipas	Paga	16,711	16,766	17,400	17,300	9,883	-7,417	57%

			kërkesave ligjore								
601		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Sigurime Shoqërore	2,411	2,667	2,906	3,390	1,650	-1,740	48%
602		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Mallra dhe shërbime të tjera	1,130	3,220	800	800	698	-102	87%
		91101AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar				300	300	188	112	62%
		91101AC	Drejtuesve të institucioneve arsimore të trajnuar				0	0	0		
		91101AD	Akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara				0	0	0		
606		91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Transferta Buxhetore			0	0	0		
Totali (1)					**20,420**	**22,653**	**21,406**	**21,790**	**12,420**	**-9,370**	**56%**
					Shpenzime kapitale						
231	Shpenzime kapitale të trupëzuara						**0**		**0**		
Totali (2)							**0**		**0**		
TOTALI A (1)+(2)											
	ARSIMI BAZË (09120)										
600	09120	91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar	Paga	2,128	2,828	2,351,854	2,501,154	1,655,188	-907,678	64%
600		91103AC	Fëmijë ne nevoje qe përfitojnë shërbim arsimor cilësor.				61,712	61,712			
601		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar	Sigurime Shoqërore	345,202	449,798	352,923	375,323	287,270	-97,950	74%
601		91103AC	Fëmijë ne nevoje qe përfitojnë shërbim arsimor cilësor.				9,997	9,997			
		91103AA	Punonjës dhe specialiste të trajnuar	Mallra dhe shërbime të tjera			0	0	0		
602		91103AE	Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re		20,639	30,840	0	0	0		
602		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar				0	1,690	0	-1,690	0%
606		91103AD	Nxënës dhe mësues qe u garantohet shërbimi i transportit.	Transferta Buxhetore			36,534	36,534	15,323	-21,211	41%
							0	2,471	2,141	-330	86%
Totali (B)					**2,584**	**3,343**	**2,813,021**	**2,988,833**	**1,959,924**	**-1,028,909**	**65%**
	ARSIMI I MESËM (09230)										
600	09230	91104AA	Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike	Paga	902,006	1,092	947,472	994,371	633,013	-361,358	63%
601				Sigurime Shoqërore	160,357	173,839	169,027	176,926	111,856	-65,070	63%
602				Mallra dhe shërbime të tjera	6,345	22,860	0	901	621	-280	68%
602		91104AB	Mësues të AML që përfitojnë shërbimin e transportit				1,000	1,000	1,000	0	100%
602		91104AC	Mësues të AML të trajnuar kurrikulën kl 10, 11, 12.				0		0		
606		91104AC		Transferta Buxhetore			0	366	273	-93	75%
Totali (C)					**1,077**	**1,289**	**1,117,499**	**1,173,566**	**746,765**	**-426,801**	**64%**
TOTAL (A+ B+C)					**3,682**	**4,656**	**3,951,926**	**4,184,190**	**2,719,110**	**1,393,080**	**64%**

Burimi: ZVAP Tiranë dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Aneksi nr.1.10

Objektivat dhe njësia matëse e produkteve të programeve të buxhetit të ZVAP Tiranë krahasuar me shpenzimet e përfshira në to për vitin 2019 dhe 2020

ZVAP Tiranë shpenzime në nivel programi dhe produkti 2019-2020						
Programi	**Përshkrimi**	**Kodi**	**Përshkimi i produktit sipas MASR**	**Njësia matëse**	**Produktet e përfshira**	**Produktet e përfshira 2019**

					2020	
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	91101AE	Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore	Nr. i punonjësve përfitues	Kancelari	Kancelari
					Karburant	Karburant
		91101 AA	Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese/Trajnimi çdo vit për 100-110 drejtues të institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor	Nr. drejtuesve te trajnuar nr. i auditimeve dhe inspektimeve te realizuara	Pastrim dhe gjelbërim	
					Elektricitet	Elektricitet
					Ujë	
					Telefoni	Telefoni
					Te tjera materiale	Te tjera materiale
09120	Arsimi Bazë	91103 AD	Nxënës dhe mësues qe u garantohet shërbimi i transportit. (Shërbim transporti për afro 28 - 30 000 nxënës dhe 9 000 mësues që punojnë mbi 5 km nga vend banimi i tyre dhe të nxënësve që mësojnë mbi 2 km jashtë vendbanimit të tyre.)	Nr. mësuesve dhe nxënësve qe përfitojnë shërbim transporti	Blerje uniforma	-
					bexha	
					Transport	
					Materiale	
		91103 AA	Fëmijët e grup moshës 3-6 vjeç qe ndjekin programin parashkollor.	Nr. femijeve qe ndjekin arsimin parashkollor	-	Modelim pikture
		91103AB	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçar.	Nr. fëmijëve qe ndjekin arsimin 9-vjecar	-	Telefonike, gjelbërim, vendime gjyqësore, dieta matura,transport, kancelari, modele,ripasim, akordim piano, materiale
09230	Arsimi i Mesëm	91104AA	Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë ne institucionet arsimore publike.	Nr.nxënësve që përfitojnë shërbim arsimor	Shpenzime gjyqësore	Shpenzime transporti, Energji Elektrike
		91104AB	Mësues të AML që përfitojnë shërbimin e transportit	Nr.mësuesve që përfitojnë shërbim transporti	Blerje uniforma liceu	Shpenzime elektrike Loro borici, internet, sigurim jete, shpenzime modele

Burimi: Grupi i auditimit KLSH

Aneksi nr. 2 *Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit*",
Nga faqja nr. 269 deri në nr. 294 të Raportit Përfundimtar

Aneksi nr.2.1– Lista e debitorëve ndaj ZVAP Dibër (ish-DAR Dibër), të cilët janë pasqyruar në llogarinë "423, 429 - Personeli, paradhënie, deficite, gjoba",

Nr.	Subjekti	Vlera
1	Subjekti "P."	49,065
2	Subjekti "4G."	248,204
3	Subjekti "V."	185,436
4	Subjekti "E.K."	1,041,106
5	Subjekti "Sh."	189,759
6	B.I.	100,000
7	F.P.	50,000
8	Xh.H.	100,000
9	F.E.	2,305
10	M.F.	86,300
11	F.S.	49,800
12	L.G.	45,400
13	V.K.	19,900
14	F.D.	53,900
15	G.H.	115,400
16	D.M.	68,500
17	A.M.	42,400
18	L.N.	81,500
19	Sh.H.	60,500
20	S.T.	30,400
21	N.K.	39,900
22	I.B.	85,400
23	F.K.	47,200
24	S.Sh.	176,800
25	M.H.	45,800
26	F.D.	105,800
27	D.H.	60,700
28	B.J.	43,954
Shuma		**3,225,429**

Aneksi nr. 2 2– Urdhër shpenzimet, objekt verifikimi nga grupi i KLSH-së

Nr.	Urdhër-Shpenzimi		Vlera (lekë)	Institucioni
	Nr.	Datë		
1	26	26/05/2020	4,164,736	DRAP Durrës
2	177	09/07/2019	4,379	ZVAP Tiranë
3	178	09/07/2019	65,803	ZVAP Tiranë
4	179	09/07/2019	8,380	ZVAP Tiranë
5	183	09/07/2019	68,837	ZVAP Tiranë
6	184	09/07/2019	1,921,838	ZVAP Tiranë
7	185	09/07/2019	2,464	ZVAP Tiranë
8	211	10/07/2019	2,723,600	ZVAP Tiranë
9	180	11/07/2019	1,177,991	ZVAP Tiranë
10	241	05/08/2019	1,242,300	ZVAP Tiranë
11	429	13/12/2019	3,784	ZVAP Tiranë
12	430	13/12/2019	213,121	ZVAP Tiranë
13	431	13/12/2019	105,708	ZVAP Tiranë
14	432	13/12/2019	3,945,878	ZVAP Tiranë
15	458	13/12/2019	1,404,920	ZVAP Tiranë
16	433	13/12/2019	4,370,432	ZVAP Tiranë
17	59	19/02/2020	942,547	ZVAP Tiranë
18	60	19/02/2020	51,975	ZVAP Tiranë
19	61	19/02/2020	27,852	ZVAP Tiranë
20	69	19/02/2020	880	ZVAP Tiranë
21	128	22/04/2020	4,048	ZVAP Tiranë
22	129	22/04/2020	235,372	ZVAP Tiranë
23	130	22/04/2020	110,298	ZVAP Tiranë
24	132	22/04/2020	4,519,258	ZVAP Tiranë
25	131	06/05/2020	3,587,036	ZVAP Tiranë
26	164	27/05/2020	3,878,072	ZVAP Tiranë
27	97	11/04/2019	584,822	ZVAP Durrës
28	98	11/04/2019	336,268	ZVAP Durrës
29	100	15/04/2019	107,268	ZVAP Durrës
30	101	15/04/2019	229,000	ZVAP Durrës
31	96	11/04/2019	2,021,958	ZVAP Durrës
32	93	10/04/2019	9,608,350	ZVAP Durrës
33	176	21/06/2019	501,588	ZVAP Durrës
34	177	21/06/2019	319,951	ZVAP Durrës
35	168	21/06/2019	957,734	ZVAP Durrës
36	174	21/06/2019	1,689,602	ZVAP Durrës
37	175	21/06/2019	1,321,663	ZVAP Durrës
38	368	12/12/2019	8,814,560	ZVAP Durrës
39	369	12/12/2019	1,392,975	ZVAP Durrës
40	370	12/12/2019	1,062,865	ZVAP Durrës

41	371	12/12/2019	209,342	ZVAP Durrës
42	372	12/12/2019	246,395	ZVAP Durrës
43	396	31/12/2019	41,760	ZVAP Durrës
44	400	31/12/2019	47,751	ZVAP Durrës
45	39	18/02/2020	490,917	ZVAP Durrës
46	40	18/02/2020	266,200	ZVAP Durrës
47	65	11/03/2020	3,322,637	ZVAP Durrës
48	111	22/04/2020	454,100	ZVAP Durrës
49	114	22/04/2020	617,493	ZVAP Durrës
50	110	22/04/2020	6,855,937	ZVAP Durrës
51	191	07/07/2020	635,466	ZVAP Durrës
52	189	07/07/2020	72,817	ZVAP Durrës
53	186	07/07/2020	873,197	ZVAP Durrës
54	112	22/04/2020	77,611	ZVAP Durrës
55	113	22/04/2020	98,236	ZVAP Durrës
56	91	13/12/2019	1,647,657	ZVAP Shijak
57	92	13/12/2019	72,624	ZVAP Shijak
58	93	13/12/2019	476,592	ZVAP Shijak
59	94	13/12/2019	36,312	ZVAP Shijak
60	95	13/12/2019	22,695	ZVAP Shijak
61	96	13/12/2019	40,851	ZVAP Shijak
62	36	09/03/2020	1,350,931	ZVAP Shijak
63	37	09/03/2020	19,200	ZVAP Shijak
64	39	09/03/2020	169,930	ZVAP Shijak
65	40	09/03/2020	20,610	ZVAP Shijak
66	81	05/06/2020	20,410	ZVAP Shijak
67	82	05/06/2020	20,410	ZVAP Shijak
68	84	08/06/2020	3,449,213	ZVAP Shijak
69	98	23/07/2020	66,878	ZVAP Shijak
70	99	23/07/2020	20,292	ZVAP Shijak
71	100	23/07/2020	45,696	ZVAP Shijak
72	102	23/07/2020	79,061	ZVAP Shijak
73	41	20/02/2019	713,092	ZVAP Kavajë
74	46	20/02/2019	321,800	ZVAP Kavajë
75	65	19/03/2019	746,672	ZVAP Kavajë
76	72	28/03/2019	344,370	ZVAP Kavajë
77	100	16/04/2019	329,510	ZVAP Kavajë
78	101	16/04/2019	23,560	ZVAP Kavajë
79	102	16/04/2019	19,190	ZVAP Kavajë
80	103	16/04/2019	11,970	ZVAP Kavajë
81	126	16/05/2019	772,512	ZVAP Kavajë
82	131	28/05/2019	256,390	ZVAP Kavajë
83	132	28/05/2019	18,544	ZVAP Kavajë
84	133	28/05/2019	14,089	ZVAP Kavajë

85	134	28/05/2019	7,272	ZVAP Kavajë
86	135	28/05/2019	352,660	ZVAP Kavajë
87	136	28/05/2019	24,800	ZVAP Kavajë
88	137	28/05/2019	20,200	ZVAP Kavajë
89	138	28/05/2019	11,200	ZVAP Kavajë
90	156	21/06/2019	1,087,068	ZVAP Kavajë
91	157	21/06/2019	365,693	ZVAP Kavajë
92	158	21/06/2019	30,080	ZVAP Kavajë
93	159	21/06/2019	20,429	ZVAP Kavajë
94	160	21/06/2019	10,542	ZVAP Kavajë
95	161	21/06/2019	507,230	ZVAP Kavajë
96	162	21/06/2019	41,000	ZVAP Kavajë
97	163	21/06/2019	29,290	ZVAP Kavajë
98	164	21/06/2019	16,240	ZVAP Kavajë
99	279	22/11/2019	1,385,032	ZVAP Kavajë
100	282	22/11/2019	298,396	ZVAP Kavajë
101	302	10/12/2019	1,174,096	ZVAP Kavajë
102	305	10/12/2019	205,047	ZVAP Kavajë
103	306	10/12/2019	10,472	ZVAP Kavajë
104	342	31/12/2019	612,568	ZVAP Kavajë
105	345	31/12/2019	126,960	ZVAP Kavajë
106	346	31/12/2019	7,392	ZVAP Kavajë
107	35	19/02/2020	1,104,664	ZVAP Kavajë
108	36	19/02/2020	115,512	ZVAP Kavajë
109	99	15/05/2020	1,391,632	ZVAP Kavajë
110	100	15/05/2020	286,699	ZVAP Kavajë
111	63	18/03/2019	62,241	ZVAP Mat
112	64	18/03/2019	26,130	ZVAP Mat
113	65	18/03/2019	7,054	ZVAP Mat
114	66	18/03/2019	19,640	ZVAP Mat
115	67	19/03/2019	137,344	ZVAP Mat
116	69	19/03/2019	15,197	ZVAP Mat
117	70	19/03/2019	38,377	ZVAP Mat
118	71	19/03/2019	870,725	ZVAP Mat
119	72	19/03/2019	232,002	ZVAP Mat
120	73	19/03/2019	59,310	ZVAP Mat
121	74	19/03/2019	166,134	ZVAP Mat
122	78	25/03/2019	5,349,456	ZVAP Mat
123	114	18/04/2019	89,054	ZVAP Mat
124	115	18/04/2019	26,041	ZVAP Mat
125	116	18/04/2019	9,870	ZVAP Mat
126	118	18/04/2019	421,452	ZVAP Mat
127	119	18/04/2019	129,885	ZVAP Mat
128	120	18/04/2019	30,380	ZVAP Mat

129	121	18/04/2019	80,064	ZVAP Mat
130	122	18/04/2019	3,061,867	ZVAP Mat
131	148	13/05/2019	2,513,983	ZVAP Mat
132	179	11/06/2019	76,308	ZVAP Mat
133	180	11/06/2019	25,924	ZVAP Mat
134	181	11/06/2019	9,400	ZVAP Mat
135	182	11/06/2019	20,371	ZVAP Mat
136	183	11/06/2019	413,226	ZVAP Mat
137	184	11/06/2019	136,313	ZVAP Mat
138	185	11/06/2019	25,164	ZVAP Mat
139	186	11/06/2019	76,231	ZVAP Mat
140	193	21/06/2019	123,162	ZVAP Mat
141	194	21/06/2019	43,544	ZVAP Mat
142	195	21/06/2019	12,512	ZVAP Mat
143	196	21/06/2019	35,996	ZVAP Mat
144	197	21/06/2019	576,623	ZVAP Mat
145	198	21/06/2019	187,633	ZVAP Mat
146	199	21/06/2019	37,166	ZVAP Mat
147	200	21/06/2019	115,283	ZVAP Mat
148	201	21/06/2019	2,888	ZVAP Mat
149	202	21/06/2019	887	ZVAP Mat
150	203	21/06/2019	406	ZVAP Mat
151	204	21/06/2019	456	ZVAP Mat
152	219	04/07/2019	3,765,946	ZVAP Mat
153	239	13/08/2019	1,195,168	ZVAP Mat
154	322	06/11/2019	19,516	ZVAP Mat
155	323	06/11/2019	19,395	ZVAP Mat
156	324	06/11/2019	6,902	ZVAP Mat
157	325	06/11/2019	6,840	ZVAP Mat
158	326	06/11/2019	214,634	ZVAP Mat
159	327	06/11/2019	62,675	ZVAP Mat
160	328	06/11/2019	13,680	ZVAP Mat
161	329	06/11/2019	20,939	ZVAP Mat
162	321	06/11/2019	1,875,942	ZVAP Mat
163	346	19/11/2019	12,276	ZVAP Mat
164	347	19/11/2019	10,452	ZVAP Mat
165	348	19/11/2019	11,176	ZVAP Mat
166	349	19/11/2019	12,276	ZVAP Mat
167	350	19/11/2019	161,429	ZVAP Mat
168	351	19/11/2019	57,881	ZVAP Mat
169	352	19/11/2019	17,439	ZVAP Mat
170	353	19/11/2019	28,832	ZVAP Mat
171	374	12/12/2019	100,172	ZVAP Mat
172	375	12/12/2019	48,803	ZVAP Mat

173	376	12/12/2019	18,105	ZVAP Mat
174	377	12/12/2019	26,987	ZVAP Mat
175	378	12/12/2019	79,440	ZVAP Mat
176	379	12/12/2019	29,727	ZVAP Mat
177	380	12/12/2019	5,610	ZVAP Mat
178	381	12/12/2019	8,211	ZVAP Mat
179	383	13/12/2019	1,165,722	ZVAP Mat
180	400	22/01/2020	15,455	ZVAP Mat
181	401	22/01/2020	12,555	ZVAP Mat
182	402	22/01/2020	6,855	ZVAP Mat
183	403	22/01/2020	7,800	ZVAP Mat
184	36	11/02/2020	31,631	ZVAP Mat
185	37	11/02/2020	15,980	ZVAP Mat
186	38	11/02/2020	9,140	ZVAP Mat
187	39	11/02/2020	9,640	ZVAP Mat
188	40	11/02/2020	411,912	ZVAP Mat
189	41	11/02/2020	131,139	ZVAP Mat
190	42	11/02/2020	43,594	ZVAP Mat
191	43	11/02/2020	77,275	ZVAP Mat
192	68	19/03/2020	51,097	ZVAP Mat
193	65	24/03/2020	35,231	ZVAP Mat
194	66	24/03/2020	16,740	ZVAP Mat
195	67	24/03/2020	9,140	ZVAP Mat
196	68	24/03/2020	10,400	ZVAP Mat
197	69	24/03/2020	1,181,742	ZVAP Mat
198	86	21/04/2020	64,242	ZVAP Mat
199	87	21/04/2020	174,636	ZVAP Mat
200	88	21/04/2020	38,750	ZVAP Mat
201	89	21/04/2020	192,182	ZVAP Mat
202	85	21/04/2020	499,023	ZVAP Mat
203	90	22/04/2020	7,272	ZVAP Mat
204	91	22/04/2020	5,022	ZVAP Mat
205	92	22/04/2020	2,742	ZVAP Mat
206	93	22/04/2020	3,120	ZVAP Mat
207	117	22/05/2020	258,740	ZVAP Mat
208	118	22/05/2020	85,618	ZVAP Mat
209	119	22/05/2020	30,384	ZVAP Mat
210	120	22/05/2020	35,308	ZVAP Mat
211	122	22/05/2020	31,067	ZVAP Mat
212	123	22/05/2020	753,112	ZVAP Mat
213	141	05/06/2020	1,060,257	ZVAP Mat
214	172	08/07/2020	21,238	ZVAP Mat
215	173	08/07/2020	15,444	ZVAP Mat
216	174	08/07/2020	4,680	ZVAP Mat

217	175	08/07/2020	12,402	ZVAP Mat
218	176	08/07/2020	158,629	ZVAP Mat
219	177	08/07/2020	50,271	ZVAP Mat
220	178	08/07/2020	17,732	ZVAP Mat
221	179	08/07/2020	23,764	ZVAP Mat
222	95	25/02/2019	1,147,704	ZVAP Dibër
223	96	25/02/2019	368,398	ZVAP Dibër
224	97	25/02/2019	37,412	ZVAP Dibër
225	98	25/02/2019	97,104	ZVAP Dibër
226	149	21/03/2019	1,513,944	ZVAP Dibër
227	150	21/03/2019	420,538	ZVAP Dibër
228	151	21/03/2019	39,600	ZVAP Dibër
229	152	21/03/2019	121,732	ZVAP Dibër
230	210	23/04/2019	1,729,626	ZVAP Dibër
231	211	23/04/2019	496,694	ZVAP Dibër
232	212	23/04/2019	37,244	ZVAP Dibër
233	213	23/04/2019	110,876	ZVAP Dibër
234	264	24/05/2019	1,706,456	ZVAP Dibër
235	265	24/05/2019	497,508	ZVAP Dibër
236	266	24/05/2019	36,856	ZVAP Dibër
237	267	24/05/2019	113,052	ZVAP Dibër
238	319	21/06/2019	37,244	ZVAP Dibër
239	320	21/06/2019	196,230	ZVAP Dibër
240	321	21/06/2019	1,864,708	ZVAP Dibër
241	538	25/10/2019	893,934	ZVAP Dibër
242	539	25/10/2019	653,096	ZVAP Dibër
243	540	25/10/2019	113,674	ZVAP Dibër
244	541	25/10/2019	43,140	ZVAP Dibër
245	631	10/12/2019	2,079,493	ZVAP Dibër
246	632	10/12/2019	599,316	ZVAP Dibër
247	633	10/12/2019	40,512	ZVAP Dibër
248	634	10/12/2019	172,622	ZVAP Dibër
249	637	11/12/2019	607,248	ZVAP Dibër
250	36	22/01/2020	2,006,238	ZVAP Dibër
251	71	10/02/2020	786,868	ZVAP Dibër
252	72	10/02/2020	221,598	ZVAP Dibër
253	73	10/02/2020	65,076	ZVAP Dibër
254	78	20/02/2020	606,456	ZVAP Dibër
255	119	13/03/2020	1,581,556	ZVAP Dibër
256	166	16/04/2020	1,581,556	ZVAP Dibër
257	217	13/05/2020	851,156	ZVAP Dibër
258	218	13/05/2020	76,200	ZVAP Dibër
259	219	13/05/2020	151,520	ZVAP Dibër
260	220	13/05/2020	146,150	ZVAP Dibër

261	221	13/05/2020	134,430	ZVAP Dibër
262	421	21/10/2020	122,278	ZVAP Dibër
263	422	21/10/2020	547,020	ZVAP Dibër
264	423	21/10/2020	115,964	ZVAP Dibër
265	423	22/10/2020	72,938	ZVAP Dibër
266	424	22/10/2020	479,706	ZVAP Dibër
267	222	13/05/2020	264,720	ZVAP Dibër
268	5	24/01/2019	1,408,360	ZVAP Bulqizë
269	10	12/02/2019	1,519,724	ZVAP Bulqizë
270	19	18/03/2019	253,740	ZVAP Bulqizë
271	24	25/03/2019	218,380	ZVAP Bulqizë
272	32	24/04/2019	1,398,722	ZVAP Bulqizë
273	49	24/05/2019	1,700,000	ZVAP Bulqizë
274	60	12/06/2019	526,249	ZVAP Bulqizë
275	74	17/07/2019	1,805,283	ZVAP Bulqizë
276	118	26/11/2019	1,873,202	ZVAP Bulqizë
277	35	22/04/2020	2,377,452	ZVAP Bulqizë
Shuma			**166,966,545**	

Aneksi nr. 3 - Qasja dhe metodologjia e auditimit

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar deri në të lartë. Kjo, nisur kryesisht nga fakti që kemi të bëjmë me një institucion të krijuar në vitin 2019.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër-shpenzimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht ne pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogarinë 602 u vlerësua 0.7; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

Për vitin 2019:

Struktura buxhetore (2019)	Baza e materialitetit	Materialiteti 2%	Precizioni 10%	Faktori i Riskut	Minimumi i çështjeve për shqyrtim
Paga (600)	4,684,967	93,699	75,896	0.7	43
Sigurime Shoqërore (601)	783,726	15,675	12,696	0.7	43
Mallra e Shërbime (602)	153,190,340	3,063,807	2,481,684	0.7	43
Total	**158,659,033**	**3,173,181**			**130**

Për vitin 2020:

Struktura buxhetore (2020)	Shuma	Materialiteti 2%	Precizioni 10%	Faktori i Riskut	Minimumi i çështjeve për shqyrtim
Paga (600)	6,285,364	125,707	101,823	0.7	43
Sigurime Shoqërore (601	1,054,423	21,088	17,082	0.7	43
Mallra e Shërbime (602)	74,325,504	1,486,510	1,204,073	0.7	43
Total	**81,665,291**	**1,633,306**			**130**

Materialiteti i përllogaritur për periudhën për vitin 2019, është në vlerën 3,173,181 lekë, ndërsa për vitin 2020 është në vlerën 1,633,306 lekë. Nisur nga fakti që shpenzimet për investime për periudhën objekt auditimit janë 0 (zëro), nuk janë shënuar në tabelën e mësipërme.

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga (llogaria 600)

Klasa 6 (llogaria 600)	Pagat faktike	Mbuluar me auditim (lekë)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2019	**4,684,967**	**3,877,946**	82%
Viti 2020	**6,285,364**	**3,286,834**	52%

Duke qenë së struktura e miratuar e DRAP Durrës përbëhet nga vetëm 15 persona, grupi i auditimit për të arritur sigurinë e arsyeshme mori në shqyrtim të gjithë pagat e punonjësve, sipas plotësimit të strukturës, shtirë në muajt si vijon:

Nr	Viti 2019	Llogaria 600
1	Maj	531,640
2	Qershor	576,102
3	Korrik	567,817
4	Gusht	557,315
5	Tetor	517,403
7	Nëntor	558,769
8	Dhjetor	568,900
Total audituar		**3,877,946**

Duke qenë së struktura e miratuar e DRAP Durrës përbëhet nga vetëm 15 persona, grupi i auditimit për të arritur sigurinë e arsyeshme mori në shqyrtim të gjithë pagat e punonjësve, sipas plotësimit të strukturës, shtirë në muajt si vijon:

Nr	Viti 2020	Llogaria 600
1	Janar	607,206
2	Shkurt	603,573
3	Mars	609,198
4	Maj	609,471
5	Korrik	857,386
	Total audituar	**3,286,834**

2. Mbulimi me auditim i shpenzimeve operative (llogaria 602) dhe prokurimeve

Grupi i auditimit, pasi mori të dhëna në lidhje me shpenzimet e kryera (Regjistrat e Realizimit dhe Parashikimit) nga DRAP Durrës dhe 12 ZVAP nën varësinë e saj, nisur nga kriteri i vlerës më të lartë[54], përzgjodhi për auditim njësitë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Njësia	Viti 2019	Viti 2020	Shuma	Fondet e përfshira në auditim	Fondet e audituara	Përqindja e fondeve të audituara	Përqindja e fondeve totale
1	ZVAP Durrës	31,978,208	14,052,904	46,031,112	46,031,112	45,308,463	98%	98%
2	ZVAP Tiranë	24,275,163	14,055,004	38,330,167	38,330,167	34,160,038	89%	89%
3	ZVAP Mat	25,869,904	5,827,451	31,697,355	31,697,355	29,884,835	94%	94%
4	ZVAP Dibër	18,175,172	8,773,524	26,948,696	26,948,696	25,587,391	95%	95%
5	ZVAP Krujë	13,336,020	8,607,016	21,943,036	0	0	0%	0%
6	ZVAP Bulqizë	11,614,937	2,717,402	14,332,339	14,332,339	13,081,112	91%	91%
7	ZVAP Kavajë	10,362,453	3,420,283	13,782,736	13,782,736	12,813,873	93%	93%
8	ZVAP Shijak	2,596,731	6,532,631	9,129,362	9,129,362	7,559,362	83%	83%

[54] Sqaruar më hollësisht në Letrën e punës nr. 16, datë 06.11.2020.

9	DRAP Durrës	8,380,502	188,547	8,569,049	8,569,049	7,000,000	82%	82%
10	ZVAP Kamëz	3,503,273	3,176,720	6,679,993	0	0	0%	0%
11	ZVAP Vorë	1,715,615	4,099,577	5,815,192	0	0	0%	0%
12	ZVAP Rrogozhinë	1,161,440	2,499,013	3,660,453	0	0	0%	0%
13	ZVAP Klos	220,922	375,432	596,354	0	0	0%	0%
SHUMA		**153,190,340**	**74,325,504**	**227,515,844**	**188,820,816**	**175,395,074**	**93%**	**77%**

Siç rezulton dhe nga tabela e mësipërme, janë përzgjedhur për auditim DRAP Durrës dhe ZVAP Durrës, Tiranë, Mat, Dibër, Bulqizë, Kavajë dhe Shijak. Fondet e këtyre subjekteve së bashku, përbëjnë 83% të fondeve në total.
Në total, janë audituar 93% e fondeve të marra nën auditim, ose 77% e fondeve total.

Për vitin 2019, grupi i auditimit auditoi 182 transaksione, ndërsa për vitin 2020, auditoi 98 transaksione, duke tejkaluar numrin minimal prej 43 çështjesh.

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e prokurimeve u krye ***së pari*** nisur nga vlera e procedurave. Konkretisht, në DRAP Durrës dhe ZVAP e audituara (Durrës, Tiranë, Kavajë, Shijak, Mat, Dibër dhe Bulqizë), u audituan procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:

Viti	**Nr. i procedurave të realizuara**	**Vlera**	**Nr . i procedurave të audituara**	**Vlera**	**Mbulimi në %**
Viti 2019	35	51,409,658	8	43,528,495	85%
Viti 2020	13	1,641,607	0	0	0%

Nisur nga kriteri i vlerës më të lartë, grupi i auditimit përzgjodhi për të audituar 8 procedura me vlerë totale, të cilat përbëjnë 82% të vlerës totale të procedurave të zhvilluara nga DRAP Durrës dhe ZVAP e përfshira në auditim (Durrës, Tiranë, Shijak, Kavajë, Mat, Bulqizë dhe Dibër).
Për vitin 2020, nga DRAP Durrës dhe ZVAP e marra nën auditim, janë zhvilluar gjithsej 13 procedura prokurimi me vlerë të vogël (nga 5,000 lekë më e vogla deri te 300,500 lekë procedura me vlerën më të lartë). Nisur nga vlerat e vogla jomateriale, këto procedura nuk u përfshinë nën auditim.

Aneksi nr. 4. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
Nga faqja nr. 53 deri në nr. 213 e Raportit Përfundimtar
Aneksi nr.4.1 – Komandimet e Drejtorëve të IPAP në ZVAP Tiranë

1	HAMDI MANCAKU	XH.M.	KOMANDUAR	19.12.2019	DREJTOR	Mësues	Nuk ka Zv.Drejtor
2	HAMDI MANCAKU	Y.H.	TRANSFERUAR NE SHKOLLEN 9-VJ. ARBANE	01.10.2019	DREJTOR		
3	ARBANË	Y.H.	KOMANDUAR	01.10.2019	DREJTOR	Drejtor në shkollën Hamdi Mancaku.	Nuk ka N.drejtor
4	ARBANË	E.T.	TRANSFERUAR NE SHKOLLEN 9-VJ. ARBANE	16.10.2019	DREJTOR		
5	PEZË E VOGËL	E.C.	KOMANDUAR	10.09.2019	DREJTOR	Mësuese në shkollën Pezë e Vogël.	Nuk ka N.drejtor
6	PEZË E VOGËL	E.H.	PENSION	31.08.2019	DREJTOR		
7	FERRAJ	R.K.	KOMANDUAR	27.01.2020	DREJTOR	Mësuese në shkollën Ferraj.	Nuk ka N.drejtor
8	FERRAJ	D.LL.	LARGUAR	27.01.2020	DREJTOR		
9	SADIK STAVILECI	SH.U.	KOMANDUAR	22.07.2020	DREJTOR	Mësuese në Sadik Stavileci.	Nuk ka N.drejtor
10	SADIK STAVILECI	F.L.	PENSION	20.07.2020	DREJTOR		
11	BEDRI LLAGAMI	E.T.	KOMANDUAR	16.10.2019	DREJTOR	Drejtore në Arbanë.	Ka nje N.Drejtor
12	BEDRI LLAGAMI	M.K.	TRANSFERUAR NE SHKOLLEN 9-VJ. NIKET DARDANI	18.09.2019	DREJTOR		
13	16 SHTATORI	A.A.	KOMANDUAR	23.12.2019	DREJTOR	N/Dr në shkollën 16 shtatori	
14	16 SHTATORI	L.H.	TRANSFERUAR NE SHKOLLEN 9-VJ. KOLË JAKOVA	14.01.2020	DREJTOR		
15	DËSHMORËT E LIRISE	M.M.	KOMANDUAR	16.04.2020	DREJTOR	N/Dr në shkollën Dëshmorët e Lirisë	
16	DËSHMORËT E LIRISE	A.D.	DORËHEQJE	14.04.2020	DREJTOR		
17	FAN NOLI	J.L.	KOMANDUAR	03.10.2019	DREJTOR	N/Dr në shkollën Fan Noli	
18	FAN NOLI	T.N.	PENSION	30.09.2019	DREJTOR		
19	HASAN PRISHTINA	T.D.	KOMANDUAR	24.01.2020	DREJTOR	Jashte sistemi/me 04.12.2019 jep dorëheqjen nga Drejtore tek Sami Frashëri.	Ka dy N.drejtor
20	HASAN PRISHTINA	B.E.	PENSION	23.01.2020	DREJTOR		
21	Inst.I nxenesve qe nuk shikojne	V.J.	KOMANDUAR	03.02.2020	DREJTOR	Mësuese në shkollën, Inst.i nxenesve qe nuk shikojne.	Ka nje N.Drejtor
22	Inst.I nxenesve qe nuk shikojne	N.A.	DORËHEQJE	15.01.2020	DREJTOR		
23	JERONIM DE RADA	S.C.	KOMANDUAR	26.08.2020	DREJTOR	N.Dr ne shkollen Jeronim de Rada	
24	JERONIM DE RADA	R.K.	DORËHEQJE	26.08.2020	DREJTOR		
25	KONGRESI I LUSHNJES	A.Z.	KOMANDUAR	29.06.2020	DREJTOR	Mësuese në shkollën Kongresi i Lushnjes.	Nuk ka N.Drejtor te tjere.[55]
26	KONGRESI I LUSHNJES	O.M.	DORËHEQJE	03.06.2020	DREJTOR		
27	KOL JAKOVA	L.H.	KOMANDUAR	14.01.2020	DREJTOR	Drejtore ne shkollen 16 Shtatori.	Ka nje N.Drejtor

[55] N.Dr A.S doli ne pension me dt. 15.07.2020.

28	KOL JAKOVA	I.K.	ZBRITJE NË DETYRË ZV.DREJTORE NE SHKOLLEN Fan Noli	10.01.2020	DREJTOR		
29	LIDHJA E PRIZRENIT	S.J.	KOMANDUAR	10.09.2019	DREJTOR	Drejtore në shkollën Niket Dardani.	Ka dy N.Dr
30	LIDHJA E PRIZRENIT	H.D.	PENSION	31.08.2019	DREJTOR		
31	MURAT TOPTANI	M.K.	KOMANDUAR	28.05.2019	DREJTOR	Jashtë sistemi. Ka punuar mësuese ne ZA Kruje.	Nuk ka N.Drejtor
32	MURAT TOPTANI	L.B.	DORËHEQJE, EMËROHET NE DPAP	15.05.2019	DREJTOR		
33	MUSTAFA GREBLLESHI	M.Q.	KOMANDUAR	24.07.2020	DREJTOR	Mësuese në shkollën Mustafa Grebllleshi.	Nuk ka N.Drejtor
34	MUSTAFA GREBLLESHI	XH.J.	PENSION	20.07.2020	DREJTOR		
35	NIKET DARDANI	M.K.	KOMANDUAR	18.09.2019	DREJTOR	Drejtore në shkollën Bedri Llagami.	Nuk ka N.Drejtor
36	NIKET DARDANI	S.J.	TRANSFERUAR NE SHKOLLEN 9-VJ. LIDHJA E PRIZRENIT	10.09.2019	DREJTOR		
37	SKENDER LUARASI	GJ.N.	KOMANDUAR	17.09.2019	DREJTOR	Mësuese në shkollën 9-vj.Gjergj Fishta.	Ka dy N.Drejtor
38	SKENDER LUARASI	A.P.	KALON ZV.DR TEK NAIM FRASHERI	17.09.2019	DREJTOR		
39	A.Z.CAJUPI	A.D.	KOMANDUAR	24.07.2020	DREJTOR	Zv.Dr në gjimnazin A.Z.Çajupi	
40	A.Z.CAJUPI	M.SH.	PENSION	20.07.2020	DREJTOR		
41	QEMAL STAFA	K.J.	EMËRUAR	15.09.2020	DREJTOR	Drejtore në shkollën Gustav Mayer	
42	QEMAL STAFA	N.G.	DORËHEQJE	12.12.2019	DREJTOR		
43	QEMAL STAFA	B.B.	ZËVENDESIM I PËRKOHSHËM	03.02.2020	DREJTOR	Zv.Dr në gjimnazin Qemal Stafa	
44	SAMI FRASHERI	M.Z.	KOMANDUAR	09.12.2019	DREJTOR	Zv.Dr në gjimnazin Sami Frashëri	
45	SAMI FRASHERI	M.Z.	EMËRUAR	15.09.2020	DREJTOR		
46	SAMI FRASHERI	T.D.	DORËHEQJE	04.12.2020	DREJTOR		

Aneksi nr. 4.2– Vendimet gjyqësore në proces 2019-2020

		Palet		Shkalla e pare			Ankimim	Apeli			Rekurs
Nr.	Viti I fillimit	Padites	I paditur	Gjykata	Nr. date	Dispozitivi		Gjykata	Nr. date	Dispozitivi	
1	2020	E.M.	ZVAT + shkolla artistike "Jordan Misja", Tirane	Gjykata e Shkalles se Pare Tirane	Ne proces gjykimi						
2	2019	F.G.	ZVAT + shkolla 9 - vjecare "Marie Logoreci", Tirane	Gjykata e Shkalles se Pare Tirane	Ne proces gjykimi						
3	2019	A.V.	ZVAT + shkolla 9 - vjecare "Avni Rustemi", Tirane	Gjykata e Shkalles se Pare Tirane	Ne proces gjykimi						

4	2019	R.Sh.S.	ZVAT (ceshtje e ardhur nga drejtoria arsimore e qarkut Tirane)	Gjykata e shkalles se pare Tirane	Nr.6272, date 26,09,2019	Pranim pjeserisht te kerkese padise. Rikthim ne pune pagen nga data 01,09,2017 deri ne rikthim ne pune.	ZVAT Nr.4988, date 21,11,2019				
5	2018	A.T.	DART dhe shkolla e arsimit 9 - vjecar "Konferenca e Pezes", Tirane	Gjykata e shkalles se pare Tirane	Nr.10742, date 27,12,2018	Rrezim padie	Ankimon pala paditese.				
6	2018	F.L.	DART	Gjykata e shkalles se pare Tirane	Nr.2941, date 29,03,2018	Rrezim padie	Ankimon pala paditese.				
7	2018	E.M.	DART + Shkolla e arsimit 9 - vjecar "Kongresi I Manastririt", Tirane	Gjykata e shkalles se Pare Tirane	Nr.2551, date 08.04.2019	Rrezim I kerkese padise	Ankimon pala paditese				
8	2016	V.P.	DART dhe shkolla e arsimit 9 - vjecar "Nikete Dardani", Tirane	Gjykata Administrative Tirane	Nr.5508, date 21,11,2016	Rrezim I kerkese padise	Ankimon pala paditese	Gjykata Administriteve e Apelit Tirane	date 14,07,2017	Lenien ne fuqi te Vendimit Nr.35508, date 21,41,2016 te Gjykates Administrative Tirane	Rekurs pala paditese
9	2015	I.P.	DART Shkolla e arsimit 9 - vjecar "Hasan Prishtina", Tirane	Gjykata Administrative Tirane	Nr.80-2015-2828, date 21,09,2015	Rrezim I kerkese padise	Ankimon pala paditese	Gjykata Administriteve e Apelit Tirane	Nr.3993, date 08,11,2018	Lenien ne fuqi te Vendimit Nr.80-2015-2828, date 21,09,2015te Gjykates Administrative Tirane	Rekurs pala paditese
10	2009	A.K.	DART + M.Z., Drejtoreshe e shkolles se mesme Teknike Ekonomike, Tirane	Gjykata e shkalles se Pare Tirane	Nr. 6553, date 13.09.2010	pranimin pjeserisht te kerkese padise. dëmshpërblim page ne masën 22,5 paga mujore dhe pagimin e demit moral nga M.Z. ne vlerën 2,500,000 leke	DART 2010	Gjykata e Apelit Tirane	Nr.2460, date 17,11,2011	Prishjen e vendimit Nr. 6553, date 13.09.2010 te Gjykatës e shkalles se Pare Tirane dhe rikthimin për rigjykim	
				Gjykata e shkalles se Pare Tirane	Nr. 3283, date 05.04.2012	Kthimin e kërkesë padisë	Ankimon pala paditëse	Gjykata e Apelit Tirane	Nr.498, date 01,11,2012	Prishjen e vendimit Nr. 3283, date 05.04.2012 te Gjykatës e shkalles se Pare Tirane dhe rikthimin për rigjykim	

Aneksi nr. 4.3 – Matrica e procesit të përzgjedhjes së drejtorëve të IPAP

MASR	DPAP	DRAP Durrës	ZVAP-et	Komisioni i vlerësimit (K.V)
- Ministria përgjegjëse për arsimin -Emëron dhe liron nga detyra Drejtorin e DRAP -Kur nëpunësi largohet nga shërbimi civil, duhet të bëjë dorëzimin e detyrës tek eprori direkt.	-Emëron dhe liron nga detyra stafin e DRAP, drejtuesit dhe stafin e ZVAP-ve. -Siguron që veprimtaria e institucioneve arsimore parauniversitare të jetë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi -DPAP/DRAP dërgon përfaqësues të saj në konkurset për drejtor të IPAP	-Shpall vendet e lira për drejtor të IPAP, emëron dhe shkarkon drejtorët e IPAP. -Në 2 shpallje, për 69 vende të lira, certif. e Sh.D është kriter kualifikues. Në shpallje nuk përcaktohet se trajnimi i IZHA do të trajtohet i barazvlefshëm me atë të SH.D. -Në një rast, kur K.V ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.2, DRAP Durrës ka kërkuar masë për K.V. -DPAP/DRAP dërgon përfaqësues të saj në konkurset për drejtor të IPAP -DRAP shpall fituesin e konkursit për drejtor brenda 8 ditëve nga përcjellja e dokumentacionit nga ZVAP. -Kandidatët për drejtor nuk duhet të kenë masë disiplinore në fuqi.	-Publikojnë në faqen web vendet e lira për drejtor. - Urdhëron ngritjen e K.V. -I dorëzon dokumentacionin e aplikantëve K.V -Shqyrton dokumentacionin e dorëzuar nga K.V pas përfundimit të vlerësimit. E kthen atë, kur konstaton parregullsi. -2 ditë nga dorëzimi i dokumentacionit nga K.V, e përcjellë atë për fazën e intervistës në DRAP - Dosjet dhe dokumentet e konkurseve për drejtorit duhet të ruhen, protokollohen dhe arkivohen.	-Bën shqyrtimin paraprak të dosjeve të aplikantëve, (2 ditë), dhe njofton kandidatët për plotësimin e dokumentacionit që mungon duke i lënë afat 3 ditë. - Më pas, vlerëson me pikë dosjet, interviston dhe vlerëson kandidatët, shpall në këndin e njoftimeve në IPAP, tabelën e pikëve të secilit kandidatë. (3 ditë). -Pret ankesat e kandidatëve për 3 ditë, dhe i vlerëson ato brenda 1 dite. -I dorëzon ZVAP-it dosjet e aplikimit dhe vlerësimet e 2 kandidatëve me më shumë pikë. Dosjet e kandidatëve të tjerë arkivohen në IPAP.

MASR	DPAP	DRAP Durrës	ZVAP-et	Komisioni i vlerësimit
-27.02.2019- 28.01.2020 Ligji 69/2012, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 57 në kundërshtim me VKM 99. 28.01.2020- deri më sot Ligji 69/2012, i ndryshuar, në kundërshtim me VKM 99, dhe Udhëzimin nr. 2. -Drejtori i DRAP Durrës i komanduar që prej maj-it 2020. - Drejtori i ish-DAR Durrës nuk ka bërë dorëzim të detyrës.	-98% e stafit të DRAP dhe ZVAP-ve nën juridiksionin e saj vijon të jenë të komanduar. - Urdhri 246 i DPAP në kundërshtim me Ligjin 69/2012 dhe Udhëzimin nr.2 (certif. e Sh.D, prioritet) -Në 20 konkurse të audituara, nuk ka patur përfaqësues të DPAP.	-26% e drejtorëve të shkollave të 7 ZVAP-ve të audituara, janë të komanduar. -Ka intervistuar dhe shpallur fitues kandidatë që nuk ishin të certif. nga Sh.D. -Ka shpallur fitues kandidatë të pajisur vetëm me vërtetimin e IZHA. -Në 4 raste, kur K.V ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, nuk ka kërkuar masa. -Ka dërguar përfaqësues vetëm në 7 nga 20 konkurse të audituara. -Për 4 raste nuk ka respektuar afatet e shpalljes së fituesit, për 3 raste nuk ka informacion. -Ka komanduar në pozicionin drejtor, kandidat me masë disiplinore në fuqi.	-57% e ZVAP-e të audituara nuk kanë web. -Në ZVAP Tiranë, për 4 procedura, dokumentacionet K.V-së ia ka dorëzuar një punonjëse e cila nuk kishte nisur punë. - ZVAP-et kanë ngritur K.V jo me përfaqësues të emëruar nga Nj.Q.V -Në 3 ZVAP, nuk është dokumentuar shqyrtimi i dokumentacionit të K.V, në 2 ZVAP shqyrtimi nuk ka identifikuar parregullsitë e konstatuara nga auditimi. - Në 7 raste, ZVAP-t nuk ka respektuar afatet për përcjelljen e dokumentacionit në DRAP. -Dosjet e konkurseve janë të pa inventarizuara dhe shumë dokumente të paprotokolluara - Në 4 raste, ZVAP-et kanë lëshuar vërtetim për mospasje mase në fuqi për kandidatë, kur duhet të lëshoheshin nga DRAP ose IPAP	-Në 13 procedura konkurrimi, në 3 ZVAP-e, K.V nuk ka respektuar afatin për plotësimin e dokumentacionit që mungon nga kandidatët, po i kanë shkualifikuar ata menjëherë. -Në të 6-ta ZVAP-të e audituara, K.V kanë pranuar dhe kaluar në fazën tjetër kandidatë të cilët nuk ishin të certifikuar nga Sh.D. -Janë konstatuar raste kur K.V nuk kanë vlerësuar drejtë kandidatët. -Në 2 raste procesverbalet nuk janë firmosur nga të gjithë anëtarët e K.V. -Si rezultat që komisionet janë Ad-Hoc kandidatët i kanë paraqitur ankesa në ZVAP. Ato nuk rezultojnë të janë trajtuar.